
بسم الله الرحمن الرحیم

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i njëzet e një)

Nga ajeti 46 i sures "Ankebut" e deri te ajeti 30 i sures "Ahzab"

Titulli: *KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT*

(Xhuzi i njëzet e një)

Autori: *Eruditi, juristi dhe komentuesi*

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: *Vullnet MERJA*

E përktheu nga arabishtja: *Vullnet MERJA & Edmond ABAZI*

E redaktoi: *Esat BUNGURI, Liseda RAMAJ, Jerida KULLA*

Korrektura teknike: *Vjollca KARAJ*

Përkujdesja grafike: *Sabrie FEZA*

Kapaku: *Sabrie FEZA*

Botoi: *Shoqata "FLLADI"*

Copyright: *Shoqata "FLLADI"*

Shtypshkronja e shtëpisë botuese *LILO*

Ajetet 46 – 49

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

۞ وَلَا تُجَٰدِلُوٓاْ أَهۡلَ ٱلۡكِتَٰبِ إِلَّا بِٱلَّتِي هِيَ أَحۡسَنُ إِلَّا ٱلَّذِينَ ظَلَمُواْ
مِنۡهُمۡۖ وَقُولُوٓاْ ءَامَنَّا بِٱلَّذِيٓ أُنزِلَ إِلَيۡنَا وَأُنزِلَ إِلَيۡكُمۡ وَإِلَٰهُنَا وَإِلَٰهُكُمۡ
وَٰحِدٞ وَنَحۡنُ لَهُۥ مُسۡلِمُونَ ٤٦ وَكَذَٰلِكَ أَنزَلۡنَآ إِلَيۡكَ ٱلۡكِتَٰبَۚ فَٱلَّذِينَ
ءَاتَيۡنَٰهُمُ ٱلۡكِتَٰبَ يُؤۡمِنُونَ بِهِۦۖ وَمِنۡ هَٰٓؤُلَآءِ مَن يُؤۡمِنُ بِهِۦۚ وَمَا
يَجۡحَدُ بِـَٔايَٰتِنَآ إِلَّا ٱلۡكَٰفِرُونَ ٤٧ وَمَا كُنتَ تَتۡلُواْ مِن قَبۡلِهِۦ مِن كِتَٰبٖ
وَلَا تَخُطُّهُۥ بِيَمِينِكَۖ إِذٗا لَّٱرۡتَابَ ٱلۡمُبۡطِلُونَ ٤٨ بَلۡ هُوَ ءَايَٰتُۢ
بَيِّنَٰتٞ فِي صُدُورِ ٱلَّذِينَ أُوتُواْ ٱلۡعِلۡمَۚ وَمَا يَجۡحَدُ بِـَٔايَٰتِنَآ إِلَّا
ٱلظَّٰلِمُونَ ٤٩

"Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, e përjashtim të të padrejtëve! Dhe thoni: 'Ne besojmë në atë që na është zbritur neve dhe në atë që ju është zbritur juve. Zoti ynë dhe Zoti juaj është një - dhe ne Atij i nënshtrohemi si myslimanë.'"

"Kështu, Ne të kemi shpallur ty Librin. Ata që u kemi dhënë Shkrimet, e besojnë atë. Por ka edhe nga ata që e besojnë atë. Shpalljet Tona i mohojnë vetëm jobesimtarët."

"Para këtij, ti (Muhammed) **nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e së pavërtetës do të dyshonin."**

"Përkundrazi! Ai (Kur'ani) **është shpallje e qartë në zemrat e atyre, të cilëve u është dhënë dija. Shpalljet Tona i mohojnë vetëm të padrejtë."**

Komentimi

Ndiqni metodën më të mirë në dialog e në hulumtim

Në ajetet e mëparshme u fol më shumë për mënyrën e sjelljes me politeistët e pabindur dhe kokëfortë. Situata ishte e atillë që të përdoreshin fjalë të ashpra dhe ato që adhurojnë përveç All'llahut, janë më të dobëta se shtëpia e merimangës.

Ajetet në fjalë, flasin për diskutimet me ithtarët e Librit. Duhet që fjalët ndaj tyre të jenë të buta sepse ata, të paktën,

dëgjuan një pjesë të asaj që sollën të Dërguarit dhe librat e Zotit. Ata kanë më shumë aftësi për bashkëpunim logjik, sepse çdo njeriu duhet t'i flitet sipas dijes, mendjes dhe sjelljes së tij. Për këtë Kur'ani thotë: **"Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë…!"**.

Fraza *"tuxhadilu"* rrjedh nga fjala *"xhidalun"*, që në origjinalitet do të thotë lidhja e litarit dhe shtrëngimi i tij. Po ashtu, kjo fjalë përdoret për ndërtimin e fortë. Kur dy veta bisedojnë për një çështje të caktuar, në të vërtetë, secili prej tyre kërkon ta kundërshtojë shokun e tij nga besimi dhe nga mendimi i tij. Për këtë, kjo bisedë quhet diskutim. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe në mosmarrëveshje. Sido që të jetë, qëllimi i All'llahut në thënien **"ue la tuxhadilu" – "mos diskutoni"**, është për diskutim logjik. Thënia: **"me atë që është më e mira"**, është përmbledhëse dhe përfshin metodat, rrugët e drejta që janë në përputhje me hulumtimin, qoftë në thënie apo në përmbajtje; qoftë me të folur apo me shenja dhe lëvizje. Kështu që kuptimi i fjalisë së mëparshme është: Vërtet, fjalët tuaja duhet të jenë të sjellshme dhe me edukatë. Të jenë fjalë dashamirësie e respekti, që të përmbajnë argumente. Zëri juaj të jetë i qetë dhe jo i ashpër, të mos e tejkalojë kufirin e moralit e të etikës. Gjithashtu, edhe lëvizjet e duarve, të syve, të vetullave, të jenë të qeta dhe me edukatë. Sa e bukur kjo shprehje kur'anore, e cila përfshin një botë me kuptime të hollësishme në një fjali të shkurtër!

Të gjitha këto çështje janë për shkak të qëllimit pas diskutimit dhe hulumtimit. Në diskutim nuk kërkohet superioriteti dhe as ndalimi i palës tjetër. Qëllimi është që fjalët të jenë depërtuese në zemrën e palës tjetër. Rruga më e mirë për të arritur këtë qëllim është metoda kur'anore.

Shpesh ndodh që nëse njeriu arrin t'i sqarojë të vërtetën palës tjetër në atë mënyrë që e sheh të përshtatshme me mendimin e tij, shumë shpejt pala tjetër do të anojë kah ai dhe do t'i bashkëngjitet atij. Kjo sepse njerëzit kanë lidhje mendore me njëri-tjetrin njësoj si lidhjet e tyre me fëmijët e tyre.

Në shumë çështje Kur'ani përdor metotën e "pyetjes" që përgjigjen ta nxjerrë nga brenda mendimit të dëgjuesit dhe ky i fundit ta mendojë se është prej mendimit të tij.

Natyrisht që për çdo ligj ka përjashtime (klauzola). Prej këtyre ligjeve është edhe ligji i përgjithshëm në hulumtimin e diskutimit islam. Në disa raste mund të quhet dobësi, ose pala tjetër mund të jetë egoiste dhe të vepruarit njerëzor me të ia shton atij guximin për të keq, armiqësinë dhe mendjemadhësinë. Prandaj, Kur'ani thotë: **"...me përjashtim të padrejtëve..."**. Ata janë të padrejtë ndaj vetave të tyre dhe ndaj të tjerëve, që fshehën shumë prej argumenteve dhe shenjave të All'llahut me qëllim që njerëzit të mos njiheshin me cilësitë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.Urdhrat e All'llahut nuk përputheshin me interesat e tyre personale, kështu që i nëpërkëmbën dhe i shkelën me këmbët e tyre.

Janë të padrejtët që u besuan paganizmave dhe ishin si politeistët në besim, sepse thanë: Vërtet Mesihu është biri i Zotit apo Uzejri është biri i Zotit.

Së fundi, janë ata, të cilët bënë padrejtësi dhe u strehuan te shpata dhe forca, në vend të strehimit në hulumtimin logjik. Ata u mbështetën te djallëzia dhe intrigat ndaj Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Islamit. Ajeti përfundon me një të vërtetë të dukshme prej **diskutimit me atë**

që është më e mira, i cili mund të jetë shembëlltyrë për çdo hulumtim. Kur'ani i Shenjtë thotë: **"…Dhe thoni: 'Ne besojmë në atë që na është zbritur dhe në atë që ju është zbritur. Zoti ynë dhe Zoti juaj është një - dhe ne Atij i nënshtrohemi si myslimanë.'"**.

Sa e mrekullueshme kjo thënie! Sa bukur tingëllon melodia e saj! Melodia e unitetit dhe e besimit në çdo gjë që ka zbritur All'llahu i Vetëm e i Pashoq! Kjo thënie zhduk racizmin dhe thotë se ne dhe ju jemi monoteistë dhe Atij i nënshtrohemi.

Ky është një shembull i vetëm prej diskutimit me atë që është më e mira, e cila tërheq gjithkënd që e dëgjon dhe tregon se njeriu duhet të qëndrojë larg shkatërrimit. Thirrja e Islamit është thirrje për unitet dhe nënshtrim ndaj çdo thënieje të vërtetë.

Shembuj të këtij hulumtimi janë të shumtë në Kur'an. Prej tyre është edhe ajo që tregon *Imam* Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Diskutimi me atë që është më e mira është ajo, me të cilën All'llahu e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij, pra, që të diskutojë kështu me ata që mohojnë Ringjalljen."*. All'llahu i Urtë ka thënë: **"Thuaj: 'Do t'i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë; Ai që prej drurit të njomë bëri për ju zjarrin, të cilin e përdorni për të ndezur.'"**.[12]

Ajeti tjetër prej ajeteve në fjalë forcon katër parimet e përmendura më parë. Ajeti thotë: **"Kështu, Ne të kemi shpallur ty Librin…" (**Kur'anin). Sigurisht, ky Kur'an ka zbritur për të adhuruar vetëm All'llahun, për të vërtetuar thirrjen e të gjithë të

1 Sure "Ja Sin", ajetet 79-80.
2 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 163.

Dërguarve kah e vërteta dhe për nënshtrimin pa kushte para urdhrave të All'llahut dhe për diskutimin me atë që është më e mira.

Disa komentues kanë thënë: Qëllimi i fjalisë **"Kështu, Ne të kemi shpallur ty Librin…"** është shembëllsim i zbritjes së Kur'anit Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo ka kuptimin se ashtu siç ia zbritëm librat e Zotit të Dërguarve të mëparshëm, po ashtu ta zbresim edhe ty Librin!. Mirëpo, komentimi i mëparshëm na duket më i saktë, edhe pse mund të bashkohen të dy komentimet.

Pastaj Kur'ani shton e thotë: **"…Ata që u kemi dhënë Shkrimet, e besojnë atë…"**.

E besojnë të vërtetën e tij, sepse shenjat e ardhjes së Profetit i gjetën në librat e tyre. Po ashtu, edhe përbajtja e tij nga ana e parimeve të përgjithshme është në përputhje me librat e tyre.

Dihet se jo të gjithë ithtarët e Librit (jahudinj dhe të krishterë) i besuan profecisë së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Atëherë kjo fjali është e posaçme për atë grup besimtarësh, që ndjekin të vërtetën pa nervozizëm e pa racizëm. Për këtë ata e meritojnë të quhen "ithtarë të librit".

Pastaj Kur'ani thotë: **"…Por ka edhe nga ata që e besojnë atë…"**[1] prej banorëve të Mekës dhe politeistëve arabë.

1 Disa komentues kanë thënë se fjalia **"Atyre që u kemi zbritur Shpalljet Tona"** tregon për myslimanët. Dhe fjalia **"…Por ka edhe nga ata që e besojnë atë…"** tregon për ithtarët e Librit. Mirëpo, mesa duket, ky komentim është

Më pas Kur'ani flet për mosbesimin e dy grupeve prej jahudinjve dhe të krishterëve: **"Shpalljet Tona i mohojnë vetëm jobesimtarët."**.

Duke patur parasysh se kuptimi i fjalës *"xhuhud"* është që njeriu të besojë në diçka me zemrën e tij dhe ta mohojë atë me gjuhën e tij[1], atëherë kuptimi i fjalisë së mëparshme është se jobesimtarët e pohojnë me zemrat e tyre madhështinë e këtyre shenjave dhe mendojnë se janë shenja të vërteta. Po ashtu, ata besojnë se rruga e Profetit dhe jeta e tij janë të pastra e pasuesit e tij janë të sinqertë. Por i mohojnë për arsye të fanatizmit verbues, kokëfortësisë dhe imitimit të të parëve të tyre, me qëllim që të ruajnë interesat e veta personale. Për këtë, Kur'ani cakton qëndrimet e popujve të ndryshëm ndaj këtij Libri dhe i ndan në dy grupe:

Grupi i parë: Janë besimtarët, qofshin prej dijetarëve jahudinj apo të krishterë, apo besimtarë të vërtetë e të thjeshtë, apo janë idhujtarë të etur ndaj së vërtetës, të cilët e njohën të vërtetën dhe ajo u ngulit në zemrat e tyre.

Grupi i dytë: Janë mohuesit kokëfortë e të pabindur, të cilët e njohën të vërtetën, por e mohuan atë dhe e fshehën në brendinë e vetave të tyre, si lakuriqi i natës, sepse errësira e mosbesimit ishte pjesë e qenies dhe e ekzistencës së tyre. Ata i frikësoheshin dritës së besimit.

---

shumë i largët sepse fraza **"Atyre që u kemi zbritur shpalljet tona"** në Kur'an ka ardhur veçanërisht për jahudinjtë dhe të krishterët.

1 Ragib Asfahani, në librin e tij "El Mufredat", thotë: Fjala *"xhuhud"* (جحود) është mohim për atë çfarë ka në zemër. Konstatimi i tij dhe konstatimi i asaj që ndodhet në zemër është mohim.

Duhet thënë se ky grup ishte mohues edhe më parë. Ndoshta mund të thuhet se ata më parë nuk kishin argument. Mirëpo, pasi u erdhën argumentet, ata u bënë mohues të së vërtetës. Ata e njohën rrugën e drejtë dhe e kundërshtuan atë duke vazhduar ecjen në rrugën e humbjes.

Më poshtë Kur'ani shton duke treguar një shenjë tjetër prej shenjave të vërtetësisë së mesazhit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo shenjë është e qartë dhe forcuese e përmbajtjes së ajetit të mëparshëm: **"Para këtij, ti nuk kishe lexuar kurrfarë libri e as që kishe shkruar gjë me dorën tënde; përndryshe, ndjekësit e së pavërtetës do të dyshonin."**. Ata thanë se kjo që solli ky Profet është rezultat i asaj që kanë lexuar në librat e mëparshëm. Kuptimi i këtij ajeti është se ti o Muhammed kurrë nuk ke shkuar në ndonjë shkollë, as nuk ke shkruar më parë. Por, nëpërmjet Shpalljes arrite të njohësh çështje që janë më të përkryera se qindra shkolla.

Si mund të besohet që një njeri, i cili nuk dinte të lexonte e as nuk ka parë mësues e as shkollë, të sjellë një libër, i cili i sfidon të gjithë njerëzit dhe i fton të sjellin një të ngjashëm me të?! A nuk është ky argument i fuqisë tënde që buron nga fuqia e Krijuesit Fuqiplotë dhe ky Libër është i Shpalluar nga All'llahu?!

Nëse dikush pyet: "Si ta dimë që Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka mësuar asnjëherë në shkollë?

Ne i përgjigjemi se Profeti jetoi në një mjedis që të kulturuarit dhe mësuesit ishin të paktë. Thuhet së në Mekë kishte vetëm shtatëmbëdhjetë persona që dinin shkrim dhe këndim. Në

një shoqëri të tillë, sikur dikush të dëshironte të shkonte në shkollë për të mësuar shkrim e këndim, ishte e pamundur që të mos merrej vesh nga të gjithë banorët. Jo vetëm kaq, por do të ishte i njohur në çdo vend.

Si është e mundur që një njeri si Profeti, të thoshte se ishte i vërtetë, e në të njëjtën kohë, të thoshte gënjeshtra skandaloze, ndërkohë që këto ajete kanë zbritur në Mekë, në vendlindjen e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe që kanë zbritur në sy të armiqve të ashpër, të cilëve nuk u fshihej as gjëja më e vogël?!

Në ajetin pasardhës, gjendet një tjetër shenjë për të vërtetën e Kur'anit. Ai thotë: **"Përkundrazi! Ai** (Kur'ani) **është Shpallje e qartë në zemrat e atyre, të cilëve u është dhënë dija…"**.

Fraza *"ajatin bejjinatin"* – **"Shpallje e qartë"**, zbulon të vërtetën që argumentet e vërtetësisë së Kur'anit sqarohen vetvetiu dhe ndriçojnë të gjitha anët e tij. Në të vërtetë, ato janë si shenjat e krijimit, të cilat e bëjnë njeriun të përulet para të vërtetave të tij kur i sheh dhe i studion ato. Edhe shenjat legjislative janë të njëjta me ato të krijimit për nga pamja dhe përmbajtja, sepse ato janë argument i së vërtetës së tyre.

Pastaj, pas gjithë kësaj, pasuesit e këtyre ajeteve dhe studiuesit e tyre, zemrat e të cilëve janë të lidhura me këto shenja, janë të zotët e dijes, edhe pse mund të jenë duarbosh dhe këmbëzbathur.

Me fjalë më të qarta: Vërtet, një prej rrugëve të njohjes së prejardhjes së një medh'hebi është studimi i tij nga ana e besimtarëve. Nëse të paditurit dhe mashtruesit e rrethojnë një

person, ai është prej llojit të tyre. Por, nëse e rrethojnë ata të cilët i kanë kraharorët dhe zemrat të mbushuara me sekretet e dijes, ata janë besnikë ndaj tij. Ky është argument i vërtetësisë së këtij personi.

Ne kemi parë edhe një grup dijetarësh prej ithtarëve të Librit, edhe të devotshëm si Ebu Dherr El Gaffari, Selman Farisiun, Mikdadin, Ammar ibn Jasirin, si dhe njerëz të mëdhenj si Ali ibn ebu Talibi, të cilët e kanë mbrojtur këtë parim. Në transmetimet e shumta të Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)* thuhet se qëllimi i thënies **"...të cilëve u është dhënë dija..."** është për *Imam*ët e Ehli Bejtit. Sigurisht, ky qëllim nuk është i kufizuar vetëm me ta, por është vërtetësi për këtë ajet.[1]

Nëse i marrim në konsideratë disa hadithe që thonë se ata janë *Imam*ët e Ehli Bejtit, në të vërtetë ata tregojnë për dijen e lartë të tyre që kanë për Kur'anin. Por, nga ana tjetër nuk është problem që të jetë tregues edhe për dijetarët dhe për ata njerëz që zotërojnë kuptim rreth të vërtetave të Kur'anit.

Në përmbajtje, ky ajet tregon se dija nuk është e kufizuar në libër apo në atë që merr nxënësi prej mësuesit sepse Profeti, sipas ajeteve të mëparshme, nuk ka mësuar në asnjë shkollë dhe nuk ka shkruar me laps. Por, ai ishte dëshmues i qartë i atyre, të cilëve u është dhënë dija.

Sigurisht, pas dijes "zyrtare" që marrim, ka edhe dije më të gjerë e më madhështore, që është dija e All'llahut të Madhëruar në formën e një drite që All'llahu e hedh në zemrën e

1 Këto transmetime përmenden te tefsiri "Burhan", vëll. 3, f. 254, e më pas, kreu 6.

njeriut. Në një hadith thuhet: *"Dija është dritë që Zoti e hedh në zemrën e atij që do."*. Ky është thelbi i dijes. Kurse të tjerat përveç kësaj, janë lëvozhga!

Ajeti mbyllet me thënien: **"...Shpalljet Tona i mohojnë vetëm keqbërësit."**. Argumenti është i qartë sepse Profeti, i cili nuk ka shkruar e as nuk ka lexuar kurrë, është ai që e solli këtë Shpallje. Dijetarët e vërtetë i besojnë kësaj Shpalljeje.

Pas gjithë kësaj, të gjitha ajetet, të cilat janë fjalë të qarta dhe ndriçuese, në vetvete janë shenja të qarta. Vallë, kush tjetër i mohon këto ajete, përveçse atyre që i bëjnë padrejtësi vetave të tyre dhe shoqërive të tyre?

E përsërisim edhe një herë se fraza *"xhuhudun"*(جحود) vjen edhe me kuptimin që njeriu të besojë diçka dhe të mohojë atë që kundërshton dijen e tij.

Hulumtime

I Dërguari i pashkolluar

Është e vërtetë që shkrimi dhe këndimi konsiderohen përsosuri për njeriun. Por, ka raste dhe situata të caktuara, që përsosuria është edhe te mosleximi dhe te mosshkrimi. Kjo thënie vërtetohet te të Dërguarit, veçanërisht në profecinë e vulës së Profetëve, hazreti Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Mund të dalë një njeri që ka studiuar e të pretendojë profecinë dhe të paraqesë një libër e të thotë se është i zbritur nga qielli. Në të tilla raste, fillojnë dyshimet, hamendësitë se ky libër është prej tij dhe jo prej Zotit. Mirëpo, kur shohim një njeri që vjen nga një bashkësi e ndryshme, që nuk ka mësuar te mësuesi, që nuk ka shkruar e as nuk ka lexuar dhe sjell një libër madhështor me përmbajtje mjaft të lartë, atëherë kuptojmë se ky libër nuk është qëndisje e mendjes së tij, por është Shpallje qiellore që përmban mësimet e Krijuesit.

Gjithashtu, në ajete të tjera të Kur'anit thuhet se Profeti ka qenë i pashkolluar. Ndër ato ajete është edhe ajeti 157 në suren "Ali Imran".

Për kuptimin e fjalës *"el ummij"* ka tre komentime dhe më i qarti e më e miri është ai që nuk di as të shkruajë e as të lexojë.

Në Hixhaz dhe në rrethinat e tij nuk gjendej asnjë shkollë ku Profeti të mësonte. Nuk kishte as mësues. Më parë thamë se në Mekë kishte vetëm shtatëmbëdhjetë njerëz që dinin të lexonin e të

këndonin. Thuhet se prej femrave ka qenë vetëm një grua që dinte shkrim dhe këndim.[1]

Është e natyrshme se në një mjedis, ku shkrimi dhe leximi nuk janë të zhvilluar, e kur dikush thotë me plot bindje se nuk di as të shkruajë e as të këndojë, askush nuk e mohon dot thënien e tij. Ky është argument i qartë për vërtetësinë e thënies së tij. Sido që të jetë, metoda e posaçme e Kur'anit për Profetin, të cilën e përmendin ajetet e lartpërmenduar, janë për të plotësuar mrekullinë e Kur'anit, me qëllim që të largohen të gjitha dyshimet dhe argumentet e kota dhe hamendësitë e pabaza. Pa dyshim, kjo metodë ka ndikim të madh dhe dobi të madhe.

Vërtet, Profeti është dijetari i pashoq. Ai nuk ka mësuar prej njerëzve, por prej Shpalljes qiellore.

Mbetet një argument tjetër që e përmendin kundërshtarët: Profeti, para profecisë së tij, udhëtoi në Sham një a dy herë, në një kohë të shkurtër për tregti. Ka mundësi që në këto dy udhëtime të jetë takuar me dijetarë të ithtarëve të Librit dhe i ka mësuar prej tyre këto çështje.

Argumenti i dobësisë së këtij pretendimi ndodhet brenda tij. Si mundet t'i dëgjojë njeriu të gjitha këto mësime, histori të Profetëve, rregulla dhe njohje të qarta dhe t'i mësojë përmendsh kaq shpejt e t'i shpegojë në një periudhë njëzetetrevjeçare?! Kjo është diçka që nuk ka ndodhur kurrë më parë.

Kjo është sikur të themi: Filani i mësoi rregullat e dijeve dhe të arteve të mjekësisë për disa ditë. Pas kësaj, ai është

1 "Fet'hul Bilad", i El Beladherij, f. 459, botuar në Egjipt.

mbikëqyrës në shërimin e të sëmurëve në spital dhe është këshilltar i mjekëve. Këto fjalë janë më pranë shakasë dhe talljes, sesa seriozitetit.

Duhet vështruar kjo çështje që Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* pasi arriti fazën e profecisë, supozohet të ketë qenë i aftë për shkrim dhe këndim me ndërmjetësimin e mësimeve qiellore, edhe pse nuk përmendet në histori që ai ka përfituar nga kjo metodë. Ai nuk ka lexuar asgjë nga vetja e tij dhe as nuk ka shkruar me dorën e tij. Profeti nuk e ka shfaqur këtë gjatë gjithë jetës së tij, me qëllim që të mos jetë justifikim për dyshuesit dhe të hedhin dyshime mbi profecinë e tij. E vetmja gjë që përmendet në librat e historisë është se Profeti shkroi në pajtimin e Hudejbijes. Kjo përmendet në "Musnedin" e Ahmedit, ku thuhet se Profeti e mbajti penën me dorën e tij dhe shkroi besëlidhjen e pajtimit.[1]

Mirëpo një grup dijetarësh islamë e mohuan këtë hadith dhe thanë: Ky është në kundërshtim me qartësinë e ajeteve, edhe pse disa besojnë se në ajete nuk ka qartësi, sepse ajetet flasin për gjendjen e Profetit pas profecisë. Ku është pengesa që Profeti në mënyrë përveçuese të shkruajë pasi mori postin e profecisë dhe kjo të jetë në vetevete një mrekulli tjetër prej mrekullive të tij?!

Mirëpo mbështjetja në të tilla çështje te *"khaberun uahid"* të anon kah rezervimi. Kjo është në kundërshtim me atë që konstatohet në dijen e parimeve (usulit), edhe nëse themi se ky lajm nuk përbën problem në vetvete.[2]

1 "Musnedi" i Ahmedit, vëll. 4, f. 298.
2 Në ajetin 157 të sures "Ali Imran", po në këtë komentim, përmendet një tjetër sqarim me detaje për çështjen "Profeti i pashkolluar".

Rrugët e depërtimit tek të tjerët

Nuk mjafton argumenti i fuqishëm e i qartë për të depërtuar në zemrat e të tjerëve dhe tërheqja e tyre me fjalë të drejta e të vërteta. Mënyra e bashkëpunimit me palën tjetër dhe mënyra e bashkëbisedimit lë gjurmë të thella. Ka shumë njerëz hulumtues të dijeve shkencore, por nuk janë të mbarësuar për të depërtuar në zemrat e të tjerëve. Kjo për shkak se nuk e njohin ashtu siç duhet metodën e diskutimit me atë që është më e mira.

Me fjalë të tjera: Depërtimi në fazën e vetëdijes te dëgjuesi nuk është i mjaftueshëm, por duhet të hyhet në fazën e pavetëdijes, e cila përbën pjesën më të madhe të njeriut.

Kjo përfitohet më mirë në leximin e jetës së Profetëve dhe në veçanti të gjendjes së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të *Imam*ëve të drejtë *(Paqja qoftë mbi ta!)*. Ata të mëdhenj ndoqën rrugën më të mirë të moralit shoqëror dhe të bazave psikike dhe njerëzore për të realizuar qëllimet e tyre predikuese dhe edukuese.

Mënyra e bashkëpunimit të tyre me njerëzit ishte që të fitonin sa më shpejt zemrat e tyre dhe ata të tërhiqeshin kah ata, edhe pse disa njerëz thonë se kjo gjë arrihet me anë të mrekullisë. Mirëpo, po të pasojmë rrugën e tyre, shumë shpejt do të arrijmë të ndikojmë te njerëzit dhe të depërtojmë në thellësi të zemrave të tyre.

Kur'ani i flet qartë Profetit Islam dhe i thotë: **"...Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do tëlargoheshin prej teje..."**.[1]

1 Sure "Ali imran", ajeti 159.

Në shumë raste ndodh që dikush, pas disa orësh diskutimi dhe dialogu, jo vetëm që nuk arrin përparësi në diskutim, por e nevrikos më shumë palën tjetër dhe e bën të kapet më fort pas besimit të tij të kotë. Ky është argument se ai nuk ka ndjekur metodën e diskutimit me atë mënyrë që është më e mira.

Ashpërsia në diskutim, kërkimi i epërsisë, nënvleftësimi i palës tjetër, shfaqja e mendjemadhësisë dhe e vetëpëlqimit, mosrespektimi i mendimit të tjetrit, mungesa e seriozitetit në diskutim, të gjitha këto çojnë në mposhtjen e njeriut në diskutimin e tij duke mos triumfuar ndaj palës tjetër. Prandaj, ne shohim në kërkimet e moralit islam se ka një kapitull të posaçëm me temë: "Ndalimi i debatit dhe i mburrjes". Qëllimi prej këtyre debateve nuk është kërkimi i të vërtetës dhe shfaqja e saj, por qëllimi në ato debate është epërsia, lartësia dhe paraqitja e muskujve palës tjetër.

Debati dhe mburrja janë të ndaluar sepse, në shtesë të dëmeve morale dhe shpirtërore, nëpërmjet tyre nuk arrihet rezultati i duhur.

Mirëpo disa dijetarë myslimanë kanë bërë dallim mes tyre. Mburrja ka si qëllim shfaqjen e virtytit dhe të përsosurisë, kurse debati ka si qëllim nënvlerësimin dhe poshtërimin e palës tjetër.

Kanë thënë se debati është faza sulmuese në bisedë, kurse mburrja është diga mbrojtëse në bisedë. Po ashtu, ka edhe një thënie se debati ndodh në çështjet shkencore, kurse mburrja është më e përgjithshme. Sigurisht nuk ka kundërshtim mes këtyre komentimeve.

Sido që të jetë, diskutimi dhe dialogu me të tjerët, herë kryhet në mënyrën më të mirë, që e sqaruam me kriteret e lartpërmendura, të cilat duhen ruajtur me kujdes e herë tjetër, me mënyrë jo të mirë. Kjo, nëse neglizhohen çështjet që përmendëm në fillim të fjalëve tona rreth debatit dhe nëse palosen në faqet e harresës.

Fjalët i përfundojmë me përmendjen e dy transmetimeve dobiprurëse dhe mjaft elokuente, me qëllim që të mësojmë prej tyre:

Në një hadith të transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: *"Robi nuk e plotëson të vërtetën e besimit, derisa të lërë mburrjen, edhe nëse është i vërtetë."*.[1]

Në një hadith tjetër lexojmë se Profeti Sulejman *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* i ka thënë djalit të tij: *"O biri im! Mjerë ti dhe mburrja, sepse në të nuk ka dobi. Ajo përhap urrejtje mes vëllezërve."*.[2]

1 "Sefinetul Bihar", lënda "merea".
2 "Ihjaul Ulum".

Jobesimtarët dhe të padrejtët

Në ajetet e mëparshme herë lexuam: **"Shpalljet Tona i mohojnë vetëm jobesimtarët."** dhe herë tjetër, vjen po e njëjta përmbajtje, por në vend të fjalës *"kafirune" –"jobesimtarë"*, ka ardhur fjala *"dhalimune"*: **"Shpalljet Tona i mohojnë vetëm të padrejtët."**.

Krahasimi mes dy thënieve tregon se çështja nuk është përsëritëse por për të sqaruar dy tema; njëra tregon për anën ideologjike të *"el kafirune" – "jobesimtarët"*, dhe tjetra tregon për anën praktike të *"edh dhalimune" – "të padrejtët"*.

Fjalia e parë thotë: Ata të cilët zgjodhën politeizmin dhe mosbesimin, rregullat dhe tradidat e tyre të kota, si dhe imitimin e verbër të të parëve të tyre, sa herë që shihnin një shenjë prej shenjave të All'llahut, e mohonin atë, edhe pse mendjet e tyre e pranonin.

Kurse fjalia e dytë thotë: Ata që zgjodhën rrugën e padrejtësisë ndaj vetave të tyre dhe ndaj të tjerëve dhe në të mendojnë se kanë dobi personale dhe janë të vendosur në vazhdimin e kësaj rruge, nuk mendojnë në shenjat dhe Shpalljet Tona, sepse shenjat dhe Shpalljet Tona nuk përputhen me vijën e tyre mendore. Gjithashtu, ato nuk përputhen me vijën praktike të tyre.

Ajetet 50 - 55

وَقَالُواْ لَوۡلَآ أُنزِلَ عَلَيۡهِ ءَايَٰتٞ مِّن رَّبِّهِۦۖ قُلۡ إِنَّمَا ٱلۡأٓيَٰتُ عِندَ ٱللَّهِ وَإِنَّمَآ
أَنَا۠ نَذِيرٞ مُّبِينٌ ﴿٥٠﴾ أَوَلَمۡ يَكۡفِهِمۡ أَنَّآ أَنزَلۡنَا عَلَيۡكَ ٱلۡكِتَٰبَ يُتۡلَىٰ
عَلَيۡهِمۡۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَرَحۡمَةٗ وَذِكۡرَىٰ لِقَوۡمٖ يُؤۡمِنُونَ ﴿٥١﴾ قُلۡ
كَفَىٰ بِٱللَّهِ بَيۡنِي وَبَيۡنَكُمۡ شَهِيدٗاۖ يَعۡلَمُ مَا فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ
وَٱلۡأَرۡضِۗ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ بِٱلۡبَٰطِلِ وَكَفَرُواْ بِٱللَّهِ أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ
ٱلۡخَٰسِرُونَ ﴿٥٢﴾ وَيَسۡتَعۡجِلُونَكَ بِٱلۡعَذَابِۚ وَلَوۡلَآ أَجَلٞ مُّسَمّٗى لَّجَآءَهُمُ
ٱلۡعَذَابُ وَلَيَأۡتِيَنَّهُم بَغۡتَةٗ وَهُمۡ لَا يَشۡعُرُونَ ﴿٥٣﴾ يَسۡتَعۡجِلُونَكَ بِٱلۡعَذَابِ
وَإِنَّ جَهَنَّمَ لَمُحِيطَةُۢ بِٱلۡكَٰفِرِينَ ﴿٥٤﴾ يَوۡمَ يَغۡشَىٰهُمُ ٱلۡعَذَابُ مِن فَوۡقِهِمۡ
وَمِن تَحۡتِ أَرۡجُلِهِمۡ وَيَقُولُ ذُوقُواْ مَا كُنتُمۡ تَعۡمَلُونَ ﴿٥٥﴾

"Ata thonë: 'Përse nuk i janë zbritur mrekulli nga Zoti i tij?'. Thuaj: 'Mrekullitë janë vetëm tek All'llahu; unë jam vetëm një paralajmërues i qartë.'"

"Vallë, a nuk u mjafton atyre që Ne të kemi shpallur ty Librin që u lexohet atyre? Me të vërtetë, që në të ka mëshirë dhe këshillë për njerëzit që besojnë."

"Thuaj: 'All'llahu mjafton si dëshmitar midis meje dhe jush. Ai di çfarë ka në qiej dhe në Tokë'. Ata që besojnë në trillime dhe nuk besojnë në All'llahun, pikërisht ata janë të humburit."

"Ata kërkojnë prej teje shpejtimin e dënimit. Sikur të mos ishte afati i caktuar, atyre do t'u kishte ardhur dënimi. Me siguri që atyre do t'u vijë papritmas e pa e vënë re."

"Ata kërkojnë prej teje shpejtimin e dënimit, por, në të vërtetë, Xhehennemi do t'i përfshijë të gjithë mohuesit."

"Ditën, kur do t'i kaplojë dënimi prej së larti dhe prej së poshti, (meleku i ngarkuar me ndëshkimin e fajtorëve)**, do t'u thotë: 'Shijoni dënimin për atë që keni bërë!'".**

Komentimi

A nuk është i mjaftueshëm Kur'ani për mrekullinë e tij?

Ata njerëz, të cilët nuk iu përulën dhe nuk iu dorëzuan sqarimit argumentues dhe logjik që solli Kur'ani për shkak të kokëfortësisë dhe këmbënguljes së tyre në të kotën dhe nuk e pranuan Kur'anin si libër që e solli Profeti i pashkolluar, u strehuan në argumente të tjerë tallës e injorues. Ata thoshin: Përse

nuk na sjell, o Muhammed, mrekulli prej mrekullive që solli Musai dhe Isai *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*: **"Ata thonë: 'Përse nuk i janë zbritur mrekulli nga Zoti i tij?'"**.

Përse ai (Muhammedi) nuk kishte mrekulli si shkopi i Musait, si dora e tij e bardhë apo si fryrja e Isait?

Përse nuk i shkatërron armiqtë e tij nëpërmjet mrekullive të veta, siç vepruan Musai, Shuajbi, Hudi dhe Nuhu me popujt e tyre të pabindur? Apo siç thotë Kur'ani përmes gjuhës së tyre në ajetet 90-93 të sures "Isra": **"Ata thonë: 'Ne nuk do të të besojmë** (o Muhammed), **derisa të bësh, që të shpërthejë nga toka një gurrë uji për ne, ose derisa të kesh një kopsht hurmash dhe rrushi, nëpër të cilin të rrjedhin lumenj, ose derisa ta bësh qiellin të bjerë copa mbi ne, siç ke thënë, ose derisa ta sjellësh All'llahun dhe melekët para nesh, ose derisa të kesh shtëpi prej ari, ose derisa të ngjitesh në qiell. Ne nuk do të të besojmë, edhe sikur të ngjitesh në qiell, derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë'. Thuaj: 'I Lavdëruar qoftë Zoti im! Unë nuk jam tjetër, veçse njeri - i dërguar!'"**.

S'ka dyshim se Profeti kishte mrekulli të tjera përveç Kur'anit, siç thonë librat e historisë. Mirëpo, qëllimi në fjalët e tyre nuk ishte që të shihnin mrekullinë. Qëllimi i tyre ishte se nga njëra anë nuk e konsideronin Kur'anin libër të rëndësishëm dhe as mrekulli. Nga ana tjetër, kërkonin mrekulli propozuese.[1]

1 Mrekulli propozuese ka kuptimin që Profeti të sillte mrekulli sipas dëshirës së ndonjërit. P.sh: dikush kërkon të çajë tokën dhe të shpërthejë burime. Një tjetër kërkon që malet e Mekës t'i shndërrojë në flori. Një i tretë thotë se këto nuk mjaftojnë, e prandaj duhet të ngjitet në qiell. Në këtë mënyrë, mrekullitë i

Për këtë, Kur'ani në ajetin 111 të sures "En'am", thotë: **"Edhe sikur t'u dërgonim atyre melekët, t'i bënim të vdekurit t'u flisnin atyre dhe t'i tubonim të gjitha gjërat para tyre, ata përsëri nuk do të besonin, nëse All'llahu nuk do të donte; por shumica e tyre janë të paditur."**.

Sido që të jetë, për t'ju përgjigjur thënieve të atyre mashtruesve me argumente hamendësuese dhe të pabaza, Kur'ani i Shenjtë ndjek dy rrugë:

Së pari, i thotë Profetit të Tij: **"Thuaj: 'Mrekullitë janë vetëm tek All'llahu…'"**, që do të thotë: I thuaj atyre kokëfortëve se All'llahu e di se cila mrekulli është e përshtatshme për çdo kohë dhe për çdo popull. Ai e di se kush janë pasuesit e së vërtetës, prandaj duhet që t'u paraqesë atyre mrekullitë e jashtëzakonshme. Ai e di se kush janë ata që pasojnë egon dhe unin e tyre.

Pastaj, ajeti shton e thotë: **"…unë jam vetëm një paralajmërues i qartë."**. Përgjegjësia ime është vetëm paralajmërimi, predikimi dhe sqarimi i fjalëve të All'llahut. Përsa i përket mrekullive dhe çështjeve të jashtëzakonshme, ato janë me urdhrin dhe lejen e All'llahut.

Përgjigje tjetër është edhe thënia e Tij: **"Vallë, a nuk u mjafton atyre që Ne të kemi shpallur ty Librin që u lexohet atyre…?"**. Ata kërkojnë mrekulli materiale "trupore" dhe vetë Kur'ani është mrekullia më e madhe shpirtërore.

---

kthejnë në lojëra të pavlera. Edhe pasi i shohin të gjitha këto, përsëri e akuzojnë se është magjistar.

Ata duan mrekulli kalimtare, që nuk qëndron gjatë. Ndërkohë që Kur'ani është mrekulli e përjetshme, ajetet e tij u lexohen ditë e natë atyre dhe brezave pas tyre. Vallë, a është e logjikshme që një njeri i pashkolluar, edhe sikur të supozojmë se lexon dhe këndon, të sjellë një përmbajtje madhështore, tërheqëse dhe të habitshme, e cila qëndron mbi aftësitë e njerëzve dhe i fton dijetarët që të sjellin një të ngjashëm si ai, e ata nuk munden?! Nëse vërtet kanë qenë kërkues të mrekullisë, me zbritjen e Kur'anit u dhamë më shumë se çfarë kërkuan. Mirëpo, ata nuk kanë qenë kërkues të mrekullisë. Ata ishin të zhytur në kotësira e në paganizma.

Duhet patur parasysh se thënia **"Vallë, a nuk u mjafton atyre…"**, në të shumtën e rasteve, përdoret kur njeriu e kryen një punë në një formë më të lartë sesa ajo që e pret pala tjetër. Ai është i pavëmendshëm ose hiqet si i pavëmendshëm ndaj asaj që bën. Për shembull, sikur të thotë: Nuk më është paguar një shërbim, ndërkohë që shërbimi që bëri është më i madh. Mirëpo ai nuk e konsideron fare atë. Ne i themi: A nuk të mjafton ajo që bëmë?!

Pas gjithë kësaj, duhet që mrekullia të jetë në përputhje me rrethanat e kohës, të vendit dhe me thirrjen e Profetit. Profeti që fton në Krijuesin e Përjetshëm, duhet që mrekullinë e tij ta ketë të përjetshme. Profeti, thirrja e të cilit përfshin botën, kohët dhe vendet, duhet patjetër të sjellë mrekulli ndriçuese shpirtërore dhe logjike, që të tërheqë mendjen e të gjithë dijetarëve dhe mendimtarëve në çdo kohë e në çdo vend. Dihet se ky qëllim i përshtatet Kur'anit dhe jo shkopit të Musait dhe as dorës së tij të bardhë. Në fund të ajetit, Kur'ani sqaron dhe forcon në formë të qartë duke thënë: **"…Me të vërtetë, që në të ka mëshirë dhe**

këshillë për njerëzit që besojnë.". Fraza *"dhalike"* këtu tregon për Librin e zbritur nga qielli, Kur'anin e Shenjtë.

Vërtet, Kur'ani është mëshirë, kujtues dhe udhëzues. Ai, për besimtarët që kanë hapur zemrat përballë së vërtetës, që ndjekin dritën dhe rrugën e drejtë, është mëshirë dhe ata e ndiejnë me gjithë qenien e tyre. Ata ndiejnë qetësi dhe bindje tek ai. Sa herë që i lexojnë ajetet e tij u shtohet vetëdija. Ajetet e tij për ta janë përmendja *(dhikr)* më e madhe.

Ka mundësi që dallimi mes "mëshirës" dhe "përmendjes" është se Kur'ani nuk është vetëm mrekulli dhe përmendje, por në shtesë të saj, ai përmban ligje, të cilat sjellin mëshirë. Ai përmban metodologji edukuese dhe njerëzore. Për shembull: shkopi i Musait ishte vetëm mrekulli, sepse ai nuk ndikonte në jetën e përditshme të njerëzve. Kurse Kur'ani është mrekulli dhe në të njëjtën kohë, është kushtetutë e plotë dhe e përkryer për jetën. Përderisa çdo pretendues ka nevojë për dëshmitar, Kur'ani sqaron në ajetin pasardhës se dëshmitari më i mirë është All'llahu: **"Thuaj: 'All'llahu mjafton si dëshmitar midis meje dhe midis jush…"**. Është e natyrshme se sa më e madhe të jetë dija e dëshmitarit, aq më shumë ka vlerë dëshmia. Për këtë, Kur'ani thotë: **"…Ai di çfarë ka në qiej dhe në Tokë…"**.

Tani të njihemi me mënyrën se si dëshmon All'llahu për të vërtetën e Profetit të Tij.

Supozohet që kjo dëshmi të jetë praktike, sepse kur All'llahu ia dha Profetit mrekullinë e madhe, Kur'anin, Ai e ka firmosur dhe e ka vulosur dokumentin e vërtetësisë së tij. Vallë, a është e mundur që All'llahu i Urtë dhe i Drejtë t'i japë mrekulli një gënjeshtari (All'llahu na ruajtë!)?! Për këtë, vetë dhënia e

mrekullisë një njeriu si Profeti Muhammed, është dëshmia më e madhe për profecinë e tij nga ana e All'llahut.

Në shtesë të dëshmisë praktike të larpërmendur, në shumë ajete të Kur'anit lexojmë dëshminë shprehimore për profecinë e Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Këtë e gjejmë në ajetin 40 të sures "Ahzab" që thotë: **"Muhammedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i All'llahut dhe vula e Profetëve; All'llahu është i Gjithëditur për çdo gjë."**. Po ashtu, edhe në ajetin 29 të sures "Fet'h",thuhet: **"Muhammedi është i Dërguar i All'llahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre…"**.

Disa komentues kanë thënë: Ky ajet ka qenë përgjigje për disa drejtues jahudinj prej banorëve të Medines, si Ka'ab ibn el Eshref dhe pasuesit e tij, të cilët kanë thënë: "O Muhammed! Kush dëshmon se ti je i Dërguari i All'llahut? Atëherë zbriti ajeti: **"Thuaj: 'All'llahu mjafton si dëshmitar mes meje dhe mes jush…'"**.

Po ashtu, ajeti i lartpërmendur mund të komentohet me komentim dhe sqarim tjetër se dëshmi të All'llahut në ajet janë premtimi dhe përmendja e Profetit në Librat e mëparshëm të All'llahut, si Teurati dhe Inxhili dhe këtë e dinë shumë mirë dijetarët e ithtarëve të Librit.

Në të njëjtën kohë, nuk ka kundërshtim mes tre komentimeve të lartpërmendur. Të tre këto komentime mund të bashkohen në kuptimin e ajetit.

Ajeti përfundon me kërcënimin e All'llahut për mohuesit dhe thotë: **"…Ata që besojnë në trillime dhe nuk besojnë në All'llahun, pikërisht ata janë të humburit."**.

A ka humbje më të madhe se kur njeriu jep çdo gjë në rrugën e asgjësë?! Kështu vepruan jobesimtarët. Ata ia dhanë zemrat dhe shpirtrat e tyre idhujve dhe statujave. Të gjitha fuqitë trupore, mundësitë shoqërore dhe individuale i harxhuan në rrugën e reklamimit dhe të përhapjes së rrymës së tyre politeiste. Neglizhuan përmendjen e All'llahut. E kjo i përgatiti atyre dëm dhe humbje. Këtë lloj humbjeje Kur'ani e përmend në disa ajete.

Në disa ajete të tjera përmendet fjala *"ekhseru"* – *"më i humbur"*, që tregon se nuk ka humbje më të madhe sesa kjo. (Shih suren "Hud", ajeti 22, suren "Neml", ajeti 5 dhe suren "Kehf", ajeti 103.)

Shembulli më i mirë është: Ka raste që njeriu dëmtohet në bashkëveprimet reciproke duke humbur kapitalin e tij dhe mposhtet. Ka mundësi që kjo situatë të zgjerohet dhe të rëndohet me borxhe. Kjo është gjendja më e keqe. Edhe politeistët të tillë janë. Por mund të jenë shkak edhe për humbjen e të tjerëve, siç thuhet: "Dështimi është zinxhir i pashkëputur".[1]

Në ajetet e mëparshme u paraqitën dy pretekste të jobesimtarëve rreth thirrjes së Profetit dhe u sqaruan. Preteksti i parë ishte thënia e tyre: Përse nuk na sjell mrekulli?! Kur'ani iu përgjigj se vërtet, ky Libër i zbritur nga qielli (Kur'ani) është mrekullia më e madhe.

1 Për këtë çështje kemi folur edhe në komentimin e ajetit 103, të sures "Kehf", po në këtë komentim.

Preteksti i dytë ishte thënia e tyre: Kush dëshmon për vërtetësinë e thirrjes tënde dhe për të vërtetën e profecisë tënde? Kur'ani iu përgjigj: **"Thuaj: 'All'llahu mjafton si dëshmitar midis meje dhe jush. Ai di çfarë ka në qiej dhe në Tokë…'"**.

Në ajetin pasardhës tregohet për preteksin e tretë. Ai thotë: **"Ata kërkojnë prej teje shpejtimin e dënimit…"**. Ata thonë: Po të jetë i vërtetë dënimi i All'lahut për jobesimtarët, përse nuk na e sjell?! Këtij preteksi Kur'ani i përgjigjet me tre përgjigje:

E para: "…Sikur të mos ishte afati i caktuar, atyre do t'u kishte ardhur dënimi…". Ky afat i caktuar *"exheli"* është për një qëllim bazë që t'i zgjojë ata nga pavetëdija e tyre dhe nga kotësia ku janë, ose për plotësimin e argumentit ndaj tyre. Për këtë, All'llahu nuk nxiton kurrë në çështjet e Tij, sepse nxitimi është në kundërshtim me urtësinë e Tij.

E dyta: Këta që strehohen në këtë thënie, nuk e dinë që dënimi mund vijë papritmas: **"…Me siguri që atyre do t'u vijë papritmas e pa ndierë."**.[1]

Meqenëse koha e dënimit është e caktuar dhe e vendosur, interesi e bën që të mos dihet dhe të vijë papërgatitje, sepse po të dihet koha e tij, jobesimtarët, gjynahqarët dhe të padrejtët do të ishin më të guximshëm në kryerjen e veprave të tyre të këqija. Ata nuk do të hiqnin dorë nga gjynahet e tyre. Sapo të afrohej koha e dënimit, ata do të drejtoheshin kah pendimi dhe do të ktheheshin tek All'llahu.

1 Fjala *"bagtaten"* rrjedh nga fjala *"el begt"*, që do të thotë realizim i befasishëm dhe i papritur.

Urtësia edukative në këtë lloj dënimi çon në fshehjen e tij, me qëllim që çdo moment të jetë ndikues dhe frika e tmerri të jenë prej faktorëve mbrojtës. Në përgjithësi, sqarohet ajo që thamë se qëllimi i fjalisë **"pa e ndierë"** nuk është se ata nuk e kuptojnë praninë e dënimit. Përndryshe filozofia e dënimit dhe urtësia prej tij nuk kanë ndikim. Por kuptimi është se ata nuk e dinë momentin e zbritjes së dënimit. Thënë ndryshe: Dënimi do t'u zbresë atyre si rrufeja dhe ata janë të pavëmendshëm.

Nga ajetet e shumta duket se pretekstet me argumente të pabaza nuk kanë qenë të kufizuar vetëm me banorët e Mekës. Por shumë prej popujve të shkuar strehoheshin në të tilla pretekste dhe këmbëngulnin në shpejtimin e dënimit dhe të ndëshkimit.

E treta: Së fundi, përgjigja e Kur'anit sqarohet në ajetin që thotë: **"Ata kërkojnë prej teje shpejtimin e dënimit, por, në të vërtetë, Xhehennemi do t'i përfshijë të gjithë mohuesit."**. Nëse vonohet dënimi i tyre në këtë jetë, dënimi i Ahiretit është i patjetërsueshëm dhe përfshirës i plotë i tyre.

Ka komentim tjetër për fjalën *Xhehennem* në këtë ajet që ndahet në dy anë:

Ana e parë: Ai është Xhehennemi i dynjasë, sepse ata vazhdojnë në politeizmin dhe përlyerjen e tyre në gjynahe. Ata digjen në Xhehennemin që e përgatitën me duart e tyre. Xhehennemi i luftërave dhe i gjakderdhjeve. Xhehennemi i konflikteve dhe i mosmarrëveshjeve. Xhehennemi i mërzisë dhe i frikës. Xhehennemi i padrejtësisë, i egos, i kokëfortësisë dhe i mosbindjes.

Ana e dytë: Sipas anës së dukshme të ajeteve të Kur'anit, Xhehennemi ekziston, ashtu siç e lexuam edhe më lart. Xhehennemi ndodhet në brendinë e dynjasë. Për këtë, Xhehennemi është rrethues në mënyrë të vërtetë. Këtë e përmendin edhe ajetet 5-7 të sures "Tekathur": **"Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri! Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues! Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë."**.[1]

Pastaj Kur'ani shton e thotë: **"Ditën, kur do t'i kaplojë dënimi prej së larti dhe prej së poshti do t'u thotë: 'Shijoni dënimin për atë që keni bërë!'"**.[2]

Ky ajet mund të jetë sqarues se dënimi është përfshirës i jobesimtarëve në Xhehennemin e Ditës së Kiametit. Mund të jetë sqarim i pavarur për atë dënim të rëndë që do t'i përfshijë ata për shkak të punëve të tyre. Nesër do të duket qartë ky dënim dhe do të jetë i prekshëm.

Sido që të jetë, përmendja e përfshirjes së dënimit: **"...kur do t'i kaplojë dënimi prej së larti dhe prej së poshti..."** dhe mospërmedja e anëve të tjera, në të vërtetë është për sqarimin e të kërkuarës. Në shtesë të saj, zjarri i dënimit, nëse zgjat gjuhët e tij nga poshtë, do të arrijë në koka dhe do të kaplojë e të rrethojë të gjithë trupin dhe të gjitha anët e tij.

Kjo shprehje përdoret edhe në gjuhën arabe, ku thuhet: Filani është i zhytur nga balli e deri te këmbët e tij në kënetën e

1 Për sqarime më të shumta lexo komentimin e ajetit 123 të sures "Ali Imran" nga ky komentim.

2 Disa komentues mendojnë se fjala *"jeum"* është e lidhur me foljen e papërmendur. Disa kanë thënë se është e lidhur me fjalën *"muhitatun"*.

shthurjes dhe të papastërtisë. Kjo do të thotë se e gjithë qënia e tij është e zhytur në gjynahe. Në këtë mënyrë, sqarohet problemi te kometuesit që ka të bëjë me përmendjen e anës së sipërme e të poshtme në këtë ajet dhe mospërmendja e anëve të tjera. Qëllimi sqarohet në atë që thamë më lart.

Kurse fjalia **"Shijoni dënimin për atë që keni bërë!"**, lë të kuptohet se thënësi i saj është All'llahu i Madhëruar. Në vetvete, ky është një dënim psikologjik për ata njerëz. Kjo fjali e zbulon këtë të vërtetë: Dënimi i All'llahut në Ahiret është prej punëve që kryen vetë njeriu.

Hulumtime

Argumentet e mrekullisë së Kur'anit

S'ka dyshim se Kur'ani është mrekullia më e madhe e Islamit. Mrekulli letrare, e përjetshme, e përshtatshme për çdo kohë dhe për çdo vend. Ai vlen për çdo shtresë shoqërore. Mrekullinë e Kur'anit e kemi sqaruar në komentimin e ajetit 23 të sures "Bekare". Prandaj, nuk është nevoja ta përsërisim.

Mbështjetja te hilet për mohimin e mrekullive

Disa dijetarë perëndimorë, të cilët anojnë te mospranimi, këmbëngulin se Profeti nuk ka mrekulli tjetër përveç Kur'anit. Ka mundësi që edhe Kur'anin nuk e konsiderojnë mrekulli. Të tilla thënie janë në kundërshtim me ajetet e Kur'anit dhe me

transmetimet *muteuatireh* dhe me historinë islame. Këtë e kemi sqaruar në komentimin e ajeteve 90-93 të sures "Isra".

Mrekullitë e propozuara

Metoda e kundërshtarëve të Profetëve ishte se gjithmonë u propozonin mrekulli, të cilat dëshironi t'i shihnin. Me këtë veprim ata përpiqeshin të nënçmonin dhe të përçmonin mrekullinë dhe të kishin preteks për mospranimin e thirrjes së Profetëve. Por të Dërguarit nuk u dorëzuan kurrë para këtyre intrigave. Në përgjigjet e ajeteve të lartpërmendura, mrekullia nuk është zgjedhje e të Dërguarve që të jetë në përshtatje me egon e tyre në çdo moment dhe në çdo kohë të sjellin mrekullinë që duan. Mrekullitë janë vetëm me urdhër të All'llahut. Ato nuk janë në duart tona. Çështjen e mrekullive propozuese e kemi sqaruar në komentimin e ajetit 20 të sures "Junus".

Ajetet 56- 60

يَـٰعِبَادِيَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ إِنَّ أَرۡضِي وَٰسِعَةٌ فَإِيَّـٰيَ فَٱعۡبُدُونِ ﴿٥٦﴾ كُلُّ نَفۡسٖ
ذَآئِقَةُ ٱلۡمَوۡتِۖ ثُمَّ إِلَيۡنَا تُرۡجَعُونَ ﴿٥٧﴾ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ
ٱلصَّـٰلِحَـٰتِ لَنُبَوِّئَنَّهُم مِّنَ ٱلۡجَنَّةِ غُرَفٗا تَجۡرِي مِن تَحۡتِهَا ٱلۡأَنۡهَٰرُ خَـٰلِدِينَ
فِيهَاۚ نِعۡمَ أَجۡرُ ٱلۡعَـٰمِلِينَ ﴿٥٨﴾ ٱلَّذِينَ صَبَرُواْ وَعَلَىٰ رَبِّهِمۡ يَتَوَكَّلُونَ ﴿٥٩﴾
وَكَأَيِّن مِّن دَآبَّةٖ لَّا تَحۡمِلُ رِزۡقَهَا ٱللَّهُ يَرۡزُقُهَا وَإِيَّاكُمۡۚ وَهُوَ ٱلسَّمِيعُ ٱلۡعَلِيمُ
﴿٦٠﴾

"O robtë e Mi, që keni besuar! Toka ime është vërtet e gjerë, prandaj më adhuroni vetëm Mua!"

"Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen dhe pastaj të gjithë do të ktheheni tek Ne."

"Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'i vendosim në pallatet e Xhennetit, ku rrjedhin lumenj. Aty do të qëndrojnë përgjithmonë. Sa i bukur është shpërblimi i atyre që punojnë mirë, të cilët kanë duruar dhe janë mbështetur te Zoti i tyre!"

“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! All’llahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka.”

Shkaku i zbritjes

Shumë prej komentuesve besojnë se ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, ka zbritur për besimtarët, të cilët ishin nën presionin e ashpër të jobesimtarëve, derisa ata nuk mundën të kryenin detyrat e tyre islame. Ky ajet erdhi që t’i urdhëronte ata për emigrim (hixhret) nga ajo tokë.

Po ashtu, disa komentues besojnë se ajeti: **“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim…”**, që është ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë, ka zbritur për besimtarët, të cilët përballeshin me keqbërjet e armiqve të tyre në Mekë. Ata thoshin se nëse emigrojmë në Medine, nuk kemi as shtëpi e as tokë. Kush do të na ushqejë atje? Atëherë zbriti ajeti: **“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim…!”**.

Komentimi

Patjetër duhet emigrimi (hixhreti)

Ajetet e mëparshme folën për qëndrimet e ndryshme të politeistëve rreth Islamit dhe myslimanëve. Ajetet në fjalë flasin për myslimanët dhe për përgjegjësitë e tyre përballë problemeve të ndryshme. Pra, me problemin e keqbërjes së jobesimtarëve ndaj tyre, me presionet e tyre, me numrin e paktë të myslimanëve e të tjera. Ajeti thotë: **"O robtë e Mi, që keni besuar! Toka ime është vërtet e gjerë, prandaj më adhuroni vetëm Mua!"**.

Është e natyrshme që ky nuk është ligj i posaçëm vetëm për besimtarët mekas. Edhe shkaku i zbritjes nuk e kufizon kuptimin e gjerë të këtij ajeti. Për këtë, nëse njeriu, në çdo kohë e në çdo vend, zhvishet plotësisht nga liria, atëherë qëndrimi i tij sjell vetëm poshtërim, dëm dhe humbje, si dhe moszbatim të detyrave të All'llahut. Atëherë, në këtë situatë, detyra e njeriut është emigrimi në zonë të "lirë", në të cilën ka mundësi të kryejë detyrat islame me liri të plotëose me liri të konsiderueshme.

Thënë ndryshe: Vërtet, qëllimi i krijimit të njeriut është që të jetë rob i All'llahut. Në realitet, adhurimi është shkak i lirisë, i fisnikërisë dhe i triumfit në të gjitha anët. Fjalia: **"…më adhuroni vetëm Mua!"** tregon për këtë kuptim. Po ashtu, kjo shprehje përmendet në ajetin 56 të sures "Dharijat", i cili thotë: **"…Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë."**.

Kur ky qëllim kryesor dhe përfundimtar bëhet i pamundur, atëherë s'ka rrugë tjetër përveç emigrimit, sepse toka

e All'llahut është e gjerë dhe duhet që njeriu të emigrojë në një vend tjetër. Ai nuk duhet të jetë rob i botëkuptimeve të zakonit, të fisit, të traditës, familjes etj. Duhet të mos e poshtërojë veten e tij për hir të tyre. Respektimi i këtyre çështjeve është kur qëllimi kryesor nuk përbën asnjë rrezik. Nëse qëllimi bazë "adhurimi i All'llahut" nuk realizohet, atëherë njeriu duhet të emigrojë.

Për këtë çështje, edhe prijësi i besimtarëve, *Imam* Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Nuk është një vend më imirë për ty se një vend tjetër. Vendi më i mirë është ai që të mban."*.[1]

Është e vërtetë që dashuria e atdheut dhe marrëdhëniet me vendlindjen janë pjesë e natyrës së çdo njeriu. Por ka raste që në jetën e njeriut ndodhin gjëra më të rëndësishme se ato gjëra dhe e bëjnë të jetë më parësore se ato.

Rreth qëndrimit të Islamit dhe pikëpamjes së tij për çështjen e emigrimit e kemi sqaruar në komentimin e ajetit 100 të sures "Nisa". Aty kemi përmendur edhe hadithe që kanë të bëjnë me këtë çështje.

Shprehja **"O robtë e Mi"** është më e buta dhe më dashamirësja e Zotit për njerëzit. Është kurora e krenarisë më të lartë. Në teshehud të qënit rob e shprehim para fjalës i Dërguar: Dëshmoj se s'ka Zot tjetër përveç All'llahut dhe se Muhammedi është robi i Tij dhe i Dërguari i Tij. *(Eshhedu en lailahe il'lall'llah ue eshhedu enne Muhammeden abduhu ue resuluhu.)*

Është interesante se kur All'llahu krijoi Ademin, e quajti *"khalifetullah"* – *"mëkëmbësi i All'llahut"*, dhe kjo është krenari për

1 "Nehxhul Belaga", thënie të shkurtra, thënia 442.

Ademin. Por kur arriti gradën e adhurimit, shejtani u dëshpërua dhe i tha Zotit: **"Ai tha: 'Betohem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë, përveç robve të Tu të sinqertë!'"**.[1] All'llahu, po për këtë çështje, i tha shejtanit: **"Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robtë e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty."**.[2]

Nga ajo që përmendëm, sqarohet më së miri se qëllimi i fjalës *"ibad"*, që përmendet në ajetin në fjalë, nuk është për të gjithë njerëzit, por vetëm për besimtarët. Fjalia **"ata të cilët kanë besuar"** ka ardhur si forcim dhe si sqarim.[3]

Disa mbetën në vendin e shirkut (idhujtarisë) dhe nuk dëshiruan të emigronin, me preteksin se kishin frikë nga dalja prej shtëpive të tyre se do të vdisnin për shkak të armiqësisë, urisë apo shkaqeve të tjera kërcënuese. Në shtesë të kësaj ata nuk donin të ndaheshin prej të dashurve, shokëve miqve dhe fëmijëve. Kur'ani u përgjigjet me një përgjigje të plotë: **"Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen dhe pastaj të gjithë do të ktheheni tek Ne."**.

Kjo dynja nuk është banesa e qëndrimit për askënd. Disa kalojnë nga kjo jetë më shpejt e disa më vonë. Të gjithë do të largohen prej saj. Sido që të jetë, ndarja prej të afërmve, miqve dhe shokëve patjetër që do të bëhet. Përderia çështja është e tillë, përse duhet që njeriu të rrijë në vendin e idhujtarisë e mosbesimit për

1 Sure "Sad", ajetet 82-83.
2 Sure "Hixhr", ajeti 42.
3 Fjalia **"Mua më adhuroni"** është e lidhur me fjalën *xhezaun* e fjalisë kushtore e papërmendur dhe e aluduar, sipas gramatikës së gjuhës arabe. Atëherë kuptimi i ajetit është: "Nëse ju ngushtohet toka, atëherë emigroni prej saj në një vend tjetër dhe më adhuroni Mua.".

çështje kalimtare? Përse duhet të përballet me poshtërimin dhe robërimin për një kohë të shkurtër?

Pas gjithë kësaj që thamë, ju duhet t'i frikësoheni vdekjes në vendin e mosbesimit e të idhujtarisë para se të arrini banesën e Islamit. Sa e rëndë është kjo vdekje dhe sa fatkeqe!

Pastaj, mos mendoni se vdekja është fundi i gjithçkaje. Vdekja është fillimi i jetës së vërtetë të njeriut, sepse të gjithë ju **"do të ktheheni tek Ne"**, pra te All'llahu Fuqiplotë dhe te mirësia e pakufizuar dhe e përjetshme.

Ajetin në vijim prej ajeteve në fjalë sqaron një pjesë të asaj mirësie dhe thotë: **"Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'i vendosim në pallatet e Xhennetit, ku rrjedhin lumenj…"**.[1]

Ata do të jenë në kështjella të rrethuara me pemët e Xhennetit nga çdo anë. Në të do të ketë lumenj me shije dhe ngjyra të ndryshme. Sipas ajeteve të tjera të Kur'anit, ato lumenj rrjedhin e ecin nën ato kështjella mes pemëve. (Fjala *"gurefun"* është shumësi i fjalës *"gurfetun"*- *"dhomë"* dhe ka kuptimin e ndërtesës së lartë dhe të mbikëqyrëses së anëve.)

Një dallim tjetër i dhomave të Xhennetit është se ato nuk janë si dhomat në këtë dynja. Dhomat e Xhennetit janë të përjetshme: **"…aty do të qëndrojnë përgjithmonë…"**.

Më pas Kur'ani thotë: **"…Sa i bukur është shpërblimi i atyre që punojnë mirë."**.

---

1 Fjala *"lenebe uenehum"* që përmendet në këtë ajet, vjen nga rrënja *"tebu'ietun"*, njësoj si përbërja e fjalës *"tedhkiretun"* dhe ka kuptimin e dhënies së vendit për të qëndruar gjithmonë në të.

Me një krahasim të thjeshtë mes asaj që u përmend në ajetet e mëparshme për jobesimtarët e gjynahqarët dhe asaj që thuhet për besimtartë në këtë ajet, do të sqarohet shpërblimi i madh i besimtarëve.

Jobesimtarët janë të zhytur në zjarr nga koka e deri te këmbët dhe u thuhet në formë qortimi: **"Shijoni atë që ju vepruat!"**. Kurse besimtarët qëndrojnë në mirësinë e Xhennetit, e cila i rrethon nga çdo anë. Në vend të fjalëve qortuese, atyre u flitet me fjalë të mira të mbushura me dashuri e butësi: **"...Sa i bukur është shpërblimi i atyre që punojnë mirë!"**.

Është e natyrshme që kuptimi i fjalës *"amilijne"- "punëtorëve"*, bazuar edhe në argumentet e fjalisë së mëparshme, është për ata që punojnë vepra të mira të shoqëruara me besimin, megjithëse kjo fjalë është e përgjithshme.

Në një thënie të tij, Profeti madhështor i Islamit, hazreti Muhammedi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e përshkruan kështu Xhennetin: *"Në Xhennet ka dhoma ku e jashtmja e tyre shfaq të brendshmen dhe e kundërta."*. Në atë çast, disa shokë i thanë: *"O i Dërguari i All'llahut, të kujt janë këto dhoma?"* Ai u përgjigj: *"Ato janë për atë që flet mirë, që ushqen të tjerët dhe që falet natën kur njerëzit flenë."*.[1]

Ajeti në vijim përshkruan virtytet më të rëndësishme të besimtarëve punëmirë: **"...e të cilët kanë duruar dhe janë mbështetur te Zoti i tyre."**. Vërtet, ata u larguan nga bashkëshortet, fëmijët, të afërmit, shokët e nga çdo gjë e dashur

1 Tefsiri i "Kurtubiut", vëll. 7, f. 5075, fundi i ajeteve në fjalë.

për ta. Edhe pse provuan hidhësinë e ndarjes, emigrimit dhe largësisë nga vendi i tyre, ata duruan.

Për mbrojtjen e besimit ata përballen me keqbërjen e armiqve. Ata përballen me vështirësitë e xhihadit (luftës) me veten e tyre. Çdo problem dhe vështirësi e përballojnë. Vërtet, ky durim dhe kjo palëkundshmëri janë simboli i triumfeve të tyre dhe faktorë të krenarisë së tyre. Pa durim nuk mund të realizohen dhe nuk mund të fitohen mirësitë e jetës.

Pas gjithë kësaj, ata nuk mbështeten as te pasuritë e tyre e as te shokët apo te miqtë e tyre. Ata i mbështeten All'llahut dhe vetëm Atij i kërkojnë. Edhe sikur të mblidhen njëmijë armiq për t'i shkatërruar, ata thonë: "Sprova Jote është mëshirë, prandaj mos u tremb nga armiqtë!".

Nëse mendojmë më thellë, do të shohim se durimi dhe mbështetja tekAll'llahu janë baza e të gjitha virtyteve të mira njerëzore. Durimi është faktori i qëndrueshmërisë para problemeve dhe vështirësive, kurse mbështetja është qëllimi dhe nxitësi për të lëvizur në rrugën e drejtë e të vërtetë.

Në të vërtetë, duhet të mbështetemi në këto dy virtyte (durimi dhe mbështjetja) për të bërë punë të mira, sepse pa ato nuk mund të kryhen këto vepra.[1]

Në ajetin e fundit të ajeteve në fjalë, ka përgjigje për ata që thoshin se nëse dalim nga shtëpitë tona dhe familjet tona, kush do

1 Rreth të vërtetës së mbështetjes tek All'llahu dhe të urtësisë së Tij kemi folur në komentimin e ajetit 12 të sures "Ibrahim". Për të vërtetën e durimit, kemi folur në komentimin e ajetit 12 të sures "Ibrahim", në ajetin 24 të sures "Rrad" dhe në ajetin 26 të sures "A'raf".

të na ushqejë dhe kush do të na furnizojë. Kur'ani u thotë atyre që të mos shqetësohen për furnizimin dhe të mos e mbartin rëndesën e poshtësisë e të robërisë, sepse Furnizuesi është All'llahu, jo vetëm për ju, por: **"Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! All'llahu u jep atyre dhe juve...!"**.

Të gjitha gjallesat, me miliona, kudo që ndodhen, në tokë, në thellësi të ujërave, në lartësi të maleve apo në vende të tjera, ushqehen në tryezën e përhershme të All'llahut.

Ti, o njeri, je më i forti i gjallesave, më i zgjuari në sjelljen e riskut. Përse i frikësohesh mosfurnizimit?! Përse vrapon drejt jetës poshtëruese e të shthurur?! Përse jeton nën thundrën e padrejtësisë, të shtypjes dhe të përçmimit?! Dil nga rrethi i errët dhe ulu në tryezën e gjerë të Krijuesit tënd dhe mos mendo për furnizimin!

Në kohën që ishe foshnje i mbyllur në barkun e nënës tënde, asnjë dorë prej duarve të nënës e të babait nuk të ushqente. Por All'llahu nuk të harroi. Ai përgatiti me shumë hollësi çdo gjë që të nevojitej në atë kohë. Si trembesh sot, ndërkohë që je krijesë e fortë dhe e zgjuar?!

Meqenëse mbërritja e furnizimit tek nevojtarët është pjesë e dijes së Tij për nevojat e tyre, Kur'ani e forcon në fund të ajetit me thënien: **"...Ai dëgjon dhe di gjithçka."**. Ai i dëgjon të gjitha fjalët dhe thëniet e tyre. Ai e di më së miri gjendjen tuaj dhe gjendjen e të gjitha krijesave të gjalla. Ai është i Mirinformuar për nevojat e të gjithëve. Ai është i Gjithëditur për gjithçka. Asgjë nuk i fshihet dijes së Tij. Dija e Tij është e pakufizuar dhe askush nuk mund ta kufizojë.

Ajetet 61 – 66

وَلَئِن سَأَلْتَهُم مَّنْ خَلَقَ ٱلسَّمَـٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ وَسَخَّرَ ٱلشَّمْسَ وَٱلْقَمَرَ
لَيَقُولُنَّ ٱللَّهُ ۖ فَأَنَّىٰ يُؤْفَكُونَ ﴿٦١﴾ ٱللَّهُ يَبْسُطُ ٱلرِّزْقَ لِمَن يَشَآءُ مِنْ عِبَادِهِۦ
وَيَقْدِرُ لَهُۥٓ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ بِكُلِّ شَىْءٍ عَلِيمٌ ﴿٦٢﴾ وَلَئِن سَأَلْتَهُم مَّن نَّزَّلَ مِنَ
ٱلسَّمَآءِ مَآءً فَأَحْيَا بِهِ ٱلْأَرْضَ مِنۢ بَعْدِ مَوْتِهَا لَيَقُولُنَّ ٱللَّهُ ۚ قُلِ ٱلْحَمْدُ لِلَّهِ
ۚ بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْقِلُونَ ﴿٦٣﴾ وَمَا هَـٰذِهِ ٱلْحَيَوٰةُ ٱلدُّنْيَآ إِلَّا لَهْوٌ وَلَعِبٌ ۚ
وَإِنَّ ٱلدَّارَ ٱلْـَٔاخِرَةَ لَهِىَ ٱلْحَيَوَانُ ۚ لَوْ كَانُوا۟ يَعْلَمُونَ ﴿٦٤﴾ فَإِذَا
رَكِبُوا۟ فِى ٱلْفُلْكِ دَعَوُا۟ ٱللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ ٱلدِّينَ فَلَمَّا نَجَّىٰهُمْ إِلَى ٱلْبَرِّ إِذَا هُمْ
يُشْرِكُونَ ﴿٦٥﴾ لِيَكْفُرُوا۟ بِمَآ ءَاتَيْنَـٰهُمْ وَلِيَتَمَتَّعُوا۟ ۖ فَسَوْفَ يَعْلَمُونَ ﴿٦٦﴾

“Nëse ti i pyet ata se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe kush i ka nënshtruar Diellin e Hënën, - me siguri që ata do të të thonë ‘All’llahu!’. Atëherë, si po largohen?”

"All'llahu ia zgjeron furnizimin kujt të dojë nga robtë e Tij, e dikujt ia zvogëlon. All'llahu është vërtet i Ditur për çdo gjë."

"Nëse ti i pyet ata se kush e zbret ujin nga qielli dhe nëpërmjet tij e gjallëron tokën pas vdekjes së saj - me siguri që ata do të të thonë 'All'llahu!'. Thuaj: 'Qoftë lëvduar All'llahu!'. Por, shumica e tyre nuk mendojnë."

"Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e Botës Tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!"

"Kur hipin në anije, ata i luten All'llahut me devotshmëri të sinqertë, por kur Ai i sjell në tokë shëndoshë e mirë, menjëherë ata i veshin Atij ortakë (në adhurim)**, për të mohuar atë që u kemi dhënë Ne dhe për t'u kënaqur. Por shpejt do ta marrin vesh!"**

Komentimi

Pohimi i monoteizmit nga brenda dhe i politeizmit nga jashtë

Ajetet e mëparshme folën rreth politeistëve, të cilët e kuptuan të vërtetën e Islamit, por nuk ishin të gatshëm të besonin e as të emigronin, prej frikës se nuk do të furnizoheshin. Kurse këto ajete, të cilat i drejtohen Profetit Muhammed, në realitet u

drejtohen të gjithë besimtarëve dhe sqarojnë argumentet e monoteizmit nëpërmjet rrugëve të krijimit, të sundimit dhe të natyrës së krijuar *(el fitratu)*. Pra, flasin për tri rrugë të ndryshme dhe u sqaron njerëzve se çdo gjë është në dorën e All'llahut, shenjat e të Cilit, i gjejnë në vetat e tyre dhe në horizonte dhe jo te idhujt, të cilët nuk sjellin as dobi e as dëm.

Ajeti i parë tregon për krijimin e Tokës e të qiejve, duke u mbështetur në besimin e tyre të brendshëm. Ajeti thotë: **"Nëse ti i pyet ata se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe kush i ka nënshtruar Diellin e Hënën, - me siguri që ata do të të thonë "All'llahu…!"**. Pra, as idhujtarët e askush tjetër nuk thotë që krijuesi i qiejve dhe i tokës dhe nënshtruesi i diellit dhe i hënës të jetë një copë gurë apo dru e prodhuar me duart e njeriut.

Me fjalë të tjera: S'ka dyshim se edhe idhujtarët nuk dyshonin në Njëtimin e Krijuesit (*Teuhid*). Ata thoshin: Ne i adhurojmë idhujt që të na afrojnë më shumë tek All'llahu. Ato idhuj janë ndërmjetës mes nesh dhe All'llahut, siç e lexojmë edhe në ajetin 18 të sures "Junus", që thotë: **"…dhe thonë: 'Këta janë ndërmjetësit tanë tekAll'llahu…'"**. Ne nuk jemi të denjë të lidhemi drejtpërsëdrejti me All'llahun, por duhet të lidhemi me Të nëpërmjet idhujve: **"Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek All'llahu."**.[1]

Ata janë të pavëmendshëm se mes Krijuesit dhe krijesës nuk ka ndarëse. Ai është më afër te ne sesa damari i qafës. Nëse njeriu, i cili përbën xhevahirin bazë në kurorën e gjithësisë nuk arrin të lidhet drejtpërsëdrejti me All'llahun, atëherë çfarë është ndërmjetësia mes tij dhe All'llahut?!

1 Sure "Zumer", ajeti 3.

Sido që të jetë, pas përmendjes së këtij argumenti të qartë, ajeti pyet: **"...Atëherë, si po largohen?"**, që do të thotë se me gjithë këto pasuri përse e kundërshtojnë adhurimin e Krijuesit të tyre dhe e zëvendësojnë adhurimin e Tij me adhurimin e gurëve e të drurëve?!

Fjala *"ju'fekune"* vjen nga fjala *"ifkun"* dhe ka kuptimin e kthimit të diçkaje në të vërtetën e saj. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe për gënjeshtrën dhe për erën që fryn në anë të kundërt.

Thënia *"ju'fekune"*, e cila përmendet në mënyrë të papërcaktuar, tregon se ata nuk kishin aftësinë e vendosjes dhe i adhuronin idhujt pa menduar e pa vullnet.

Kuptimi i nënshtrimit të diellit e të hënës është për sistemin e caktuar nga All'llahu për to. Ai e ka vendosur diellin dhe hënën në rrethin e këtij sistemi që të jenë në shërbim të njeriut.

Më pas Kur'ani, në ajetin në vazhdim, e forcon më shumë kuptimin se All'llahu është Krijuesi i krijesave dhe Furnizuesi i tyre. Ajeti thotë: **"All'llahu, ia zgjeron furnizimin kujt të dojë nga robtë e Tij, e dikujt ia zvogëlon..."**. Çelësi i furnizimit është në dorën e All'llahut dhe jo në dorën e idhujve. Më lart u sqarua se vetëm besimtarët i mbështeten All'llahut dhe në dorën e Tij është gjithçka. Nëse ata mendojnë se All'llahu është i Plotfuqishëm, por i panjohur për gjendjen e tyre, ky është gabim i madh, sepse **"...All'llahu është vërtet i Ditur për çdo gjë."**.

Vallë, a mundet që Krijuesi dhe Sunduesi t'i furnizojë krijesat me mirësitë në çdo moment dhe po në të njëjtën kohë, të jetë i paditur për gjendjen e tyre?

Në pjesën e dytë të ajeteve flitet për monoteizmin në sundim dhe për zbritjen e furnizimit nga ana e All'llahut. Ajeti thotë: **"Nëse ti i pyet ata se kush e zbret ujin nga qielli dhe nëpërmjet tij e gjallëron tokën pas vdekjes së saj, me siguri që ata do të të thonë 'All'llahu!'"**. Kjo është ajo që besojnë idhujtarët në brendinë e tyre, por nuk e pranojnë me gjuhët e tyre. Ata e dinë se Krijuesi është All'llahu dhe Ai është Sunduesi i botës dhe Rregulluesi i saj.

Pastaj Kur'ani i thotë Profetit: **"...Thuaj: 'Qoftë lëvduar All'llahu!'"**. Lavdërimi dhe falënderimi janë për Atë që i begaton dhe i mirëson të gjithë.

Ndërkohë, fjalët dhe veprat e politeistëve dhe të idhujtarëve kundërshtojnë njëra-tjetrën. Ajeti përfundon me këtë fjali: **"...Por, shumica e tyre nuk mendojnë."**.

A është e mundur që njeriu i mençur t'i kundërshtojë thëniet e tij ku njëherë të thotë se Krijuesi, Sunduesi, Rregulluesi i botës është All'llahu e pastaj t'i përulet idhujve?! Pra, nga njëra anë, besojnë në Njëshmërinë e All'llahut dhe nga ana tjetër shfaqin idhujtarinë në adhurim! Është interesante se ajeti nuk thotë: "Vërtet, shumica e tyre nuk kanë mendje", por thotë **"nuk mendojnë"**. Kuptimi është se ata kanë mendje, por nuk logjikojnë.

Për t'i shndërruar fjalët e tyre nga horizonti i kësaj jete të kufizuar në botën më të gjerë, nëpërmjet pikëpamjes së logjikës, Kur'ani sqaron në ajetin pasardhës jetën e kësaj bote në krahasim me Jetën Tjetër. Me fjalë përmbledhëse, ajeti thotë: **"Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e**

Botës Tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!".

Sa e mrekullueshme kjo thënie! Sepse fjala *"leh'un"* ka kuptimin e *"inshigal"*, që do të thotë "çdo vepër që e largon njeriun nga vetja e tij dhe e ngarkon me çështje më të rëndësishme të jetës". Kurse fjala *"la'bun"* përdoret për punët, të cilat përmbajnë një lloj imagjinate dhe janë të paqëllimshme. Kështu, në lojë, një prej lojtarëve është mbret dhe tjetri ministër, i treti, komandant ushtrie, i katërti, hajdut, i pesti simbolizon karvanin e kështu me radhë. Pas mbarimit të lojës së përkohshme, çdo gjë kthehet në vendin e saj. Çështja duket sikur nuk e kalon iluzionin dhe nuk ka ndikim.

Kështu e sqaron Kur'ani gjendjen e dynjasë, duke thënë se ajo është një lloj angazhimi dhe loje, ku njerëzit mblidhen dhe e lartësojnë me imagjinatat e tyre. Pas disa ditësh ata ndahen dhe fshihen nën dhe. Pastaj, çdo gjë paloset dhe hidhet në koshin e harresës. Ndërsa jeta e vërtetë, në të cilën s'ka zhdukje, as dhimbje, as zemërim, as frikë, as kundërthënie e as lodhje, është Jeta Tjetër. Sikur njeriu ta dijë këtë, do të ishte i përqëndruar dhe hulumtues.

Kurse ata, zemrat e të cilëve, janë të lidhura me këtë jetë dhe janë sprovuar me bukuritë dhe mirësitë e saj, shqetësohen prej saj. Ata janë si fëmijët, edhe pse janë të mëdhenj në moshë.

Duhet ditur që kutimi i fjalës *"el hajauan"* që përmendet në ajet, është për jetën. Kjo fjalë ka kuptim burimor.[1]

1 Zanafilla e fjalës vjen nga rrënja *"hajjaun"*. Burimi i kësaj fjale është *"hajjaan"*. Më pas *"ja-u"* i dytë u shndërrua në *"uau"* dhe u bë *"hajauan"*.

Fjalia: **"...Ndërsa jeta e Botës Tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë..."** tregon se jeta e vërtetë është ajo e Ahiretit dhe jo jeta e kësaj dynjaje.

Është e natyrshme se Kur'ani nuk do të mohojë e as të harrojë dhuntinë e All'llahut në këtë jetë. Ai do të trupëzojë vlerën e kësaj dynjaje me Ahiretin në formë të qartë e të drejtë. Në shtesë të gjithë kësaj, Kur'ani i tërheq vëmendjen njeriut që të mos jetë rob i dhuntive, por të jetë prijës i tyre dhe ato dhunti të mos ndikojnë në vlerat parimore.

Në fazën e tretë, Kur'ani drejtohet kah *"el fitretu"* (natyra e krijuar), kah dukja e dritës së Njëshmërisë në kohët më të vështira. Drejtohet në thellësinë e shpirtit të njeriut duke përmendur një shembull mjaft retorike e të shkëlqyer, ku thotë: **"Kur hipin në anije, ata i luten All'llahut me devotshmëri të sinqertë, por kur Ai i sjell në tokë shëndoshë e mirë, menjëherë ata i veshin Atij ortakë."**.

Vërtet, vështirësitë dhe krizat përgatisin mundësitë e hapjes së natyrës krijuese të njeriut, sepse drita e monoteizmit është e fshehur në shpirtrat e të gjithë njerëzve. Mirëpo, traditat dhe zakonet pagane dhe edukimi i gabuar hedhin mbi këtë natyrë perde dhe mbulesë. Por, kur njeriun e godasin vështirësitë dhe e rrethojnë problemet, vetvetiu, ai drejtohet kah metafizika dhe e pastron shpirtin e tij nga të gjitha llojet e politeizmit e të mosbesimit dhe bëhet vërtetues i thënies së All'llahut: **"...me devotshmëri të sinqertë..."**.

Me fjalë përmbledhëse: Në brendinë e zemrës së njeriut gjendet një pikë drite që është fija e marrëdhënies dhe e lidhjes së tij me metafizikën dhe me rrugën më të afërt për tek All'llahu.

Mësimet e gabuara, pavetëdija dhe mendjemadhësia, veçanërisht kur gjendet shëndeti dhe pasuria, e mbulojnë zemrën e njeriut. Por, furtuna e problemeve dhe e vështirësive e heqin këtë mbulesë dhe duket pika ndriçuese e zemrës. Për këtë, *Imam*ët e mëdhenj të Islamit i udhëzonin renegatët në çështjen e "njohjes së All'llahut".

Nga *Imam* Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* vjen historia e një burri dyshues rreth çështjes së njohjes së All'llahut, të cilin, *Imam*i e udhëzoi nëpërmjet rrugës së natyrës së krjiuar *(el fitrtu)*. Burri i tha *Imam* Sadikut: *"O i nipi i të Dërguarit të All'llahut, më trego për All'llahun se çfarë është Ai.Unë diskutoj shumë dhe me kanë hutuar."*.

Imam Sadiku i tha: *"O Abdullah (rob i All'llahut). A ke hipur ndonjëherë në anije?"*.

Ai i tha: *"Po"*. *Imam*i i tha: *"A të ka ndodhur që anija është çarë dhe as ajo nuk të shpëton dhe as noti nuk të sjell dobi?"*. Ai iu përgjigj: *"Po!"*. *Imam*i i tha: *"A u lidh zemra jote me diçka të aftë për të të shpëtur nga kjo situatë?"*. Burri iu përgjigj: *"Po."*. *Imam* Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: *"Ai është All'llahu. Ai është i aftë për shpëtim, sepse nuk ka shpëtues tjetër të aftë për shpëtim përveç Tij dhe Ai është Ndihmuesi."*.[1]

Në ajetin e fundit, prej ajeteve në fjalë dhe pas përmendjes së të gjitha atyre argumenteve rreth Njëtimit dhe adhurimit të All'llahut, Kur'ani u drejtohet politeistëve dhe jobesimtarëve me

1 "Biharul Anuar", vëll. 3, f. 41 (botim i ri).

një kërcënim të ashpër. Ajeti thotë se ata mohuan shenjat dhe Shpalljet Tona, ishin mosmirënjohës për atë që u dhamë. Atëherë le të kënaqen për pak ditë: **"Për të mohuar atë që u kemi dhënë Ne dhe për t'u kënaqur. Por shpejt do ta marrin vesh!"** se ku do t'i shpjerë mosbesimi i tyre.

Në ç'sprovë dhe në ç'fund të dhembshëm do të bien?!

Edhe pse ajeti flet për mosbesimin dhe mohimin e shenjave dhe Shpalljeve të All'llahut, është e natyrshme që të ketë edhe kuptimin e kërcënimit. Kjo është njëlloj sikur t'i themi një krimineli: Bëj çfarë të duash, por shumë shpejt do të provosh hidhësinë e punëve të tua! Në këto thënie, edhe pse përdoret forma urdhërore, qëllimi pas saj është kërcënimi dhe jo kërkesa.

Është interesante se fjalia **"...do ta marrin vesh..."** (seufe ja'lemun) ka ardhur në formë të përgjithshme. Ajo nuk thotë: "...çfarëdo që bëjnë...". Por thotë "...shumë shpejt do ta dinë, do ta marrin vesh...". Ky është kuptimi i thënies **"...Por shpejt do ta marrin vesh!"**.

Përdorimi i kësaj thënieje në formë përgjithësuese është bërë që kuptimi i saj të jetë i gjerë dhe të mos kufizohet në mendjen e dëgjuesit. Rezultati i punëve të këqija është dënimi i All'llahut, demaskimi në të dy jetët dhe përfundimi i keq.

Hulumtim

Fatkeqësitë dhe ndriçimi i natyrës së krijuar fillestare *(el fitretu)*

Në komentimin e ajeti 30 të sures "Rrum" do të flasim në mënyrë të detajuar rreth *"el fitretu"*, parimit të monoteizmit dhe njohjes së All'llahut. Ajo që duhet përmendur këtu është se Kur'ani i Shenjtë, në shumë ajete flet për problemet dhe vështirësitë dhe se ato nxisin dhe shtyjnë në shfaqjen e natyrës fillestare të krijuar të njeriut. Pra, problemet dhe vështirësitë janë shkak i ndriçimit të fitretit. Në disa ajete të tij Kur'ani thotë: **"Çdo mirësi që keni, është nga All'llahu. E, nëse ju godet ndonjë fatkeqësi, prapë nuk keni kujt t'i kërkoni ndihmë përveç Tij."**.

Dhe: **"E prapëseprapë, kur Ai jua shmang fatkeqësinë, disa nga ju i shoqërojnë Zotit të vet** (zota të tjerë në adhurim)**, duke mohuar kështu mirësitë që u dhamë Ne. E po mirë, kënaquni edhe pak, sepse së shpejti do ta merrni vesh!"**.[1]

Ky kuptim gjendet edhe në suren "Junus", por me një mënyrë tjetër: **"E, kur njeriun e gjen e keqja, atëherë Na lutet shtrirë ose ulur, ose në këmbë. E, sapo Ne ia largojmë të keqen, vazhdon rrugën, thuajse nuk Na është lutur për fatkeqësinë që e ka goditur…"**.[2]

Gjithashtu, ky kuptim përmendet edhe në suren "Rrum", ajeti 32; në suren "Zumer", ajeti 49; në suren "Isra", ajetet 67-69,

1 Sure "Nahl", ajetet 53-55.
2 Sure "Junus", ajeti 12.

me shprehje të ndryshme dhe me tregues të mbushur me kuptime.

Në ajetet në fjalë lexuam se idhujtarët në gjendje të zakonshme drejtoheshin kah idhujt, por kur udhëtonin në det dhe i rrethonin dallgët dhe furtuna dhe anija e tyre lëvizte si kashta në mesin e dallgëve që e shtynin andej-këndej, zemrat i ndriçoheshin me dritën e Teuhidit (monoteizmit). Në këto momente i linin të gjitha idhujt e prodhuara dhe i pastronin plotësisht zemrat e tyre. Por ky pastrim ishte i detyruar dhe i pavlerë, sepse sapo qetësohej situata, ktheheshin në gjendjen e zakonshme të mëparshme. Në këtë mënyrë, binte mbulesa e natyrës së pastër krijuese dhe dukeshin gjembat e politeizmit e të idhujtarisë.

Mund të thuhet se kjo gjendje është si rezultat i fiksimeve mendore, i kulturës shoqërore dhe i ideve rrethuese. Këto thënie mund të pranohen nëse çështja është e posaçme për besimtarët apo për ata të cilët janë rritur në një mjedis fetar.

Mirëpo, kjo gjendje ndodh edhe te mohuesit më të ashpër të All'llahut dhe në shoqëritë jofetare. Atëherë sqarohet se rrënjët e kësaj çështjeje ndodhen në ndërgjegjen (jo të vetëdijshme) e njeriut dhe në brendësi të natyrës së tij të krijuar.

Ajetet 67 - 69

أَوَلَمۡ يَرَوۡاْ أَنَّا جَعَلۡنَا حَرَمًا ءَامِنًا وَيُتَخَطَّفُ ٱلنَّاسُ مِنۡ حَوۡلِهِمۡۚ أَفَبِٱلۡبَٰطِلِ يُؤۡمِنُونَ وَبِنِعۡمَةِ ٱللَّهِ يَكۡفُرُونَ ٦٧ وَمَنۡ أَظۡلَمُ مِمَّنِ ٱفۡتَرَىٰ عَلَى ٱللَّهِ كَذِبًا أَوۡ كَذَّبَ بِٱلۡحَقِّ لَمَّا جَآءَهُۥٓۚ أَلَيۡسَ فِي جَهَنَّمَ مَثۡوٗى لِّلۡكَٰفِرِينَ ٦٨ وَٱلَّذِينَ جَٰهَدُواْ فِينَا لَنَهۡدِيَنَّهُمۡ سُبُلَنَاۚ وَإِنَّ ٱللَّهَ لَمَعَ ٱلۡمُحۡسِنِينَ ٦٩

"Vallë, a nuk e shohin ata se si Ne u kemi dhënë atyre një vend të shenjtë e të sigurt, ndërkohë që njerëzit rreth tij po grabiten? A mos vallë ata besojnë në gjëra të kota, ndërsa dhuntitë e All'llahut i mohojnë?"

"'Kush është i padrejti më i madh se ai që trillon gënjeshtra kundër All'llahut ose mohon të vërtetën që i ka ardhur?!' Vallë, a nuk është Xhehennemi vend për jobesimtarët?!"

"Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, All'llahu është me punëmirët!"

Shkaku i zbritjes

Në tefsirin "Durr'rrul Menthur", në komentimin e ajetit në fjalë, është transmetuar një thënie nga ibn Abbasi: Një grup prej politeistëve ka thënë: *"O Muhammed, ajo që na pengon të hyjmë në fenë tënde është frika se njerëzit do të na grabisin për shkak të pakicës sonë, ndërkohë që arabët janë më shumë se ne. Kur ta marrin vesh që kemi hyrë në fenë tënde, do të na rrëmbejnë dhe do të jemi koka të ngrëna."*. Atëherë zbriti ajeti: **"Vallë, a nuk e shohin ata se si Ne u kemi dhënë atyre një vend të shenjtë e të sigurt ..."** si përgjigje e thënies së tyre.

Komentimi

Ajetet e mëparshme treguan për disa argumente të pabaza të politeistëve dhe të jobesimtarëve. Ata thoshin se i frikësoheshin jetës, nëse e shfaqnin besimin dhe emigronin me Muhammedin. Kur'ani iu përgjigj atyre me rrugë dhe mënyra të ndryshme.

Në ajetet në fjalë, Kur'ani u përgjigjet atyre me tjetër metodë dhe u thotë: **"Vallë, a nuk e shohin ata se si Ne u kemi dhënë atyre një vend të shenjtë e të sigurt..."**, pra, tokën e Mekës së bekuar. Ndërkohë që arabët jashtë Mekës jetonin të pasigurtë, ku fiset merreshin me vjedhje, me grabitje e mësymje, toka brenda Mekës ishte e sigurtë: **"...ndërkohë që njerëzit rreth tij po grabiten...?"**.

All'llahu i Plotfuqishëm, i Cili në mesin e detit të tërbuar dhe të furtunës mësymëse të "pasigurisë" në tokën e Hixhazit, bëri një ishull të qetë e të sigurtë, si ka mundësi që nuk mund ta mbronte atë prej armiqve?! Pse kanë frikë njerëzit e dobët përballë fuqisë madhështore të All'llahut të Madhëruar? **"…A mos vallë ata besojnë në gjëra të kota, ndërsa dhuntitë e All'llahut i mohojnë?"**

Me fjalë përmbledhëse: Vërtet, All'llahu i Madhëruar është i Plotfuqishëm që në një tokë të trazuar dhe në mesin e një grupi njerëzish të ashpër, të bëjë një zonë të vogël të qetë. Si ka mundësi që Ai nuk mund ta ruajë një grup të pakët besimtarësh, të cilët jetojnë në mesin e shumicës jobesimtare?!

Pas përmendjes së këtij argumenti të qartë, në ajetin pasardhës, Kur'ani arrin në rezultatin: **"Kush është më i padrejtë, sesa ai që trillon gënjeshtra kundër All'llahut ose mohon të vërtetën që i ka ardhur…?!"**.

Ne iu paraqitëm juve argumente të qarta se askush nuk e meriton adhurimin më shumë se All'llahu. Por ju gënjyet kundër All'llahut dhe i shoqëruat ortakë Atij me duart tuaja dhe pretendoni se vepra juaj është rruga e All'llahut.

Nga ana tjetër, Kur'ani që Ne e zbritëm për ju ka shumë argumente të qarta, por ju nuk interesoheni për të dhe e keni hedhur pas shpinave tuaja. A ka padrejtësi më të madhe se kjo?! Ju i bëtë padrejtësi vetave tuaja, sepse idhujtaria është padrejtësi e madhe.

Me fjalë të tjera: Vallë, a është padrejtësia në kuptimin e saj të gjerë vetëm nxjerrja dhe devijimi i diçkaje nga vendi që e

meriton? A ka gjë më të keqe sesa dukuria kur njeriu e quan një copë gurë apo dru të punuar e të pavlerë, ortak të Krijuesit të Madhëruar, i Cili krijoi qiejtë dhe Tokën? Në shtesë të kësaj, idhujtaria është burimi i të gjitha të këqijave shoqërore. Në realitet, prej padrejtësive burojnë: vetëpëlqimi, adhurimi i postit, adhurimi i kësaj jete, e të gjitha këto janë lloje të idhujtarisë.

Por dijeni se fundi fatkeq dhe poshtërues është për jobesimtarët: **"...Vallë, a nuk është Xhehennemi vend për jobesimtarët?!"**.

Është mirë të përmendet se në Kur'an, për disa persona thuhet se janë më të padrejtët dhe kjo përmendet në 15 vende. Në të gjitha këto vende fillohet me shprehjen pyetësore **"kush është më i padrejtë"**. Të përqëndruarit në këto ajete tregon se ajetet e përmendura, edhe pse zgjidhin çështje të ndryshme, flasin që të gjitha për shirkun. (Për sqarime, lexo komentimin e ajetit 21të sures "En'am".)

Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë, i cili është edhe ajeti i fundit i sures "Ankebut", sqaron një realitet të rëndësishëm, i cili është esenca e të gjithë sures dhe është në përputhje me fillimin e saj. Ajeti thotë se ecjen në rrugën e All'llahut dhe në rrugën e njohjes së të vërtetës e rrethojnë vështirësi dhe probleme të shumta, ku prej tyre është vesvesi i shejtanit, kokëfortësia e armiqve dhe e të padrejtëve dhe problemi i devijimit të mundshëm. Por këtu është një e vërtetë konstante se All'llahu jep fuqi, bindje dhe qetësi përballë problemeve dhe Ai është Mbrojtësi. Ajeti thotë: **"Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, All'llahu është me punëmirët!"**.

Për fjalën *"xhihad"* që përmendet këtu ka disa mendime. A është xhihad ndaj armiqve? Xhihad ndaj vetes? Apo xhihad në rrugën e njohjes së All'llahut nëpërmjet rrugëve shkencore? Komentuesit kanë disa mendime rreth kësaj teme.

Po ashtu, kuptimi i fjalës *"fijna"* që përmendet në ajet, a është për rrugën e All'llahut?! Për rrugën e xhihadit me veten? Për xhihadin në adhurim? Apo për përballjen me armikun?

Është mëse e qartë se fjala"*xhihad"* ka kuptim të gjerë. Njësoj është edhe fjala*"fijna"*, e cila përfshin çdo përpjekje dhe sakrificë në rrugën e All'llahut, për hir të Tij dhe për të arritur në qëllimet e shenjta. E gjitha kjo vërteton thënien *"xhahedu fijna"* (sakrifikojnë, përpiqen dhe luftojnë në rrugën Tonë) - qoftë kjo në rrugën e fitimit të njohjes, në xhihadin ndaj vetes, në përballjen me armiqtë, në rrugën e durimit, në adhurim e në gjynahe, në rrugën e ndihmesës së të paaftëve e të privuarve, a në përpjekjen për kryerjen e veprave të mira.

Nga ajo që thamë sqarohet se kuptimi i fjalës *"subul"* është për rrugët e shumta që mbarojnë tek All'llahu i Madhëruar, si rruga e xhihadit ndaj vetes, rruga e xhihadit ndaj armikut, rruga e dijes dhe e kulturës. Me fjalë përmbledhëse themi: Xhihadi në çdo rrugë prej këtyre rrugëve është shkak i udhëzimit që përfundon tek All'llahu. Ky është premtim që All'llahu ua ka bërë të gjithë muxhahidinëve (përpjekësve, sakrifikuesve dhe luftuesve) në rrugën e Tij. Këtë e ka forcuar më shumë me germën *"lam"* (të

forcimit) dhe me germën *"nun"* (të rëndë).[1] Mbarësia, triumfi dhe përparimi kanë si bosht dy gjëra: xhihadin dhe qëllimin e pastër.

Një grup filozofësh besojnë se meditimi dhe leximi nuk sjellin dije, por ato e përgatisin shpirtin e njeriut për të pranuar format e të logjikshmeve. Kur shpirti i njeriut përgatitet për pranim, atëherë nga ana e Krijuesit të Lartë zbret mirësia e dijes dhe e urtësisë.

Për këtë, duhet që njeriu të përpiqet, të sakrifikojë e të luftojë në këtë rrugë dhe udhëzimi është në dorë të All'llahut. Në një hadith lexojmë: *"Nuk është dija te larmia e të mësuarit, por ajo është dritë që All'llahu e hedh në zemrën e atij që do."*. Edhe ky mund të jetë vërtetues i asaj që përmendëm.

Dy hulumtime

Xhihadi dhe sinqeriteti

Nga ajetet e lartpërmendura sqarohet fare mirë se nëse goditemi prej çfarëdolloj humbjeje apo mosmbarësie, kjo vjen për shkak të dy gjërave: ose ne neglizhojmë në xhihadin tonë, ose nuk jemi të sinqertë në vepra e punë. Bazuar në premtimin e All'llahut, triumfi dhe udhëzimi janë të padiskutueshëm.

1 Këto dy germa përdoren në gjuhën arabe për të forcuar një çështje dhe për ta bërë të padyshuar. Sh.p.

Sikur të mendonim mirë, do të arrinim të kuptonim se sulmet e problemeve dhe të vështirësive në shoqërinë islame, kanë ardhur si pasojë e lënies së xhihadit dhe të pasinqeritetit.

Përse u vonuan myslimanët, të cilët deri dje ishin pararojë? Ata nuk ia kishin nevojën të tjerëve në asgjë, qoftë në ligje e kulturë dhe në sisteme të posaçme.

Ata nuk kërkonin ndihmën e të tjerëve për të mbrojtur vetat e veta nga rrymat e ndryshme politike dhe nga sulmet ushtarake. Më parë ishin të tjerët që uleshin në tryezën e myslimanëve, e cila ishte e pasur me dije me njohje dhe me kulturë. Ndërsa sot janë myslimanët të cilët ulen në tryezat e të tjerëve. Së fundi: Përse i shohim myslimanët të robëruar në dorën e të tjerëve dhe vendet e tyre të pushtuara nga të padrejtët?

Përgjigjja e të gjitha këtyre pyetjeve është e kufizuar në një shkak të vetëm që është "harresa e xhihadit dhe pasinqeriteti" i tyre.

Vërtet, ata e neglizhuan xhihadin (përpjekjen) në fushën shkencore, kulturore, politike, ekonomike dhe ushtarake. Vetëpëlqimi, dashuria dhe admirimi i kësaj dynjaje, kërkimi i qetësisë, horizontet e ngushta dhe interesat personale, janë bërë qëllimi kryesor i jetës së tyre. Më shumë lutojnë kundër njëri-tjetrit, sesa kundër armikut të tyre.

Kur të duket pak sinqeritet në mesin tonë dhe të duket një lëvizje sado e pakët e përpjekësve dhe sakrifikuesve të vërtetë, triumfi do të jetë aleati ynë gjithmonë. Prangat e robërimit do të thyhen, plogështia do të shndërrohet në shpresë të ndritur,

fatkeqësia në lumturi, poshtërsia në krenari e kryelartësi. Po ashtu, ndarja dhe përçarja shndërrohen në bashkim dhe unitet.

Sa madhështore kjo thënie e Kur'anit! Sa retorike dhe frymëzuese! Në një fjali të vetme ka bashkur sëmundjen dhe shërimin.

S'ka dyshim se sakrifikuesit në rrugën e All'llahut i përfshin udhëzimi i Tij. S'ka udhëzim më të mirë se udhëzimi i All'llahut. S'ka humbje pas këtij udhëzimi e as mposhtje.

Në disa transmetime vëmë re se ajeti është komentuar për Ehli Bejtin e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe për pasuesit e tyre. Ajo është vërtetësi e plotë.

Në ajet nuk ka argument për kufizimin e kuptimit të tij. Sido që të jetë, çdo njeri e kupton këtë të vërtetë kur'anore në përpjekjet dhe sakrificat e tij. Nëse punon për All'llahun duke sakrifikuar, i gjen të gjitha portat e hapura dhe problemet zgjidhen me lehtësi.

Njerëzit janë tre llojesh

- Lloji kokëfortë e i pabindur, të cilit nuk i sjell dobi asnjë lloj udhëzimi.

- Lloji përpjekës, i zellshëm dhe i sinqertë. Ky lloj arrin tek e vërteta.

- Lloji i tretë është më lart se lloji i dytë. Këta lloj njerëzish nuk janë të largët nga e vërteta e as të ndarë prej saj, sepse ata gjithmonë janë me të vërtetën.

Ajeti i lartpërmendur **"Kush është më i padrejtë më i madh se ai që trillon gënjeshtra kundër All'llahut ose mohon të vërtetën që i ka ardhur...?!"** është për llojin e parë. Kurse fjalia: **"...Ata që luftojnë në rrugën Tonë..."** është për llojin e dytë. Fjalia: **"...Vërtet, All'llahu është me punëmirët!"** është për llojin e tretë.

Nga kjo thënie përfitohet se pozita e punëmirëve është më e lartë se e muxhahidinëve, sepse punëmirët, në shtesë të përpjekjeve, sakrificave dhe luftës së tyre në rrugën e All'llahut për të shpëtuar vetat e tyre, përpiqen edhe për të tjerët. Ata u bëjnë mirë atyre dhe përpiqen t'i ndihmojnë ata.

O Zoti ynë, na mbarëso e na mëshiro! Mos na i lidh duart nga përpjekja dhe sakrifica! O Zoti ynë, na jep sinqeritetin, që të mos mendojmë për diçka tjetër veçse për Ty dhe të ecim vetëm drejt Teje! O Zoti ynë, na i lartëso shkallët, që të arrijmë në gradën e muxhahidinëve dhe të fitojmë vendin e punëmirëve! Na dhuro udhëzimin Tënd në jetën tonë!

Sure "Er Rrum"

Vendzbritja: Mekë

Numri i ajeteve: 60

Përmbajtja e sures "Rrum"

Kjo sure ka zbritur në Mekë dhe siç është e nohur, përmbajtja e sureve mekase është e qartë. Para çdo gjëje, ato flasin për çështjen e besimit në krijim dhe në Ringjallje. Sepse periudha e Mekës ka qenë ajo e mësimit të besimit të pastër dhe themelor të Islamit, si: monoteizmi, përballja me politeizmin, njohja me Jetën Tjetër, me Ringjallen, me tubimin, me Gjykatën e All'llahut e të tjera. Po ashtu, nëpërmet hulumtimit të këtyre çështjeve, flet edhe për çështje të tjera që kanë lidhje me ato që përmendëm.

Përmbajtja e saj mund të ndahet në shtatë pjesë:

1- Lajmërimi për fitoren e romakëve ndaj persëve në një betetjë që do të ndodhë në të ardhmen. Kjo për faktin se mes myslimanëve dhe politeistëve ndodhi një bisedë rreth kësaj çështjeje. Sqarimet e kësaj çështjeje do të vijnë në faqet e ardhshme me lejen e All'llahut.

2- Të menduarit të jomyslimanëve dhe gjendja e tyre. Pastaj u përmend atyre kërcënimet me dënimin dhe ndëshkimin e All'llahut në Ditën e Kiametit.

3- Përmban një pjesë prej shenjave madhështore të All'llahut në Tokë e në qiell, në ekzistencën e njeriut. Flet për nxjerrjen e të gjallit prej të vdekurit dhe nxjerrjen e të vdekurit nga i gjalli, krijimin e njeriut prej balte, për sistemin e jetës bashkëshortore tek njerëzit, për marrëdhëniet e dashurisë dhe të respektit mes bashkëshortëve, për krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe ndryshimin e gjuhëve, për mirësinë e gjumit gjatë natës dhe për lëvizjen gjatë ditës, për dukjen e vetëtimës e të bubullimës, për

shiun, për jetën në Tokë dhe vdekjen pas saj dhe për menaxhimin e Tokës dhe të qiellit nga All'llahu.

4- Flet për monoteizmin "fitrij" (natyrës së parë krijuese tek njeriu) pas sqarimit të argumenteve në horizonte dhe në vetat e njerëzve për njohjen e All'llahut të Madhëruar.

5- Sqarimi i gjendjes së jobesimtarëve dhe mëkatarëve dhe detajimi i gjendjes së tyre. Dukja e shkatërrimit në Tokë, si rezultat i gjynaheve të tyre.

6- Tregon për çështjen e posedimit të pasurisë, për të drejtat e të afërmve dhe për dënimin e kamatës.

7- Përsëri flet për argumentet e monoteizmit, shenjat e All'llahut dhe gjurmët e Tij dhe çështjet që kanë lidhje me Ringjalljen.

Në përgjithësi, në këtë sure, ashtu si në suret e tjera të Kur'anit, ka çështje argumentuese, emocionale dhe shprehimore të përziera së bashku dhe kanë si qëllim edukimin dhe udhëzimin e njerëzve.

Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Nga *Imam* Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është transmetuar, siç e sqaruam edhe te mirësia e leximit të sures "Ankebut", se ka thënë: "*Kush e lexon suren 'Ankebut' dhe suren 'Rrum' në muajin e Ramazanit dhe në natën e njëzet e tretë, betohem në All'llahun, o Aba*

Muhammed, se do të jetë prej banorëve të Xhennetit…! Vërtet, këto dy sure kanë pozitë tek All'llahu.".[1]

Në një hadith tjetër të ardhur nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: "*Kush e lexon këtë sure, do të marrë dhjetë të mira me numrin e çdo meleku që e lartëson All'llahun në qiell e në Tokë dhe e kupton atë që i humbet në ditën dhe në natën e tij.*".[2]

Është e natyrshme se ai që e vendos përmbajtjen e kësaj sureje, e cila është mësim i përgjithshëm për monoteizmin dhe për Gjykatën Supreme në Ditën e Gjykimit, në zemrën dhe në shpirtin e tij, që në çdo moment e kujton All'llahun dhe beson në Ditën e Gjykimit, pa dyshim që devotshmëria do të mbushë zemrën e tij derisa të jetë vërtetues i këtij shpërblimi.

1 "Theuabul A'mal", i Sadukut, sipas asaj që përcjell komentimi "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 169.

2 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f, 294, fillimi i sures "Rrum".

Ajetet 1 – 7

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

الٓمٓ ﴿١﴾ غُلِبَتِ ٱلرُّومُ ﴿٢﴾ فِيٓ أَدۡنَى ٱلۡأَرۡضِ وَهُم مِّنۢ بَعۡدِ غَلَبِهِمۡ
سَيَغۡلِبُونَ ﴿٣﴾ فِي بِضۡعِ سِنِينَۗ لِلَّهِ ٱلۡأَمۡرُ مِن قَبۡلُ وَمِنۢ بَعۡدُۚ وَيَوۡمَئِذٖ
يَفۡرَحُ ٱلۡمُؤۡمِنُونَ ﴿٤﴾ بِنَصۡرِ ٱللَّهِۚ يَنصُرُ مَن يَشَآءُۖ وَهُوَ ٱلۡعَزِيزُ
ٱلرَّحِيمُ ﴿٥﴾ وَعۡدَ ٱللَّهِۖ لَا يُخۡلِفُ ٱللَّهُ وَعۡدَهُۥ وَلَٰكِنَّ أَكۡثَرَ ٱلنَّاسِ لَا
يَعۡلَمُونَ ﴿٦﴾ يَعۡلَمُونَ ظَٰهِرٗا مِّنَ ٱلۡحَيَوٰةِ ٱلدُّنۡيَا وَهُمۡ عَنِ ٱلۡأٓخِرَةِ هُمۡ
غَٰفِلُونَ ﴿٧﴾

"Elif, Lâm, Mîm."

"U mundën bizantinët."

"Në afërsi të Tokës, por pas thyerjes së tyre, me siguri do të fitojnë."

"Brenda disa vjetëve. Me të vërtetë, është vendimi i All'llahut, si për të parën dhe për të dytën. Dhe, atë ditë, do të gëzohen besimtarët."

"Për ndihmën e All'llahut; Ai ndihmon kë të dojë dhe është i Plotfuqishëm e Mëshirëplotë."

"(Ky është) **premtimi i All'llahut, e All'llahu nuk e thyen premtimin e Vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë."**

"Ata dinë vetëm anën e dukshme të kësaj jete, ndërsa për Jetën Tjetër janë të pakujdesshëm."

Shkaku i zbritjes

Komentuesit e mëdhënj janë të një mendimi se ajetet e para të kësaj sureje kanë zbritur në fund të luftës mes bizantëve dhe persëve, në të cilën fituan persët. Në atë kohë, Profeti ishte në Mekë dhe besimtarët përbënin pakicën. Këtë triumf të persëve politeistët e konsideruan punë të mirë dhe e quajtën argument të së vërtetës së politeistëve dhe të politeizmit. Ata thanë: Vërtet, persët janë mexhusa (zjarrdhurues) dhe idhujtarë. Kurse romakët janë të krishterë prej ithtarëve të Librit. Ashtu siç triumfuan persët ndaj bizantëve, po ashtu triumfi përfundimtar do të jetë i politeistëve dhe Islami do të zhduket shpejt dhe fitorja do të jetë aleati ynë.

Edhe pse ky konkluzion ishte i pabazë dhe i zbrazët në argumentim, nuk ishte i zbrazët në ndikim në mesin e atij mjedisi dhe në përhapjen e tij në mesin e njerëzve të paditur. Për këtë, kjo çështje ishte e vështirë për myslimanët.

Prandaj, zbritën ajetet e lartpërmendura: Nëse persët triumfojnë ndaj bizantëve, pas një kohe të shkurtër, do të vijë triumfi dhe fitorja e bizantëve ndaj persëve dhe e caktuan kohën e triumfit të bizantëve ndaj persëve me thënien: **"Brenda disa vjetëve."**. Kjo thënie e parakohshme, nga njëra anë, është argument për mrekullinë e Kur'anit, këtij Libri qiellor, dija e të cilit bazohet te Krijuesi Absolut. Nga ana tjetër, ishte një vepër e mirë për myslimanët përballë veprës së politeistëve, derisa disa myslimanë vunë kapare e baste me politeistët rreth kësaj çështjeje të rëndësishme. Në atë kohë nuk kishte zbritur akoma rregulli i ndalimit të këtij kushti.[1]

Komentimi

Parashikimi i habitshëm

Kjo sure është një prej njëzet e nëntë sureve që fillojnë me germa të veçuara: **"Elif, Lâm, Mîm."**.

Këtë temë e kemi hulumtuar disa herë në komentimin e germave të veçuara, sidomos në fillim të sures "Bekare", "Ali imran" dhe "A'raf". Ndryshimi i vetëm që vërejmë këtu është se

1 Ky shkak i zbritjes gjendet në libra të ndryshëm komentimesh me pak ndryshime në shprehje. Shiko komentimet: "Mexhmaul Bejan"; "El Mijzan"; "Nuruth Thekalejn"; "El Kebijr"; "Ruhul Xhinan"; "El Alusij"; "Fi dhilalil Kur'an"; dhe komentime të tjera.

në shumë sure të tjera, pas germave të veçuara, flitet për madhështinë e Kur'anit, kurse në këtë sure, pas germave të veçuara, flitet për thyerjen e bizantëve dhe për triumfin e tyre në të ardhmen. Por, me një vështrim të hollësishëm do të sqarohet se edhe këtu flitet për madhështinë e Kur'anit, sepse lajmi i fshehur (*gajbij*) që ka lidhje me të ardhmen, është argument i mrekullisë së Kur'anit dhe i madhështisë së këtij Libri qiellor.

Pas germave të veçuara, Kur'ani thotë: **"U mundën bizantinët." "Në afërsi të tokës…"** ata janë pranë jush, o banorë të Mekës, sepse ata janë në veri të Gadishullit arabik, në tokat e Shamit në zonën mes "Basra" dhe "Adhreat". Nga këtu mësohet se kuptimi i fjalës *bizantë* këtu është për bizantë lindorë dhe jo ata perëndimorë. Shejh Tusij në tefsijrin "Et Tibjan" thotë se ka mundësi që thënia *"edna erdh"* – *"pranë tokës"*, të jetë për një vend pranë Persisë. Që do të thotë, se beteja ndodhi në pikën më të afërt mes bizantëve dhe persëve.[1]

Është e vërtetë që komentimi i parë është më i përshtatshsëm, sepse fjala *"el erdh"* ka *"elif"* dhe *"lam"*. Por nga anët e tjera, siç do ta përmendim, duket se komentimi i dytë është më i saktë.

Këtu gjendet një komentim i tretë. Ndoshta edhe ky nuk ndryshon për nga rezultati me komentimin e dytë. Ai thotë se kuptimi i kësaj toke është për tokën e bizantëve. Kjo ka kuptimin se ata triumfuan në pikën më të afërt të kufirit të tyre me persët. Kjo tregon për rëndësinë e kësaj thyerjeje, sepse mposhtja në zona të largëta nuk është e rëndësishme. E rëndësishme është që një shtet të mposhtet në pikën më të afërt të kufirit të saj me armikun.

1 Tefsiri "Et Tibjan", vëll. 8, f. 206.

Kjo, sepse ky vend është më i fortë dhe më i ashpër se në zona të tjera. Për këtë, përmendja e fjalisë **"Në afërsi të tokës…"** tregon për rëndësinë e kësaj mposhtjeje.

Sigurisht, ky parashikim për triumfin dhe fitoren e një vendi të mposhtur pas disa vitesh, në të ardhmen ka rëndësi më të madhe, sepse kjo nuk mund të realizohet vetëm nëpërmjet rrugës së mrekullisë. Më pas Kur'ani thotë: **"…por pas thyerjes së tyre, me siguri do të fitojnë."**. Ata janë bizantinët. Edhe pse shprehja **"do të fitojnë"** është e mjaftueshme për sqarim, është përmendur në formë të posaçme edhe thënia: **"pas thyerjes së tyre"** për të sqaruar më shumë rëndësinë e kësaj fitoreje. Kjo sepse nuk pritet që një grup i mposhtur të fitojë në pikën më të afërt të kufirit të saj dhe në kohë të shkurtër. Mirëpo Kur'ani lajmëron qartë për këtë ndodhi që s'ka ndodhur akoma.

Pastaj sqaron kohën e shkurtër prej këtyre viteve duke thënë: **"Brenda disa vjetëve…"**.[1] Dihet se *"bidh'atun"* është e pakta tre dhe e shumta nëntë. Kur All'llahu informon për të ardhmen, kjo është sepse: **"…Me të vërtetë, është vendimi i All'llahut, si për të parën dhe për të dytën…"**.

Është e natyrshme që gjithçka të jetë në dorën e All'llahut, në urdhrin e Tij dhe me dëshirën e Tij. Kjo nuk bie ndesh me zgjedhjen, dëshirën, lirinë dhe përpjekjen tonë në rrugën e qëllimeve tona të parashikuara.

1 Ka supozime të shumta për kuptimin e fjalës *"bidh'atun"* – *"disa"*. Disa kanë thënë se shkon nga tre deri në dhjetë, apo mes njëshit dhe nëntës. Thuhet se më e pakta është gjashtë dhe më e shumta, nëntë, por ajo që përmendëm në tekst është më e njohura.

Me fjalë të tjera: vërtet, kjo thënie nuk zhvesh zgjedhjen prej të tjerëve, por sqaron se i Plotfuqishmi dhe Poseduesi Absolut është All'llahu dhe gjithçka është prej Tij.

Më pas Kur'ani shton se nëse sot gëzohen politeistët për fitoren e persëve ndaj bizantëve, bizantët do të fitojnë: **"…Dhe, atë ditë, do të gëzohen besimtarët."**. Vërtet, ata gëzohen: **"Për ndihmën e All'llahut; Ai ndihmon kë të dojë dhe është i Plotfuqishëm e Mëshirëplotë."**.

Çfarë është gëzimi i besimtarëve?

Disa kanë thënë: Kuptimi është për gëzimin e tyre prej fitores së bizantëve, edhe pse ishin në rreshtat e politeistëve. Por, përderisa kanë libër qiellor, fitorja e tyre ndaj mexhusëve (zjarradhuruesve) konsiderohet prej fitoreve të "monoteizmit" mbi "politeizmin".

Disa të tjerë kanë thënë: Vërtet besimtarët gëzohen sepse këtë vepër e quajtën të mirë dhe argument për triumfin e tyre ndaj politeistëve.

Ose, ata u gëzuan sepse në atë ditë u shfaq madhështia dhe vërtetësia e Kur'anit dhe e thënieve të tij të prera dhe ishte fitore shpirtërore për besimtarët.

Nuk është i largët edhe supozimi se fitorja e bizantëve ishte e shoqëruar me disa fitore të myslimanëve ndaj politeistëve. Veçanërisht, disa komentues thanë se kjo fitore është si ajo e Bedrit apo ajo e Hudejbijes. Edhe kjo në vetvete quhet fitore e

madhe. Kjo sepse thënia *me ndihmën e All'llahut* gjithashtu është në përshtatje me këtë kuptim.

Përmbledhje: Vërtet mylimanët besimtarë u gëzuan atë ditë për disa arsye:

1- Prej fitores së ithtarëve të Librit ndaj mexhusitëve, sepse ajo është fushëbeteja e fitores së monoteistëve ndaj politeistëve.

2- Prej fitores shpirtërore, për shkak të shfaqjes së mrekullisë së Kur'anit.

3- Prej fitores së krahasuar me fitore dhe supozohet se është pajtimi i Hujdebijes apo disa çlirime të myslimanëve.

Për ta forcuar edhe më shumë, Kur'ani shton: **"**(Ky është) **premtimi i All'llahut, e All'llahu nuk e thyen premtimin e Vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë."**.[1] Shkaku është padija e njerëzve dhe mosnjohja e All'llahut dhe e fuqisë së Tij nga ana e tyre. Ata nuk e kanë njohur All'lahun ashtu siç duhet njohur. Ata nuk e dinë këtë të vërtetë se All'llahu kurrë nuk e shkel premtimin e Tij sepse shkelja e premtimit bëhet ose nga padituria, ose nga dobësia dhe paaftësia. Por All'llahu kurrë nuk e shkel dhe nuk e thyen premtimin e Tij, sepse Ai është i Gjithëditur, i Plotfuqishëm për çdo gjë.

Pastaj Kur'ani vazhdon e thotë: **"Ata dinë vetëm anën e dukshme të kësaj jete, ndërsa për Jetën Tjetër janë të pakujdesshëm."**.

1 Thënia *"uadAll'llahi"* ka *fet'ha* (zanoren *e*), sepse është *mef'ul mutlak* (kundrinor i përgjigjshëm) dhe faktori i tij është i papërmendur dhe kuptohet prej fjalisë para saj *"sejeglebune"*, e cila është vërtetësi e premtimit të All'llahut. Aludimi është: All'llahu e ka bërë atë premtim.

Ata njohin vetëm këtë jetë. Jo vetëm kaq, ata njohin vetëm të dukshmen e saj dhe binden me të. Kjo dynja për ata është lojë, zbavitje, kënaqësi kalimtare, gjumë, iluzion etj.

Sikur ta dinin të brendshmen e kësaj jete dhe realitetin e saj, do të mjaftonte për njohjen e Ahiretit! Kjo sepse, thellimi në këtë jetë kalimtare zbulon se është një hallkë e një zinxhiri të gjatë. Po ashtu, të menduarit e thellë në fazën e formimit të embrionit zbulon se qëllimi përfundimtar nuk është vetëm faza e formimit të foshnjës, por ajo është premisë për jetën më të gjerë!

Po, ata dinë vetëm të jashtmen e jetës së dynjasë dhe janë të paditur për përmbajtjen, përbërjen dhe kuptimin e saj. Është interesante se përsëritja e përemrit *"hum"* - *"ata"*, tregon për një të vërtetë se shkaku i kësaj pavëmendshmërie dhe sekreti i saj u kthehet atyre. Ata janë të pavëmendshëm dhe të paditur. Kjo është njësoj si thënia e thënësit për ty: Më bëre të pavetëdijshëm nga kjo çështje. Ti i përgjigjesh: Ti ishe i pavëmenshëm ndaj saj. Që do të thotë, se shkaku i pavëmendshmërisë është tek vetja jote.

Hulumtime

Mrekullia e Kur'anit

Një prej rrugëve të konstatimit të mrekullisë së Kur'anit është ajo e lajmërimit për të pandodhurat dhe shembulli i saj është i qartë në ajetet e lartpëmendura. Në disa ajete Kur'ani lajmëron qartë se pas disa vitesh ushtria që u mposht do të korrë fitore të madhe. Ky konsiderohet si premtim i All'llahut i padyshimtë dhe i pathyer. Nga njëra anë, ajeti flet si lajmëtar për fitoren: **"…por pas thyerjes së tyre, me siguri do të fitojnë."**.

Dhe nga ana tjetër, flet për lajmin e fitores tjetër të myslimanëve ndaj politeistëve dhe idhujtarëve. Këtë e përmend në të njëjtën kohë me fitoren e bizantëve: **"Dhe, atë ditë, do të gëzohen besimtarët për ndihmën e All'llahut…"**.

Ajeti flet qartë se kjo do të ndodhë brenda disa vjetësh: **"Brenda disa vjetëve…"**.

Ajeti shënon premtimin e prerë të All'llahut duke përmendur dy herë fjalën *"ua'dun"*: **"**(Ky është) **premtimi i All'llahut, e All'llahu nuk e thyen premtimin e Vet..."**.

Historia na flet se kaluan nëntë vjet, derisa u vërtetuan këto dy ndodhi dhe bizantët fituan luftën ndaj persëve. Kjo kohë ishte e shoqëruar me Pajtimin e Hudejbijes. Sipas një transmetimi tjetër, thuhet se kjo luftë ka ndodhur në kohën e luftës së Bedrit, në të cilën myslimanët fituan mbi politeistët.

Këtu lind pyetja: A mundet që një njeriu që zotëron dije të paktë e të thjeshtë të lajmërojë për një ndodhi të rëndësishme në formë të prerë? Edhe sikur të supozohet se çështja ka qenë me parashikim politik, dhe që nuk ka qenë e tillë, ai lajm duhet të ishte në formë supozimi dhe rezervimi, e jo në formë të qartë e të prerë; përndryshe, nëse do të ndodhte e kundërta e lajmërimit, do të ishte argumenti më i vlefshëm për armiqtë që të mohonin misionin e Profetit!

E vërteta është se çështje të tilla si fitorja e një shteti të madh si Bizanti, apo çështja e lutjes për mallkim (El Mubaheletu), tregojnë qartë se zemra e Profetit të Islamit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka qenë e lidhur me diçka tjetër dhe ka qenë mbështetje e fortë. Për këtë, në të tilla situata, askush nuk do të guxonte të bënte diçka të tillë.

Sigurisht, studimi i jetëshkrimit të Profetit Muhammed zbulon se ai nuk ka qenë njeri që peshkonte në ujë të turbullt, por çdo punë e tij ka qenë e përllogaritur dhe e studiuar. Një parashikim i tillë nga ky njeri tregon se ai mbështetej te metafizika, te Shpallja e All'llahut dhe te dija e Tij absolute dhe e pakufishme. Për realizimin e këtij parashikimi do të flasim së afërmi inshAll'llah.

Sipërfaqësorët

Pikëpamja e njeriut besimtar ndryshon shumë nga pikëpamja e njeriut materialist. I pari, bazuar në besimin te monoteizmi, e sheh botën të krijuar nga Sunduesi i Gjithëditur dhe i Urtë. Të gjitha veprat e Tij janë të përllogaritura dhe të

studiuara. Për këtë ai beson se bota është një grumbull sekretesh dhe simbolesh precize. Të gjitha fjalët e Librit të gjithësisë kanë përmbajtje të thellë dhe kuptim madhështor.

Kjo pikëpamje monoteiste i thotë poseduesit të saj: Mos ec kalimthi në këto ndodhi, sepse gjëja më e thjeshtë mund të jetë më kritikja! Gjithmonë ai sheh në thellësi të kësaj bote dhe nuk bindet me të jashtmen e saj. Ai ka studiuar në shkollën e monoteizmit dhe e sheh botën qëllim të madh dhe çdo gjë e sheh brenda rrethit të këtij qëllimi. Kurse njeriu materialist, e quan botën një grup ndodhish verbuese dhe shurdhuese të paqëllimshme. Ai mendon vetëm për të jashtmen e tyre dhe nuk thellohet më tej. Vallë, a është e logjikshme që një libri që vizaton një fëmijë shkel e shko në faqet e tij, t'i kushtohet rëndësi?! Disa dijetarë të mëdhenj në shkencat e natyrës kanë thënë: "Të gjithë dijetarët e njerëzimit, të cilitdo grup qofshin apo të cilësdo shtresë, kur mendonin për sistemin e kësaj bote, ata kishin si pikënisje të menduarin religjioz. (Mendo thellë!) Ajnshtajni ka thënë: Është e vështirë që të gjesh në mesin e mendimtarëve në botë një njeri që nuk e ndien një fe të veçantë… kjo fe ndryshon nga feja e një njeriu të zakonshëm, sepse ajo e fton këtë dijetar në habi dhe mahnitje prej sistemit të çuditshëm e preciz te krijesat. Ajo zbulon para tij sekrete që nuk krahasohen me të gjitha ato përpjekje dhe mendime të sistemuara te njeriu."[1]

Përsëri thotë: Të gjithë ato për të cilat ftojnë dijetarët, mendimtarët dhe zbuluesit, në çdo kohë dhe në çdo vend, që

1 Marrë nga libri: "Ed Dunja el leti eraha".

njerëzit të mendojnë në sekretet precize të botës, është besim fetar."[1]

A është e mundur që të jenë të barabartë ata që e konsiderojnë këtë jetë fazë përfundimtare dhe qëllimin bazë dhe ata që e konsderojnë atë arë mbjellëse dhe mejdan sprove për Jetën e Përtejme që vjen pas kësaj jete?!

Ky ndryshim ndikon në jetën e tyre. Ai që jeton jetë sipërfaqësore dhe të dukshme, e konsideron shpenzimin humbje dhe dëm, kurse monoteisti e konsideron tregëti fitimprurëse e të pashtershme. Materialisti e konsideron veprimin e kamatës shkak të shtimit të pasurisë, kurse monoteisti e konsideron dëm dhe fatkeqësi. Materialisti e konsideron xhihadin dëmtim, humbje e fatkeqësi dhe martirizimin zhdukje. Kurse monoteisti e konsideron xhihadin simbol të lartësimit dhe martirizim në Jetën e Përjetshme! Vërtet, jobesimtarët nuk njohin veçse të jashtmen e kësaj jete dhe janë të pavëmendshëm ndaj Jetës Tjetër. **"Ata dinë vetëm anën e dukshme të kësaj jete, ndërsa për Jetën Tjetër janë të pakujdesshëm."**.

Përshtatshmëria historike

Për të njohur pjesën historike në të cilën ndodhën luftërat mes bizantëve dhe persëve, mjafton të njohim se në kohën e Khasru Peruiz, mbretit të Persisë, kanë ndodhur luftëra të gjata përafërsisht njëzet e katër vjet, nga viti 604-624 sipas kalendarit gregorian.

1 I njëjti burim.

Rreth vitit 616 dy udhëheqës ushtarakë pers, Sheheberaz dhe Shahijn, sulmuan bizantët në kufirin lindor. Ata i mposhtën rëndë bizantët dhe morën nën kontroll zonën Shamat, Egjipt dhe Azinë e vogël. Për shkak të kësaj humbjeje, bizantët lindor u përballën me gjendjen e zhdukjes. Persët morën çdo gjë që kishin bizantët në Egjipt dhe në Azi. Kjo ishte afërsisht në vitin e dërgimit të profecisë.

Mirëpo mbreti i bizantit, Herakliu, i sulmoi persët në vitin 622 dhe e mposhti disa herë ushtrinë perse. Këto luftëra vazhduan deri në vitin 628 në favor të bizantëve. Khasru Peruiz u mposht dhe u thy disa herë dhe persët e zhveshën nga pushteti. Në vend të tij, vendosën djalin e tij, Shirvijeh.

Duke parë që ditëlindja e Profetit ishte në vitin 571 dhe ardhja e profecisë në vitin 610, atëherë humbja e bizantëve ndodhi në vitin e shtatë të profecisë. Dhe fitorja e tyre ka qenë mes vitit 5 ose 6 të hixhretit të Profetit. Në vitin e pestë të hixhrit ndodhi beteja e Hendekut. Në vitin e gjashtë ndodhi Pajtimi i Hudejbijes. Është e natyrshme se përcjellja e lajmeve të luftës së persëve dhe bizantëve në zonën e Hixhazit dhe Mekës kërkonte kohë. Me këtë, ky lajm kur'anor është në përshtatje me këtë periudhë të historisë. (Mendo thellë!)

Ajetet 8 - 10

أَوَلَمۡ يَتَفَكَّرُواْ فِيٓ أَنفُسِهِمۗ مَّا خَلَقَ ٱللَّهُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضَ وَمَا بَيۡنَهُمَآ إِلَّا بِٱلۡحَقِّ وَأَجَلٖ مُّسَمًّىۗ وَإِنَّ كَثِيرٗا مِّنَ ٱلنَّاسِ بِلِقَآئِ رَبِّهِمۡ لَكَٰفِرُونَ ٨ أَوَلَمۡ يَسِيرُواْ فِي ٱلۡأَرۡضِ فَيَنظُرُواْ كَيۡفَ كَانَ عَٰقِبَةُ ٱلَّذِينَ مِن قَبۡلِهِمۡۚ كَانُوٓاْ أَشَدَّ مِنۡهُمۡ قُوَّةٗ وَأَثَارُواْ ٱلۡأَرۡضَ وَعَمَرُوهَآ أَكۡثَرَ مِمَّا عَمَرُوهَا وَجَآءَتۡهُمۡ رُسُلُهُم بِٱلۡبَيِّنَٰتِۖ فَمَا كَانَ ٱللَّهُ لِيَظۡلِمَهُمۡ وَلَٰكِن كَانُوٓاْ أَنفُسَهُمۡ يَظۡلِمُونَ ٩ ثُمَّ كَانَ عَٰقِبَةَ ٱلَّذِينَ أَسَٰٓـُٔواْ ٱلسُّوٓأَىٰٓ أَن كَذَّبُواْ بِـَٔايَٰتِ ٱللَّهِ وَكَانُواْ بِهَا يَسۡتَهۡزِءُونَ ١٠

"Vallë, a nuk mendojnë ata në vetvete? All'llahu ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe ato që gjenden në mes tyre - vetëm me qëllim dhe afat të caktuar. E, me të vërtetë, shumica e njerëzve nuk besojnë në takimin me Zotin e tyre."

"Vallë, a nuk udhëtojnë nëpër botë e të shohin se si kanë përfunduar popujt e mëparshëm? Ata kanë qenë më të fortë se këta dhe tokën e kanë shfrytëzuar dhe punuar më mirë se sa e punojnë këta, e të Dërguarit e tyre u kanë sjellë prova të qarta. Nuk ishte All'llahu që u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë vetvetes padrejtësi."

"Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe (Xhehennemi)**, ngase përgenjështronin Shpalljet e All'llahut dhe talleshin me to."**

Komentimi

Fundi i keqbërësve

Në fund të ajeteve të mëparshme u fol për sipërfaqësorët dhe pasuesit e të jashtmes, ku horizonti i të menduarit të tyre nuk e kalonte kufirin e dynjasë dhe të botës materiale. Ata ishin të paditur për metafizikën dhe për Ditën e Kiametit.

Kurse në ajetet në fjalë dhe ato që do të vijnë më pas, ka hulumtime të ndryshme rreth fillimit të krijimit dhe të Ringjalljes. Ajeti i parë prej këtyre ajeteve fillon në formë pyetësori duke thënë: **"Vallë, a nuk mendojnë ata në vetvete? All'llahu ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe ato që gjenden në mes tyre - vetëm me qëllim dhe afat të caktuar…"** që do të thotë: sikur ata të mendonin ashtu siç duhet dhe të kthehen në logjikën dhe ndërgjegjen e tyre për të gjykuar, do t'i njihnin mirë dy gjëra:

E para: Bota është krijuar mbi bazën e së vërtetës dhe udhëhiqet nga sisteme. Ajo është treguese se Krijuesi i saj është i Gjithëditur dhe i Plotfuqishëm.

E dyta: Kjo botë shkon drejt zhdukjes. Krijuesi i Urtë nuk e ka krijuar pa qëllim. Këtë e tregon prania e Botës së Përtejme që është e përhershme. Përndryshe, krijimi i kësaj bote do të ishte i pakuptimtë. Nuk është e logjikshme që gjithë këto krijesa janë krijuar vetëm për disa ditë të kufizuara të kësaj jete. Kështu që do të pranohet Ahireti.

Në këtë mënyrë, të menduarit thelle në sistemet e krijimit është argument i pranisë së Krijuesit. Po ashtu, të menduarit thellë në thënien **"…dhe afat të caktuar…"** tregon për Ringjalljen.

Për këtë, Kur'ani, në fund të ajetit, thotë: **"…E, me të vërtetë, shumica e njerëzve nuk besojnë në takimin me Zotin e tyre."**. Ata mohojnë takimin me All'llahun apo e mohojnë plotësisht Ringjalljen, siç lexojmë në disa ajete të Kur'anit thëniet e politeistëve që thonin: **"Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur** (do të ringjallemi sërish)**? Ai kthim është i largët!"**.[1] Dhe: **"Vërtet që kjo është një gjë e çuditshme!"**.[2]

Ka edhe të tjera ajete me thënie të ndryshme, siç thuhet në suren "Rrad", ajeti 5; suren "Mu'minun", ajeti 35; suren "Neml", ajeti 67 etj.

Ose ata nuk e mohojnë me gjuhët e tyre, por punët e tyre të përlyera dhe poshtëruese tregojnë se ata nuk besojnë në Ringjallje, sepse po të besonin në Ringjallje nuk do të ishin as të devijuar e as devijues.

Fraza **"fi enfusihim"** në vetat e tyre, nuk ka kuptimin që të studiojnë sekretet e ekzistencës së tyre, siç thotë Fahru Raziu në komentimin e tij. Por kuptimi është që të mendojnë në brendinë e tyre nëpërmjet rrugës së logjikës dhe të ndërgjegjes rreth krijimit të Tokës dhe të qiejve.

1 Sure "Kaf", ajeti 3.
2 Sure "Sad", ajeti 5.

Thënia **"bil hakki"**, me të vërtetë, ka dy kuptime: *I pari:* Vërtet, krijimi është binjak me të vërtetën, ligjin dhe sistemin. *I dyti:* Qëllimi në krijim është i vërtetë. Nuk ka kundërshtim mes dy kuptimeve.[1]

Fraza **"bi likai rabbihim"** tregon për Ditën e Kiametit dhe të Tubimit, në të cilën zbulohen perdet dhe njeriu e njeh madhështinë e All'llahut me pamjen e brendshme.

Përderisa thënia **"afat i caktuar"** zbulon se e gjitha kjo jetë është e paqëndrueshme dhe që është paralajmërim për të gjithë idhujtarët, Kur'ani thotë në ajetin në vijim: **"Vallë, a nuk udhëtojnë nëpër botë e të shohin se si kanë përfunduar popujt e mëparshëm? Ata kanë qenë më të fortë se këta dhe tokën e kanë shfrytëzuar dhe punuar më mirë se sa e punojnë këta, e të Dërguarit e tyre u kanë sjellë prova të qarta..."** pra, u sollën atyre argumente të qarta. Mirëpo, ata nuk ia vunë veshin atyre dhe nuk iu nënshtruan të vërtetës, prandaj u sprovuan me dënimin e rëndë të All'llahut. Por: **"...Nuk ishte All'llahu që u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë vetvetes padrejtësi."**.

Në realitet, Kur'ani tregon për popujt që sipas idhujtarëve mekas ishin madhështorë nga ana e fuqisë fizike dhe pasurisë. Ai përfundim i dhembshëm i tyre ishte mësim për ata idhujtarë.

Fjalia **"...dhe tokën e kanë shfrytëzuar..."** ka mundësi të tregojë ose për punimin dhe mbjelljen e tokës, ose për hapjen e lumenjve, ose për ndërtimin e ndërtesave, ose për të gjitha së

1 Nëse marrim komentimin e parë, germa *"ba"*, në fjalën *"bil hakki"*, ka kuptimin e shoqërimit. Në komentimin e dytë ka kuptimin e *"lamit"*, *"lil hakki"* - për të drejtën.

bashku, sepse kjo fjali ka kuptim të gjerë dhe i përfshin të gjitha këto çështje, të cilat janë parahyrje për ndërtimin e tokës.[1]

Meqenëse në atë kohë njihej shumë bujqësia dhe ndërtimi, sqarohet se popujt e mëparshëm kanë qenë më të lartë dhe më të përparuar se idhujtarët mekas. Mirëpo, megjithë mundësitë e tyre, kur mohuan shenjat dhe Shpalljet e All'llahut si dhe përgënjeshtruan të Dërguarit, nuk mundën t'i shpëtojnë kthetrave të dënimit. Si ka mundësi t'i shpëtojnë dënimit të All'llahut?! Ky dënim i rëndë është si rezultat i veprave të tyre shkatërruese për vetat e tyre, sepse ata i bënë padrejtësi vetave të veta dhe se All'llahu nuk i bën padrejtësi askujt. Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë, sqaron fazën e fundit të mosbesimit e të mohimit të tyre: **"Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe** (Xhehennemi)**, ngase përgenjështronin Shpalljet e All'llahut dhe talleshin me to."**.

Vërtet, gjynahu, kur bie në zemrën e njeriut, është si sëmundje e keqe. Ajo sëmundje e ha besimin dhe e zhduk atë. Çështja arrin deri në atë kufi, saqë njeriu përgënjeshtron Shpalljet e All'llahut. Jo vetëm kaq, më e keqja është se mëkati e bën mbartësin e tij të tallet edhe me të Dërguarit dhe me Shpalljet. Pra, nuk bën dobi as porosia e as këshilla. Në të nuk ndikon as urtësia e këshilla. Për të nuk mbetet gjë tjetër, përveç kamzhikut të dënimit të dhembshëm.

Një shikim i vetëm mbi faqet e historisë së kriminelëve e të padrejtëve do të zbulojë se ata nuk kanë qenë të tillë në fillim, sepse të paktën kishin një dritë të dobët besimi në zemrat e tyre.

1 Fjala *"atharun"* vjen nga rrënja *"theur"*, që do të thotë ndarje, përhapje. Është quajtur *"theuren"*, sepse e ndan tokën dhe e shtron.

Por kryerja e mëkateve të vazhdueshme nga ana e tyre shkaktuan që ditë pas dite, të largoheshin nga besimi dhe devotshmëria dhe të përfundonin në fazën e mohimit e të mosbesimit.

Në fjalimin e zonjës Zejneb *(Paqja qoftë mbi të!)* përballë Jezidit, të birit të Muavijes në Sham, shohim po atë rezultat që përmendëm më lart. Ajo pa Jezidin që tallej me çdo gjë dhe fliste me fjalë mosbesimi dhe mohimi duke thurur një poezi ku prej saj ishte:

Hashimiti luajti me pushtetin se

As lajm s'ka ardhur dhe as shpallje s'ka zbritur.

Këto fjalë zbulojnë mosbesimin e tij në parimet e Islamit. Zejnebja e falënderoi All'llahun e Madhëruar. Dërgoi bekime mbi Profetin dhe tha: "All'llahu është i vërtetë dhe të vërtetën thotë: **"Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe** (Xhehennemi)**, ngase përgenjështronin Shpalljet e All'llahut dhe talleshin me to."**. Kuptimi i thënies së saj është se nëse ti sot mohon Islamin dhe besimin me poezitë që thur për mohimin dhe u thua të parëve të tu politeistë që u vranë nga dora e myslimanëve në betejën e Bedrit: Ah sikur të shihnit hakmarrjen time ndaj fisit Hashimit - kjo nuk është çudi. Për këtë All'llahu i Madhëruar thotë: **"Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe** (Xhehennemi)**, ngase përgenjështronin Shpalljet e All'llahut dhe talleshin me to."**.

Për këtë çështje ka shumë thënie. Për sqarime, lexo volumin e dyzetë e pestë të librit "Biharul Anuar"!

Ajetet 11 - 16

ٱللَّهُ يَبۡدَؤُاْ ٱلۡخَلۡقَ ثُمَّ يُعِيدُهُۥ ثُمَّ إِلَيۡهِ تُرۡجَعُونَ ﴿١١﴾ وَيَوۡمَ تَقُومُ ٱلسَّاعَةُ
يُبۡلِسُ ٱلۡمُجۡرِمُونَ ﴿١٢﴾ وَلَمۡ يَكُن لَّهُم مِّن شُرَكَآئِهِمۡ شُفَعَٰٓؤُاْ وَكَانُواْ
بِشُرَكَآئِهِمۡ كَٰفِرِينَ ﴿١٣﴾ وَيَوۡمَ تَقُومُ ٱلسَّاعَةُ يَوۡمَئِذٖ يَتَفَرَّقُونَ ﴿١٤﴾
فَأَمَّا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ ٱلصَّٰلِحَٰتِ فَهُمۡ فِي رَوۡضَةٖ يُحۡبَرُونَ ﴿١٥﴾
وَأَمَّا ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ وَكَذَّبُواْ بِـَٔايَٰتِنَا وَلِقَآءِ ٱلۡأٓخِرَةِ فَأُوْلَٰٓئِكَ فِي ٱلۡعَذَابِ
مُحۡضَرُونَ ﴿١٦﴾

"All'llahu e fillon krijimin e pastaj e përsërit dhe pastaj tek Ai do të ktheheni."

"E, atë Ditë kur të arrijë Ora, gjynahqarët do të mbesin pa gojë, shpresëkëputur."

"Ata nuk do të kenë ndërmjetës nga idhujt e vet dhe do t'i mohojnë idhujt e tyre."

"E, atë Ditë kur të arrijë Ora, ata (besimtarët dhe jobesimtarët) **do të ndahen."**

"Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, do të gëzojnë në kopshtin e Xhennetit."

"Kurse ata që kanë mohuar dhe kanë përgënjeshtruar shenjat Tona dhe takimin në Jetën Tjetër, do të hidhen në zjarr."

Komentimi

Përfundimi i kriminelëve dhe vendi i tyre në Ditën e Kiametit

Në ajetet e mëparshme u fol për përgënjeshtruesit dhe tallësit e Shpalljeve dhe të shenjave të All'llahut. Ajetet në fjalë janë plotësuese të hulumtimeve të mëparshme rreth Ringjalljes duke sqaruar disa anë prej saj dhe vendin e jobesimtarëve në Ditën e Kiametit.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **"All'llahu e fillon krijimin e pastaj e përsërit dhe pastaj tek Ai do të ktheheni."**. Në këtë ajet sqarohet një argumentim i shkurtër, përmbledhës dhe kuptimplotë rreth çështjes së Ringjalljes. Ky kuptim gjendet edhe në disa ajete të tjera të Kur'anit, prej tyre: **"Thuaj: 'Do t'i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë; Ai që prej drurit të njomë bëri për ju zjarrin, të cilin e përdorni për të ndezur'. Vallë, a nuk është i Zoti Ai që krijoi**

qiejt dhe Tokën, t'i rikrijojë ato? Po! Ai është Krijuesi i çdo gjëje dhe i Gjithëdituri!".[1]

Fjalia **"...tek Ai do të ktheheni."** tregon se pas tubimit dhe Ringjalljes, të gjithë do të kthehen te Gjykata e All'llahut.

Ajeti tjetër trupëzon gjendjen e kriminelëve keqbërës e gjynahqarë në Ditën e Kiametit. Ai thotë: **"E, atë Ditë kur të arrijë Ora, gjynahqarët do të mbesin pa gojë, shpresëkëputur."**.

Fjala *"jelbesu"* vjen nga rrënja *"iblas"*, që në origjinalitet ka kuptimin e shqetësimit dhe të mëzitjes nga ndikimi i humbjes së shpresës. Është e natyrshme se kur njeriu shqetësohet nga diçka jo e domosdoshme, ky shqetësim nuk është i rëndësishëm. Por shqetësimi dhe zemërimi zbulojnë çështje të rëndësishme të të shqetësuarit. Për këtë, disa komentues mendojnë se *"domosdoshmëria"* (ed daruratu) është pjesë e "Iblisit". Edhe Iblisi ësht quajtur i tillë sepse ai humbi shpresën prej mëshirës së All'llahut dhe e kaploi shqetësimi dhe zemërimi. Sido që të jetë, kriminelët gjynahqarë kanë të drejtë të shqetësohen e të mërziten në atë Ditë, sepse ata nuk besonin dhe nuk bënin punë të mira që t'i ndihmonin ata në fushën e Mahsherit. Ata nuk do të kenë as shokë e as miq. Po ashtu, nuk mund të kthehen në këtë dynja që të plotësojnë ato që lanë dhe nuk e bënë. Prandaj edhe Kur'ani në ajetin e tretë shton e thotë: **"Ata nuk do të kenë ndërmjetës nga idhujt e vet..."**. Kur pyeteshin se pse i adhuronin ato idhuj të prodhuara, thonin: **"...Këta janë ndërmjetësit tanë tek All'llahu...!"**.[2] Në atë Ditë atyre do t'u sqarohet fare mirë se ato janë të pavlera dhe nuk do t'u sjellin asnjë dobi. Në atë Ditë do t'i

1 Sure "Jasin", ajetet 79-81.
2 Sure "Junus", ajeti 18.

mohojnë ato idhuj dhe do të largohen prej tyre: **"...dhe do t'i mohojnë idhujt e tyre."**. E përse të mos i mohojnë ato idhuj ndërkohë që i shohin të heshtur dhe nuk i mbrojnë ata?! Jo vetëm kaq, Kur'ani thotë se në atë Ditë, idhujt do t'i përgënjeshtrojnë ata adhurues të tyre dhe do të thonë: **"...O Zoti ynë. Ata nuk na adhuronin neve..."**[1] por ata adhuronin egon e tyre.

Në ajetin 6 të sures "Ahkaf", Kur'ani thotë se ato idhuj do të jenë armiqtë e tyre: **"Kur të tubohen njerëzit** (në Ditën e Gjykimit)**, idhujt do të jenë armiq të tyre dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre."**.

Pastaj Kur'ani flet për grupe të ndryshme njerëzish në Ditën e Kiametit dhe thotë: **"E, atë Ditë kur të arrijë Ora, ata** (besimtarët dhe jobesimtarët) **do të ndahen."**.

"Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, do të gëzojnë në kopshtin e Xhennetit."

Fjala *"juhberune"* vjen nga rrënja *"hibr"* dhe ka kuptimin e ndikimit të qartë e të mrekullueshëm. Po ashtu, përdoret edhe për gjendjen e gëzimit që duket në fytyrë. Përderisa zemrat e banorëve të Xhennetit janë aq të gëzuara saqë ndikimi i këtij gëzimi duket tek të gjithë, kjo fjalë përdoret edhe me këtë kuptim.

Fjala *"reudatun"* ka kuptimin e vendit që ka shumë pemë dhe ujë. Për këtë, kjo fjalë përdoret për kopshtet me pemë e me bimë të gjelbra. Kjo fjalë ka ardhur këtu në trajtën e pashquar për qëllim madhështor dhe ekzagjerim. Që do të thotë se ata janë në vendet më të mira dhe më të larta në Xhennet.

1 Sure "Kasas", ajeti 63.

Në fund, All'llahu i Madhëruar thotë: **"Kurse ata që kanë mohuar dhe kanë përgënjeshtruar shenjat Tona dhe takimin në Jetën Tjetër, do të hidhen në zjarr."**.

Interesantja këtu është se për besimtarët është përdorur fjala *"juhberuane"* që tregon për kënaqësinë e madhe nga të gjitha anët te banorët e Xhennetit. Kurse për banorët e Zjarrit është përdorur fjala *"muhdherune"* që tregon pakënaqësinë dhe urrejtjen e madhe që i pret ata, sepse fjala *"ihdhar"*, përdoret për ato çështje që janë në kundërshtim me dëshirat e brendshme të njeriut.

Diçka tjetër interesante është se banorët e Xhennetit janë përmendur me kriterin e besimit dhe të punës së mirë, kurse banorët e Zjarrit janë përmendur vetëm me mosbesimin në krijim dhe Ringjallje. Kjo tregon se hyrja në Xhennet kërkon besim dhe punë të mirë dhe nuk mjafton vetëm besimi. Por për të hyrë në Zjarr mjafton vetëm mosbesimi, edhe nëse jobesimtari nuk bën gjynah, sepse vetë mosbesimi është gjynahi më i madh.

Hulumtim

Përse një prej emrave të Ditës së Kiametit është *"Es Saatu"*?

Duhet parë me vëmendje kjo çështje e rëndësishme se në shumë ajete të Kur'anit, ndër to edhe dy ajetet në fjalë, Kiameti përmendet edhe me fjalën *"es saatu"*. Kjo sepse *"es saatu"*, në origjinalitet është pjesë e kohës ose çast kalimtar. Meqenëse

Kiameti nga njëra anë, është në mënyrë të papritur si vetëtima rrëmbyese, dhe nga ana tjetër se All'llahu është Llogaitësi më i shpejtë, duke i llogaritur shumë shpejt robtë e Tij, është përdorur kjo fjalë për Kiametin, me qëllim që njerëzit ta kujtojnë Ditën e Kiametit dhe të jenë të gatshëm e të përgatitur.

Ibn Mendhuri në librin e tij "Lisanul Arab", thotë: Është emër për kohën në të cilën mahniten njerëzit dhe është koha e Ringjalljes dhe e ngritjes për në Kiamet. Është quajtur *"es saatu"*, sepse ajo i befason njerëzit. Të gjitha gjallesat vdesin kur ndodh *Sahati* i parë, të cilën e ka përmendur All'llahu në Kur'an: **"**(Mjaftoi për t'i dënuar ata) **vetëm një zë i tmerrshëm, pas të cilit u shuan përnjëherësh."**.[1] Dhe: **"Do të jetë ai vetëm një zë i tmerrshëm e ata të gjithë do të paraqiten para Nesh."**.[2]

Ez Zubedij, në librin "Taxhul Arus", ka thënë se disa kanë përmendur tre *saate*:

Saatul Kubra: Kjo është Dita e Kiametit, Ringjallja e të vdekurve për llogari.

Saatul Usta: Është dita e vdekjes së papritur për banorët e një kohe të vetme për dënim dhe ndëshkim nga ana e All'llahut.

Saatul Sugra: Është dita e vdekjes normale të çdo njeriu.

1 Sure "Ja Sin", ajeti 29.
2 Sure "Ja Sin", ajeti 53.

Ajetet 17 - 19

فَسُبْحَٰنَ ٱللَّهِ حِينَ تُمْسُونَ وَحِينَ تُصْبِحُونَ ﴿١٧﴾ وَلَهُ ٱلْحَمْدُ فِى
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَعَشِيًّا وَحِينَ تُظْهِرُونَ ﴿١٨﴾ يُخْرِجُ ٱلْحَىَّ مِنَ
ٱلْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ ٱلْمَيِّتَ مِنَ ٱلْحَىِّ وَيُحْىِ ٱلْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا ۚ وَكَذَٰلِكَ
تُخْرَجُونَ ﴿١٩﴾

"Prandaj lartësojeni All'llahun, kur bie muzgu dhe, kur gdhin drita!"

"Për Atë është falënderimi në qiej dhe në Tokë, në mbrëmje dhe në mesditë."

"Ai krijon të gjallën prej së vdekurës, krijon të vdekurën prej së gjallës dhe e gjallëron Tokën pas shkretimit të saj. Në të njëjtën mënyrë do të ktheheni edhe ju në jetë."

Komentimi

Lartësimi dhe falënderimi në përgjithësi - janë vetëm për All'llahun

Pas thënieve të shumta në ajetet e mëparshme, të cilat flisnin për krijimin dhe Ringjalljen, për shpërblimin e besimtarëve dhe ndëshkimin e politeistëve dhe të jobesimtarëve, në ajetet në fjalë përmendet lartësimi dhe lavdërimi i All'llahut, shenjtërimi dhe pastrimi i Tij prej të gjitha llojeve të shirkut (idhujtarisë), mangësivë dhe të metave. Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **"Prandaj lavdërojeni All'llahun, kur bie muzgu dhe, kur gdhin drita!" "Për Atë është falënderimi në qiej dhe në Tokë, në mbrëmje dhe në mesditë."**.

Në këto dy ajete përmenden katër kohë për lartësimin e All'llahut:

- Fillimi i natës - **"kur bie muzgu"**
- Lindja e agimit - **"kur zbardh drita"**
- Mbrëmja – **"mbrëmje"**
- Mesdita - **"në mesditë"**

Kurse fjala "*el hamd*" për nga vendi është e përgjithshme dhe përfshin qiejt dhe Tokën. Ka mundësi që përmendja e katër kohëve në ajetin e lartpërmendur mund të jetë metaforë për përhershmërinë dhe vazhdueshmërinë e lartësimit, me kuptimin "lartësimi është në çdo kohë dhe në çdo vend.".

Disa komentues supozojnë se kuptimi i këtyre katër kohëve është për kohët e namazit. Por ata nuk i janë përgjigjur

kësaj pyetjeje: "Përse në Kur'an përmenden katër kohë në vend të pesë kohëve?"; "Përse nuk përmendet namazi i jacisë?!".

Por përgjigjja e kësaj pyetjeje mund të jetë se koha e namazit të akshamit është relativisht afër kohës së namazit të jacisë dhe distanca kohore mes tyre është një orë deri në një orë e gjysëm. Për këtë përmenden dy namaze në një vend, sepse distanca kohore mes namazit të drekës dhe ikindisë është relativisht më e gjatë, e cila shkon më shumë se dy orë.

Mirëpo, po t'i konsiderojmë fjalët *"tesbijh"* dhe *"hamd"* me kuptim të gjerë në ajet, do të shohim se këto dy fjalë nuk përkufizohen me pesë namazet e ditës, edhe pse pesë namazet janë vërtetësi e këtyre dy fjalëve.

Është mirë të përmendim një çështje interesante: të dyja shprehjet *"subhanAll'llahi"; "ue lehu el hamd"* mund të jenë diktimi për lartësim dhe lavdërim nga ana e All'llahut, siç ka thënë edhe në ajetin 14 të sures "Mu'minun": **"...Qoftë lartësuar All'llahu, Krijuesi më i përsosur!"**. Ka mundësi që ky lartësim dhe ky lavdërim të jenë me kuptimin e urdhrit, që do të thotë "lartësojeni dhe lavdërojeni Atë".

Ky komentim duket se është më afër dhe më i konsiderueshëm, sepse ajetet e mëparshme janë si kushtetutë për të gjithë robtë, me qëllim që të fshijnë gjurmët e idhujtarisë dhe mëkatit prej shpirtit dhe zemrës çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje, në çdo mesditë e në çdo pasdite, prandaj lartësojeni dhe lavdërojeni All'llahun si në namaz, ashtu edhe jashtë namazit.

Në një hadith të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* lexojmë se ai ka thënë:

"Ai që thotë tre herë kur ngryset, kur bie muzgu dhe kur gdhin drita: I Lartësuar është All'llahu (tre ajetet e lartpërmendur)*, do të arrijë atë që i ka ikur në ditën e tij. Nëse e thotë kur ngryset, do të arrijë atë që i ka ikur në natën e tij."*.[1]

Në ajetin pasardhës flitet sërish për Ringjalljen. Kur'ani u përgjigjet mohuesve të saj me një metodë tjetër dhe u thotë: **"Ai krijon të gjallën prej të vdekurës, krijon të vdekurën prej së gjallës dhe e gjallëron tokën pas shkretimit të saj. Në të njëjtën mënyrë do të ktheheni edhe ju në jetë."**. Pra, Ringjallja dhe fundi i kësaj bote përsëriten çdo ditë para syve tuaj dhe nuk ka vend për t'u habitur rreth ringjalljes së të gjitha krijesave. Pra, në Ditën e Kiametit, njerëzit do të ringjallen.

Fraza **"krijon të gjallin nga i vdekuri"** është përdorur për tokat e vdekura. Kur'ani i Shenjtë e ka përmendur disa herë çështjen e Ringjalljes. Është e qartë se toka në dimër duket e vdekur, e pajetë, sepse në të nuk gjendet as gjelbërim e as lule e çelur. Kurse në stinën e pranverës, me rënien e shiut dhe zbutjen e klimës fillon lëvizja dhe gjallëria në tokë. Në çdo vend, mbin dhe zhvillohet gjelbërimi, lulet fillojnë të çelin, sythet e pemëve fillojnë të shpërthejnë. Ky është fenomeni i Rinjgjalljes, të cilin e shohim në këtë jetë.

Ndërsa çështja e **"nxjerjes së të vdekurit nga i gjalli"** nuk është e padukshme e as e mbuluar. Gjithmonë thahen pemët dhe kthehen në drunj. Edhe njerëzit vdesin, e po ashtu, edhe kafshët ngordhin dhe bëhen trupa të pajetë.

1 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 172.

Komentuesit kanë mendime të ndryshme rreth frazës e **"nxjerrjes së të gjallit nga i vdekuri"**. Disa kanë thënë se ka të bëjë me krijimin e njeriut dhe të kafshëve nga sperma. Disa të tjerë kanë thënë se ka kuptimin e lindjes së besimtarit nga jobesimtari. Disa të tjerë kanë thënë se ka kuptimin e zgjimit të të fjeturve dhe të pavëmendshmëve.

Në aparencë duket se asnjë prej këtyre kuptimeve nuk është kuptimi origjinal, sepse sperma në vetvetve është e gjallë. Çështja e mosbesimit dhe e besimit është prej brendësisë së ajetit dhe jo prej aparencës së tij. Kurse zgjimi dhe gjumi janë me kuptim figurative, sepse zgjimi dhe gjumi nuk janë jetë dhe vdekje të vërteta.

Duke e parë nga jashtë ajetin, duket që All'llahu i Madhëruar gjithmonë nga krijesat e gjalla nxjerr krijesat e vdekura dhe i konverton gjallesat e shkatërruara e pa shpirt brenda tyre në krijesa të gjalla me jetë.

Pavarësisht se është e padiskutueshme - të paktën në kohët e sotme - që nga eksperimentimet dhe pikëpamjet e përditshme nuk është parë asnjëherë që një krijesë e gjallë të lindë apo të gjenerohet nga një krijesë e vdekur, përkundrazi gjallesat e gjalla gjithmonë gjenerohen nga vezët ose rrënjët, apo farat e krijesave të tjera të gjalla, edhe pse është vërtetuar shkencërisht dhe është e padiskutueshme që Toka, në zanafillën e saj, ka qenë një lëmsh i zjarrtë dhe s'ka pas jetuar mbi të asnjë gjallesë. Pastaj në bazë të kushteve specifike që - deri më tani - shkenca nuk i ka zbuluar, në mënyrë të beftë, të menjëhershme, lindën gjallesat e gjalla prej lëndëve që s'kanë shpirt në të me një hap të madh... Mirëpo dija njerëzore akoma nuk ka arritur ta sqarojë këtë çështje. (Sigurisht,

supozohet që ky hap i madh të vërtetohet në thellësitë e deteve dhe oqeaneve në një pjesë të kushteve aktuale).

Ajo, të cilën ne e prekim dhe e perceptojmë, është se krijesat e vdekura janë gjithmonë pjesë e krijesave të gjalla dhe e mveshin rrobën e jetës!

Kështu, uji dhe ushqimi kur të dy bashkë janë brenda trupit të njeriut dhe bëhen pjesë e tij, shndërrohen në një krijesë të gjallë, duke shtuar se ajo që ne e marrim si ushqim nuk është prej krijesave të gjalla, porse ato të dy janë dy rruaza dhe qeliza të reja që i bashkohen rruazave të trupit dhe qelizave të tij, ashtu sikurse edhe fëmija i vogël bëhet një djalë i ri e i fortë sipas kësaj mënyre! A nuk është kjo ngjallja e jetës nga zemra e vdekjes apo **"i gjalli nga i vdekuri"**?

Bazuar në këtë, mund të themi se në sistemin e natyrës, gjithmonë i gjalli del nga i vdekuri dhe i vdekuri del nga i gjalli dhe me këtë argument, pa dyshim se All'llahu, i Cili e ka krijuar natyrën, është i Aftë dhe i Fuqishëm që t'i ringjallë të vdekurit në Botën Tjetër.

Sigurisht që ajeti i lartpërmendur në aspektin metaforik e shpirtëtor ka komentime të tjera... Një prej tyre është lindja e besimtarit nga kafiri dhe lindja e kafirit nga besimtari, e dijetarit nga injoranti dhe i injorantit nga dijetari, i punëmirit prej shkatërrimtarit dhe shkatërruesit nga punëmiri, ashtu sikurse është treguar për të gjitha këto në tregimet islame.

Mundet që këto kuptime të jenë edhe në brendësitë e ajetit, sepse ne e dimë mirë se ajetet kur'anore kanë pjesën e dukshme dhe atë të brendshme, ashtu sikurse mundet që për jetën dhe

vdekjen të ketë një kuptim të bashkuar të gjerë që përfshin aspektin material dhe atë shpirtëror.

Në një transmetim të *Imam* Musa bin Xhaferr *(Paqja qoftë mbi të!)* për komentimin e ajetit **"e gjallëron tokën pasiqë ajo ka vdekur"** thuhet: *"Nuk e gjallëron atë me shi, por All'llahu dërgon burra që e gjallërojnë drejtësinë. Kështu që Toka gjallërohet nëpërmjet ringjalljes së drejtësisë. Ringjallja e drejtësisë në Tokë është më e dobishme sesa shiu për dyzet sabahe."*.[1] Është e qartë se ajo që synon *Imam*i është se kuptimi i ajetit nuk kufizohet vetëm me zbritjen e shiut dhe as që nevojitet komentimi i ajetit vetëm në lidhje me shiun, sepse ringjallja shpirtërore me drejtësinë e Tokës është më e rëndësishme sesa ringjallja e saj me anë të shiut.

1 Marrë nga "Usulul Kafij", sipas tefsirit të "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 173.

Ajetet 20 – 22

وَمِنْ ءَايَـٰتِهِۦٓ أَنْ خَلَقَكُم مِّن تُرَابٍ ثُمَّ إِذَآ أَنتُم بَشَرٌ تَنتَشِرُونَ ﴿٢٠﴾
وَمِنْ ءَايَـٰتِهِۦٓ أَنْ خَلَقَ لَكُم مِّنْ أَنفُسِكُمْ أَزْوَٰجًا لِّتَسْكُنُوٓا۟ إِلَيْهَا وَجَعَلَ
بَيْنَكُم مَّوَدَّةً وَرَحْمَةً ۚ إِنَّ فِى ذَٰلِكَ لَـَٔايَـٰتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٢١﴾ وَمِنْ
ءَايَـٰتِهِۦ خَلْقُ ٱلسَّمَـٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَٱخْتِلَـٰفُ أَلْسِنَتِكُمْ وَأَلْوَٰنِكُمْ ۚ إِنَّ فِى
ذَٰلِكَ لَـَٔايَـٰتٍ لِّلْعَـٰلِمِينَ ﴿٢٢﴾

“Nga faktet e fuqisë së Tij është edhe ajo, se Ai ju krijoi juve prej dheu, e mandej ju (u zhvilluat) **në njerëz që veproni të shpërndarë.”**

“Dhe nga faktet (e madhështisë) **së Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën** (gratë)**, ashtu që ju të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”**

“Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i Tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz që dinë.”

Komentimi

Këto ajete dhe ajete të tjera që i pasojnë, kanë folur për modalitete dhe mirësi të argumenteve të Teuhidit (Njëtimi i Zotit), për argumentet e All'llahut dhe gjurmët e Tij në sistemin e botës së ekzistencës, të cilat plotësojnë studimet hulumtuese të mëparshme, kurse ne mundemi që të themi, në mënyrë të përgjithshme, se pjesën e rëndësishme të argumenteve të Njëtimit në Kur'an e përfaqësojnë këto ajete.

Ato kanë një nënshkrim të veçantë dhe një melodi elokuente tërheqëse, si dhe mënyra të shprehuri ndikuese dhe të thella: **"prej argumenteve të Tij është"**. Janë këto ajete të cilat fillojnë të gjitha me këtë thënie të Tij: një grup prej shtatë ajetesh, gjashtë të njëpasnjëshme, kurse njëra e ndarë që është ajeti i dyzet e gjashtë; ku tre prej tyre flasin për argumentet e nefsit (argumentet "faktet e shpirtrave" dhe "faktet e horizonteve"). Këto ajete janë ndarë me një ndarje të veçantë e të rrallë, ku Krijuesi është në vetë ekzistencën e njeriut kurse tre prej tyre janë prej argumenteve të horizonteve (argumentet e Krijuesit jashtë ekzistencës së njeriut). Një ajet prej tyre na flet për argumentet e njerëzve dhe të horizonteve së bashku.

Janë gjithsej vetëm njëmbëdhjetë ajete në të gjitha suret që citohet shprehja **"dhe prej argumenteve të Tij"** dhe ajo që ne duhet ta kthejmë shikimin është se ajetet të cilat fillojnë me këtë shprehje Kur'ani, shtatë prej tyre janë në këtë sure, dy janë në suren "Fussilet", ajeti 37 dhe 39 kurse dy ajete të fundit janë në suren "Shura", ajetet 29 dhe 32.

Pra, sikurse e cituam më lart janë vetëm njëmbëdhjetë ajete të cilat formojnë një cikël të plotë në Teuhid që meriton të vërehet me kujdes - para hyrjes në komentimin e këtyre ajeteve - mbi këtë mirësi se ajo që na ka treguar Kur'ani është në këto ajete. Edhe pse në pamje të parë duken të prekshme, konkrete, mundet që shumica e njerëzve t'i preceptojnë ato, mirëpo me përparimin e shkencës dhe zhvillimin e saj, njerëzimit mund t'i duken mirësi të reja në këtë aspekt, kurse shkencëtarëve u bëhet e qartë çështja që ka një rëndësi të madhe, gjë të cilën do ta tregojmë nëpërmjet komentimit tonë të këtyre ajeteve.

"...prej argumenteve të Tij është se Ai ju krijoi juve prej dheu."

Së pari, Kur'ani këtu na flet rreth krijimit të njeriut, gjë e cila konsiderohet si një nga dhuratat e para të Tij dhe thotë: **"e mandej ju u zhvilluat në njerëz që veproni të shpërndarë."**.

Në këtë ajet ka tegues për dy nga argumentet e madhështisë së All'llahut.

Ai e krijoi njeriun prej dheu, mbase ka qenë një tregues i krijimit të parë të njeriut, domethënë Ademit, apo krijimit të të gjithë njerëzimit: e para.

Prej dheut sepse të gjitha lëndët ushqyese që krijojnë ekzistencën e njeriut, që të gjitha janë direkt apo indirekt prej dheut;

Shtimi i pasardhësve "njerëzorë" dhe shpërndarja e bijve të "Ademit" në sipërfaqen e banueshme, pasi nëse nuk do të ishte

krijuar specialiteti i shtimit në racë tek Ademi, do të shuhej: e dyta - pasardhësit e tij në ekzistencë me shpejtësi!

Shikoni ku është dheu dhe ku është njeriu në këtë elegancë dhe hijeshi!

Nëse i vendosim qelizat dhe kapakët e syve, të cilat janë më të holla sesa gjethet e luleve, më të buta dhe shumë të ndjeshme, po kështu qelizat e rafinuara të trurit në njërën anë dhe i vëmë në peshore për t'i krahasuar, do të kuptojmë se çfarë fuqie madhështore ka Krijuesi i botës, i Cili ka sjellë në ekzistencë nga një lëndë e zezë e trazuar e e *pavlerë*, këto aparate të rralla dhe me vlerë të rrallë, pasi dheu në përbërje të tij nuk ka dritë, as nxehtësi, as bukuri, as pjekuri, as ndjenjë dhe as lëvizje e megjithatë ka bërë brumin e njeriut dhe ka gjithë këto cilësi.

Ai, i cili ka sjellë në ekzistencë nga kjo gjallesë e vdekur dhe e kotë një krijesë të gjallë e të çuditshme, është meritor për të gjithë lavdet dhe falënderimet për këtë fuqi të jashtëzakonshme dhe këtë dije absolute **"i Madhëruar qoftë All'llahu, më i miri Krijues."**.[1]

Ajeti që po komentojmë na e qartëson garancinë e kësaj të vërtete, që nuk ka ndryshim midis bijve të njeriut dhe rrënja e tyre i referohet vetëm një gjëje dhe një origjine që është dheu dhe sigurisht, sepse edhe përfundimi i tyre në fund është në këtë dhe'.

Në gjuhën arabe përdoren në burime të paparashikueshme dhe ndoshta shprehja këtu është tregues i asaj që fjala *"idha"*, gjë e cila tërheq shikimin, se fjala e All'llahut ka fuqinë e papërshkrueshme që Ai të krijojë njësoj si Ademi, një numër të

1 Sure "Mu'minun", ajeti 14.

stërmadh njerëzish duke i shpërndarë pasardhësit në një kohë shumë të shkurtër – menjëherë – mbushet sipërfaqja e Tokës plot dhe bëhet një shoqëri e plotë njerëzore.

Ajetet flasin gjithashtu për një pjesë tjetër të ajeteve të shpirtrave, të cilat përfaqësojnë fazën se çfarë ka pas një krijimi, domethënë nga raca juaj dhe qëllimi është qetësia shpirtërore dhe rehatia.

"Dhe nga faktet e madhërisë së Tij është që për të mirën tuaj Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë)**, ashtu që ju të gjeni prehje tek ato."**

Përderisa lidhja midis dy bashkëshortëve është speciale dhe ndërmjet gjithë njerëzve në përgjithësi, ajo ka nevojë për tërheqje zemre dhe shpirtërore e pa dyshim se ajeti e mbyll këtë në fund duke shtuar: **"dhe në mes jush krijoi dashuri dhe dhembshuri"** dhe për ta konfirmuar edhe më shumë garancinë, ajeti mbyllet me thënien: **"në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë"**.

E çuditshme këtu është se Kur'ani - në këtë ajet - qëllimin e martesës e ka bërë qetësi dhe rehati dhe i ka qartësuar mirë shumë çështje në një mënyrë shprehjeje të rrallë, sikurse është përmendur e njëjta shprehje në suren "A'raf", ajeti 189: kuptimi është *"li teskunuu"*.

E vërteta është se ekzistenca e bashkëshortëve me këto karakteristika të njerëzve, të cilat konsiderohen thelbi i qetësimit në jetë, është një nga dhuratat madhështore të All'llahut dhe kjo qetësi dhe rehati buron nga ajo që këto dy sekse e plotësojnë njëri-tjetrin dhe secili prej atyre të dyve është thelb i aktivitetit dhe i

zhvillimit të shoqëruesit të tij, pasi secili prej të dyve konsiderohet i paplotësuar pa palën tjetër. Kështu që është normale që midis dy bashkëshortëve të këtë këtë lloj tëheqjeje të fortë.

Prej këtu mund të dalim në përfundimin se ata të cilët e neglizhojnë këtë traditë hyjnore, ekzitenca e tyre është e mangët, sepse faza e plotësimit të tyre ka ndaluar (vetëm se të qënit beqar ka kushte specifike dhe detyruese).

Megjithatë nuk ka asnjë dyshim se kjo rehati apo qetësi është në disa aspekte, si: trupore, shpirtërore, individuale dhe shoqërore. Në situatën e beqarisë ne nuk mund t'i mohojmë sëmundjet që godasin trupin e po kështu, edhe mosekulibrimin shpirtëror dhe shqetësimin psikologjik tek të pamartuarit.

Pastaj individët që janë beqarë nuk e ndiejnë shumë përgjegjësinë nga aspekti shoqëror. Prandaj edhe vetëvrasja shtohet edhe më shumë midis këtyre individëve, sikurse prej tyre burojnë edhe krime më të llahtarshme sesa pjesa tjetër.

Kur njeriu hedh hapin nga faza e beqarisë drejt fazës së jetës familjare, gjen në veten e tij një personalitet të ri dhe e ndien më shumë përgjegjësinë. E gjithë kjo qetësi dhe rehati ndodhet tek hija e martesës.

Sa i përket çështjes së "dashurisë dhe mëshirës", në realitet, ato të dyja janë "ilaçi" konstruktiv në shoqërinë njerëzore, sepse shoqëria përbëhet nga individë të ndryshëm, sikurse edhe ndërtesa gjigande është e përbërë nga një numër i madh tullash apo gurësh, e sikur këta individë të ndryshëm do të bashkoheshin apo ato pjesë të ndryshme do të arrinin njëra-tjetrën, atëherë do të lindte e do të rritej nga kjo shoqëria apo ndërtesa.

Ai, i cili e krijoi njeriun për jetën shoqërore, i ka krijuar atij në zemrën dhe shpirtin e tij këtë lidhje të domosdoshme.

Dallimi midis "mëshirës" dhe "dashurisë" mund t'i referohet aspekteve të mëposhtme.

Dashuria ndodh tek të rriturit, të cilëve mund t'u shërbehet, kurse sa i përket fëmijëve dhe të vegjëlve ata rriten nën hijen e mëshirës. Në shumicën e rasteve, dashuria është "pranimi i të dyja palëve", kështu që ajo është në pozitën e veprimit dhe të kundërveprimit, porse mëshira nga njëra anë, ka altruizëm dhe dhembshuri, sepse ajo mundet ndonjëherë të mos ketë nevojë për shërbimet e ndërsjellta; pra thelbi i vijueshmërisë së shoqërisë është "dashuria", por mund të ketë nevojë për shërbesa pa asnjë kompesim, e ajo është altruizmi dhe mëshira.

Fjala *"bejnekum"* (ndërmjet jush) dhe sigurisht ajeti kur'anor e bën të qartë dashurinë midis dy bashkëshortëve, por supozohet që shprehja të jetë një tregues për të gjithë njerëzit. Kuptimi i fjalës *bashkëshortët* është një nga kriteret e qarta të kësaj shprehjeje, sepse vetëm me këto dy origjina "dashuria dhe mëshira" nuk rregullohet në rrugën e drejtë vetëm jeta familjare, por e gjithë shoqëria njerëzore. Ajo është e ngritur mbi bazën e këtyre dy rrënjëve e edhe shuarja e shoqërisë, saqë edhe neglizhimi i atyre të dyjave apo pakësimi çon drejt përshtjellimeve të ndryshme, vështirësi dhe trazira shoqërore.

Ndërsa ajeti i fundit - prej ajeteve që ne po komentojmë - fillon duke na treguar për krijimin e qiellit dhe të Tokës, pasi ai ajet është përzierje e argumenteve të horizonteve dhe krijesave

dhe thotë: "**dhe prej argumenteve të Tij është krijimi i qiejve dhe Tokës"**.

Qiejt bashkë me gjithë orbitat që kanë në to dhe të gjitha sistemet dhe galaktikat, qiejt të cilat, sado që të rrotullohet mendja, ajo është shumë e dobët për të perceptuar madhështinë dhe mësimet e saj... Dhe sado që të përparojë dituria e njeriut, atij i shfaqen pika të reja të madhështisë së tyre.

Njeriu i shikonte yjet në qiell dhe numëronte aq sa shikonte me sy (kurse dijetarët kanë numëruar yjet që shikohen me sy të lirë dhe zbuluan që silleshin ndëmjet pesëdhjetë mijë deri në gjashtëdhjetë mijë yje).

Mirëpo sa më shumë që përparon shkenca dhe teknologjia e mikroskopëve dhe të teleskopëve, pa dyshim, se edhe numri i yjeve shtohet e shtohet edhe më shumë... deri në atë shkallë sa sot është konfirmuar se vetëm galaktika jonë midis të gjitha galaktikave të qiellit përfshin më tepër se një miliard yje, kurse Dielli për nga madhësia e tij konsiderohet si një nga yjet e mesëm nga përmasa dhe kështu që numrin e galaktikave nuk e di kush veç All'llahut dhe vetëm Ai mund t'i numërojë, Ai është i vetmi, i Cili e di se sa yje ka në këto galaktika.

Gjithashtu sa më shumë të përparojë shkenca e natyrës dhe e gjeologjisë, shkenca e bimësisë dhe të biologjisë, e kafshëve, shkenca e anatomisë dhe e fizikës, shkencat psikologjike e të tjera si këto, atëherë do të bëhen edhe më të qarta mrekulli të krijimit të Tokës që kanë qenë të fshehta; secila konsiderohet prej argumenteve të All'llahut.

Më pas Kur'ani zhvendoset tek një prej argumenteve të mëdha të shpirtrave dhe thotë: **"ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja"**.

Nuk ka asnjë dyshim se jeta shoqërore e njerëzve nuk ngrihet vetëm se mbi bazën e njohurisë dhe analizës së individëve; pasi nëse një ditë, të gjithë njerëzit do kishin një paraqitje dhe të njëjtën veshje, pa dyshim se mënyra e jetesës së tyre do të trazohej në atë ditë, ku nuk njihet babai, biri apo bashkëshorti nuk dallohet nga të huajt, as krimineli ndaj të pafajshmit, as kredidhënësi nga borxhliu, as urdhëruesi nga i urdhëruari, as presidenti nga populli e as mikpritësi ndaj mysafirit, as armiku nga shoku dhe çfarëdo lloj trazire e çuditshme që do të ndodhte sikur të ishte në këtë formë.

Duhet pranuar se ky problem mund të ndodhë midis dy vëllezërve binjakë ose shumë vëllezërve të ngjashëm si binjakë, në të gjitha drejtimet dhe sa shumë probleme ndodhin midis njerëzve dhe midis tyre. Ka ndodhur të kemi dëgjuar ndonjëherë se një grua ka pasur binjakë shumë të ngjashëm dhe njëri prej tyre ishte i sëmurë duke i dhënë ilaçin atij që ishte shëndosh.

Prandaj edhe All'llahu ka krijuar zërat dhe ngjyrat për të sistemuar shoqërinë njerëzore, siç citon "Err Rrazi" në komentimin e tij në fundin e ajetit që po diskutojmë, ku thotë: Vërtet, njeriu e njeh njeriun vetëm nëpërmjet mënyrës së shikimit ose të veshit, kështu që All'llahu ka krijuar ngjyrat, figurat dhe format e ndryshme që syri t'i njohë dhe t'i analizojë mirë, si dhe ka krijuar zëra të ndryshëm që veshi t'i diagnostifikojë deri në atë shkallë sa në të gjithë botën nuk do gjesh dy persona identikë në fytyrë dhe në zë së bashku, domethënë, pa dyshim se fytyra e

njeriut që është një organ i vogël dhe zëri i tij që është një subjekt i thjeshtë, me fuqinë e All'llahut janë me miliarda forma dhe zëra të ndryshëm dhe ky ndryshim apo dallim nuk është vetëm se prej argumenteve të madhështisë së All'llahut.

Sikurse supozohet se qëllimi me gjuhët e ndryshme sikurse e kanë përmendur edhe komentuesit e mëdhenj janë gjuhët e ndryshme që fliten njësoj si arabishtja, persishtja dhe gjuhë të tjera, por nga fjala "ndryshim" mund të përftohet një kuptim i gjerë duke përfshirë këtë komentim dhe atë para tij dhe çdo komentim tjetër, pasi kjo lloj larmie në krijim është dëshmuese e madhështisë dhe e fuqisë së Krijuesit.

Ferid Vuxhdi thotë në enciklopedinë e tij duke transmetuar një thënie nga shkencëtari i njohur i perëndimit, Njutoni: Mos u ankoni për Krijuesin, sepse nuk mund të perceptohet me logjikë që vetëm domosdoshmëria të jetë rregulli i ekzistencës, sepse domosdoshmëria e verbër është e ndryshme në çdo vend dhe në çdo kohë dhe nuk mund të imagjinohet që prej saj të burojnë apo të lindin një larmi krijesash, as edhe e gjitha kjo ekzistencë me gjithçka që ka brenda saj në radhitjen e pjesëve të saj dhe në përshtajtjen e tyre pavarësisht ndryshimit të periudhave kohore dhe vendore. Përkundrazi, e gjitha kjo nuk mund të burojë ndryshe vetëm se nga një qënie e përhershme që ka dëshirë, vullnet dhe urtësi.[1]

Në fund të ajetit, Kur'ani thotë: **"...pa dyshim se në këtë ka argumente për ata që dinë"**.

Dijetarët janë ata që i dinë këto gjëra para çdokujt tjetër.

1 "Dairetul Mearif", Muhamed Erijd Vuxhdij, vëll. 1, f. 496, lënda *ilahun*.

Ajetet 23 - 25

وَمِنْ ءَايَـٰتِهِۦ مَنَامُكُم بِٱلَّيْلِ وَٱلنَّهَارِ وَٱبْتِغَآؤُكُم مِّن فَضْلِهِۦٓ ۚ إِنَّ فِى ذَٰلِكَ لَـَٔايَـٰتٍ لِّقَوْمٍ يَسْمَعُونَ ﴿٢٣﴾ وَمِنْ ءَايَـٰتِهِۦ يُرِيكُمُ ٱلْبَرْقَ خَوْفًا وَطَمَعًا وَيُنَزِّلُ مِنَ ٱلسَّمَآءِ مَآءً فَيُحْىِۦ بِهِ ٱلْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَآ ۚ إِنَّ فِى ذَٰلِكَ لَـَٔايَـٰتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ﴿٢٤﴾ وَمِنْ ءَايَـٰتِهِۦٓ أَن تَقُومَ ٱلسَّمَآءُ وَٱلْأَرْضُ بِأَمْرِهِۦ ۚ ثُمَّ إِذَا دَعَاكُمْ دَعْوَةً مِّنَ ٱلْأَرْضِ إِذَآ أَنتُمْ تَخْرُجُونَ ﴿٢٥﴾

"Nga argumentet e Tij është edhe gjumi juaj natën dhe ditën edhe përpjekja juaj për të fituar nga të mirat e Tij. Në këtë ka argumente për popullin që dëgjon."

"Nga argumentet e Tij është edhe ajo që dëfton vetëtimën edhe si frikë, edhe si shpresë dhe nga qielli lëshon shi e me të ngjall Tokën pas vdekjes së saj. Në këtë ka argumente për një popull që di të mendojë."

"Nga argumentet e Tij është që me fuqinë e Tij bëri të qëndrojë (pa shtylla) **qielli dhe Toka, mandej kur t'ju thërrasë juve me një thirrje prej Tokës, ju menjëherë dilni."**

Komentimi

Edhe një herë argumente të madhështisë së Tij

Pas hulumtimeve të mëparshme rreth argumenteve të All'llahut në horizonte dhe në vetat e njerëzve, këto ajete që ne po komentojmë, flasin për një pjesë tjetër të këtyre argumenteve madhështore.

Në fillim, flasin për fenomenin e "gjumit", duke cituar se ai është një nga fenomenet më të rëndësishme të krijimit dhe një shembull i qartë i sistemit të Krijuesit të Urtë: **"Dhe nga argumentet e Tij është gjumi juaj natën dhe ditën edhe përpjekja juaj për të fituar nga të mirat e Tij"**; pastaj ajeti vjen në fund dhe mbyllet duke na dhënë një mësim: **"vërtet në këtë ka argumente për popullin që dëgjon"**.

Kjo e vërtetë nuk i fshihet askujt që të gjitha "krijesat e gjalla" kanë nevojë për qetësim dhe pushim, e kjo me qëllim për të ripërtërirë fuqitë dhe për të bërë përgatitjet e nevojshme për të patur vazhdimësi në punë dhe efektivitet; qetësi e cila është aq e nevojshme, madje edhe për ata individë që janë të kujdesshëm dhe seriozë.

A ka gjë më të mirë sesa gjumi për të arritur këtë qëllim, i cili vjen natyrshëm në një mënyrë të duhur dhe e fton individin për të ç'aktivizuar aktivitetin e tij trupor dhe një pjesë të rëndësishme të aktivitetit të tij mendor dhe psikologjik, kur ndërkohë, aparate specifike të trupit të njeriut si zemra, mushkëritë dhe një pjesë e aktivitetit mendor vazhdojnë të punojnë, gjë të cilën e kërkon vazhdimësia e jetës tek njeriu?! Kurse sa i përket pjesës tjetër të trupit, ai qetësohet dhe ç'aktivizohet ndaj punës. Kjo dhuratë madhështore ndodh që trupi i njeriut dhe shpirti i tij të arrijë qetësinë dhe çlodhjen e duhur.

Edhe lodhja largohet duke fjetur gjumë, i cili është në pozitën e ndalimit ndaj punës së trupit dhe një lloj ç'aktivizimi. Njeriu, nën ndikimin e tij, gjen forcë të re dhe aktive në jetën e vet.

Pa diskutim se nëse nuk do të ishte gjumi, shpirti i njeriut do të plaste dhe trupi do të shkrihej e do të shkatërrohej me shpejtësi, kurse debolesa dhe pleqëria do t'i vinte më shpejt... prandaj për këtë nuk ka dyshim se gjumi i përshtatshëm dhe i qetë ofron qetësinë dhe rehatinë, si dhe jetë të gjatë, madje edhe zgjatjen e rinisë dhe të qënit aktiv.

Së pari, ajo që meriton të shihet me kujdes është se gjumi është përmendur para shprehjes **"përpjekja juaj për të përfituar të mirat e Tij"**, e cila do të thotë përpjekja në kërkim të riskut dhe kjo shprehje është tregues i asaj që gjumi është thelbi i përpjekjes, sepse pa bërë gjumin e nevojshëm, vështirësohet përpjekja për të mirat e All'llahut.

Së dyti, është e vërtetë që gjumi bëhet natën, kurse kërkimi i të mirave të All'llahut bëhet ditën, por për njeriun nuk është e vështirë për ta ndryshuar këtë rregull, nëse ia kërkon nevoja. Përkundrazi, All'llahu e ka krijuar njeriun në atë formë që ai mundet që ta ndryshojë metodikën e ditës dhe ta përshtasë atë sipas nevojave dhe kërkesave dhe duket sikur shprehja **"gjumi juaj natën dhe ditën"** është një tregues i kësaj "mirësie" të rafinuar.

Nuk ka asnjë dyshim se metoda origjinale e gjumit është e lidhur me natën, sepse nata është e qetë për shkak të errësirës, prandaj edhe ka përparësi specifike në këtë kontekst, por njeriu, për shkak të kushteve specifike, mund të jetë i detyruar që të udhëtojë gjatë natës dhe të pushojë ditën... e nëse metoda e programimit të gjumit është jashtë zgjedhjes së njeriut, atëherë ai do të përballet me shumë vështirësi. Në kohët e sotme, një pjesë e kompanive industriale dhe mjekësore janë të detyruara të punojnë natën e ditën dhe e kanë të pamundur për ta prishur këtë regjim, duke i bërë punëtorët e tyre të punojnë me tre turne.

Kjo domethënie në kohët e sotme është më qartë se çdo periudhë kohe tjetër që ka kaluar.

Nevoja e trupit dhe e shpirtit të njeriut për gjumë është e madhe deri aty sa individi nuk mundet ta suportojë qëndrimin zgjuar në mënyrë të vazhdueshme për më tepër sesa dy – tre ditë; prandaj edhe ndalimi i gjumit konsiderohet si një nga ndëshkimet më të rënda që e praktikojnë mizorët, zullumqarët me të burgosurit e tyre.

Gjumi, po ashtu, konsiderohet si një nga mënyrat kurative për shumë sëmundje, ku mjekët e këshillojnë të sëmurin që të bëjë një gjumë të thellë që të sëmurit t'i shtohet fuqia dhe imuniteti.

Sigurisht, askush nuk mund të përcaktojnë masën e caktuar të gjumit si "kohëzgjatja e duhur e gjumit" për njerëzit në përgjithësi, sepse ajo ka lidhje me moshën e personave, situatën e tyre, gjendjen shpirtërore dhe mënyrën e konstruktit fiziologjik dhe psikologjik të tyre (fizik dhe shpirtëror).

Madje e rëndësishme është që gjumi i mjaftueshëm është deri në atë masë që e ndien njeriu se është ngopur me gjumë... sikurse është situata në raport me ngopjen me ushqim apo me ujë.

Kjo çështje duhet të shihet me kujdes, pasi duke shtuar "gjatësinë" në kohë të gjumit, edhe gjumi i thellë ka karakteristikën dhe rëndësinë e tij gjithashtu. Mbase një orë gjumë të thellë të bëjë njeriu, i mbush disa orë gjumë sipërfaqësor që mund të bëjë për të rinuar shpirtin dhe trupin e tij.

Sigurisht, kur nuk është i mundur gjumi i thellë, edhe kotja (përgjumja) është një prej mirësive të All'llahut, sikurse e ka përmendur ajeti i njëmbëdhjetë i sures "Enfal" në lidhje me luftëtarët (muxhahidinët) në luftën e Bedrit **"dhe kur Ai ju kaploi me një kotje që ishte siguri për ju nga ana e Tij"**, sepse është e pamundur të bëhet një gjumë i thellë në fushën e betejës - nuk është e dobishme dhe as e favorshme.

Sidoqoftë, nuk ka asnjë dyshim se mirësia e gjumit, e qetësisë dhe e rehatisë që buron prej tij, si dhe forca dhe aktiviteti që përfiton njeriu pas gjumit, është prej mirësive, e cila nuk mund të përshkruhet me asnjë lloj deklarate.

Ajeti që vjen më pas, i cili bën të qartë argumentin e pestë të argumenteve të madhështisë së All'llahut, gjithashtu orientohet kah "argumente dhe horizonte" dhe thotë **"Nga argumentet e Tij është edhe ajo që ua dëfton vetëtimën edhe si frikë, edhe si shpresë."**.

Ky ajet flet për vetëtimën dhe bubullimën, shiun dhe ngjalljen e Tokës pasiqë ajo ka vdekur.

"El Khaufu" – *"frika"* është ajo që të shqetëson mendjen është hipoteza, mundësia e rënies së vetëtimës duke djegur gjithçka ku bie dhe duke e bërë pluhur; kurse *"et tam'u"* – *"shpresa"* është në aspektin e zbritjes së shiut pasi kanë rënë vetëtimat, prandaj vërtet që vetëtimat qiellore i paraprijnë rënies së shiut (duke shtuar këtu edhe dobitë e ndryshme të dobishme të vetëtimës), të cilat së fundmi i ka zbuluar edhe shkenca për të cilën kemi folur në fillimin e sures "Rrad".[1]

Më pas Kur'ani shton e thotë: **"dhe nga qielli lëshon shi e me të ngjall Tokën pas vdekjes së saj"**, Tokën e vdekur, tek e cila nuk ka shpresë në të as jeta, dhe as bimësia. Ajo dridhet me rënien e shiut duke e gjallëruar dhe duke shfaqur shenjat e jetës mbi të, mbi format e luleve dhe të bimëve, saqë ndonjëherë duket e pabesueshme se më herët ka qenë një tokë e vdekur.

Në fund, Kur'ani konfirmon në fund të ajetit **"Vërtet, në këtë ka argument për një popull që di të mendojë"** – pra ata e kuptojnë se pas këtij projekti të studiuar qëndron një "dorë" e aftë e fuqishme, që e drejton dhe e udhëzon Tokën dhe çështja nuk

1 Shih këtë tefsir, sure "Rrad", ajetet e para.

mundet kurrë që të jetë e rastësishme dhe nevojë e të verbërve dhe e shurdhëve.

Ajeti i fundit i këtyre ajeteve që po interpretojmë, përsëri flet për argumentet e horizontit, që është kontrolli, drejtimi i sistemit të qiellit dhe të Tokës dhe vazhdimësisë së tyre, ku thotë: **"Nga argumentet e Tij është që me fuqinë e Tij bëri të qëndrojë** (pa shtyllë) **qielli dhe Toka."**.

Domethënë: vërtet, krijimi i qiejve - treguar në ajetet e mëparshme – nuk është i vetmi argument, madje qëndrimi (pa shtylla) dhe vazhdimësia e tyre është po ashtu një argument tjetër, prandaj këto trupa qiellorë gjigandë, në orbitën e saj të mirëorganizuar rreth vetes, kanë nevojë për shumë gjëra dhe më e rëndësishmja prej tyre është llogaritja e përpiktë e forcave tërheqëse dhe shtytëse.

Pa dyshim se Krijuesi ka krijuar një ekuilibër perfekt, aq sa trupat qiellorë nuk bëjnë as devijimin më të vogël në orbitën e tyre dhe rrotullimin e tyre rreth vetes për miliona vite.

Pra, me një mënyrë tjetër të shprehuri, me të vërtetë, ajeti i mësipërm ishte tregues i "Teuhidit hyjnor dhe kontrollit, drejtimit", kurse ky ajet është tregues i "Teuhidit të krijimit".

Mënyra e shprehjes për qëndrimin pa shtylla të qiellit dhe të Tokës është një shprehje e gjetur e bukur e marrë nga situatat e njeriut, sepse një nga situatat, gjendjet më të mira të njeriut për hir të vazhdimësisë së aktivitetit të tij, është situata e qëndrimit të tij në këmbë, pasi vetëm në këtë situatë ai mundet që t'i kryejë të gjitha nevojat e veta dhe duke i pasur nën kontroll të plotë krahët e tij.

Shprehja *"bi emrihi"* - **"me urdhrin e Tij"** këtu ka një tregues të kulmit të fuqisë së All'llahut, ku mjafton një urdhër i vetëm nga ana e Tij për vazhdimësinë e jetës dhe të sistemeve të kësaj bote të gjerë.

Në fund të ajetit, duke përfituar edhe nga faktori i Teuhidit për vërtetimin e ridaljes, rikthimit në jetë, Kur'ani e transferon kërkimin drejt kësaj çështjeje dhe thotë: **"mandej kur t'ju thërret juve me një thirrje prej Tokës, ju menjëherë dilni"**.

Shpesh, në ajetet kur'anore kemi parë se kur All'llahu dëshiron të argumentojë rikthimin në jetë, e bën këtë me argumentet e fuqisë së Tij në Tokë dhe në qiell dhe ajeti që po komentojmë ne është njëri prej tyre.

Shprehja *"deákum"* – **"ju thërret juve"** është për të na bërë me dije se ashtu sikurse mjafton një urdhër i vetëm i Tij për kontrollimin dhe për sistemet e botës, po ashtu mjafton një thirrje e vetme që t'ju ringjallë prej varreve dhe t'ju tubojë për Ditën e Kiametit; sidomos nëse vërejmë me kujdes fjalinë "**ju menjëherë dilni"**. Vërtet fjala *"idha"* na e sqaron mirë pikësynimin e kësaj fjalie, ku vërtet ajo është e befasishme, sikurse e kanë etiketuar specialistët e gjuhës dhe të gramatikës dhe kuptimi i saj është: Nëse All'llahu ju thërret, ju do të dilni shpejt dhe në mënyrë të beftë.

Ndërsa shprehja **"me një thirrje prej Tokës"** është një argument i qartë për ringjalljen trupore ku njeriu do të kapërcejë matanë në Ditën e Kiametit nga kjo Tokë.

Hulumtime

1- Mësime për njohjen e All'llahut

Gjashtë ajetet e përmendura më lart kanë trajtuar diskutime dhe kërkime të ndryshme rreth njohjes së All'llahut dhe të tëra këto ajete formojnë zinxhire të lidhura me njëra-tjetrën dhe një cikël të plotë, duke filluar me krijimin e qiellit e deri tek krijimi i njeriut prej dheu, prej lidhjes së dashurisë në familje tek gjumi, i cili dhuron qetësinë dhe rehatinë ditën dhe natën dhe nga kontrolli i sistemit të botës shkallë-shkallë tek vetëtima, shiu, gjuhët dhe ngjyrat e ndryshme... Këto pra janë një grupim i përshtatshëm i argumenteve të horizonteve dhe të shpirtrave.

E veçanta këtu është se në secilin prej këtyre gjashtë ajeteve, përmenden në to dy pjesë të argumenteve të Teuhidit: e para është Toka e përshtatur, kurse tjetra, është arbitrazhi dhe konfirmimi.

Këtu ngjan plotësisht sikur të sjellësh dy dëshmitarë për të vërtetuar akuzën dhe numri total arrin në dymbëdhjetë dëshmitarë të sinqertë, kundër fuqisë së vërtetë të All'llahut, e cila nuk mund të llogaritet se është e pafund.

2- Cilët janë të inspiruarit në këto ajete?

Në katër nga gjashtë prej këtyre ajeteve citohet konfirmimi që në këto çështje ka argumenta të qarta për të gjithë ata që dinë, që mendojnë, që dëgjojnë dhe logjikojnë, porse ky konfirmim nuk përmendet në ajetin e parë dhe as në ajetin e fundit.

Fakhru Raziu e qartëson këtë aspekt dhe thotë: Kjo mospërmendje mbase është sepse ajeti i parë dhe i dytë kanë ardhur të lidhur së bashku në një kontekst të vetëm dhe secila prej atyre argumenteve është aq e qartë, saqë nuk ka nevojë për t'u sqaruar më tepër. Përsa i përket ajetit të fundit prej ajeteve të cilat flasin për shpirtrat, pa dyshim se çështja është e qartë dhe nuk ka nevojë për përforcim logjikimi e meditimi.[1]

E veçanta këtu është se biseda rreth meditimit është përmendur para se të flitet për "diturinë", sepse meditimi ose të menduarit thellë është paraprirës dhe një rregull i dijes, pastaj vjen fjala për atë që dëgjon, sepse njeriu përgatitet për dëgjimin dhe për pranimin e së vërtetës, nëse ajo është në kontekstin e diturisë dhe të të mësuarit, sikurse ka thënë edhe Kur'ani në lidhje me këtë: **"dhe përgëzoji robtë... Ata të cilët dëgjojnë fjalën dhe ndjekin atë që është më e mira."**.[2]

Në fazën e fundit, është folur për logjikën, sepse ata ishin prej atyre që dëgjonin, kështu që patjetër që duhet ta kenë kaluar fazën e logjikës së plotë.

Sikurse duhet të kthejmë shikimin tek kjo mirësi, ku është folur në fundin e ajetit të parë rreth krijimit të njeriut dhe shpërndarjes së pasardhësve të tij në Tokë **"e mandej ju** (u zhvilluat) **në njerëz që veproni të shpërndarë"**, kurse në një ajet tjetër është përmendur gjithashtu, dalja e njerëzve dhe shpërndarja e tyre Ditën e Kiametit **"ju menjëherë dilni"**.

Ajeti i parë flet për fillimin e krijimit, kurse i fundit për mbarimin, fundin.

1 Tesiri "El Kebijr", vëll. 25, fundi i ajetit në fjalë.
2 Sure "Zumer", ajetet 17-18.

3- Mrekullitë e botës së gjumit

Pavarësisht hulumtimeve dhe studimeve që kanë shkruar shkencëtarët rreth gjumit dhe karakteristikave të tij, duket qartë se qoshet e kësaj bote nuk i kanë zbuluar të gjitha dhe akoma nuk është ngritur perdja e sekreteve dhe e të vërtetave të fshehura.

Akoma edhe sot e kësaj dite diskutohet midis shkencëtarëve: Çfarë veprimi dhe reagimi ndodh brenda trupit – në një çast papritur – saqë ndalon një pjesë e aktiviteteve të trurit dhe të trupit dhe fillon të përhapet në të gjithë shpirtin dhe trupin fizikisht?

Një grup mendon se njeriu ndodhet në situatën e ndodhisë dhe të veprimit dhe kanë thënë: Vërtet faktori kryesor i gjumit është një "reaksion kimik", ku shtohen në të helmet, duke çuar në prishjen e ndërvperimit të një pjese të trurit dhe njeriu nën efektin e kësaj, fle gjumë dhe kur helmet veniten ose shuhen dhe rruazat e kuqe marrin nën kontroll trurin, njeriu zgjohet përsëri.

Një grup tjetër beson dhe mendon se aktiviteti nervor ka një "faktor nervor" dhe thonë:

Me të vërtetë, faktori kryesor i gjumit është një faktor nervor.

Një karakteristikë në tru ka kontrollin dhe drejtimin e makinës dhe kur ajo lodhet, truri fiket dhe ndalon së vepruari menjëherë, mirëpo ka pyetje dhe pika të errëta rreth të gjitha këtyre pikëpamjeve. Deri më tani, nuk kemi arritur tek asnjë

përgjigje e qartë dhe gjumi vazhdon akoma të jetë i mbuluar me sekrete.

Një nga mrekullitë e botës së gjumit që shkencëtarët kanë zbuluar së fundmi është se kur një pjesë e madhe e trurit ndalon së vepruari, disa qeliza që duhet të emërtohen si "qelizat roje" mbeten zgjuar dhe nuk i harrojnë këshillat që i ka dhënë njeriu para se të flinte. Kur vjen koha e zgjimit, këto qeliza e zgjojnë të gjithë trurin dhe lëvizin përsëri duke vepruar.

Për shembull:

Nëna që ushqen fëmijën me qumësht, e lodhur, kur bie të flejë natën dhe në një anë ka foshnjën e saj në djep, mendjen e saj të brendshme e këshillojnë qelizat roje që bëjnë lidhjen ndërmjet shpirtit dhe trupit, që kur ajo të dëgjojë edhe zërin më të vogël të fëmijës, atëherë më zgjo, por zë tjetër nuk më intereson fare e mbase kjo grua nga zhurma e vetëtimës as që mund të zgjohet fare, por zgjohet për zërin më të vogël të foshnjës së saj. Kjo detyrë është punë e qelizave roje.

Edhe neve na ka tërhequr shumë kjo temë. Edhe kur vendosnim për t'u zgjuar herët apo në mes të natës për të udhëtuar apo për të bërë diçka të rëndësishme, i flisnim veteve tona me këtë formë dhe në shumicën e rasteve, zgjoheshim në orarin që kërkonim, kur ndërkohë mund të mbyteshim në një gjumë të thellë përpos kësaj situate; sepse gjumi është prej fenomeneve shpirtërore dhe shpirti ka një botë të mbushur me sekrete. Nuk është çudi që kjo çështje të mbetet në mister për

shumë kohë... por sa më shumë e gërmojë shpellën e kësaj bote, aq më shumë njihemi me madhështinë e Krijuesit të këtij fenomeni.

Kaq sa i përket fenomenit të gjumit, ndërsa në lidhje me ëndrrat dhe vizionet, ne kemi bërë shumë hulumtime për to dhe kemi diskutuar shumë, por s'ka ndonjë gjë nëse e përsëritim tefsirin e sures "Jusuf".

4- Lidhja e dashurisë midis dy bashkëshortëve

Pavarësisht se lidhja midis njeriut dhe babait të tij, nënës, motrës dhe vëllezërve të tij është një lidhje familjare, rrënjët e saj zgjaten thellë në afërsinë e gjakut.

Lidhja midis dy bashkëshortëve është një lidhje ligjore dhe "lidhje e pajtuar midis atyre të dyve", por në shumicën e rasteve, kjo lidhje triumfon, madje edhe ndaj lidhjes së njeriut me babain e vet dhe nënën e vet. Ajetet e lartpërmendura, në të vërtetë, këtë kanë pasur si qëllim, duke u shprehur **"dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë"**.

Le të lexojmë një hadith nga i Dërguari *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur ai e lajmëroi bijën e Xhahshit për rënien dëshmor të dajës së saj dhe ajo tha: "Të All'llahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi"; e lajmëroi për rënien dëshmor të vëllait të vet dhe tha të njëjtën gjë përsëri: "të All'llahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi" dhe u lut për të që të ketë marrë shpërblimet dhe sevapet. Mirëpo, kur e lajmëroi atë për rënien dëshmor të bashkëshortit të saj, e vendosi dorën mbi

kokë dhe ulëriti, kurse Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "Askush nuk ka vend të barabartë me burrin te gruaja.".[1]

1 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 174.

Ajetet 26 - 29

وَلَهُۥ مَن فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۖ كُلٌّ لَّهُۥ قَٰنِتُونَ ﴿٢٦﴾ وَهُوَ ٱلَّذِى
يَبْدَؤُا۟ ٱلْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُۥ وَهُوَ أَهْوَنُ عَلَيْهِ ۚ وَلَهُ ٱلْمَثَلُ ٱلْأَعْلَىٰ فِى
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ وَهُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ﴿٢٧﴾ ضَرَبَ لَكُم مَّثَلًا مِّنْ
أَنفُسِكُمْ ۖ هَل لَّكُم مِّن مَّا مَلَكَتْ أَيْمَٰنُكُم مِّن شُرَكَآءَ فِى مَا رَزَقْنَٰكُمْ
فَأَنتُمْ فِيهِ سَوَآءٌ تَخَافُونَهُمْ كَخِيفَتِكُمْ أَنفُسَكُمْ ۚ كَذَٰلِكَ نُفَصِّلُ
ٱلْءَايَٰتِ لِقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ﴿٢٨﴾ بَلِ ٱتَّبَعَ ٱلَّذِينَ ظَلَمُوٓا۟ أَهْوَآءَهُم بِغَيْرِ
عِلْمٍ ۖ فَمَن يَهْدِى مَنْ أَضَلَّ ٱللَّهُ ۖ وَمَا لَهُم مِّن نَّٰصِرِينَ ﴿٢٩﴾

“E Tij është ç’ka në qiej e në Tokë dhe të gjithë vetëm Atij i përulen.”

“Dhe Ai është që shpik jetën e pastaj e përsërit atë, e ajo (përsëritja) **është edhe më e lehtë për Të** (sipas mendimit tuaj)**. Shëmbëlltyra më e lartë është vetëm e Tij në qiej e në Tokë dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti**.”

"Ai (Zoti) **ju jep një shembull nga vetë ju; a i keni shokë** (ortakë) **ata që janë në posedimin tuaj** (shërbëtorët)**, në atë që Ne ua dhamë juve** (në pronësi) **që të jeni ju dhe ata të barabartë në të,** (në përdorimin e saj) **e të frikësoheni prej tyre** (se po marrin kompetencë) **si frikësoheni ju në mes vete.** (Ju nuk pranoni për otakë shërbëtorët tuaj, të jeni të barabartë, nuk kini frikën e tyre e si më përshkruani Mua ortak)**? Ne kështu u sqarojmë faktet njerëzve që janë të logjikshëm."**

"Jo (ata nuk kanë fakt)**, por ata që i bënë të padrejtë vetes, pa ndonjë fakt të dijes, shkuan pas dëshirave të epshit të vet. Po kush mund të vërë në rrugë të drejtë atë që All'llahu e ka lënë të humbur, e ata nuk do të kenë ndihmëtarë."**

Komentimi

Sundimi i takon vetëm All'llahut

Ajetet e mëparshëm na folën rreth Njehsimit të Krijuesit, ndërsa ajeti i parë i këtyre ajeteve që po komentojmë flet për një degë tjetër të degëve të Teuhidit që është Teuhidi i zotërimit dhe thotë: **"E Tij është ç'ka në qiej dhe në tokë"**, sepse ata janë të gjithë në zotërimin e Tij dhe **"të gjithë vetëm Atij i përulen"**, të nënshtruar Atij.

Zotërimi dhe përulja është një çështje në aspektin e krijimit dhe është e qartë se qëllimi është për nënshtrimin e krijesave dhe përuljen e tyre... domethënë se gjithçka në aspektin e gjithë ligjeve

krijuese janë në dorën e Tij dhe ata (njerëzit) i janë dorëzuar ligjit të botës së krijimit, formimit sipas vullnetit të All'llahut, deshën apo s'deshën, madje edhe vetë kundërshtuesit, mizorët, rebelët ndaj ligjit dhe zullumqarët edhe ata janë të detyruar që të ulin kokat ndaj urdhrit të All'llahut në ligjet e krijimit.

Argumenti për këtë "zotërim" është cilësia krijuese sepse nuk ka asnjë dyshim se Ai i Cili i ka krijuar gjallesat në fillim duke i garantuar edhe kontrollin, organizimin, atëherë është e padiskutueshme se Ai është Zotëruesi kryesor i tyre dhe askush tjetër; meqë të gjitha krijesat e dynjasë janë të barabartë në këtë çështje, atëherë është e qartë që Ai të mos ketë asnjë ortak në zotërim, e edhe putat dhe gjërat e fabrikuara që imagjinojnë idhujtarët se ato janë zotat e tyre, edhe ato janë të poseduara dhe të zotëruara nga Mbreti i "mbretërisë" dhe mbretërive, ajo është bindje ndaj urdhrit të Tij.

Duhet të shikojmë me kujdes se fjala *"kanitun"* në fakt, sikurse thotë Rragibi në librin "El Mufredat", do të thotë bindja e pandarë nga nënshtrimi.

Një hadith i të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë: *"Çdo nënshtrim në Kur'an është bindje."*.

Nganjëherë bindja vjen *"kreative"* – *"tekuinijeh"* e herë tjetër *"legjislative"* – *"teshriijeh"*, **"të qëndrueshëm në dëshminë e Njehsimit të Tij"**. Një pjesë e komentuesve kanë thënë se fjala *"kanitune"* këtu ka kuptimin e atyre që dëshmojnë Njëtimin e Tij.[1]

1 Transmeton "Alusij" në tefsirin e tij "Ruhul Meanij", fundi i ajetit që ne po komentojmë thënë nga disa komentues të hershëm.

Në realitet, kjo është vërtetësi për Njëtimin e All'llahut, sepse dëshmia për Njëtimin e All'llahut është një prej llojeve të bindjes.

Meqenëse vërtet çështjet lidhur me zanafillën dhe fundin e kohës janë njësoj si një brumë i vetëm në harmonizimin e tyre në zinxhirin e argumenteve të larpërmendura dhe ato të cilat do të vijnë më pas, në ajetin që pason, Kur'ani i kthehet temës së rikthimit dhe thotë: **"dhe Ai është që e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo** (përsëritja) **është edhe më e lehtë për Të"**.[1]

Vërtet, Kur'ani konfirmon në këtë ajet - me një argumentim të përmbledhur - çështjen e mundësisë së rikthimit, duke i thënë atyre (njerëzve): "Me të vërtetë ju besoni se fillimi i krijimit është prej All'llahut e kështu përsëritja e krijimit edhe një herë tjetër është edhe më e lehtë sesa fillimi i krijimit dhe argumenti që rikrijimi është edhe më i lehtë është se në fillim, nuk ka pasur asgjë, por All'llahu është Ai që e gjeti krijimin. Për rikrijimin ekzistojnë lëndët thelbësore ku një pjesë janë në shtresat e tokës, kurse një pjesë janë në shkallët e horizontit dhe ajo që ka nevojë është vetëm sistemimi dhe dhënia asaj formën e saj të parë, e kjo është edhe më e lehtë.

1 Fakhru Rraziu transmeton nga Zamkhasheriju, në tefsirin e Keshafit se All'llahu, në lidhje me lindjen e Isait (Paqja qoftë mbi të!) pa baba, ka thënë: "Ajo është e lehtë shumë për Mua" dhe se fjala *"alejje"* është përpara fjalës *"hejjinun"*. Ky është një argument i kufizimit, koncentrimit; domethënë: kjo punë është e lehtë vetëm për Mua dhe për askënd tjetër; ndërsa në këtë ajet që po komentojmë, i Lartësuarti ka thënë: *"ve huve ehvenu aljehi"*, pra këtu nuk përftohet kufizimi. Ky është një tregues që secili që mund të kryejë një punë, në fillim, është i aftë që ta përsërisë atë, e prandaj vërejeni me kujdes!

Mirëpo, është e nevojshme që të shikojmë me kujdes këtë mirësi që mënyra e shprehjes më e lehtë dhe e vështirë është nëpërmjet dritares tonë intelektuale, kurse sa i përket të Fuqishmit Absolut, tek Ai nuk ka asnjë ndryshim midis "e vështirë dhe e lehtë". Në thelb, vërtet "e vështira dhe e lehta" konfirmojnë një nocion në një vend ku fjala ekziston në një forcë të kufizuar sikurse një person të bëjë një punë në një mënyrë të re, kurse të fundit nuk e kryen me mënyrë të mirë, por me vështirësi, ndërsa kur bëhet fjalë për një fuqi të pakufishme, atëherë këtu nuk ka vend dhe nuk mund të perceptohet e vështira apo e lehta.

Me një mënyrë tjetër të shprehuri: vërtet bartja e "maleve më të mëdha mbi faqen e Tokës për sa i përket All'llahut dhe bartja e gjërave më të lehta janë njësoj tek Ai, sepse fuqia e Tij është e pakufishme.

Ndoshta për këtë shkak Kur'ani ka përsëritur menjëherë në fundin e ajetit duke thënë:

"Shëmbëlltyra më e lartë është vetëm e Atij në qiej dhe në Tokë", sepse nëse ne imagjinojmë çdo lloj përshkrimi të përsosur të çdolloj gjallese në qiell dhe në Tokë, si: dije, fuqi, posedim, madhështi, ekzistencë dhe bujari, atëherë dëshmitari më i saktë dhe vërtetimi më i plotë, më i përsosur është tek All'llahu; kjo sepse të gjitha gjallesat kanë cilësi të kufizuara përveç Atij, të Vetmit. Nuk ka dyshim se Ai ka cilësitë (sifatet) e pakufizuara; të gjithë kanë përshkrime, cilësi kundërshtuese, ndërsa All'llahu ka cilësi të vetvetishme; Ai është burimi i përsosjeve dhe thelbi i tyre, saqë edhe shprehjet që dalin nga gjuhët tona janë dëshmitare të qëllimeve tona të përditshme është e pamundur që të jenë

sqaruese të përshkrimit të Tij, sikurse thuhet në shprehjen *"ehvenu"* – *"më e lehtë"*, shembull të cilin e gjejmë tek ne.

Ajeti përfundon me një konfirmim dhe argument, ku i Madhërishmi thotë: **"Ai është Mbizotëruesi, i Urti."**.

Ai është Ngadhënjyesi që nuk mposhtet kurrë; në kulmin e fuqisë së Tij të pakufishme nuk buron prej Tij ndonjë veprim jopreciz, pasi të gjitha veprat e Tij ndodhin sipas urtësisë së Tij. Në një shembull që ka sqaruar mirë dhe pasi sqaron një pjesë tjetër të argumenteve të Teuhidit dhe rikthimit në ajetet e mëparshme, Kur'ani trajton temën e "ndalimit të shirkut" dhe thotë: **"Ai ju jep një shembull nga vetë ju"; "A i keni shokë** (ortakë) **ata që janë në posedimin tuaj** (shërbëtorët)**, në atë që Ne ua dhamë juve** (në pronësi)**."**.

Pra, o ju idhujtarë - keni skllevër dhe robër dhe këta bëhen pjesë e pasurive tuaja dhe në atë që Ne ju kemi furnizuar, aq sa ju bashkë me shërbëtorin bëheni të barabartë **"e të frikësoheni prej tyre si frikësoheni ju ndërmjet vete"**, domethënë, shërbëtori juaj është i barabartë me ju në posedimin e pasurive dhe mirësive dhe ju frikësoheni të menaxhoni në mënyrë të pavarur këto pasuri njësoj sikurse për shembull është situata me oragnizimin e ortakëve tuaj të lirë apo të trashëgimisë...

Ju jeni të papërgatitur që ata të menaxhojnë pasuritë tuaja, pasi nëse ju do të kishit një skllav të besueshëm "që është një pronë falas", nuk do ta pranonit këtë veprim të tyre, por si mund të imagjinoni krijesat, të cilat janë pronë e vërtetë e All'llahut se janë ortakë të Tij?! Apo të pohoni se disa Pejgamberë si Mesihu apo melekët e All'llahut apo një pjesë tjetër e krijesave si xhindet

apo putat prej guri e prej druri janë ortakët e Tij?! Sa gjykim i lig është ky i juaji!

Pasuritë metaforike, të cilat mund të çlirohen me shpejtësi dhe bëhen pjesë e radhëve tuaja sikurse ka ndodhur në Islam - gjendja e saj nuk quhet e poseduar tek poseduesi i tij dhe nuk ka të drejtë që të ndërhyjë në zonën e ndikimit të tij, atëherë si i bëni robërit e vërtetë apo pasuritë e vërteta ortakë të All'llahut, ndërkohë që ju jeni të lidhur pas All'llahut me trup e me shpirt dhe kjo lidhje me All'llahun nuk mund të largohet dhe çdo gjë që ju keni është prej Tij dhe ju nuk jeni asgjë pa Të?!

Një pjesë e komentuesve kanë thënë: Me të vërtetë, ky ajet është mbikëqyrës i asaj që kanë thënë idhujtarët kurejshë kur po kryheshin ritualet e Haxhit. Ata thonin "Të përgjigjemi Ty, o All'llah, i Pashoq je Ti, përveç një ortaku që Ti ke Vetë në pronësi dhe atë që ai posedon "... Kjo ishte përmbajtja e thirrjes së tyre.[1]

Kuptohet që pozita e zbritjes së këtyre ajeteve është e njëjtë me ato ajete që kanë zbritur duke mos përcaktuar kuptimin e ajetit, sikurse në të njëjtën kohë, është edhe një kundërpërgjigje për të gjithë idhujtarët.

Ajo është marrë nga vetë jeta e tyre, e cila sillet rrotull skllavërisë dhe shërbëtorëve dhe që protestojnë fort kundër tyre.

Shprehja **"ma rezaknakum" – "ajo që Ne ju kemi furnizuar"**, na e tregon këtë mirësi, që është: ju nuk jeni poseduesit e vërtetë të këtyre skllevërve dhe shërbëtorëve dhe as

1 Tefsiri "El Mizan", vëll. 16; tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 303; tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 181, fundi i ajetit që po komentojmë.

zotërusit realë të pasurisë, sepse e gjitha kjo është vetëm e All'llahut, të Vetmit, mirëpo ju jeni të papërgatitur t'i autorizoni apo t'i jepni të drejtën shërbëtorëve tuaj që të menaxhojnë pasuritë tuaja dhe t'i konsideroni ata ortakët tuaj, ndërkohë që kjo, në aspektin e kreativitetit nuk konsiderohet e pamundur dhe s'ka asnjë problem nga aspekti i kreativitetit, sepse biseda është rreth mënyrave teorike.

Nga njëra anë, t'i bësh krijesat ortake të All'llahut dhe pa dyshim adhurimi i ndonjërës prej krijesave për shkak të madhështisë së saj apo sepse ajo i bën dobi apo dëm njeriut, është prej absurditeve të mëdha, se dallimi midis All'llahut dhe krijesave të Tij është një dallim strukturor dhe nuk ndryshon dhe këta krijesa as nuk dëmtojnë dhe as nuk bëjnë dobi.[1]

Kur'ani Famëlartë e mbyll ajetin në fund me konfirmimin dhe saktësinë e përmbajtjes së pyetjes dhe thotë: **"Ne kështu ua sqarojmë faktet njerëzve që logjikojnë."**.

Po, Ne ju kujtojmë juve në shembuj të vërtetë e të qartë të jetës tuaj që ju të mendoni dhe të mos ia atribuoni All'llahut - të paktën - atë që nuk do ta dëshironit për vetet tuaja, mirëpo këto argumente të qarta dhe këto shembuj të pastra janë për ata njerëz që janë të zgjuar dhe jo për zullumqarët, pasionantët dhe injorantët, zemrat e të cilëve i ka mbuluar injoranca, kurse horizontet e tyre i kanë përfshirë trillimet dhe fanatizmat. Prandaj

1 Një pjesë e komentuesve të Kur'anit e kanë komentuar fjalinë **"ju i frikësoheni atyre njësoj siç i frikësoheni veteve tuaja"** me një komentim tjetër; ndodh që këta skllevër nuk kanë asnjë fuqi që ju t'i frikësoheni atyre njësoj sikurse e keni frikë njëri-tjetrin. Po si është puna vallë, nëse frika është edhe më e madhe?! Mirëpo, komentimi që dhamë në fillim, duket se është më afër arsyes.

edhe Kur'ani në ajetin që pason ka shtuar duke thënë: **"Jo, por ata që i bënë të padrejtë vetes pa ndonjë fakt të dijes shkuan pas dëshirave të epshit të vet"**, për këtë All'llahu i braktisi ata për shkak të veprave të tyre të këqija dhe ata humbën në luginën e humbjes së madhe.

Shpreja me fjalën *"dhalemu"* në vend të fjalës *"esh'reku"* është tregues i asaj që shirku (vënia shok) konsiderohet si padrejtësia më e madhe, që është padrejtësia ndaj Krijuesit duke e vendosur krijesën e Tij në krah të Krijuesit, duke ia bërë ortak.

Ne e dimë se padrejtësi quhet kur e vendos diçka në vendin që nuk i takon të jetë - padrejtësia ndaj krijimit që ia pengon atyre rrugën e hajrit dhe të lumturisë rrugën e Teuhidit dhe të padrejtësi ndaj veteve të tyre, sepse e kanë hedhur në erë të gjithë qënien dhe ekzistencën e tyre dhe kanë mbetur brenda strehës së verbër, të zbrazët e të braktisur **"po kush mund ta vërë në rrugë të drejtë atë që All'llahu e ka lënë të humbur?"**.

Kjo mënyrë të shprehuri, që All'llahu i ka lënë në humbje ndaj rrugës së vërtetë me padrejtësinë e tyre, është prezantuese e fjalisë vijuese, sikurse përmendet me këtë shprehje në suren "Ibrahim", ajeti 27: **"All'llahu i çon në humbje zullumqarët."**.

Nuk ka asnjë dyshim se atë që e braktis All'llahu **"e ata nuk do të kenë ndihmëtarë"**.

Me këtë që u tha, Kur'ani e sqaron mirë fundin e këtij grupacioni të përbuzur, dhe përse të mos jetë kështu? Kur ata kryejnë gjynahet më të mëdha dhe padrejtësinë më të madhe, duke e ndaluar së punuari mendjen dhe logjikën, kurse diellin e dijes e kanë lënë pas krahëve, duke u drejtuar kah errësirat e

injorancës dhe të pasionit; prandaj është mëse normale që All'llahu t'ua marri atyre suksesin dhe t'i lërë ata në errësirat e tyre. Në fund ata nuk kanë asnjë ndihmëtar që t'i ndihmojë.

Ajetet 30 – 32

فَأَقِمْ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا ۚ فِطْرَتَ ٱللَّهِ ٱلَّتِى فَطَرَ ٱلنَّاسَ عَلَيْهَا ۚ لَا تَبْدِيلَ لِخَلْقِ ٱللَّهِ ۚ ذَٰلِكَ ٱلدِّينُ ٱلْقَيِّمُ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَ ٱلنَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٠﴾ ۞ مُنِيبِينَ إِلَيْهِ وَٱتَّقُوهُ وَأَقِيمُوا۟ ٱلصَّلَوٰةَ وَلَا تَكُونُوا۟ مِنَ ٱلْمُشْرِكِينَ ﴿٣١﴾ مِنَ ٱلَّذِينَ فَرَّقُوا۟ دِينَهُمْ وَكَانُوا۟ شِيَعًا ۖ كُلُّ حِزْبٍۭ بِمَا لَدَيْهِمْ فَرِحُونَ ﴿٣٢﴾

“Përqendro vetveten tënde sinqerisht në fenë e All’llahut. Përqendro vetveten në atë fe’, në të cilën All’llahu i krijoi njerëzit. Në atë fe’, e cila s’ka asnjë ndryshim; në atë fe, të natyrshme të krijuar nga All’llahu. Ajo fe’ është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”

“ (Përqendrohuni në atë fe’) **Të kthyer sinqerisht tek Ai, kini frikë prej Atij dhe faleni namazin e mos u bëni nga idhujtarët.”**

“Idhujtarët e përçanë fenë e tyre, u ndanë në grupe dhe secili grup i gëzohet idesë së vet.”

Komentimi

Deri tani janë zhvilluar shumë diskutime rreth Teuhidit dhe njohjes së All'llahut. Në qendër të këtyre diskutimeve ka qenë shikimi i sistemit të krijimit dhe përpjekjet për të vërtetuar zanafillën e diturisë dhe të fuqisë. Janë diskutuar edhe argumentet që flasin për atë se çfarë ka pas botës së natyrshmërisë. Të gjitha këto diskutime janë zhvilluar duke u mbështetur në argumentet e Njehsimit që sjell kjo sure.

Ajeti i parë, prej këtyre ajeteve që po komentojmë, flet për Teuhidin e natyrshëm - do me thënë argumentimin e Teuhidit nëpërmjet shikimit të anës së brendshme përmes njohurive të domosdoshme dhe të vetëdijshme.

Kur'ani, në lidhje me këtë, thotë: **"Përqendro vetveten tënde sinqerisht në fe', i larguar prej çdo të kote"**, sepse ajo është: **"**(e ajo fe') **feja e All'llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim të asaj natyrshmërie të krijuar nga All'llahu, ajo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.".**

Fjala *"el vexh'hu"* ka kuptimin *"i njohur"*, *"mirësi"*. Kjo fjalë përdoret edhe me kuptimin *''pjesa e përparme e kokës''* (fytyra). Por këtu nënkuptohet edhe përdorimi i saj me kuptimin *''njohuri, mirësi e brendshme, mirësi e zemrës dhe e shpirtit''*. Pra, duhet të kuptojmë se mirësia nuk shprehet vetëm me pamjen e jashtme, vetëm me fytyrën, por me gjithë qenien, përfshirë edhe fytyrën si pjesa më shprehëse e trupit.

Kurse fjala *"ekim"* rrjedh nga fjala *"ikametun"*. Kuptimi i saj është drejtimi i drejtë dhe qëndrimi i drejtë, i qëndrueshëm (mbi këmbë të qëndrueshme).

Fjala *"hanijf"* rrjedh nga *"hanefe"*. Ajo përdoret me kuptimin ''lënia e të pavërtetës dhe animi kah e drejta". Kjo është e kundërta e fjalës *"xhenefe"*, njësoj si *"hanefe"* dhe kuptimi i të cilave është animi, largimi nga e kota drejt së vërtetës.

Kuptimi i fesë së pastër është feja që anon drejt drejtësisë dhe qëndrimi i drejtë në të, largimi nga çdo devijim dhe e pavërtetë, nga çdo trillim dhe humbje.

Ka mundësi që kjo fjali të ketë kuptimin në tërësinë e saj të drejtosh dhe të orientosh veten tënde gjithmonë drejt origjinës dhe rrugës së pastër nga çdo lloj lakimi, nga çdo lloj devijimi. Ky është principi i besimit islam dhe feja e pastër e All'llahut.[1]

Ajeti paraprirës, pa dyshim që konfirmon se feja e pastër, e sinqertë dhe e çliruar nga të gjitha llojet e shirkut (vënies ortak All'llahut), është feja të cilën e ka frymëzuar All'llahu i Madhëruar në çdo natyrshmëri e krijim. Natyrshmëria e përhershme nuk ndryshon edhe pse shumica e njerëzve nuk e kthejnë shikimin e tyre nga kjo e vërtetë.

Ajeti i mësipërm sqaron disa të vërteta:

1 *Elifi* dhe *lami* në fjalën *"ed dinu"* janë të dyja për premtimin, dhe ato të dyja këtu janë treguese të fesë që është urdhëruar Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që të përcjellë, domethënë fenë "islame".

1- Pa dyshim se njohja e All'llahut është një çështje e natyrshme. Pa dyshim se feja dhe besimi sipas mësimeve të Teuhidit konfirmojnë se mes sistemit të krijimit dhe të legjislacionit ka një harmoni të domosdoshme. Ajo që thuhet në ligj në mënyrë të padiskutueshme, duhet që t'i ketë rrënjët në fe, në natyrshmëri dhe ajo që është në krijim, formim dhe në natyrshmërinë e njeriut është në harmoni me ligjet e Sheriatit.

Në një mënyrë tjetër të shprehuri thuhet: Pa dyshim se krijimi dhe legjislacioni janë dy organe të forta që punojnë në harmoni në fusha të mjaftueshme, sepse ligji nuk mund të ftojë kur mungon mbështetja në baza të shëndosha dhe në rrënjë të futura thellë në thellësitë e natyrshmërisë së njeriut. Krijimi dhe legjislacioni nuk mund të jenë në kundërshtim me thellësitë e natyrshmërisë së njeriut dhe në kundërshtim me ligjin e All'llahut.

Nuk ka asnjë dyshim se ligji përcakton kufij dhe kushte për udhëheqjen e natyrshmërisë, që të mos bjerë në rrugën e devijuar. Por ai nuk e kundërshton origjinën e vullnetit të natyrshmërisë, përkundrazi, e udhëzon atë drejt rrugës legjitime, të vërtetë. Në të kundërtën, ligji do të shkaktonte kontradiktë mes legjislacionit dhe krijimit dhe kjo gjë nuk harmonizohet me bazën e Teuhidit.

Me të vërtetë se All'llahu nuk bën kurrë vepra kontradiktore. Urdhri i Tij kreativ është kur thotë: Bëhu! Kurse urdhri legjislativ kur thotë: Mos u bëj.

2- Pa dyshim se feja ka një natyrshmëri ekzistence të pastër, të kulluar nga çdo dyshim brenda vetë njeriut.

Devijimet janë një çështje që shfaqen befas. Lind nevoja e punës së Profetëve që të shkatërrojnë këto çështje të befta dhe të përhapin drejtësinë e aspektit të natyrshmërisë së njeriut në lindje.

3- Fjalia: **"S'ka ndryshim të asaj natyrshmërie të krijuar nga All'llahu"** dhe pas saj fjalia: **"ajo është feja e drejtë"** janë dy konfirmime të tjera në çështjen e të qenit të fesë fe e natyrshmërisë dhe pamundësia e ndryshimit të kësaj natyrshmërie, edhe pse shumica e njerëzve nuk e dinë këtë të vërtetë, për arsye se nuk janë udhëzuar ashtu siç duhet.

Fjala *"bedhere"* përdoret me kuptimin *''çarja e diçkaje për së gjati''*. Këtu kuptimi i saj lidhet me nocionin e krijimit. Konotacioni kuptimor të jep idenë sikur perdja e mosekzisencës çahet, hapet tek krijimi i gjallesave dhe prej saj shfaqet mirë çdo gjë.

Megjithatë, që kur njeriu ka vendosur këmbën e tij në botën e ekzistencës, kjo dritë ka qenë e ndezur në brendësi të tij, që në ditën e parë të asaj ekzistence.

Transmetimet e shumta që janë përmendur në komentimin e ajetit e mbështesin atë që kemi thënë më parë. Por ne do të flasim për këtë në vijim, në dashtë All'llahu, duke shtuar edhe diskutime të tjera, duke treguar natyrshmërinë e Teuhidit.

Në ajetin që vijon Kur'ani shton: Duhet që tërheqja e shikimit tuaj nga feja e pastër dhe e natyrshme, të jetë tregues i të qenit të ekzistencës tuaj **"të kthyer sinqerisht tek Ai"**. Origjina dhe rrënja juaj është në Teuhid dhe duhet që të riktheheni tek Ai.

Fjala *"munibine"* është nga lënda *"inabetun"*. Kjo fjalë, në origjinë ka kuptimin *''rikthimi i përsëritur''*. Këtu ka kuptimin rikthim drejt All'llahut dhe kthim nga feja e natyrshmërisë (njehsuese e saj). Do të thotë se kur nuk arrin asnjë faktor të devijojë besimin e njeriut nga origjina e Teuhidit, atëherë ai duhet që të kthehet tek Ai. Sado që të diskutohet kjo çështje, nuk ka asnjë pengesë që shtyllat e forta dhe të qëndrueshme të fesë të bëhen pengesa dhe nxitëse vakante e të boshatisura; nuk ka asnjë gjë që ta pengojë njeriun të qëndrojë në mënyrë të vazhdueshme në ballë të Teuhidit dhe të bëhet konfirmues i ajetit: **"Përqendro vetveten tënde sinqerisht në fenë."**.

Ajo që na tërheq vëmendjen, është se togfjalëshi **"përqendro vetveten tënde"** është përdorur në formën e njëjësit, kurse fjala *"munibine"* vjen në formën e shumësit. Kjo tregon se, edhe pse urdhri i parë i drejtohet Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pra vetëm një personi, biseda, në të vërtetë, është për të gjithë besimtarët dhe të gjithë myslimanët.

Komentimi i urdhrit, delegimi dhe rikthimi tek Ai, urdhërimi në devotshmëri, është një fjalë që bashkon dhe përmbledh kuptimet e urdhëresave të All'llahut dhe ndalesat e Tij. Ai thotë: **"kijeni frikë Atë"**. Domethënë kini frikë kundërshtimin e urdhëresave të Tij.

Më pas Kur'ani përqendrohet në temën e namazit dhe të urdhëresave që lidhen me të. Ai thotë: **"...dhe faleni namazin, sepse namazi në të gjitha dimensionet e tij, është mënyra më e mirë në përballimin e shirkut dhe metoda me ndikimin më të madh në forcimin e bazave, shtyllave të Teuhidit dhe besimit tek All'llahu i Madhëruar".**

Kur'ani fokusohet në ndalimin e "shirkut" në mesin e të gjitha ndalesave të tjera dhe thotë: **"e mos u bëni nga idhujtarët"**.

Shirku (vënia ortak All'llahut) është një nga gjynahet më të mëdha. All'llahu mund t'i falë të gjitha gjynahet, përveç shirkut. E pa dyshim se Ai nuk e fal atë.

Këtë e lexojmë në ajetin 48 të sures Nisa: **"S'ka dyshim se All'llahu nuk fal** (gjynahun) **t'i përshkruhet Atij shok** (idhujtarinë)**, e përpos këtij** (gjynahu) **i falë kujt do."**.

Është e qartë se katër urdhëresat që janë përmendur në këtë ajet, janë konfirmim dhe përforcim i çështjes së Teuhidit dhe i gjurmëve të tij praktikë, sepse kjo çështje është çështje më e përgjithshme se pendimi dhe rikthimi tek Ai, i Lartësuari, rikthimi te devotshmëria ndaj Tij, rikthimi te falja e namazit dhe mosvënies shok, mosbërjes ortak Atij.

Në ajetin e fundit prej ajeteve që po komentojmë, Kur'ani bën të qartë një nga efektet e shirkut dhe shenjat e tij. Komentohet, veç të tjerave dhe një shprehje e shkurtër, por me një kuptim të madh, kur thotë: Mos u bëni prej idhujtarëve të cilët janë ndarë në fenë e tyre, janë ndarë në grupe dhe parti të shumta: **"Të cilët e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe."**.

Dhe e çuditshme në këtë çështje është se ata janë në kontradiktë dhe përçarje edhe mes vetes. Secili grup i gëzohet idesë së vet.

Një nga shenjat e përshkrimit ortak të All'llahut është përçarja. Idhujt e ndryshëm janë burimi i mënyrave të përçarjes, janë esenca e ndarjes dhe e përcarjes. Por, kur shirku është

binjaku i adhurimit të egos, pasionit të nefsit, fanatizmit, mendjemadhësisë, egoizmit dhe adhurimit të vetvetes, apo ç'ka lind prej saj, atëherë, përçarja është shumë e madhe. Prandaj nuk mund të vërtetohet bashkimi dhe uniteti, përveçse nën hijen e adhurimit të All'llahut, logjikës, përuljes dhe altruizmit.

Përçarja dhe kontradikta janë një lloj shirku, i cili të çon në mendjemadhësi, në egoizëm, në rrugën e gabuar etj. Atëherë, gjatë këtij komentimi do të tregojmë se vënia ortak All'llahut është përçarja e radhëve, është kontradikta dhe bllokimi i fuqive dhe në fund, dobësimi dhe humbja e besimit.

Kurse sa i përket çështjes **"secili grup i gëzohet idesë së vet"**, është e qartë dhe argumenti i saj është sqaruar mirë. Ata besojnë se ajo çfarë ata kanë është e vërtetë, sepse pasioni ua zbukuron nefsin, unin e njeriut, veprën e tij. Rezultati i këtij zbukurimi është lidhja gjithnjë e më shumë dhe kënaqja e njeriut me rrugën që e ka zgjedhur nefsi, edhe pse kjo rrugë të çon drejt humbjes dhe devijimit.

Pa dyshim se adhurimi i vetvetes nuk e lejon njeriun që të shikojë realitetin, të vërtetën ashtu siç është. Ai nuk mund të bëjë një gjykim të drejtë dhe të zhveshur nga zilia dhe dashuria.

Në Kur'anin e Lavdishëm, në ajetin 8 të sures "Fatir" thuhet: **"E atij që vepra e vet e keqe i është hijeshuar dhe e sheh si të mirë** (a është i njëjtë me atë që i largohet asaj)**?"**.

Njësoj si ai që ecën në rrugën e vërtetë dhe i shikon të vërtetat ashtu siç janë dhe i kupton ato ashtu siç duhet.

Dy hulumtime

1 - Teuhidi është një motiv i brendshëm dhe i fortë

Argumentet mendorë dhe logjikë e orientojnë njeriun, sepse në brendësi të tij ka stimulues dhe pengues që "ndonjëherë" i përcaktojnë atij anën e asaj që di dhe të asaj që nuk di.

Filozofia e ekzistencës së argumenteve në brendësi të njeriut, nuk mundet që gjithmonë të presë instruksionin e mendjes dhe intelektit. Kjo punë mund të shkatërrojë qëllimet "jetësore" në ndonjë rast.

Për shembull, nëse njeriu dëshiron të frymëzohet nga logjika e "domosdoshmërisë në vend të natyrshmërisë së sjelljes", nga nevoja e konsumimit të ushqimit, apo nga "domosdoshmëria e vazhdimësisë së shumimit dhe riprodhimit" nëpërmjet praktikimit të seksit, sa më shumë të punojë dhe të lëvizë sipas logjikës, këto do të kishin sjellë zhdukjen e njeriut para shumë kohësh. Por instikti seksual nga njëra anë dhe forca tërheqëse e shijimit të ushqimit nga ana tjetër, e tërhoqën atë drejt këtij qëllimi, deshi apo nuk deshi ai. Sa më shumë që të kemi qëllime jetësore dhe universale, përballjet me këta "stimulantë" do jenë gjithmonë të ashpra e të forta.

Çështjen e këtyre ''stimulantëve'' duhet ta shohim në dy drejtime:

Stimulimet që lindin së brendshmi dhe nuk kanë nevojë për ndërmjetësimin e logjikës dhe të ndjenjave. Kjo ndodh me kafshën që tërhiqet drejt ushqimit dhe seksit pa pasur nevojë për t'u menduar.

Mirëpo stimulantët e brendshëm të quajtur ''të përgjegjshmërisë'' lënë gjurmët e tyre në mendje dhe logjikë dhe e nxisin atë në zgjedhjet e preferuara gjatë rrugës në jetë.

Zakonisht, lloji i parë i këtyre stimulantëve njihet me emrin "instikte", kurse lloji i dytë "natyrshmëri" (Vëreni me kujdes!).

Adhurimi i All'llahut dhe drejtimi nga Ai, me sinqeritet dhe pastërti emërtohet "natyrshmëri".

Disa njerëz mund ta konsiderojnë këtë si pohim nxitës, inkurajues për besimtarët, por ne kemi argumente dhe dëshmitarë të ndryshëm që e qartësojnë pastëritnë e "animit nga All'llahu" natyrshmërisht, me dëshirë. Madje këtë dëshirë e mbështet e gjithë baza e fesë dhe dimensionet e saj:

1- Pa dyshim, vazhdimësia e besimit fetar dhe besimit në Zot gjatë tërë historisë njerëzore është argument i natyrshmërisë. Nëse ajo do të ishte diçka e zakonshme, nuk do të kishte anë të përgjithshme dhe as anim të përhershëm. Por ky universalitet dhe kjo vazhdimësi janë argumente të natyrshmërisë së gjendjes.

Historianët e mëdhenj thonë: Nuk është parë në shoqëritë njerëzore, në thellësitë e historisë njerëzore apo dhe në kohën para historisë njerëzore, që popujt të kenë jetuar pa fe'.

Historiani bashkëkohës, Uill Durant, thotë: "Nëse ne e përkufizojmë fenë si një adhurim i fuqive, të cilat janë më të

mëdha se e natyrshmja, atëherë duhet që ta marrim në konsideratë këtë çështje partikulare, sepse disa nga popujt primitivë nuk kanë pasur asnjë fe' nga sa duket".

Më pas sjell disa shembuj për këtë temë: Është përmendur një nga situatat e rralla për të cilën ka opinione se është e vërtetë:

''Të qenit fetar përfshin të gjithë individët e njerëzimit''.

Më pas shton: Kjo çështje në optikën e filozofëve konsiderohet si një nga çështjet thelbësore në histori dhe në studimet psikologjike, sepse nuk është e sigurtë se të gjitha fetë janë të mveshura me të pavërteta, me gabime dhe trillime. Përkundrazi, filozofët tregojnë shumë kujdes dhe vëmendje ndaj kësaj çështjeje. Ata thonë se të gjitha fetë, që në kohët e lashta, kanë qenë shoqëruese të historisë së njerëzimit."[1]

Po ky historian (Uall Duranti), në hulumtimet e tij rreth ekzistencës së fesë në kohët parahistorike thotë: "Nëse nuk i imagjinojmë rrënjët e fesë në kohët që para historisë, atëherë nuk mundemi që ta njohim atë në kohën historike, ashtu si është ajo.".[2]

Kërkimet dhe hulumtimet për njeriun parahistorik janë bërë nëpërmjet metodës së gërmimit. Gjithashtu, këtë temë e bën të qartë edhe sociologu Samuel Kenixh, në librin e tij "Dirasetul Muxhtemai": "Të parët e njeriut bashkëkohës prej të cilëve vijmë, i përkasin njeriut të Neandertalit. Edhe ata e kanë pasur patjetër një fe". Ai e argumenton më pas konfirmimin e kësaj teme me

1 "Tarikhu Temedun", vëll. 1, f. 87-89.
2 I njëjti burim, f. 156.

gjurmët që janë gjetur dhe janë analizuar nëpërmjet metodës së hulumtimit dhe kërkimit.

Njëra prej tyre është se ata i varrosnin të vdekurit e tyre me një mënyrë të veçantë, i varrosnin bashkë me gjëra, sende që tregonin për besimin e tyre në Ditën e Kiametit. [1] .

Pa dyshim ndarjen e fesë nga historia e njerëzimit nuk mund ta pranojë asnjë investigues apo hulumtues.

2- Vëshguesit okularë bashkëkohorë zbulojnë se zullumqarët dhe diktatorët me sistemet e tyre të padrejta janë munduar dhe janë përpjekur që ta fshijnë fenë dhe gjurmët e saj me mënyra të ndryshme. Por, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme të tyre, nuk kanë mundur që të shkulin fenë dhe rrënjët e saj nga thellësitë e shoqërisë njerëzore.

Ne e dimë shumë mirë se partia komuniste e Bashkimit Sovjetik është përpjekur të përdorë propagandën dhe metoda të llojllojshme informimi, që të bëjë lavazhin e mendjeve dhe të zemrave intelektuale dhe të shuajë besimet fetare te njerëzit. Pavarësisht presionit të madh demagogjik që mbushi faqet e revistave dhe gazetave me informacione të pavërteta, denigruese ndaj fesë, Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik nuk ia arriti qëllimit. Me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, në të gjithë republikat, feja u rikthye në vendin që i takon, me një shpejtësi marramendëse. Ky është një argument tjetër për natyrshmërinë e stimulit fetar.

1 "Dirasetul Muxhtema", f. 192, origjina e saj është në persisht dhe adresa e saj është universiteti "Shenasi".

3- Zbulimet e fundit nga ana e psikologëve dhe e shkencëtarëve sociologë në raportet e dimensioneve të shpirtit njerëzor, sjellin një argument tjetër për këtë pohim. Ata thonë: Pa dyshim se vërtetimet në fushat e psikologjisë na tregojnë për një dimension esencial që është "dimensioni fetar", apo me një mënyrë tjetër të shprehuri "dimension i shenjtë", "dimensioni hyjnor" dhe mbase e kanë konsideruar këtë dimension si baza e tre dimensioneve të tjera që janë: "dimensioni shkencor", "dimensioni estetik" dhe "dimensioni filantropik".

Ata pohojnë se motivet, stimulantët kryesorë të shpirtit njerëzor janë këto:

a- Stimuli i kërkimit të së vërtetës është burimi i llojeve të shkencave dhe synimeve të vazhdueshme vërtetuese në njohjen e botës së ekzistencës.
b- Nocioni "mirësia dhe vepra e mirë" e tërheq njeriun drejt nocioneve morale si sakrifica, altruizmi, drejtësia dhe zemërgjerësia e të tjera si këto. Kur njeriu nuk e gjen veten të mbrujtur me këto cilësi, atëherë, pa dyshim, ai i pëlqen ato kur ekzistojnë te dikush tjetër. Kjo tregon se dashuria për veprën e mirë dhe mirësinë është e fshehur në rrënjët e nefsit, egos.
c- Sensi "estetik" e tërheq njeriun drejt artit origjinal, drejt edukatës dhe çështjeve me shije. Ky mbase është bërë ndonjëherë burimi, arsyeja e shndërrimit në jetën e individit apo të shoqërisë.
d- Sensi "fetar" do të thotë besimi në një princip të lartë, adhurimi dhe ndjeka e tij.

Në librin "Kuventajm" predikohet:

Njohja e identitetit dhe hulumtimi së brendshmi i natyrës njerëzore jo koshiente u krye nga Frojdi, i cili në fillim vazhdoi të mbështetej me "Adlerin" dhe "Junkun". Në thellësitë e shpirtit të njeriut qëndrojnë fuqi të fshehura që lidhen me plot aspekte e faza të konceptimit të njohjes pas logjikës, por ka mundësi që sensi fetar të jetë një nga çelësat e zgjidhjes së kësaj enigme.

Edhe pse akoma nuk është arritur të bihet dakort rreth opinioneve lidhur me këtë situatë, koncepti "rruga e mendimit" vazhdon në rritje ditë pas dite dhe shumë prej mendimtarëve e besojnë përkufizimin të cilin do ta përmendim në fund:

"Pa dyshim, sensi fetar është një nga komponentët e parë të qëndrueshëm dhe të natyrshëm të shpirtit të njeriut. Me këtë mveshje fetare shpirti njerëzor fiton më shumë autenticitet. Përshtatshmëria e tij nuk është e mundur të zbatohet për asnjë shqisë tjetër, apo të nxitet nga ndonjë stimulues tjetër. Sensi fetar dhe përshtatshmëria i zgjat rrënjët në thellësitë e subkoshiencës, prandaj dhe konsiderohet "nocioni fetar" apo "nocioni i shenjtë". Ky nocion është në lidhje kovalente me nocionet e estetikës, të mirësisë dhe të së vërtetës. Predikimi i katërt ka autenticitetin e tre nocioneve. Ka gjithashtu dhe pavarësinë e tyre."[1]

Investiguesi "Tan Ki Du Kenten" ka tëhequr vëmendjen në këtë citim: "Zbulimi i dimensionit të katërt është njëri prej dallimeve, një prej veçorive të kohës dhe natyrës ku jetojmë. Ai është emërtuar edhe si "dimension i kohës''. Ai u shtohet edhe tre dimensioneve të trupit duke u bërë njëherësh edhe bashkues i tyre. Po kështu, në këtë kohë, është zbuluar edhe predikimi i

1 Shih librin "*El His el medhhebij eu el bu'durr rrabi'u*", i autorit Kuntajm, përkthim i El Bejanij.

katërt, predikimi "i shenjtë" apo predikimi i shenjtë "hyjnor", i cili rri paralel me tre nocionet si: "estetika, mirësia dhe kërkimi i së vërtetës". Ai është dimensioni i katërt i shpirtit të njeriut dhe është i veçuar nga tre dimensionet e tjera. Mbase ka qenë ky dimension zanafilla e lindjes së tre dimensioneve të tjera."[1]

e- Drejtimi, tërheqja dhe orientimi i njeriut drejt forcave të fshehta, drejt fatkeqësive dhe sprovave dhe largimi prej natyrshmërisë, kërkimi i zgjidhjes së problemeve dhe nevojave larg kësaj force, gjithashtu është një argument tjetër për autenticitetin e këtij stimuluesi të brendshëm dhe frymëzimi të natyrshëm. Ka mundësi që duke i bashkuar të gjithë këto argumente që i përmendëm më parë, mund të ndodhë që njeriu të anojë nga All'llahu i Madhërishëm.

Ka mundësi që një pjesë e tyre ta konsiderojnë këtë orientim si i fituar nga diktimi apo informacioni fetar në oqeanin shoqëror religjioz.

Vetëm se ndikimi i gjithë këtyre fenomeneve tek të gjithë njerëzit, deri edhe te ata që nuk kanë fare lidhje me çështjet fetare, tregon se ato kanë rrënjë më të thella sesa kjo hipotezë.

f- Në jetën e njeriut ka ngjarje dhe fenomene që mund të komentohen vetëm nëpërmjet sensit fetar, sepse shumica e njerëzve kanë sakrifikuar dhe vazhdojnë akoma të sakrifikojnë gjithçka që kanë pasur vetëm për të qenë të orientuar në udhën e fesë. Në këtë udhë shpesh kanë sakrifikuar edhe vetet e tyre.

1 Shih librin "*El His el medhhebij eu el bu'durr rrabi'u*", i autorit Kuntajm, përkthim i El Bejanij, f. 39, botimi i dytë.

Shumë janë ata që ranë dëshmorë për shkak të udhëheqjes nga qëllimet hyjnore dhe për t'i vërtetuar ato, për t'i kthyer në shembuj në historinë e gjatë islame. Edhe kronologjia e ngjarjeve të popujve të tjerë e vërteton këtë dhe tregon se sensi fetar ka rrënjë të thella në shpirtin e njeriut.

Mirëpo mund të thuhet se në këtë kontekst ekziston një paradoks. Disa persona, si komunistët për shembull, kanë një qëndrim ateist, kundërshtojnë ideologjinë fetare dhe fenë. Ato nuk i fshehin qëndrimet e tyre dhe luftojnë me të gjitha mënyrat, edhe duke sakrifikuar, që t'i mbrojnë ato.

Por ky paradoks zgjidhet plotësisht me shikimin e kësaj çështjeje. Komunistët, të cilët e mohojnë plotësisht fenë, besojnë se feja është e lidhur me historinë e vjetër dhe nuk ka mundësi që të ketë një funksion në shoqëritë komuniste. Ata nuk e njohin fenë, as logjikën e saj. Komunistët e kanë pranuar fenë në një mënyrë tjetër, ndryshe, në një mënyrë që nuk ka lidhje me logjikën e brendshme, por me subkoshiencën.

Ata i shenjtërojnë kryetarët dhe udhëheqësit e tyre, siç kishin bërë, shumë kohë më parë egjiptianët e vjetër me statujat e tyre. Radhët e tyre të gjata për të vizituar trupin e Leninit, gjithashtu, janë një argument tjetër për këtë temë.

Komunistët, zakonisht, i konsiderojnë principet marksiste si një frymëzim qiellor që nuk e pranon kriticizmin, sepse parimet e tyre i konsiderojnë të shenjta. Për mendimin e tyre, Marksi, Lenini dhe Engelsi janë të mbrojturit prej gjynaheve dhe hutimit. Ata e konsiderojnë një gjynah të rëndë verifikimin dhe kontrollin e logjikës, pranimin e një pozicioni të ri ndaj këtyre principeve.

Por më e rëndë, më ekstremja e çështjes është se opinioni i tyre është një loj mendimi fetar në formë të devijuar.

2- Natyrshmëria e Teuhidit në transmetimet islame

Tema: "Njohja e All'llahut me anë të natyrës së pastër (fitratu)", nuk është përmendur vetëm në Kur'an. Kjo temë është përmendur në transmetimet islame në një mënyrë që të tërheq vëmendjen. Pas kësaj, disa prej tyre e mbështeten Teuhidin me natyrshmëri; disa të tjerë e mbështeten me njohuri, kurse një pjesë tjetër e trajtoi si ''natyrshmëri në islam". Më në fund, një pjesë prej tyre e trajtuan këtë temë si mundësi që i ofrohet njeriut për një mbrojtje të sigurtë.

Në një hadith të vlerësuar dhe të transmetuar nga muhadithi i madh, dijetari Kulejni, në librin "El Kafij", të cilin e ka përcjellë nga Hisham ibn Salim, thuhet: Kam pyetur *Imam* Sadikun *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Çfarë nënkupton me fjalën e Tij i Madhërishmi **"feja e All'llahut në të cilën i krijoi njerëzit?"**, dhe ai tha: "*Ai është Teuhidi.*".[1]

Po ashtu në librin "El Kafij" është përcjellë se kur është pyetur *Imam* Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* për komentimin e ajetit të mësipërm ai ka thënë: "*Ai është Islami.*".[2]

Gjithashtu, gjendet një hadith i ngjashëm me atë të lartpërmendurin i ardhur nga *Imam* Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* kur

1 "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 12, kapitulli "fitratul khalk ala Teuhijd".
2 I njëjti burim.

Zuraratu, njëri prej shokëve të tij, e pyeti për komentimin e ajetit ai ka thënë: *"I ka krijuar ata që ta njohin Atë."*.[1]

Në hadithin e transmetuar nga Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: *"Çdo fëmijë është i lindur mysliman në natyrshmërinë e tij, ndërsa prindërit janë ata që e bëjnë atë ose çifut ose kristian."*. Ai gjithashtu e mbështet këtë përmbledhje.[2]

Në një hadith i ardhur nga *Imam* Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* për komentimin e ajetit, thuhet: *"Ai është Vilajeti."*.[3]

Në hytben e parë, Prijësi i Besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)* përmend një hadith të shkurtër me shprehje elokuente e kuptim të gjerë. Aty thotë: *"All'llahu ua dërgoi atyre të Dërguarin e Tij dhe një sërë të Dërguarish të Tij që ta përmbushin betimin e krijimit origjinar, që t'ua përkujtojë shpërblimin e Tij, që t'u cytë me anë të mësimeve, që t'ua zbulojë dritën e fshehur të njohjes, që t'ua tregojë shenjat e Plotfuqishmërisë së Tij."*.

Sipas transmetimeve paraprirëse, nuk është vetëm njohja e All'llahut e cila bazohet te natyra e pastër e njeriut e krijuar nga All'llahu, por është edhe i gjithë Islami në mënyrë të përmbledhur, në brendësi të natyrshmërisë njerëzore, duke filluar nga Teuhidi dhe duke përfunduar me udhëhëqësit hyjnorë dhe zëvendësit e tyre të sinqertë. Po kështu, edhe degët e ligjeve të jurisprudencës.

1 I njëjti burim.

2 Tesiri "Xheuamiul Xhamiu", fundi ajetit në fjalë.

3 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 182.

Prandaj, në bazë të kësaj dhe sipas mënyrës së shprehjes së përmendur në hytben e elokuencës, del se puna e Pejgamberëve është ruajtja e natyrshmërisë derisa të ajo të përhapet dhe t'u kujtojë njerëzve mirësitë e All'llahut. Nga tërë këto mirësi është natyrshmëria në Teuhid, nxjerrja e thesareve të diturisë fetare prej librave të Islamit dhe depërtimi i tyre në shpirtin e njeriut dhe në mendimet e tij.

Ajo që na tërheq vëmendjen është se Kur'ani, në shumë ajete, sjell si shembull fatkeqësitë, problemet dhe ngjarjet e dhimbshme nëpër të cilat kalon njeriu në jetën e tij, i përshtatur nën klimën e sensit fetar. Në njërin prej ajeteve thuhet: **"**(Idhujtarët e dinë për All'llahun se) **Kur hipin ata në anije** (u këputet lidhja me tokën dhe frikësohen) **i luten sinqerisht All'llahut, e kur i shpëton ata** (dhe dalin) **në tokë, ja, po ata të njëjtët lusin idhuj!"**.[1]

Reth kësaj çështjeje do të flasim me lejen e All'llahut në fund të ajeteve të ardhshme, të cilat u ngjasojnë ajeteve të sures "Ankebut".

1 Sure "Ankebut", 65.

Ajetet 33 – 36

وَإِذَا مَسَّ ٱلنَّاسَ ضُرٌّ دَعَوْا۟ رَبَّهُم مُّنِيبِينَ إِلَيْهِ ثُمَّ إِذَآ أَذَاقَهُم مِّنْهُ رَحْمَةً إِذَا
فَرِيقٌ مِّنْهُم بِرَبِّهِمْ يُشْرِكُونَ ﴿٣٣﴾ لِيَكْفُرُوا۟ بِمَآ ءَاتَيْنَٰهُمْ ۚ فَتَمَتَّعُوا۟ فَسَوْفَ
تَعْلَمُونَ ﴿٣٤﴾ أَمْ أَنزَلْنَا عَلَيْهِمْ سُلْطَٰنًا فَهُوَ يَتَكَلَّمُ بِمَا كَانُوا۟ بِهِۦ
يُشْرِكُونَ ﴿٣٥﴾ وَإِذَآ أَذَقْنَا ٱلنَّاسَ رَحْمَةً فَرِحُوا۟ بِهَا ۖ وَإِن تُصِبْهُمْ سَيِّئَةٌۢ بِمَا
قَدَّمَتْ أَيْدِيهِمْ إِذَا هُمْ يَقْنَطُونَ ﴿٣٦﴾

"Kur njerëzit i prek ndonjë e keqe, ata me përulje i luten Zotit të tyre, duke iu drejtuar vetëm Atij, e kur Ai me të mirat e Veta ua shijon atyre, ja, që një grup prej tyre i përshkruajnë shok Zotit të vet."

"Le të mohojnë atë që Ne u kemi dhënë, pra kënaquni, e më vonë do ta kuptoni."

"A mos Ne u kemi shpallur atyre ndonjë argument, që ia vërteton për atë që ata Mua më përshkruajnë shok?"

"E kur Ne u japim njerëzve begati të mira, ata u gëzohen atyre, e nëse ata i godet ndonjë e keqe për shkak të veprimit të tyre, atëherë ata e humbin shpresën."

Komentimi

Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, në të vërtetë është argumentim dhe konfirmim rreth diskutimit të mëparshëm. Ai vërteton qënien e Teuhidit natyrshëm. Kjo dritë hyjnore lind nga fakti se fatkeqësitë dhe vështirësitë bien mbi ata që nuk e pranojnë natyrshmërinë. Ajeti thotë: **"Kur njerëzit i prek ndonjë e keqe, ata me përulje i luten Zotit të tyre duke iu drejtuar vetëm Atij."**.

Vetëm se ata janë formalë në veprimtarinë dhe sjelljet e tyre. Atyre ua ka zënë sytë idiotizmi e fanatizmi që vijnë nga tradita e verbër e të parëve të tyre idhujtarë.

Sapo u largohen problemet dhe prap ndiejnë mëshirën e Zotit, ata harrojnë: **"...e kur Ai nga të mirat e veta u shijon atyre, ja, që një grup prej tyre i përshkruajnë shok Zotit të vet."**.

Shprehja **"njerëzit i prek ndonjë e keqe"** është tregues i goditjeve të vogla të tyre, pra pak të dëmshme. Kurse shprehja **"Ai nga të mirat e Veta ua shijon atyre"** është tregues i arritjes së diçkaje prej mirësisë, sepse mënyra e të shprehurit me *"messe"* (i prek, i godet) apo *"dhaka"* (i shijoi) kuptimisht u referohet çështjeve të vogla dhe të pjesshme. Në mënyrë të veçantë përdorimi i dy fjalëve *"durrun"* – "e keqe" dhe *"rahmetun"* – *"mëshirë"* janë emra të papërcaktuar, pra gjithëpërfshirës.

Duhet thënë se një grup njerëzish arrijnë deri aty sa t'i frikësohen All'llahut kur u ndodh edhe problemi më i vogël.

Mirëpo, sapo shohin një mirësi, qoftë edhe më pak nga ç'mendojnë, hutohen plotësisht dhe harrojnë çdo gjë.

Sigurisht, në situatën e parë, Kur'ani sqaron se njerëzit i tremben që të gjithë All'llahut në të keqe dhe fatkeqësi, sepse natyra e Njehsimit ekziston tek të gjithë.

Në situatën e dytë, Kur'ani flet për një grup që zgjedhin vetëm rrugën e vënies shok All'llahut. Një grup prej adhuruesve të All'llahut e përmendin All'llahun edhe në fatkeqësi, edhe kur janë komodë, edhe kur janë në gëzime, edhe kur janë në situata të vështira. Ndryshimet e mëdha ata nuk i bëjnë që të harrojnë së përkujtuari All'llahun.

Kurse mënyra e të shprehurit **"duke iu drejtuar vetëm Atij"**, ashtu siç e pamë në nocionin e fjalës *"inabetun"* – *"drejtim, anim"* më parë, është nga lënda e *"en'neubu"* dhe do të thotë rikthimi edhe një herë tek diçka. Kjo shprehje është e ëmbël për kuptimin që sjell. Baza, esenca e kësaj shprehjeje që tregon natyrshmëri është Njehsimi i All'llahut dhe adhurimi i Tij, ndërsa vënia shok Atij, është një çështje e refuzuar, sepse kur ata mërziten prej tij (shirkut), atëherë ata rikthehen drejt besimit dhe Njehsimit.

E veçanta këtu është se *"err rrahmetu"* – *"mëshira"* në këtë ajet i bashkangjitet "All'llahut", sepse Ai, i Madhërishmi, është burimi i mëshirës për robtë, njësoj si në mënyrë direkte, dhe në mënyrë indirekte. Por vetëm se e keqja nuk vjen prej Atij, të Madhërishmit. Shumë prej fatkeqësive dhe problemeve që na mbërthejnë janë rezultat i veprave dhe i gjynaheve tona.

Fjala *"rab'bihim"* – *"Zotit të tyre"*, e cila është përsëritur në ajet dy herë, konfirmon se njeriu e ndien kontrollin e Zotit, e ndien qënien e Zotit, të All'llahut të Madhëruar në ekzistencën e tij dhe leksionet e gabuara nuk arrijnë të ndikojnë tek ai, nuk arrijnë që ta orientojnë atë drejt shirkut dhe humbjes.

Duhet të shikohet me kujdes kjo çështje. Përemri në fjalën *"minhu"* i refrohet All'llahut. Ky është një konfirmim i asaj që të gjitha mirësitë janë prej All'llahut të Madhëruar. Shumë prej komentuesve e kanë zgjedhur këtë kuptim siç janë: Tabatabai tek "El Mijzan"; Et Tusij në "Et Tibjan" dhe Ebu El Fettuh Err Rrazi në tefsirin e tij. Komentues të tjerë, si Fakhru Rraziu e të tjerë, kanë thënë se përemri *"minhu"* i refrohet të keqes dhe e kanë komentuar ajetin kështu: kur All'llahu ua shijon robve të Tij mëshirën pas së keqes, një grup prej tyre i bëjnë ortak All'llahut.

(Kuptimi i fjalës *"min"* këtu merret me kuptimin si zëvendësuese). Mirëpo, duket qartë se komentimi i parë është më shumë i harmonizuar me ajetin e parë.

Kurse ajeti tjetër ka ardhur si kërcënim për këta idhujtarë, të cilët e harrojnë Zotin e tyre sapo i marrin mirësitë. Ajeti thotë: Lëri ata **"le të mohojnë atë që Ne u kemi dhënë"** dhe le të bëjnë çfarë të munden në rrugën e tyre! E, më pas, u flet idhujtarëve që të kënaqen me këto mirësi dhe dhurata të shkatërruara të kësaj dynjaje, sepse kanë për ta parë dënimin e keq për këtë: **"pra, kënaquni, e më vonë do ta kuptoni..."**.[1]

1 Germa *lam* tek fjalia *"li jekfuru"* është *lami* i urdhërores dhe ky urdhër është për kërcënim, po kështu fjalia *"temetteu"* – *"kënaquni"*, gjithashtu, është për kërcënim. Nëse e para ka ardhur në formën e të "munguarit", e dyta është në formën e "folësit" ... dhe duket sikur në situatën e parë ka supozuar se ata janë

Ky adresim në këtë ajet është për të gjithë idhujtarët, për të gjithë ata që e harrojnë All'llahun kur i vijnë mirësitë dhe shqetësohen vetëm me kënaqesinë e këtyre mirësive. Për të gjithë ata që nuk e përmendin All'llahun, për ato që u ka dhuruar...

Në ajetin tjetër, Kur'ani e përdor formën pyetësore të shoqëruar me qortim. Aty thuhet: **"A mos Ne u kemi shpallur atyre ndonjë argument, që ia vërteton për atë që ata Mua më përshkruajnë shok?"**. *"Em"* këtu është forma pyetësore e fjalës. Këtu pyetja supozon një tendencë mosmiratimi dhe qortimi. Pra, zgjedhja e kësaj mënyre komunikimi bëhet që thirrja në natyrshmëri të jetë ose me vendim logjik, ose me urdhrin e All'llahut. Mirëpo, kur është bërë kaq e qartë se natyrshmëria kërkon me këmbënguje Njehsimin e All'llahut edhe në fatkeqësi, edhe me dhimbje, atëherë pa dyshim, logjika thotë: Duhet që të drejtohemi drejt Atij që na i ka dhuruar mirësitë.

Përfundimisht, vendimi i All'llahut në këtë ajet është se duhet të kuptohet si ndalim dhe jo si të urdhëruar nga All'llahu. Por me besim, me bindjet e tyre, duke mos u mbështetur në asnjë origjinë të pranueshme.

Fjala *"es sulltanu"*, kuptimimisht tregon për autoritetin dhe forcën që zakonisht përfundon me triumf, fitore. Dhe ky është argument perfekt dhe bindës.

---

të papranishëm e më pas, për shkak të kërcënimit, i ka vënë ata përballë kërcënimit dhe bisedës. Një pjesë e komentuesve e kanë konsideruar *"lamin"* si *lami* i dënimit, domethënë se ka qenë dënimi i çështjes së tyre mohimi i mirësive të All'llahut, porse kuptimi i parë është më në harmoni me aparencën e ajetit.

Mënyra e të shprehurit me *"jetekel'lemu"* është një lloj shprehjeje figurative, që përdoret në qartësimin e një argumenti duke thënë: "duket sikur ky argument flet bashkë me njeriun".

Disa komentues kanë supozuar se me fjalën *"es sulltanu"* duhet të nënkuptohet një nga melekët e aftë, të fuqishëm. Prandaj bëhet përdorimi i *"jetekel'lemu"*, me kuptimin "në drejtim të së vërtetës". Domethënë se nuk u kemi dërguar atyre ndonjë melek që të flasë duke i bërë ortak All'llahut dhe ata ta ndjekin atë.

Por, nga sa duket, komentimi i parë është më i qartë.

Në ajetin e fundit prej ajeteve që po diskutojmë, përshkruhet forma mendore dhe shpirtërore e këtyre injorantëve idiotë, të cilët e humbin shpresën dhe mërziten për një fatkeqësi të vogël dhe thotë: **"E kur Ne u japim njerëzve begati të mira, ata u gëzohen atyre, e nëse ata i godet ndonjë e keqe për shkak të veprimit të tyre, atëherë ata e humbin shpresën."**.

Besimtarët e sinqertë nuk hutohen dhe nuk harrojnë ta përkujtojnë All'llahun për mirësitë, nuk e humbin shpresën, edhe pse mund të ndeshen me fatkeqësi dhe vështirësi. Ata e falënderojnë All'llahun për mirësitë e Tij dhe e shikojnë fatkeqësinë si një sprovim dhe testim. Ata e konsiderojnë atë si rezultat të veprave të tyre dhe durojnë e i drejtohen All'llahut të Madhëruar. Idhujtarët jetojnë gjithmonë mes "kryeneçësisë" dhe "dëshpërimit", kurse besimtarët janë mes "falënderimit" dhe "durimit".

Përmbajtja e këtyre ajeteve tregon në mënyrë të qartë se një pjesë e fatkeqësive dhe sprovave që e rrethojnë njeriun, më e pakta, janë si rezultat i veprave të tyre dhe të gjynaheve të tyre,

pasi All'llahu dëshiron që t'i zgjojë ata, t'i pastrojë dhe t'ua drejtojë shikimin nga Ai.

Fjalia **"ata u gëzohen atyre"** nuk nënkupton vetëm gëzimin dhe mirësitë, por gëzimin e shoqëruar me kryeneçësi, me një lloj dehjeje dhe intoksikimi. Ajo është rruga dhe situata më e urryer. E kundërta është gëzimi i shoqëruar me falënderim dhe drejtim nga All'llahu. Kjo nuk është një gjë e keqe, përkundrazi, ajo është gjë e urdhëruar **"Thuaj: 'Vetëm mirësisë së All'llahut dhe mëshirës së Tij t'i gëzohen'..."**.[1]

Shprehja **"...për shkak të veprimit të tyre"** nga ana kuptimore, tregon se shumica e gjynaheve është në dorën e njeriut, qofshin këto që kanë shkak shikimin, dëgjimin, ndjenjat apo gjynahet që bëhen nga dora e njeriut.

Në këtë kontekst, lind pyetja: A nuk e kundërshton ky ajet, ajetin tridhjetë e tre? Njëri nga ajetet flet për njerëzit që dëshpërohen në fatkeqësi, kurse ajeti tjetër flet për njerëzit që i drejtohen All'llahut kur ndodhen në vështirësi, ku njëri ajet flet për ''shpresë'' dhe tjetri flet për "dëshpërim"?

Po ta shohim me kujdes këtë çështje, përgjigjja del e qartë.

Në ajetin paraprirës, fjala **''e keqe''** përdoret me kuptimin për të emërtuar ngjarjet e dëmshme, si: tërmetet, apo fatkeqësitë e tjera, të cilat i godasin njerëzit pa dallim, qofshin njehësues apo idhujtarë. Edhe ky fakt është një ndër argumentet e natyrshmërisë për Teuhidin.

1 Sure "Junus", ajeti 58.

Kurse në ajetin që po komentojmë, fjala është për rezultatet e gjynaheve dhe dëshpërimit që lind prej tyre. Ka plot njerëz që kur bëjnë vepra të mira, bëhen kryeneçë, sepse e llogarisin veten e tyre të mbrojtur nga dënimi i All'llahut, kurse kur bëjnë vepra të këqija dhe e meritojnë dënimin, atëherë e humbin shpresën te mëshira e All'llahut. Secila prej këtyre situatave, si: "vetëkënaqësia dhe kryeneçësia", "dëshpërimi dhe humbja e shpresës nga mëshira e All'llahut" janë të përçmuara, të dënueshme. Si rrjedhim, secili prej dy ajeteve i ka trajtuar temat të ndara nga njëra-tjetra.

Ajetet 37 – 40

أَوَلَمۡ يَرَوۡاْ أَنَّ ٱللَّهَ يَبۡسُطُ ٱلرِّزۡقَ لِمَن يَشَآءُ وَيَقۡدِرُۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَأٓيَٰتٖ لِّقَوۡمٖ يُؤۡمِنُونَ ٣٧ فَـَٔاتِ ذَا ٱلۡقُرۡبَىٰ حَقَّهُۥ وَٱلۡمِسۡكِينَ وَٱبۡنَ ٱلسَّبِيلِۚ ذَٰلِكَ خَيۡرٞ لِّلَّذِينَ يُرِيدُونَ وَجۡهَ ٱللَّهِۖ وَأُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلۡمُفۡلِحُونَ ٣٨ وَمَآ ءَاتَيۡتُم مِّن رِّبٗا لِّيَرۡبُوَاْ فِيٓ أَمۡوَٰلِ ٱلنَّاسِ فَلَا يَرۡبُواْ عِندَ ٱللَّهِۖ وَمَآ ءَاتَيۡتُم مِّن زَكَوٰةٖ تُرِيدُونَ وَجۡهَ ٱللَّهِ فَأُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلۡمُضۡعِفُونَ ٣٩ ٱللَّهُ ٱلَّذِي خَلَقَكُمۡ ثُمَّ رَزَقَكُمۡ ثُمَّ يُمِيتُكُمۡ ثُمَّ يُحۡيِيكُمۡۖ هَلۡ مِن شُرَكَآئِكُم مَّن يَفۡعَلُ مِن ذَٰلِكُم مِّن شَيۡءٖۚ سُبۡحَٰنَهُۥ وَتَعَٰلَىٰ عَمَّا يُشۡرِكُونَ ٤٠

"Vallë, a nuk shohin ata se All'llahu i jep furnizim të mjaftueshëm atij që do Ai dhe ia pakëson. Në këtë, për një popull që beson ka argument."

"Prandaj, jepja të afërmit atë që i takon, e edhe të varfrit edhe udhëtarit, e kjo është shumë më e dobishme për ata që veprojnë për hir të All'llahut dhe të cilët janë ata të shpëtuarit."

"Dhe çka të jepni nga pasuria për ta shtuar e rritur (me kamatë)**, në pasurinë e njerëzve, ajo nuk do të shtohet tek All'llahu, e çka të jepni nga sadakaja** (bamirësia) **me qëllim që**

t'i afroheni All'llahut, të tillët janë ata që u shumëfishohet (shpërblimi)**."**

"All'llahu është Ai që ju krijoi, që ju furnizoi, që ju bën të vdisni e pastaj ju ngjall. A ka ndonjë prej zotave që mund të bëjë diçka nga këto? I pastër është Ai, i Patëmeta, i Madhëruar është Ai nga çka ata ia mveshin dhe trillojnë."

Komentimi

Ajeti i parë prej ajeteve që po diskutojmë, flet për Njehsimin (Teuhidin). Ato janë në harmoni me kontekstin e ajeteve të mëparshme, të cilat flisnin për kryeneçësinë e disa njerëzve materialistë, kur atyre u vinte mirësia dhe dëshpërimin e humbjen e shpresës kur përballeshnin me fatkeqësi dhe sprova.

Ajeti thotë: **"Vallë, a nuk shohin ata se All'llahu i jep furnizim të mjaftueshëm atij që Ai do dhe ia pakëson?"**.

Prandaj nuk duhet që kur na vijnë të mirat kjo të bëhet shkak, apo motiv i kryeneçësisë dhe i harresës së All'llahut. As kur na largohen apo pakësohen mirësitë, të na lindë dëshpërimi dhe humbja e shpresës. Shtimi dhe pakësimi i furnizimit me të mira është në dorën e All'llahut. Ai e di kur dhe kujt ia shton apo pakëson furnizimet dhe mirësitë.

Në këtë botë janë të lidhura ngushtë përpjekjet dhe mundimet, përballjet e vështirësive, fitimet apo humbjet me qëndrimet e njerëzve ndaj All'llahut të Madhërishëm. Ai e di se kur dhe kujt i jep apo ia pakëson furnizimet.

Mirëpo ky rregull, në kohën e tij, nuk është i përhershëm dhe universal. Sot shohim njerëz që e meritojnë dhe që mundohen shumë, vrapojnë sa andej–këtej, por nuk e arrijnë rezultatin që përmbush qëllimin e tyre dhe e kundërta, shohim njerëz që nuk përpiqen dhe nuk mundohen fare, por që u hapen portat e furnizimit nga të gjitha drejtimet.

Këto përjashtime duhet të sqarohen. All'llahu nuk duhet harruar në çastet e vështira apo të mangësive. Ndonjëherë, sipas dëshirës së Tij, njeriut edhe mund t'i përplasen të gjitha dyert në fytyrë. Sado që të përpiqet dhe të mundohet njeriu, nuk mund të mëshirohet dhe t'i lehtësohen gjynahet , t'i realizohen çështjet pa hedhur një hap, hapin drejt All'llahut, i Cili është i Vetmi që ia hap apo ia mbyll dyert e mëshirës dhe të furnizimit.

Këto paradokse që hasen në jetën e njeriut, lidhen dhe shpjegohen me kryeneçësinë që lind te njeriu kur atij i shtohen mirësitë. Dëshpërimi buron nga fukarallëku. Njëherësh është argument që vërteton se pas dëshirës dhe vullnetit tonë ka një dorë tjetër të fortë "që i projekton veprat tona".

Për këtë, Kur'ani, në fund të ajetit, thotë: **"Në këtë, për një popull që beson, ka argument."**.

Disa komentues transmetojnë se kur është pyetur njëri nga dijetarët se cili është argumenti që bota ka vetëm një krijues?

Ai ka thënë se për vërtetimin e kësaj pyetjeje, ka tre argumente:

‘‘Poshtërimi i të urtit, varfërimi i njeriut të rafinuar dhe sëmundja e mjekut.”.[1]

Ekzistenca e këtyre përjashtimeve dhe paradokseve është një argument që vërteton se të gjitha çështjet janë në dorën e një fuqie tjetër. Kështu shprehet në fjalën e tij Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*. Ai thotë: *“E njoha Zotin e Madhështuar kur më duhej të braktisja vendimet, të prishja planet e të humbisja kurajon.”*[2]

Për çdo mirësi dhe dhuratë që përfiton njeriu, i ngarkon atij përgjegjësi që duhet t’i zbatojë. Kjo shpjegohet në Kur’an kur Kur’ani ia drejton fjalën Profetit *(Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përmes ajetit që pason, duke thënë: **“Prandaj, jepja të afërmit atë që i takon e edhe të varfrit edhe udhëtarit...”**.

Kur shtohet risku dhe furnizimi me të mira, duhet kuptuar se ajo që ke ti nuk është vetëm e jotja. Edhe të tjerët kanë të drejtën e tyre në pasurinë tënde, siç janë: të afërmit dhe të varfërit, të dashurit tuaj etj.

Mënyra e të shprehurit me *“hak’kahu”* – **“atë që i takon”** tregon se edhe ata janë pjesëmarrës, janë ortakë në pasurinë e njeriut. Nëse një njeri paguan diçka nga pasuria e tij për ta, ai vetëm ka dhënë atë që u takon atyre dhe kurrësesi nuk ka bërë ndonjë favor për ta.

---

1 Tefsiri “Ruhul Bejan”, vëll. 7, f. 39, fundi i ajetit është vendi i komentimit.

2 “Nehxhul Belaga”, Fjalët e urta, fjalia 250.

Një grup komentuesish mendojnë se ajo që thuhet në këtë ajet i adresohet vetëm Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe se **"të afërmit"** janë të afërmit e tij nga nëna. Është përmendur në një transmetim nga Ebu Seid Khuderij dhe të tjerë lidhur me këtë sqarim: *"Kur i zbriti ky ajet Profetit, ai i dha Fatimesë Fedekun dhe ia dorëzoi atë asaj."*.[1]

Të njëjtën përmbajtje e kanë transmetuar edhe Imam Sadiku dhe Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Përmendet i njëjti kuptim i detajuar kur Fatimeja debatoi me Ebu Bekrin për çështjen e Fedekut. Kjo është shpjeguar në transmetimin e Imam Sadikut.[2]

Por një grup tjetër komentuesish kanë thënë: Adresa e fjalës në këtë ajet është e përgjithshme. Ajo përfshin Profetin *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të tjerët. Në zbatim të këtij komentimi, të gjithë njerëzit nuk duhet të harrojnë (hakun), atë që u takon të afërmve.

Sigurisht që nuk ka kontradiktë në shumicën e komentuesve rreth kësaj çështjeje. Kështu që kuptimi i ajetit është i gjerë dhe Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të afërmit e tij, dhe në mënyrë të veçantë, Fatimeja, janë konfirmimi më i plotë i këtij ajeti.

Prej këtyre shpjegimeve, bëhet e qartë se nuk ka asnjë kontradiktë për secilin prej komentimeve të mësipërme edhe pse surja është mekase. Nocioni i ajetit është një nocion gjithëpërfshirës, sipas të cilit, duhet të veprohet në Mekë dhe në

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, fq 306, fundi i ajeteve në fjalë.
2 Tefsiri i Ali ibn Ibrahim, sipas komentimit "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, fq 186.

Medine, gjithashtu. Lajmi i dhënies së "Fedekut" Fatimesë, në lidhje me këtë ajet, është mëse i pranuar.

E vetmja gjë që mbetet këtu është fjalia "kur zbriti ky ajet". Në transmetimin e Ebu Seid Khuderij, duket se dhënia e Fedekut ka ndodhur pas zbritjes së ajetit. Mirëpo, nëse e marrim fjalën *"lem'ma"* me kuptimin e shkakut e jo me kuptimin e kohës së posaçme, zgjidhet ky problem dhe bëhet i qartë nocioni i ajetit. Pra, i Dërguari *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i ka dhënë Fatimesë Fedekun me urdhrin e zbritur nga All'llahut për të.

Mirëpo, përse janë përmendur vetëm këta të tre në mes të të gjithë atyre nevojtarëve që e meritojë me të vërtetë?

Mbase kjo është për shkak të rëndësisë së tyre, sepse ajo që u takon të afërmve, është më e rëndësishme dhe më e lartë se çdokush tjetër veç tyre. Në mes të afërmve të afërt dhe nevojtarëve, pa dyshim se të varfrit dhe udhëtarët janë më në nevojë se të gjithë.

Mund të merret e vërtetë edhe ajo që nënvizohet nga Fakhru Rrazi, i cili ka thënë: Edhe pse All'llahu i ka përmendur dhe dalluar tetë llojet e sadakave, Ai është kujdesur të sqarojë se kujt i duhet bërë mirësi. Çdo njeri që ka një pasuri, duhet të ndiejë dhembshuri, të ndiejë mëshirë për të tre llojet e njerëzve të përmendur më lart: për të afërmit, për nevojtarët dhe për udhëtarët.

Dhembshuria dhe përkujdesja për të afërmit është detyrim, edhe nëse nuk e ka detyrim zekatin e plotësimit të të dobtëve apo edhe nëse pasuria që ka nuk i detyrohet vitit, pra,

nuk e ka kapur vitin e prej të cilës duhet të japësh zekat. Edhe i varfri që është jetim duhet të konsiderohet i tillë, sepse ai nuk ka asnjë gjë, e ka mbetur në pikë të hallit. Derisa jetimi të arrijë moshën e pjekurisë, njeriu që ka mundësi ta ndihmojë dhe t'ia largojë vështirësitë, duhet ta bëjë, edhe sikur të mos e ketë detyrim zekatin.

Po kështu, ai që ka mbetur në shkretëtirë, apo në një vend të ashpër, bashkë me një kafshë tjetër duhet ndihmuar, duhet çuar në një vend të sigurtë. Kjo është detyrë, edhe sikur të mos e ketë detyrim zekatin.

Kush i jep diçka me dëshirë një të vobekti, duhet që ta ndihmojë gjithashtu edhe të varfrin. Radhitja e këtyre kategorive të njerëzve në nevojë është bërë nga ajeti sipas përshtatjes së çështjes dhe pozitës së tyre."[1]

Megjithatë, Kur'ani sqaron në fund të ajetit se bamirësit që e bëjnë mirësinë e tyre me dëshirë dhe për hir të All'llahut, janë nga të shpëtuarit: **"...e kjo është shumë më e dobishme për ata që veprojnë për hir të All'llahut dhe të tillët janë ata të shpëtuarit."**.

Ata janë të shpëtuarit në këtë botë, sepse shpenzimi për hir të All'llahut, të sjell begati të çuditshme, të sjell edhe në Ahiret.

Shpenzimi në rrugë të All'llahut është një nga veprat më të rënda në peshoren e Ditës së Kiametit.

Ajo që nënkuptohet prej **"uaxh'hull'llah" - "për hir të All'llahut"** nuk është aspekti trupor, sepse Ai i Madhërishmi nuk

1 Tefsiri "El Kebijr", fundi i ajeteve në fjalë.

ka trup. Përkundrazi, është me kuptimin e unit të Tij të shenjtë. Por ky ajet tregon edhe se shpenzimi për të afërmit dhe për të tjerët nuk është i mjaftueshëm. Më i rëndësishëm është sinqeriteti dhe nijeti i pastër dhe i boshatisur nga çdo lloj syfaqësie, përmendjeje, përbuzjeje dhe pritjeje të shpërblimit për atë që jep.

Në kundërshtim me atë që kanë thënë disa komentues, shpenzimi me pikësynim mbërritjen në Xhennet nuk është konfirmim për hir të All'llahut. Pa dyshim se të gjitha veprat që i bën njeriu kanë një lloj lidhjeje me All'llahun, qofshin për të fituar kënaqësinë e Tij, apo për të arritur sevapin e Tij, të gjitha këto janë konfirmim për hir të All'llahut. Por faza më e lartë dhe më e plotë është që njeriu të mos aspirojë asgjë tjetër pas të mirës që bën, përveç bindjes dhe adhurimit të pastër.

Duke iu përshtatur komentimit paraprirës rreth shpenzimit të sinqertë, duhet sqaruar se ka dy lloje shpenzimesh: e para për All'llahun, kurse tjetra kur synohet mbërritja drejt pasurisë së dynjasë. Ajeti thotë: **"Dhe çka të jepni nga pasuria për ta shtuar e rritur** (kamatë)**, në pasurinë e njerëzve, ajo nuk do të shtohet tek All'llahu, e çka të jepni nga sadakaja** (bamirësia) **me qëllim që t'i afroheni All'llahut, të tillët janë ata që u shumëfishohet** (shpërblimi)**."**.

Nocioni i fjalisë se dytë lidhet me dhënien e zekatit dhe shpenzimin për hir të All'llahut. Për këto edhe sevapi është i qartë. Vetëm se fjalia e parë **"dhe atë çka jepni nga pasuria juaj për ta shtuar e rritur** (si kamatë)**"** është e ndryshme në këtë komentim, nëse kemi parasysh se fjala *"rriba"* është përdorur me kuptimin e rrënjës, që është **"shtimi"**.

Pra komentimi i parë është më i qartë se të gjithë komentimet dhe i harmonizuar më shumë me nocionin e ajetit bashkë me transmetimet e përmendura nga Ehli Bejti. Ajo që synohet me *''rribanë''* janë dhuratat, të cilat, disa persona ua japin personave të tjerë, e sidomos atyre që kanë shumë pasuri, me qëllim që të përfitojnë prej tyre një shpërblim më të mirë e më të madh.

Është e pamohueshme se në dhurata të tilla nuk merren në konsideratë meritat, që u takojnë palës tjetër dhe as meritat parësore. Përkundrazi, i gjithë pikësynimi është që të arrijë dhurata në një vend dhe t'i kthehet atij që e dhuron atë me një shumë më të madhe e më të majme. Dhurata të tilla nuk e kanë "anën" e sinqeritetit, prandaj nuk ka asnjë vlerë morale dhe shpirtërore prej tyre.

Mbi bazë të kësaj, bëhet i qartë kuptimi i *"rribasë"* – *"kamatës"* në këtë ajet "dhuratë dhe donacion". Kurse ajo që nënkuptohet nga fjalia **"për ta shtuar e rritur** (me kamatë) **në pasurinë e njerëzve"** është marrja e shpërblimit të majmë prej njerëzve.

Nuk ka asnjë dyshim se marrja e një shpërblimi të tillë nuk është e ndaluar, pasi nuk ka në të as kusht e as afat, vetëm se ajo humb vlerën morale dhe shpirtërore. Prandaj, për këtë kamatë thuhet shprehja në transmetime të shumta nga Imam Sadiku, në burime të njohura si: "kamata e lejuar", përballë "kamatës së ndaluar", e cila kërkon kushtin, kontratën dhe pranimin.

Në një hadith të Imam Sadikut, në librin "Tehdhibul Ahkam'', në komentimin e ajetit thuhet: "*Ajo është dhurata jote për*

njeriun që kërkon prej tij një të mirë që është më e mirë se ato të dyja, dhe ajo është një kamatë që hahet.".

Sërish lexojmë një hadith tjetër: "Kamata është dy llojesh: njëra është e lejuar, kurse tjetra e ndaluar. Kamata e lejuar është kur një njeri i jep borxh vëllait të vet e ai që e merr, dëshiron ta shtojë e ta kompesojë më shumë nga sa ka marrë pa vënë asnjë kusht mes tyre. Nëse ai i jep atij më shumë nga çka marrë pa asnjë kushtëzim mes tyre, atëherë ajo është e lejuar. Por tek All'llahu për borxhin që ka dhënë nuk ka asnjë sevap. Prandaj Ai thotë: **"...ajo nuk do të shtohet tek All'llahu"**, kurse harami është kur njeriu merr një borxh dhe ai e kushtëzon që t'i kthehet atij më shumë nga sa i është marrë, e atëherë kjo është haram." [1].

Mirëpo ka edhe një komentim tjetër për këtë ajet. Ajo që nënkuptohet me kamatën në këtë ajet, është kamata e ndaluar. Sipas këtij komentimi, Kur'ani dëshiron që të krahasojë kamatën me shpenzimin e sinqertë për hir të All'llahut. Kur'ani qartëson se kamata, edhe pse në dukje është shtimi i pasurisë, ajo nuk është e shtuar tek All'llahu, sepse shtimi i vërtetë është shpenzimi në rrugë të All'llahut.

Mbi këtë bazë është konsideruar ajeti paraprirës për çështjen: "ndalimi i kamatës", të cilën e ka përmendur Kur'ani edhe para hixhretit, para emigrimit në rrugë të udhëzimit moral dhe të këshillimit. Por ndalimi i kamatës është plotësuar pas hixhretit me tre sure: "Bekare, Ali Imran dhe Nisa", në formë të shkallëzuar.".

1 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 189, 190.

Sigurisht që midis dy kuptimeve nuk ka kontradiktë, dhe mundet që të merret ajeti me kuptimin e tij të gjerë, i cili bashkon "kamatën e lejuar" dhe "kamatën e ndaluar" dhe matet secila prej të dy llojeve të kamatave me shpenzimin në rrugë të All'llahut. Mënyrat e shprehjes së ajetit janë më shumë në harmoni me komentimin e parë. Por kur jepet kamatë për të shtuar pasurinë, nuk ka sevape për të. Për këtë, ajeti thotë: me të vërtetë se kjo punë nuk shtohet tek All'llahu. Tek All'llahu shtohet ajo që bëhet për hir të Tij. Transmetimet islame kanë patur dhe kanë këtë kuptim.

Duhet të jemi të kujdesshëm të kuptojmë drejt një shaka të hollë gjuhësore, që është te përdorimi i fjalës *"mudifune"*. Kjo fjalë është një formën e emrit veprues dhe nuk do të thotë se ata e shtojnë dhe e shumëfishojnë vetë pasurinë. Por kuptimi i saj është se janë ata që marrin shpërblimin e shtuar.

Duhet që të qartësohet edhe ajo që nënkuptohet prej fjalëve *"di'fun"* – *"dy herë"* dhe *"mudaafun"* – *"shumë herë"*. Kuptimi i saj nuk është "një gjë dy herë", por brenda kuptimit ''dy herë'' përfshihen edhe shumë gjëra të tjera. Dhe më e pakta në ajet është dhjetë të mira si ajo, sepse Kur'ani thotë: **"...e kush vjen me një** (punë) **të mirë, ai** (në Ditën e Gjykimit) **do të shpërblehet dhjetëfish."**[1]

Ndonjëherë shtesa është treguar se është më e madhe se dhjetëfish. Është fjala për rastin e kthimit të borxhit. Për rastin e dhënies së borxhit, lexojmë në një këtë hadith nga Imam Sadiku:

1 Sure "Enam", ajeti 160.

"Mbi derën e Xhennetit është e shkruar: Dhënia e borxhit (kardun) është me tetëmbëdhjetëfish, kurse sadakaja me dhjetëfish.".[1]

Por shtesa mund t'i tejkalojë shtatëqindfish, kur shpenzimi bëhet në rrugë të All'llahut. Ajeti thotë: **"Shembulli i pasurisë së atyre që japin në rrugën e All'llahut, është si i një kokrre që i mbin shtatë kallinj, në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. All'llahu ia shumëfishon** (shpërblimin) **atij që dëshiron."**.[2]

Në ajetin e fundit prej ajeteve që po komentojmë është një rikthim tjetër te çështja e zanafillës dhe e Ditës së Kiametit. Dhe kjo është tema kryesore që është përmendur në këtë sure. Ajeti e përshkruan "All'llahun" me katër sifate, katër cilësi për të treguar për Teuhidin dhe përballimin e shirkut, vënies shok All'llahut dhe argumentet për Ditën e Kiametit dhe thotë: **"All'llahu është Ai që ju krijoi, që ju furnizoi, që ju bën të vdisni e pastaj ju ngjall. A ka ndonjë prej zotave tuaj që mund të bëjë diçka nga këto? I Pastër është Ai i Patëmeta, i Madhëruar është Ai nga çka ata ia mveshin dhe trillojnë."**.

Idhujtarët besonin se krijimi është bërë nga ana e statujave. Edhe furnizimet e tyre janë në dorë të statujave dhe putave, edhe përfundimi i jetës së tyre është në dorën e këtyre statujave.

Madje, ata i patën bërë këto statuja të fabrikuara edhe si ndërmjetëse mes tyre dhe All'llahut. Përgjigjia për këto pyetje është mohimi.

1 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 190.
2 Sure "El Bekare", ajeti 261.

Tema tjetër që duhet diskutuar është se idhujtarët nuk besojnë në jetën pas vdekjes. Atëherë ku bazohet Kur'ani në përshkrimin e fundit të All'llahut të Lartësuar për atë?!

Besimi në Ringjalljen dhe jetën pas vdekjes, siç e kemi përmendur në diskutimet e mëparshme, ka "anën" e natyrshme dhe Kur'ani këtu nuk bazohet tek besimet e tyre, por tek natyrshmëria e tyre.

Duke shtuar më tej, mund të pranohet se një folës i artikuluar, kur është përballë një personi tjetër, mohon një temë çfarëdo, tenton gradualisht që të vërtetat që t'ia transmetojnë tjetrit dhe të bazohet tek ato të vërteta, të pranojë efektin e tyre dhe e zbret bashkëbiseduesin e tij nga mohimi këmbëngulës.

All'llahu i Madhëruar është i Plotfuqishëm në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër dhe nuk e pranon ndarjen e këtyre dy jetëve. Kjo lidhje e këtyre dy jetëve është një lidhje logjike, por secila prej dy çështjeve është bashkuar në një çështje të vetme.

E megjithatë, Kur'ani thotë: Kur krijimi dhe furnizimi, vdekja dhe jeta është në dorën e All'llahut, atëherë edhe adhurimi duhet të jetë vetëm për Të. Kur'ani e zbulon këtë të vërtetë me thënien e Tij: **"...i Pastër është Ai, i Patëmeta, i Madhëruar është Ai nga çka ata ia mveshin dhe trillojnë"**, kurse idhujtarët e përbuzën shumë pozitën e Zotit të Fuqisë. Ata i shoqëruan Atij ortak në adhurim bashkë me statujat e tyre.

Ajetet: 41 – 45

ظَهَرَ ٱلۡفَسَادُ فِي ٱلۡبَرِّ وَٱلۡبَحۡرِ بِمَا كَسَبَتۡ أَيۡدِي ٱلنَّاسِ لِيُذِيقَهُم بَعۡضَ ٱلَّذِي عَمِلُواْ لَعَلَّهُمۡ يَرۡجِعُونَ ﴿٤١﴾ قُلۡ سِيرُواْ فِي ٱلۡأَرۡضِ فَٱنظُرُواْ كَيۡفَ كَانَ عَٰقِبَةُ ٱلَّذِينَ مِن قَبۡلُۚ كَانَ أَكۡثَرُهُم مُّشۡرِكِينَ ﴿٤٢﴾ فَأَقِمۡ وَجۡهَكَ لِلدِّينِ ٱلۡقَيِّمِ مِن قَبۡلِ أَن يَأۡتِيَ يَوۡمٞ لَّا مَرَدَّ لَهُۥ مِنَ ٱللَّهِۖ يَوۡمَئِذٖ يَصَّدَّعُونَ ﴿٤٣﴾ مَن كَفَرَ فَعَلَيۡهِ كُفۡرُهُۥۖ وَمَنۡ عَمِلَ صَٰلِحٗا فَلِأَنفُسِهِمۡ يَمۡهَدُونَ ﴿٤٤﴾ لِيَجۡزِيَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ ٱلصَّٰلِحَٰتِ مِن فَضۡلِهِۦٓۚ إِنَّهُۥ لَا يُحِبُّ ٱلۡكَٰفِرِينَ ﴿٤٥﴾

"Për shkak të veprave të (këqija) **të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza** (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.)**, e për ta përjetuar atë një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që të tërhiqen** (nga të këqijat)**."**

"Thuaj: Ecni nëpër tokë dhe shikoni se si ishte përfundimi i atyre që ishin më parë, shumica e tyre ishin jobesimtarë."

"Ti përmbaju fuqimisht fesë së drejtë, para se të vijë Dita që nuk ka kthim, pse prej All'llahut është përcaktuar, atë Ditë ata (njerëzit) **ndahen."**

"Kush nuk besoi, barrën e mosbesimit të vet e ka kundër vetes, e kush bëri punë të mirë, ata vetvetes ia përgatitën vendin (Xhennetin)**."**

"Që t'i shpërblejë Ai (All'llahu) **nga të mirat e veta, ata që besuan dhe bënë vepra të mira, vërtet Ai nuk i do jobesimtarët."**

Komentimi

Origjina e shkatërrimit dhe burimi i tij janë vetë punët e njerëzve

Në ajetet e kaluara është folur për shirkun, vënien shok All'llahut. Ne e dimë se origjina e të gjitha të këqijave është mungesa e vëmendjes rreth thelbit të Njehsimit dhe drejtimi nga shirku. Prandaj edhe Kur'ani në këto ajete që po komentojmë flet për shfaqjen e të keqes në Tokë për shkak të veprave të njerëzve. Për këtë Kur'ani thotë: **"Për shkak të veprave** (të këqija**) të njerëzve janë shfaqur në tokë e në det të zeza** (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.)**."**.

All'llahu dëshiron që të tërhiqen nga të këqijat: **"...e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që të tërhiqen** (nga të keqijat)**."**.

Ajeti që u përmend më parë sqaron kuptimin e gjerë rreth lidhjes së të keqes me gjynahun. Kjo lidhje nuk specifikohet për tokën e Mekës dhe Hixhazit dhe as për kohën e Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ajo është si një çështje e vërtetë, e cila sqaron lidhjen mes temës dhe subjektit.

Një shprehje tjetër kur'anore thotë: Kudo ku shfaqet, e keqja është reflektim i veprave të njerëzve dhe mbart një qëllim edukativ. Qëllimi edukativ synon që njerëzit të njohin vlerën e veprave të tyre me shpresën që t'i japin fund mosbesimit dhe të stabilizohen në udhëzimin e tyre.

Disa prej tyre thonë: ''Ky ajet tregon se dënimet që pësuan idhujtarët e Mekës ndodhën për shkak të lutjes që bëri kundër tyre Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.''. Nga kjo lutje idhujtarët e patën shumë të vështirë gjuetinë në Detin e Kuq.

Kjo fjalë është sqarim i një prej konfirmimeve dhe nuk e përcakton kuptimin e ajetit që bën fjalë për dënime që lidhen me mëkatin. Ajo nuk është përcaktuese e asaj kohe, e atij vendi dhe as e shterpësisë dhe ndërprerjes së shiut.

Nga sa përmendëm më sipër, bëhet mëse e qartë se shumë prej komentimeve të kufizuara dhe të ngushta të transmetuara nga disa komentues në fund të ajetit, nuk janë të pranueshme në asnjë mënyrë.

Ashtu siç e komentuan, me shkatërrim në Tokë kuptohet marrja me forcë e anijeve në kohën e Musait, dhe Hidrit *(Paqja qoftë mbi ta!)*, është shfaqja e mbretërve predominues dhe shkatërrues, të cilët përhapën shkatërrimin gjithandej.

Ka mundësi që konfirmimet e ajetit të jenë si shembull i këtyre personave që kontrollojnë njerëzit plotësisht. Kontrolli i njerëzve arrihet si rezultat i mirësjelljes dhe, përmes saj, i tërheqjes së tyre drejt poshtërimit. Mirëpo ky ajet nuk do të thotë se është rast i veçantë, rast specifik.

Një grup komentuesish kanë bërë kërkime për të kuptuar nocionin e shkatërrimit në det. Disa prej tyre kanë thënë: ''Me termin *'detin'*, nënkuptohen qytetet që janë në anë të detit''. Disa të tjerë kanë thënë: ''...ajo që nënkuptohet me *'detin'* janë "zonat e fertilizuara, pjellore që kanë kopshte dhe fruta".

Ne nuk gjejmë argument për këto supozime, sepse sa i përket detit, kuptimi i tij është i njohur, kurse shkatërrimi i tij mbase duhet kuptuar se është pakësimi i dhuratave detare, mungesa e sigurisë në të, apo luftërat detare.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, në lidhje me këtë ka thënë: "*Jeta e gjallesave të detit është e lidhur me shiun. Nëse ndërpritet shiu, shfaqet shkatërrimi në det dhe në tokë. Kjo ndodh për shkak të shtimit të gjynaheve.*"[1]. Ajo që është përmendur në këtë transmetim është një konfirmim i qartë i shkatërrimit dhe i asaj që thuhet në lidhje me zbritjen e shiut "dhe jetës së gjallesave të detit me të". Kjo është një temë delikate që kërkon kujdes dhe eksperiencë. Sa herë që pakësohet uji i qiellit "shiu", pakësohet edhe peshku në det. Në lidhje me këtë, ne kemi dëgjuar prej atyre që jetojnë pranë brigjeve të detit të thonë: Dobia e shiut për detin është më e madhe se dobia e shiut për shkretëtirën.

1 Tefsiri i Ali ibn Ibrahim, sipas transmetimit të tefsirit "Mexhmaul Bejan", vëll. 4, f. 190.

Në ajetin që pason, All'llahu i urdhëron njerëzit që të ecin në Tokë, që të shohin dëshmitë e shumta "të gjalla" që vërtetojnë çështjen e shfaqjes së shkatërrimit në Tokë për shkak të kundërshtimeve dhe mëkateve të njerëzve. Dhe e këshillon Profetin e Tij *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që t'i urdhërojë ata me këtë porosi: **"Thuaj: 'Ecni nëpër Tokë dhe shikoni se si ishte përfundimi i atyre që ishin më parë!'"**.

Shikojini kështjellat e "zullumqarëve" të shkatërruara dhe kullat e tyre të rrënuara, depot e tyre të boshatisura dhe grupimet e tyre të përçara e pastaj shikojini varret e tyre të fshira, të harruara dhe kockat e tyre të dekompozuara!

Shikoni përfundimin e çështjes së padrejtësisë dhe shirkut, vënies shok All'llahut dhe se në ç'përfundim arritën!

Vërtet **"...shumica e tyre ishin jobesimtarë."**.

Pra, shirku, vënia shok All'llahut, është origjina e shkatërrimit, e devijimit dhe e humbjes.

Në ajetet e mëparshme u fol për mirësitë e All'llahut. Fillimi, zanafilla ishte rreth krijimit të njeriut e më pas furnizimi i tij nga All'llahu: **"All'llahu është Ai që ju krijoi juve e më pas ju furnizoi."**. Vetëm se në ajetet që po komentojmë, fjala është për dënimin. Së pari, tregon largimin e mirësive si shkak i kundështimeve dhe gjynaheve; më pas shkatërrimin si rezultat i shirkut, vënies shok All'llahut, sepse tek dhurata dhe donacioni "...çështja e parë që përmendet, është krijimi, pastaj furnizimi".

Kurse në revokim, rikthim mbrapa "...çështja e parë është heqja e mirësive e pastaj shkatërrimi".

Mënyra e të shprehurit me: **"shumica e tyre ishin jobesimtarë"**, na lë të kuptojmë se në atë kohë myslimanët kanë qenë pakicë. Kjo tregon se nuk duhet të keni frikë nga numri i madh i idhujtarëve. All'llahu i ka shkatërruar ata që kanë qenë më të fuqishëm dhe më të shumtë në numër para tyre. Në të njëjtën kohë, është një paralajmërim për mizorët që të ecin në tokë dhe të shikojnë me sytë e tyre fundin e zullumqarëve që kanë qenë para tyre. Mendimi, imagjinata dhe kujdesi, pastaj rikthimi dhe mbështetja tek All'llahu, nuk janë gjithmonë të dobishme dhe afektuese. Në sqarim të ketij problemi, në ajetin që pason, Kur'ani i drejtohet Profetit më të nderuar *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* duke thënë: **"Ti përmbaju fuqimisht fesë së drejtë, para se të vijë Dita që nuk ka kthim, pse prej All'llahut është caktuar, atë Ditë ata** (njerëzit) **ndahen!"**[1] që domethënë, ndahen në grupe: "një grup në Xhennet dhe një grup në Zjarr".

Fjala *"el kaj'jimu"* ka kuptimin e qëndrimit *''fort dhe drejt"* dhe është tregues se ky drejtim i vazhdueshëm *"apo qëndrimi drejtë"* është për fenë. Domethënë: Islami është një fe' e

1 Fjala *"mereddu"* në fjalinë *"la meredde lehu min All'llahi"* këtu është me kuptimin: *"nuk ka kthim mbrapa nga All'llahu"*. Kurse përemri tek *"lehu"* i referohet *"jeumun"* – *"ditës"* dhe bëhet nocioni i përgjithshëm i fjalisë, nuk mundet askush që ta rikthejë atë Ditë nga All'llahu, domethënë qëndron në formën e vendimit dhe gjykimit në vonimin e asaj Dite "dhe vënien në pritje të saj".

Përmbledhja: Me të vërtetë, All'llahu nuk e thyen premtimin e Tij që të rikthejë atë Ditë, dhe askush përveç Tij nuk e ka fuqinë për këtë; pasi ndodhia e asaj Dite është e padiskutueshme dhe se ajo është Ditë e paevitueshme.

qëndrueshme dhe e drejtë dhe që ka një sistem, rregull të drejtë, si për jetën materiale, ashtu edhe për jetën shpirtërore të njerëzve. Prandaj kurrë nuk duhet të braktiset feja. Përkundrazi, përmbaju fuqimisht fesë së drejtë!

Mënyra e të shprehurit me *"jes'sad'daune"* – *"ndahen"* është nga lënda *"sadaun"*. Kuptimi i saj është: *''të thyesh enën''*. Më pas u zgjerua kuptimi i kësaj shprehjeje dhe nënkuptonte çdo lloj të ndarjes dhe përçarjes. Këtu tregon një tregues të ndarjes së radhëve të banorëve të Xhennetit nga radhët e banorëve të Zjarrit dhe secila prej këtyre radhëve ndahet në radhë të tjera. Kjo për shkak të ndarjes së Xhennetit dhe të Xhehennemit (Zoti na ruajtë prej tij!).

Ajeti që vjen më pas sqaron ndarjen në Ditën e Kiametit. Ai thotë: **"Kush nuk besoi, barrën e mosbesimit të vet e ka kundër vetes, e kush bëri punë të mirë, ata vetvetes i përgatitën vendin** (Xhennetin)**."**.

Fjala *"jemhedune"* rrjedh nga fjala *"mehdun"* njësoj si *"ahdun"*. Kuptimi i saj është *''krevati i përgatitur për foshnjën''*. Më pas e zgjeruan këtë kuptim dhe nënkuptonte djepin dhe çdo lloj krevati të qetë, të rehatshëm dhe të butë. U zgjodh kjo shprehje për të treguar se ku do të jetonin banorët e Xhennetit dhe besimtarët punëmirë.

Përmbledhja: Mos mendoni se besimi dhe mosbesimi juaj dhe veprat tuaja të mira dhe të këqija kanë ndikim tek All'llahu! Përkundrazi, jeni ju ata që do të gëzoheni apo do të hidhëroheni për ato që keni bërë: **"...atë Ditë do t'i shihni ato"**.

Kur'ani u mjaftua me çështjen e jobesimtarëve vetëm me shprehjen: **"...kush nuk besoi, barrën e mosbesimit të vet e ka kundër vetes."**. Kurse për besimtarët, ajeti thotë se besimtarët nuk do të shohin vetëm punët e tyre, madje All'llahu u jep atyre më tepër nga dhuratat dhe mirësitë e Tij dhe thotë: "**...që t'i shpërblejë Ai** (All'llahu) **nga të mirat e veta, ata që besuan dhe bënë vepra të mira."**.

Mirësia nuk i përfshin jobesimtarët: **"...vërtet, Ai nuk i do jobesimtarët."**. Nuk ka asnjë dyshim se All'llahu i trajton ata sipas drejtësisë së Tij dhe i shpërblen ata me atë që meritojnë. Asgjë më shumë. Jobesimtarët nuk përfitojnë prej Atij asnjë mirësi dhe asnjë dhuratë.

Hulumtime

1- Lidhja mes gjynahut dhe shkatërrimit

Të gjithë e dinë se çdo gjynah lë gjurmët e tij në shoqëri, ashtu siç lë gjurmë edhe te individi nëpërmjet rrugës së shoqërisë. Kjo shkakton një lloj shkatërrimi në sistemin shoqëror. Gjynahu, vepra e shëmtuar dhe tejkalimi i kufirit, i ngjajnë ushqimit të keq e të helmuar.

Gënjeshtra e zhvlerëson besimin.

Tradhtia e amanetit, shkatërron lidhjet shoqërore.

Padrejtësia shkakton dëmtimin e të tjerëve dhe privimin e të tjerëve.

Teprimi në liri të çon drejt diktaturës, kurse diktatura të çon drejt shpërthimit.

"Lënia pas dore e të drejtave të të privuarve" trashëgon armiqësinë, zilinë, urrejtjen dhe armiqësinë e cila i trondit bazat e shoqërisë.

Pra, përmbledhtas mund të themi se çdo punë jo e mirë ka ndikimin e saj të keq, edhe sikur të jetë përdorur në një rreth të kufizuar shoqëror apo më gjerë. Ndaj thuhet në ajet: **"Për shkak të veprave të këqija të njerëzve, janë shfaqur në Tokë e në det."**.

Në transmetimet islame theksohet se shumë prej gjynaheve, duke shtuar edhe ato që përmendëm, sjellin një zinxhir të efekteve të këqija. Lidhja e tyre me gjurmët që lënë është e panjohur.

Për shembull, në transmetimet islame thuhet se ndërpreja e embrionit (aborti) e shkurton jetën; të hash pasurinë haram (të ndaluar), shkakton errësirën e zemrës; kryerja e tepërt e marrëdhënieve të ndaluara shkakton shkatërrimin e njerëzve dhe pakëson furnizimin.[1]

1 Në një hadith, i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Për veprën e zinasë ka ndëshkime: tre prej tyre janë në dynja, kurse tre janë në Ahiret. E sa i përket ndëshkimeve në dynja ajo është që hiqet drita nga njeriu, dhe e zë një vdekje e papritur, dhe i ndërpritet furnizimi, kurse sa i përket asaj në Ahiret, ai është në llogarinë më të keqe të hidhërimit të All'llahut dhe përjetësisë në zjarrin e Xhehenemit", "Biharul Enuar"– lënda e zinasë, imoralitetit.

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"Ata që vdesin prej gjynaheve janë më shumë sesa ata që vdesin prej exhelit (koha e caktuar e vdekjes)."*[1].

Përmendet në Kur'an një shembull i ngjashëm me këtë kuptim, por i formuluar dhe i shprehur në një mënyrë tjetër: **"Sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do t'ju hapnim begati nga qielli dhe nga Toka, por ata përgënjeshtruan, prandaj i dënuam me shkatërrim për atë që merituan."**[2].

Atëherë shthurja, shkatërrimi që përmendet në ajetin që po komentojmë, është shthurja e përgjithshme, e cila përfshin shthurjet shoqërore, belatë, tërheqjen nga largimi i të mirave dhe begative.

Në ajetin e mësipërm thuhet se sëmundjet, belatë, fatkeqësitë kanë ndikimin e tyre edukativ dhe moral te njerëzit. Ata duhet të kundërpërgjigjen me veprat e tyre, të zgjohen nga gjumi dhe hutimi i tyre dhe t'i rikthehen pastërtisë dhe devotshmërisë.

Nuk themi se të gjitha të këqijat dhe epidemitë janë të këtij lloji, por themi se një pjesë e tyre e kanë këtë ndikim.

1 "Biharul Enuar" - lënda e imoralitetit.

2 Sure "A'raf", 96.

2- Filozofia e të ecurit në Tokë

Shtatë herë është përmendur çështja e "të ecurit në Tokë" në Kur'an (në suren "Ali Imran", "En'am", "En Nahl", "En Neml", "Ankebut", "Err Rrum").

Një herë është përmendur me qëllim që t'i tërheqë njerëzit në meditim. (''Ankebut'', ajeti 20). Pesë herë përmendet me qëllim që të marrin mësim prej dënimeve të dhimbshme që kanë bërë zullumqarët, mendjemëdhenjtë, mizorët dhe gjynahqarët.

Kur'ani u jep rëndësi të veçantë çështjeve identifikuese dhe të ndjeshme, të cilat mund të ndikojnë në çështjet edukative. Kur'ani i urdhëron myslimanët që të kuptojnë se duhet të ecin drejt hapësirave të gjera, se duhet ta vizitojnë këtë botë dhe të mendojnë për veprat e tyre dhe të të tjerëve, për dënimet që vijnë nga gabimet apo veprat e padrejta, se duhet të kuptojnë se kjo jetë është kalimtare dhe gjatë saj të mësojnë, studiojnë e të karakterizohen nga veprimtari të drejta dhe të pëlqyera.

Në epokën moderne, mënyra e jetesës, sjellja dhe kultura e njerëzimit ka pësuar goditje dhe dëmtime në shumë drejtime.

Kur'ani i Shenjtë thotë: "Për të zëvendësuar këta mendjemëdhenj ju ecni sipas mësimeve të udhëzuara dhe mos bini pre' e planeve të tyre, e kurtheve të tyre djallëzore, por merrni mësime mëshiruese.''.

Marrja e shembujve pozitivë, konsiderimi dhe vlerësimi i jetës së tjerëve është më e rëndësishme se eksperienca personale. Njeriu duhet të shmangë përvojat negative dhe të përvetësojë mënyra të tjera të shëndosha.

Urdhri i Kur'anit që të ecni në Tokë është krejtësisht i mundur të zbatohet plotësisht edhe sot. Kjo bëhet duke marrë mësimet më të çmuara të librave të rekomanduar dhe duke ndjekur edhe shembujt pozitivë të njerëzve të ditur.

Sot ka një lloj tjetër ''të udhëtimit nëpër Tokë''. Ky udhëtim është turizmi. Reklama e këtij ''udhëtimi'' është mjaft djallëzore. Ajo synon vetëm të fitojë pasuri, para "haram". Por, njëherësh me të përcillen edhe ''sëmundje'' si: kultura e sëmurë, përhapja e pasionit, e abuzivizmit, e idiotësisë dhe e dëfrimit etj., të cilat njihen si shoqëruese të këtij turizmi, të "turizmit shkatërrues".

Islami nuk është kundër turizmit, madje e mbështet atë. Turizmi duhet parë si një mundësi e përhapjes së kulturave të shëndosha, e eksperiencave dhe përvojave që zotëron njerëzimi në njohjen e botës dhe të natyrës.

Por duhet të tregojmë se ka edhe turizëm që Islami e ka ndaluar, sipas një hadithi ku thuhet: "Nuk ka turizëm në Islam.".[1]

Ajo që nënkuptohet si ''ndalim'' nga ky hadith ka të bëjë me ato njerëz që i shpenzojnë të gjitha vitet e jetës si turistë, ka të bëjë me ato njerëz që veçohen nga jeta shoqërore, me ato njerëz që shndërrohen në parazitë.

Islami e kundërshton këtë orientim dhe izolim shoqëror, sepse e konsideron këtë lloj "turizmi" si të paligjshëm.

1 "Mexhmeul Bahrejn" lënda *"sejeha"* në një hadith tjetër nga Pejgamberi më i madh *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në të njëjtin libër lexojmë fjalën e tij: "Turizmi i ymetit tim është beteja dhe xhihadi".

3- Feja e vërtetë

Ajetet e kaluara i drejtohen Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që t'i drejtohet plotësisht fesë së drejtë dhe të qëndrueshme, fesë e cila nuk ka devijim apo kthesë dhe nuk i trondit kurrë rregullat e saj.

Ajete të shumta të Kur'anit kanë ardhur në lidhje me këtë fe', si, p.sh. ajeti 105 i sures ''Junus'', që përmend fjalën *''hanijf''* – *"të pastër"*, **"...përqendrohu me tërë qënien tënde në fenë e drejtë."**.

Ajeti i 3-të i sures ''Zumer'' e përshkruan *"khalis"* – *"i sinqertë"*. **"Vini re! Adhurimi i sinqertë është vetëm ai për All'llahun!"**.

Kurse në ajetin e 52-të të sures ''Nahl'' përshkruhet si *''vasibun''* – *"i vazhdueshëm"*, do me thënë që nuk ndryshon kurrë: **"...dhe vetëm Atij i takon vazhdimisht adhurimi."**.

Në ajetin 78 të sures ''Haxhxh'' e ka përshkruar: ai është larg vështirësisë dhe ashpërsisë , **"dhe nuk ju detyroi në fe' me ndonjë vështirësi"**.

Dhe shembujt e këtyre ajeteve janë të shumtë në Kur'an.

Secila prej këtyre çështjeve përfaqëson një dimension të veçantë të fesë islame.

Po, vërtet, duhet që të zgjidhet shembulli i kësaj feje, duhet të bëhen përpjekje për njohjen e thellë të saj dhe të ruhet deri në pikën e fundit të jetës.

4- Nuk ka rikthim prapa në Ditën e Kiametit

Kemi lexuar në ajetet paraprirëse rreth Ditës së Kiametit, fjalën e Tij, të Madhërishmit: **"...para se të vijë Dita që nuk ka kthim"** dhe nuk ka asnjë mënyrë për t'u kthyer në dynja.

Vihet re në ajetet e Kur'anit një tjetër gjë që i ngjason kësaj mënyre të shprehuri. Është ajeti 44 i sures ''Shura'', ku tregohet se zullumqarët shikojnë dënimin me sytë e tyre dhe thonë: **"A ka ndonjë rrugë për rikthim** (në dynja)**?"**.

Në ajetin e 47-të të sures ''Shura'', i Madhërishmi e ka përshkruar Ditën e Kiametit kështu: **"...para se të vijë një ditë që All'llahu nuk e kthen më.".**

E vërteta është se në këtë botë ka disa gjëra që nuk kthehen prapa. Dhe kjo është rruga e All'llahut, e cila nuk zëvendësohet dhe nuk ndryshohet.

Për ta ilustruar mendimin e mësipërm, sillet si shembull fakti që një fëmijë nuk mundet të kthehet dot edhe një herë në embrionin fillestar.

Ajetet: 46 – 50

وَمِنْ ءَايَـٰتِهِۦٓ أَن يُرْسِلَ ٱلرِّيَاحَ مُبَشِّرَٰتٍ وَلِيُذِيقَكُم مِّن رَّحْمَتِهِۦ وَلِتَجْرِىَ ٱلْفُلْكُ بِأَمْرِهِۦ وَلِتَبْتَغُوا۟ مِن فَضْلِهِۦ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٤٦﴾ وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مِن قَبْلِكَ رُسُلًا إِلَىٰ قَوْمِهِمْ فَجَآءُوهُم بِٱلْبَيِّنَـٰتِ فَٱنتَقَمْنَا مِنَ ٱلَّذِينَ أَجْرَمُوا۟ ۖ وَكَانَ حَقًّا عَلَيْنَا نَصْرُ ٱلْمُؤْمِنِينَ ﴿٤٧﴾ ٱللَّهُ ٱلَّذِى يُرْسِلُ ٱلرِّيَـٰحَ فَتُثِيرُ سَحَابًا فَيَبْسُطُهُۥ فِى ٱلسَّمَآءِ كَيْفَ يَشَآءُ وَيَجْعَلُهُۥ كِسَفًا فَتَرَى ٱلْوَدْقَ يَخْرُجُ مِنْ خِلَـٰلِهِۦ ۖ فَإِذَآ أَصَابَ بِهِۦ مَن يَشَآءُ مِنْ عِبَادِهِۦٓ إِذَا هُمْ يَسْتَبْشِرُونَ ﴿٤٨﴾ وَإِن كَانُوا۟ مِن قَبْلِ أَن يُنَزَّلَ عَلَيْهِم مِّن قَبْلِهِۦ لَمُبْلِسِينَ ﴿٤٩﴾ فَٱنظُرْ إِلَىٰٓ ءَاثَـٰرِ رَحْمَتِ ٱللَّهِ كَيْفَ يُحْىِ ٱلْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَآ ۚ إِنَّ ذَٰلِكَ لَمُحْىِ ٱلْمَوْتَىٰ ۖ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ قَدِيرٌ ﴿٥٠﴾

“Nga argumentet e Tij është edhe: që Ai t’i lëshojë erërat përgëzuese dhe t’u shijojë juve nga mëshira e Vet (shiun)**; dhe**

që të lundrojnë anijet me vullnetin e Tij, dhe që të përfitoni nga të mirat e Tij dhe ashtu, ju të jeni mirënjohës."

"Ne, edhe para teje, popujve të tyre u dërguam Pejgamberë dhe ata u erdhën atyre me argumente të qarta, e kundër atyre që bënë krim, Ne ndërmorëm masa ndëshkuese. Detyrimi Ynë ishte të ndihmojmë besimtarët."

"All'llahu është Ai që i lëshon erërat, e ato lëkundin retë dhe Ai i shtrin lart si të dojë i bën ato edhe të ndara në pjesë, dhe përmes tyre e sheh se si bie shi, e kur ia lëshon atë kujt të dojë prej robërve të Vet, ja, ata gëzohen."

"Edhe pse para se t'u binte (shiu) **atyre, ata më para tij ishin të dëshpëruar."**

"Shiko pra, gjurmët e mëshirës së All'llahut, se si e ngjall tokën pas vdekjes së saj, e s'ka dyshim se Ai është që do t'i ngjallë të vdekurit, pse Ai për çdo send është i Plotfuqishëm."

Komentimi

Shiko gjurmët e mëshirës së All'llahut!

Në këtë sure ka një pjesë që duhet parë më me kujdes, sepse shënohet si një prej fakteve të Njehsimit dhe argumenteve të All'llahut. Janë shtatë ajete që fillojnë njësoj: **"...dhe prej argumenteve të Tij"**. Kemi lexuar gjashtë prej ajeteve në mënyrë të pandërprerë. Ajeti i parë prej ajeteve të mësipërme është ajeti i

shtatë. Fjala në ajetet e mëparshme ka qenë për besimin dhe punën e mirë.

Në këtë ajet thuhet: **"Nga argumentet e Tij është edhe që t'i lëshojë erërat përgëzuese."**. Pra, ajo i bashkon pjesët e ndara të reve të zeza, i lidh dhe i bashkon, i dërgon ato në tokat e thata e të etura. Ato e mbulojnë faqen e qiellit dhe bashkë me ndryshimin e temperaturës së ajrit përgatisin shiun që të zbresë nga retë. Mbase rëndësia e ardhjes së reve për popullin e qyteteve luksoze nuk është ndonjë ngjarje e shënuar, por populli i shkretëtirës së thatë e të etur për shi gëzohet shumë kur sheh të lëvizin erërat të shoqëruara me re.

Ajetet e Kur'anit mbështeten te përgëzimi në zbritjen e shiut më shumë se çdo gjë tjetër, por fjala **''përgëzime''** nuk është e vetmjaftueshme kuptimisht për këtë kontekst, sepse retë shoqërojnë edhe përgëzime të tjera.

Erërat ekuilibrojnë nxehtësinë e ajrit me freskinë që sjellin.

Ato bëjnë shkatërrimin e gjërave të kalbura, të dekompozuara dhe e pastrojnë ajrin, zbusin nxehtësinë e diellit dhe frenojnë djegiet prej tij.

Erërat transportojnë oksigjenin që çlirohet nga bimët dhe gjethet e pemëve te njeriu dhe marrin dioksidin e karbonit që del nga frymëmarrja dhe e dërgon te bimët, të transportojnë pjalmin e luleve mashkullore tek lulet femërore.

Erërat vënë në lëvizje mullinjtë e erës dhe pastrojë stepat. Ato i transportojnë farërat nga zonat që janë mbledhur dhe i përhapin në shkretëtirë.

Erërat i transportojnë anijet bashkë me udhëtarët e tyre, bashkë me ngarkesat në pika të ndryshme.

Në ditët e sotme, puna e erërave është zëvendësuar deri në një farë mase, me punën e mjeteve moderne.

Por erërat vazhdojnë të kryejnë punë që mjetet moderne nuk arrijnë t'i kryejnë. Ato ndikojnë te lëvizjet e anijeve në drejtimet e ndryshme të tyre.

Prandaj ne lexojmë në fund të ajetit fjalën e të Madhërishmit: **"...dhe t'u shijojë juve nga mëshira e Vet** (shiun)**; dhe që të lundrojnë anijet me vullnetin e Tij, dhe që të përfitoni nga të mirat e Tij dhe ashtu ju të jeni mirënjohës."**.

Pa dyshim, erërat janë një nga mënyrat e shtimit të mirësive të shumta në fushën e bujqësisë dhe të mbarështimit të kafshëve. Ajo është bartëse, transportuese dhe shkaktare të prosperitetit tregtar.

Në temën e parë tregohet me fjalinë: **"dhe t'u shijojë juve nga mëshira e Vet"**. Tek e dyta me fjalinë: **"dhe që të lundrojë anija me vullnetin e Tij"**, kurse tek e treta me: **"dhe që të përfitoni nga të mirat e Tij"**.

Të gjitha këto begati e kanë burimin e tyre te erërat, te lëvizja e atomeve të ajrit.

Mirëpo, asnjëherë nuk i dihet plotësisht vlera e një të mire nga njeriu! Në atë moment që mirësia i ikën, njeriu e kupton vlerën e saj. Po të ndalojnë këto erëra e fllade njeriu nuk di se çfarë do t'i ndodhë atij.

Ndalimi i erës e bën jetën në ara më të ashpër se jeta në korridoret e burgjeve të errëta. Zakonisht, një nga metodat e ndëshkimit nëpër burgje është bllokimi i ajrit të dritareve.

Sikur ajri të ndalonte në oqeane dhe të qetësoheshin dallgët, jeta e kafshëve detare do të kërcënohej për shkak të pakësimit të oksigjenit. Në atë rast deti do të shndërrohej në një moçal, kënetë të zymtë.

Fakhri Raziu thotë se fjalia **"që t'u shijojë juve nga mëshira e Vet"**, tregon se shijimi përdoret në gjërat e vogla, të pakta. Kjo tregon se gjithë bota dhe mirësitë e saj nuk i afrohen mëshirës së pakët, përveçse mëshirës së gjerë (nga All'llahu) që është e posaçme për Jetën Tjetër.

Në ajetin pasues flitet për dërgimin e Pejgamberëve te populli i tyre. Ajeti që e pason, flet për fryrjen e erërave. Një herë tjetër flitet për mirësinë e fryrjes së erërave që kanë kah të kundërt, ashtu siç e mendojnë disa komentues.

Përmendja e profecisë në krah të këtyre çështjeve është vetëm për plotësimin e diskutimit lidhur me zanafillën dhe rikthimin. Diskutimi është përmendur për të dyja në këtë sure. Këtë e thonë një pjesë e komentuesve.

Ka mundësi që prania e këtij ajeti të jetë si një paralajmërim për ata që kënaqen me të gjitha këto mirësi të shumta dhe i mohojnë ato.

Ajeti thotë: **"Ne edhe para teje popujve të tyre u dërguam Pejgamberë dhe ata u erdhën atyre me argumente të qarta"**, domethënë me mrekulli dhe argumente të qarta, me argumente

logjikë. Një grup prej tyre iu përgjigj këtyre argumenteve, kurse të tjerët nuk iu përgjigjën atyre, pavarësisht këshillave: **"...e kundër atyre që bënë krim Ne ndërmorëm masa ndëshkuese"** dhe i ndihmuam besimtarët. **"Detyrimi Ynë ishte të ndihmojmë besimtarët."**.

Mënyra e të shprehurit me *"kane"* që ka kuptimin **''ishte''**, tregon se kjo rrugë ka një mur të thellë. Fjala *"hak'kan"* - **"detyrim"** dhe pas saj shprehja me *"alejna"* – **"i Yni"**, është qartësusese e së vërtetës. Të gjitha këto shprehje janë konfirmuese të vazhdueshme dhe paraprin **"detyrim i Yni"** para **"shpëtimit të besimtarëve"**. Këto tregojnë për ruajtjen, përforcimin dhe janë një konfirmim tjetër. Në total, ajeti sjell këtë kuptim: "Në shpëtimin e besimtarëve është i padiskutueshëm premtimi Ynë. Këtë premtim do ta bëjmë realitet pa pasur nevojë për ndihmën e të tjerëve.".

Kjo fjali është garanci për zemrat e besimtarëve, të cilët kanë qenë nën shtypjen e armiqve në atë kohë në Mekë. Armiqtë e besimtarëve kanë qenë më të shumtë në numër e më të fuqishëm.

Është për t'u theksuar se armiqtë, për sa kohë ishin të mbytur në gjynahe, ishin një nga faktorët e triumfit të besimtarëve. Gjynahet i shkatërrojnë deri në fund, u përgatisin shkatërrimin atyre dhe dërgojnë mbi ta ndëshkimin e All'llahut.

Në ajetin tjetër rikthehet edhe një herë përmendja e mirësisë. Në atë ajet thuhet: **"All'llahu është Ai që i lëshon erërat, e ato lëkundin retë dhe Ai i shtrin lart si të dojë, i**

bën ato edhë të ndara në pjesë"[1] të akumuluara, nga të cilat dalin pikat e vogla të shiut: **"dhe përmes tyre e sheh se si bie shi."**.[2]

Detyra e erërave është zbritja e shiut. Erërat i bartin retë nga deti dhe i çojnë në tokën e etur dhe të thatë. Retë janë të urdhëruara për ta bërë këtë gjë. Retë e shiut në qiell janë të akumuluara sipër njëra-tjetrës. Ata e zbusin ajrin, e bëjnë të lagësht dhe shiu bëhet gati për të zbritur.

Shembulli i erërave është si shembulli i bariut të deleve me eksperiencë, i cili mbledh delet e shpëndara, i kalon nëpër një shteg të përcaktuar dhe më pas, mjel qumështin e tyre.

Fjalia: **"e përmes tyre e sheh se si bie shi"** është tregues i reve të dendura dhe të forta deri në atë gradë sa të mos ndalojë pikat e vogla të shiut të dalin nga reja dhe të zbresin në tokë. Përkundrazi, këto atome të vogla që kanë mbuluar qiellin, e gjejnë rrugën e tyre nëpërmjet reve në Tokë dhe shpërndajnë mirësi në tokat e etura duke i ujitur pa ua dëmtuar frutet.

Erërat e forta dhe furtunat të cilat ndonjëherë shkulin pemët me gjithë rrënjë, e lejojnë shiun të kalojë përmes tyre dhe të bjerë në tokë.

---

1 "*El kisefu"* është shumësi i *"kisfetun"* njësoj si *"haxheletun"* dhe kuptimi i saj është pjesë, copë, dhe ajo këtu – sic duket - është tregues i pjesëve (prej reve) të akumuluara njëra sipër tjetrës dhe i bën ato shumë të dendura. Kjo ndodh kur retë janë gati për të zbritur shiun.

2 "*El uidku"* është njësoj si *"el halku"* dhe emërtohen me këtë emër pikat e vogla të ujit, njësoj si ato të rërës ndonjëherë, ku përhapen në qiell kur zbret shiu, ashtu siç thuhet me këtë emër *pikat e shiut të shpërndara ndonjëherë.*

Në fund të ajetit, Kur'ani shton: **"...e kur ia lëshon atë kujt të dojë prej robve të Tij, ja, ata gëzohen."**.

Ajeti tjetër pas tij thotë: **"...edhe para se t'u binte** (shiu) **atyre, ata më para tij ishin të dëshpëruar."**.[1]

Ky dëshpërim dhe gëzim lidhet me arabët, të cilët gjenden vazhdimisht në udhëtimet e tyre nëpër shkretëtirë. Jeta e tyre ka një lidhje shumë të fortë me këto pika uji. Ndonjëherë duket që hijet e zeza sjellin dëshpërim. Por kur pas tyre vjen shiu, rikthehet jeta e freskët në tokën e thatë, lind shpresa në zemrat e udhëtarëve në shkretëtirë. Pra, pas dëshpërimit dhe humjes, vjen shpresa.

Përsëritja e fjalës **"edhe pse para"** konfirmon se fytyrat janë të vrenjtura e të ngrysura para çasteve të shiut, disa çaste para shiut, janë të trembura dhe të frikësuara. Po kur mbi ta bie shiu, shkëlqejnë fytyrat dhe buzëqeshin buzët. Sa qenie e dobët është njeriu! Sa i mëshirshëm është Zoti ynë!

Në ajetin e fundit prej ajeteve që po komentojmë, All'llahu i Madhëruar i thotë Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Shiko, pra, gjurmët e mëshirës së All'llahut, se si e ngjall Tokën pas vdekjes së saj."**.

Fjala *"undhur"* – **"shiko"**, tregon gjurmët e mëshirës së All'llahut në rigjallërimin e tokës përmes shiut. Mjafton një shikim i vetëm për të parë këto gjurmë, pa pasur nevojë për diskutime të tjera.

---

1 *"Mublisun"* është marrë nga lënda e *"iblasun"* dhe kuptimi i saj është dëshpërimi dhe mungesa e shpresës.

Grupi emëror: **“e mëshirës së All’llahut”** është tregues i gjurmëve të bekuara që shiu i jep tokës.

Ai e pastron atmosferën dhe oqeanin prej pluhurit të akumuluar e të përhapur në hapësirë. Shiu i lan bimët dhe u jep atyre freskinë dhe butësinë.

Shiu kalon në thellësitë e tokës dhe pas njëfarë kohe, rikthehet në formën e burimeve në sipërfaqen e tokës.

Ai mbush lumenjtë dhe përrenjtë, të cilët, kur grumbullohen pas digave, prodhojnë energji elektrike, pra fuqi, dritë dhe lëvizje.

Së fundi, shiu përmirëson ajrin, sepse e freskon ambientin nga nxehtësia e madhe dhe e zbut nga të ftohtit e madh.

Në disa ajete të Kur’anit, si: në ajetin 48 të sures ‘‘Furkan’’, në ajetin 63 të sures ‘‘Neml’’, në ajetin 28 të sures ‘‘Shura’’, përmendet fjala ‘‘mëshirë’’ për shiun. Për këtë, i Madhërishmi thotë: **“...dhe Ai është që e lëshon shiun, pasi që ata t’i kenë humbur shpresat dhe Ai shtrin mëshirën e Vet.”**.

Kur’ani, në fund të ajetit, thotë: **“...e s’ka dyshim se Ai është që do t’i ngjallë të vdekurit, pse Ai për çdo send është i Plotfuqishëm.”**.

Shprehja *“muhji”* – *“që i ngjall”* është një argument për afirmimin e asaj që u tha më lart.

Në ajetet e Kur’anit konfirmohet çështja e Ditës së Kiametit. Ringjalljen e mëpasme të jetës në Tokë, e ngjason me ringjalljen e tokës nga shiu.

Për të qartësuar kthimin e jetës në Tokë, pas vdekjes së saj, Kur'ani thotë: **"Kështu do të jetë edhe Ringjallja."**.

Kjo mënyrë të shprehuri ngjason me ajetin 9 të sures ''Fatir'', ku Kur'ani thotë: **"..Ja kështu është Ringjallja."**.

Ligji i jetës dhe i vdekjes në çdo vend është i ngjashëm. Ai që ringjall tokën e vdekur me pikat e ujit të qiellit dhe i jep asaj lëvizjen e gjallërinë, e përsërit këtë gjatë gjithë vitit. Ai ka fuqinë e ringjalljes së njerëzve pas vdekjes, pasi jeta dhe vdekja janë kurdoherë në dorën e Tij, në urdhrin e Tij.

Ringjallja e Tokës shfaqet me rritjen e farave që mbijnë nga zemra e saj. Këto fara të vogla i shndërrojnë qeniet e vdekura në qenie të gjalla. Edhe mbetjet e këtyre bimëve të vyshkura shndërohen në forcë dhe fuqi për tokën, e gjallërojnë atë përsëri.

Ata që e mohojnë Ringjalljen, nuk kanë asnjë argument që të thonë. Ata përpiqen vetëm të mënjanojnë mësimet e Kur'anit që gjithmonë dëshmon me argumente se lindja dhe vdekja në Tokë janë në dorën e Tij.

Ajetet: 51 - 54

وَلَئِنۡ أَرۡسَلۡنَا رِيحٗا فَرَأَوۡهُ مُصۡفَرّٗا لَّظَلُّواْ مِنۢ بَعۡدِهِۦ يَكۡفُرُونَ ﴿٥١﴾ فَإِنَّكَ لَا
تُسۡمِعُ ٱلۡمَوۡتَىٰ وَلَا تُسۡمِعُ ٱلصُّمَّ ٱلدُّعَآءَ إِذَا وَلَّوۡاْ مُدۡبِرِينَ ﴿٥٢﴾ وَمَآ أَنتَ
بِهَٰدِ ٱلۡعُمۡيِ عَن ضَلَٰلَتِهِمۡۖ إِن تُسۡمِعُ إِلَّا مَن يُؤۡمِنُ بِـَٔايَٰتِنَا فَهُم مُّسۡلِمُونَ
﴿٥٣﴾ ۞ ٱللَّهُ ٱلَّذِي خَلَقَكُم مِّن ضَعۡفٖ ثُمَّ جَعَلَ مِنۢ بَعۡدِ ضَعۡفٖ قُوَّةٗ ثُمَّ
جَعَلَ مِنۢ بَعۡدِ قُوَّةٖ ضَعۡفٗا وَشَيۡبَةٗۚ يَخۡلُقُ مَا يَشَآءُۖ وَهُوَ ٱلۡعَلِيمُ ٱلۡقَدِيرُ ﴿٥٤﴾

"E sikur Ne të lëshojmë një erë e ta shohin atë (të mbjellat) **e zverdhur, pa dyshim ata pas kësaj janë mohues** (përbuzës)**."**

"Në të vërtetë, ti (Muhammed) **nuk mund t'i bësh të dëgjojnë të vdekurit e as nuk mund ta bësh që i shurdhëti të dëgjojë thirrjen, kur ata kthejnë shpinën."**

"Dhe as që je ti udhëzues i të verbërve nga humbja e tyre, ti nuk mund ta bësh ta dëgjojë tjetër vetëm atë që u beson argumenteve Tona, se ata janë të bindur."

"All'llahu është Ai që ju krijoi në një gjendje të dobët, pastaj pas asaj dobësie ju dha fuqi, e pas fuqisë, dobësi e

pleqëri. Ai krijon çka të dojë, Ai është më i Dituri, më i Fuqishmi."

Komentimi

Vetëm të vdekurit dhe shurdhët nuk e dëgjojnë fjalën Tënde

Në ajetet e mëparshme u diskutua për erërat e begata. Ajeti i parë prej ajeteve që po komentojmë, flet për erërat shkatërruese që sjellin dëme. Në lidhje me këtë, Kur'ani thotë: **"E sikur Ne të lëshojmë një erë e ta shohin atë** (të mbjellat) **e zverdhura, pa dyshim ata pas kësaj do të jenë mohues."**.

Shpesh njerëzit tregohen të dobët. Para rënies së shiut janë të dëshpëruar, kurse pasi bie shi gëzohen. Nëse fryn erë e verdhë saharaje ndjehen keq dhe bëhen mohues.

E kundërta ndodh me besimtarët e sinqertë, të cilët gëzohen me mirësitë e All'llahut dhe e falënderojnë Atë për ato. Kur zbresin fatkeqesitë dhe problemet, ata janë të durueshëm. Te besimtarët nuk bën asnjë efekt ndryshimi i kushteve natyrore, apo materiale e jetësore.

Besimtarët janë të vendosur në bindjet e tyre dhe për çdo gjë falënderojnë All'llahun e Madhëruar.

Fjala *"musferren"* – *"të zverdhura"* rrjedh nga fjala *"sufretun"* njësoj si *"sefretun"*. Ajo i referohet pemës dhe bimëve, të cilat zverdhen dhe vyshken për shkak të erërave shkatërruese.

Një pjesë e komentuesve mendojnë se përemri *"re'euhu"* i referohet erës. Erërat natyrore zakonisht nuk kanë ngjyra (pasi ata janë pa ngjyra). Por disa erëra janë të verdha, janë të nxehta, janë erëra të shkretëtirës.

Por ka edhe një supozim të katërt. Fjala *"musferrun"* – *"e zverdhur"* ka kuptimin *''bosh''*, në kuptimin e një ene bosh, apo stomaku bosh që nuk u jep ushqim venave të gjakut etj.

Ky kontekst përdoret edhe për erërat e boshatisura, të zbrazura nga shiu.

Në këtë kuptim, përemri *"re'euhu"* i referohet erës.

Ajo që na tërheq vëmendjen, është se për erërat e dobishme me shi është përdorur përemri në formën e shumësit. Kurse për erërërat që sjellin dëme, përemri përdoret në formën e njëjësit. Kjo tregon se shumica e erërave janë të dobishme dhe sjellin përfitime. Ato fryjnë çdo ditë. Kurse era shumë e nxehtë është vetëm një dhe fryn një herë në muaj ose një herë në vit.

Kjo tregon se erërat e dobishme janë të tilla që kanë efekt të dobishëm, nëse vazhdojnë, kurse era e keqe e lë efektin e saj kur fryn që herën e parë.

Së fundi, do të tregohet për mirësitë dhe për kënaqësitë. Në fund të këtij ajeti bëhet e qartë diferenca mes konceptit "gëzohen" (kur frynin erërat e dobishme) dhe konceptit ''bëhen mohues'' kur fenomenet natyrore ishin të keqësuara. Kjo vërtetohet me

fjalinë **"pas kësaj do të jenë mohues"** që përmendet në ajetin që po komentojmë.

Ky ndryshim dhe kontrast tregon se ata i shikojnë këto mirësi të mëdha e të vazhdueshme, të cilat ua dhuron All'llahu dhe gëzohen e kënaqen. Kur ata goditen, qoftë edhe një herë të vetme apo një ditë të vetme nga një fatkeqësi, ata bëjnë zhurmë dhe bëhen mohues.

Kjo i ngjason situatës së atyre që jetojnë një jetë të shëndoshë dhe nuk e falënderojnë All'llahun, mirëpo, kur ata sëmuren vetëm një natë të vetme me ethe dhe ju ngrihet temperatura, tregohen mohues ndaj All'llahut. Kjo është situata e njerëzve me besim të dobët. Kjo tregohet në ajetin 35 të kësaj sureje, në dy ajetet 9 dhe 10 të sures ''Hud'', në ajetin 11 të sures ''Haxhxh'' e të tjera.

Në dy ajetet që vijojnë, në kontekstin e komentimit të përmendur më parë, njerëzit ndahen në katër grupe:

1- Grupi i "të vdekurve", të cilët nuk konceptojnë asnjë të vërtetë, edhe pse në dukje janë të gjallë.
2- Grupi i "shurdhëve", të cilët janë të papërgatitur për të dëgjuar fjalën e vërtetë.
3- Grupi i "të verbërve", të cilët janë të ndaluar që të shikojnë fytyrën e së vërtetës.
4- Së fundi, grupi i besimtarëve të sinqertë, të cilët kanë zemra që kuptojnë me to, kanë sy që shikojnë me to dhe kanë veshë që dëgjojnë me to.

Ajeti i parë thotë: **"Në të vërtetë, ti** (Muhammed) **nuk mund t'i bësh të dëgjojnë të vdekurit"**, prandaj nuk ndikojnë këshillat e tua tek ata që kanë zemra të vdekura.

Po kështu: **"e as nuk mund të bësh që shurdhi të dëgjojë thirrjen, kur ata kthejnë shpinën"**.

Ajeti i dytë synon të qartësojë pjesën e mbetur të grupeve. Ajeti thotë: **"Dhe ti as që je udhëzues i të verbërve nga humbja e tyre, ti nuk mund ta bësh të dëgjojë tjetër, vetëm atë që u beson argumenteve Tona, se ata janë të bindur."**.

Kur'ani ka një standart në vlerësimin e këtyre çështjeve, jo me vlerën materiale dhe fizike, por me vlerat shpirtërore dhe njerëzore.

Kushti i parë i kuptimit të së vërtetës është që njeriu të ketë një zemër të gatshme, sy që shikojnë dhe veshë që dëgjojnë. Ai që nuk e koncepton të vërtetën për shkak të gjynaheve që ka bërë, mosbindjes dhe kokëfortësisë, ai nuk i takon grupit të besimtarëve.

Tre fazat në ajetet e përmendura më lart janë të ndryshme nga devijimi dhe mungesa e konceptimit të së vërtetës.

Faza e parë është vdekja e zemrave. Me konceptin "të vdekura" duhet kuptuar se në ato zemra nuk depërton e vërteta.

Faza e dytë është faza e "shurdhërisë" dhe e mungesës së dëgjimit. Ata që kthejnë shpinën dhe duan të arratisen, nuk mund ta kuptojnë dhe ta dëgjojnë të vërtetën.

Ky grup nuk është si ''të vdekurit'', sepse ata mund të kumtojnë nëpërmjet gjesteve apo shenjave. Por ne e dimë se shumë prej të vërtetave nuk mund t'i sqarosh dhe t'ia përcjellësh trurit me shenja. E sidomos kur grupi tjetër e kthen shpinën e tij dhe është larg.

Faza e tretë: (Verbëria) Sigurisht se jeta me të verbërit është më e lehtë se jeta me të "shurdhërit" apo jeta me "të vdekurit", sepse të verbërit kanë veshë që dëgjojnë dhe mund të përcjellësh shumë nocione tek ata. Mirëpo, janë shumë larg nga dëgjimi e shikimi në konceptimin e të vërtetave.

Pas gjithë kësaj, sqarimi i çështjeve nuk është i vetëmjaftueshëm. Le të supozojmë që t'i themi një të verbri një sekret në drejtimin djathtas apo majtas. Ai nuk mund të orientohet që të përfitojë nga ajo që i themi.

Në fund të dy ajeteve 80 dhe 81 të sures ''Neml'' kemi qartësuar të vërtetën e jetës dhe të vdekjes, paradoksin imagjinar, të cilin e ka shkaktuar një grup vehabistësh. Vehabistët marrin si shembull ajete si këto që po diskutojmë për të vërtetuar mungesën e lejimit të ndërmjetësimit, të lutjes së Pejgamberit dhe Imamëve të pastër dhe thonë: ''të vdekurit", madje edhe Pejgamberi, nuk kuptojnë asgjë.

Në komentet e mësipërme kemi vërtetuar se njerëzit, sidomos ata që janë në nivelin e Imamëve të nderuar dhe dëshmorëve të mëdhenj, kanë një lloj jete të ndërmjetme (barzakhije). Kjo dëshmohet nga Kur'ani. Edhe hadithet konfirmojnë se në këtë jetë të ndërmjetme ka një konceptim dhe shikim më të gjerë se jeta e kësaj dynjaje. (Për më tepër sqarim, përsërit komentimin e ''Më i miri'', fundin e ajeteve).

Këtu duhet të shtojmë faktin se myslimanët në namazin e tyre gjithmonë i flasin Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e përshëndesin me këtë fjali: ***"Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ty, o Pejgamber; mëshira e All'llahut dhe begatitë e Tij qofshin mbi ty, o Pejgamber!"***.

Prandaj, nga ajo kohë e më pas, është bërë detyrim përshëndetja ndaj Pejgamberit në këtë formë. Shpirti i tij i shenjtë i dëgjon të gjitha këto përshëndetje. Nuk ka asnjë argument që të na bindë që kjo përshëndetje supozohet si metaforë.

Në fund të ajetit që po komentojmë, Kur'ani na sjell një argument tjetër prej argumenteve të Njehsimit. Ai është argumenti i varfërisë dhe i pasurisë. Ky i plotëson komentimet që bëhen rreth Njehsimit në këtë sure kur thotë: **"All'llahu është Ai që ju krijoi në një gjendje të dobët, pastaj, pas asaj dobësie, ju dha fuqi, e pas fuqisë, dobësi e pleqëri."**.

Në fillim, ju keni qenë të dobët deri në atë gradë sa nuk keni pasur fuqi që të largonit edhe mizat prej vetes tuaj, që të ruanit rrjedhshmërinë e gojës tuaj. Bëhet fjalë për anën fizike. Për anën mendore, fjala e të Lartësuarit **"nuk dinit asgjë"** është konfirmimi i asaj gjendjeje kur njeriu është në atë moshë që nuk njeh as prindërit.

Por, pak nga pak, trupi juaj u bë i fortë, me mendje dhe logjikë të aftë për konceptime të gjera.

Më pas, ju nuk mundët që ta ruanit këtë forcë, sepse filloi "faza e dobësimit të trupit dhe e shpirtit".

Ky ndryshim, kjo ngjitje dhe zbritje është argumenti më i mirë që vërteton se pas jush është Ai, i Madhërishmi që i kontrollon punët tuaja dhe ua lehtëson jetën tuaj.

Këto i ka treguar prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, në fjalën e tij: *"E kam njohur All'llahun e Madhëruar përmes zhdukjes së qëllimeve, prishjes së marrëveshjeve dhe mohimit të synimeve."*.[1]

Fuqia e vërtetë nuk është në duart tona. Ajo është në dorë të All'llahut dhe ne nuk kemi asnjë gjë, përveç gjërave që na ka dhuruar Ai.

Kur bën sqarimin e ''dobësisë së dytë'' të njeriut, Kur'ani shton fjalën *"shejbetun"* – *"pleqëri"*, pa përmendur *"et tufuletu"* – *"fëmijëria"*, e cila i përket ''dobësisë së parë''.

Kjo mënyrë të shprehuri ka qenë tregues i dobësisë së thyrjes në moshë, tregues së pleqërisë dhe mundimeve të shumta që sjell ajo. Dobësia e pleqërisë është e kundërta e dobësisë së fëmijërisë. Pleqëria të çon drejt vdekjes.

Ajo që pritet prej të moshuarve, nuk është si ajo që pritet prej fëmijëve. Dobësitë e tyre ngjasojnë, por të moshuarit mbartin mbi vete përvojat e gjata të jetës.

Fjalia e fundit në ajet është treguese e diturisë së gjerë të All'llahut dhe fuqisë së Tij Absolute: **"Ai krijon çka të dojë, Ai është më i Dituri, më i Fuqishmi."**. Në të njëjtën kohë, është edhe përgëzim, edhe paralajmërim. All'llahu i shikon dhe i di mirë të gjitha nijetet tuaja. Ai është i Aftë, i Fuqishëm në shpërblimin tuaj dhe sevapin tuaj.

1 "Nehxhul Belaga", fjalët e urta, fjala 250.

Ajetet: 55 – 60

وَيَوْمَ تَقُومُ ٱلسَّاعَةُ يُقْسِمُ ٱلْمُجْرِمُونَ مَا لَبِثُواْ غَيْرَ سَاعَةٍۚ كَذَٰلِكَ كَانُواْ
يُؤْفَكُونَ ﴿٥٥﴾ وَقَالَ ٱلَّذِينَ أُوتُواْ ٱلْعِلْمَ وَٱلْإِيمَـٰنَ لَقَدْ لَبِثْتُمْ فِى كِتَـٰبِ ٱللَّهِ
إِلَىٰ يَوْمِ ٱلْبَعْثِۖ فَهَـٰذَا يَوْمُ ٱلْبَعْثِ وَلَـٰكِنَّكُمْ كُنتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٥٦﴾
فَيَوْمَئِذٍ لَّا يَنفَعُ ٱلَّذِينَ ظَلَمُواْ مَعْذِرَتُهُمْ وَلَا هُمْ يُسْتَعْتَبُونَ ﴿٥٧﴾
وَلَقَدْ ضَرَبْنَا لِلنَّاسِ فِى هَـٰذَا ٱلْقُرْءَانِ مِن كُلِّ مَثَلٍۚ وَلَئِن جِئْتَهُم بِـَٔايَةٍ
لَّيَقُولَنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُوٓاْ إِنْ أَنتُمْ إِلَّا مُبْطِلُونَ ﴿٥٨﴾ كَذَٰلِكَ يَطْبَعُ ٱللَّهُ
عَلَىٰ قُلُوبِ ٱلَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٥٩﴾ فَٱصْبِرْ إِنَّ وَعْدَ ٱللَّهِ حَقٌّۖ وَلَا
يَسْتَخِفَّنَّكَ ٱلَّذِينَ لَا يُوقِنُونَ ﴿٦٠﴾

"E Ditën kur të bëhet Kiameti (Ditën e Gjykimit)**, kriminelët betohen se nuk qëndruan** (në dynja) **gjatë, por vetëm një çast të shkurtër. Kështu kanë qenë ata që i bënë bisht së vërtetës."**

"E atyre që iu është dhënë dija dhe besimi thonë: 'Ju keni qëndruar aq sa ju pat caktuar All'llahu deri në Ditën e Ringjalljes, e kjo pra është Dita e Ringjalljes, por ju ishit që nuk e pranonit."

"E atë Ditë për ata që bënë zullum, arsyetimi nuk u bën dobi e as që kërkohet prej tyre të justifikohen."

"Ne në këtë Kur'an u kemi sjellë njerëzve nga të gjithë shembujt, po edhe sikur ti t'u sillje atyre që nuk besuan çfarëdo mrekullie do të thonin: ju (Muhammedi me besimtarë) **nuk jeni tjetër veçse mashtrues** (gënjeshtarë)**."**

"Në këtë mënyrë, All'llahu vulos zemrat e atyre që nuk kuptojnë."

"Ti, pra, bën durim, pse premtimi i All'llahut është i saktë, e kurrsesi të mos luhasin ty ata që janë të dyshimtë."

Komentimi

Atë Ditë që nuk bën dobi arsyetimi

Në këtë sure ka komentime të harmonizuara që lidhen me zanafillën dhe me Ditën e Fundit. Në ajetet që po komentojmë diskutohet rreth zanafillës dhe Ditës së Fundit. Diskutimi synon të qarojë edhe një herë një prej pamjeve më të dhimbshme të Ditës së Kiametit. **" E Ditën kur të bëhet Kiameti, kriminelët betohen**

se nuk qëndruan gjatë (në dynja)**, por vetëm një çast të shkurtër "** në botën e ndërmjetme. **"Kështu kanë qenë ata që i bënë bisht të vërtetës"**, sepse ata nuk e kuptonin ose nuk donin ta kuptonin të vërtetën. Si rrjedhim, u larguan shumë prej saj.

Përdorimi i fjalës *"es'saatu"* në gjuhën arabe do të thotë *''një pjesë ose një çast i kohës''* dhe tregon se Dita e Kiametit do ndodhë në një çast, papritur. Veprat e robve do të llogariten me shpejtësi atë Ditë. All'llahu është Llogaritës i shpejtë.[1]

Pavarësisht se ajeti paraprirës nuk ka treguar për vendin e (qëndrimit), një pjesë e komentuesve kanë nënkuptuar se bëhet fjalë për qëndrimin e tyre në dynja, në botën e ndërmjetme dhe qëndrimin në botën pas vdekjes, para Ditës së Kiametit. Fjalia: **"Ju keni qëndruar aq sa ju pat caktuar All'llahu deri në Ditën e Ringjalljes"** tregon se ky qëndrim përfundon Ditën e Kiametit. Kjo është e vërtetë vetëm për pjesën e ndërmjetme. Kurse fjala *"Berzakhu"* nuk përdoret për të gjithë njësoj, me të njëjtin kuptim dhe në të njëjtën formë, sepse edhe jetët e njerëzve nuk kanë qenë njësoj. Dikush ka patur një jetë të vetëdijshme, kurse një pjesë tjetër një jetë pa ideale, sikur kanë qenë në gjumë të thellë në botën e ndërmjetme dhe zgjohen Ditën e Kiametit duke imagjinuar mijëra vite në një orë të vetme.[2]

1 E kemi sqaruar këtë me një diskutim të detajuar në fund të ajetit 14 të kësaj sureje.

2 E kemi sqaruar këtë diskutim (në lidhje me temën e Barzakhut) në fund të ajetit 100, të sures "El Mu'minun".

Dy hulumtime

E para: Po si betohen kriminelët në gënjeshtër?!

Përgjigjia është e qartë. Ata mendojnë se koha e Barzakhut (bota e ndërmjetme mes kësaj bote dhe Botës Tjetër) ka qenë shumë e shkurtër. Gjatë asaj kohe ata kanë qenë si të përgjumur, kurse shokët e shpellës, të cilët ishin punëmirë e besimtarë, kur u zgjuan pas atij gjumi të gjatë, menduan se kishin qëndruar një ditë ose një pjesë të ditës në gjumë.

Në suren ''Bekare'' në ajetin 259, tregohet historia e njërit prej Pejgamberëve, të cilin, pasi vdiq, All'llahu e ringjalli njëqind vjet më vonë. Ai nuk e perceptonte dot se kishte qëndruar 100 vjet, por një ditë apo një pjesë të ditës.

E çfarë i pengon që të imagjinojnë kriminelët - duke vërejtur gjendjen e tyre të veçantë në botën e ndërmjetme dhe mungesën e kuptimit të tyre - që të mendojnë kështu?!

Siç e përmend edhe ajeti që vjen pas këtij, besimtarëve u thonë: "Vërtet, ju nuk qëlluat në shenjë me fjalën tuaj, pasi qëndruat në botën e Barzakhut deri në Ditën e Kiametit dhe kjo është Dita e Kiametit!".

Komentimi i fjalisë: **"kështu kanë qenë ata që i bënë bisht të vërtetës"** sqaron edhe çështjen e dytë, sepse fjala *"el ifku"* në origjinalitet ka kuptimin *"zëvendësimi i fytyrës së vërtetë dhe largimi nga e vërteta"*. Ky grup u largua nga realiteti për shkak të gjendjes së tyre të veçantë në botën e ndërmjetme, prandaj nuk ka mundur që të përcaktojë qëndrimin e tij në botën e ndërmjetme.

Nuk ka nevojë për komentime më të gjata për të treguar se kriminelët nuk kanë gënjyer me qëllim në Ditën e Kiametit, sepse në ajet nuk ka ndonjë argument për gënjeshtrën e tyre me qëllim në këtë rast.

Ajetet e fundit të Kur'anit, veçanërisht fundi i ajetit 23 i sures '' En'am'', qartëson me detaje gënjeshtrat e kriminelëve në Ditën e Kiametit.

Në ajetin që vjen më pas, flitet për përgjigjen e besimtarëve që e kuptojnë fjalën e kriminelëve të hutuar nga gjendja e Barzakhut në Ditën e Kiametit dhe thonë: E atyre që iu është dhënë dituria dhe besimi thonë: **"Ju keni qëndruar aq sa u pat caktuar All'llahu deri në Ditën e Ringjalljes, e kjo pra, është Dita e Ringjalljes, por ju ishit që nuk e pranonit."**.

Dituria i paraprin besimit, sepse dituria është esenca e besimit.

Fjalia: **"aq sa u pat caktuar All'llahu"** është tregues i Librit qiellor, pra i Librit të ardhur me urdhër të All'llahut. Qëndrimi në botën e ndërmjetme, e më pas tubimi në Ditën e Kiametit, caktohet nga All'llahu i Madhëruar.[1]

1 Në të qënurit e ajetit, se a ka shpejtim dhe vonesë, apo jo - ka fjalë dhe debat mes komentuesve dhe dijetarëve, pasi një pjesë e tyre kanë thënë: **"në caktimin e All'llahut"** është i lidhur me fjalinë **"iu është dhënë dituria dhe besimi"** dhe bëhet kështu kuptimi i ajetit: atyre që iu është dhënë dituri në Librin e All'llahut dhe e besojnë atë, ashtu sic kanë thënë, dhe një pjesë kanë thënë "në Librin e All'llahut" është i lidhur me fjalinë "keni qëndruar" dhe ne kemi zgjedhur këtë mendim gjithashtu në shpjegimin tonë të ajetit, sepse vendimi për shpejtim dhe vonim ka nevojë për një shoqërues të qartë dhe këtu ne nuk gjejmë asnjë shoqërues për atë.

Fjalia që vijon: **"atyre që u është dhënë dija dhe besimi"** tregon se bëhet fjalë për melekët e All'llahut që kanë dituri dhe ua përcjellin atë besimtarëve.

Një pjesë e komentuesve kanë thënë se kriminelët betohen se ata nuk kanë qëndruar më shumë se një orë. Atyre iu është treguar se kanë qëndruar deri në Ditën e Kiametit, por ata dëshironin vonesën e Kiametit.

Kurse grupi i dytë ishin besimtarët që e prisnin Xhennetin dhe mirësitë e tij të përhershme, e dëshironin shumë shpejtimin e Kiametit dhe pushimin e shikonin shumë të gjatë.[1]

Kur kriminelët do të përballen me realitetin e tyre të dhimbshëm, do të pendohen dhe do të kërkojnë falje për ato që kanë bërë. Kur'ani, në lidhje me këtë, thotë: **"E atë Ditë për ata që bënë zullum, arsyetimi nuk bën dobi e as që kërkohet prej tyre të justifikohen."**[2].

1 Tefsiri "El Kebijr", vëll. 25, f. 137, fundi i ajeteve është burimi i komentimit.

2 Fjala *"jesteuabe"* – *"të kërkosh prej tyre justifikimin"* rrjedh nga fjala *"atebe"* njësoj si *"hateme"* dhe kuptimi i saj në rrënjë është detyrimi personal *"i brendshëm"* dhe kur kjo folje formohet nga kapitulli i efiçencës, atëherë bëhet kuptimi i saj, largimi i këtij efekti dhe detyrimi, ashtu siç vjen në gjuhën arabe se efikasiteti kryen kuptimin e efiçencës këtu, prandaj thuhet në lidhje me çështjen e kërkimit të kënaqësisë dhe kuptimi i saj është kërkesa e kënaqësisë dhe e pendimit, dhe kuptimi i fjalës këtu në ajet është njësoj me atë që përmendëm, dhe kuptimi është se kriminelët në Ditën e Kiametit nuk kanë asnjë fuqi për pendimin.

Në disa ajete kur'anore ka një sqarim. Aty theksohet se kriminelëve nuk u lejohet të kërkojnë falje: **"atyre as që u lejohet që të arsyetohen"**[1] .

Por ajeti që po diskutojmë thotë: "...atyre nuk u bën dobi justifikimi atje. Në pamje të parë ata kërkojnë falje, vetëm se nuk ka asnjë dobi justifikimi i tyre''.

Sigurisht që nuk ka asnjë konflikt mes këtyre ajeteve, sepse Dita e Kiametit ka faza të ndryshme. Në disa faza nuk u lejohet kriminelëve të justifikohen kurrë dhe gojët e tyre mbyllen. Por lejohen të flasin vetëm organet e tyre për të këqijat që kanë bërë. Në disa faza të tjera gjuhët e tyre fillojnë me justifikimet, por nuk u bën kurrë dobi justifikimi i tyre.

Një nga justifikimet e tyre është se ata ia hedhin përgjegjësinë e gjynaheve të parëve të tyre dhe u thonë: **"Sikur të mos ishit ju ne do të ishim besimtarë."**.[2] Të parët e tyre u kundërpërgjigjen duke thënë: **"A ne ju penguam prej udhëzimit të drejtë pasi që u pat ardhur juve?"**.[3]

Ndonjëherë ata mallkojnë shejtanin për humbjen dhe devijimin e tyre. Por shejtani u përgjigjet: **"...atëherë, pra, mos më qortoni mua, por qortoni veten tuaj"**,[4] domethënë se nuk ju kam detyruar unë juve që të mohoni, por ju vetë m'u përgjigjët mua me dëshirën tuaj.

1 Sure "El Murselat", ajeti 36.
2 Sure "Sebe", ajeti 31.
3 Sure "Sebe", ajeti 32 .
4 Sure "Ibrahim", ajeti 22.

Në ajetin që pason tregohen të gjitha temat me sqarimet e përmendura në këtë sure: **"Ne në këtë Kur'an u kemi sjellë njerëzve nga të gjithë shembujt"** kemi përmendur premtimin dhe kërcënimin, urdhrin dhe ndalimin, përgëzimin dhe paralajmërimin, argumentet në horizonte dhe në vetvete, argumentet e zanafillës dhe të Ditës së Takimit, lajmet e gajbit (të së panjohurës) dhe pastërtinë. Kemi përmendur gjithçka që mundet që të ndikojë në shpirtat dhe në nefset e njerëzve.

Në mënyrë të përgjithshme në Kur'an dhe veçanërisht në suren ''Rrum'' që flet për fazat e saj të fundit, janë trajtuar një seri problemesh dhe mësimesh që të qartësojnë çdo kategori njerëzore me qëllim që të sigurojnë rrugën drejt lumturisë.

Pavarësisht këtyre, ka një grup njerëzish që nuk ndikohen në zemrat e tyre të errëta e të zeza prej asgjëje. Prandaj edhe Kur'ani thotë në lidhje me ta: **"...edhe sikur t'u sillje çfarëdo mrekullie ti atyre, ata që nuk besuan, do të thonin: ju nuk jeni tjetër, veçse mashtrues."**.

Fjala *"mubtilune"* është një shprehje gjithpërfshirëse. Ajo mban të gjitha kuptimet e mashtrimit, të gënjeshtrës dhe të shthurjes nga ana e idhujtarëve. Ngarkimi me gënjeshtër dhe me magji i Pejgamberit është budallallëk, njësoj si rasti i legjendave trilluese. Të gjitha këto janë të pavërteta. Këtë kuptim gjithëpërfshirës përcjell fjala *''mubtilune''* – *"mashtrime"*.

Ata i akuzonin gjithmonë Pejgamberët me ndonjërën prej këtyre çështjeve të pavërteta, që të largonin prej tyre njerëzit e mirë e të pastër, qoftë edhe për disa ditë.

Kurse fjala *"entum" – "ju"* ka mundësi të jetë për të treguar Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe besimtarët e vërtetë mundet që të përfshijë të gjithë njerëzit e së vërtetës që prej Pejgamberëve dhe Imamëve të pagabueshëm e deri te ndjekësit e tyre, sepse ky grupim jobesimtarësh kundërshton të gjithë ndjekësit e së vërtetës.

Ajeti që vjen pas tij sqaron shkakun e kundërshtimit të këtij grupimi dhe thotë: "...me të vërtetë, kokëfortësia dhe armiqësia e tyre ndaj së vërtetës, nuk njeh kufij. Kjo është se kishin humbur ndjeshmërinë dhe kuptimin nga gjynahet e tyre të shumta. Ata nuk dinë asgjë. **"...në këtë mënyrë, All'llahu vulos zemrat e atyre që nuk kuptojnë."**.

Fjala *"jetbeu" – "vulos"* është marrë nga "*et tab'u"*. Kuptimi i saj është vulosja e diçkaje dhe tregon se çfarë ka ngjarë në të kaluarën, ndodh edhe sot.

Kur'ani e ka përdorur këtë shprehje si metaforë për zemrat në të cilat nuk depërton as këshilla dhe as udhëzimi. Ata kanë humbur ndjenjat, mendjen dhe diturinë dhe nuk kanë asnjë shpresë në udhëzimin e tyre.

Në ajetet paraprirëse është përmendur dituria si esenca e besimit. Kurse në këtë ajet është përmendur injoranca si esenca e mohimit dhe e mosdorëzimit ndaj së vërtetës.

Ajeti i fundit prej ajeteve që po komentojmë është i fundit i sures ''Rrum''. Ky ajet e urdhëron Pejgamberin *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me dy urdhëresa të rëndësishme. Ky ajet e përgëzon atë me një lajm shumë të madh:

që të përballojë idhujtarët, injorantët dhe budallenjtë përmes qëndrimin të fortë, të drejtë dhe të duruar.

Në fillim thotë: Nëse çështja është e tillë, atëherë ti duhet të bësh durim dhe të qëndrosh në rrugën e drejtë të ngjarjeve të ndryshme, përballë llojeve të ndryshme të dëmtimit, të fabrikimit të trillimeve dhe fatkeqësive: **"bëj durim"**.

Durimi dhe të qëndruarit fort në rrugën e drejtë, janë çelësi i triumfit të vërtetë.

Për të qenë sa më i qetë Profeti *(Paqja dhe bekimete All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ajeti shton: **"me të vërtetë se premtimi i All'llahut është i vërtetë"**. All'llahu u ka premtuar besimtarëve fitore dhe triumf. Ai u jep ndihmë atyre, trashëgimi në Tokë dhe fitore të Islamit ndaj mohimit, të dritës ndaj errësirës, të dijes ndaj injorancës. Dhe ky premtim do të kthehet në vepra.

Fjala *"el uadu"* – *"premtimi"* është tregues i premtimeve të përsëritura e të premtuara nga Kur'ani për triumfin e besimtarëve. Kjo sqarohet në ajetin 47 të kësaj sureje: **"Detyrimi Ynë ishte të ndihmonim besimtarët."**.

Dhe ajeti 51 i sures ''Gafir '' thotë: **"Ne patjetër do t'i ndihmojmë të Dërguarit Tanë në jetën e kësaj bote, edhe ata që besuan, e edhe në Ditën e prezantimit të dëshmive."**.

Ajeti 56 i sures ''El Maide'' thotë: **"...s'ka dyshim se ana** (pala, krahu) **e All'llahut është ngadhënjyese."**.

Së dyti, kërkohet ruajtja e qetësisë dhe e mosdevijimit në përballje me idhujtarët. Ajeti thotë: **"...e kurrsesi, mos të të luhasin ty ata që janë të dyshimtë!"**.

Përgjegjësi është të durosh çdo gjë. Ai që është i tillë, meriton të jetë komandant dhe udhëheqës.

"Mos të të luhasin ty" rrjedh nga *"el khiffetu"* dhe ka kuptimin e kundërshtimit të rëndë. Domethënë: bëhu i qëndrueshëm, me qëllim që mos të të luhasin ty njerëz të tillë, jobesimtarë. Ji i vendosur në rrugën e drejtë! Ata kanë humbur sigurinë, besimin, kurse ti je qendra, je boshti i sigurisë dhe i besimit.

Kjo sure filloi me premtimin e triumfit të besimtarëve ndaj armiqve dhe përfundoi me këtë premtim. Kushti i saj kryesor është durimi dhe qëndrimi drejtë.

Zoti ynë, na jep durim dhe qëndrueshmëri që të mos na lëkundë asnjëherë tufani i ngjarjeve dhe problemeve!

Zoti ynë, ne strehohemi te Madhëria Jote që të mos jemi prej grupit të atyre që nuk ndikon në zemrat e tyre këshilla dhe fjala e mirë, udhëzimi dhe mësimi prej të tjerëve; që nuk ndikon betimi dhe angazhimi.

Zoti ynë, armiqtë tanë janë të bashkuar dhe të armatosur me lloje të ndryshme armësh të djallëzuara, prandaj na ndihmo ne, o Zoti ynë! Na mbro nga armiqtë tanë nga jashtë dhe nga shejtani nga brenda!

Amin, o Zoti i gjithë botërave!

Sure "Lukman"

Mekase

Numri i ajeteve të saj është tridhjetë e katër.

Përmbajtja e sures

Në mesin e komentuesve të Kur'anit është e njohur kjo sure ka zbritur në Mekë. Një pjesë e komentuesve si shejkh Tusij në "Et Tibjan", ka veçuar ajetin e katërt, i cili flet për namazin dhe zekatin. Fakhru Razi, përveç ajetit të katërt ka veçuar edhe ajetin 27, i cili diskuton për dijen e gjerë të All'llahut. Nuk ka asnjë argument të qartë për këto veçime, sepse namazi dhe zekati në pamje të përgjithshme, kanë qenë të pranishme edhe në Mekë.

Në bazë të kësaj, surja ''Lukman'', me gjithë qënien e saj, është mekase; përfshin përmbajtjen e përgjthshme të sureve mekase. Domethënë: ata diskutojnë për besimet thelbësore islame, e në mënyrë të veçantë, për zanafillën dhe Ditën e rikthimit (Kiametit). Përmbajtja e kësaj sureje përmblidhet në pesë pjesë:

Në pjesën e parë tregohet përmendja e Madhështisë së All'llahut dhe qënia e Tij udhëzim dhe mëshirë për besimtarët. Tregohet edhe për palën tjetër që shfaq fanatizmin dhe kokëfortësinë që para ajeteve të qarta duken sikur janë të shurdhët nga veshët. Madje, përpiqen deri në largimin e të tjerëve nga Kur'ani nëpërmjet krijimit të mënyrave zbavitëse të pavërteta, jo të mira.

Pjesa e dytë flet për argumentet e All'llahut në krijimin e qiellit, për ngritjen e tij pa asnjë shtyllë, për krijimin e maleve dhe gjallesave të ndryshme, për zbritjen e shiut dhe për zhvillimin e bimëve.

Pjesa e tretë transmeton një anë të fjalës së Lukmanit të mençur, tregon adhurimin për këshillën e tij ndaj të birit. Kjo pjesë fillon nga Njehsimi dhe luftimi i politeizmit dhe përfundon

me këshillën që të bëhet mirë nga dy prindërit namazi, tregon të urdhëruarit në të mirë, tregon ndalimin ndaj së keqes, qëndrimin e fortë para ngjarjeve të vështira, gëzimin e dëfrimin bashkë me njerëzit dhe përuljen para drejtësisë.

Në **pjesën e katërt** surja rikthehet tek argumentet dhe shenjat e Njehsimit dhe flet për nënshtrimin e qiellit dhe të Tokës, për mirësitë e bollshme të All'llahut, për përçmimin dhe përbuzjen e mentalitetit të paganëve, të cilat ranë në humbje dhe në devijim si rezultat i traditës dhe i ndjekjes së shembujve të baballarëve dhe të gjyshërve. Kjo sure i bëri ata që të jenë të kënaqur me All'llahun krijues që është esenca e adhurimit të Tij.

Kjo sure zbulon diturinë absolute të All'llahut që përmbledh të gjithë argumentet rreth Teuhidit të natyrshëm, i cili është i qartë në çdo aspekt.

Në **pjesën e pestë** rikthehet diskutimi i Ditës së Kiametit dhe i jetës pas vdekjes. Kjo pjesë e paralajmëron njeriun që të mos mashtrohet nga bota tokësore dhe e nxit atë që të mendojë thellë dhe të përgatitet për jetën e përhershme.

Përmes këtyre diskutimeve njihet dituria e All'llahut për të fshehtat që lidhen me njeriun. Njëra prej të fshehtave është çasti i vdekjes. Me këtë përfundon surja.

Kjo sure është emërtuar "Lukman", sepse trajton këshillat e njërit prej dijetarëve të mëdhenj, të Lukmanit.

Mirësia e leximit të sures "Lukman"

Janë përmendur shumë transmetime nga i Dërguari *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nga disa Imamë të Ehli Bejtit për mirësinë e kësaj sureje. Njëra prej tyre përmendet në një hadith të Profetit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *''Kush e lexon suren 'Lukman', Lukmani do të jetë për të shoqërues i tij Ditën e Kiametit dhe i jepen dhjetë të mira, aq sa ai që bën një vepër të mirë dhe ndalon një vepër të keqe."*.[1]

Kurse në një hadith tjetër nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: "*Kush lexon suren 'Lukman' në një natë, All'llahu i dërgon tridhjetë melekë që të kujdesen për të, që ta ruajnë nga Iblisi dhe ushtarët e tij, derisa të agojë. Nëse e lexon atë edhe gjatë ditës, ata vazhdojnë ta ruajnë atë nga shejtani dhe ushtarët e tij derisa të ngryset."*.[2]

Gjithë kjo mirësi që vjen nga leximi i një sureje nga Kur'ani tregon rëndësinë e leximit. Leximi vlerësohet si paraprijës i meditimit, kurse meditimi vlerësohet si paraprijës i veprës së mirë. Njeriu nuk duhet ta presë gjithë këtë të mirë vetëm duke folur me zhurmë të madhe e me zë të lartë.

1 Tefsiri i dispozitave të sqarimit, vëll. 8, f. 312.

2 Burimi i mësipërm dhe tefsiri "Nuruth Thakalajn", vëll. 4, f. 193.

Ajetet: 1 – 5

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

الٓمٓ ﴿١﴾ تِلۡكَ ءَايَٰتُ ٱلۡكِتَٰبِ ٱلۡحَكِيمِ ﴿٢﴾ هُدٗى وَرَحۡمَةٗ لِّلۡمُحۡسِنِينَ ﴿٣﴾
ٱلَّذِينَ يُقِيمُونَ ٱلصَّلَوٰةَ وَيُؤۡتُونَ ٱلزَّكَوٰةَ وَهُم بِٱلۡأٓخِرَةِ هُمۡ يُوقِنُونَ ﴿٤﴾
أُوْلَٰٓئِكَ عَلَىٰ هُدٗى مِّن رَّبِّهِمۡۖ وَأُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلۡمُفۡلِحُونَ ﴿٥﴾

Me emrin e All'llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

"Elif, Lam, Mim."

"Ato janë ajete të Librit me plot urtësi të përsosur."

"E që janë udhëzim e mëshirë për ata që janë punëmirë."

"Të cilët rregullisht e falin namazin dhe e japin zekatin, e që ata janë të plotbindur për Botën Tjetër (Ahiretin)**."**

"Të tillët janë të udhëzuar në një rrugë të qartë prej Zotit të vet dhe ata janë fatlumë."

Komentimi

Kush janë punëmirët?

Surja fillon me germat e shkëputura "Elif, Lamë, Mimë" duke treguar rëndësinë dhe madhështinë e Kur'anit. Sqarimi i shkronjave të shkëputura në fillimin e saj tregon vërtetësinë dhe ëmbëlsinë e saj. Këto ajete që përfaqësohen vetëm me tri fjalë përcjellin një përmbajtje që ndryshon jetët njerëzore. Prandaj, pas përmendjes së fjalëve të ndërprera, thuhet: **"Ato janë ajete të librit me plot urtësi të përsosur."**.

Fjala *"tilke"* në gjuhën arabe është shenjë treguese për larg. Është thënë se kjo mënyrë të shprehuri është një metaforë që tregon rëndësinë e madhe të këtyre ajeteve.

Përshkrimi i "librit" me fjalën *"el hakimu"* – *"plot urtësi"*, është bërë për shkak të forcës dhe të kontekstit të përmbajtjes së tij. Ky libër thotë vetëm të vërtetën. E pavërteta nuk gjen mënyrë që të arrijë tek ai. Ky libër dëbon nga vetja e tij çdo lloj trillimi dhe legjende. Kjo mënyrë të shprehuri është vënë përballë emërtimit **"tregime boshe"**. Ky emërtim sqarohet plotësisht në ajetet pasuese.

Ose mund të përdoret edhe me kuptimin se Kur'ani është si dijetari me plot urtësi që flet me një mijë gjuhë, duke qëndruar i heshtur. Kur'ani i mëson të tjerët, i këshillon dhe i qorton, u zgjon dëshirën dhe i terrorizon, u fut frikën dhe i paralajmëron, u premton për dënim dhe ua sqaron mirë tregimet që merren prej

Tij. Me pak fjalë, Kur'ani është me plot urtësi në kuptimin e plotë të fjalës.

Nuk ka asnjë pengesë që të pranohen të dy kuptimet e mësipërme të shpjeguara në ajet.

Ajeti që pason, tregon synimin kryesor të zbritjes së Kur'anit dhe thotë: **"...e që janë udhëzim dhe mëshirë për ata që janë punëmirë."**.

Udhëzimi paraprin mëshirën e All'llahut, sepse njeriu e gjen të vërtetën vetëm nën hijen e dritës së Kur'anit dhe e beson Atë, punon siç thotë Ai, e pas kësaj, përfshihet në mëshirën e gjerë të All'llahut dhe të mirësive të Tij, të cilat nuk mund të llogariten.

Kjo sure e konsideron Kur'anin si shkaktari i udhëzimit dhe i mëshirës për punëmirët.

Në fillim të sures ''En Neml'', thuhet: **"udhëzim dhe mëshirë për besimtarët"**, kurse në fillim të sures ''El Bekare'', thuhet: **"udhëzim për të devotshmit."**.

Ky ndryshim në mënyrën e të shprehurit mbase ka qenë për shkak se shpirti i dorëzimit dhe pranimi i të vërtetave nuk jetojnë në brendësi të njeriut që nuk ka devotshmëri. Në këtë rast nuk mund të realizohet udhëzimi. Pas fazës së pranimit të së vërtetës, arrijmë në fazën e besimit, i cili përmban përgëzimin për mirësitë e All'llahut. Përmes udhëzimit, nëse përparojmë më shumë, do të arrijmë në fazën e veprës së mirë. Tek ajo fazë kthjellohet mëshira e All'llahut më shumë se më parë.

Tre ajetet e mësipërme sqarojnë tri faza të njëpasnjëshme të plotësimit të adhuruesve të All'llahut: faza e pranimit të së vërtetës, faza e besimit dhe më pas, vepra dhe Kur'ani. Në këto faza është burimi i udhëzimit, i përgëzimit dhe i mëshirës.

Ajeti që pason, i përshkruan punëmirët me tri cilësi: **"Ata të cilët e falin namazin dhe e japin zekatin dhe ata që janë të plotbindur për Botën Tjetër** (Ahiretin)**."**. Lidhja e këtyre me Krijuesin nëpërmjet namazit dhe lidhja e krijesave me All'llahun nëpërmjet zekatit në Ditën e Kiametit është një motiv i fortë i largimit nga gjynahet dhe nxitës i kryerjes së detyrave.

Ajeti i fundit nga ajetet që po komentojmë sqaron rezultatin e punës së punëmirëve. Ai thotë: **"Të tillët janë të udhëzuar në një rrugë të mbarë prej Zotit të vet dhe ata janë fatlumë."**.

Fjalia: **"Të tillët janë të udhëzuar në një rrugë të mbarë prej Zotit të vet"** shpall se udhëzimi i atyre është përmbushur nga ana e Zotit të tyre. Nga ana tjetër, shprehja me *"ala"* është një argument që udhëzimi është si një kalë shale që ecën shpejt. Ata i kanë hipur atij dhe e kanë kapur për frerësh. Kështu qartësohet kontrasti mes këtij udhëzimi dhe udhëzimit që është përmendur në fillimin e sures. Sepse udhëzimi i parë është përgatitja e pranimit të së vërtetës, kurse ky udhëzim është një program për të arritur drejt qëllimit dhe synimit.

Ndërsa fjalia **"dhe ata janë fatlumët"** tregon se kjo rrugë është rruga e vetme e shpëtimit, rruga e punëmirëve, rruga e atyre që janë të lidhur me All'llahun dhe krijesat e Tij, është rruga e atyre, të cilët besojnë me një besim të plotë për fillimin e krijimit dhe në Ditën e Ringjalljes.

Ajetet: 6 -9

وَمِنَ ٱلنَّاسِ مَن يَشۡتَرِي لَهۡوَ ٱلۡحَدِيثِ لِيُضِلَّ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِ بِغَيۡرِ عِلۡمٖ
وَيَتَّخِذَهَا هُزُوًاۚ أُوْلَٰٓئِكَ لَهُمۡ عَذَابٞ مُّهِينٞ ٦ وَإِذَا تُتۡلَىٰ عَلَيۡهِ ءَايَٰتُنَا
وَلَّىٰ مُسۡتَكۡبِرٗا كَأَن لَّمۡ يَسۡمَعۡهَا كَأَنَّ فِيٓ أُذُنَيۡهِ وَقۡرٗاۖ فَبَشِّرۡهُ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ
٧ إِنَّ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ ٱلصَّٰلِحَٰتِ لَهُمۡ جَنَّٰتُ ٱلنَّعِيمِ ٨
خَٰلِدِينَ فِيهَاۖ وَعۡدَ ٱللَّهِ حَقّٗاۚ وَهُوَ ٱلۡعَزِيزُ ٱلۡحَكِيمُ ٩

"Po ka nga njerëzit që sajojnë tregime boshe me qëllim që t'i largojnë njerëzit prej rrugës së All'llahut pa pasur kurrfarë fakti dhe për t'i marrë ato (ajetet) **All'llahut si tallje. Për ta, me siguri, është përgatitur dënim i turpshëm."**

"E kur i lexohen atij ajetet Tona, ai kthehet kryelartë dhe bëhet sikur nuk i ka dëgjuar ato, bëhet sikur në veshët e tij ka shurdhim të rëndë, pra, ti përgëzoje atë me një dënim të dhimbshëm!"

"E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, për ata janë Xhennetet e begatshme."

"Në të cilat janë përgjithmonë. Premtimi i All'llahut është i prerë, e Ai është i Gjithëfuqishmi, i Urti."

Shkaku i zbritjes

Disa komentues të Kur'anit kanë thënë se ajeti i parë prej këtyre ajeteve ka zbritur për Nedir ibn Harithi. Ai ka qenë një tregtar që udhëtonte në Iran dhe u tregonte kurejshëve tregimet iraniane dhe thoshte: Nëse Muhammedi u ka treguar ju për tregimet e Adit dhe Themudit, unë do ju tregoj për tregimet e të parit prej shtatë vendeve kryesore të muzikës dhe shkrimit kunjor, për lajmet e Kisrasë dhe sulltanëve joarabë. Ata mblidheshin rreth tij dhe e linin mënjanë dëgjimin e Kur'anit.

Kurse një pjesë tjetër kanë thënë se kjo pjesë e ajeteve ka zbritur për një njeri që kishte blerë një skllave këngëtare që i këndonte atij ditë e natë duke e shpërqëndruar nga përmendja e All'llahut.

Komentuesi i madh Tabersiju për shkakun e zbritjes thotë se është përmendur në një hadith se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e mbështet shkakun e zbritjes së përmendur më lart. Ai, *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Nuk është e lejuar mësimdhënia e këngëtarëve dhe as blerja e tyre. Vlerat, çmimet e tyre janë të ndaluara."*. Dhe zbriti konfirmimi në librin e All'llahut: **"po ka nga njerëzit që sajojnë tregime boshe..."**.

Komentimi

Kënga është një nga kurthet më të mëdha të shejtanëve

Në këto ajete bëhet fjalë për një grup që i janë vënë përballë grupit të punëmirëve dhe besimtarëve.

Ky grup përdor propagandën e tij për të mashtruar shoqërinë njerëzore për vlera që, sipas tyre, duhen shijuar në këtë dynja dhe jo në Ahiret. Por njerëzit që mashtrohen nuk e dinë se për ata që u besojnë atyre është përgatitur dënimi përkatës. Ajeti thotë: **"Po ka nga njerëzit që sajojnë tregime boshe e me qëllim që t'i largojnë njerëzit prej rrugës së All'llahut pa pasur kurrfarë fakti dhe për t'i marrë ato** (ajetet) **All'llahut si tallje."**.[1] Pastaj shton në fund: **"Për ta me siguri është përgatitur një dënim i turpshëm."** .

Tregimet dhe fjalët boshe realizohen përmes shumave të mëdha të parave në këmbim të dëgjimit të trillimeve dhe legjendave. Këtë e lexuam edhe në tregimin e Nedir ibn Harithit.

Përmes blerjes së këngëtarëve synohet zbavitja me aktivitete të kota. Shpenzimi i pasurive për të tilla qëllime, konsiderohet si "tregime dhe fjalë boshe".

1 Përemri *"jet'tekhidhuha"* – *"i merr ato"*, i referohet (ajeteve të librit), të cilat janë përmendur në ajetet e mëparshme dhe disa kanë supozuar se ajo i referohet *"es sebilu"* – *"rrugës"*, sepse fjala *"es sebilu"* është përmendur në ajetet e Kur'anit ndonjëherë në formën e gjinisë mashkullore, kurse herë të tjera, në formën e gjinisë femërore.

E çuditshme është se këta njerëz të mashtruar e blenin fjalën dhe zbavitjen boshe me një çmimin shumë të lartë dhe i kundërshtonin argumentet e Zotit dhe fjalët e mençura që All'llahu ua ka dhënë atyre falas!

Kuptimi i emërtimit: **"tregimet boshe"** tregon çdo lloj fjale apo muzike që të çon drejt kotësisë dhe hutimit, që e tërheq njeriun drejt humbjes, siç mund të ishte një këngë a muzikës eksituese, ndikuese të epshit dhe instikteve djallëzore. "Tregimet boshe" e orientojnë njeriun drejt shthurjes nëpërmjet përmbajtjes së tyre.

Ndikimi i tregimeve boshe është i njëjtë me historitë dhe legjendat trilluese, të cilat i largojnë njerëzit nga rruga e drejtë.

''Tregimet boshe'' janë njësoj si fjalët tallëse dhe përbuzëse që thuhen për të fshehur të vërtetën, për të dobësuar bazat e besimit, ashtu siç transmetohet nga Ebu Xhehli, i cili, kur qëndronte para kurejshëve, thoshte: A dëshironi që t'u ushqejë juve prej zekumit[1], me të cilin ju kërcënon Muhammedi? E pastaj kërkon që t'i sillet aty gjalpë dhe hurma? Dhe thoshte: Ja, ky është zekkumi! Në këtë mënyrë, ai tallej me ajetet dhe me argumentet e All'llahut.

Për ''fjalët boshe'' ka një kuptim të gjerë që përfshin të gjithë këto kuptime dhe shembuj. Transmetimet islame dhe fjalët e komentuesve tregojnë njërin prej këtyre kuptimeve. Ato nuk tregojnë kufizimin e kuptimit të ajetit.

1 *Zekkumi* është pemë e Xhehennemit me frute shumë të pakëndshme.

Transmetimet e përmendura nga Ehli Bejti *(Paqja e Zotit qoftë mbi ta!)* e bëjnë të qartë kuptimin e gjerë të kësaj fjale. Edhe në hadithin e përmendur nga Imam Sadiku *(Paqja e Zotit qoftë mbi të!)* thuhet: "Kënga është një tubim, një mbledhje, të cilat All'llahu nuk i shikon me syrin e mëshirës. Nuk i mëshiron as njerëzit që janë në të. Për këtë, ajeti thotë: siç thotë All'llahu: **'Po ka nga njerëzit që sajojnë tregime boshe me qëllim që t'i largojnë njerëzit prej rrugës së All'llahut.'**".[1]

Shprehja me **"tregime boshe"** në vend të "fjalës boshe" tregon se qëllimi kryesor i këtyre është argëtimi dhe kotësia.

Fjalia **"që t'i largojnë njerëzit prej rrugës së All'llahut"** rrok një kuptim të gjerë, që përfshin përhumbjen ideologjike e fetare, ashtu siç e lexuam në historinë e Nedir ibn Harithit dhe të Ebu Xhehlit, e po kështu, përfshin edhe shthurjen morale, ashtu siç u përmend në ndodhitë e këngës.

Shprehja **"pa pasur kurrfarë fakti"** tregon se ky grup i humbur e i devijuar nuk beson as edhe tek metoda e tyre e kotë, e pavërtetë, madje beson injorancën dhe traditën e verbër. Ata janë injorantë që përpiqen të implikojnë edhe të tjerët me injorancën e tyre.

Shprehjen **"pa pasur kurrfarë fakti"** e konsiderojmë përshkrim të mashtruesve. Një pjesë e komentuesve e kanë konsideruar këtë shprehje si një përshkrim i të humburve dhe i të devijuarve.

1 "Uesailush Shiia", vëll. 12, f. 228 (kapitulli i ndalimit të këngës) dhe vëll. 18, f. 308, Botimi i shtëpisë botuese "Alel Bejt".

Pa dyshim se këta mashtrues mund të ngulin këmbë në qëllimin e tyre, nuk binden për kotësinë e këtyre çështjeve, madje përpiqen ta bëjnë fjalën e tyre të kotë dhe fjalën boshe një metodë talljeje me argumentet e All'llahut.

Këtë tregon fundi i ajetit, i cili thotë: **"i marrin ato si tallje"**.

Përshkrimi i dënimi me *"el muhinu"* tregon se dënimi që u jepet këtyre mashtruesve është homolog me gjynahun, sepse ata u tallën me argumentet e All'llahut dhe i përbuzën ato. Prandaj, All'llahu i Madhërueshëm u ka përgatitur atyre një dënim të turpshëm dhe të dhimbshëm.

Ajeti që vjen më pas na tregon se këta grupe nuk i dëgjojnë argumentet e All'llahut. I kundërshtojnë ato dhe u përgjigjen me fjalë boshe. Ajeti thotë: **"E kur i lexohen atij ajetet Tona, ai kthehet kryelartë dhe bëhet sikur nuk i ka dëgjuar ato, bëhet sikur në veshët e tij ka një shurdhim të rëndë"** pra, as që duan të dëgjojnë.

Në fund, ajeti përmend dënimin e dhimbshëm të njerëzve të tillë: **"...pra, ti përgëzoje atë me një dënim të dhimbshëm!"**.

Shprehja: **"ai kthehet kryelartë"** është një tregues i kundërshtimit të tij. Kundërshtimi nuk vinte vetëm nga dëmtimi i interesave të kësaj dynjaje dhe nga pengimi i dëshirave e pasioneve të tij. Përkundrazi, çështja është më e madhe se kaq. Nxitësi, stimuluesi i mendjemadhësisë para madhështisë së All'llahut dhe argumenteve të Tij, është gjynahi më i madh.

Ajetit në fillim thotë: me të vërtetë ai i neglizhoi, nuk u dha rëndësi ajeteve të All'llahut. U hoq sikur nuk i kishte dëgjuar kurrë ato dhe parakalonte para tyre me indiferencë. Pastaj shton: përkundrazi, ai është i shurdhët dhe nuk dëgjon kurrë, asnjë fjalë.

Shpërblimi i personave të këtillë u përshtatet veprave të tyre. Veprat e tyre kanë qenë të dhimbshme, ofenduese dhe tallëse për ithtarët e së vërtetës, prandaj All'llahu i Madhërueshëm ua ka bërë dënimin dhe ndëshkimin e tyre të dhimbshëm.

Duhet thënë se përdorimi i frazës *"besh'shir"* – **"përgëzo"** për dënimin e rëndë të All'llahut është në përputhje me veprat e mendjemëdhenjve dhe me cilësitë e Ebu Xhehlit, të cilët talleshin me argumentet e All'llahut. Ata e komentonin "zekkumin e Xhehennemin" me fjalët ''gjalpë dhe hurma''!

Ajetet që vijnë më pas, rikthehen në shpjegimin dhe sqarimin e gjendjes së besimtarëve të vërtetë. Surja ka filluar me krahasimin me përmendjen e situatës së tyre në fillim e pastaj e ka mbyllur fundin e kësaj pjese duke thënë: **"E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, për ata janë Xhennetet e begatshme."**.

Ky grup është në kontranst me mendjemëdhenjtë dhe mashtruesit, të cilët nuk deshën t'i shikonin gjurmët e fuqisë së All'llahut në botën e ekzistencës dhe nuk i dëgjuan fare fjalët e Pejgamberëve të All'llahut.

Këta besojnë në vendimin e logjikës, të syrit që shikon dhe veshit që dëgjon. Por ata nuk e pranuan faktin se është All'llahu Ai që ua ka dhuruar këto cilësi shqisave njerëzore, nuk arritën të

besonin në argumentet e All'llahut. Sa fort e meritojnë ata dënimin e dhimbshëm, kurse besimtarët Xhennetin e begatë!

Më e rëndësishmja është se shpirti i besimtarëve shpërblehet me begati të përhershme dhe të bollshme. Kjo kuptohet nga thënia: **"që në to janë përgjithmonë, premtimi i All'llahut është i prerë"** dhe se All'llahu i Madhërueshëm nuk bën premtim të rremë. All'llahu i Madhërueshëm gjithnjë i mban premtimet e Tij: **"E Ai është i Gjithëfuqishmi, i Urti."**.

Po ka një çështje që duhet qartësuar. Kjo çështje lidhet me dënimin e merituar të mendjemëdhenjve. Kur bëhet fjalë për dënimin e mendjemëdhenjve, fjala përdoret në trajtën e njëjësit, kurse kur flitet për shpërblimet që fitojnë besimtarët që bëjnë vepra të mira, përdoret fjala *"Xhennatun"* – *"Xhennetet"*, pra, në formën e shumësit. Kjo tregon se mëshira e All'llahut është më e gjerë se zemërimi i Tij.

Garancia e përjetësisë dhe premtimet e All'llahut janë të vërteta dhe të përjetshme që përforcojnë gjerësinë e madhe të mëshirës së All'llahut dhe që është më e madhe se zemërimi.

Koncepti për begatinë është i gjerë dhe gjithpërfshirës. Në të futen të gjitha llojet e begative materiale dhe shpirtërore. Përfshihen deri edhe ato mirësi që ne nuk mundemi t'i konceptojmë. Begatia është një mirësi e madhe.

Hulumtime

1- Ndalimi i të kënduarit *(el ginau)*

Të kënduarit, në një kuptim të përgjithshëm, është i ndaluar mes dijetarëve shiitë. Kjo arrin deri në kufijtë e konsesusit *(ixhmait)*.

Shumë prej dijetarëve ithtarë të traditës Profetike e kanë konfirmuar këtë ndalim, edhe pse një pjesë e tyre kanë përjashtuar disa çështje. Një pjesë e tyre nuk konsiderohet përjashtuese. Përkundrazi, ato konsiderohen të jashtme si për nga tema, ashtu edhe për nga subjekti i të kënduarit.

Kurtubijju, në fund të ajeteve që po komentojmë në këtë kapitull, thotë se është i ndaluar të kënduarit që i jep rëndësi pasionit, erotikës e paturpësisë, të kënduarit që përmend femrat dhe përshkrimin e bukurive të tyre, që përmend pijet alkolike dhe gjërat e ndaluara. Pra, konsiderohet e pëlqyeshme ajo që është e mirë, e pëlqyeshme. Lejohet pak prej saj në momentet e gëzimit, si p.sh.: kur martohet njeriu, në festa që stimulojnë punët e vështira etj. Të papëlqyera konsiderohen ata që kanë shpikur sufitët sot, prej narkomanëve e deri te dëgjimi i këngëve të tyre, që pa dyshim, janë haram, të ndaluara.[1].

Kurtubijju e ka sqaruar atë si përjashtim, siç u quajtën si përjashtim edhe poezitë e veçanta që i thonin myslimanët gjatë hapjes së kanalit të Hendekut. Kjo tregon se poezitë nuk kanë qenë këngë, por të ngjashme me poezitë të cilat i lexonin grupe

1 Tefsiri i Kurtubijjut, vëll. 7, f. 5136.

besimtarësh, që edhe mund t'i shoqëronin me ndonjë melodi të veçantë gjatë ecjeve apo mbledhjeve të asambleve fetare.

Në burimet islame ka shumë argumente që ndalojnë të kënduarit. Njëri prej tyre është ky ajet: **"Po ka nga njerëzit që sajojnë tregime boshe"**. Në disa ajete të tjera nga Kur'ani tregohet se kënga është konsideruar prej konfirmimeve të tyre: Në një hadith nga Imam Sadiku, thuhet: **"dhe largohuni fjalës shpifëse"**,[1] se: *"fjala shpifëse është te kënga"*[2], **"edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm"**, [3] *"është kënga"*[4].

Në komentimin e këtij ajeti janë transmetuar shumë mendime nga Imam Bakiri, Sadiku dhe Riza *(Paqja qoftë mbi ta!)* të cilët kanë sqaruar se një nga konfirmimet që ka hadithi dhe që e bën të detyrueshëm dënimin e turpshëm është: *"Kënga, të kënduarit"*.[5]

Duke shtuar se në burimet islame edhe shumë transmetime të tjera e bëjnë të qartë ndalimin e këngës në formë të prerë:

Në një hadith të transmetuar nga Xhabir ibn Abdullah, nga Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Iblisi, shejtani ka qenë i pari që ka kënduar."*.[6]

1 Sure "El Haxhxh", ajeti 30.
2 "Uesailu Shia", vëll. 12, f. 225, kapitulli i ndalimit të këngës.
3 Sure "El Furkan", ajeti 72.
4 "Uesailush Shiia", vëll. 12, fq 225-227 dhe 231, kapitulli 99, kapitulli i ndalimit të këngës.
5 Burimi i mësipërm .
6 Burimi i mësipërm

Në një hadith tjetër thuhet nga Imam Sadiku *"Në shtëpinë që këndohet, nuk është e sigurtë nga tragjedia, edhe duatë nuk iu përgjigjen dhe as nuk futen në të melekët."*.[1]

Kurse në një hadith tjetër thuhet: *"...kënga trashëgon hipokrizinë dhe ndjek varfërinë."*.[2]

Në një hadith tjetër nga Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Këngëtarja është e mallkuar dhe ai që e shoqëron atë në këngë është i mallkuar. I mallkuar është dhe ai që ushqehet me atë që përftohet prej saj."*.[3]

Në librat e njohur të traditës Profetike janë transmetuar shumë mendime në lidhje me këtë aspekt. Njëri prej tyre është tregimi që transmetohet në "Ed Durr'rrul Menthur" nga një grup i madh prej muhadithave, nga i Dërguari më i nderuar *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në të cilin thuhet: *"Nuk është e lejuar mësimdhënia e këngëve dhe as blerja e tyre dhe çmimet. Vlerat e tyre janë haram."*.[4]

Edhe imam Ahmedi nga Tirmidhijju ka transmetuar të njëjtin kuptim.[5]

Transmeton ibn Mesudi nga Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Kënga, të kënduarit zhvillon hipokrizinë në zemër, ashtu siç i zhvillon uji perimet."*.[6]

1 Burimi i mësipërm.
2 Burimi i mësipërm.
3 "Sefijnetul Bihar", vëll. 2, f. 337.
4 Tefsiri "Ed Durrrrul Menthur", fundi i ajetit është burimi i komentimit.
5 Tefsiri "Et Taxh", vëll. 5, f. 287.
6 Tefsiri "Ruhul Meanij", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Transmetimet e përmendura në këtë kapitull janë të shumta. Ata arrijnë deri në kufirin e frekuencës. Për këtë arsye, shumica e dijetarëve e kanë dhënë fetvanë e tyre për t'i ndaluar ato. Duhet shtuar se edhe dijetarët e Shiave, bien dakord me këtë mendim. Përafërsisht, është transmetuar ndalimi i saj, edhe nga Ebu Hanife.

Kur e kanë pyetur Ahmedin, Imamin e njohur të synetit për këngët, ai ka thënë: ''*...ajo rrit hipokrizinë.*''.

Maliku, Imami i njohur i traditës Profetike, duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje ka thënë: ''*...atë e bejnë njerëzit e shthurur.*''.

Shafiu ka sqaruar se dëshmia e atyre që këndojnë, është e papranueshme dhe ky është një argument i shthurjes së tyre.

Është transmetuar nga shokët e Shafiut se ata gjithashtu, e kanë konsideruar fetvanë e Shafiut ndalim, në kundërshtim me atë që mendojnë një pjesë prej tyre.[1]

2- Çfarë është kënga?

Ne nuk përballemi me paradoksin e ndalimit të këngës. Por vështirësia është klasifikimi i temës, i subjektit të këngës dhe i zërit të mirë për të kënduar.

Është e padiskutueshme se nuk jemi kundër këngës, sepse vetë Kur'ani dhe ezani këndohen, thirren me zë të bukur.

Por a është këngë çdo zë që dridhet në fyt?

1 Burimi i mësipërm.

Ajo që pranohet nga seria e thënieve të Ehli Synetit është se këngë është çdo melodi dhe zë që të ekzalton dhe të përfshin në zbavitje dhe kotësi.

Në një shprehje tjetër thuhet: Këngë janë zërat dhe meloditë që i përshtaten vendeve të shthurjes dhe çoroditjes, dëfrimit dhe njerëzve që janë gjynahqarë dhe të shthurur.

Me një mënyrë tjetër të shprehuri, është thënë: Këngë i thuhet zërit, i cili vë në lëvizje forcat epshore tek njeriu.

Njeriu, në atë situatë, ndien sikur të ishte në krah të atij zëri dehës që të çon në shthurje seksuale. Kjo do të ishte shumë e përshtatshme.

Ka një çështje që meriton kujdes. Një pjesë e melodive ndonjëherë konsiderohen këngë dhe zbavitje e kotë në vetvete, sepse me përmbajtjen e tyre nxisin ndjenja dashurie dhe pasioni të prishur. Këto ndjenja shoqërohen me melodi dhe muzikë që kërcehet.

Meloditë ndonjëherë mund të prezantohen si këngë të ndjenjave të mira, si këndime të ajeteve kur'anore, si këngë për lutje dhe thirrje shpëtimi, por që shoqërohen me melodi të tilla që u ngjasojnë organizimeve, tubimeve të njerëzve të shthurur dhe të çoroditur. Edhe ajo është haram, e ndaluar në të dyja mënyrat, prandaj kini kujdes!

Por duhet sqaruar se për këngën përdoren dy kuptime: Një kuptim i përgjithshëm dhe një kuptim i veçantë. Kuptimi i përgjithshëm përfshin ata që u thanë më sipër lidhur me muzikën, tingujt, meloditë që vënë në lëvizje epshet, pasionet dhe i shkojnë përshtat tubimeve të shthurjes dhe çoroditjes.

Kurse kuptimi tjetër përdoret për çdo zë të mirë e të bukur. Sipas këtyre kuptimeve, këngët klasifikohen në këngë të lejuara dhe këngë të ndaluara.

Po ç'nënkuptohet me këngën e ndaluar? Kjo u sqarua më lart. Kurse me këngën e lejuar nënkuptohet zëri i bukur, i mirë, i cili nuk shkakton shthurje dhe çoroditje.

Ky argumentim nuk ka patur kundërshtime. Është normale që edhe për këngën të ketë kuptime të ndryshme si për të gjitha nocionet e tjera, siç është normale të ketë diskutime për to edhe në librat e jurisprudencës.

Këto që janë përmendur më lart kishin lidhje me këngën. Përdorimi i instrumenteve muzikore dhe ndalimi i tyre është një diskutim tjetër, që është jashtë këtij subjekti.

3-Filozofia e ndalimit të këngës

Lloji, kuptimi, tematika, zëri etj., për të cilat u dha sqarimi më lart, e bëjnë shumë të qartë synimin e ndalimit të këngës.

Po t'u hidhnim një shikim të shpejtë të dhënave të këngës, do të njihnim të këqijat që vijnë prej saj, si më poshtë:

E para: Zgjimi i dëshirës dhe thirrja për prishje të moralit

Eksperienca ka treguar se shumë prej njerëzve nën efektin e muzikës dhe melodive të këngës e kanë lënë mënjanë rrugën e devotshmërisë dhe u janë drejtuar pasioneve dhe shthurjes.

Vendet ku këndohet, zakonisht, konsiderohen qendrat e shthurjes dhe të shkatërrimit. Ajo që i nxit këto të këqija është kënga.

Në media të ndryshme, herë pas here, rrëfehet për grupe të rinjsh e të rejash, që nën efektin e muzikës dhe të këngës kanë provuar provokime dhe sulme të pamoralshme.

Transmetohet në tefsirin e "Ruhul Meanij", një hadith për një nga komandantët e beni Umejes se ka thënë: Kini kujdes, ruhuni nga kënga, se ajo ju pakëson turpin dhe ju shton epshin, ju shkatërron burrërinë dhe zëvendëson alkoolin, ju bën të silleni njësoj siç bën edhe i dehuri.[1] Kjo e bën të qartë pse ata ishin të kujdesshëm për të këqijat që sjell ajo.

Në transmetimet islame thuhet se të kënduarit e rrit hipokrizinë. Kjo tregon edhe njëherë se shpirti i hipokrizisë është shpirti i papastër, i mbushur me shthurje dhe i larguar nga devotshmëria.

Nëse në transmetime thuhet se melekët nuk hyjnë në shtëpinë që ka këngë, kjo është për shkak të përlyerjes dhe shthurjes, sepse melekët janë të pastër dhe kërkojnë të mos përlyhen duke hyrë në ato ambiente.

Së dyti: Pavëmendshëmria ndaj përmendjes së All'llahut

Në disa transmetime islame thuhet se kënga dhe zbavitja e bëjnë njeriun skllav dhe të dehur nga pasionet, aq sa të hutohet ndaj përmendjes së All'llahut.

1 Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 21, f. 60 .

Në ajetet e mësipërme kemi lexuar se *"tregimet boshe"* ishin një nga faktorët e humbjes së rrugës së All'llahut dhe meritimit të dënimit të dhimbshëm.

Në një hadith nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"Distancimi nga përmendja e All'llahut vjen prej kumarit."*[1], domethënë nën efektin e kumarit.

Së treti: Dëmtimi i sitemit nervor

Kënga dhe muzika luajnë edhe rolin e anestezisë, të dehjes, të dëmtimit të nervave, pothuaj njësoj si heroina.

Kënga dhe muzika vokaliste mund t'i trullosin njerëzit, aq sa t'i ngjajnë një të dehuri, prandaj thuhet se shumë prej të këqijave të drograve janë të pranishme në këngë.

Prandaj muzikantët e famshëm bëjnë shumë kujdes kur krijojnë këngë, që të jenë të qarta. Ata janë përballuar me fatkeqësi dhe përplasje psikologjike gjatë jetës së tyre. Disa prej tyre kanë provuar edhe sëmundje psikologjike, disa kanë humbur ndjenjat dhe kanë shkuar në çmendinë dhe disa të tjerë kanë provuar paralizë dhe dobësi të thellë, infarkte etj.[2]

Si përfundim, thuhet se efektet shkatërruese të këngës dhe të muzikës mund të shkaktojnë psikopati dhe mund të ndikojnë edhe në punën e zemrës, në rritjen e presionit të gjakut etj.

Statistikat e kohës sonë tregojnë se numri i vdekjeve të papritura, në krahasim me të kaluarën, është shtuar shumë. Për

1 "Uesailush Shiia", vëll. 12, f. 235.
2 Efekti i muzikës tek shpirti dhe nervat, f. 26.

këto vdekje kanë përmendur shkaqe të ndryshme. Një prej këtyre shkaqeve ishte kënga dhe muzika.

Së katërti: Kënga është një nga metodat e kolonizimit

Kolonizuesit e botës kanë gjithmonë frikë nga zgjimi i popujve, e sidomos nga rinia. Prandaj, një nga programet e tyre për të ruajtur kolonizimin e tyre kanë shfrytëzuar tërheqjen e shoqërive në hutime dhe injorancë, në dëfrime shkatërruese.

Politikat kolonizuese përpiqen të krijojnë qendra dhe klube bixhozi e kumari, muzikore e shthurjeje, për të droguar e për të shushatur mendjet njerëzore. Dhe muzika qëndron në radhët e para të këtij manipulimi.

Ajetet: 10 – 11

خَلَقَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ بِغَيۡرِ عَمَدٖ تَرَوۡنَهَاۖ وَأَلۡقَىٰ فِي ٱلۡأَرۡضِ رَوَٰسِيَ أَن تَمِيدَ بِكُمۡ وَبَثَّ فِيهَا مِن كُلِّ دَآبَّةٖۚ وَأَنزَلۡنَا مِنَ ٱلسَّمَآءِ مَآءٗ فَأَنۢبَتۡنَا فِيهَا مِن كُلِّ زَوۡجٖ كَرِيمٖ ١٠ هَٰذَا خَلۡقُ ٱللَّهِ فَأَرُونِي مَاذَا خَلَقَ ٱلَّذِينَ مِن دُونِهِۦۚ بَلِ ٱلظَّٰلِمُونَ فِي ضَلَٰلٖ مُّبِينٖ ١١

"Ai i krijoi qiejt pa shtylla, sikurse po i shihni e në Tokë vendosi kodra të rënda që të mos luajë vendi, bashkë me ju e nëpër të shpërndau nga të gjitha gjallesat, dhe nga qielli Ne kemi lëshuar shi e kemi bërë të mbijnë në të nga të gjitha çiftet më të dobishme."

"Kjo është vepër e krijimit të All'llahut, e më tregoni pra Mua se ç'krijuan ata të tjerët pos Tij... Jo, asgjë, pra, idhujtarët janë në humbje të pafund."

Komentimi

Ky është krijimi i All'llahut

Argumentet e Teuhidit janë nga shtyllat më të rëndësishme të besimit. Kjo theksohet në të gjithë ajetet që komentuam, si dhe në ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë tregon për pesë pjesë të krijesave të All'llahut. Ata lidhen me njëra-tjetrën me një lidhje të fortë që nuk ndahet. Dhe janë: Krijimi i qiellit dhe ekzistenca e planeteve të lidhuara në hapësirë. Krijimi i maleve që mbajnë të palëvizur Tokën. Krijimi i gjallesave. Uji dhe bimët janë ushqim. Për këtë, ajeti thotë: **"Ai i krijoi qiejt pa shtylla, sikurse po i shihni..."**.

Fjala *''el amedu''* është shumësi i fjalës *''amudun''* dhe këtu përdoret për të treguar se qielli qëndron pa shtylla mbajtëse: **"...sikurse po e shihni"**. Ky është një argument se qielli nuk ka shtylla të dukshme që ta mbajnë. Në fakt, punën e shtyllës mbajtëse e kryen ligji i tërheqjes, por që nuk është i kapshëm nga shikimi. Në komentimin e sures ''Rra'd'' flitet për ligjin e tërheqjes, i cili duket si shtyllë shumë e fortë, vetëm se ai nuk është i dukshëm dhe i ruan trupat qiellorë.

Hysejn ibn Khalid, në një hadith, tregon se Imam Aliu ibn Musa Ridha *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"I Madhëruar qoftë All'llahu. A nuk thotë All'llahu:* **"...pa shtylla, sikurse po e**

shihni..."*? Posi, - tha ai, - pastaj i ka vënë shtylla, mirëpo ju nuk mund t'i shihni ato..."*.[1]

Fjalia e mësipërme është një nga mrekullitë shkencore të Kur'anit të lavdishëm. Rreth kësaj mrekullie kemi përmendur shumë detaje në fundin e ajetit 2, të sures ''Rra'd'' .

Më pas, ajeti flet për qëllimin e krijimit të maleve: **"...e në Tokë vendosi kodra të rënda që të mos luajë vendi bashkë me ju."**.[2]

Si ky ajet ka shumë shembuj të tillë në Kur'an që e bëjnë të qartë se malet e bëjnë Tokën të qëndrueshme. Kjo e vërtetë është vërtetuar sot nga ana shkencore.

Rrënjët e tyre janë të lidhura me njëra–tjetrën. Ata janë si mburojë e fortë që ruajnë rruzullin e Tokës nga presionet e brendshme të saj. Sikur të mos ishin malet, tërmetet do të ishin tejet shkatërruese.

Ky zinxhir i maleve, i mirëllogaritur, përballon forcën e madhe tërheqëse të Hënës dhe të Diellit. Po të mos ekzistonin këto forca balancuese, do të ndodhnin tërheqje dhe zgjatime të mëdha në koren e Tokës, më të forta se baticat dhe zbaticat e deteve dhe do ta bënin jetën e njeriut të pamundur.

Masivet malore qëndrojnë si diga para shtrëngatave dhe erërave të forta dhe zbusin përplasjet e forta të ajrit me Tokën. Toka rrotullohet rreth vetes në limitin e lejuar. Po të mos ishin

1 Tefsiri "El Burhan", vëll. 2, f. 278.
2 Folja *"temidu"* është nga *"el mejdu"* dhe domethënë: tronditja e gjërave dhe detyrimi i tyre me një detyrim të madh. Fjalia **"të mos luajë vendi bashkë me ju"** vjen në një vlerësim: me qëllim që të mos luajë bashkë me ju.

malet, sipërfaqja e Tokës do të ishte si shkretëtirat e thata, e ekspozuar ndaj uraganeve dhe cikloneve shkatërruese ditë e natë.[1]

Pas përmendjes së mirësisë së stabilizimit të qiellit me shtylla tërheqëse, stabilizimi i Tokës nëpërmjet maleve, është mirësi e All'llahut.

Tani vjen radha e krijimit të gjallesave dhe e stabilizimit të tyre. Gjallesat stabilizohen aq sa mund të vendosin këmbët e tyre në një oqean të qeta e të sigurta. Për këtë thuhet: **"...e nëpër të shpërndau nga të gjitha gjallesat."**.

Shprehja: **"nga të gjitha gjallesat"** është tregues i larmisë së jetës së gjallesave. Ato janë të shumëllojshme dhe të larmishme, duke filluar nga qëniet e gjalla mikroskopike e deri te kafshët gjigande dhe të frikshme, e po kështu, edhe kafshët me ngjyra dhe përmasa të ndryshme që jetojnë në ujë dhe në ajër, shpendët, zvarranikët dhe insektet me përmasa të ndryshme. Secila prej këtyre gjallesave ka botën e vet të veçantë. Këto janë në vetvete qindra mijëra argumente të Krijuesit.

Këto kafshë kanë nevojë për ujë dhe ushqim. Fjalia që vjen, e sqaron këtë temë duke thënë: **"...dhe nga qielli Ne kemi lëshuar shi e kemi bërë të mbijnë në të nga të gjitha çiftet më të dobishme."**.

Ajeti sqaron bazën e jetës së të gjitha kafshëve, e sidomos *njeriut*; sqaron se si formohen bimët dhe uji, sqaron se Toka mund të konsiderohet një sofër e gjerë me ushqime të larmishme

1 Për më tepër lexim rreth dobive të maleve, përsërit fundin e ajetit 3 të sures "Rra'd".

dhe e përshtatshme për çdo lloj gjallese. Këto tregojnë Madhështinë e Krijuesit.

Tani do të sqarojmë çështjen e zbritjes së shiut dhe mbirjes së bimëve: **"Ne zbritëm nga qielli shi dhe Ne i bëmë që të mbijnë bimët në Tokë."**.

Zbritja e shiut dhe mbirja e bimëve janë të dyja argumente të një rëndësie të veçantë.

Ky ajet tregon për çështjen e çiftëzimit në botën e bimëve. Ajo është prej mrekullive shkencore të Kur'anit. Çiftëzimi në botën e bimëve nuk ka qenë i vërtetuar në atë kohë në një mënyrë të zgjeruar, por Kur'ani e sqaroi edhe këtë çështje. Për një analizë më të thellë për këtë çështje, ju mund të përsëritni fundin e ajetit të 7 të sures ''Esh Shuara''.

Përshkrimi i llojeve të bimëve me fjalën *"kerim"*, është një tregues gjithëpërfshirës i llojeve të dhuratave të të Madhërishmit.

Pas përmendjes së Madhështisë së All'llahut në botën e Krijimit dhe shumëllojshmërisë së krijesave, ajeti e drejton bisedën drejt idhujtarëve dhe i bën ato objekt pyetjeje dhe hetimi dhe thotë: **"Kjo është vepër e Krijimit të All'llahut! Më tregoni, pra, çfarë krijuan ata të tjerët pos Tij?!"**.

Ata nuk kishin asnjë mundësi të tregonin për krijimin e statujave. Prandaj, ata pohonin me gojë për Njehsimin e Krijuesit. Kështu përpiqeshin ta justifikonin idhujtarinë në adhurim?! Njehsimi i Krijuesit është një argument i Teuhidit të Zotit dhe i të qënurit kontrollues i vetëm i botës. Ai është një argument i Teuhidit të adhurimit.

Prandaj ajeti e ka konsideruar punën e tyre të padrejtë dhe humbëse dhe ka thënë: **"...jo, asgjë, pra, idhujtarët janë në një humbje të pafund."**.

Dihet se fjala *"edh dhulmu"* – *"padrejtësia"*, tregon se asgjë nuk ishte vendosur në vendin e vet. Kur idhujtarët e lidhnin adhurimin dhe kontrollin e botës ndonjëherë edhe me putat, bënin padrejtësinë më të madhe dhe humbjen e pafundme. Kjo mënyrë të shprehuri është një tregues i lidhjes së "padrejtësisë" dhe "humbjes". Kur njeriu nuk e di pozitën e krijesave në botë, ose e di, por nuk kujdeset për to, kur nuk e shikon çdo gjë në vendin e vet, kjo padrejtësi, do të bëhet shkaktare e humbjes së pafund.

Ajetet: 12 – 15

وَلَقَدْ ءَاتَيْنَا لُقْمَـٰنَ ٱلْحِكْمَةَ أَنِ ٱشْكُرْ لِلَّهِ ۚ وَمَن يَشْكُرْ فَإِنَّمَا يَشْكُرُ لِنَفْسِهِۦ ۖ وَمَن كَفَرَ فَإِنَّ ٱللَّهَ غَنِىٌّ حَمِيدٌ ﴿١٢﴾ وَإِذْ قَالَ لُقْمَـٰنُ لِٱبْنِهِۦ وَهُوَ يَعِظُهُۥ يَـٰبُنَىَّ لَا تُشْرِكْ بِٱللَّهِ ۖ إِنَّ ٱلشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ ﴿١٣﴾ وَوَصَّيْنَا ٱلْإِنسَـٰنَ بِوَٰلِدَيْهِ حَمَلَتْهُ أُمُّهُۥ وَهْنًا عَلَىٰ وَهْنٍ وَفِصَـٰلُهُۥ فِى عَامَيْنِ أَنِ ٱشْكُرْ لِى وَلِوَٰلِدَيْكَ إِلَىَّ ٱلْمَصِيرُ ﴿١٤﴾ وَإِن جَـٰهَدَاكَ عَلَىٰٓ أَن تُشْرِكَ بِى مَا لَيْسَ لَكَ بِهِۦ عِلْمٌ فَلَا تُطِعْهُمَا ۖ وَصَاحِبْهُمَا فِى ٱلدُّنْيَا مَعْرُوفًا ۖ وَٱتَّبِعْ سَبِيلَ مَنْ أَنَابَ إِلَىَّ ۚ ثُمَّ إِلَىَّ مَرْجِعُكُمْ فَأُنَبِّئُكُم بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٥﴾

“Ne i patëm dhënë Lukmanit urtësi të përsosur (e i thamë)**: ‘Ta falënderosh All’llahun, e kush falënderon, e mira e atij falënderimi i takon atij; e kush refuzon** (edhe ai e ka për vete)**, në të vërtetë, All’llahu nuk ka nevojë** (për falënderimin e tij) **sepse Ai Vetë është i Lavdishëm.’”**

"(Përkujtoju popullit tënd) **kur Lukmani duke e këshilluar, birit të vet i tha: 'O djali im, mos i përshkruaj All'llahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe!'"**

"Ne njeriun e kemi urdhëruar (për sjellje të mira) **ndaj prindërve të vet, sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mundi dhe pas dy vitesh, ia ndau gjirin.** (E porositëm) **të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj prindërve të tu, pse vetëm tek Unë është kthimi juaj!"**

"E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrëfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre! E ti, ndiqe rrugën e atij që është kthyer kah Unë, mandej kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t'ju njoftoj për atë që keni punuar."

Komentimi

Respekti i prindërve

Për të plotësuar diskutimet e mëparshme rreth Teuhidit dhe idhujtarisë, për të plotësuar dhe kuptuar sa më mirë rëndësinë e madhështinë e Kur'anit dhe urtësinë e përdorur dhe ndjekur në këtë Libër qiellor, në këto ajete përmendet Lukmani i urtë dhe disa këshilla të rëndësishme të tij. Ato këshilla forcojnë monoteizmin dhe luftojnë idhujtarinë (vënies shok All'llahut).

Gjithashtu, janë reflektuar çështje të rëndësishme morali në këshillat e Lukmanit për të birin e tij.

Këto dhjetë këshilla, të cilat janë përmendur brenda gjashtë ajeteve, kanë sqaruar në mënyrë të shkëlqyer çështjet e besimit, duke shtuar edhe bazat e detyrimeve fetare dhe të moralit.

Do të diskutojmë në vijim se kush është Lukmani dhe çfarë veçorish kishte ai. Ajo që përmendim këtu, tregon se ai nuk ka qenë Pejgamber, madje ka qenë njeri i ditur dhe i edukuar që pati triumfuar në luftën ndaj pasionit të egos dhe të nefsit. Ai ishte prej atyre që All'llahu shpërtheu në zemrën e tij burimet e diturisë dhe urtësisë.

Për pozitën e lartë të Lukmanit mjafton ajo që All'llahu i ka shoqëruar këshillat e tij me fjalët e Tij, në shtresat kuptimore të ajeteve të Kur'anit. Kur zemra e njeriut ndriçohet me dritën e urtësisë, me pastërtinë dhe devotshmërinë, fjala në ligjërimin e tij thotë atë çka thotë All'llahu dhe mendon në atë mënyrë që kënaq All'llahun.

Pas këtij sqarimi të shkurtër, rikthehemi në komentimin e ajeteve:

Ajeti i parë thotë: **"Ne i patëm dhënë Lukmanit urtësi të përsosur** (e i thamë)**: Të falënderosh All'llahun, e kush falënderon, e mira e atij falënderimi i takon atij, e kush refuzon** (edhe ai e ka për vete)**, në të vërtetë, All'llahu nuk ka nevojë** (për falënderimin e tij) **sepse Ai Vetë është i Lavdishëm."**.[1]

1 Ka një diskutim mes komentuesve në atë që a gjendet aludim në fjalinë **"që të falënderosh All'llahun"** apo jo? Disa besojnë se para fjalisë **"i thamë atij"** ka

Çfarë është urtësia?

Në hadithin për urtësinë ata kanë përmendur shumë kuptime për të, si: dituria e sekreteve të botës së ekzistencës dhe gjithpërfshirja; dituria për të vërtetat e Kur'anit, arritja drejt së vërtetës nëpërmjet fjalës dhe veprës dhe njohja e All'llahut.

Të gjitha këto kuptime mund të bashkohen në një përkufizim të vetëm, sepse urtësia për të cilën flet Kur'ani, të cilën All'llahu ia pat dhënë Lukmanit, është një tërësi, një sistem njohurish, diturish dhe moralesh të pastra devotshmërie, drite dhe udhëzimi.

Thuhet se Imam Musa ibn Xhaferr *(Paqja qoftë mbi të!)* i ka thënë Hisham ibn Hakemit nëlidhje me komentimin e këtij ajeti: *"...urtësia është të kuptuarit dhe të logjikuarit."*[1]

Kurse në një hadith tjetër Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, në komentimin e këtij ajeti ka thënë: *"I është dhënë dituria e Imamit, prijësit të kohës së tij."*[2]

Është e qartë se secila prej këtyre nocioneve konsiderohet një nga nëndegët e kuptimit të gjerë të urtësisë dhe nuk ka kontradiktë mes tyre.

Lukmani i urtë e falënderonte All'llahun. Ai e dinte qëllimin e këtyre të mirave të Zotit. Ai dinte edhe përfitimet prej tyre. Ai e vendoste urtësinë në përdorim me përpikëri dhe drejtësi

---

aludim, kurse disa thonë: nuk ka nevojë për aludim dhe se *"enne"* në fjalinë *"që të falënderosh"* është sqaruese, sepse vetë falënderimi është urtësi dhe vetë urtësia është falënderim. Secili prej dy komentimeve mund të pranohen.

1 "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 13, (libri i logjikës dhe injorancës) hadithi 12 .

2 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 196 .

të plotë, e vinte në vendin e saj të përshtatshëm për të vërtetuar qëllimin për të cilin është krijuar. Kjo është urtësia! Vendosja e çdo gjëje në vendin e vet. Falënderimi dhe urtësia i referohen një pike të vetme.

Në këto ajete është bërë i qartë rezultati i falënderimit dhe i mohimit të mirësive. Falënderimi për mirësitë është në të mirë të njeriut, kurse mohimi i mirësisë do jetë shkaku i humbjes së tij. All'llahu i Madhëruar nuk ka nevojë për askënd. Edhe sikur të gjitha gjallesat ta falënderonin Atë, asgjë nuk do t'i shtohej Madhështisë së Tij; edhe sikur të gjitha gjallesat ta mohonin Atë, asgjë nuk do t'i pakësohej Madhështisë së Tij!

Fjala *"lam"* në fjalinë: **"të falënderosh All'llahun"** është përdorur me kuptimin e veçimit. Dhe *''lami"* në frazën *"li nefsihi"* **– "për veten e tij"** është me kuptimin e dobisë. Mbi këtë bazë, falënderimi, vazhdimi i mirësisë dhe shtimi i saj janë të dobishme. Edhe sevapi i Ahiretit, edhe dëmi i mohimit i referohen njeriut që i kryen ato.

Shprehja: **"Ai është Vetë i lavdishëm"** tregon se falënderimi i njerëzve ndaj personave të zakonshëm është i dobishëm për atë që falënderon, sepse ndoshta ndikon në shtimin e pozitës së autorit në opinionin e njerëzve. Këto falënderime nuk kanë asgjë të njëjtë me falënderimet ndaj All'llahut, sepse All'llahu nuk ka nevojë për asgjë nga ne, nuk ka nevojë për asgjë tonën. Ai i meriton të gjitha falënderimet dhe lavdërimet e të gjitha gjallesave, përfshirë edhe melekët.

Falënderimi i përmendur në formën e kohës së tashme tregon vazhdimësinë, kurse mohimi është përmendur në formën

e kohës së shkuar dhe tregon se nëse mohon, qoftë edhe një herë të vetme, mund që të përballesh me dënime të dhimbshme. Falënderimi është i nevojshëm. Ai duhet që të jetë i vazhdueshëm në udhën e njeriut drejt përsosjes.

Ajeti që pason, tregon këshillat e Lukmanit për të birin. Ai thotë: **"O djali im, mos i përshkruaj All'llahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe..."**.

Urtësia e Lukmanit shfaqet edhe kur trajton çështjet më të rëndësishme, siç është çështja e Njehsimit të Teuhidit në të gjitha aspektet dhe dimensionet. Çdo shmangie nga drejtimi i Zotit buron nga idhujtaria, nga adhurimi i dynjasë, nga pasionet e ndryshme etj., të cilat konsiderohen degë të idhujtarisë.

Esenca e të gjitha lëvizjeve të vërteta është Teuhidi, është orientimi drejt All'llahut, bindja ndaj urdhëresave të Tij, largimi nga të tjerët dhe thyerja e të gjithë putave në hapësirën e Madhështisë së Tij.

Lukmani i urtë u bë shkaku i ndalimit të idhujtarisë. Idhujtaria është një padrejtësi e madhe që konfirmohet nga shumë drejtime.[1]

Idhujtaria është padrejtësia më e madhe. Ajo i bën krijesat të mos kenë asnjë vlerë tek All'llahu. Idhujtaria i tërheq njerëzit drejt humbjes dhe devijimit, ua errëson shikimet dhe i nxit drejt devijimeve me veprat e tyre. Idhujtarët e shkatërrojnë edhe veten e tyre, sepse janë në pozitën më të ulët të përbuzjes e të dënimit.

1 Si parashtesa *"enne"* ashtu edhe *"lam"* dhe të qënurit e fjalisë emërore janë prej instrumenteve të konfirmimit, forcimit.

Dy ajetet që vijnë më pas janë fjali kundërshtuese që All'llahu i Madhërueshëm i ka përmendur në kontekstin e këshillave të Lukmanit. Mirëpo ky kundërshtim nuk do të thotë mungesë e lidhjes apo e bashkimit. Përkundrazi, do të thotë lidhje e qartë e fjalës së Lukmanit me Fjalën e All'llahut. Në këto dy ajete ka një komentim rreth mirësisë së ekzistencës së dy prindërve. Kush u qëndron prindërve pranë, ua zgjidh problemet dhe u shërben atyre, do të fitojë falënderimin e prindërve dhe falënderimin ndaj All'llahut.

Të dy prindërit përfshihen në këshillat e Lukmanit ndaj të birit. Lukmani, duke e porositur të birin, thotë: **"Ne njeriun e kemi urdhëruar për** (sjellje të mira) **ndaj prindërve të vet."** dhe në këtë rast na tregon përpjekjet dhe vështirësitë, lodhjet e mëdha të nënës dhe thotë: **"... sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mundi."**.

Kjo çështje është e vërtetuar nga ana shkencore. Eksperimentet kanë bërë të qartë se nënat në kohën e barrës, dobësohen dhe humbin fuqinë e tyre, sepse shpenzojnë energji për të ushqyer dhe rritur embrionin. Nënave gjatë kësaj faze u pakësohen vitaminat dhe ndiejnë lodhje më shumë se më parë.

Kjo gjendje vazhdon gjatë gjithë kohës së ushqyerjes me gji', sepse qumështi është esenca e qënies së nënës. Kjo gjendje vazhdon për dy vjet: **"...dhe pas dy viteve ia ndau gjirin"**. Kjo është treguar edhe në një vend tjetër të Kur'anit: **"Nënat le t'u japin gji fëmijëve të tyre dy vjet, për ata që duan t'ia plotësojnë**

dhënien e gjirit...".[1] Pra, nënkuptohet që koha e plotë e gjidhënies është dy vjet, por ndonjëherë mund të jetë më e shkurtër.

Nëna, gjatë 33 muajve të periudhës së shtatzanisë dhe të gjidhënies, bën sakrificën më të madhe për fëmijën e saj, si nga ana shpirtërore, ashtu edhe nga ana e shërbimeve dhe e ruajtjes.

Ajeti në fillim këshillon që të respektohen të dy prindërit, sepse të dy përballojnë sakrifica të panumërta për kujdesin dhe mirërritjen e fëmijës.

Pastaj thotë: **"Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve të tu..."**, pra: më falëndero Mua, sepse Unë jam Krijuesi yt dhe Begatuesi yt dhe të kam dhënë ty këto dy prindër të dhimbshëm e të mëshirshëm. Falëndero të dy prindërit e tu, sepse ata janë ndërmjetësit e këtij bollëku, se ata kanë marrë përgjegjësinë e çuarjes së mirësive të Mia tek ti. Sa bukur është që të falënderosh dy prindërit, dy shoqëruesit e falënderimit të All'llahut! E sa e thellë është domethënia e kësaj.

Me një theks që nuk largohet nga kërcënimi, qortimi dhe paralajmërimi, në fund të ajetit, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...pse vetëm tek Unë është kthimi juaj."**. Po, sepse vërtet, nëse ti e neglizhon këtë, atëherë do të japësh llogari për të gjitha këto të drejta, vështirësi dhe shërbime. Prandaj duhet që njeriu ta falënderojë me sa të mundet All'llahun për këto dhurata të mrekullueshme (prindërit) që i ka dhënë. Ky falënderim do ta shpëtojë atë në llogaridhënien e fundit.

Është përmendur kujdesi i prindërit dhe të drejtat e prindërve në Kur'an. Këshillimi për t'i kryer sa më mirë detyrat

1 Sure "El Bekare", ajeti 233.

ndaj dy prindërve mund të shihet me dyshim nga disa që mendojnë se fëmija e ka për detyrë atë kujdes. Mirëpo, ajeti që vjen më pas thotë: **"E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çfarë ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata!"**. Pra, nuk duhet që lidhja e njeriut me prindërit t'i paraprijë lidhjes së tij me All'llahun në mënyrë kategorike. Lidhjet familjare nuk duhet që të vendosin për besimin fetar.

Fjalia **"të dy tentojnë"** tregon se të dy prindërit e dëshirojnë lumturinë e fëmijës të tyre dhe përpiqen që ta bëjnë të lumtur duke e tërhequr atë drejt besimit të tyre të devijuar. Detyra e fëmijëve është që të mos dorëzohen kurrë para këtyre presioneve dhe të mbrojnë pavarësinë e mendimit, të mos bëjnë tregti me ideologjinë e Teuhidit, apo ta ndërrojnë atë me çdo gjë.

Fjalia **"për çfarë ti nuk ke kurrfarë fakti"** tregon se nuk duhet t'i injorojmë argumentet e pavërtetësisë së idhujtarisë. Besimtarët duhet të vërtetojnë se idhujtarët janë kokëfortë e kryeneçë dhe nuk kanë asnjë argument për ta vërtetuar idhujtarinë e tyre.

Por le të pranojmë për një moment se idhujtaria e ka një të vërtetë. Atëherë duhet të sjellë patjetër një argument për ta vërtetuar atë. Përderisa nuk ka asnjë argument për të vërtetuar të drejtën e supozuar pak më sipër, kjo, pa dyshim, është argument i pavërtetësisë.

Është diskutuar çështja kur dy prindërit janë idhujtarë dhe fëmijët nuk kanë respekt ndaj tyre. Për ta sqaruar këtë diskutim, ajeti nuk duhet të jetë një argument i prerjes së lidhjes me ata të

dy, e madje ajeti urdhëron e thotë: **"...po, në çështjet e jetës së kësaj bote të keshë mirëkuptim ndaj tyre."**.

Prandaj shoqëroji ata të dy dhe shprehi dashurinë dhe dhembshurinë në jetën e kësaj bote, por mos iu dorëzo mendimeve dhe propozimeve të tyre lidhur me besimin dhe përkatësinë fetare. **Kjo është pika kryesore e ekuilibrit dhe e drejtësisë,** e cila bashkon në një të drejtat e All'llahut dhe të prindërve. Prandaj shton më pas: **"...e ti ndiqe rrugën e atij që është kthyer kah Unë"**, sepse kthimi është vetëm tek Ai, i Madhërishmi: **"mandej kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t'ju njoftoj për atë që keni punuar."**.

Urdhëresat dhe ndalimet e vazhdueshme në ajetet e mësipërme janë për t'u treguar myslimanëve rrugën e drejtë edhe për çështje të tilla, për të cilat ka diskutime e kundërshti. Nëse do të ecin në rrugën që u tregon All'llahu i Madhëruar që e kanë para syve, kjo tregon përpikërinë dhe butësinë e Kur'anit.

Ajeti i mësipërm ngjan me atë që thuhet në ajetin 8 të sures ''Ankebut'', në të cilën thuhet: **"Ne e kemi urdhëruar njeriun që të sillet mirë me prindërve të vet, e nëse ata të dy përpiqen të të çojnë ty që të më përshkruash Mua shok** (zot tjetër) **për çfarë ti nuk di asgjë, atëherë ti mos i respekto ata! Kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t'ju njoftoj për atë që keni vepruar."**.

Dy hulumtime

1- Kush është Lukmani?

Emri "Lukman" është përmendur në dy ajete të Kur'anit dhe në këtë sure. Në asnjë rast nuk ka një argument të qartë nëse ai ka qenë Pejgamber apo jo. Metodologjia e Kur'anit, në lidhje me çështjen e Lukmanit, thotë se nuk ka qenë pejgamber. Në Kur'an, kur flitet për Pejgamberët, fjala sillet rreth mesazhit dhe thirrjes në Teuhid, rreth luftimit të idhujtarisë, rreth devijimeve të dukshme, rreth mungesës së kërkesës për shpërblim e pagesë. Po kështu, përgëzimi i popujve dhe paralajmërimi i tyre, në kohën kur asnjë prej këtyre çështjeve nuk është përmendur në lidhje me Lukmanin janë vetëm një seri këshillash, e në mënyrë të veçantë, këshillat për birin (pavarësisht kuptimit gjithëpërshirës të tyre). Ky është një argument që ka qenë vetëm një burrë i urtë.

Në një hadith nga i Dërguari *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Unë them se Lukmani nuk ka qenë pejgamber, por ka qenë një rob që meditonte shumë, një njeri me besim të mirë, që e donte All'llahun dhe All'llahu e donte atë dhe Ai i dhuroi atij hikmetin (urtësinë)."*.

Thuhet në disa komentime se Lukmani ka qenë një njeri me ngjyrë, nga Seudani i Egjiptit. Por ai, pas fytyrës së tij të zezë, kishe një zemër të ndriçuar e një shpirt të pastër, ishte i sinqertë në të folur, nuk e përziente amanetin me tradhti dhe nuk i fuste hundët aty ku nuk i interesonte.[1]

1 "Kisasul Kur'an", shpjegimi i situatave të Lukmanit.

Disa komentues e kanë supozuar Profetësinë e tij, mirëpo, siç thamë, nuk ka asnjë argument për këtë, madje kemi dëshmi të qarta për të kundërtën e saj.

Thuhet në disa transmetime se një person e pyeti Lukmanin: A ke qenë bari bashkë me ne? Ai tha: Po.

Po nga se të erdhi gjithë kjo dituri dhe urtësi?

Lukmani tha: Kjo dituri ishte kaderi, kryerja e amanetit, thënia e të vërtetës dhe heshtja për ato që nuk më interesojnë.[1]

Po kështu, thuhet edhe në fund të hadithit që e transmetuam nga i Dërguari *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Lukmani ishte duke fjetur në gjysmën e ditës kur i erdhi një thirrje: 'O Lukman, a dëshiron që All'llahu të të bëjë ty mëkëmbës që të gjykosh mes njerëzve me drejtësi?'''*.

Dhe iu përgjigj zërit: ''*Nëse Zoti im më zgjedh mua, do pranoja shëndetin e mirë, e nuk do pranoja fatkeqësinë dhe nëse e ka marrë vendimin për mua, atëherë e dëgjoj dhe bindem, sepse me të vërtetë, unë e di se nëse Ai ma bën mua atë, më ka ndihmuar dhe më ka mbrojtur.*''.

Melekët i thanë: "*Pa i parë ato? Përse, o Lukman?"*.

Lukmani tha: "*Sepse gjykimi është nga çështjet më të vështira e më me kurthe. Nëse do të gjykosh me drejtësi, do të shpëtosh nga dënimi; nëse gabon, ke gabuar rrugën e Xhennetit. Kush është i përulur në dynja, i përbuzur në Ahiret, ai është një fisnik. Është më mirë për të se sa të jetë fisnik në dynja e i përbuzur në Ahiret. Kush e zgjedh dynjanë para Ahiretit, e merr dynjanë dhe nuk e fiton Ahiretin. Melekët u*

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajeteve në fjalë.

habitën nga logjika e tij e mirë dhe pastaj bëri një sy gjumë dhe iu dha urtësia.”.[1]

2- Portrete nga urtësia e Lukmanit

Një pjesë e komentuesve kanë përmendur një pjesë nga fjalët e mençura të Lukmanit që i kanë marrë nga këshillat për të cilat u fol në ajetet e kësaj sureje. Do të përmendim shkurtimisht disa prej tyre:

a) Lukmani i thoshte birit të tij: *“O biri im, me të vërtetë, s’ka dyshim se dynjaja është një det i thellë dhe në të janë shkatërruar shumë botë, prandaj drejtoje anijen tënde duke besuar në All’llah! Bëje velën e anijes tënde të mbështetet tek All’llahu: bëje forcën tënde të frymëzohet nga devotshmëria ndaj All’llahut, sepse nëse shpëton, shpëton prej mëshirës së All’llahut dhe nëse shkatërrohesh, shkatërrohesh prej gjynaheve të tua!”*.[2]

Është përmendur i njëjti postulat në bisedën e Imam Kadhimit *(Paqja qoftë mbi të!)* me Hisham ibn Hakemin. Kjo bisedë është transmetuar nga Lukmani i urtë: *‘‘O biri im, s’ka dyshim se vërtetë kjo dynja është një det i thellë dhe është mbytur në të një botë e tërë. Pra, le të jetë anija jote devotshmëria ndaj All’llahut. Perifraza e saj është besimi, vela e saj është mbështetja tek All’llahu, majat e saj janë logjika, kurse argumenti i saj është dituria, e banorët e saj janë durimi.”*.[3]

1 Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 8, f. 316, fundi i ajetit në fjalë.

2 Burimi i mëparshëm.

3 “Usulul Kafij”, vëll. 1, f. 13 (kapitulli i logjikes dhe injorancës).

b) Kurse në një dialog tjetër me të birin rreth edukatës së udhëtimit, thotë:

''O biri im, udhëto me shpatën tënde, me devenë tënde, me çallmën tënde dhe tendën tënde, me celikun, perin dhe fëndyellin tënd dhe merr shumë furnizime me vete duke filluar që prej ilaçeve! Bëji të gjitha këto përgatitje që të jesh i dobishëm për shokët e tu, me të cilët duhet të jesh dakort, përveçse në se ata janë në kundërshtimin dhe në gjynahun ndaj All'llahut.

O biri im, nëse udhëton me një popull, atëherë këshilloji ata dhe ndihmoji në çështjet e tyre! Shtoje buzëqeshjen në fytyrat e tyre! Bëhu bujar me furnizimet e tua mes tyre! E nëse të ftojnë ty, përgjigju; e nëse të kërkojnë ty ndihmë, ndihmoji ata! Zgjate heshtjen gjatë namazit! Bëhu bujar me çfarë të kesh: kafshë, ujë apo furnizime të tjera! Nëse të kërkojnë që të dëshmosh për të vërtetën, atëherë dëshmo për të!

Përpiqu të japësh mendimin tënd. Nëse të kërkojnë këshillimin, mos merr vendim deri kur të jesh i sigurtë; mos u përgjigj në këshillë me nxitim! Përdore mendimin tënd, opinionin tënd dhe urtësinë tënde në mbledhjen e tij. Kush nuk tregon sinqeritetin e rezultatit të atij që ka kërkuar këshillë, All'llahu e deprivon atë nga mendimi i tij.

Nëse i shikon shokët e tu të ecin në këmbë, atëherë ec edhe ti bashkë me ta; nëse i shikon ata duke punuar, atëherë puno edhe ti bashkë me ta!

Dëgjoje atë që është më i madh se ti në moshë!

Nëse të urdhërojnë me diçka dhe të kërkojnë diçka, atëherë thuaj po dhe mos thuaj jo, sepse (jo-ja) është një dobësi.

O biri im, kur të vijë koha e namazit, mos e vono atë për asnjë gjë; fale atë dhe qetësohu prej tij, pasi ai është borxh!

Falu me xhemat, edhe nëse të kalojnë shigjetat mbi kokë.

Nëse mundesh që të mos hash ushqim derisa të japësh sadaka prej tij, atëherë bëje!

Duhet që ta lexosh Librin e All'llahut.''.[1]

c) Ka edhe një histori të famshme nga Lukmani. Kur ishte skllav, padroni i tij e ftoi dhe i tha: *''Më ther një dhi dhe më sill për të ngrënë pjesën më të mirë të saj! Ai e theri dhinë dhe i solli atij zemrën dhe gjuhën.*

Pas disa ditësh e urdhëroi atë që t'i therte një dhi tjetër dhe t'i sillte pjesën, organin më të keq. Ai e theri dhinë dhe përsëri i solli zemrën dhe gjuhën. Ai u habit shumë dhe e pyeti atë për këtë gjë. Lukmani i tha: Nëse pastrohen zemra dhe gjuha, ato të dyja janë më të mirat nga çdo gjë. Nëse nuk janë të pastra, janë më të këqijat se çdo gjë tjetër."[2]

E përfundojmë këtë diskutim me një hadith nga Imam Sadiku, i cili ka thënë: *"Lukmanit nuk i është dhënë urtësia për para' as për pasuri dhe as nga ndonjë mangësi në trup; nuk i është dhënë as për bukurinë. Ai ka qenë një burrë besimfortë në urdhrin e All'llahut, i ndriçuar nga All'llahu, i heshtur, i qetë, me shikim të thellë, largpamës në mendim, i fortë në shikim.*

Nrihej herët në mëngjes. Nuk mbështetej asnjëherë në një tubim, që është shenjë e mendjemëdhenjve. Ai nuk përbuzte asgjë dhe nuk ka çuar kurrë dëm diçka. Askush nga njerëzit nuk e ka parë kurrë duke

1 "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 13, libri i "logjikës dhe injorancës" dhe tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 318.

2 Tefsiri i "Bejdaviut" dhe tefsiri i "Tha'lebit", mirëpo është transmetuar në tefsirin "Mexhmaul Bejan" vetëm xhuzi i tij i parë.

urinuar, as duke marrë gusull, për shkak të mbulimit të tij të fortë dhe mbrojtjes së tij të mirë.

Nuk ka kaluar kurrë mes dy burrave që kanë qenë duke u grindur, por është afruar tek ata dhe i ka pajtuar. Nuk ka dëgjuar kurrë fjalë që i bënin qefin atij. Rrinte shumë me njohësit e fesë dhe dijetarët dhe mësonte nga dituritë e tyre. Ai luftonte që ta mundte veten, luftonte unin e tij, me pasionin e tij. Ai nuk shikonte vetëm atë që i interesonte, por gjithçka. Për të gjitha këto arsye, iu dha urtësia...".[1]

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 318, përmbledhje.

Ajetet: 16 – 19

يَـٰبُنَيَّ إِنَّهَآ إِن تَكُ مِثْقَالَ حَبَّةٍ مِّنْ خَرْدَلٍ فَتَكُن فِى صَخْرَةٍ أَوْ فِى
ٱلسَّمَـٰوَٰتِ أَوْ فِى ٱلْأَرْضِ يَأْتِ بِهَا ٱللَّهُ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ لَطِيفٌ خَبِيرٌ ﴿١٦﴾ يَـٰبُنَيَّ
أَقِمِ ٱلصَّلَوٰةَ وَأْمُرْ بِٱلْمَعْرُوفِ وَٱنْهَ عَنِ ٱلْمُنكَرِ وَٱصْبِرْ عَلَىٰ مَآ أَصَابَكَ ۖ
إِنَّ ذَٰلِكَ مِنْ عَزْمِ ٱلْأُمُورِ ﴿١٧﴾ وَلَا تُصَعِّرْ خَدَّكَ لِلنَّاسِ وَلَا تَمْشِ
فِى ٱلْأَرْضِ مَرَحًا ۖ إِنَّ ٱللَّهَ لَا يُحِبُّ كُلَّ مُخْتَالٍ فَخُورٍ ﴿١٨﴾ وَٱقْصِدْ فِى
مَشْيِكَ وَٱغْضُضْ مِن صَوْتِكَ ۚ إِنَّ أَنكَرَ ٱلْأَصْوَٰتِ لَصَوْتُ ٱلْحَمِيرِ ﴿١٩﴾

“O djali im, s’ka dyshim se edhe nëse ajo (vepra) **peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në Tokë, All’llahu do ta sjellë atë, se All’llahu është i butë dhe hollësisht i informuar.”**

“O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira, e ndalo nga të këqijat, përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të preferuara.”

"Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se All'llahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet."

"Të jesh i matur në ecjen tënde, ule zërin tënd, se zëri më i egër është zëri i gomarit."

Komentimi

Qëndro si mali dhe sillu mirë me njerëzit

Këshillat e para të Lukmanit kanë qenë për Teuhidin dhe luftimin e idhujtarisë, kurse këshillat e dyta për llogaritjen e veprave dhe Ringjalljen, të cilat plotësojnë hallkën e fillimit të krijimit dhe të Ringjalljes. Ai ka thënë: **"O djali im, s'ka dyshim se edhe nëse ajo** (vepra) **peshon sa kokrra e lirit, e të jetë fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në tokë, All'llahu do ta sjellë atë."** - domethënë në Ditën e Kiametit dhe e vendos aty për t'u llogaritur: **"...se All'llahu është i Butë dhe hollësisht i informuar."**.

Fjala *"el khardelu"* është një bimë që ka kokrra të zeza shumë të vogla. Shembulli me kokrrat e lirit tregon se veprat e mira dhe të këqija, sado të vogla të jenë, pa asnjë vlerë në dukje, sado të fshehta të jenë, si liri në brendësi të një guri në thellësitë e tokës apo në një cep të qiellit, pa dyshim se All'llahu i Butë është hollësisht i informuar për të gjitha krijesat, të vogla apo të mëdha qofshin, në të gjithë anët e botës. Ai do ta na i sjellë ata për t'na i

llogaritur për dënim apo shpërblim. Asgjë nuk humbet në këtë llogaridhënie.

Përemri te "*inneha*" i referohet të mirave dhe të këqijave, të bërit mirë dhe të bërit keq.[1]

Kjo njohje e plotë e All'llahut për njeriun, shënimi i veprave të tij të mira dhe të këqija në librin e veprave ku asgjë nuk humbet, është forcë për të bërë punë të mira dhe për t'u larguar nga punët e këqija.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: "*Kini frikë nga abuzimet, nga ofendimet, kini frikë prej gjynaheve që kryeni, sepse vërtetë ato të gjitha regjistrohen.*". All'llahu i Madhëruar thotë: **"...dhe i shkruajmë veprat; gjurmët e tyre dhe çdo gjë kemi regjistruar në librin e ruajtur** (Leuhi Mahfudh)**."**[2] dhe thotë Ai i Madhëruar: **"...s'ka dyshim se edhe nëse ajo** (vepra) **peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në tokë, All'llahu do ta sjellë atë, se All'llahu është i Butë dhe hollësisht i informuar."**. [3]

Lukmani depërton në punët më të rëndësishme (çështja e namazit) dhe thotë: **"O biri im fale namazin!"**, sepse namazi është lidhja më e rëndësishme me Krijuesin. Namazi ndriçon zemrën tënde dhe pastron shpirtin tënd nga gjurmët e gjynahut dhe hedh dritën e besimit në gjithë ekzistencën, në gjithë qënien tënde, të ndalon ty nga veprat e urryera dhe të këqija.

---

1 Disa kanë supozuar se përemri i mësipërm është përemri pozitës dhe tregimit, ose i referohet nocionit të idhujtarisë dhe secili prej dy supozimeve është larg.

2 Sure "Jasin", ajeti 12.

3 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 204.

Pas namazit, Lukmani zbatonte një kushtetutë të rëndësishme shoqërore, domethënë të urdhëruarit në të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja, dhe thotë: **"...urdhëro në punë të mira dhe ndalo të këqijat."**.

Pas këtyre urdhëresave praktike shumë të rëndësishme, ai kalon të çështja e durimit dhe e rrugës së drejtë dhe thotë: **"...përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të preferuara."**.

Dihet se ka shumë probleme dhe vështirësi në të gjitha veprat shoqërore, e sidomos në çështjen e urdhërimit në të mirë dhe të ndalimit në të keq. Është e pasdiskutueshme, gjithashtu, se ata që kanë interesa dhe autoritet, se kriminelët dhe egoistët nuk dorëzohen lehtë. Ata përpiqen të dëmtojnë sa të mundin me akuzat e tyre udhëzimin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja. Është i pamundur triumfi ndaj këtyre vështirësive dhe disavantazheve pa pasur durim, tolerancë dhe qëndrueshmëri në udhëzimin e drejtë.

Fjala *"el azmu"* përdoret me kuptimin *''dëshira arbitrare e fortë''* dhe mënyra e të shprehurit me *"azmul umuri"* e orienton këtë kuptim në veprat për të cilat All'llahu ka urdhëruar me një urdhër të konfirmuar, ose për çështjet dhe veprat që njeriu duhet t'i kryejë me shumë dëshirë dhe vendosmëri. Cilido kuptim që të përdoret, tregon rëndësinë e madhe të atyre veprave.

Përdorja e fjalës *"dhalike"* është treguese e durimit dhe e tolerancës, e cila mund t'u referohet të gjitha çështjeve dhe problemeve që u përmendën në ajetin e mësipërm. Njëri prej tyre është urdhërimi në të mirë dhe ndalimi në të keqen. Përdorimi në

disa ajete i kësaj fjale pas çështjes së durimit, forcon dhe mbështet supozimin e parë.

Pastaj Lukmani diskuton për çështjet e moralit që lidhen me njeriun, me nefsin dhe me egon. Në filim, këshillon që njeriu të tregojë respekt, të jetë gazmor dhe të mos jetë mendjemadh. Lukmani thotë: **"...dhe mos e shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve!"** – domethënë: mos i kundërshto njerëzit me fytyrën tënde, **"Mos ec nëpër Tokë kryelartë, se All'llahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet."**.

Fjala *"tusa'iru"* (تُصَعر) është nga lënda *"sa'are"* dhe përdoret me kuptimin e një sëmundjeje që godet devenë dhe shkakton përdredhjen e qafës së saj.

Kurse *"el merehu"* do të thotë kryeneçësia dhe mosmirënjohja që buron nga mirësia.

Fjala *"el mukhtalu"* emërton personin i cili e shikon veten e tij madhështor, si pasojë e fantazive dhe imagjinatës së tij.

Ndërsa *"el fukhuru"* quhet personi, i cili mburret ndaj të tjerëve.

Këto dy fjalë ndryshojnë nga njëra-tjetra. Fjala *''mukhtalu''* tregon njeriun që imagjinon veten e tij sikur është mendjemadh, kurse fjala *''fekhuur''* tregon veprat që vijnë pas veprimeve të një njeriu mendjemadh.

Mbi këto kuptime e ndërton shpjegimin e tij Lukmani i urtë. Me këto përdorime kuptimore ai tregon se është shumë i

dëmshëm dobësimi apo shkëputja e lidhjeve të vërteta shoqërore nga të qënit mendjemadh, nga vetëkënaqësia etj.

Njeriu i shëndoshë nga ana shpirtërore dhe personale nuk i shfaq në sjelljen dhe marrëdhëniet me njerëzit e tjerë mendjemadhësinë dhe vetëkënaqësinë.

Qëllimi i Lukmanit ishte luftimi i të gjitha fenomeneve të mendjemadhësisë dhe kryeneçësisë, të cilat shfaqeshin në marrëdhëniet shoqërore.

Lukmani, në ajetin pasues, tregon për dy sjellje të njerëzve të mirë përballë dy sjelljeve negative. Ai thotë: **"të jesh i matur në ecjen tënde"**, pra, të jesh i matur kur flet dhe kur ecën, dhe mos e ngri zërin: **"Ule zërin, se zëri më i egër është zëri i gomarit."**.

Këta dy ajete urdhërojnë për t'i patur këto dy cilësi të mira dhe për të mos i patur dy cilësitë negative.

Urdhërohet ndalimi i sjelljeve prej mendjemadhi dhe të vetëkënaquri, sepse njëra prej tyre e çon njeriun që të bëjë mendjemadhësi ndaj krijesave të All'llahut, kurse tjetra e çon njeriun deri aty sa të mendojë se ai është në shkallën e përsosjes dhe më lart se të tjerët. Si rrjedhim, do t'i mbyllen dyert e përsosjes në fytyrën e tij.

Pavarësisht se këto dy cilësi shpesh shoqërohen me njëra–tjetrën, ato kanë një origjinë të përbashkët. Ato duhet të ndahen nga njëra–tjetra.

Me fjalë të tjera, urdhërohemi të jemi të matur në fjalë, të matur në të ecur, të matur në ngritjen e zërit etj.

Njeriu që ndjek këto katër këshilla është i suksesshëm, i lumtur dhe i shpëtuar në jetë, është i dashur në mes të njerëzve dhe i dashur tek All'llahu.

Të gjithë e kemi provuar se të nxitosh në të folur, të nxitosh në të ecur, të flasësh me zë të lartë nuk janë sjellje të preferuara për njeriun. Ato i shqetësojnë të tjerët.

Disa komentues kanë thënë se të flasësh me ulërima në mes zërave të tjerë është sjellje e shëmtuar. Ulërimat janë sjellje e kafshëve.

Nëse vërejmë hadithet e ardhura nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* që e komentojnë këtë ajet me tështimën me zë të lartë, ose me të bërtiturit kur flitet dhe bisedohet, do të shohim se ky komentim është vërtetësi dhe konfirmim i qartë i asaj që u tha më lart.[1]

Hulumtime

1- Kultura e të ecurit

Të ecurit është një çështje e lehtë dhe e thjeshtë, por që reflekton karakterin e njeriut, gjendjen e brendshme sociale dhe morale të njeriut. Të ecurit mund të jetë përcaktuese edhe e vlerave të personalitetit të tij, sepse ana shpirtërore e morali i

1 "Mexhmaul Bejan", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

njeriut reflektohen në të gjitha veprimet e tij. Përderisa Islami i ka dhënë rëndësi çdo dimensioni të jetës, pa dyshim se nuk ka neglizhuar asgjë në këtë kapitull.

Në një hadith të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Kush ecën mbi sipërfaqen e tokës me mendjemadhësi atë e mallkon toka dhe çfarë ka nën të dhe sipër saj."*. [1]

Në një hadith tjetër nga Pejgamberi më i nderuar *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e ka ndaluar burrin të ecë me krenari. Ai ka thënë: *"Ai, i cili vesh një rrobë dhe mburret me të, All'llahu do ta zhysë atë në gropën e Xhehennemit dhe do jetë shoqërues i Karunit, sepse ai ka qenë i pari që është mburrur."*. [2]

Po kështu, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"All'llahu i Madhëruar e ka bërë të detyruar besimin ndaj organeve të trupit të të birit të Ademit; ia ka detyruar të dy këmbët që të mos ecin në diçka që është prej gjynaheve të All'llahut dhe ia ka detyruar atyre të ecurit drejt asaj që e kënaq All'llahun."*. I Lartësuari thotë: **"...dhe mos ec nëpër Tokë kryelartë"**. Dhe: **"të jesh i matur në ecjen tënde."**. [3]

Është transmetuar nga Pejgamberi i dashur i Islamit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se një ditë kur Ai po kalonte në një rrugë, pa një budalla. Rreth budallait ishin mbledhur plot njerëz duke e parë. Ai pyeti: *"Përse janë grumbulluar këta?"*. Njerëzit thanë: *"Për një budalla që e kap*

1 Theuabul A'mal dhe Amali i Sadukut, sipas transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 207.

2 Burimi i mëparshëm.

3 "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 28.

epilepsia". Pejgamberi shkoi drejt tyre dhe tha: "*Ky nuk është budalla! A t'ju tregoj se kush është budallai i vërtetë?*" Njerëzit thanë: "*Posi, o i Dërguari i All'llahut*". Dhe ai tha: "*Budalla është ai që është kryelartë në ecjen e tij, ai i cili shikon në supet e tij dhe ai që lëviz dhe shpatullat e tij. Ai, pra, është budallai, kurse ky është i sprovuar.*".[1]

2- Kultura e të folurit

Mënyrat e të folurit janë përmendur shumë në Islam dhe në këshillat e Lukmanit. Rreth tyre është bërë një diskutim i gjerë.

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, lidhur me kulturën e të folurit, thuhet: "*Heshtja është qetësimi i mendjes.*". [2]

E thënë me fjalë të tjera, kur njeriu nuk ka ndonjë dertyrim për të folur, heshtja është më e mirë.

Imam Aliu ibn Musa Rridha *(Paqja qoftë mbi të!)*, në hadithin e sjellë prej tij, thotë: "*Prej shenjave të kuptimit është dituria, ëndrra dhe heshtja. Heshtja është një derë prej dyerve të urtësisë.*".[3]

Në disa transmetime të tjera thuhet se nuk është e nevojshme për besimtarin që të heshtë kur është i domosdoshëm të folurit. Pejgamberët u dërguan me fjalë dhe jo me heshtje.

1 "Biharul Anuar", vëll. 26, f. 303 .

2 "Uesailush Shiia", vëll. 8, f. 530 dhe 532 .

3 Burimi i mëparshëm.

Mënyra e arritjes për në Xhennet, shpëtimi nga Zjarri bëhet përmes të folurit në vendin dhe kohën e përshtatshme.[1]

3- Kultura e shoqërimit

Transmetimet islame të përmendura nga Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Imamët e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)* i kanë dhënë rëndësi çështjes së përuljes dhe moralit të mirë, butësisë në sjellje, lënies së ashpërsisë e të qënurit i thatë në shoqërim. Një kujdes që i ka të pakët shëmbujt. Në kapitujt e tjerë argumentohet se dëshmitari më i mirë dhe më i qartë për këto janë transmetimet islame.

Këtu do të përmendim disa shembuj:

- Një njeri shkoi tek i Dërguari i All'llahut dhe i tha: O i Dërguari i All'llahut, më këshillo! Ai e këshilloi e i tha: *"Takoje vëllanë tënd me fytyrë të gëzuar!"*. [2]

Në një hadith tjetër nga Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Ditën e Kiametit nuk do të vihet në peshoren e një njeriu punë më e mirë sesa morali, sjellja e mirë."*.[3]

1 Burimi i mëparshëm.

2 "Biharul Anuar", vëll. 74, f. 171 .

3 "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 81 dhe 82 (kapitulli i moralit të mirë e pas saj).

Në një hadith tjetër nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"Sjellja e mirë dhe morali i mirë do të popullojnë shtëpiat dhe do të zgjasin jetët, vitet e jetës."*.[1]

Nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Shumica që do të hyjnë në Xhennet nga ymeti im janë ata, të devotshmit e All'llahut dhe me moral të mirë."*.[2]

Nga Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* në lidhje me çështjen e modestisë thuhet: *"Zbukurimi i fisnikut është të qënurit modest, i thjeshtë."*. [3]

Në fund lexojmë një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Modestia është origjina e çdo të mire me vlerë të lartë. Sikur modestia të kishte një gjuhë që ta kuptonin krijesat, ajo do të fliste për të vërtetat e asaj, do të tregonte për dënimet që bien mbi mohuesit e saj. Kush është modest ndaj All'llahut, All'llahu do ta nderojë atë mbi të gjithë robtë e Tij. Për All'llahun nuk ka adhurim që e pranon dhe kënaqet prej tij në qoftë se nuk kalon nëpër derën e së vërtetës, të modestisë dhe të të qënurit i përulur."*.[4]

1 Burimi i mëparshëm.
2 Burimi i mëparshëm.
3 "Biharul Anuar", vëll. 75, f. 120.
4 Burimi i mësipërm, f. 121 .

Ajetet: 20 – 24

أَلَمۡ تَرَوۡاْ أَنَّ ٱللَّهَ سَخَّرَ لَكُم مَّا فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِي ٱلۡأَرۡضِ وَأَسۡبَغَ عَلَيۡكُمۡ نِعَمَهُۥ ظَٰهِرَةٗ وَبَاطِنَةٗۗ وَمِنَ ٱلنَّاسِ مَن يُجَٰدِلُ فِي ٱللَّهِ بِغَيۡرِ عِلۡمٖ وَلَا هُدٗى وَلَا كِتَٰبٖ مُّنِيرٖ ٢٠ وَإِذَا قِيلَ لَهُمُ ٱتَّبِعُواْ مَآ أَنزَلَ ٱللَّهُ قَالُواْ بَلۡ نَتَّبِعُ مَا وَجَدۡنَا عَلَيۡهِ ءَابَآءَنَآۚ أَوَلَوۡ كَانَ ٱلشَّيۡطَٰنُ يَدۡعُوهُمۡ إِلَىٰ عَذَابِ ٱلسَّعِيرِ ٢١ ۞ وَمَن يُسۡلِمۡ وَجۡهَهُۥٓ إِلَى ٱللَّهِ وَهُوَ مُحۡسِنٞ فَقَدِ ٱسۡتَمۡسَكَ بِٱلۡعُرۡوَةِ ٱلۡوُثۡقَىٰۗ وَإِلَى ٱللَّهِ عَٰقِبَةُ ٱلۡأُمُورِ ٢٢ وَمَن كَفَرَ فَلَا يَحۡزُنكَ كُفۡرُهُۥٓۚ إِلَيۡنَا مَرۡجِعُهُمۡ فَنُنَبِّئُهُم بِمَا عَمِلُوٓاْۚ إِنَّ ٱللَّهَ عَلِيمُۢ بِذَاتِ ٱلصُّدُورِ ٢٣ نُمَتِّعُهُمۡ قَلِيلٗا ثُمَّ نَضۡطَرُّهُمۡ إِلَىٰ عَذَابٍ غَلِيظٖ ٢٤

"A nuk e dini ju se All'llahu nënshtroi për të mirën tuaj ç'ka ka në qiej e ç'ka në Tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta, e megjithatë prej njerëzve ka që polimezojnë çështjen e All'llahut duke mos pasur as dituri, duke mos qenë i udhëzuar dhe duke mos pasur Libër të ndritshëm."

"Dhe kur atyre u thuhet: 'Pasoni atë që e shpall All'llahu', ata thonë: 'Jo, ne ndjekim atë që gjetëm tek prindërit tanë!'. E edhe sikur djalli t'i kishte thirrur ata në dënimin e zjarrtë."

"E kush ia dorëzon veten All'llahut e duke qenë edhe punëmirë, ai është kapur për lidhjen më të sigurt dhe vetëm tek All'llahu është përfundimi i çështjeve."

"Ty mos të brengosë mosbesimi i atij që nuk beson, kthimi i tyre është vetëm tek Ne, e për atë që vepruan, Ne do t'u tregojmë. All'llahu vërtet është i dijshëm për atë që mbajnë në zemra."

"Ne u japim të jetojnë pak (në këtë botë)**, e pastaj i shtrëngojmë ata me një shtrëngim të rëndë."**

Komentimi

Pas përfundimit të dhjetë këshillave të Lukmanit rreth zanafillës, rreth Ditës së Kiametit dhe stilit të jetës, rreth planeve dhe programeve morale dhe shoqërore të Kur'anit, për të plotësuar diskutimin, ajetet orientohen drejt sqarimit të mirësive të All'llahut të Lartësuar që të ringjallë te njerëzit mirësinë e falënderimit. Ai do ta ringjallë atë falënderim, i cili buron nga

njohja e All'llahut dhe bindja ndaj urdhëresave të Tij.[1] Në këtë bisedë që ia drejton gjithë njerëzimit, Ai thotë: **"A nuk e dini ju se All'llahu nënshtroi për të mirën tuaj ç'ka ka në qiej dhe në Tokë..."**.

Gjithçka në tokë dhe në qiell janë krijuar prej All'llahut të Madhëruar dhe janë në dorën e Tij. All'llahu i Madhëruar i ka urdhëruar krijesat qiellore dhe tokësore që t'i nënshtrohen dhe t'i shërbejnë njeriut. Në bazë të kësaj, atëherë s'ka dyshim se të gjitha krijesat janë të nënshtruara me lejen e All'llahut në dobi të njerëzimit dhe për këtë s'ka dyshim. Shkronja *''lam''* tek *"lekum"* – *"juve"* tregon për dobi. [2]

Pastaj ajeti shton: **"...dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta"**.

Fraza *"esbega"* është nga lënda *"sebega"*. Ajo përdoret me kuptimin e rrobës ose të mburojës së gjerë e të plotë. Më pas u përdor për mirësitë e shumta.

Ka një kontradiktë mes komentuesve për mirësitë e dukshme dhe të fshehta në këtë ajet.

---

1 Disa komentues si Aluzi në "Ruhul Meani" dhe Fakhru Razi në tefsirin "El Kebijr", mendojnë se këto ajete janë të lidhura me ajetet që paraprinë këshillat e Lukmanit, kur i flet idhujtarëve: **"Kjo është vepër e krijimit të All'llahut, e më tregoni ju mua se ç'krijuan ata të tjerët përveç Tij"** dhe thotë në ajetet që po komentojmë: **"A nuk e dini ju se All'llahu nënshtroi për të mirën tuaj ç'ka ka në qiej e ç'ka ka në Tokë"**. Vetëm se fundi i këtij ajeti dhe ajetet që janë pas tij dhe transmetimet e përmendura në komentimin e tyre, përshtaten me gjithpërfshirjen e ajetit.

2 Kemi pasur diskutime të tjera rreth nënshtrimit të krijesave ndaj njeriut në fundin e ajetit 2 të sures "Rra'd".

Disa kanë supozuar se mirësia e dukshme është ajo të cilën askush nuk mund ta mohojë, si: krijimi, jeta dhe llojet e furnizimit. Kurse mirësitë e fshehta janë treguese të çështjeve të cilat nuk mund të konceptohen pa i saktësuar mirë, siç janë fuqitë shpirtërore dhe instiktet e brendshme të rëndësishme.

Disa i kanë konsideruar organet e dukshme si mirësi, kurse zemrën e kanë quajtur si mirësia e fshehtë.

Një pjesë tjetër e ka konsideruar portretin, fytyrën, qëndrimin në këmbë drejt dhe shëndetshmërinë e gjymtyrëve si mirësi të jashtme, kurse njohjen e All'llahut si mirësi të brendshme.

Në një hadith të transmetuar nga Ibën Abbasi tregohet se kur e ka pyetur të Dërguarin e All'llahut për mirësitë e dukshme dhe të padukshme, ai i ka thënë: "*O i biri i Abbasit, sa i përket asaj që është e dukshme ajo është Islami dhe në atë ç'ka ka krijuar All'llahu në krijimin tënd, në atë që ka derdhur furnizimin mbi ty, e sa i përket mirësive të fshehta, ato janë mbulimi i veprave tuaja të këqija dhe nuk t'i ka ekspozuar ato ty.*".[1]

Kurse në një hadith tjetër të transmetuar nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: "*Mirësia e dukshme është Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe ajo çka solli Pejgamberi prej diturisë së All'llahut, kurse mirësia e fshehur është mbrojtja jonë e Ehli Bejtit dhe lidhja e dashurisë sonë.*".[2]

Pra, nuk ka asnjë kontradiktë midis këtyre komentimeve dhe secili prej tyre sqaron një konfirmim të dukshëm për mirësinë

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 320, fundi i ajetit në fjalë.
2 Burimi i mësipërm.

e dukshme dhe mirësinë e fshehtë pa përcaktuar kuptimin e gjerë të tyre.

Në fund, ajeti flet për atë që mohon mirësitë e mëdha të Zotit, të cilat e rrethojnë njeriun nga çdo anë. Ajeti hap edhe polemikën lidhur me luftimin e së vërtetës dhe thotë: **"E megjithatë, prej njerëzve ka që polemizojnë çështjen e All'llahut duke mos pasur as dituri, duke mos qenë i udhëzuar dhe duke mos pasur Libër të ndritshëm."**. Në vend që të njohë dhe të vlerësojë dhurimin e gjithë këtyre të mirave të dukshme dhe të fshehta, njeriu i drejtohet idhujtarisë dhe mohimit. Kjo ndodh për shkak të injorancës.

Cili është dallimi mes "diturisë", "udhëzimit" dhe "Librit ndriçues"?

Më e mira që mund të thuhet është:

"Dituria" është treguese e koncepteve që i kupton njeriu.

"Udhëzimi", ai që fitohet nga mësuesit dhe udhëheqësit hyjnorë dhe qiellorë, nga dijetarët, të cilët e çojnë njeriun drejt qëllimit dhe synimit.

Me "Librin ndriçues" kuptohen librat qiellorë që mbushin zemrën e njeriut me dritë përmes Shpalljes, frymëzimit.

Por ekziston edhe një grup kokëfortësh, të cilët, në të vërtetë, nuk zotërojnë dituri, nuk ndjekin ndonjë udhëzim apo udhëheqës dhe as nuk frymëzohen nga Shpallja. Për këto, rrugët e udhëzimit janë të bllokuara. Ata nuk i njohin çështjet që përmendëm më lart. Prandaj do bijnë në gropën e humbjes e të mashtrimit, do të bien pre' e shejtanëve.

Ajeti që pason tregon logjikën e dobët e të sëmurë të këtij grupi. Ai thotë: **"...dhe kur u thuhet atyre: pasoni atë që e shpall All'llahu"**, ata thonë: **"Jo, ne ndjekim atë që gjetëm tek prindërit tanë."**. Përderisa ata vijonin të ndiqnin rrugën e baballarëve injorantë e të devijuar, nuk kishte asnjë shpërblim për asnjërin prej tyre, përveç dënimit. Për ata që ndjekin rrugën djallëzore, Kur'ani thotë: **"E edhe sikur shejtani t'i kishte thirrur ata në dënimin e zjarrtë..."**.[1]

Kur'ani tërheq vëmendjen te diskutimi i ndjekjes së traditës fallco të baballarëve dhe gjyshërve. Kur'ani ua bën të qartë se vepra është ndjekja e shejtanit në rrugën e Xhehennemit.

Njeriu që shkon pas shejtanit detyrohet të kundërshtojë thirrjen në të vërtetën. Ky veprim është mbulim dhe mashtrim.

A ka ndonjë njeri me logjikë që ta braktisë thirrjen e Pejgamberëve të All'llahut për në Xhennet dhe të vrapojë drejt thirrjes së shejtanit drejt Xhehennemit?!

Ajeti që vjen më pas sqaron situatën e dy grupeve: besimtarët e sinqertë dhe jobesimtarët e rremë, kur thotë: **"E kush ia dorëzon veten All'llahut e duke qenë edhe punëmirë, ai është kapur për lidhjen më të sigurtë."**.

Ajo që nënkuptohet me dorëzimin e fytyrës tek All'llahu i Madhëruar, është orientimi i plotë me gjithë qënien drejt Unit të shenjtë të All'llahut, sepse fytyra është organi më fisnik i trupit

1 Komentuesit e kanë konsideruar *"leu"* këtu kushtore si zakonisht, dhe shpërblimi i saj është i fshehur, dhe vlerësimi është: sikur shejtani t'i thërriste ata në dënimin e zjarrit të Xhehenemit a do ta ndiqnin ata atë?

dhe qendra e shqisave njerëzore më të rëndësishme, prandaj ajo përdoret si metaforë në këtë rast.

Shprehja: **"...duke qenë punëmirë..."** duhet kuptuar si përmendja e punës së mirë sipas besimit. Kurse **''... kapja pas lidhjes më të sigurtë...''** tregon mbështetjen tek e vërteta. Kjo do të thotë se njeriu ka nevojë që t'i tregohet se si shpëtohet prej materializmit të kësaj dynjaje dhe si të fitohet dituria, morali, sjelljet e vyera, të cilat do ta çojnë drejt shpërblimeve prej All'llahut të Madhëruar.

Prandaj ajeti në fund thotë: **"...dhe vetëm tek All'llahu është përfundimi i çështjeve."**.

Në një hadith të marrë nga tefsiri "El Burhan" nga Imam Ali ibn Musa Rida *(Paqja e All'llhut qoftë mbi të!)*, tregohet se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Pas meje do të ketë një mashtrim të errët. Ai që do të shpëtojë prej saj, është ai që kapet pas lidhjes më të sigurtë.*".

Ata i thanë: "*O i Dërguari i All'llahut, po cila është lidhja më e sigurt?*".

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Mbrojtja e të parit të këshilluesve.*".

Ata thanë: "*O i Dërguari i All'llahut, po cili është më i nderuari i këshilltarëve?*".

Ai tha: "*Vilajei i zotërisë së të caktuarëve.*".

Ata thanë: "*O i Dërguari i All'llahut, po kush është zotëria i caktuar?*".

Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Prijësi i besimtarëve."*.

Ata thanë: *"O i Dërguari i All'llahut, po kush është prijësi i besimtarë?"*.

Profeti *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Udhëheqësi i myslmanëve dhe Imami i tyre pas meje."*.

I thanë: *"Kush është udhëheqësi i myslmanëve dhe Imami i tyre pas teje?"*.

Ai tha: *"Vëllai im Ali ibn Ebi Talib."*. [1]

Për këtë çështje ka edhe transmetime të tjera që konfirmojnë se ajo që nënkuptohet me *''lidhjen e sigurtë''*, është respekti i Ehli Bejtit, dashuria e familjes së Muhammedit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* apo Imamët prej gjeneratës së Hysejnit *(Paqja qoftë mbi ta!)*.[2]

Kemi thënë shpesh se këto komentime janë një sqarim i konfirmimeve të qarta dhe nuk i kundërshtojnë konfirmimet e tjera, si Teuhidi dhe devotshmëria e të tjera të ngjashme me këto.

Ajeti që pason sqaron situaten e grupit të dytë, duke thënë: **"Ty mos të të brengosë mosbesimi i atij që nuk beson"**, sepse pa dyshim se ti e ke kryer detyrën tënde në mënyrën më të përsosur dhe është ai (njeriu) vetë që i ka bërë padrejtësi vetes së tij.

1 Tefsiri "El Burhan", vëll. 3, f. 279. Fundi i ajetit është burimi i komentimit.

2 Për më tepër sqarim dhe qartësim, shih tefsirin "El Burhan", vëll. 3, f. 278 dhe 279.

Shembulli i këtyre shprehjeve që janë përmendur shpesh në Kur'an e bëjnë të qartë se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ndiente dhimbje dhe vuante shumë kur i shikonte injorantët kokëfortë që e braktisnin rrugën e All'llahut. Ai u kishte sjellë atyre gjithë ato argumente dhe shenja të qarta, u kishte treguar se si të zgjidhnin rrugën e duhur dhe jo rrugën e gabuar e të humbjes. Ai shqetësohej deri në atë shkallë, sa All'llahu i Madhërueshëm e ngushëllonte shpirtin e tij në shumë raste.

Por ti mos u mërzit, sepse një grup njerëzish mohojnë dhe bëjnë padrejtësi e zullum. Ata kënaqen me mirësitë hyjnore të pamerituara dhe nuk marrin ndëshkim. Nuk ka nxitim në këtë çështje sepse: **" ...kthimi i tyre është vetëm tek Ne, e për atë që vepruan, Ne do t'u tregojmë... "** . Nuk ka asnjë dyshim se Ne i dimë sekretet e tyre dhe nijetet e tyre, ashtu siç i dimë punët Tona.

"All'llahu vërtet është i Ditur për atë që mbajnë në zemra."

Fjalitë: "All'llahu do t'i lajmërojë njerëzit për veprat e tyre në Kiamet. All'llahu do t'i lajmërojë ata për konfliktet që kishin", janë zbërthim i shumë ajeteve nga Kur'ani. Duke parë se *"nuneb'biukum"* është nga lënda *"nebe'e"* dhe se *"en nebe'u"* tregon lajm që ka përmbajtje dhe dobi të rëndësishme dhe që është shumë i qartë dhe është larg çdo dyshimi dhe gënjeshtre. Këto shprehje tregojnë se All'llahu i Madhërueshëm i qartëson veprat e njerëzve dhe askujt nuk i mbetet asnjë kundërshtim dhe mohim. Ai shfaq veprat që kanë kryer njerëzit në këtë dynja dhe i kanë

harruar, ose bëjnë sikur e kanë harruar. Ai e bën të mundur që çdokush të japë llogari dhe të marrë shpërblim.

Pa dyshim se Ai, i Madhërishmi do t'ua kujtojë ato atyre.

Pastaj shton se të kënaqurit e këtyre me jetën nuk duhet që të të habisë ty, sepse vjen sqarimi: **"Ne u japim të jetojnë pak** (në këtë botë)**, e pastaj i shtrëngojmë ata me një dënim të rëndë."** e ai është një dënim i vazhdueshëm e i dhimbshëm.

Kjo shprehje tregon se askush nuk duhet të mendojnë se është jashtë shikimit dhe fuqisë së All'llahut të Madhërueshëm. Madje Ai dëshiron që t'u japë atyre kohë për të gjetur justifikimet për veprat e kryera. Por situata e këtyre njerëzve ndryshon. Ata tërhiqen dhe zvarriten me përbuzje dhe dhunë drejt dënimit të ashpër të Zotit. Kurse ata që e patën vënë të gjithë qënien e tyre në rrugën e adhurimit të All'llahut të Madhërueshëm dhe u kapën fort pas lidhjes së sigurt, jetojnë në këtë botë të pastër e punëmirë, ndërsa në Ahiret kënaqen me mëshirën e All'llahut.

Ajetet: 25 – 30

وَلَئِن سَأَلْتَهُم مَّنْ خَلَقَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ ٱللَّهُ ۚ قُلِ ٱلْحَمْدُ لِلَّهِ ۚ
بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٢٥﴾ لِلَّهِ مَا فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ هُوَ
ٱلْغَنِىُّ ٱلْحَمِيدُ ﴿٢٦﴾ وَلَوْ أَنَّمَا فِى ٱلْأَرْضِ مِن شَجَرَةٍ أَقْلَٰمٌ وَٱلْبَحْرُ يَمُدُّهُۥ
مِنۢ بَعْدِهِۦ سَبْعَةُ أَبْحُرٍ مَّا نَفِدَتْ كَلِمَٰتُ ٱللَّهِ ۗ إِنَّ ٱللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٢٧﴾ مَّا
خَلْقُكُمْ وَلَا بَعْثُكُمْ إِلَّا كَنَفْسٍ وَٰحِدَةٍ ۗ إِنَّ ٱللَّهَ سَمِيعٌۢ بَصِيرٌ ﴿٢٨﴾ أَلَمْ تَرَ
أَنَّ ٱللَّهَ يُولِجُ ٱلَّيْلَ فِى ٱلنَّهَارِ وَيُولِجُ ٱلنَّهَارَ فِى ٱلَّيْلِ وَسَخَّرَ ٱلشَّمْسَ
وَٱلْقَمَرَ كُلٌّ يَجْرِىٓ إِلَىٰٓ أَجَلٍ مُّسَمًّى وَأَنَّ ٱللَّهَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿٢٩﴾
ذَٰلِكَ بِأَنَّ ٱللَّهَ هُوَ ٱلْحَقُّ وَأَنَّ مَا يَدْعُونَ مِن دُونِهِ ٱلْبَٰطِلُ وَأَنَّ ٱللَّهَ هُوَ
ٱلْعَلِىُّ ٱلْكَبِيرُ ﴿٣٠﴾

"Nëse ti i pyet ata: Kush i krijoi qiejt e Tokën? Me siguri do të thonë: 'All'llahu!' (Thuaj)**: 'All'llahut i qoftë lavdërimi'. Por shumica e tyre nuk e dinë."**

"Vetëm të All'llahut janë të gjitha që gjenden në qiej e në Tokë; All'llahu është Ai që s'ka nevojë dhe është i Lavdishëm."

"Sikur të gjithë drutë në tokë të jenë lapsa dhe sikur detit t'i shtohen edhe shtatë dete (e të jenë ngjyra)**, nuk do të mbaronin fjalët e All'llahut** (do të shterroheshin detet, do të mbaronin lapsat e jo mrekullitë e All'llahut)**. All'llahu është Ngadhënjyesi i Urtë."**

"Krijimi dhe Ringjallja juaj nuk është më i rëndë se krijimi i një qënieje (një njeriu)**; vërtet, All'llahu është që i dëgjon e i sheh veprat e njerëzve."**

"A nuk e di se All'llahu e fut (errësirën) **natën në ditë dhe e fut** (dritën) **në natë, dhe Ai i nënshtroi Diellin dhe Hënën** (të lindin e të perëndojnë) **dhe secili rrjedh** (noton) **deri në një afat të caktuar dhe se All'llahu hollësisht është i njohur për atë që veproni."**

"Kjo (dokumenton) **se All'llahu është Ai** (Zoti) **i vërtetë dhe se ajo që ata adhurojnë përveç Tij është gënjeshtër, e All'llahu është Ai i Larti, i Madhi."**

Komentimi

Dhjetë sifatet (cilësitë) e All'llahut të Madhëruar:

Gjashtë ajetet e mësipërme kanë sqaruar një seri sifatesh të All'llahut të Madhëruar. Ato janë dhjetë cilësi kryesore, ose dhjetë emra nga emrat e bukur të All'llahut: i Pasuri, i Falënderuari, i

Forti, i Urti, Dëgjuesi, Shikuesi, i Mirëinformuari, i Vërteti, i Larti dhe i Madhi.

Kjo është njëra anë. Nga ana tjetër, ajeti i parë flet për krijimin e All'llahut; ajeti i dytë, për sundimin e Tij; ajeti i tretë për diturinë e Tij të pafundme; ajeti i katërt dhe i pestë, për fuqinë e Tij të pafundme, kurse ajeti i fundit, përmbledh këto rezultate dhe na tregon se Ai që i zotëron këto cilësi dhe kënaqet me to, është All'llahu i Lartësuar dhe çdo gjë tjetër pos Tij është e pavërtetë, fallco dhe e përbuzur.

Pasi pamë këtë përmbledhje, rikthehemi te shpjegimi i ajeteve.

Ajeti i parë thotë: **"Nëse ti i pyet ata se: Kush i krijoi qiejt e Tokën? Me siguri do të thonë: 'All'llahu!'"**.

Kjo mënyrë të shprehuri, dhe ajo e cila vihet re në ajetet e tjera të Kur'anit, si në ajetet 61-63 të sures "Ankebut", në ajetin 38 të sures "Zumer" dhe në ajetin 9 të sures "Zukhruf", tregon nga njëra anë se idhujtarët nuk ishin mohues në mënyrë kategorike të Njehsimit të Krijuesit. Por, ata besonin në idhujtari vetëm në adhurimin e statujave dhe në ndërmjetësimin e tyre.

Një tregues tjetër lidhet me Teuhidin e natyrshëm *(fitrijun)* dhe kjo lidhje e brendshme është në karakterin dhe natyrën e të gjithë njerëzve.

Pastaj thotë: Nëse këta e njihnin Teuhidin e Krijuesit, atëherë thuhet**: "...'All'llahut i qoftë falënderimi', por shumica e tyre nuk dinë."**.

Pastaj sqarimi arrin tek sundimi i All'llahut, sepse Ai pas vërtetimit të të qënurit të Tij Krijues, nuk ka nevojë për një argument shtesë për të qënurit të Tij Zotërues. Për këtë thotë: **"Vetëm të All'llahut janë të gjitha që gjenden në qiej e në Tokë."**.

Është e padiskutueshme se Krijuesi dhe Zotëruesi është Admistruesi i gjithësisë. Me këtë vërtetohen tre shtyllat e Njehsimit, që janë: "Teuhidul Khalikijeh (Njëshmëria e All'llahut në krijim që do të thotë se vetëm All'llahu është Krijuesi); "Teuhidul malikijeh" (Njëshmëria e All'llahut në zotërim që do të thotë se All'llahu është Zotëruesi i Vetëm dhe Absolut); dhe "Teuhidu rububijeh" (Njëshmëria e All'llahut në sundim. Kjo do të thotë se All'llahu është Zoti i vetëm i të gjitha botëve.). Ai që i njeh këto tri shtylla të Njehsimit, është më i pasuri nga çdo gjë dhe meriton çdo falënderim dhe lavdërim.

Prandaj edhe ajeti në fund thotë: **"All'llahu është Ai që s'ka nevojë dhe është i Lavdishëm."**.

All'llahu është i pasur në mënyrë absolute dhe i falënderuar nga çdo anë. Çdo dhuratë në këtë botë i referohet Atij dhe çdo gjë që ka njeriu, buron prej Tij. Magazinat e të gjitha të mirave janë në dorën e Tij. Ky është një argument i gjallë për pasurinë e Tij.

"*El hamd*u" – "*falënderimi*" është përdorur këtu me kuptimin ''lavdërimi për punën e mirë'', kur personi e kryen atë punë me dëshirën e tij. Çdo e mirë që na vjen, na vjen se ashtu dëshiron All'llahu i Madhërueshëm, sepse çdo falënderim dhe lavdërim vjen vetëm prej Tij. Për çdo lavdërim që njeriu bën, p.sh.

për bukurinë e luleve, për bujarinë e njeriut etj., në të vërtetë, kemi falënderuar Atë, sepse çdo bukuri, çdo bujari është prej Tij. Ai është i falënderuar shumë, në mënyrë absolute.

Ajeti që pason tregon diturinë e pakufishme të All'llahut. Për këtë shohim se ç'thuhet në tefsirin e Ali ibn Ibrahimit: "Kur një grup çifutësh e pyeti Pejgamberin rreth çështjes së shpirtit, ai iu përgjigj me Kur'an: **"Shpirti është prej çështjes së Zotit tim dhe juve nuk u është dhënë vetëm se pak dituri."**[1] Atyre u erdhi rëndë kjo fjalë dhe e pyetën përsëri Pejgamberin: **"A është kjo vetëm në të drejtën tonë?"**. Pejgamberi iu përgjigj: **"Përkundrazi, është për të gjithë njerëzit."**. Ata thanë: "Po si mblidhet kjo, o Muhammed?! A po thua se ty të është dhënë vetëm pak dituri, kur ty të është dhënë Kur'ani dhe neve na është dhënë Teurati. Ti sapo lexove: **"...dhe kujt i jepet urtësia..."**, dhe ajo është Teurati. **"Atij i është dhënë një e mirë shumë e madhe."**.[2]

Për të qartësuar këtë, zbriti ajeti: **"Sikur të gjithë drutë në tokë të jenë lapsa."**. Ajeti që po komentojmë e bëri të qartë se dituria e njeriut, sado e gjerë të jetë, përballë diturisë së All'llahut nuk është veçse një atom i venitur. Ajo që konsiderohet ''shumë'' në optikën tuaj, është ''shumë pak'' tek All'llahu.[3]

Në fundin e ajetit 109 të sures ''El Kehf'' sqarohet kjo situatë edhe me një tregim.

Megjithatë, Kur'ani, për hir të mishërimit të diturisë së pafundme të All'llahut, thotë: **"Sikur të gjithë drutë në tokë të jenë lapsa dhe sikur detit t'i shtohen edhe shtatë dete** (e të jenë

1 Sure "Isra", ajeti 85.
2 Sure "Bekare, ajeti 269.
3 Tefsiri "El Burhan", vëll. 3, f. 279.

ngjyrë)**, nuk do të mbaronin fjalët e All'llahut** (do të shterroheshin detet, do të soseshin lapsat e jo mrekullitë e Zotit)**. All'llahu është Ngadhënjyesi i Urtë."**.

"Jemud'duhu" vjen nga rrënja e fjalës *"el midad"* dhe përdoret me kuptimin e bojës apo lëndës me ngjyrë me të cilën shkruhet mbi fletën e letrës nëpërmjet lëvizjes, nëpërmjet shkrimit të lapsit.

Një pjesë e komentuesve kanë transmetuar një kuptim tjetër të këtij përdorimi. Kuptimi që sqarohet këtu tregon se bëhet fjalë për vajin, i cili vendoset në llambë dhe ndriçon përreth.

Fjala *"El kelimatu"* është shumësi i fjalës *"kelimetun"* dhe tregon shprehjet, me të cilat flet dhe bisedon njeriu. Pastaj termat e mësipërm u përdorën me një kuptim më të gjerë: ''çdo gjë që ka mundësi të sqarojë qëllimin dhe kërkesën''. Çdo krijesë e kësaj bote, e bën të qartë Unin e shenjtë të All'llahut dhe Madhështinë e Tij. Për këtë na ndihmon ajo që lexojmë në lidhje me Mesihun në ajetin 171 të sures ''Nisa'': **"Mesihu Isa, i biri i Merjemes, ishte vetëm i Dërguar i All'llahut.** (Ishte fjalë e Tij.)

Tani duhet që të mendojmë thellë në mënyrë të drejtë se mund të mjaftojë. Dihet se me një laps të vetëm, bashkë dhe me një sasi boje, mund të shkruash mjaft informacione që lidhen me një njeri, apo me shumë njerëz e çështje. Kur'ani thotë: Edhe sikur të gjitha pemët që ekzistojnë mbi sipërfaqen e tokës të bëheshin lapsa, edhe të gjithë detrat të bëheshin bojë, përsëri nuk do të mjaftonin për të shkruar dituritë hyjnore. Pra, kjo bën të qartë madhështinë e diturisë së All'llahut, të cilat nuk kanë fund.

Madhështia, gjerësia dhe thellësia e diturive të All'llahut të Madhërishëm nuk kanë fillim e as fund.

Njeriu ndjen se informacionet e tij përballë diturisë së All'llahut janë si zeroja përballë pafundësisë.

Zgjedhja e fjalës *shtatë* në gjuhën arabe tregon shumën. Përdorimi në shumës, ndoshta, është bërë për shkak se njerëzit e asaj kohe besonin se numri i planeteve të sistemit diellor ishte shtatë (planete). Edhe java ka shtatë ditë dhe ndoshta për këtë arsye, njerëzit e asaj kohe e kishin ndarë rruzullin tokësor në shtatë zona dhe u kishin vënë atyre shtatë emra.

Më tej do të bëhet e qartë se pse kanë zgjedhur numrin shtatë si një numër të plotë mes numrave të tjerë dhe pse është përdorur pikërisht ky numër për të treguar shumësin. [1]

Pas përmendjes së diturisë së pakufishme të All'llahut, ajeti tjetër flet për fuqinë e Tij të pakufishme: **"Krijimi dhe Ringjallja juaj nuk është më e rëndë se krijimi i një qënieje** (një njeriu)**; vërtet, All'llahu është që i dëgjon e i sheh veprat e njerëzve."**.

Një pjesë e komentuesve kanë thënë: "Një grup jobesimtarësh kurejshë thonin se ishin të habitur nga qëndrimi i besimtarëve ndaj Ditës së Kiametit. Ata e anashkalonin këtë qëndrim dhe thonin se si ka mundësi të pranojmë se All'llahu na ka krijuar ne në forma të ndryshme dhe në periudha kohore të ndryshme, kur paskemi qenë dikur një pikë uji, e më pas qenkemi bërë gjak i ngjizur, e pastaj u bëmë embrion, u bëmë në forma dhe figura të ndryshme etj. Pra, si do të na krijoka All'llahu ne të

1 Kemi folur rreth (diturisë absolute të All'llahut) në fundin e ajetit 109 të sures "Kehf".

gjithëve përsëri për një orë të vetme?". Për të sqaruar këtë situatë dhe për t'u dhënë përgjigjen e merituar jobesimtarëve kurejshë, zbriti ajeti që po komentojmë.

Kurejshët sigurisht kanë qenë befasuar nga mrekullia e krijimit nga ana e All'llahut të Madhëruar. Ata nuk arrinin t'i kuptonin nocione të tilla. Ata nuk arrinin të imagjinonin se fuqia krijuese e All'llahut mishërohej nga krijesat më të vogla e deri te gjithë njerëzimi e universi në një çast të vetëm. Ata nuk e kuptonin këtë fuqi e madhështi absolute.

Kurejshët jobesimtarë habiteshin dhe thonin se si ishte e mundur ndarja e trupave nga njëri–tjetri dhe rikthimi i secilit prej tyre përsëri në vendin e vet, kur natyrat e atyre kishin qenë të ndryshme, format jo të barabarta, personalitetet dhe karakteret të shumëllojshme dhe, mbi të gjitha, pasi trupi i njeriut është shndërruar në dhe'. Ata nuk arrinin të kuptonin se dituria e pafundme e All'llahut dhe fuqia e Tij e pakufishme u jep lehtësisht përgjigje pyetjeve të tyre.

Habia e këtyre shprehet edhe në shkurtimin e kohës së rikrijimit. Ata thonin se si ka mundësi që të kapërcehen etapat të cilat duhet t'i kalojë njeriu, kur dihet se fëmijëve u duhet një kohë e gjatë që të ngrihen në këmbë, të ecin mirë, të flasin etj. etj. Ndërkohë që ndryshe ndodh me zogun e pulës, i cili fillon të ecë sapo del nga veza.

Këto fenomene e bëjnë edhe një herë tjetër të qartë fuqinë e All'llahut.

Cilësimi i All'llahut si "Dëgjues dhe Shikues" (në fund të ajetit), është një përgjigje për jobesimtarët. Jobesimtarët thonë se si

mundet që i gjithë njerëzimi, me gjithë ndryshimet në llojshmëritë e krijimit të tyre dhe me të gjitha veçoritë e tyre, të ringjallen brenda një orë të vetme. Si mund të jenë nën kontroll sjelljet, fjalët dhe veprat e tyre?!

Përgjigjet i jep Kur'ani duke thënë se All'llahu është Dëgjues dhe Shikues. Kur'ani shton se veprat, sjelljet dhe fjalët e tyre janë regjistruar me precizionin më të madh.

All'llahu është i mirinformuar për fjalët e tyre dhe sjelljet e tyre, madje edhe për çfarë kanë në gjokset dhe zemrat e tyre.

Ajeti që vjen më pas është një konfirmim dhe qartësim tjetër i fuqisë së gjerë të All'llahut. Ajeti përmes fjalës së Pejgamberit thotë: **"A nuk e di se All'llahu e fut** (errësirën) **natën në ditë dhe e fut** (dritën) **në natë, dhe Ai i nënshtroi Diellin dhe Hënën** (të lindin e të perëndojnë, për t'u shërbyer njerëzve dhe për të garantuar nevojat e tyre) ... **dhe secili noton deri në një afat të caktuar dhe se All'llahu hollësisht është i njohur për atë që veproni?"**.

"El vuluxhu" përdoret me kuptimin *"ed dukhulu"* – *"hyrja"*. Hyrja e natës në ditë dhe ditës në natë mund të jetë tregues i zgjatjes dhe e shkurtimit të natës dhe ditës. Gradualisht, përgjatë një viti, pakësohet diçka te njëra prej atyre të dyjave dhe i shtohet tjetrës në një mënyrë të pandjeshme, të pakuptueshme. Kështu formohen katër stinët e vitit me veçoritë dhe efektet e tyre. Vetëm në dy pika të sipërfaqes së Tokës nuk ka katër stinë. Këto janë: Poli i Veriut dhe Poli i Jugut. Atje gjatë gjithë vitit nata është gjashtë muaj dhe dita është gjashtë muaj. Vendi i dytë është Vija e Ekuatorit, ku dita dhe nata janë të barabarta gjatë gjithë vitit.

Shndërrimi i natës në ditë dhe i ditës në natë për arsye të faktorëve të shtresës atmosferike nuk ndodh në mënyrë të papritur. Njeriu dhe të gjitha krijesat e gjalla ballafaqohen me rreziqe të ndryshme në atë kohë. Madje, rrezet e diellit fillojnë të përhapen që në agun mëngjesor, shpërndajnë errësirën e pastaj përhapin gjithandej dritën e tyre. E kundërta ndodh në mbarim të ditës dhe në fillim të natës.

Kjo zhvendosje graduale dhe e organizuar mirë me kaq precizion është tregues i fuqisë së All'llahut të Lartësuar.

Këto dy komente nuk konfliktohen dhe bashkohen në konceptimin kuptimor të ajetit.

Lidhur me nënshtrimin e Diellit dhe të Hënës dhe të të gjithë planeteve të tjerë ndaj njeriut, duhet kuptuar se njeriu i vë ato në shërbimin e tij. Me këtë kuptim përmendet togfjalëshi **"ua nënshtroi juve"**, që do të thotë se Madhështia e All'llahut dhe Mirësitë e Tij bëjnë të mundur që të gjitha krijesat tokësore dhe qiellore t'i nënshtrohen dhe t'i binden urdhrit të Krijuesit dhe me gjithë këtë nënshtrim nuk është e drejtë që ta kundërshtojnë All'llahun e Madhëruar dhe të mos i binden urdhrit të Tij.[1]

Fjalia **"...dhe secili noton deri në afat të caktuar "**, tregon se ky sistem perfekt nuk do të vazhdojë deri në pafundësi. Ky sistem e ka një fund. E ky fund arrin cakun e vet me mbarimin e

1 Kemi pasur një diskutim të detajuar rreth nënshtrimit të diellit dhe të hënës dhe krijesave të tjera ndaj njeriut në fundin e ajetit 2 të sures "Rra'd" dhe në ajetin 32 të sures "Ibrahim".

dynjasë. Për këtë thuhet në suren ''Tekuir'': **"Kur dielli të jetë mbështjellë** (dhe errësohet)**, dhe kur yjet të kenë rënë..."**.[1]

Fjalia: **"...dhe se All'llahu hollësisht është i njohur për atë që veproni..."** e bën mëse të qartë se krijuesi i gjithçkaje është All'llahu. Ai krijoi Diellin dhe Hënën aq të mëdha dhe që i nënshtrohen me saktësi një sistemi ku alternohet nata dhe dita. Ky sistem ka funksionuar me mijëra dhe miliona vjet, sipas urdhrit të All'llahut. Atëherë shtrohet pyetja: Kur All'llahu krijon dhe administron gjithçka në qiell, në Tokë dhe në det, a është e mundur që t'i fshihen Atij veprat e njerëzve?

All'llahu i Madhëruar i di veprat, mendimet, sjelljet, karakteret... Po. Ai di gjithçka!

Ajeti i fundit, që mund të merret si një përmbledhje e përgjithshme, thotë: **"Kjo** (dokumenton) **se All'llahu është Ai,** (Zoti) **i vërtetë, dhe se ajo që ata adhurojnë përveç Tij është gënjeshtër, e All'llahu është Ai i Larti i Madhi."**.[2]

Të gjithë diskutimet që janë përmendur në ajetet e mëparshme kanë treguar se All'llahu është Një dhe çdo gjë tjetër përveç Tij është e shkatërruar, e pavërtetë dhe e kufizuar. Ai është i Larti dhe më i Madhi. Ai është mbi çdo gjë. Ai është më

1 Sure "Tekuir", ajetet 1 dhe 2.

2 *"El Bau"* në **"se All'llahu është Ai i vërtetë"** edhe pse ajo duket në fillim të çështjes shkakore, dhe mbase disa komentues, si Alusij në "Ruhul Meanij", e kanë konsideruar përbajtjen e këtij ajeti, si shkak të kërkesave të mëparshme. Mirëpo konteksti i ajeteve dhe përmendja e cilësive të mëparshme, si ***"el khalikijeh"***, ***"el malikijeh"***, dija dhe fuqia si dhe shenjat në tyre në botën e krijimit – është e dukshme se ato të gjitha janë dëshmuese të këtij rezultati. Në bazë të kësaj, pa dyshim se përmbajtja e këtij ajeti është rezultat i ajeteve të mëparshme dhe nuk ka asnjë shkak për të.

Madhështori. Ai është vetëm Ai. Prandaj duhet të kuptohet qartë dhe prerë nga të gjithë se çdo gjë tjetër, përveç All'llahut, është e kotë, e pavërtetë. Vetëm Atë duhet të adhurojmë, vetëm Atij duhet t'i lutemi dhe vetëm Atë duhet të falënderojmë për çdo mirësi që na jep. Një poet ka thënë: "A nuk është e vërtetë se çdo gjë përveç All'llahut është e kotë, e pavërtetë dhe çdo mirësi në mënyrë definitive është e ezauruar?''.[1]

Kjo fjali mund të qartësohet me shprehjen filozofike si më poshtë:

E vërteta është treguese e ekzistencës reale dhe të vërtetuar në këtë botë. Vërtetimi i qëndrueshëm dhe i përhershëm është vetëm All'llahu dhe çdo gjë tjetër përveç Tij nuk ekziston vetë. Ai e zgjat ekzistencën e çdo gjëje. Nëse ndërpritet furnizimi i All'llahut qoftë dhe vetëm një çast, çdo gjë do të zhduket.

Këto ajete janë një seri prej dhjetë sifateve prej sifateve të All'llahut të Lartësuar. Aty përmes përmendjes së dhjetë emrave të Tij, sillen argumente të forta, të pamohueshme në lidhje me shkatërrimin e çdo lloj idhujtarie. Aty tregohet edhe domosdoshmëria e Teuhidit dhe të gjitha fazat e adhurimit.

1 "Biharul Anuar", vëll. 22, f. 267.

Ajetet: 31 – 32

أَلَمۡ تَرَ أَنَّ ٱلۡفُلۡكَ تَجۡرِي فِي ٱلۡبَحۡرِ بِنِعۡمَتِ ٱللَّهِ لِيُرِيَكُم مِّنۡ ءَايَٰتِهِۦٓۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَأٓيَٰتٖ لِّكُلِّ صَبَّارٖ شَكُورٖ ٣١ وَإِذَا غَشِيَهُم مَّوۡجٞ كَٱلظُّلَلِ دَعَوُاْ ٱللَّهَ مُخۡلِصِينَ لَهُ ٱلدِّينَ فَلَمَّا نَجَّىٰهُمۡ إِلَى ٱلۡبَرِّ فَمِنۡهُم مُّقۡتَصِدٞۚ وَمَا يَجۡحَدُ بِـَٔايَٰتِنَآ إِلَّا كُلُّ خَتَّارٖ كَفُورٖ ٣٢

"A nuk e sheh se anijet lundrojnë në saje të mirësisë së All'llahut, e për t'ju treguar juve Madhërinë e Tij? Vërtet, edhe në këtë ka argumente për secilin që është shumë i durueshëm dhe shumë mirënjohës."

"E kur i mbulon ata ndonjë valë si reja, i drejtohen All'llahut sinqerisht me besim vetëm ndaj Tij, e kur i shpëton ata e dalin në tokë, ka disa prej tyre që i mbesin besnik besimit të drejtë. E, faktet Tona nuk i refuzon kush përveç të pabesit dhe përbuzësit."

Komentimi

Në vazhdimësinë e fatkeqësisë

Në këto ajete diskutohet për mirësitë e All'llahut të Madhërueshëm, për argumentet e Teuhidit. Në ajetin e parë diskutohet për argumentimin e rregullit, kurse në ajetin e dytë për natyrshmërinë e Teuhidit. Të dy këto diskutime plotësojnë diskutimet e përmendura në ajetet e mëparshme.

Ajeti i parë thotë: **"A nuk e sheh se anijet lundrojnë në saje të mirësisë së All'llahut,**[1] **e për t'ju treguar juve Madhërinë e Tij? Vërtet, edhe në këtë ka argumente për secilin që është shumë i durueshëm dhe shumë mirënjohës."**.

Lundrimi i anijeve në oqeane bëhet sipas disa rregullash, disa prej të cilave janë:

- lëvizja e erërave.

- pesha specifike e drurit apo lëndëve prej të cilave është ndërtuar anija.

- dendësia e ujit.

- presioni i ujit mbi trupat që notojnë në të.

1 *"El bau"* në *"bi ni'metil'lah"* - **"në saje të mirësisë së All'llahut"** ka mundësi që të jetë shkakore, apo shoqëruese, vetëm se supozimi i parë është më i përshtatshëm.

Në qoftë se ndodh ndonjë çrregullim në njërën prej këtyre çështjeve, anija ose do të mbytet ose do të mbetet pezull në mesin e detit dhe nuk do të orientohet drejt shpëtimit të saj. Ai ka përgatitur kushtet dhe situatat.

Është dëshira e All'llahut të Lartësuar që detet dhe oqeanet i bëri të gjëra dhe rruga më e mirë për udhëtimin e njerëzve për të transportuar sendet që u nevojiten nga një vend në një vend tjetër. Të gjitha këto janë mirësi prej mirësive të Tij.

Madhështia e fuqisë së All'llahut të Madhëruar e treguar edhe në detërat dhe oqeanet nuk ka limit, kurse fuqitë e njeriut janë fare të papërfillshme përballë atyre të All'llahut.

Në të shkuarën, i gjithë njerëzimi që mbështetej te anijet që lundronin me ndihmën e erërave, nëse do të bashkoheshin për ta lëvizur anijen në mes të detit për të lundruar në anë të kundërt të lëvizjes së erës së fortë, nuk do ta bënin. Në ditët tona, vendin e erërave e kanë zëvendësuar gjeneratorët dhe mekanizmat e fuqishëm, por as këto nuk arrijnë dot të mposhtin fuqinë e stuhive e shtrëngatave, të cilat shpeshherë i shkatërojnë ato.

Në fund të ajetit përdoret fjala *"sab'barun"*, me kuptimin "shumë durues" dhe fjala *"shekurun"* me kuptimin "shumë falënderues", të cilat, së bashku duket se kanë kuptimin se jeta e kësaj bote është një sfidë ku përballen e mira dhe e keqja. Qëndrueshmëria dhe vendosmëria para vështirësive dhe falënderimi për mirësitë janë konkluzioni logjik i gjithë këtyre komenteve, të cilat njeriu duhet t'i ketë gjithmonë parasysh. Këtë kuptim kanë transmetuar shumë prej komentuesve nga i Dërguari më i nderuar *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të*

dhe mbi familjen e tij!): *"...besimi është dy gjysma: njëra gjysëm është durimi, kurse gjysma tjetër është falënderimi."*.[1]

Besimi mund të jetë edhe shkak e kuptimit të argumenteve madhështore të All'llahut në procesin e krijimit. Ky qëllim është falënderimi i Begatuesit, i shoqëruar me durim dhe vendosmëri për këtë perfeksion të madh.

Pas sqarimit të mirësisë së All'llahut për lëvizjen e anijeve në detra, mbetet për t'u sqaruar edhe mënyra e ngarkesës dhe e transportit të mallrave dhe njerëzve me anije. Ky ajet ka treguar edhe një formë tjetër të kësaj çështjeje dhe ka thënë: **"E kur i mbulon ata ndonjë valë si reja, i drejtohen All'llahut sinqerisht me besim vetëm ndaj Tij."**.

Fjala *"edh dhulelu"* është shumësi i *"dhul'letun"* dhe komentuesit i kanë përmendur me disa kuptime këto dy fjalë :

Fjala *"edh dhul'letu"* në fjalor shpjegohet si "reja që bën hije", por këtu përdoret më shumë me kuptimin "e asaj që bën pis dhe urrehet".

Disa komentues e kanë konsideruar me kuptimin e "çadrës së madhe" (e lidhur kuptimisht me hijen e çadrës), kurse disa të tjerë e kanë konsideruar atë me kuptimin e "malit".

Por kjo fjalë më shpesh është përmendur në Kur'an me kuptimin e "resë që bën hije", prandaj duket se ky komentim është më i drejtë.

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 323 dhe tefsiri i Kurtubiut, tefsiri "El Kebijr" dhe tefsiri "Es Safij".

Po të vazhdojmë komentin në këtë kontekst duhet thënë se dallgët gjigande të detit ngrihen lart dhe i rrethojnë ata "si një re" dhe u bën atyre një hije të frikshme, të tmerrshme.

Në rrethana të tilla, njeriu e gjen veten të dobët dhe të pafuqishëm dhe nuk arrin të bëjë asgjë. Njeriu nuk mund të komandojë asnjë aparat që drejton anijen. Atij nuk i mbetet asnjë rreze shprese dhe atëhere thotë: "A ka ndonjë njeri që mund të më ndihmojë?" Ai e sheh me sytë e vet se ka mbetur si një lodër në mëshirën e dallgëve të detit. Dallgët, deti, erërat dhe gjithçka i binden vetëm Krijuesit të ujit, Krijuesit të ajrit, Krijuesit të dheut.

Njeriu e kupton se mësimet e sinqerta të Teuhidit dhe feja duhen përqafuar me gjithë zemër. Kurse adhurimi i përket vetëm Atij, Krijuesit të Madhëruar.

Por, sapo All'llahu i Madhëruar i shpëton njerëzit nga shkatërrimi, ata ndahen në dy grupe: **"...e kur i shpëton ata e dalin në tokë, ka disa prej tyre që i mbesin besnik besimit të drejtë."**[1] Ky grup ka dhënë fjalën dhe qëndron besnik, nuk thyen besën e as nuk e harron mirësinë e All'llahut.

Kurse grupi tjetër e harroi çdo gjë dhe iu bashkua ushtrisë së idhujtarisë dhe mosbesimit.

Disa komentues e kanë konsideruar ajetin e mësipërm si një tregues të Islamit të "Akreme ibn Ebu Xhehli". Kur u çlirua Meka, Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i fali të gjithë njerëzit përveç katër personave. Njëri prej atyre që iu fal jeta ishte Akreme ibn Ebu Xhehli. Por ai

1 *"Muktesidun"* është nga lënda e *"kasdun"*, me kuptimin: sinqeriteti, drejtësia në punë dhe mbajtja e premtimit.

nuk ka lënë gjë të keqe dhe krim pa bërë kundër Islamit dhe myslimanëve. Ai urdhëroi vrasjen e myslimanëve kudo që të shiheshin. Për këtë shkak, Akreme u detyrua që të arratisej nga Meka dhe iu drejtua Detit të Kuq. Kur i hipi anijes, filloi një erë e fortë dhe një pjesë e njerëzve që ndodheshin me të në anije i thanë njëri–tjetrit: "Ejani të lëmë putat dhe të kthehemi nga All'llahu i Vetëm dhe të kërkojmë mirësinë e Tij, sepse këto zotat tanë nuk bëjnë dobi asgjë!".

Akreme tha: "Nëse në det nuk na shpëton asgjë tjetër, veç njehsimit tonë, atëherë nuk do të na shpëtojë as në tokë. O Zot, me të vërtetë të jap fjalën Ty, se nëse më shpëton mua nga kjo sprovë, do të shkoj te Muhammedi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ta njoh atë si khalif, sepse me të vërtetë, unë e di se ai është bujar dhe falës".

Akreme shpëtoi nga ajo furtunë që e zuri në det dhe shkoi te Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*[1].

Është përmendur në historitë islame se Akreme u bë një nga myslimanët e vërtetë dhe ra shehid në betejën e Jermukut ose Exhnadinit.

Ajeti shton në fund: **"...e faktet Tona nuk i refuzon kush, pos të pabesit përbuzës."**.

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 323, fundi i ajetit është burimi i komentimit dhe është përmendur kjo ngjarje në "Usdul Gabeh fi ma'rifeti sahabeh", vëll. 4, f. 5, me një ndryshim të vogël.

"Khat'tarun" vjen nga fjala *"el khatru"* dhe ka kuptimin *"prishja e premtimit"*. Ky përdorim i kësaj fjale në këtë kontekst ka kuptim figurativ dhe tregon se idhujtarët shpeshherë, kur ndodhen në vështirësi, drejtohen nga All'llahu dhe premtojnë se do të përkrahin mësimet e Tij. Por, sapo kalojnë vështirësitë, kthehen sërish në mohues të mirësive të All'llahut.

Fjalët *"khat'tarun"* dhe *"kefurun"*, që përmenden në fund të këtij ajeti, qëndrojnë përballë fjalëve *"sab'barun"* dhe *"shekurun"*, të cilat janë përmendur në fund të ajetit të mëparshëm. Pra, mohimi është përballë falënderimit; prishja e betimit përballë durimit, përballë mbajtjes së premtimit. Por premtimin dinë ta mbajnë vetëm ata që janë të qëndrueshëm dhe të vendosur, jo ata që thyhen para çdo vështirësie.

Ajetet: 33 – 34

يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ ٱتَّقُواْ رَبَّكُمۡ وَٱخۡشَوۡاْ يَوۡمٗا لَّا يَجۡزِي وَالِدٌ عَن وَلَدِهِۦ وَلَا مَوۡلُودٌ هُوَ جَازٍ عَن وَالِدِهِۦ شَيۡـٔٗاۚ إِنَّ وَعۡدَ ٱللَّهِ حَقّٞۖ فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ ٱلۡحَيَوٰةُ ٱلدُّنۡيَا وَلَا يَغُرَّنَّكُم بِٱللَّهِ ٱلۡغَرُورُ ٣٣ إِنَّ ٱللَّهَ عِندَهُۥ عِلۡمُ ٱلسَّاعَةِ وَيُنَزِّلُ ٱلۡغَيۡثَ وَيَعۡلَمُ مَا فِي ٱلۡأَرۡحَامِۖ وَمَا تَدۡرِي نَفۡسٞ مَّاذَا تَكۡسِبُ غَدٗاۖ وَمَا تَدۡرِي نَفۡسُۢ بِأَيِّ أَرۡضٖ تَمُوتُۚ إِنَّ ٱللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرُۢ ٣٤

“O ju njerëz, kini kujdes ndaj Zotit tuaj dhe kini frikë ditën kur prindi nuk do t’i bëjë dobi fëmijës së vet, e as fëmija nuk mund t’i bëjë asnjë dobi prindit të vet! Premtimi i All’llahut (për sevap ose dënim) **është i sigurt, pra, të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë ndaj All’llahut djalli mashtrues.”**

“S’ka dyshim se vetëm All’llahu e di kur do të ndodhë Kiameti, Ai e di kur e lëshon shiun. Ai e di se ç’ka në mitra (të nënave)**, nuk e di kush, pos Tij, se ç’ka do t’i ndodhë nesër, dhe**

askush nuk e di, përveç Tij, se në ç'vend do të vdesë. All'llahu është i Gjithëdituri, i Mirëinformuari."

Komentimi

Dituria e gjerë e All'llahut

Këto janë dy ajetet e fundit të sures ''Lukman''. Ata janë përmbledhje e predikimeve dhe këshillave të mëparshme, të argumenteve të Teuhidit dhe të Ditës së Kthimit (Kiametit). Ata tregojnë orientimin e njerëzve nga All'llahu dhe tregojnë për Ditën e Fundit. Këto ajete janë edhe një paralajmërim për idhujtarët kryeneçë të orientuar nga dynjaja dhe shejtani. Për diturinë e gjerë të All'llahut të Madhërueshëm dhe të përfshirjes së Tij në çdo gjë, ajeti thotë: **"O ju njerëz, kini kujdes ndaj Zotit tuaj dhe kini frikë ditën kur prindi nuk mund t'i bëjë dobi fëmijës së vet, e as fëmija nuk mund t'i bëjë dobi prindit të vet!"**.

Kushtetuta e parë është drejtimi nga Dita e Kthimit. Ajo zgjon tek njeriu forcën e kontrollit, kultivon shpirtin e sevapit dhe të dënimit. S'ka dyshim se njeriu që e di se është dikush i Mirëinformuar i Ditur që e shikon atë, që di për të çdo gjë, që regjistron të gjitha veprat e tij dhe e di se një Gjykatë e Drejtë do t'i gjykojë të gjitha veprat e tij, ai kurrë nuk mund ta njollos veten e tij me gjynahe dhe me mëkate.

Fjalia: *"la jexhzi"* – *"nuk bën dobi"*, ka lidhje me *"el xhezau"* dhe *"el xhezau"* gjuhësisht përmendet me dy kuptime:

Njëri prej tyre këtyre kuptimeve është: "shpërblimi dhe pagesa për diçka", njësoj siç thuhet: "All'llahu ia shpërbleftë me të mira!''.

Kurse kuptimi tjetër është: "mjaftueshmëria dhe zëvendësimi, suporti i diçkaje ndaj të tjerave", njësoj siç thuhet në ajetin që po komentojmë: **"...prindi nuk mund t'i bëjë dobi fëmijës së vet..."**.

Por ndodh që të dy kuptimet e mësipërme mund t'i referohen një origjine të vetme, sepse shpërblimi dhe dënimi meritohen sipas veprës së kryer dhe e zëvendësojnë atë.

Çdo njeri, atë ditë do të zihet me veten e tij, sprovohet me veprat dhe sjelljet e tij. Në këto raste mund të ndodhë që njeriu të mos dijë se si reagon, se kush i qëndron pranë. Në këto raste atij nuk i intereson askush, qoftë babai apo fëmija i tij.

Ky ajet është i ngjashëm me atë që thuhet në fillim të sures "Haxhxh'', ku flitet për Kiametin dhe tërmetin drithërues: **"Atë Ditë, kur ta përjetoni atë, secila gjidhënëse braktis atë që ka për gjiri."**.

Fjalia *"la jexhzi"* – *"nuk bën dobi"* përdoret në kuptimin e babait, ndërsa fjala *"xhazin"* përdoret në lidhje me fëmijën. Këto përdorime vërtetojnë larminë e ligjërimeve.

Është e ditur nga të gjithë se çdo prind, çdo baba është gati të pranojë çdo lloj dënimi për fëmijën e tij, siç ka pranuar të përballojë çdo sakrificë për edukimin e mirë të fëmijës së vet.

Por jo çdo fëmijë është i gatshëm të pranojë fatkeqësitë që vijnë nga kujdesi për prindërit e tij. Ndodh që edhe secili prej të dyve (prindi dhe fëmija) të mos kujdeset për tjetrin, sepse është i zënë me veprat e tij dhe është i hutuar vetëm në çështjet e tij.

Prandaj ajeti në fund i paralajmëron njerëzit për dy gjëra: **"Premtimi i All'llahut është i sigurtë, pra, të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë ndaj All'llahut djalli mashtrues."**.

Në realitet, këtu vihen re dy ndalesa përballë dy urdhëresave që ishin në fillim të ajetit. Nëse te njeriu kultivohet të drejtuarit kah All'llahu i Lartësuar dhe frikën nga llogaridhënia, për atë nuk duhet pasur frikë nga devijimi, vetëm në dy raste:

E para: Bukuritë dhe stolitë e kësaj jete t'ia ndryshojnë atij të vërtetat në formë tjetër dhe ta zhveshin atë nga aftësia e përcaktimit të së mirës dhe të së keqes. Pa dyshim që dashuria për këtë jetë është kreu i të gjitha mëkateve dhe gabimeve.

E dyta: Kur e mashtrojnë cytjet e djallit dhe e largojnë atë rruga e drejtë dhe nga e vërtetat e krijimit dhe e Ringjalljes. Nëse i mbyll këto dy rrugë të kryerjes së gjynahut, atëherë njeriu do të jetë i mbrojtur dhe nuk do të kërcënohet nga asnjë rrezik. Bazuar në këtë, katër pikat e lartpërmendur përfaqësojnë programin e plotë të shpëtimit të njeriut.

Në ajetin e fundit të kësaj sureje flitet për dituritë specifike të All'llahut të Madhëruar. Ajeti thotë: **"S'ka dyshim se vetëm All'llahu e di kur do të ndodhë Kiameti. Ai e di kur e lëshon shiun. Ai e di se ç'ka në mitra** (të nënave)**, nuk e di kush përveç Tij se çka do t'i ndodhë nesër, dhe askush përveç Tij, nuk e di**

se në ç'vend do të vdesë (ose kohë)**. All'llahu është më i Dituri, i Mirëinformuari."**.

Ky ajet është një përgjigje për pyetjen që i bënin idhujtarët shpesh dhe në mënyrë të përsëritur Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Idhujtarët pyesnin: **"Kur është ajo Ditë?"**.[1]

Kësaj pyetjeje Kur'ani i është përgjigjur kështu: **"Askush nuk e di për premtimin e Ditës së Kiametit, përveç All'llahut të Madhërueshëm."**.

Në disa ajete tregohet se All'llahu nuk e tregon se në cilën ditë do të ndodhë Dita e Kiametit. Ai ka thënë: **"S'ka dyshim se momenti** (Kiameti) **do të vijë patjetër. Unë gati e kam fshehur atë..."**.[2] Kjo mbahet e fshehtë nga All'llahu i Ditur që njerëzit të mos frikësohen.

Ajeti më tej shton: "Çështja e Kiametit nuk është çështja e vetme e fshehur prej jush. Ju nuk dini se kur do ju ndodhin edhe gjëra të tjera, si p.sh.: nuk e dini se kur dhe ku do t'ju vijë vdekja etj.".

Ju nuk e dini as se kur do fillojë shiu dhe as se ç'do t'ju ndodhë nesër. Prandaj nuk duhet t'ju vijë çudi nga fshehja e Ditës së Kiametit.[3]

---

1 Sure "Isra", ajeti 51.

2 Sure "Ta Ha", ajeti 15.

3 Është e vërtetë se fjalia **"zbret shiun"** në ajetet e mësipërme nuk flet për çështjen e diturisë së All'llahut – dhe për këtë shkak, disa e kanë konsideruar këtë fjali përjashtuese në mesin e këtyre fjalive dhe e ka bërë atë sqaruese të

Në tefsirin "Ed Durr'rrul Menthur" transmetohet se një burrë me emrin El Uirathu nga fisi Mazin ibn Hafsah, shkoi te Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: "O Muhammed, kur do të bëhet Kiameti? Kur do të bjerë shi në vendet tona të thara? Kur do të lindë gruaja ime shtatzënë? Sa do të fitoj nesër? Kur do të vdes?" Pas këtyre pyetjeve, zbriti ky ajet.[1]

Hulumtime

1- Llojet e hiles dhe të mashtrimit

Ajetet e mësipërme i paralajmërojnë njerëzit që të mos mashtrohen nga iluzionet dhe bukuritë e jetës së dynjasë, nga stolitë e saj, të mos mashtrohen prej shejtanit dhe kurtheve të tij. Këto ajete lajmërojnë rreziqet që vijnë prej mashtrimeve të tilla.

Njerëzit janë disa llojesh. Një pjesë e tyre janë të paditur dhe mund të mashtrohen lehtë, vetëm duke i parë bukuritë e

---

fuqisë së All'llahut, jo të diturisë së Tij, vetëm se harmonia e pesë fjalive me njëra–tjetrën nga njëra anë dhe transmetimet e shumta të cilat janë thënë në "Nehxhul Belaga" dhe në libra të tjerë – do të tregojmë për to së shpejti - nga ana tjetër, janë një evidencë se ato lidhen edhe me diturinë e All'llahut gjithashtu.

1 Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthur", sipas transmetimit të tefsirit "El Mijzan", vëll. 16, f. 254.

dynjasë. Një pjesë tjetër rezistojnë më shumë. Për t'i mashtruar ata, shejtani i mallkuar duhet të bëjë më shumë përpjekje.

Por, të dy grupet e njerëzve duhet t'i kenë vazhdimisht në mendje paralajmërimet e ajateve të mësipërme.

Duhet thënë se *"el gururu"* do të thotë *"qenie shumë mashtruese"*. Disa komentues e kanë identifikuar atë me shejtanin. Por duhet të bëhet shumë kujdes se në çdo hap mund të takojmë njerëz mashtrues, mund të lexojmë informacione mashtruese, mund të gjendemi në situata tunduese, mund të mashtrohemi prej pasurisë, prej prestigjit, prej dëshirës për karrierë etj. Në këtë kontekst është thënë me mjaft elokuencë: "Kjo dynja të mashtron, të dëmton dhe pastaj ikën.".[1]

Prandaj i lutemi Zotit të na mbrojë nga gjithë këto mënyra mashtruese.

2- Mashtrimi i dynjasë

Mund të ndodhë që njeriu të shpërqendrohet nga pamje të ndryshme të kësaj bote. Shpesh edhe mund të mashtrohet prej tyre deri në atë masë sa të përhumbet fare. Lidhur me këto situata e kanë pyetur Prijësin e Besimtarëve dhe ai ka thënë: *''... ai që nuk*

1 Është përmendur fjalia "të mashtron dhe të dëmton e pastaj ikën", në lidhje me dynjanë në shtegun e elokuencës në kapitullin e portës së vendimit të fjalëve të urta të prijësit të besimtarëve Aliut.

mashtrohet nga njerëzit, nuk mashtrohet as nga dynjaja me stimulimet e saj.".[1]

Në një hadith thuhet se Prijësi i Besimtarëve, Aliu, dëgjoi një njeri që shante dynjanë dhe e konsideronte atë mashtruese. Ai i tha: *"O ti që e shan këtë botë, o ti që je mashtruar nga dinakëria e saj dhe je joshur nga padrejtësitë e saj! Gënjehesh nga kjo botë dhe pastaj e shanë? Ose e fajëson ti atë, ose ajo do të fajësojë ty? Kur të ka penguar dhe kur të ka mashtruar? Mbase me zhdukjen dhe mashtrimin e të parëve të tu? Ose me shtrojën e nënave tuaja nën dhé?!*

Kjo botë, vërtet është shtëpi për atë që e konsideron të tillë, është vend i sigurtë, është shtëpi e pasuri, është vendi ku mësohet dhe adhurohet për ato që e vlerësojnë të tillë. Kjo botë është vendi i lutjeve të melekëve të All'llahut, është vendi ku bihet në sexhde, është vendi i zbritjes së Shpalljes së All'llahut dhe i tregtisë së miqve të All'llahut të Lartësuar.".[2]

3- Këto pesë njohuri janë specifike për All'llahun

Ajeti i mësipërm tregon se vetëm All'llahu i Madhëruar ka dijeni për Ditën e Kiametit, për zbritjen e shiut, për kohën e lindjes së shtatzanave, për të ardhmen e njeriut, për vendin dhe kohën e vdekjes etj.

1 Atij që nuk i vjen i dituri, sipas transmetimit të tefsirit të Nuruth Thekalejn, vëll. 4, f. 217.

2 "Nehxhul Belaga", fjalët e urta, fjalia 131.

Lidhur me këtë çështje, një ajet tjetër thotë: "Çelësat e gajbit (të të panjohurës) janë pesë. Ato nuk i ka askush, përveç All'llahut[1].

Në një transmetim tjetër, thuhet se Aliu, një ditë po tregonte se ç'do të ndodhte në të ardhmen. Njëri nga shokët e pyeti: "O prijësi i besimtarëve, a po flet për gajbin (të fshehtën), a e di ti atë?". Imami i nderuar buzëqeshi dhe i tha: "O vëlla i Kelbit (sepse ai njeri ishte prej fisit benu Kelb). Kjo që tregoj unë nuk i përket të fshehtës. Këtë e kam mësuar nga ai që ka pasur këto njohuri. E fshehta konsiderohet vetëm dituria që lidhet me Ditën e Gjykimit, të cilën e di vetëm All'llahu i Madhëruar. Kjo që thuhet këtu, vërtetohet me ajetin e mëposhtëm, ku thuhet: **'Vetëm All'llahu e di kur do të vijë Kiameti.'**".

"All'llahu i Madhëruar është i vetmi që e di se në barkun e shtatzanave ka embrion femër apo mashkull, nëse do të jetë i shëmtuar apo i bukur, dorëlirë apo dorështrënguar, i pafat apo fatlum, nëse do të jetë i caktuar për Xhehennem, apo do të jetë në shoqërinë e të Dërguarit në Xhennet. Këto njohuri janë sekret, të cilin e di vetëm All'llahu. Çdo dituri tjetër All'llahu ia mësoi Pejgamberit të Tij, kurse Pejgamberi më ka mësuar mua.".[2]

Nga këto tregime kuptohet se dituria e njerëzve është e kufizuar. Kjo mund të vërtetohet me një shembull të thjeshtë. Në qoftë se i lëmë kohë dhe mjetet e nevojshme, që të studiojë dhe të mësojë se embrioni në barkun e shtatzanës është mashkull apo femër, ai nuk do të arrijë të përcaktojë gjë, sepse studimi i

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 324, fundi i ajetit është burimi i komentimit.

2 "Nehxhul Belaga", hytbja 128.

embrionit dhe njohuritë shkencore rreth tij duhet të studiohen në kompleks, në harmoni me të gjithë organizmin. Por, edhe nëse arrihet të plotësohet ky studim kompleks, nuk do të arrihet njohja tjetër: njohja që lidhet me vlerat shpirtërore, të cilat i di vetëm All'llahu i Madhëruar.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ato që do t'i ndodhin njeriut të nesërmen, apo në ditët në vazhdim.

Nga këto komentime bëhet mëse e qartë përgjigjja e pyetjes që lidhet me parashikimet e vdekjes së vet të Imamëve të Ehli Bejtit, apo edhe të disa miqve të All'llahut të Madhëruar. Njëra prej tyre ka të bëjë me ngjarjet e lidhura me Kerbelanë, në të cilën tregohet se Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, apo Prijësi i Besimtarëve dhe Pejgamberët e mëparshëm kanë lajmëruar për rënien dëshmor të Imam Hysejnit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe shokëve të tij në tokën e Kerbelasë. Dhe në librin "Usulul Kafij" është një kapitull që flet për diturinë e Imamëve për kohën e vdekjes së tyre[1].

Përgjigjja është: "Dituria për një pjesë të këtyre çështjeve është dituri e përgjithshme që fitohet nga të mësuarit hyjnor. Kjo dituri nuk është aq specifike dhe aq e detajuar sa ç'janë dituritë që i di vetëm All'llahu i Madhëruar. Vetëm Ai zotëron aftësinë për dituri të hollësishme.

Prandaj shikojmë një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* se njëri nga shokët e tij e ka pyetur atë lidhur me këto çështje: "A e di Imami të fshehtën?".

1 "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 202 (kapitulli që "Imamët e dinë se kur do të vdesin").

Ai i tha: "Jo, mirëpo, nëse dëshiron që të dijë një gjë, All'llahu ia mëson atë.".[1]

Në kapitullin që flet për diturinë e fshehtë dhe për mënyrën se si e fitonin diturinë Pejgamberët dhe Imamët, thuhet se ka shumë dituri të tjera që nuk i njeh dhe nuk i di askush tjetër, përveç All'llahut.[2]

O All'llah, na i ndriço zemrat tona me dritën e diturisë!

O All'llah, na dhuro ne nga dituria e diturisë Tënde të pakufishme!

O All'llah, na mbro ne nga bukuritë e kësaj bote!

O All'llah, na mbro ne nga mashtrimi i shejtanit dhe nga pasionet tona!

O All'llah, na bëj të jemi gjithmonë të vëmendshëm ndaj Teje! Na largo që të veprojmë ato vepra që janë në kundërshtim me kënaqësinë Tënde! O All'llah, na udhëzo në rrugën Tënde të mbarë!

1 "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 201 (kapitulli i rrallë në të është përmendja e të fshehtës).

2 Kemi në bazat e mjaftueshme shumë transmetime që All'llahu ka dituri që nuk i di askush përveç Tij, dhe dituri që Ai ia ka mësuar melekëve, Pejgamberëve dhe Imamëve, vëll 1, f. 199 (kapitulli që Imamët i dinë të gjitha dituritë që u janë dhënë melekëve).

Sure "Sexhde"

E zbritur në Mekë. Ka tridhjetë ajete.

Është e njohur se kjo sure është mekase. Mirëpo disa komentues mendojnë se ajetet 18, 19 dhe 20 janë medinase, ndërkohë që nuk shihet ndonjë argument apo shenjë që këto ajete kanë zbritur në Medine.

Në disa transmetime dhe sipas mendimit të njohur të komentuesve të Kur'anit, kjo sure njihet me emrin ''surja Sexhde'', apo (elif, lamë, mim - es sexhdeh). Nganjëherë e quajnë edhe sexhdja e Lukmanit për ta dalluar atë nga surja (ha, mim - es sexhde), sepse ajo vjen pas sures Lukman.

Në disa transmetime të tjera njihet me emrin (elif, lam, mim - tenzijl).

Fakhru Razi dhe Alusi kanë thënë se njëri prej emrave të saj është "el mudaxhiu" (surja e dyshekut). Këtë emërtim e tregon ajeti 16 i kësaj sureje: **"...i heqin trupat e tyre prej dyshekut..."**.

Mirësia e leximit të kësaj sureje

Në një hadith nga i Dërguari më i nderuar, Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thuhet: "*Kush lexon: elif, lamë, mim- tenzijl dhe suren Tebarekel'ledhi bijedihil mulk* (sure "Mulk") *është sikur të ketë qëndruar zgjuar në Natën e Kadrit.*".[1]

Transmetohet nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* se ka thënë: "*Kush e lexon suren "Sexhde" në çdo natë të xhumasë, All'llahu do t'ja japë librin e veprave të tij nga e djathta e tij, nuk do ta llogarisë*

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 324.

për ato që ka bërë dhe do të jetë në shoqërinë e Muhamedit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Ehli Bejtin e tij (Paqja qoftë mbi ta!)."[1]

Përderisa në këtë sure janë përmendur diskutime të gjera për zanafillën dhe Ditën e Kthimit, për dënimin e kriminelëve në Ditën e Kiametit si dhe mësime paralajmëruese që lidhen me besimtarët dhe mohuesit, pa dyshim që leximi i saj është burim i meditimit dhe bazë e lëvizjes për të ndërtuar një njeri model në përsosuri të cilin e përfshijnë të gjitha këto mirësi e krenari. Ndikimet e leximit të kësaj sureje janë si të qëndruarit zgjuar në Natën e Kadrit duke bërë adhurime. Rezultati i leximit të saj është prania në radhët e të djathtëve dhe përfitimit të krenarisë së dashurisë së Pejgamberit dhe familjes së tij.

Përmbajtja e sures "Sexhde"

Kjo sure, si të gjitha suret mekase, ndjek me rigorozitet linjat kryesore të sureve mekase. Pra, flet për zanafillën e Krijimit dhe të Ringjalljes, për përgëzimin dhe paralajmërimin. Në përgjithësi hulumtimet e kësaj sureje flasin për:

1- Madhështinë e Kur'anit, për shpalljen e tij nga Zoti i botëve dhe mohon akuzat e armiqve ndaj tij.

2- Argumentet e All'llahut të Madhëruar në qiell dhe në tokë dhe admistrimin e kësaj bote nga ana e Tij.

1 Burimi i mëparshëm, f. 325 .

3- Krijimin e njeriut nga "dheu", nga "pika e ujit" dhe "shpirti hyjnor" dhe pajisja e tij me mjetet për të përftuar dituri, pra: me sy, me veshë dhe intelek nga ana e All'llahut të Lartësuar.

4- Kiametin dhe ngjarjet që i paraprijnë atij: vdekja dhe ç'ka pas saj, të pyeturit dhe llogaridhënia.

5, 6 – Përgëzimin dhe paralajmërimin, që trondisin ndërgjegjen. Përgëzon besimtarët me Xhennetin dhe kërcënon njerëzit e shthurur me dënimin e ashpër të Xhehennemit.

7- Historinë e Beni Israilëve dhe historia e Musait *(Paqja qoftë mb të!)*, në formë të shkurtër dhe për triumfet e popullit të tij.

8- Për përgëzimin dhe paralajmërimin e popujve të tjerë dhe për fundin e tyre të dhimbshëm.

9,10- Pastaj rikthehet edhe një herë tjetër dhe flet për çështjen e Teuhidit dhe argumentet e Madhështisë së All'llahut dhe përfundon me kërcënimin e armiqve kokëfortë.

Qëllimi kryesor i sures është forcimi i bazave të besimit në zanafillën e Krijimit dhe në Ditën e Ringjalljes. Kultivimi i një besimi të fortë dhe të brendshëm drejt devotshmërisë dhe largimit nga të kundërshtuarit, nga rebelimi dhe nga padrejtësia. Ky kuptim i kësaj sureje pati rëndësi të madhe, sidomos në fillimin e lëvizjes së Islamit në rrethinat e Mekës.

Ajetet: 1- 5

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

الٓمٓ ﴿١﴾ تَنزِيلُ ٱلۡكِتَٰبِ لَا رَيۡبَ فِيهِ مِن رَّبِّ ٱلۡعَٰلَمِينَ ﴿٢﴾ أَمۡ
يَقُولُونَ ٱفۡتَرَىٰهُۚ بَلۡ هُوَ ٱلۡحَقُّ مِن رَّبِّكَ لِتُنذِرَ قَوۡمٗا مَّآ أَتَىٰهُم مِّن نَّذِيرٖ
مِّن قَبۡلِكَ لَعَلَّهُمۡ يَهۡتَدُونَ ﴿٣﴾ ٱللَّهُ ٱلَّذِي خَلَقَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضَ وَمَا
بَيۡنَهُمَا فِي سِتَّةِ أَيَّامٖ ثُمَّ ٱسۡتَوَىٰ عَلَى ٱلۡعَرۡشِۖ مَا لَكُم مِّن دُونِهِۦ مِن وَلِيّٖ
وَلَا شَفِيعٍۚ أَفَلَا تَتَذَكَّرُونَ ﴿٤﴾ يُدَبِّرُ ٱلۡأَمۡرَ مِنَ ٱلسَّمَآءِ إِلَى ٱلۡأَرۡضِ ثُمَّ
يَعۡرُجُ إِلَيۡهِ فِي يَوۡمٖ كَانَ مِقۡدَارُهُۥٓ أَلۡفَ سَنَةٖ مِّمَّا تَعُدُّونَ ﴿٥﴾

Me emrin e All'llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

"Elif, Lamë, Mim."

"Shpallja e Librit (e Kur'anit)**, nuk ka dyshim se është** (Shpallje) **nga Zoti i gjithësisë."**

"A mos po thonë se ai (Muhammedi) **e trilloi? Jo, ajo është e vërtetë prej Zotit tënd që t'i tërheqësh vërejtjen një populli që nuk u erdhi ndonjë Pejgamber para teje, ashtu që ata të gjejnë rrugën e drejtë."**

"All'llahu është Ai që krijoi qiejt dhe Tokën dhe gjithë ç'ka ndërmjet tyre, brenda gjashtë ditëve, pastaj mbizotëroi Arshin. Përveç Tij nuk keni ndonjë ndihmëtar tjetër e as ndërmjetësuses, pra a nuk po mendoni?"

"Ai është që udhëheq çështjen (e të gjitha krijesave) **prej qiellit në tokë, pastaj ajo** (çështja) **ngrihet tek Ai në një ditë që sipas llogarisë suaj është sa njëmijë vjet."**

Komentimi

Madhështia e Kur'anit, zanafilla e Krijimit dhe Ringjallja

Përsëri në këtë sure përballemi me shkronjat e ndara: (elif, lam, mim.). Kjo është hera e pesëmbëdhjetë që i shohim këto shkronja në fillim të sureve të Kur'anit.

Në fillimin e sureve "El Bekare", "Ali Imran" dhe "El A'raf" kemi diskutuar në mënyrë të detajuar për komentimet e ndryshme të këtyre shkronjave. Diskutimi i këtyre shkronjave vjen menjëherë pas rëndësisë së Kur'anit. Ky diskutim sqaron mirë edhe një herë tjetër të vërtetën se "elif, lam, mim" janë treguese të madhështisë së Kur'anit dhe fuqisë së zbulimit të madhështisë së All'llahut të Madhërueshëm. Tregon madhështinë e këtij Libri me përmbajtje të pasur që është mrekullia e përhershme e Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimet e All'llahut*

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe që përbëhet nga shkronjat e fjalorit të thjeshtë, të cilin e njohin të gjithë.

Ajeti thotë: **"Shpallja e Librit** (e Kur'anit)**, nuk ka dyshim se është nga Zoti i gjithësisë."**.[1]

Ky ajet është përgjigje për dy pyetje: e para për përmbajtjen e këtij Libri qiellor. Kjo vërtetohet me ajetin tjetër që i referohet atij dhe thotë: **"Përmbajtja e tij është e vërtetë dhe nuk ka asnjë shans dyshimi në të."**. Dhe pyetja e dytë është për autorësinë e këtij libri. Në përgjigje të kësaj pyetjeje ajeti thotë: **"S'ka dyshim se ky Libër është nga Zoti i gjithësisë."**.

Në këtë komentim grupi emëror: **"...nga Zoti i botëve..."** merret si fakt dhe argument i fjalisë **"...nuk ka dyshim në të'..."** dhe vërteton se ky Libër vjen nga Zoti i botërave dhe çdo gjë që vjen prej Tij është e drejtë dhe e vërtetë.

Cilësimi: **"Zoti i botëve"** në mes të cilësive të pafundme të All'llahut të Madhëruar mund të jetë tregues se ky Libër është një seri prej çudirave të botës së krijimit dhe esenca e të vërtetave të botës së ekzistencës, sepse ai është Zoti i botërave.

Kur'ani nuk mjaftohet vetëm me pohimin, vetëm me pretendimin e të qenit i pastër. Prandaj sqaron më tej: "Ajo që është e qartë për atë që ka sy nuk ka nevojë për sqarim. Vetë

1 **"Shpallja e Librit"** është kallëzues i kryefjalës së munguar dhe vlerësimi i saj është *"hadha"* – *"ky"* dhe fjalia **"nuk ka dyshim në të"** është si mbiemri i tij, dhe **"nga Zoti i gjithësisë"** është një mbiemër tjetër . Disa kanë supozuar që të treja fjalitë të jenë kallëzues të alternuar, vetëm se kuptimi i parë është më i përshtatshëm, e megjithatë pa dyshim se **"shpallje"** është paskajore që vjen me kuptimin e kundrinorit, dhe aneksimi i tij te libri është si shtesë e mbiemrit ndaj emrit. Dhe supozohet gjithashtu që paskajorja të jetë me kuptimin e tij origjinal dhe ta kalojë kuptimin e hiperbolës.

përmbajtja e këtij Libri dëshmon për të vërtetën e tij, dëshmon për vërtetësinë e plotë në çdo aspekt.”.

Pastaj Kur’ani tregon akuzën që bëjnë idhujtarët dhe hipokritët për Librin qiellor dhe të pashoq. Ata thonë: ‘‘Ky Libër është vepër e Muhamedit’’. Por ata u përgënjeshtruan vetë me fjalët e tyre kur thanë: **“A mos po thonë se ai** (Muhammedi) **e trilloi”**?[1]. Përgjigjia për akuzën e tyre është: **“Jo, ajo është e vërtetë prej Zotit tënd”** dhe argumentet e vërtetësisë së Tij janë të qarta dhe të sqaruara mirë nëpërmjet të gjithë ajeteve përkatëse.

Pastaj sqaron qëllimin e zbritjes së tij, duke thënë: **“...që t’i tërheqësh vërejtjen një populli të cilit nuk i erdhi ndonjë Pejgamber para teje.”**.

Meqenëse thirrja e Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është përgëzim dhe paralajmërim dhe se ai është përgëzues para se të jetë paralajmërues, por duhet dëshmuar se paralajmërimi është më shumë për njerëzit kokëfortë dhe të humbur.

Fjalia: **“... ashtu që ata ta gjejnë rrugën e drejtë”** tregon se Kur’ani përgatit terrenin e udhëzimit. Mirëpo vendimmarrja përfundimtare është e lidhur me vetë njeriun.

Këtu shtrohen dy pyetje:

---

1 Fraza *“em”* këtu është me kuptimin *“bel”* – *“madje”*. Disa kanë supozuar se në fjali ka një vlerësim që ka qenë në rrënjë: “*a dinë ndonjë gjë për të apo thonë ai e trilloi atë*”, shih tefsirin “El Kebijr” dhe “Ruhul Xhinan”, vetëm se ky supozim duket larg.

1- Cili është ai populli, para Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* të cilit nuk i erdhi paralajmërues?

2- A nuk thotë Kur'ani i Shenjtë: **"...e nuk pati asnjë nga popujt që nuk pati të Dërguar."**?[1]

Për përgjigjen e pyetjes së parë të gjithë komentuesit kanë thënë: Qëllimi është për fisin Kurejsh, i cili nuk ka pasur paralajmërues para Pejgamberit të Islamit.

Disa komentues të tjerë kanë thënë: Qëllimi është për periudhën kohore mes profecisë së Isait *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe ardhjes së profecisë së Pejgamberit të Islamit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Por asnjëra nga këto përgjigje nuk është e saktë, sepse asnjë çast dhe në asnjë vend të botës, në mënyrë kategorike, nuk ka periudhë boshe pa argumentet e All'llahut. Prandaj prania e një Pejgamberi apo pasardhës të Pejgamberit kudo e kurdo është e padiskutueshme.

Në bazë të kësaj, nga fjala *"en'nedhiru"* nënkuptohet se është Pejgamber i madh, i cili e sqaroi thirrjen e tij të shoqëruar me mrekullitë në këtë botë kaq të gjerë dhe se nuk banonte në Gadishullin Arabik dhe as në mesin e fiseve arabe.

Lidhur me përgjigjen e pyetjes së dytë, duhet të thuhet se kuptimi i fjalisë: **"...e nuk pati asnjë nga popujt që nuk pati të Dërguar"**është se çdo populli e ka pasur të Dërguarin e tij, por nuk ka qenë e nevojshme prania e tij fizike në çdo vend. Mjafton që të

1 Sure "Fatir", ajeti 24 .

arrijë zëri i thirrjes së Pejgamberëve të mëdhenj të All'llahut në veshët e njerëzve kudo që ndodhen nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

Kjo ngjason me thënien: Çdo popull ka pasur një Pejgamber prej atyre me vendosmëri të lartë *(ulul azmi)* që kanë pasur libra qiellorë. Kuptimi i kësaj thënie është se zëri i Pejgamberit dhe libri i tij qiellor ka ardhur nëpërmjet përfaqësuesve të tij për secilin prej ymeteve, gjatë gjithë historisë.

Pas sqarimit të madhështisë së Kur'anit dhe të mesazhit të Pejgamberit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ajeti pasardhës flet për një prej bazave më të rëndësishme dhe shtyllave të besimit islam. Ky ajet thotë: **"All'llahu është Ai që krijoi qiejt dhe Tokën dhe gjithë ç'ka ndërmjet tyre, brenda gjashtë ditësh."**.[1]

E kemi thënë shpesh se qëllimi i frazës **"...brenda gjashtë ditësh"** që ndodhet në këtë ajet ka kuptimin e gjashtë fazave, sepse një prej kuptimeve të fjalës ditë (jeumun) në bisedat e përditshme është: fazë (el merhaletu). Në bisedat tona themi: Sistemi shtypës na udhëhiqte dje dhe sot na udhëheq sistemi i konsultimit (esh shura), ndërkohë që qeveritë shtypëse udhëhiqnin me mjiëra vite, mirëpo udhëheqësinë e tyre në atë fazë kohore e quajnë ditë.

---

1 Fjala **"All'llah"** në këtë fjali është kryefjalë, kurse *"el ledhi"* - *"i cili"* është kallëzuesi i tij. Në përberjen dhe strukturën e kësaj fjalie ka supozime të tjera e njëra prej tyre është, se fjala **"All'llah"** është kallëzuesi i kryefjalës së munguar, apo se fjala **"All'llah"** është kryefjalë, kurse kallëzuesi i tij është **"përveç Tij ju nuk keni ndonjë ndihmëtar"**. Mirëpo këto dy supozime nuk duken të përshtatshëm deri në atë nivel.

Nga ana tjetër kanë kaluar periudha dhe kohëra të ndryshme për qiellin dhe tokën:

Në një ditë (fazë) të gjitha planetet diellore kanë qenë një masë e vetme e lëngët. Në një ditë planetet janë ndarë nga Dielli dhe kanë filluar të rrotullohen rreth tij. Në një ditë tjetër, Toka ka qenë një masë zjarri përvëlues. Një ditë tjetër, është bërë e ftohtë dhe e gatshme për jetën e bimëve dhe kafshëve, e pastaj janë krijuar qëniet e gjalla. I gjithë ky proces ka kaluar nëpër fazat përkatëse.

Ne kemi bërë një sqarim të detajuar për këtë kuptim në komentimin e ajetit 54 i sures ''El A'raf".

Fuqia e pakufishme e All'llahut është e mjaftueshme për krijimin e kësaj bote në një çast, madje edhe në një pjesë të vogël të saj. Këtë aftësi krijuese e ka vetëm All'llahu i Madhëruar. Ky sistem qartëson madhështinë e Tij, diturinë e Tij, administrimin e Tij në mënyrë të përsosur dhe në të gjitha fazat.

Për shembull: Nëse embrioni i kalon në një çast të vetëm të gjitha fazat e përsosjes së tij, pastaj lind, mrekullitë e krijimit vështirë të perceptohen nga njerëzit. Ndërsa, kur e shikojmë atë të kalojë në çdo ditë dhe javë gjatë këtyre nëntë muajve të marrë forma të reja të mrekullueshme, ne do të njihemi fare qartë dhe më shumë me madhështinë e All'llahut të Madhëruar.

Pas çështjes së krijimit, ajeti trajton çështjen e qeverisjes së All'llahut të Madhëruar në botën e ekzistencës. Ajeti thotë se All'llahu i Lartësuar, pas kësaj u ngjit mbi Arshin (Fronin) e fuqisë së Tij dhe kontrollon të gjitha qëniet: **"... pastaj u ngjit mbi Arsh"**.

Fjala "*Arsh*", siç e kemi thënë edhe më parë, në origjinalitet ka kuptimin e karriges me këmbë të gjata. Nga një herë vjen me kuptimin e figurshëm dhe nënkupton fuqinë, siç themi në thëniet tona të përditshme: U thyen këmbët e arshit të filanit, pra fuqia e tij dhe udhëheqja e tij ranë. Bazuar në këtë, ngjitja e All'llahut në Arsh nuk ka kuptim trupor që All'llahu qëndron në fron si mbretërit dhe ulet në të. Por kuptimi është se Ai është Krijuesi i botës ekzistuese si dhe sunduesi i mbarë botës.[1]

Ajeti i plotëson fazat e Teuhidit duke treguar për Teuhidin e udhëheqësisë (vilajetit) dhe Teuhidin e ndërmjetësimit (shefaatit). Ai thotë: **"Përveç Tij ju nuk keni ndonjë ndihmëtar tjetër e as ndërmjetës."**.

Duke qenë se All'llahu i Madhëruar është Krijuesi kjo tregon njëherësh se Ai është edhe Sunduesi. Sundimi tregon për Njëshmërinë e udhëheqësisë, shefaatit dhe të adhurimit. Përderisa çështja është e tillë, atëherë përse devijoni dhe humbni rrugën dhe kapeni pas putave? **"Pra, a nuk po mendoni?"**.

Secila nga tre fazat e Teuhidit që trajtohen në ajetin e mësipërm, konsiderohen argument për njëra-tjetrën, sepse Teuhidi (Njëshmëria) i krijimit është argument i Teuhidit të sundimit dhe Teuhidi i sundimit është argument për Teuhidin e udhëheqësit, të ndërmjetësuesit dhe të të adhuruarit.

Fjalia e fundit e ajetit thotë: **"Përveç Tij ju nuk keni ndonjë ndihmëtar tjetër e as ndërmjetës"** që do të thotë se ju nuk keni mbrojtës tjetër përveç All'llahut dhe as ndërmjetësues tjetër

1 Për sqarime më të shumta shih komentimin e ajetit 54 të sures "A'raf".

përveç Tij. Për këtë, disa komentues kanë shtruar pyetjen: A është e mundur që të ndërmjetësojë dikush tek All'llahu i Madhëruar?

Përgjigjia për këtë pyetje mund të shtrihet në tri anë:

1- Duke ditur se të gjithë ndërmjetësuesit mund të bëjnë ndërmjetësim vetëm me lejen e All'llahut të Lartësuar, siç thotë Kur'ani: **"Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, përveçse me lejen e Tij..."**,[1] mund të thuhet se ndërmjetësimi, edhe në qoftë se bëhet nga Pejgamberët apo nga të dashurit e All'llahut, ai i referohet vetëm All'llahut të Madhëruar. Qoftë ky ndërmjetësim për faljen e gjynaheve, apo për të arritur mirësitë e All'llahut. Dëshmuese e kësaj është thënia e Kur'anit: **"Ai rregullon gjendjen. Ndërmjetësues nuk do të ketë vetëm nëse lejon Ai."**.[2]

2- Kur ne bëjmë ndërmjetësim te All'llahu e bëjmë me emrat (sifatet) e Tij dhe mbështetemi te mëshira e Tij, te bujaria e Tij, te falja e Tij, etj. Këto sifate i konsiderojmë si ndërmjetësuese mes tyre dhe Vetës së Tij të Shenjtë. Në një dua të Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"...dhe kërkoj ndërmjetësimin Tënd me Ty tek vetja Jote"*.

3- Kuptimi i fjalës *"esh shefi'u"* është për përkrahësin dhe ndihmësin. Ne e dimë se ndihmëtari, mbrojtësi dhe ndihmësi është vetëm All'llahu. Ajo që thuhet se fjala *"shefaah"* këtu është me kuptimin e krijimit dhe të përsosjes së shpirtrave, në të vërtetë ka po këtë kuptim.

Ajeti i fundit, prej ajeteve në fjalë, në fillim tregon për Teuhidin e All'llahut të Madhëruar, pastaj për Ringjalljen. Me

1 Sure "El Bekare", ajeti 255.
2 Sure "Junus", ajeti 3 .

këtë plotësohen tri degët dhe shtyllat e Teuhidit që u sqaruan në ajetet e mëparshme (Teuhidi në krijim, Teuhidi në sundim dhe Teuhidi në adhurim.).

Në këtë ajet përmendet edhe Teuhidi "Rububijet" me kuptimin se udhëheqja e gjithësisë bëhet vetëm nga ana e All'llahut të Madhëruar. Ajeti thotë: **"Ai është që udhëheq çështjen** (e të gjitha krijesave) **prej qiellit në Tokë."**.

Thënë ndryshe: All'llahu i Madhëruar e ka krijuar botën e ekzistencës prej qiellit në Tokë sipas urdhrave të Tij, nën udhëheqjen e Tij dhe nuk ka asnjë udhëheqës tjetër përveç Tij në këtë botë.[1]

Pastaj shton: **"...pastaj ajo** (çështja) **ngritet tek Ai në një ditë që sipas llogarisë suaj është sa njëmijë vjet."**. Me fjalën **"ditë"** nënkuptohet se ajo ditë është Dita e Kiametit.

Për këtë çështje komentuesit kanë hedhur hipoteza të ndryshme:

1- Një pjesë e tyre e kanë konsideruar si tregues të harkut të ngritjes dhe të zbritjes për qeverisjen dhe administrimin e kësa bote.

2- Disa të tjerë kanë shkuar deri aty sa kanë thënë se ajo është treguese për melekët e All'llahut, të cilët përshkojnë distancën mes qiellit dhe Tokës në pesëqind vjet dhe po me këtë periudhë kohore, kthehen përsëri. Melekët janë të zënë me qeverisjen e kësaj bote me urdhrin e All'llahut të Lartësuar.

3- Kurse disa të tjerë e konsiderojnë treguese të fazave të qevrisjes së All'llahut në këtë botë. Ata besojnë se fazat e qeverisjes së All'llahut në këtë botë janë çdo njëmijë vjet. All'llahu

1 Sipas shprehjes së parë, pa dyshim se *"es semau"* - *"qielli"* është me kuptimin e pozitës së afrimit të All'llahut dhe sipas një shprehjeje tjetër, pa dyshim se *"es semau"* - *"qielli"* ka si kuptim po këtë qiell. (Vërejeni me kujdes!)

i Madhëruar i urdhëron melekët e Tij për kontrollimin e urdhrit të qiellit dhe të tokës në çdo njëmijë vjet. Pas përfundimit të një njëmijëvjeçari, fillon një fazë tjetër.

Këto komentime shtrojnë kërkesa misterioze dhe të pakuptueshme. Këto komentime nuk kanë asnjë argument, nuk kanë asnjë dëshmitar nga ky ajet apo nga ajetet e tjera të Kur'anit.

Sipas besimit tonë, ajo që nënkuptohet nga ajeti, sipas ajeteve të tjera të Kur'anit dhe transmetimeve të ardhura për komentimin e tij, është tjetër gjë. Kuptimi në këtë ajet është se All'llahu i Madhëruar e ka krijuar këtë botë dhe e ka sistemuar dhe i ka projektuar qiellin dhe Tokën me një projekt të veçantë dhe i ka veshur njerëzimit dhe krijesave të tjera të gjalla rrobat e jetës. Mirëpo, në fundin e kësaj bote Ai, All'llahu i Madhëruar, e palos dhe e shkatërron këtë sistem. Ai e errëson Diellin dhe yjeve ua humbet shkëlqimin. Sipas thënies së Kur'anit All'llahu i Lartësuar qiejt do t'i bëjë palë-palë, derisa të kthehen në gjendjen e parazgjerimit të kësaj bote: **"...përkujto atë ditë kur Ne e palosim qiellin sikurse palosja e fletëve të librit. Ashtu sikundër e kemi filluar krijimin, e rikthejmë..."**.[1] Pas palosjes së kësaj bote, do të fillojë krijimi i një programi dhe projekti të ri botëror edhe më i gjerë, pra, do të nisë Bota Tjetër pas përfundimit të kësaj bote.

Ky kuptim është përmendur edhe në ajetet të tjera:

Në ajetin 156 të sures "El Bekare" All'llahu i Madhëruar thotë: **"Ne jemi të All'llahut dhe vetëm tek Ai do të kthehemi."**.

1 Sure "El Enbija, ajeti 104 .

Në ajetin 27 të sures "Rrum" thuhet: **"...dhe Ai është që e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo** (përsëritja**) është edhe më e lehtë për Të."**.

Në ajetin 34 të sures "Junus" lexojmë: **"All'llahu e nis krijimin dhe sërish e rikthen atë. Si i largoheni, pra, së vërtetës?"**.

Bazuar në këto thënie dhe në një thënie tjetër që thotë: **"...çdo çështje i kthehet** (në kompetencë) **vetëm Atij"**,[1] qartësohet se ajetet që ne po komentojmë flasin, gjithashtu, për fillimin e krijimit të kësaj bote, për fundin e saj dhe afrimin e Ditës së Kiametit, të cilën, në komentet e tyre ndonjëherë e emërtojnë edhe si "harku i zbritjes" dhe "harku i ngjitjes".

Sipas këtij argumentimi, kuptimi i ajetit është: All'llahu i Madhërueshëm e administron çështjen e kësaj bote nga qielli në Tokë. Fillon nga qielli dhe përfundon në Tokë, e pastaj çdo gjë kthehet tek Ai në Ditën e Kiametit.

Në fund të këtij ajeti të tefsirit të Ali ibn Ibrahimit lexojmë: ...të gjitha çështjet e administrimit, urdhëresat dhe ndalimet që Ai ka urdhëruar si dhe veprat e robve, do të shfaqen në Ditën e Kiametit. Masa e asaj Dite do të jetë sa e njëmijë vite prej viteve të dynjasë.

Këtu lind një pyetje:

Në ajetin 4 të sures ''Mearixh'', lidhur me gjatësinë e Ditës së Kiametit, thuhet: **"Atje ngjiten melekët dhe shpirti** (Xhibrili) **në një ditë që zgjatë pesëdhjetëmijë vjet** (ose lartësia e atyre

1 Sure "Hud", ajeti 123.

shkallëve është pesëdhjetëmijë vjet).". Vallë, si mund të bëhet bashkimi mes ajetit që po komentojmë dhe atij që ka përcaktuar masën me vetëm njëmijë vjet dhe ajetit të sures "Mearixh"?!

Përgjigjia për këtë pyetje është dhënë në një hadith të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, transmetuar në librin "Amalij", i shejkh Tusit, në të cilin ka thënë: "*Në Ditën e Kiametit ka pesëdhjetë vendqëndrime dhe çdo vendqëndrim është baraz me njëmijë vjet sipas llogarisë tuaj. Pastaj lexoi këtë ajet:* **" ... në një ditë që zgjat pesëdhjetëmijë vjet."**.[1]

Normale është se këto shprehje këtu nuk i kundërshtojnë numrat njëmijë dhe pesëdhjetëmijë e as numrin dhe llogarinë. Secila prej tyre tregon shumicë dhe pakicë që do të thotë se në Ditën e Kiametit ka pesëdhjetë vende, në të cilat, njeriu duhet të ndalojë një periudhë shumë të gjatë në çdo vend.

Hulumtim

Keqpërfitimi nga ajeti "*Ai është që udhëheq çështjen*"

Disa ndjekës të rrymave artificiale, të shpikura[2] e kanë përdorur ajetin e mësipërm si metodë dhe argument të orientimit të rrugës dhe rrymës së tyre. Ata deshën që ta zbatonin këtë ajet

1 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 221 dhe tefsiri Es Safij. Fundi i ajetit në fjalë.
2 "El Behaijeh ue El Babijeh".

për qëllimin e tyre, për të ngritur dyshime. Ata pretendonin se qëllimi i fjalës *"el emru"* në ajet është: "feja" dhe *"medh'hebi''*, kurse *"et tedbiru"* do të thotë "përhapja fesë'', kurse *"el uruxhu"* do të thotë *"ngritja dhe abrogim i fesë''*! Bazuar në këtë sqarohet se çdo medh'heb apo fe nuk mund të jetojë më shumë se një mijë vjet. Pas njëmijë vjetësh, duhet që t'ia lërë vendin një feje tjetër. Lidhur me këtë, ata thonë: Me të vërtetë, ne e pranojmë Kur'anin, mirëpo duke u mbështetur po te ky Kur'an, një fe' tjetër do të vijë, pasi të kalojnë njëmijë vjet!.

Edhe pse kuptimi ky kuptim është shumë larg kuptimit të ajetit, këtu duam të diskutojmë dhe të analizojmë ajetin e lartpërmendur nëse ka ndonjë lidhje me të ky ajet me atë që pretendojnë këta apo jo?

Ne mendojmë se ajo çfarë thonë ata nuk është në harmoni me nocionin e ajetit, i cili është mjaft i qartë në çdo aspekt:

1- Komentimi i fjalës *"el emru"* dhe lidhja e kuptimit të saj me fenë nuk mbështetet në asnjë argument, madje edhe ajetet e tjera kur'anore e mohojnë këtë gjë, sepse fjala *"el emru"* është përdorur në ajete të tjera me kuptimin "urdhri i All'llahut'', njësoj si **"Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhri i Tij është vetëm t'i thotë: 'Bëhu' e ai menjëherë bëhet."**.[1]

Fjala *"el emru"* është pëdorur në këtë ajet dhe ajete të tjera, si në ajetin 50 të sures "Kamer", në ajetin 27 të sures "Mu'minun'', në ajetin 54 të sures "A'raf", në ajetin 32 të sures "Ibrahim", në ajetin 12 të sures "Nahl'', në ajetin 25 të sures

1 Sure "Jasin", ajeti 82.

"Rrum", në ajetin 12 të sures "Xhathije", me kuptimin e urdhrit natyral, jo me kuptimin e legjislacionit të fesë dhe medh'hebit.

2- Fjala *"et tedbijru"* përdoret gjithashtu në kuptimin e krijimit të sistemit dhe të gjendjes së botës ekzistuese dhe nuk përdoret me kuptimin e zbritjes së fesë dhe të Sheriatit. Prandaj, themi se ajetet komentojme njëri-tjetrin dhe se kjo fjalë nuk përdoret në kuptimin e fesë dhe të medh'hebit, por përdoret fjala *"legjislacioni" – "et teshrij'u"* , *"zbritja" – "et tenzijlu"* apo *"el inzalu"*:

"Ai u përcaktoi juve për fe' atë që i pat përcaktuar Nuhut."[1]

"E kush nuk gjykon me atë që ka zbritur All'llahu, ata janë mohues."[2]

"Ai ta zbret ty (Muhammed) **Librin me argument që është vërtetues i librave të mëparshëm."**[3]

3- Ajetet para dhe pas këtij ajeti, janë të lidhura me krijimin e gjithësisë dhe nuk kanë lidhje me legjislacionin e feve, sepse në ajetin e mëparshëm flitej për krijimin e qiellit dhe Tokës në gjashtë ditë, ose në gjashtë faza, kurse në ajetin që pason, flitej për krijimin e njeriut.

Përshtatja dhe harmonia e ajeteve bën që ky ajet të jetë ndërmjetësues i ajeteve të lidhur me çështjen e natyrës, të kontrollit dhe të çështjes së krijimit. Në asnjë libër të Tefsirit të shkruar para qindra viteve, nuk gjendet asnjë supozim që ajeti të

1 Sure "Esh Shura", ajeti 13.
2 Sure "El Maide", ajeti 44.
3 Sure "Ali Imran", ajeti 3.

jetë i lidhur me legjislacionin e feve. Pavarësisht se ata i kishin preferenca supozimet dhe hipotezat, në asnjë prej dijetarëve islamë nuk ka asnjë fjalë që të pohojë se ajeti të jetë i lidhur me legjislacionin e feve. Për shembull: Autori i tefsirit "Mexhmaul Bejan" - që është prej komentimeve të njohura islame - dhe autori i tij ka jeuar në shekullin e gjashtë të Hixhrit, ky autor, edhe pse ka përmendur thënie të ndryshme për këtë ajet, ai nuk ka përcjellë asnjë thënie prej dijetarëve islam që të pretendojë e të thotë se ky ajet ka lidhje me legjislacionin qiellor dhe me fenë.

4- Fjala *"el uruxhu"* do të thotë ngjitje dhe lartësi dhe nuk ka kuptimin e agrogimit të feve dhe zhdukjen e tyre. Fjala *"uruxhu"* nuk vihet re në asnjë vend të Kur'anit me kuptimin e abrogimit. Kjo fjalë është përmendur në pesë ajete të Kur'anit dhe asnjëri prej tyre nuk të jep këtë kuptim. Në Kur'an përdoren fjalët: *"en nes'khu"* – *"shfuqizim, abrogim"* dhe *"et tebdilu"* – *"zëvendësim"*.

Fetë dhe librat qiellorë në esencë nuk janë si shpirtrat e njerëzve që ngjiten lart në qiell bashkë me melekët pas përfundimit të jetës. Por fetë e abroguara janë të pranishme në Tokë mirëpo nuk merren në konsideratë në disa çështje, ndërkohë që parimet e tyre qëndrojnë të forta.

Si përfundim, fjala *"uruxhun"*, jo vetëm nuk është përdorur në asnjë vend të Kur'anit me kuptimin e *"abrogimit të fesë"*, por ajo nuk përshtatet me nocionin e abrogimit të feve, sepse fetë e abroguara nuk ngjiten lart në qiell.

5- Në shtesë të gjithçkaje që u tha më parë, ky kuptim nuk është në përputhje me realitetin, sepse koha ndarëse mes feve të mëparshme nuk ka qenë një mijë vjet. Për shembull: hapësira

kohore mes shfaqjes së Musait *(Paqja qoftë mi të!)* dhe Mesihut *(Paqja qoftë mi të!)* ka qenë më shumë se 1500 vjet, kurse hapësira ndarëse mes Mesihut *(Paqja qoftë mi të!)* dhe shfaqjes së Pejgamberit të madh të Islamit ka qenë më pak se 600 vjet. Siç shihet në këto dy shembuj nuk përputhet një mijë vjet, siç e thonë këta, përkundrazi hapësira kohore mes aktualitetit dhe asaj që pohojnë ata është e madhe.

Periudha kohore mes shfaqjes së Nuhut, i cili ka qenë prej Pejgamberëve të vendosmërisë së lartë *(ulil azmi)* dhe shkatërruesit të putave Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!),* që ishte një tjetër Pejgamber prej atyre të vendosmërisë së lartë, ka qenë më shumë se 1600 vjet dhe koha mes Ibrahimit *(Paqja qoftë mi të!)* dhe Musait *(Paqja qoftë mi të!)* ka qenë më pak se 500 vjet.

Nga këto diskutime, arrijmë në përfundimin se nuk ka pasur kohë dhe hapësirë kohore të ndarë prej një mijë vjetësh mes feve dhe medh'hebeve dhe fesë që e pason atë.

6- Nëse mbyllim sytë nga gjthçka që u tha, bidati (risia), i Sejjid Ali Muhamed Bab, që pasuesit e tij e mbartin dhe që mbrojnë të gjitha opinionet e kota e të pavërteta, nuk janë në përputhje me këtë përllogaritje. E kjo për shkak të pohimit të tyre se Sejjid Ali Muhamed Bab ka lindur në vitin 1325 hixhri, kurse fillimi i thirrjes së tij ka qenë në vitin 1260 hixhri hënor. Duke ditur se fillimi i thirrjes së të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka qenë trembëdhjetë vjet para hixhretit, atëherë hapësira kohore midis këtyre të dyve bëhet 1273, që domethënë duke shtuar 273. Atëherë si duhet argumentuar kjo distancë kohore?

7- Nëse do ti lëmë me një anë të gjitha këto gjashtë pika, nuk i marrim parasysh këto përgjigje të sakta, e vendosim veten tonë në vend të Kur'anit dhe u themi njerëzve: Pas njëmijë vjetësh prisni ardhjen e një pejgamberi. Vallë, a është në përputhje kjo me kuptimin që përmend ajeti? A thua se dijetarët apo jodijetarët islamë nuk e kanë vënë re dhe nuk e kanë kuptuar përgjatë dymbëdhjetë apo trembëdhjetë shekujve kuptimin e ajetit, e të na vijë një grup pasi kanë kaluar 1273 vjet dhe të pohojë se ata paskan bërë një zbulim të ri? Ndërkohë që pranimi i këtij pretendimi nuk e kalon rrethin e tyre e jo më ta pranojnë të tjerët!.

A nuk do të ishte më mirë dhe më shumë e urtë që në vend të kësaj fjalie, të thuhet: ju përgëzoj juve se një pejgamber me këtë emër do të shfaqet pas njëmijë vjetësh, ashtu siç tha Isa *(Paqja qoftë mbi të!)* në lidhje me Pejgamberin e Islamit *(Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **" ...dhe jam përgëzues për një të Dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed."**[1]

Si do që të jetë, kjo çështje nuk e meriton që të zgjatemi më shumë se kaq. Por ajo meriton të përmendet për të zgjuar rininë islame, për informimin e tyre për kurthet që përgatit kolonizimi botëror duke shpikur dhe duke formuar rryma dhe medh'hebe për të dobësuar Islamin. Prandaj, duhej t'i diskutonim këto çështje që ta dinë dhe të njihen me mentalitetin e komplotistëve.

1 Sure "Es Saff", ajeti 6.

Ajetet: 6 – 9

ذَٰلِكَ عَٰلِمُ ٱلۡغَيۡبِ وَٱلشَّهَٰدَةِ ٱلۡعَزِيزُ ٱلرَّحِيمُ ٦ ٱلَّذِيٓ أَحۡسَنَ كُلَّ شَيۡءٍ
خَلَقَهُۥۖ وَبَدَأَ خَلۡقَ ٱلۡإِنسَٰنِ مِن طِينٖ ٧ ثُمَّ جَعَلَ نَسۡلَهُۥ مِن سُلَٰلَةٖ مِّن
مَّآءٖ مَّهِينٖ ٨ ثُمَّ سَوَّىٰهُ وَنَفَخَ فِيهِ مِن رُّوحِهِۦۖ وَجَعَلَ لَكُمُ ٱلسَّمۡعَ
وَٱلۡأَبۡصَٰرَ وَٱلۡأَفۡـِٔدَةَۚ قَلِيلٗا مَّا تَشۡكُرُونَ ٩

"Ai është Njohës i të (gjitha) **fshehtës dhe i të dukshmes, i Gjithëfuqishmi, Mëshirëbërësi."**

"Ai që përsosi krijimin e çdo sendi, e krijimin e njeriut e filloi nga balta."

"Pastaj bëri që pasardhësit e tij të rrjedhin prej një pike uji të dobët."

"Më pas, Ai e formëson atë (në barkun e nënës) **dhe nga ana e Vet, i jep shpirt atij dhe Ai është që juve ju pajis edhe me dëgjim, edhe me të parit, edhe me zemër, e sa pak është ajo që ju falënderoni..."**

Komentimi

Fazat e habitshme të krijimit të njeriut!

Ajetet që po komentojmë janë tregues dhe konfirmim i diskutimeve të Teuhidit që janë thënë në ajetet e kaluara. Ato diskutime përmblidheshin në katër faza: Teuhidul El Khalikijeh (Njëshmëria në krijim); Teuhidul Hakimijeh (Nëshmëria në sundim); Teuhidul Vilajeh (Njëshmëria në udhëheqje e administrim); Teuhidu Rrububijeh (Njëshmëria në krijim, në mbretërim, në furnizim, në ngjallje dhe në vdekje). Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, thotë: **"Ai është Njohës i të fshehtës dhe të dukshmes, i Gjithëfuqishmi, Mëshirëbërësi."**.

Është e natyrshme se kush dëshiron që të qeverisë çështjet e qiellit dhe të Tokës dhe të jetë gjykatës për ato, të jetë udhëheqës, krijues, administrues, ai duhet që të jetë i ditur për gjithçka: për të dukshmen dhe të padukshmen, duhet të jetë me dituri të gjerë e të pakufizuar.

Në të njëjtën kohë ky admistrues duhet të jetë i fortë, i fuqishëm që nuk mposhtet, duhet që kjo fuqi të jetë e shoqëruar me butësi dhe mëshirë, jo me vrazhdësi dhe ashpërsi.

Ajeti pasardhës tregon për sistemin e krijimit në përgjithësi në formën më të përsosur në çdo aspekt. Më pas qartëson fazat e krijimit të njeriut dhe përsosjen e tij. Ajeti thotë: **"Ai që përsosi krijimin e çdo sendi..."** dhe i ka dhënë çdo gjëje atë që ka nevojë. Ai ka ngritur një sistem perfekt të shëndoshë që nuk mund të imagjinohet. Ai është Krijuesi i gjithçkaje, Ai është All'llahu i

Madhërueshëm që ka krijuar lidhje dhe harmoni mes krijesave dhe i ka dhënë secilës prej tyre atë që kërkon, sipas nevojës.

Nëse vështrojmë krijimin e njeriut do të shohim se ai është krijuar në atë mënyrë që përbëhet nga skeleti dhe nga qelizat që funksionojnë në mënyrë perfekte. Në të njëjtën kohë mes organeve të tij ka lidhje të forta që ndikojnë te njëri-tjetri. Kjo do të thotë se All'llahu është Sunduesi i gjithësisë me gjithë krijesat e saj.

Si përfundim themi se All'llahu është Ai, i cili ka vendosur aromën te lulet, i ka dhënë shpirtin dheut dhe baltës dhe krijoi prej saj një njeri të lirë, të zgjuar, të logjikshëm. Është Ai që prej dheut të përzier ndonjëherë krijon lulet, ndonjëherë njeriun e ndonjëherë tjetër, shumë krijesa të tjera.

Të njëjtin kuptim e shohim në ajetin 50 të sures "Ta Ha" përmes fjalëve të Musait dhe Harunit *(Paqja qoftë mbi ta!)*: **"Zoti ynë është Ai që çdo sendi i ka dhënë formën e vet, pastaj e udhëzoi atë."**.

Këtu shtrohet një pyetje rreth krijimit të të këqijave e fatkeqësive dhe mënyrës së harmonizimit të tyre me sistemin e botës më të mirë. Me lejen e All'llahut, këtë do ta diskutojmë më pas.

Pas këtij prezantimi, në të cilin përmenden argumente në horizonte, Kur'ani cek krijimin e njeriut. Në ajetet që flisnin për argumentet në horizonte u përmendën llojet e Teuhidit (Njëshmërisë). Këtu përmenden llojet e mirësive të mëdha që All'llahu u ka dhënë njerëzve. Së pari, thotë: **"...e krijimin e njeriut e nisi nga balta"**. Kjo thënie tregon qartë madhështinë e

All'llahut të Madhëruar, i Cili krijoi njeriun, këtë krijesë të nderuar dhe madhështore. Kurse nga ana tjetër, e paralajmëron njeriun dhe i kujton atij se nga ka ardhur dhe ku do të shkojë!

Dihet që ky ajet flet për krijimin e Ademit dhe jo të të gjithë njerëzimit, sepse vazhdimi i pasardhësve të tij është përmendur në ajetin që vjen më pas. Pamja e jashtme e këtij ajeti është argument i qartë për krijimin e njeriut. Ky ajet mohon hipotezën e shndërrimit të llojeve (të paktën në kuptimin e llojit të njeriut).

Megjithëse disa komentues kanë dashur që këtë ajet t'ia përshtasin hipotezës së përsosjes së llojeve, ku sipas tyre krijimi i njeriut i referohet llojeve të ulëta dhe në fund përfundon në ujë dhe baltë, mirëpo fillimi i ajetit e mohon ekzistencën e llojeve të tjera të gjallesave të gjalla. Këmbëngulja e tyre vijon me pohimin se ato janë lloje që nuk llogariten dhe bëjnë një ndarje mes Ademit dhe baltës. Dihet se krijimi i njeriut është bërë direkt nga balta dhe pa asnjë ndërhyrje. Kur'ani nuk ka folur për lloje të tjera gjallesash të gjalla.

Ky kuptim bëhet më i qartë në ajetin 59 të sures "Ali Imran". Ajeti thotë: **"Vërtet, çështja e Isait** (i lindur pa baba**) tek All'llahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu."**.

Në ajetin 26 të sures "El Hixhr" Kur'ani thotë: **"Ne e krijuam njeriun nga balta e argjilit të zi e të prishur."**.

Në shumë ajete përftohet se krijimi i Ademit është formuar nga dheu dhe nga balta si një krijesë e pavarur. Hipoteza e zhvillimit të llojeve nuk ka qenë një çështje e prerë dhe e qartë nga ana shkencore. Prandaj, nuk është nevoja që të përpiqemi t'i

komentojmë ajetet e larpërmenduar në një formë tjetër për shkak të mospajtimit të tyre me këtë hipotezë. Thënë ndryshe: Nëse nuk gjendet argument i qartë që të kundërshtojë të dukshmen e ajeteve, atëherë duhet të zbatohet kuptimi i dukshëm i ajeteve. E njëjta gjë është edhe me krijimin e Ademit.

Hulumtim

Mënyra e krijimit të Ademit prej dheut

Nganjëherë, ajetet kur'anore flasin për krijimin e njeriut nga "balta", siç janë ajetet që po komentojmë. Në fjalën e All'llahut të Lartësuar përmendet historia e Ademit dhe e Iblisit (shejtanit): **"...e ata i bënë sexhde** (në shenjë falënderimi) **me përjashtim të Iblisit. Ai tha: 'A t'i bëj sexhde atij që e krijove nga balta?'"**.[1]

Ndonjëherë tjetër ajetet flasin për krijimin nga uji, si: **"dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi."**.[2] Mirëpo, dihet se të gjitha këto i referohen një çështjeje të vetme. Madje edhe kur flitet për krijimin e Ademit prej dheut, siç thotë ajeti: **"Vërtet, çështja e Isait** (të lindur pa baba) **tek All'llahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu."**.[3] Ajo që ka për qëllim ajeti

1 Sure "El Isra", ajeti 61.
2 Sure "El Enbija", ajeti 30.
3 Sure "Ali Imran", ajeti 59.

është: Dheu i përzier me ujin, domethënë balta dhe Krijuesi është All'llahu i Plotfuqishëm.

Këtu sqarohen disa pika:

1- Ata që supozuan se ajo që kuptohet nga grupi emëror: **"krijimi i njeriut prej dheut"**, se individët e njerëzimit ushqehen me bimë, si të ishte ushqim, në mënyrë direkt apo indirekt dhe të gjitha bimët janë prej toke, i janë larguar të vërtetës, sepse ajetet e Kur'anit komentojnë njëra–tjetrën. Ajetet e mësipërme janë treguese të natyrës së Ademit, i cili është krijuar nga dheu.

2- Të gjitha këto ajete janë argument i mohimit të hipotezës së përsosjes, të paktën në kuptimin e njeriut, i cili përfundon me Ademin. Është thënë se argumentet e krijimit nga dheu janë treguese për njeriun, i cili u referohet krijesave një qelizore, me mijëra agjentë të jashtëm. Gjithashtu, edhe ato, sipas hipotezave të fundit, kanë ardhur nga balta ekzistuese në breg të oqeaneve. Për sa i përket vetë Ademit, ai ka qenë një individ i zgjedhur në mesin e llojit të njerëzve dhe për të nuk ka pasur një krijim të pavarur, të veçantë, përkundrazi ai dallohej nga cilësitë e tij të veçanta... Kjo hipotezë nuk përshtatet në asnjë mënyrë me dukuritë e ajeteve të Kur'anit.

Ne theksojmë sërish se çështja e shndërrimit të llojeve nuk është ligj shkencor i padiskutueshëm, përkundrazi është thjesht një hipotezë, sepse një diçka që ka zanafillë në miliona vite dhe është fshehur në këtë hark kohor, është e natyrshme që ajo nuk i nënshtrohet as eksperimentimit e as vëzhgimit dhe nuk mund të jetë në kategorinë e ligjeve konstante shkencore. Përkundrazi, kjo është një hipotezë për t'u njohur me hamendje me dukurinë e

llojshmërisë së gjinive, që janë shfaqur në ekzistencë. Ne dimë mirë se hipotezat gjithmonë janë në gjendjen e ndryshimit dhe të shndërrimit duke ia lënë vendin hipotezave të reja.

Në bazë të kësaj, s'ka dyshim se për çështjet filozofike, të cilat kanë nevojë për shtylla të padiskutueshme, të sigurta, nuk mund të mbështetemi në këtë hipotezë.

Një sqarim të detajuar rreth shtyllave të hipotezës së përsosjes së llojeve dhe jovërtetësinë e saj e kemi paraqitur nën adresën "Kur'ani dhe krijimi i njeriut", në fundin e ajetit 28 të sures "El Hixhr".

Në fund të këtij hulumtimi, e shohim të domosdoshme përmendjen e kësaj çështjeje: Hipoteza e përsosjes, nuk ka asnjë lidhje me çështjen e Teuhidit dhe njohjes së All'llahut, si dhe nuk konsiderohet një argument për mohimin e metafizikës, sepse besimi njehsues thotë: Bota është krijuar nga All'llahu i Madhëruar dhe Ai i ka dhënë specifikat çdo krijese dhe Ai i përfshin ato në të gjitha fazat e tyre me mirësinë e Tij.

Këtë kuptim mund ta pranojë vetëm ai që beson teorinë "Vërtetimi i llojeve", ashtu siç e pranon atë ai që shkon te "Zhvillimi i llojeve". Problemi i vetëm që përballet ai që beson hipotezën e Shndërrimit të llojeve, është se kjo hipotezë nuk përshtatet me analizën që e ka sqaruar Kur'ani Famëlartë, rreth krijimit të Ademit, ku përmend mënyrën e krijimit të tij nga dheu dhe balta.

Mbi bazë të kësaj, ne e mohojmë hipotezën e përsosjes, vetëm për këtë shkak dhe jo për shkak se ajo kundërshton çështjen e Teuhidit, kjo nga ana komentuese.

Për sa i përket anës shkencore, domethënë shkencave të natyrës, s'ka dyshim se ne e mohojmë hipotezën e përsosjes, ashtu siç është treguar për të, nga ana e mungesës së argumenteve të sigurta për vërtetimin e saj.

Ajetet 10 – 14

وَقَالُوٓاْ أَءِذَا ضَلَلۡنَا فِي ٱلۡأَرۡضِ أَءِنَّا لَفِي خَلۡقٖ جَدِيدِۭۚ بَلۡ هُم بِلِقَآءِ رَبِّهِمۡ كَٰفِرُونَ ١٠ ۞ قُلۡ يَتَوَفَّىٰكُم مَّلَكُ ٱلۡمَوۡتِ ٱلَّذِي وُكِّلَ بِكُمۡ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُمۡ تُرۡجَعُونَ ١١ وَلَوۡ تَرَىٰٓ إِذِ ٱلۡمُجۡرِمُونَ نَاكِسُواْ رُءُوسِهِمۡ عِندَ رَبِّهِمۡ رَبَّنَآ أَبۡصَرۡنَا وَسَمِعۡنَا فَٱرۡجِعۡنَا نَعۡمَلۡ صَٰلِحًا إِنَّا مُوقِنُونَ ١٢ وَلَوۡ شِئۡنَا لَأٓتَيۡنَا كُلَّ نَفۡسٍ هُدَىٰهَا وَلَٰكِنۡ حَقَّ ٱلۡقَوۡلُ مِنِّي لَأَمۡلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنَ ٱلۡجِنَّةِ وَٱلنَّاسِ أَجۡمَعِينَ ١٣ فَذُوقُواْ بِمَا نَسِيتُمۡ لِقَآءَ يَوۡمِكُمۡ هَٰذَآ إِنَّا نَسِينَٰكُمۡۖ وَذُوقُواْ عَذَابَ ٱلۡخُلۡدِ بِمَا كُنتُمۡ تَعۡمَلُونَ ١٤

"Ata thonë: 'Vallë, pasi të humbasim nën tokë, përsëri do të ngjallemi?' Vërtet, ata nuk besojnë se do të takohen me Zotin e tyre."

"Thuaju: 'Shpirtin do t'jua marrë engjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju, e pastaj do të ktheheni te Zoti juaj."

"Sikur t'i shohësh keqbërësit se si para Zotit të tyre kokulur do të thonë: 'O Zoti ynë, pamë dhe dëgjuam, andaj,

kthena (në atë botë) **që të bëjmë vepra të mira! Ne tashmë besojmë me bindje!"**

"Sikur Ne të donim, do t'ia jepnim secilit udhëzimin e tij, por do të përmbushet Fjala Ime: 'Me të vërtetë, do ta mbush Xhehennemin me xhind dhe njerëz bashkërisht!"

"(Ne do t'u themi atyre)**: 'Shijoni dënimin, sepse nuk e keni besuar takimin e kësaj Dite. Në të vërtetë, Ne ju kemi braktisur, prandaj shijoni dënimin e përhershëm për atë që keni bërë!"**

Komentimi

Pendimi dhe kërkesa për t'u kthyer pas edhe një herë

Këto ajete fillojnë me një diskutim të qartë e të pastër rreth Ditës së Kiametit. Pastaj sqarojnë dhe diskutojnë gjendjen e kriminelëve në Botën Tjetër. Këto ajete janë epilog i diskutimeve të mëparshme, të cilat kanë folur rreth zanafillës, pasi diskutimi për zanafillën dhe Ditën e Kiametit, në shumicën e rasteve, në Kur'anin e Lavdishëm, janë të shoqëruara të dyja. Këta jobesimtarë pyesin me habi se, nëse vdesin dhe trupat e tyre janë shndërruar në dhè dhe janë dekompozuar plotësisht, a do të krijohen përsëri rishtazi?: **"Ata thonë: 'Vallë, pasi të humbasim nën tokë, përsëri do të ngjallemi?'"**.

Kjo mënyrë e të shprehurit: **"Vallë, pasi të humbasim nën tokë..."** tregon se njeriu bëhet dhè pas vdekjes së tij, si të gjitha dherat ai shpërbëhet, si rezultat i faktorëve natyrorë dhe jo natyrorë. Nuk mbetet asgjë prej tij, derisa All'llahu i Madhëruar ta ringjallë atë edhe një herë tjetër në Kiamet.

Vetëm se këta, në të vërtetë, nuk janë mohues të fuqisë së All'llahut: **"Ata nuk besojnë se do të takohen me Zotin e tyre."**.

Ata e mohojnë fazën e takimit me All'llahun, llogarinë, shpërblimin dhe dënimin, për të justifikuar lirinë e veprës dhe të veprojnë atë që dëshirojnë.

Ky ajet ngjason shumë me ajetet e para të sures "El Kijame", të cilat thonë: **"A mendon njeriu se nuk do t'i tubojmë eshtrat e tij? Po, do t'ia tubojmë! Duke qenë se Ne jemi të aftë t'ia rikrijojmë si kanë qenë edhe majat e gishtave të tij! Por, njeriu dëshiron të vazhdojë edhe më tej në mëkate. Andaj, edhe pyet: 'Kur është Dita e Kiametit?'"**.[11]

Në bazë të kësaj, s'ka dyshim se këta nuk janë të paaftë, nga ana e argumentimit, mirëpo pasionet e tyre kanë mbuluar zemrat e tyre, kurse qëllimet e tyre të këqija i kanë penguar ata të pranojnë çështjen e Kiametit. Në të kundërt, s'ka dyshim se All'llahu, që i ka dhënë copës së magnetit forcën që të tërheqë drejt vetes së saj copa shumë të vogla të hekurit dhe të përhapura në brendësi të tonelatave të dheut të tokës, nëpërmjet një xhiroje të shpejtë në atë tokë dhe i mbledh ato me shumë lehtësi, Ai krijon mes atomeve të vogla të trupit të njeriut shembullin e kësaj force të kundërt tërheqëse.

1 Sure "El Kijame", ajetet 3-6.

Kush është ai që mund të mohojë se ujërat e pranishme në trupin e njeriut (shumica e trupit të njeriut është ujë dhe po kështu edhe lëndët ushqyese), atomet e tyre kanë qenë të përhapura në një cep të botës para njëmijë viteve? Për shembull, çdo pikë uji në oqean dhe çdo atom në tokë është bashkuar nëpërmjet reve, shiut dhe faktorëve të tjerë natyrorë dhe kanë formuar, në fund, ekzistencën e njeriut. Pra, cili është ai thirrës i çuditshëm, që të mbledhë dhe të kthejë në gjendjen e tyre të parë, pas tretjes dhe prishjes së tyre?!

Ajeti u përgjigjet këtyre nëpërmjet një mënyre tjetër, duke u thënë që të mos mendojnë se karakteri i tyre është në trupat e tyre, përkundrazi është në shpirtrat e tyre dhe ato janë të përhershme dhe të ruajtura: **"Thuaju: 'Shpirtin do t'jua marrë engjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju, e pastaj do të ktheheni te Zoti juaj.'"**.

Fjala *"jetevefakum"* rrjedh nga fjala "*tuvuffije"* (njësoj si *tesadda*). Kuptimi i saj është *"kapje"*, "*marrje"*. Atëherë, pa dyshim, vdekje nuk do të thotë shkatërrim, përkundrazi është një lloj i kapjes së engjëjve ndaj shpirtit të njeriut, i cili formon ekzistencën më të rëndësishme të njeriut.

Është e vërtetë se Kur'ani flet për Kiametin trupor. Rikthimi i shpirtit dhe trupit lëndor konsiderohet i përfunduar në Kiamet. Ajo që ka për qëllim ajeti i mësipërm, është sqarimi se këto pjesë lëndore që ju angazhuat plotësisht mendjen tuaj, nuk janë themeli i personalitetit të njeriut, përkundrazi themeli është pastërtia shpirtërore, që ka ardhur nga ana e All'llahut te Lartësuar dhe tek Ai kthehet.

Në përgjithësi, mund të thuhet: Dy ajetet e mësipërme u përgjigjen mohuesve të Kiametit me këtë përgjigje: Nëse problemi juaj është shpërbërja e pjesëve të trupit, atëherë s'ka dyshim se ju pohoni fuqinë e All'llahut të Madhëruar dhe nuk e mohoni atë, por, nëse problemi juaj është zhdukja dhe shfarosja e personalitetit të njeriut, menjëherë pas tretjes së atyre atomeve, grimcave, atëherë ajo nuk është e vërtetë, sepse thelbi i personalitetit të njeriut mbështetet te shpirti.

Ky vullnet nuk ndryshon nga dyshimi i njohur (ngrënësi dhe i ngrëni), ashtu edhe përgjigjja e tij, në të dy kuptimet, i ngjason përgjigjes së atij dyshimi.[1]

Ka edhe një çështje që duhet ta sqarojmë. Në disa ajete kur'anore, vdekja i atribuohet All'llahut të Madhëruar: **"All'llahu ua merr shpirtrat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë. Pastaj Ai ndal shpirtin e atij që i është caktuar vdekja, ndërsa të tjerëve ua lë deri në një kohë të caktuar. Me të vërtetë, këto janë shenja për njerëzit që mendojnë."**.[2]

Në ajete të tjera, një grup engjëjsh: **"Engjëjt ua marrin shpirtin, duke qenë të padrejtë ndaj vetvetes. Ata do të shfaqin përulshmëri** (duke thënë)**: 'Ne nuk kemi bërë asgjë të keqe!'** (Dhe do t'u thuhet)**: 'Nuk është kështu! Natyrisht që All'llahu i di mirë veprat që keni punuar.'"**.[3]

1 Për më shumë sqarim rreth dyshimit (ngrënësi dhe i ngrëni) shiko komentimin e tefsirit "El Emthel", fundin e ajetit 260, të sures "El Bekare".
2 Sure "Ez Zumer", ajeti 42.
3 Sure "En Nahl", ajeti 28.

Në ajetet që po komentojmë, marrja e shpirtrave i atribuohet engjëllit të vdekjes dhe nuk ka asnjë kundërshtim mes këtyre shprehjeve, sepse engjëlli i vdekjes ka kuptimin e llojit dhe ai përdoret për të gjithë engjëjt, ose është tregues i engjëllit më të madh dhe kryetarit të tyre. Përderisa të gjithë i marrin shpirtrat me urdhrin e All'llahut të Madhëruar, atëherë veprimi i atribuohet All'llahut.

Pastaj mishëron situatën e këtyre kriminelëve jobesimtarë, mohues të Kiametit, të cilët pendohen shumë në Kiamet për atë që kanë bërë, kur kanë parë argumentet e saj dhe pozitat e tyre të ndryshme. Ajeti thotë: **"E, sikur të shihje mëkatarët se si ulin kokat e veta pranë Zotit të tyre: 'Zoti ynë, tani pamë dhe dëgjuam, na kthe pra edhe një herë e të bëjmë vepra të mira, se tani jemi bindur.'"**.[14]

Do të çuditen me të vërtetë!

Këta të penduar, që kanë ulur kokat e tyre, janë ata mendjemëdhenj kryeneçë, kundërshtues, të cilët nuk i bindeshin në dynja asnjë të vërtete?! Ata ndryshojnë plotësisht, kur shohin panoramat e Kiametit dhe arrijnë nivelin e dëshmisë. Mirëpo ky perceptim dhe ndryshim qëndrimi mbaron shpejt, sepse ata, pa dyshim dhe sipas ajeteve të tjera të Kur'anit, sikur të ktheheshin te kjo dynja, do të ktheheshin në gjendjen e tyre të parë: **"Sikur t'i shohësh ata kur të vihen para zjarrit, duke thënë: 'Ah! Sikur të**

1 Folja *"leu"* në ajetin fisnik është kushtore dhe kushti i saj është fjalia *"ve tera ..."* kurse përgjigjja e kushtit mungon dhe aludimi këtu është: "e sikur t'i shihje mëkatarët ... do të shihje çudi." Në fjalinë: **"Zoti ynë tashmë pamë"** mungon aludimi dhe kuptimi është: Ata thonë Zoti yt tashmë shikuam.

ktheheshim pas, nuk do t'i mohonim Shpalljet e Zotit tonë dhe do të bëheshim besimtarë!'". Sure El En'am", ajeti 27.

Origjina e fjalës *"en nakisu"* është nga fjala *"nekese"* njësoj si fjala *"kelebe"* dhe ka kuptimin e përmbysjes së diçkaje, kurse këtu, do të thotë ulje e kokës deri poshtë dhe përkulja e saj.

Paraprirja e **"tashmë shikuam"** ndaj **"dëgjuam"** është për shkak se njeriu, në fillim, shikon pamjet dhe vendet, pastaj dëgjon përgjigjen e All'llahut dhe të engjëjve.

Nga sa thamë më lart, bëhet e qartë se fjala *"gjynahqarët"* përfshin jobesimtarët dhe në mënyrë të veçantë, mohuesit e Kiametit.

Megjithatë, nuk është hera e parë që, në ajetet e Kur'anit, përballemi me këtë çështje, që gjynahqarët pendohen me një pendim të thellë, kur shikojnë rezultatet e veprave dhe dënimin e All'llahut dhe kërkojnë kthimin në dynja, në kohën kur një kthim i tillë është i pamundur në legjislacionin hyjnor, ashtu si kthimi i fëmijës në mitrën e nënës dhe i frytit të këputur në pemë është i pamundur.

Ajo që meriton të përmendet është: Kërkesa e vetme e gjynahqarëve është kthimi në dynja, që të bëjnë vepra të mira. Prej këtu bëhet e qartë se kapitali i vetëm i shpëtimit në Kiamet janë veprat e mira, ato vepra që burojnë nga një zemër e pastër, e mbushur me besim, ato vepra që kanë qëllim të sinqertë e të pastër.

Meqenëse gjithë kjo këmbëngulje dhe fokusim ka qenë në pranimin e besimit, ka bërë që dikush të besojë dobësinë e All'llahut të Madhëruar që Ai të hedhë dritën e besimit në zemrat

e këtyre, atëherë, pa dyshim, edhe ajeti që vjen më pas, shton: **"Sikur Ne të donim, do t'ia jepnim secilit udhëzimin e tij."**.

Është e padiskutueshme që All'llahu i Lartësuar e zotëron një fuqi të tillë, vetëm se besimi që vërtetohet dhe plotësohet me detyrim, nuk ka asnjë vlerë. Vullneti i All'llahut ka dashur që njeriu të përfitojë fisnikërinë e të qenit zgjedhës, që të ecë në rrugën e përsosjes së tij me lirinë dhe zgjedhjen e tij, prandaj edhe në fund shton: **"por do të përmbushet Fjala Ime: 'Me të vërtetë, do ta mbush Xhehennemin me xhind dhe njerëz bashkërisht!'"**.

Kuptimi i ajetit, me pak fjalë, është: S'ka dyshim se gjynahqarët kanë zgjedhur këtë rrugë me zgjedhjen e tyre të keqe dhe për këtë ata meritojnë dënimin. Ne kemi një vendim të prerë ndaj vetes Sonë, do ta mbushim Xhehennemin me të tillë njerëz.

Duke vërejtur atë që thamë dhe duke parë se qindra ajete kur'anore, të cilat e konsiderojnë njeriun si një krijesë përzgjedhëse me vullnet dhe të ngarkuar me përgjegjësi, përgjegjës ndaj veprave të tij, pranues i udhëzimit nëpërmjet Profetëve dhe i aftë të disiplinojë dhe të edukojë nefsin e tij, atëherë, pa dyshim, çdo imagjinatë që është e ngritur mbi atë që ajeti i mësipërm është argument i arrogancës, ashtu siç e ka menduar atë Fakhru Razi e të tjerë si ai, është qartësisht e pavërtetë.

Mbase fjalia e mësipërme tregon se zullumqarët të mos imagjinojnë se mëshira e gjerë e All'llahut do ta ndalojë dënimin e tyre. Ata të mos krenohen me ajetet e mëshirës së All'llahut dhe ta konsiderojnë veten të sigurt ndaj dënimit hyjnor, pasi s'ka dyshim

se për mëshirën e Tij ka një vend dhe për hidhërimin e Tij ka një tjetër vend.

All'llahu do ta mbajë premtimin e Tij, e sidomos duke vënë re *"lamin"* e betimit në fjalinë (*le'emle enne*) (do ta mbush) dhe *"nuni"* i sigurisë në fundin e saj - dhe do të mbushet Xhehennemi me këta banorë. Nëse Ai nuk e bën, është kundërshtim i urtësisë *(el hikmetu)*. Për këtë flet ajeti që vjen më pas: **"**(Ne do t'u themi atyre)**: 'Shijoni dënimin, sepse nuk e keni besuar takimin e kësaj Dite. Në të vërtetë, Ne ju kemi braktisur, prandaj shijoni dënimin e përhershëm për atë që keni bërë!'"**.

Edhe një herë, nga ky ajet përftohet se harresa e gjykatës së drejtësisë së Kiametit, është baza e hidhërimit dhe e vështirësisë së njeriut, sepse ai do ta shikojë veten e tij në këtë foto, të lirë përballë kryerjes së veprave të shëmtuara, padrejtësisë dhe armiqësisë.[1]

Po kështu, nga ajeti, në mënyrë të qartë, përfitohet se dënimi i përhershëm për individin, është rezultat i veprave që ka kryer në shtëpinë e dynjasë, e për asgjë tjetër.

E përgjithshmja është: Bëhet e qartë se ajo që kuptohet nga "harresa e All'llahut", është mungesa e mbrojtjes së Tij dhe e ndihmës së Tij ndaj tyre. Në të kundërt, pa dyshim, e gjithë bota është gjithmonë tek All'llahu dhe nuk ka kuptim harresa e All'llahut.

1 Për më shumë sqarim, shiko komentimin e fundit të ajetit 107 të sures "Hud"

Dy hulumtime

1- Pavarësia dhe origjinaliteti i shpirtit

Ajeti 10, i cili ka argumentim për marrjen e shpirtrave nëpërmjet engjëllit të vdekjes, është argument i pavarësisë së shpirtit të njeriut, sepse mënyra e të shprehurit me fjalën "*tuvuffije*" (e cila do të thotë "kapje", "marrje") shpall se shpirti mbetet pas ndarjes nga trupi dhe nuk tretet.

Mënyra e të shprehurit për njeriun me shpirt apo me nefs, në ajetin e mësipërm është një dëshmi tjetër në këtë kuptim, sepse shpirti, sipas teorisë së materialistëve, nuk është gjë tjetër veçse veçori fiziologjike dhe kimike e qelizave cerebrale dhe ato zhduken me vdekjen e tyre, njësoj siç zhduken lëvizjet e akrepave të orës pas zhdukjes dhe shkatërrimit të tyre.

Sipas kësaj teorie, pa dyshim se shpirti nuk është ai që ruan personalitetin e njeriut, përkundrazi ai është një pjesë e veçorive të trupit, që tretet me tretjen e trupit.

Ne kemi shumë argumente filozofike për origjinalitetin e shpirtit dhe pavarësinë e tij. Një pjesë të tyre i kemi përmendur në fundin e ajetit 85 të sures "El Isra". Qëllimi në këtë ajet është sqarimi i argumentit tradicional për këtë subjekt. Ky ajet konsiderohet prej argumenteve provues të këtij kuptimi.

2- Engjëlli i vdekjes

Nga ajetet e Kur'anit të Lavdishëm përftohet se All'llahu i Madhëruar i rregullon çështjet e kësaj bote nëpërmjet një grupi engjëjsh. Në ajetin 5 të sures "En Naziat" thuhet: **"...pasha ata që çdo çështje e rregullojnë"**. Ne e dimë se tradita hyjnore ka ndodhur që çështjet të sqarohen me shkaqet e tyre.

Një pjesë e këtyre engjëjve janë ngarkuar me detyrën e marrjes së shpirtrave. Ajetet 28 dhe 33 të sures "En Nahl" dhe disa ajete të tjera kur'anore kanë treguar për këta engjëj. Mbi ta është engjëlli i vdekjes.

Janë transmetuar shumë hadithe në këtë kapitull. Mendojmë se tregimi për disa prej tyre është i nevojshëm në këtë pikë:

a- Në një hadith të transmetuar nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet: *"Sëmundjet dhe dhimbjet janë bartëse të vdekjes dhe të engjëjve të vdekjes! Nëse afrohet Exheli, afati, vjen vetë engjëlli i vdekjes dhe thotë: 'O ti rob, sa lajme ke pasur njëra pas tjetrës? Sa të dërguar kanë ardhur njëri pas tjetrit? Sa korrespondenca ke pasur njëra pas tjetrës? Unë jam lajmi. Pas meje nuk ka më asnjë lajm! Unë jam i dërguari që i përgjigjem Zotit tënd, me dëshirë apo me dhunë. Nëse e merr shpirtin e tij dhe ulërijnë për të, ai thotë: Për kë po ulërini? Për kë po qani? Pasha All'llahun, nuk i kam bërë atij padrejtësi në Exhel dhe as nuk i kam ngrënë riskun, përkundrazi atë e ka thirrur Zoti i tij. Atëherë le të qajë*

qaramani për veten e tij. S'ka dyshim se unë do të kem kthime e kthime, derisa të bëj, që të mos mbetet askush në mesin tuaj.'".[1]

Lexojeni këtë hadith të mrekullueshëm edhe një herë tjetër, pasi në të janë fshehur shumë të vërteta.

b- Në një hadith nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: "I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vizitoi një prej ensarëve. Kur pa engjëllin e vdekjes te koka e tij, tha: *'O engjëlli i vdekjes, trajtoje me mëshirë, me butësi shokun tim, se ai është besimtar'.*

Engjëlli i vdekjes tha: 'Gëzohu o Muhammed, sepse s'ka dyshim se unë jam i butë me çdo besimtar. Dije mirë o Muhammed, se unë vërtet mund ta marr shpirtin e birit të Ademit dhe, kur familja e tij ulërin duke qarë, ngrihem e qëndroj në anë të derës dhe them: Për Zotin, nuk kam asnjë gjynah dhe s'ka dyshim se unë kthehem herë pas here, i kujdesshëm, vigjilent. All'llahu nuk ka krijuar banorë të një shtëpie dhe as të një qyteti dhe as ata të poezisë dhe as beduinë, nomadë, në tokë apo në det, vetëm se unë takohem me ta pesë herë në çdo ditë dhe natë, saqë unë i njoh vetë të vegjlit dhe të mëdhenjtë e tyre.'".[2]

Nga burime të ndryshme islame janë përmendur transmetime të tjera me këtë përmbajtje, që i paralajmëron të gjithë, se largësia mes tyre dhe mes vdekjes nuk është e madhe. Ka shumë mundësi që të përfundojë gjithçka në një çast të shkurtër.

---

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 329, fundi i ajetit është burimi i komentimit. Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 225.

2 Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthur", sipas transmetimit të tefsirit "El Mijzan", vëll. 16, f. 268.

A është e mirë për njeriun, që të gënjehet dhe të mashtrohet me bukuritë e kësaj dynjaje, me stolitë e saj dhe të ndotet me shumë gjynahe dhe padrejtësi, si dhe të jetë i hutuar, i pavëmendshëm nga dënimi i veprave të tij?!

Ajetet 15 - 20

إِنَّمَا يُؤۡمِنُ بِـَٔايَـٰتِنَا ٱلَّذِينَ إِذَا ذُكِّرُواْ بِهَا خَرُّواْ سُجَّدٗا وَسَبَّحُواْ بِحَمۡدِ رَبِّهِمۡ وَهُمۡ لَا يَسۡتَكۡبِرُونَ ۩ ﴿١٥﴾ تَتَجَافَىٰ جُنُوبُهُمۡ عَنِ ٱلۡمَضَاجِعِ يَدۡعُونَ رَبَّهُمۡ خَوۡفٗا وَطَمَعٗا وَمِمَّا رَزَقۡنَـٰهُمۡ يُنفِقُونَ ﴿١٦﴾ فَلَا تَعۡلَمُ نَفۡسٞ مَّآ أُخۡفِيَ لَهُم مِّن قُرَّةِ أَعۡيُنٖ جَزَآءُۢ بِمَا كَانُواْ يَعۡمَلُونَ ﴿١٧﴾ أَفَمَن كَانَ مُؤۡمِنٗا كَمَن كَانَ فَاسِقٗاۚ لَّا يَسۡتَوُۥنَ ﴿١٨﴾ أَمَّا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ ٱلصَّـٰلِحَـٰتِ فَلَهُمۡ جَنَّـٰتُ ٱلۡمَأۡوَىٰ نُزُلَۢا بِمَا كَانُواْ يَعۡمَلُونَ ﴿١٩﴾ وَأَمَّا ٱلَّذِينَ فَسَقُواْ فَمَأۡوَىٰهُمُ ٱلنَّارُۖ كُلَّمَآ أَرَادُوٓاْ أَن يَخۡرُجُواْ مِنۡهَآ أُعِيدُواْ فِيهَا وَقِيلَ لَهُمۡ ذُوقُواْ عَذَابَ ٱلنَّارِ ٱلَّذِي كُنتُم بِهِۦ تُكَذِّبُونَ ﴿٢٠﴾

“Shpalljet Tona i besojnë vetëm ata të cilët, kur u përmenden, bien në sexhde, dhe të cilët e madhërojnë Zotin e tyre, e lavdërojnë dhe nuk bëhen mendjemëdhenj.”

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.”

"Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në Jetën Tjetër)**, si shpërblim për punët e mira që kanë bërë."**

"Vallë! A është besimtari njësoj si keqbërësi? Jo, ata nuk janë të barabartë."

"Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë Xhennetin - Strehim, si shpërblim për punët (e mira) **që kanë bërë."**

"Ndërsa ata që nuk besojnë e që bëjnë keq, vendbanim i tyre do të jetë zjarri. Sa herë që do të duan të dalin nga ai, do të kthehen në të dhe do t'u thuhet: 'Shijoni dënimin e zjarrit, të cilin e mohonit!'"

Komentimi

Shpërblime të mëdha që askush nuk i di

Stili i Kur'anit është që nëpërmjet krahasimit, të bëjë të qartë shumë prej të vërtetave, që çdo gjë të jetë e kuptueshme dhe e qëndrueshme plotësisht në zemër. Ajetet e mëparshme shpjeguan dhe analizuan gjendjen e kriminelëve dhe të jobesimtarëve. Pasi depërton në sifatet e dukshme të besimtarëve

të sinqertë, bën të qartë bazat e tyre fetare dhe programet e tyre brenda dy ajeteve, duke përmendur tetë sifate.[1]

Ajeti 15 thotë: **"Shpalljet Tona i besojnë vetëm ata të cilët, kur u përmenden, bien në sexhde, dhe të cilët e madhërojnë Zotin e tyre, e lavdërojnë dhe nuk bëhen mendjemëdhenj."**.

Fjala *"innema" - "në të vërtetë"*, që zakonisht përdoret për të dhënë kuptimin e limitimit, sqaron se kushdo që flet për besimin dhe nuk ka veçoritë që u përmendën në këtë ajet, nuk është në radhët e besimtarëve të vërtetë, përkundrazi ai është një person me besim të dobët.

Në këtë ajet janë sqaruar katër cilësi:

1- Ata bëjnë sexhde, sapo dëgjojnë ajetet e All'llahut. Mënyra e shprehjes me fjalën *"kharru"* në vend të fjalës *"sexhedu"* është tregues i një sensi të mirë, që këta besimtarë tërhiqen nga fjala e All'llahut, kur dëgjojnë ajetet e Kur'anit dhe i duan ato aq shumë, saqë bien në sexhde pa vetëdije.[2]

Cilësia e parë e tyre është dashuria e zjarrtë dhe lidhja shumë e fortë me fjalën e të dashurit dhe shpirtit të tyre.

---

1 Duhet të kthejmë shikimin te fakti se ajeti i parë është ajeti i parë i sexhdeve të detyruara në Kur'anin Kerim. Nëse dikush nuk e lexon atë plotësisht, apo e dëgjon atë nga një tjetër, atëherë duhet të bëjë sexhde. Sigurisht, në këtë rast nuk është i detyruar abdesi, por duhet të jemi të kujdesshëm në vendin ku do vihet balli, pasi duhet të jetë i pastër.

2 Fjala *"kharru"* rrjedh nga fjala *"el khariru"*, domethënë zëri i ujit apo të ngjashëm me të, kur bie nga një vend i lartë. Përdorimi i tij në këtë shprehje, në lidhje me ata që bëjnë sexhde, është tregues i asaj se zërat e tyre, kur ata bien në tokë për sexhde, ngrihen lart.

Kjo cilësi është përmendur në disa ajete të tjera të Kur'anit, si një nga cilësitë më të dukshme të Profetëve. All'llahu i Madhëruar, në lidhje me një numër Profetësh të mëdhenj, thotë: **"Këta janë ata, të cilët All'llahu i begatoi nga Profetët pasardhës të Ademit, të atyre që Ne i mbartëm me Nuhun, nga pasardhësit e Ibrahimit dhe të Izraelit dhe nga ata që Ne i udhëzuam dhe i zgjodhëm. Kur iu lexoheshin vargjet e të Gjithëmëshirshmit, binin duke bërë sexhde dhe qanin."**.[1]

Megjithëse ajetet këtu, janë përmendur në formë absolute, ajo që kuptohet prej saj, shpesh janë ajetet që bëjnë thirrje në Teuhid dhe në luftimin e idhujtarisë.

2- Shenja e tyre e dytë dhe e tretë është madhërimi dhe falënderimi i i All'llahut, pasi ata, nga njëra anë, i mohojnë çdo të metë All'llahut, kurse, nga ana tjetër, e falënderojnë dhe e lavdërojnë All'llahun me cilësitë e përsosjes dhe të bukurisë së Tij.

3- Cilësia tjetër e tyre është përulja, modestia dhe lënia mënjanë e çdo lloj mendjemadhësie, sepse kryelartësia dhe kryeneçësia janë shkallët e para të mohimit dhe të mosbesimit, kurse përulja para të drejtës dhe të vërtetës janë hapat e para të besimit!

Ata që ecin në rrugën e kryelartësisë dhe të vetëkënaqësisë, nuk i bëjnë sexhde All'llahut, as nuk e madhërojnë dhe as nuk e falënderojnë Atë, si dhe nuk i njohin të drejtat e adhurimit të Tij. Për këta ka një statujë, putë të madhe dhe ajo është vetja e tyre.

1 Sure "Merjem", ajeti 58.

Ajeti 16 tregon për cilësitë e tjera të tyre: **"Ata ngrihen nga shtrati"**[1], duke iu lutur Zotit të tyre. I drejtohen Zotit të tyre dhe të dashurit të tyre, kërkojnë shpëtimin e Tij dhe e adhurojnë Atë.

Këta zgjohen dhe gjallërojnë një pjesë të natës, kur sytë e të pavëmendshmëve janë mbyllur në një gjumë të thellë, kur programet e jetës së zakonshme prishen dhe puna e të menduarit pakësohet në një nivel të ulët, kur qetësia dhe errësira përfshin çdo anë, dhe pakësohet rreziku i ndotjes me dyfaqësi në adhurim.

Përmbledhja është: Kur bashkohen kushtet më të mira të pranisë së zemrës, pa dyshim se ata drejtohen me gjithë qenien e tyre drejt adhurimit. Ulin kokat e tyre te pragjet e derës së të dashurit të tyre të zemrës dhe e lajmërojnë atë çfarë ka në zemrat e tyre, pasi ata janë të gjallë me përmendjen e All'llahut. Trofetë e zemrave të tyre janë të mbushura me dashuri për All'llahun.

Pastaj shton: **"i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë."**.

Ajeti përmend dy cilësi të tjera të tyre, që janë: **"frika"** dhe **"shpresa"**. Nuk kanë të siguruar hidhërimin e All'llahut dhe nuk marrin fuqi nga mëshira e Tij, pasi ekuilibrimi mes frikës dhe shpresës është siguria e përsosjes së tyre dhe ecja në rrugën e All'llahut të Madhëruar dhe gjykatësit të ekzistencës së tyre, sepse triumfi i frikës e tërheq njeriun drejt dëshpërimit dhe humbjes së shpresës, kurse triumfi i shpresës e ngjit njeriun dhe e

1 Fjala *"tetexhafa"* rrjedh nga fjala *"xhefa"*. Kuptimi i saj është: këputja dhe largimi. Fjala *"el xhunubu"* është shumësi i fjalës *"xhenbun"*. Kuptimi është *"ana"*. Fjala *"el medhaxhiu* المضاجع*"* është shumësi i fjalës *"madxheun"* - *"vend fjetjeje"*. Largimi, heqja e anës nga vendi i fjetjes, është metaforë e ngritjes nga gjumi dhe drejtimi kah adhurimi i All'llahut në mesin e natës.

bën atë të hutuar, të pavëmendshëm. Secila prej tyre është armik i njeriut në rrugën e përsosjes së tij drejt All'llahut të Madhëruar.

Cilësia e tetë dhe e fundit është: **"Japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne."**.

Ata nuk u japin nevojtarëve vetëm pasurinë e tyre, por japin edhe nga dituria e tyre, fuqia e tyre, aftësia e tyre, mendimi i tyre i drejtë, përvojat e tyre intelektuale dhe dhurojnë prej tyre ato që kanë nevojë të tjerët.

Ata janë burim i të mirës dhe i begatisë. Janë burim depozitues prej uji të pastër dhe të shëndetshëm për t'u pirë, i cili u jep për të pirë atyre që janë të etur dhe i pasuron nevojtarët, sipas mundësive të tyre.

Cilësitë e tyre janë një bashkësi ideologjie të qëndrueshme: besimi të fortë dhe dashurie përvëluese të All'llahut, adhurim dhe bindje, përpjekje dhe lëvizje këmbëngulëse për të ndihmuar robërit e All'llahut, në të gjitha aspektet.

Ajeti 17 thekson shpërblimin e madh të besimtarëve të vërtetë, të cilët janë të kënaqur me cilësitë e përmendura në dy ajetet e mëparshme. Këtë e jep me një shprehje të bukur, që tregon rëndësinë e paparë të shpërblimit të tyre: **"Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata** (në Jetën Tjetër)**, si shpërblim për punët e mira që kanë bërë."**.

Mënyra e të shprehurit me: **"askush nuk di"** dhe shprehja **"çfarë gëzimesh"** sqarojnë madhështinë e këtyre dhuratave dhe begative, që nuk numërohen dhe nuk kanë kufi. Fjala *"nefsun"* - *"askush"*, që është përmendur në formën e përemrit të pacaktuar, në kontekstin e mohimit, do të thotë se e përgjithshmja përfshin të

gjitha shpirtrat, deri edhe engjëjt e afërt të All'llahut dhe miqtë e All'llahut.

Kurse shprehja **"çfarë gëzimesh"**, pa shtuar edhe nefsin, tregon mirësitë e All'llahut, të cilat janë përcaktuar si shpërblim për besimtarët e sinqertë në Ahiret, në atë formë që bashkë me të janë kënaqësitë e të gjithëve.

Fjala *"kurretun"* rrjedh nga fjala *"el karru"*, që ka kuptimin *"të ftohtët"*. Dihet se lotët e dashurisë janë gjithmonë të ftohta, kurse lotët e dëshpërimit dhe të keqardhjes janë të nxehta, përvëluese. Mënyra e të shprehurit me **"çfarë gëzimesh"** tregon se ajo gjë shkakton brishtësinë e syrit të njeriut, domethënë se dëshira e madhe dhe gëzimi dalin nga sytë e tyre. Kjo është një metaforë e ëmbël rreth kulmit të kënaqësisë, gëzimit dhe lumturisë.

Në një hadith nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe me familjen e tij!)* thuhet: *"All'llahu thotë: 'Kam përgatitur për robërit e Mi të mirë, atë që syri kurrë nuk e ka parë, veshi kurrë nuk e ka dëgjuar dhe zemra e njeriut kurrë nuk e ka ndier.'"*.[11]

Komentuesi i madh, dijetari Tabersiju, në veprën "Mexhmaul Bejan", shtron një pyetje: Përse është fshehur ky shpërblim?

Për këtë pyetje përmend tri përgjigje:

1 Këtë hadith e kanë transmetuar shumë komentues. Njëri prej tyre është Tabersiju. E ka transmetuar në tefsirin "Mexhmaul Bejan". Alusij në tefsirin "Rruhul Meanij" dhe Kurtubiju në tefsirin e tij. E kanë përmendur atë dy muhadithët e njohur, Bukhariu dhe Muslimi.

a- E vërteta e çështjeve të rëndësishme dhe me vlerë nuk mund të perceptohet me lehtësi nëpërmjet shprehjeve dhe fjalëve, prandaj s'ka dyshim se fshehja dhe paqartësia e tyre, ndonjëherë është më shumë nxitëse për aktivizim. Kur'ani është më elokuent dhe i qartë.

b- Ajo gjë që është e kënaqshme, zakonisht është aq e gjerë, saqë dituria e birit të Ademit nuk i arrin të gjitha veçoritë e saj.

c- Meqenëse ky shpërblim është bërë për namazin e fshehtë të natës, pa dyshim se shpërblimi i kësaj vepre do të jetë i madh. Duhet të theksojmë se fjalia: **"Ata ngrihen nga shtrati"**, në ajetin 16, është tregues i namazit të natës.

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Nuk ka asnjë të mirë që shpërblimi i saj të mos jetë i sqaruar në Kur'an, përveç namazit të natës, sepse pa dyshim, All'llahu i Lartësuar nuk e ka sqaruar shpërblimin e tij, për shkak të rrezikut të madh të tij. Prandaj ka thënë:* **'Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata.'"**.[1]

Duke e larguar shikimin nga e gjithë kjo, pa dyshim se Bota e Kiametit, siç e kemi treguar më parë, është një botë më e gjerë se kjo botë e nuk mund të krahasohet, pasi ajo është edhe më e gjerë se jeta e dynjasë, në krahasim me jetën e embrionit në mitrën e nënës. Hapësirat e asaj bote nuk mund të perceptohen nga ne, të burgosurit brenda katër mureve të dynjasë. Imagjinimi i saj nuk është i mundur nga askush.

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 331, fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Ne vetëm dëgjojmë fjalë rreth saj dhe shikojmë nga larg fantazmën e saj. Ne atë botë nuk e perceptojmë dot se nuk e kemi parë. Pa dyshim se është e pamundur perceptimi i rëndësisë dhe i madhështisë së saj, ashtu siç është i pamundur perceptimi i fëmijës në barkun e nënës për mirësitë e kësaj dynjaje, pasi nuk ka akoma të plotësuar logjikën dhe ndjenjën.

E njëjta mënyrë shprehjeje është përmendur për dëshmorët në rrugë të All'llahut, sepse dëshmori, kur bie në tokë, toka i thotë atij: "Mirë se erdhe, o shpirt i mirë, që ke dalë nga trupi i mirë! Gëzohu se për ty ka nga ato që syri s'i ka parë kurrë, veshi nuk i ka dëgjuar kurrë dhe as zemra e njeriut nuk i ka ndier kurrë."[1]

Ajeti 18, sqaron në një formë më të qartë krahasimin që kaloi në ajetet e mëparshme: **"Vallë! A është besimtari njësoj si keqbërësi? Jo, ata nuk janë të barabartë."**.

Fjalia është përmendur në formën e pyetjes mohuese. Kjo pyetje lind përgjigjen e saj nga mendja dhe natyra e çdo njeriu, se këto dy cilësi nuk barazohen kurrë. Në të njëjtën kohë miraton. Ajeti e ka bërë të qartë mungesën e barazisë, me përmendjen e fjalisë: **"nuk janë të barabartë."**.

"Njeriun e shthurur" e ka vënë përballë "besimtarit". Ky është një argument se shthurja, dalja nga rruga është një nocion i gjerë, që përfshin mohimin dhe gjynahet e tjera, sepse kjo fjalë, rrjedh nga rrënja *"u prish fryti"*, nëse i hiqet lëkura e tij. Në këtë kontekst, është përdorur për daljen nga rruga e All'llahut, për shkeljen dhe kundërshtimin e urdhëresave të All'llahut. Ne e

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 2, fundi i ajetit 171 i sures "Ali Imran" dhe tefsiri "El Emthel", fundi i këtij ajeti

dimë se çdokush që nuk beson, apo ka bërë një gjynah, ka dalë nga rruga e All'llahut.

Ajo që e meriton të përmendet është se për sa kohë fryti është brenda lëkurës, është i shëndoshë. Sapo ai të dalë nga lëkura, prishet. Duke u bazuar në këtë shembull, pa dyshim se dalja jashtë rruge e të shthururit, është si prishja e frytit dhe e keqja e saj është si e keqja e tij.

Disa komentues të mëdhenj, në fund të këtij ajeti, kanë transmetuar se Velid ibn Akabe i tha një ditë Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Unë jam më i shkathët se ti në të folur dhe më i fortë se ti në përdorimin e heshtës!"*. Ai mendonte se ia kalonte Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* në të folur dhe në përdorimin e shpatës.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* iu përgjigj: *"Nuk është ashtu si thua ti, o i dalë nga rruga!"*. I tregoi atij se ishte ai që akuzoi Beni Mustalakun se ishin kundër Islamit, në historinë e mbledhjes së zekatit. All'llahu e përgënjeshtroi atë dhe e konsideroi të dalë nga feja, të shthurur, në ajetin 6 të sures "El Huxhurat": **"O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm ju sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni atë ..."**.[11]

Disa kanë shtuar këtu se ajeti: **"A mos është ai që ishte besimtarë, sikurse ai që ishte jashtë rruge?"**, ka zbritur pas këtij

1 E ka përmendur këtë tregim dijetari Tabersiju, në tefsirin "Mexhmaul Bejan" dhe Kurtubiju në tefsirin e tij. Fadil Bersui në tefsirin "Ruhul Meanij". Duhet të theksojmë se nga ajo që lexojmë në librin "Usdul Gabeh fi ma'rifeti Sahabeh" nuk ka kontradiktë mes leximeve të tefsirit të Kur'anit dhe asaj që njohin ata, se ajeti: **"nëse ndonjë i pandërgjegjshëm ju sjell ndonjë lajm"**, ka zbritur për Velid ibn Akaben, në tregimin e Beni Mustalakut.

dialogu. Surja që po komentojmë (surja "Sexhde") ka zbritur në Mekë, kurse tregimi i Velidit dhe i Beni Mustalakut ka ndodhur në Medine, pasi kjo është njësoj si zbatimi i ajetit ndaj miratimit të qartë të saj.

Disa komentues kanë shkuar deri aty sa kanë thënë se ajeti i mësipërm dhe dy ajetet që vijnë pas tij janë medinase. Nuk mbetet dyshim nga kjo anë dhe nuk ka asnjë pengesë që këto tri ajete të kenë zbritur pas dialogut të mësipërm.

E megjithatë, nuk ka asnjë diskutim dhe as polemikë për besimin e thellë e të brendshëm të Prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe as për daljen nga rruga e All'llahut të Velidit, siç u tregua nga ajetet e Kur'anit për secilin nga ata të dy.

Ajeti 19 sqaron, në një formë më të gjerë dhe më të detajuar, mosbarazinë midis këtyre kategorive: **"Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë Xhennetin, si shpërblim për punët** (e mira) **që kanë bërë."**.[1]

Ajeti shton se këto Xhennete i ka përgatitur All'llahu i Lartësuar, për pritjen e tyre, në këmbim të veprave të mira që kanë bërë: **"për hir të veprave që bënë"**.

Me të vërtetë fjala *"nuzulen"*, e cila zakonisht thuhet për një gjë që e përgatisin për pritjen dhe nderimin e mysafirit, është tregues i bukur se besimtarët priten dhe shërbehen gjithmonë, siç është situata e mysafirit, në kohën kur Xhehennemlinjtë, ashtu siç

1 Fjala *"el me'vá "* rrjedh nga fjala *"evá"* me kuptimin: *puthitja e një sendi me një send tjetër*. Pastaj u tha për vendin, banesën dhe vendqëndrimin.

do të vijë në ajetin më pas, janë si të burgosurit, të cilët shpresojnë të dalin prej tij në çdo kohë, pastaj trajtohen si armiq.

Ajo që përmendet në ajetin 102 të sures "El Kehf": **"Ne kemi përgatitur për jobesimtarët Xhehennemin vendpritje"**, është njësoj si ajeti: **"atëherë përgëzoji ata me një dënim të dhimbshëm"**. Këto ajete janë një metaforë se All'llahu i dënon dhe i ndëshkon këta, në vend që t'i nderojë, si dhe i kërcënon me vendin e përgëzimit të tyre.

Disa mendojnë se fjala *"en nezlu"* është gjëja e parë me të cilën pritet miku që vjen për vizitë, si çaji dhe lëngu në kohën tonë. Në bazë të kësaj, s'ka dyshim se është një tregues i ëmbël se Xhennetet janë vendpritjet me plot mirësi dhe begati. Ato janë gjërat e para me të cilat priten mysafirët e Mëshiruesit. Pastaj atë e ndjekin dhuratat me begati të tjera, që nuk i di askush përveç All'llahut të Lartësuar.

Kurse mënyra e të shprehurit me **"ata kanë Xhennetin"**, mbase tregon se All'llahu i Madhëruar nuk ua jep atyre bosh kopshtet e Xhennetit, madje ua bën pronë, deri në përjetësi. Jo vetëm kaq, por nuk ua turbullon qetësinë e mendimit të tyre, duke ua bërë të mundur kënaqësinë e qëndrimit në të.

Ajeti 20 thekson një pikë që u takon atyre: **"Ndërsa ata që nuk besojnë e që bëjnë keq, vendbanim i tyre do të jetë zjarri."**. Këta janë banorë të përhershëm në këtë vend të frikshëm. Ata, **"Sa herë që do të duan të dalin nga ai, do të kthehen në të dhe do t'u thuhet: 'Shijoni dënimin e zjarrit, të cilin e mohonit!'"**.

Edhe një herë tjetër, këtu shikojmë dënimin hyjnor, që është vënë në këmbim të "mosbesimit dhe përgënjeshtrimit",

kurse shpërblimi në këmbim të "veprës". Ky është tregues se nuk mjafton vetëm besimi, përkundrazi duhet të jetë nxitës dhe kërkues i veprës. Mjafton vetëm mosbesimi që njeriu të dënohet, edhe nëse nuk lidhet apo shoqërohet me vepër.

Hulumtim

Ata që rrinë zgjuar natën

Për fjalinë: **"Ata ngrihen nga shtrati"** janë përmendur dy komentime në transmetimet islame: Njëra prej tyre është: Komentimi i saj me namazin e natës. Ky fakt tregon se besimtarët e vërtetë nuk flenë pas namazit të akshamit dhe para namazit të jacisë, nga frika se i kaplon gjumi dhe u ikën namazi i jacisë (sepse ishte bërë zakon në atë kohë që ata nuk pushonin në fillim të natës, duke zbatuar rekomandimin e ndarjes mes pesë namazeve. Secilën prej tyre ata e kryenin në kohën e pëlqyeshme të tyre) dhe mbase nuk zgjoheshin për namazin e jacisë, nëse nuk flinin menjëherë pas namazit të akshamit.

Këtë komentim e ka transmetuar Ibn Abasi, sipas transmetimit të Ed Durr'rrul Menthur. Po kështu, është transmetuar në "Amalij Saduk" nga Imam Sadiku *(Paqja e qoftë mbi të!)*.[1]

1 Tefsiri "Ed Durr'rrul Menthur"; "Amali Saduk" sipas transmetimit të Tefsirit "El Mijzan", vëll. 16, f. 283.

Komentimi i dytë është: Ky ajet flet për ata persona që ngrihen nga dysheku, për të falur namazin e natës. Në një transmetim nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet se ai i ka thënë njërit prej shokëve të tij: *"A të të tregoj ty për rrënjën e Islamit, për degën e tij dhe për kulmin e tij?"*

Ai u përgjigj: *"Posi jo, t'u bëfsha kurban."*

Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: *"Rrënja e tij ai është namazi, dega e tij është zekati, kurse kulmi i vendit të ngritur të tij është xhihadi. A dëshiron të të tregoj ty për dyert e mirësisë?"*

Ai tha: *"Po, t'u bëfsha kurban."*

Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Agjërimi është mburojë, sadakaja e fshin gjynahun dhe ngritja e njeriut në errësirën e natës me përmendjen e All'llahut."* Pastaj lexoi ajetin: **"Ata ngrihen nga shtrati."**.[1]

Në tefsirin "Mexhmaul Bejan" është transmetuar për Muadh ibn Xhebelin.

Ishim me të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Betejën e Tebukut. Ishte shumë nxehtë dhe njerëzit ishin të shpërndarë. Kur i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u afrua afër meje dhe unë u afrova afër tij, i thashë: *"O i Dërguari i All'llahut më këshillo me një vepër që të më fusë mua në Xhennet dhe të më largojë nga zjarri."*.

1 "Usulul Kafij", vëll. 2 , Kreu "Shtyllat e Islamit", Hadithi 15, f. 20 dhe tefsiri "El Mijzan", vëll. 163 , f. 283.

I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Ke pyetur për diçka të madhe, por ajo është e lehtë për atë, që All'llahu ia lehtëson atij: Të adhurosh All'llahun, të mos i bësh Atij ortak (shirk), të falësh namazet e obliguara (farzet), të japësh zekatin e obliguar dhe të agjërosh muajin e Ramazanit."*.

I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* më pyeti: *"Do të të tregoj për dyert e mirësisë?"*

I thashë: *"Po."*

I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Agjërimi është mburojë, sadakaja e fal gjynahun dhe ngritja e njeriut në errësirën e natës, duke kërkuar kënaqësinë e All'llahut."*. Pastaj lexoi këtë ajet: **"Ata ngrihen nga shtrati."**.[1]

Pavarësisht mungesës së pengesës, ajeti ka kuptim të gjerë, që përfshin qëndrimin zgjuar në fillim të natës për namazin e jacisë, duke shtuar ngritjen në syfyr për namazin e natës. Ideja më e saktë për fjalën *"tetexhafa" - "i ngritën"* reflekton më shumë në mendje kuptimin e dytë, sepse fillimi i ajetit thotë se trupat janë shtrirë dhe janë qetësuar në dyshekë, pastaj janë ngritur dhe janë larguar prej tij. Kjo gjendje i përshtatet fundit të natës për faljen e namazit. Duke u bazuar në këtë përfundim, seria e parë e transmetimeve është si gjithëpërfshirësja e nocionit dhe e anulimit të veçorisë.

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 331 , fundi i ajetit është burimi i komentimit. Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 229.

Megjithëse këto transmetime të pakta duken të mjaftueshme rreth rëndësisë së këtij namazi të bekuar, transmetimet islame i kanë dhënë këtij adhurimi një rëndësi të madhe. Shumë pak është folur për një adhurim tjetër.

Ndihmësit e të vërtetës dhe ata që kanë zgjedhur rrugën e mirësisë, i kanë dhënë shumë rëndësi këtij adhurimi të sinqertë, i cili e ndriçon zemrën dhe e pastron atë nga të gjitha defektet.

Mund të ndodhë që disa të mos kenë gjithmonë sukses në këtë adhurim të bekuar. Nuk ka asnjë pengesë që individi të përpiqet ta fitojë këtë sukses në disa net dhe, kur nata lëshon perden e saj dhe zërat qetësohen, kurse sytë flenë, atmosfera bëhet e gatshme për praninë e zemrës, që nxiton të bisedojë në fshehtësi me All'llahun, e ndriçon zemrën e tij me dritën e dhembshurisë dhe dashurisë së All'llahut.[11]

1 Kemi pasur një diskutim tjetër rreth rëndësisë së namazit të natës dhe mënyrës së tij, në fundin e ajetit 79 të sures "El Isra".

Ajetet 21 - 22

وَلَنُذِيقَنَّهُم مِّنَ ٱلۡعَذَابِ ٱلۡأَدۡنَىٰ دُونَ ٱلۡعَذَابِ ٱلۡأَكۡبَرِ لَعَلَّهُمۡ يَرۡجِعُونَ ﴿٢١﴾ وَمَنۡ أَظۡلَمُ مِمَّن ذُكِّرَ بِـَٔايَٰتِ رَبِّهِۦ ثُمَّ أَعۡرَضَ عَنۡهَآۚ إِنَّا مِنَ ٱلۡمُجۡرِمِينَ مُنتَقِمُونَ ﴿٢٢﴾

"Dhe, Ne do të bëjmë që të shijojnë një dënim më të lehtë në këtë jetë, para dënimit më të madh në Jetën e Përtejme, ndoshta kthehen në rrugën e drejtë."

"Kush është më i padrejtë se ai që, kur i përmenden Shpalljet e Zotit të tij, nuk ua vë veshin atyre? Vërtet, Ne do të hakmerremi ndaj keqbërësve."

Komentimi

Dënime edukative

Pas diskutimit që u bë në ajetet e mëparshme, për kriminelët dhe dënimet të tyre të dhimbshme, ajetet 21-22 tregojnë një nga mirësitë e fshehta hyjnore, kuptimet e dënimit të lehtë në dynja.

All'llahu i Madhëruar nuk dëshiron kurrë që ta sprovojë një rob me dënimin e përhershëm dhe për këtë përdor të gjitha mënyrat e paralajmërimit për shpëtimin e tij: i dërgon Profetët, i zbret libra qiellorë, i begaton me mirësi dhe i sprovon me fatkeqësi. Nëse nuk bën dobi asnjë prej këtyre mënyrave, atëherë nuk kanë rrugë tjetër veçse zjarrin e Xhehennemit.

Ajeti 21 thotë: **"Dhe, Ne do të bëjmë që të shijojnë një dënim më të lehtë në këtë jetë, para dënimit më të madh në Jetën e Përtejme, ndoshta kthehen në rrugën e drejtë."**

Është e padiskutueshme se *"dënimi më i hershëm"* ka një kuptim të gjerë, që përfshin pjesën më të madhe të supozimeve, të cilat komentuesit i kanë shkruar në mënyrë të detajuar.

Njëra prej tyre ka për qëllim fatkeqësitë, dhimbjet dhe vështirësitë.

Po përmendim një shembull: Thatësira e madhe zgjati shtatë vjet. Me këtë thatësirë u sprovuan idhujtarët në Mekë, saqë u detyruan të hanë kufomat e të vdekurve.

Apo goditja e ashpër dhe e fortë që zbriti mbi ta në Betejën e Bedrit. Ka shumë e shumë raste si këto.

Kurse për sa i përket mendimit të disave, që supozuan se ajo që kuptohet nga ajeti, është dënimi i varrit, apo dënimi i kthimit, përsëri prapa në injorancë, nuk është i saktë, sepse nuk i përshtatet fjalisë **"ndoshta kthehen në rrugën e drejtë"**, domethënë nga veprat e tyre të këqija.

Është e padiskutueshme se dënimi është i pranishëm edhe në këtë botë. Nëse zbret, mbyllen dyert e pendimit. Ai është

dënimi i vazhdueshëm, domethënë dënimi dhe ndëshkimet që zbresin për shkatërrimin e popujve gjynahqarë, kur nuk u bën dobi dhe nuk ndikon tek ata asnjë mënyrë paralajmërimi.

Kurse grupi emëror *"dënimit më të madh"*, tregon dënimin e Ditës së Kiametit, i cili e tejkalon çdo dënim për nga përmasa dhe dhimbja.

Një pjesë e komentuesve të Kur'anit kanë treguar se përse fjala *"edna"* - *"më e afërt"*, është vënë përballë fjalës *"el ekber"* - *"më e madhe"*, kur duhet të ishte fjala *"më e afërt"* përballë fjalës *"më e largët"*, apo fjala *"më e vogël"* përballë fjalës *"më e madhe"*.

Kjo paraqitje është vënë kështu, sepse dënimi i dynjasë ka dy cilësi: i vogël dhe i afërt. Nuk është e përshtatshme miratimi i vogëlsisë së tij te kërcënimi, madje duhet të theksohet të qenit afër tij. Edhe për dënimin e Ahiretit ka, gjithashtu, dy cilësi: të qenit larg dhe i madh. E përshtatshme në lidhje me të është fokusimi i të qenit i madh dhe i madhështisë së tij dhe jo i largësisë së tij. Vëreni me kujdes.

Më parë kemi përmendur se mënyra e të shprehurit me *"leal'le"* - *"ndoshta"* në fjalinë **"ndoshta kthehen në rrugën e drejtë"**, është për shkak se ndjeshmëria për dënimet paralajmëruese nuk është një arsye e plotë për t'u ndërgjegjësuar dhe për t'u zgjuar, madje ajo është një pjesë e arsyes dhe ka nevojë për kushte të përgatitura. Pa këtë kusht, nuk vërtetohet rezultati i kërkuar. Fjala *"leal'le"* - *"ndoshta"* është tregues i kësaj të vërtete.

Nga ky ajet bëhet i qartë një nga ligjet e fatkeqësive, të sprovave dhe të dhimbjeve, të cilat konsiderohen një nga çështjet

urgjente dhe ndikuese të polemikës në diskutimin e Teuhidit dhe njohjes së All'llahut dhe drejtësisë së Tij.

Për këtë të vërtetë nuk flitet vetëm në këtë ajet, por edhe në ajete të tjera të Kur'anit. Njëri prej tyre është ajeti 94 i sures "El A'raf": **"Ne nuk e dërguam asnjë Pejgamber në ndonjë vendbanim e që nuk e ndëshkuam atë** (popullin) **me skamje e vështirësi të tjera, në mënyrë që ata të përulen** (të binden)**."**.

Përderisa nuk bëri dobi asnjë mënyrë prej mënyrave të ndërgjegjësimit dhe të paralajmërimit, deri edhe ndëshkimi hyjnor, atëherë nuk mbeti rrugë tjetër përveç hakmarrjes së All'llahut ndaj këtij populli zullumqar. Po kështu thotë edhe ajeti që vjen më pas: **"E kush është më zullumqar se ai që këshillohet me ajetet e Zotit të vet, e pastaj u kthyen shpinën atyre? Ne me siguri do të hakmerremi kundër kriminelëve."**.

Atyre nuk u bëri asnjë efekt mirësia hyjnore, as ndëshkimi dhe sprovat paralajmëruese. Për këtë gjë nuk ka askënd më zullumqar se ata. Nëse nuk hakmerret kundër këtyre, atëherë kundër kujt do të hakmerret?

Është e qartë, duke parë edhe ajetet e mëparshme, se ajo që kuptohet me fjalën *"el muxhrimine" - "kriminelëve"*, janë mohuesit e zanafillës dhe Ditës së Kthimit, të cilat ata nuk i besojnë.

Një grup njerëzish, në ajetet e Kur'anit, janë përshkruar shpesh në këtë mënyrë: janë *"më zullumqarët"* se pjesa tjetër. Pavarësisht mënyrave të ndryshme të shprehjes, ato të gjitha i referohen origjinës së mohimit dhe idhujtarisë. Në bazë të kësaj, pa dyshim, se kuptimi i fjalës *"më zullumqarët"*, e cila

konsiderohet një formë përjashtuese, shoqërohet me këto miratime.

Kurse mënyra e të shprehurit me *"thumme"* - *"pastaj"* në ajet, e cila zakonisht tregon për shtendosjen, mbase tregon se njerëz të tillë, si këta, u jepet një shans dhe një aspekt i mjaftueshëm për të menduar dhe për të diskutuar. Gjynahet e tyre fillestare nuk janë kurrë shkaktare të hakmarrjes së All'llahut, vetëm se ata do ta meritojnë hakmarrjen e All'llahut, pas përfundimit të shansit të nevojshëm.

Duhet të theksojmë se fjala *"el intikamu"*, në gjuhën arabe, do të thotë *"ndëshkim"*, siç thuhet në "Lisanul Arab". Edhe pse kuptimi i fjalës është bërë "bisedë e përditshme", do të thotë, kurimi i zemrës dhe ftohja e etjes për hakmarrje. Ky kuptim nuk ekziston në rrënjën gjuhësore, prandaj s'ka dyshim se kjo shprehje është përdorur shpesh në Kur'anin Famëlartë për All'llahun. All'llahu i Madhëruar është më i Larti dhe më i Ngrituri nga këto nocione, pasi Ai nuk bën asgjë që nuk është në përputhje me urtësinë e Tij.

Ajetet 23 - 25

وَلَقَدْ ءَاتَيْنَا مُوسَى ٱلْكِتَٰبَ فَلَا تَكُن فِى مِرْيَةٍ مِّن لِّقَآئِهِۦ ۖ وَجَعَلْنَٰهُ هُدًى لِّبَنِىٓ إِسْرَٰٓءِيلَ ﴿٢٣﴾ وَجَعَلْنَا مِنْهُمْ أَئِمَّةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا لَمَّا صَبَرُوا۟ ۖ وَكَانُوا۟ بِـَٔايَٰتِنَا يُوقِنُونَ ﴿٢٤﴾ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ يَفْصِلُ بَيْنَهُمْ يَوْمَ ٱلْقِيَٰمَةِ فِيمَا كَانُوا۟ فِيهِ يَخْتَلِفُونَ ﴿٢٥﴾

"Ne i dhamë Musait Librin (Teuratin) **- prandaj mos dysho në takimin me atë - dhe e bëmë atë udhërrëfyes për bijtë e Izraelit."**

"Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm dhe besonin bindshëm."

"Me të vërtetë, Zoti yt do të gjykojë midis tyre Ditën e Kiametit, për çështjet në të cilat kishin mosmarrëveshje."

Komentimi

Kushti i udhërrëfimit është durimi dhe besimi

Ajetet që po komentojmë, na tregojnë shkurtimisht për historinë e Musait dhe Beni Israilëve, për të ngushëlluar Profetin e Islamit *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe besimtarët e parë, për të qetësuar shpirtrat e tyre. Këto ajete i ftojnë ata të vetëpërmbahen, të jenë të duruar dhe të fortë përballë përgënjeshtrimit dhe mohimit të idhujtarëve, që, me triumfin e tyre, të jenë përgëzim për besimtarët ndaj popullit jobesimtar, kryeneç, ashtu siç triumfuan Beni Israilët ndaj armiqve të tyre dhe u bënë udhërrëfyes në tokë. Për këta është folur në ajetet e mëparshme.

Përderisa Musai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka qenë një Profet i madh, që i besuan të gjithë çifutët dhe të krishterët, atëherë s'ka dyshim se ai orienton ithtarët e librit drejt Kur'anit dhe Islamit.

Ajeti 23 thotë: **"Ne i dhamë Musait Librin** (Teuratin) **- prandaj mos dysho në takimin me atë - dhe e bëmë atë udhërrëfyes për bijtë e Izraelit."**, domethënë ti mos ki dyshim apo të hamendësosh në atë që Musai ka marrë, argumentet e All'llahut. Ne e kemi bërë librin e Musait, Teuratin, një metodë udhëzimi të Beni Israilëve: **"dhe e bëmë atë udhërrëfyes për bijtë e Izraelit."**.

Në mesin e komentuesve ka mendime të ndryeshme për sa i përket referimit të përemrit: **"në takimin me atë"**. Për këtë ka pasur shtatë ose më shumë supozime. Supozimi më i afërt është

referimi ndaj librit qiellor të Musait, domethënë, Teuratit. Siç duket, edhe ai ka kuptimin e objektit dhe të subjektit të Musait. Në bazë të kësaj, pa dyshim se kuptimi i përgjithshëm i kësaj fjalie bëhet: Nuk ka dyshim se Musai *(Paqja qoftë mbi të!)* e mori librin qiellor, i cili iu dorëzua atij nga ana e All'llahut. Dëshmia më e fortë për këtë komentim është: Në ajetin e mësipërm janë përmendur tri fjali. Fjalia e parë dhe e fundit flet në mënyrë të prerë për Teuratin. Është e pranueshme, që edhe fjalia e mesit, të ndjekë, gjithashtu, po këtë kuptim, e jo të flasë për Kiametin apo Kur'anin Famëlartë dhe në këtë mënyrë të bëhet një fjali sfiduese, kundërshtuese. Ne e dimë se fjalia kundërshtuese është një kontradiktë e hapur dhe, përderisa vazhdojmë të kemi nevojë për të, atëherë nuk duhet të orientohemi drejt saj.

Duhet të theksojmë se mënyra e të shprehurit me fjalën *"likaun"*, edhe nëse nuk është përdorur në Kur'an në kuptimin e librave qiellorë, por fjalët *"il kaun"* - *"hedhur"* dhe *"telekki"* - *"merr"*, janë përdorur shpesh me këtë kuptim, ashtu si në ajetin 25 të sures "El Kamer": **"Vallë, vetëm atij mes nesh t'i dërgohet Shpallja?"**.

Në historinë e Sulejmanit dhe të mbretëreshës Sebe lexojmë se ajo, kur i erdhi mesazhi i Sulejmanit, ka thënë: **"Mua më ka ardhur një letër madhështore."**.[1]

Në po këtë sure, "Surja e Sulejmanit", në ajetin 6, në lidhje me Kur'anin lexojmë: **"S'ka dyshim se ti** (Muhammed) **e pranon Kur'anin nga i Urti, i Dijshmi."**.

1 Sure "En Neml", ajeti 29.

Në bazë të kësaj, s'ka dyshim se foljet *"il kaun"* dhe "*telekki"* janë përdorur shpesh në këtë kuptim, madje edhe vetë folja *"likaun"* është përdorur në kuptimin e librit të veprave të njeriut. Në ajetin 13 të sures "El Isra" lexojmë: **"Në Ditën e Gjykimit, Ne do t'ia prezantojmë atij si një libër të hapur."**.

Nga gjithçka që thamë, bëhet e qartë preferenca e këtij komentimi ndaj të gjitha supozimeve që u bënë në ajetin e mësipërm.[1]

---

1 Disa komentues kanë shkuar deri aty sa kanë thënë se pika e referimit të përemrit, te fjala *"likaihi",* është Musai. Duke u bazuar te ky mendim, kuptimi bëhet: Nuk ka dyshim se ti o Muhammed, do të takohesh me Musain. E konsideruan atë një tregues të takimit të Profetit Muhammed me Musain, në natën e Miraxhit, ose në Ditën e Kiametit. Ky kuptim nuk duket i harmonizuar me nocionin e fjalisë.

Kurse disa të tjerë kanë thënë: Përemri i referohet librit dhe ka për qëllim Kur'anin, domethënë: Mos ki asnjë dyshim o Profet, se ky Kur'an është një mënyrë shpalljeje hyjnore te ti. Ky kuptim, edhe në qoftë se është i saktë, është në harmoni me fillimin e sures, por nuk harmonizohet shumë me fjalitë e tjera që janë të pranishme në këtë ajet. Duhet të shtojmë se libri, në ajetin që po komentojmë, është me kuptimin e Teuratit, pra, referimi i përemrit nuk harmonizohet me Kur'anin. Orientimi ndaj këtij kuptimi, në mënyrë absolute është libri qiellor, është një kontradiktë e hapur.

Kurse disa komentues kanë thënë se përemri *"likaihi"* i referohet All'llahut. Kjo fjali tregon se nuk ka asnjë dyshim në çështjen e kthimit (Kiametit). Ky kuptim, edhe nëse harmonizohet me ajetet e mëparshme, nuk harmonizohet, në asnjë mënyrë të përafërt, me vetë ajetin që po komentojmë.

Prej këtu bëhet e qartë se ajo që u përmend në një pjesë të komentimeve, ajeti është tregues i marrjes së planit dhe i programit të Musait dhe i Profetit të Islamit, është një kërkesë e shijshme, që nuk i përshtatet nocionit aktual të shprehjeve të ajetit. Në bazë të kësaj, pa dyshim, se komentimi më i qartë dhe më i pastër është ai që përmendëm më sipër.

Mirëpo duhet të theksojmë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk ka dyshuar kurrë në çështje të tilla. Shprehje të tilla përdoren zakonisht për të siguruar kërkesën dhe për të qenë model, shembull për të tjerët.

Ajeti 24 na tregon për nderimet dhe trajtimet madhështore që arritën Beni Israilët nën hijen e qëndrimit në rrugën e drejtë të besimit, duke qenë mësim për të tjerët: **"Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm dhe besonin bindshëm."**.

Ajeti ka përmendur këtu dy kushte për të qenë prijës. Kushti i parë është besimi dhe bindja në argumentet e All'llahut. Kushti i dytë është durimi, qëndrimi në rrugën e drejtë dhe vendosmëria. Kjo çështje nuk është e veçantë për Beni Israilët, përkundrazi është një leksion për të gjithë popujt dhe për të gjithë myslimanët e djeshëm, të sotëm dhe të së nesërmes, që ata të forcojnë shtyllat e bindjes, të besimit të tyre dhe të mos kenë frikë nga problemet që hasin në rrugën e Teuhidit, si dhe të jenë të durueshëm dhe të fortë. Këta prijës janë Imamët e krijesave, udhëheqësit e popujve dhe udhërrëfyesit e tyre në historinë e botës.

Fjalët *"jehdune"* dhe *"jukinune"*, në formën e foljes së tashme, janë argument i vazhdimësisë së këtyre dy cilësive gjatë jetës së tyre, sepse çështja e udhëheqjes nuk mund të shmanget një çast nga problemet dhe personi udhëheqës, Imami i njerëzve, përballet me një problem të ri në çdo hap. Ai, për t'i përballuar të gjitha vështirësitë, duhet të ketë "armët" e tij, forcën e bindjes,

qëndrimin e vazhdueshëm në rrugën e drejtë dhe të përjetësojë vijën e udhëzimit drejt All'llahut të Madhëruar.

Ajo që e meriton vëmendjen është se ajeti e lidh udhëzimin me urdhrin e All'llahut dhe thotë: **"udhëzonin me urdhrat Tanë"**. Kjo është e rëndësishme në urdhrin e udhëzimit, që të burojë nga urdhëresat hyjnore, jo nga urdhrat e njerëzve, apo tradita e kësaj apo e asaj, apo me urdhrin e nefsit, të prirjeve apo devijimeve të zemrës.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!*) thotë: "*Prijësit në librin e All'llahut janë dy lloje. All'llahu i Madhëruar dhe i Lartësuar ka thënë se Ne i bëmë ata prijës që të udhëzojnë me urdhrin Tonë, jo me urdhrin e njerëzve dhe t'i paraprijnë urdhrit Tonë, para urdhrit të tyre dhe ligjit Tonë, para ligjit të tyre. Dhe tha: I bëmë ata prijës që ftojnë në zjarr sepse ata paraprijnë urdhrin e tyre para urdhrit Tonë dhe ligjin e tyre para ligjit Tonë dhe i përdorin pasionet e tyre në kundërshtim me atë çfarë ka në librin Tonë.*"[1]

Pastaj, s'ka dyshim se qëllimi i përdorimit të fjalës "*urdhri*", këtu është për urdhrin legjislativ, apo urdhrin që në krijim. Fillimi i ajetit na jep kuptimin e parë, kurse shprehjet dhe transmetimet e komentuesve e mbështesin atë. Vetëm një pjesë e komentuesve të mëdhenj e kanë konsideruar atë me kuptimin e urdhrit që në krijim.

Sqarimi i asaj është: Udhëzimi është përmendur në ajete dhe transmetime me dy kuptime: "sqarimi i rrugës" dhe "të dorëzosh atë që të kërkohet". Po kështu edhe udhëzimi i prijësve

1 "Usulul Kafij", vëll. 1, Kreu "Imamët në librin e All'llahut janë dy llojesh", f. 168.

hyjnorë merr dy pamje: Nganjëherë mjaftohen me urdhërim dhe ndalim, kurse herë të tjera depërtojnë në thellësitë e zemrës së përgatitur, që e meriton udhëzimin, duke e lidhur atë me qëllimet edukative dhe pozita të larta shpirtërore.

Mirëpo, në disa ajete kur'anore, fjala *"el emru"* është përdorur me kuptimin e "urdhrit legjislativ", njësoj si: **"Kur Ai dëshiron ndonjë gjë, urdhri i Tij është vetëm t'i thotë: 'Bëhu!' Ai menjëherë bëhet."**.[1]

Kurse fjalia: **"udhëzonin me urdhrat Tanë"**, në ajetin që po diskutojmë, është, gjithashtu, tregues i këtij kuptimi, domethënë, ata kanë qenë prijës që, me fuqinë e All'llahut, hynin në shpirtrat e përgatitura dhe i orientonin ata drejt qëllimeve të larta edukative dhe njerëzore.[2]

Ky kuptim meriton të vërehet dhe të shikohet me kujdes, sepse është një nga çështjet e prijësisë, një prej degëve dhe mënyrave të udhëzimit. Kufizimi i fjalisë "**udhëzonin me urdhrat Tanë"**, me këtë kuptim, nuk bie dakord me fillimin e ajetit. Mirëpo nuk ka asnjë pengesë që ta komentojmë fjalën e urdhërimit në këtë fjali me kuptimin e saj të gjerë, e cila përfshin edhe urdhrin legjislativ dhe bashkon kuptimet e udhëzimit në ajet. Ky kuptim harmonizohet me disa hadithe të përmendura në komentimin e këtij ajeti.

Mirëpo, sido që të jetë, nuk është e mundur që prijësi dhe udhëzuesi të arrijë në këtë pozitë vetëm se nën hijen e bindjes dhe qëndrimit në rrugë të drejtë.

---

1 Sure "Ja Sin", ajeti 82.
2 Tefsiri "El Mijzan", vëll. 1, f. 275 .

Mbetet një pyetje për t'u bërë: Fjala *"prijës"* nënkupton Profetët që u dërguan tek ata, apo dijetarët që i udhëzonin njerëzit në punë të mira me urdhrin e All'llahut?

Ajeti hesht për këtë dhe është mjaftuar vetëm me fjalinë: **"Ne kemi bërë prej tyre prijës."**.

Mirëpo fjala *"xhealna" - "kemi bërë"*, orienton mendjen tonë, se ajo që synohet, janë Profetët, të cilët u ngritën në këtë pozitë me urdhrin e All'llahut.

Meqenëse Beni Israilët, si të gjithë popujt patën konflikte pas këtyre prijësve të vërtetë dhe zgjodhën rrugë të ndryshme, atëherë edhe ajeti 25, me një ton kërcënues, thotë: "**Me të vërtetë, Zoti yt do të gjykojë midis tyre Ditën e Kiametit, për çështjet në të cilat kishin mosmarrëveshje."**.

S'ka asnjë dyshim se burimi i konfliktit gjithmonë është përzierja e të vërtetës me dëshirat dhe pasionet. Përderisa Dita e Kiametit është një ditë që në të nuk kanë asnjë kuptim as pasionet e as dëshirat, ku pastrohet e vërteta me pamjet e saj më të kthjellëta, atëherë atje All'llahu i Madhëruar i ndalon konfliktet me urdhrin e Tij. Kjo është, gjithashtu, një nga filozofitë e Kiametit. Vërejeni me kujdes këtë.

Hulumtim

Mbështetja dhe qëndrimi në rrugën e drejtë i udhëheqësve hyjnorë

Kemi thënë se në ajetet që po diskutojmë janë përmendur dy kushte të prijësve. Kushti i parë është durimi dhe vendosmëria, kurse kushti tjetër është besimi dhe bindja në argumentet e All'llahut.

Për këtë durim dhe vendosmëri ka shumë degë dhe forma.

Nganjëherë janë para fatkeqësive, të cilat zgjidhen me njeriun.

Herë të tjera janë përballë dëmit, i cili fabrikohet me shokët dhe mbështetësit e tij.

Ka raste, kur janë përballë armiqësive dhe gjuhëve të pista, që përfitojnë shenjtërimet e saj.

Raste të tjera, përballë të devijuarve nga mendja.

Ka raste, kur gjenden para injorantëve idiotë.

Por ka dhe raste, kur gjenden përballë dijetarëve të pisët.

Përmbledhja është: Udhëheqësi i ndërgjegjshëm dhe udhërrëfyes duhet të qëndrojë fort para të gjitha këtyre problemeve dhe të mos tërhiqet nga fusha e betejës dhe e ngjarjeve. As të mos frikësohet, as të mos humbë shpresën, as të mos e humbasë kontrollin e çështjeve nga dora e tij, as të mos

bëhet konfuz dhe as të mos pendohet, derisa të realizojë qëllimin e tij të madh.

Në këtë kapitull, është transmetuar një hadith gjithëpërfshirës dhe i mrekullueshëm nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*. Ai i ka thënë njërit prej shokëve të tij: "*Kush duron, ka duruar pak, se pas saj vjen triumfi. Kush frikësohet, është frikësuar pak, se pas saj vjen humbja.*

Pastaj i tha: Duhet të bësh durim me të gjitha çështjet, sepse All'llahu e ka dërguar Muhammedin dhe e ka urdhëruar atë të durojë dhe të jetë i butë: **"Duroji llomotitjet e atyre dhe largohu nga ata në mënyrë të hijshme!"**[1]

"**Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë. Ky virtyt u dhurohet vetëm atyre që durojnë dhe vetëm atyre që kanë një fat të madh."**.[2]

I Dërguari i All'llahut duroi, derisa fatkeqësitë e zunë. Atë e qëlluan, e quajtën magjistar, budalla dhe poet. E përgënjeshtruan atë në thirrjen e tij. Atij iu ngushtua gjoksi, por All'llahu zbriti mbi të: **"Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë. Kur dëshiron të lexosh Kur'anin, kërko mbrojtjen e All'llahut kundër djallit të mallkuar."**.[3] Pa dyshim, ky adhurim të jep ty qetësinë dhe rehatinë.

1 Sure "El Muzzemmil", ajeti 10.
2 Sure "Fussilet", ajetet 34-35.
3 Sure "En Nahl", ajetet 97- 98.

Pastaj atë e përgënjeshtruan dhe e qëlluan me gurë. U dëshpërua shumë për këto veprime. All'llahu i zbriti këto ajete: **"Ne e dimë se ty të zemëron ajo që thonë ata. Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë Shpalljet e All'llahut. Edhe para teje** (o Muhammed)**, shumë të Dërguar janë mohuar, por ata e kanë duruar mohimin dhe lëndimin** (që kanë pësuar)**, derisa u ka ardhur ndihma Jonë, sepse askush nuk mund t'i ndryshojë vendimet e All'llahut. Ti tashmë ke dëgjuar për ata të Dërguar."**.[1]

Profeti Muhammed u tregua i duruar. E dhunuan, i përmendën All'llahun e Lartësuar dhe e përgënjeshtruan atë. Ai u tha se kishte duruar jo vetëm ai, por edhe familja e tij, por nuk kishte fare durim në përmendjen e Zotit. All'llahu zbriti: "**Edhe para teje** (o Muhammed)**, shumë të Dërguar janë mohuar, por ata e kanë duruar mohimin dhe lëndimin** (që kanë pësuar)**."**. *Profeti Muhammed duroi në të gjitha situatat e tij.*

Pastaj u përgëzua me trashëgimtarët e tij, me prijës, të cilët kishin si tipar dallues durimin. Në këtë rast tha se durimi është prej besimit, siç koka është për trupin. Falënderoi All'llahun e Madhëruar për atë që i dha dhe All'llahu ia lejoi atij luftimin e idhujtarëve. All'llahu i luftoi ata me dorën e të Dërguarit dhe të të dashurve të Tij. Ai ia shpërbleu durimin, duke ia ruajtur atij shpërblimin në Ahiret.".

Në fund, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* shtoi: *"Kush bën durim dhe i bën llogarinë vetes së tij, nuk del nga dynjaja, derisa All'llahu ta kënaqë atë te armiqtë e tij, duke ia ruajtur atij në Ahiret."*.[2]

1 Sure "El En am", ajetet 33-34.
2 "Usulu Kafij", vëll. 2, kreu "es sabru", f. 88.

Ajetet 26 - 30

أَوَلَمۡ يَهۡدِ لَهُمۡ كَمۡ أَهۡلَكۡنَا مِن قَبۡلِهِم مِّنَ ٱلۡقُرُونِ يَمۡشُونَ فِي مَسَٰكِنِهِمۡۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَأٓيَٰتٍۖ أَفَلَا يَسۡمَعُونَ ﴿٢٦﴾ أَوَلَمۡ يَرَوۡاْ أَنَّا نَسُوقُ ٱلۡمَآءَ إِلَى ٱلۡأَرۡضِ ٱلۡجُرُزِ فَنُخۡرِجُ بِهِۦ زَرۡعٗا تَأۡكُلُ مِنۡهُ أَنۡعَٰمُهُمۡ وَأَنفُسُهُمۡۖ أَفَلَا يُبۡصِرُونَ ﴿٢٧﴾ وَيَقُولُونَ مَتَىٰ هَٰذَا ٱلۡفَتۡحُ إِن كُنتُمۡ صَٰدِقِينَ ﴿٢٨﴾ قُلۡ يَوۡمَ ٱلۡفَتۡحِ لَا يَنفَعُ ٱلَّذِينَ كَفَرُوٓاْ إِيمَٰنُهُمۡ وَلَا هُمۡ يُنظَرُونَ ﴿٢٩﴾ فَأَعۡرِضۡ عَنۡهُمۡ وَٱنتَظِرۡ إِنَّهُم مُّنتَظِرُونَ ﴿٣٠﴾

"A nuk e kanë të qartë ata, se sa popuj i kemi shkatërruar Ne para tyre; nëpër vendbanimet e të cilëve ecin? Me të vërtetë, në këto ka shenja paralajmëruese, por ata nuk po vënë vesh."

"A nuk e shohin ata, se Ne e dërgojmë ujin në tokën e shkretuar, e nëpërmjet tij bëjmë që të rriten bimët, me të cilat ushqehen bagëtitë e tyre dhe ata vetë?! A nuk kanë sy për të parë?!"

"Ata pyesin: 'Kur do të vijë Gjykimi, nëse thoni të vërtetën?'

Thuaju: 'Ditën e Gjykimit nuk do t'u bëjë dobi mohuesve besimi i tyre e as që do t'u jepet afat.'"

"Prandaj, mos ua vë veshin atyre dhe prit, edhe ata, me të vërtetë, po presin!"

Komentimi

Dita e triumfit tonë

Ajetet e mëparshme ishin të përziera me kërcënimin e kriminelëve prej jobesimtarëve. Ajeti 26, duke plotësuar kërcënimin, thotë: **"A nuk e kanë të qartë ata, se sa popuj i kemi shkatërruar Ne para tyre?"**[1], pasi këta, duke ecur nëpër pjesët e mbetura, i shikojnë gjurmët e atyre popujve që janë shkatërruar para tyre: **"nëpër vendbanimet e të cilëve ecin."**.[2]

Vendbanimet e shkatërruara të popullit të Adit dhe Themudit, qytetet e kombit të Lutit shtrihen të shkatërruara në rrugën për në Sham. Këto vendbanime kanë qenë vende dhe

1 Subjekti **"Nuk e kanë të qartë."** kuptohet nga fjalia **"Sa nga popujt para tyre i shkatërruam!"**. Vlerësimi është: A nuk e kanë të qartë ata sa shumë kemi shkatërruar?!

2 Pjesa më e madhe e komentuesve, për komentimin e ajetit 26, kanë përmendur atë që përmendëm më lart. Disa kanë supozuar se fjala *"ecin"* është sqarim i situatës së të shkatërruarve, domethënë, ata popuj kanë qenë në një hutim të plotë ndaj dënimit hyjnor dhe ecnin në banesat e tyre dhe kënaqeshin me to. Kur atyre u erdhi papritur dënimi i All'llahut, i shkatërroi ata. Vetëm se ky supozim duket larg.

qendra të popujve të fuqishëm, të devijuar dhe sado që Profetët i paralajmëruan, nuk bëri asnjë dobi tek ata. Në fund, dënimi hyjnor e mbylli kapakun e jetës së tyre, kurse idhujtarët kalonin nëpër ato mbetje dhe dukej sikur shtëpitë e këtyre dhe kështjellat e tyre të shkatërruara kishin njëqind gjuhë, që i thërrisnin këtyre që të kenë kujdes, duke ua bërë atyre të qartë dhe duke u folur atyre për rezultatin e mosbesimit dhe të degjenerimit. Mirëpo ata nuk i dhanë rëndësi asaj dhe nuk e kthyen kokën drejt tyre. Ata sikur e kishin humbur dëgjimin. Prandaj ajeti në fund shton: **"Me të vërtetë, në këto ka shenja paralajmëruese, por ata nuk po vënë vesh."**.

Ajeti 27 tregon për një nga mirësitë më të rëndësishme të All'llahut, e cila është baza e zhvillimit të të gjitha qyteteve dhe metoda e jetës së të gjitha qenieve të gjalla, duke e bërë të qartë se All'llahu i Madhëruar, ashtu siç zotëron fuqinë e shkatërrimit të qyteteve të humbura, është i aftë të ringjallë tokat e shkatërruara dhe të vdekura dhe u ka dhënë robërve të Tij çdo lloj dhurate. Ajeti thotë: **"A nuk e shohin ata, se Ne e dërgojmë ujin në tokën e shkretuar, e nëpërmjet tij bëjmë që të rriten bimët, me të cilat ushqehen bagëtitë e tyre dhe ata vetë?! A nuk kanë sy për të parë?!"**.

Fjala *"el xhuzuru"* do të thotë *"tokë shterpë, që nuk mbin kurrë bimë në të"*. Ajo rrjedh nga fjala *"xhezer"*, njësoj si *"meredh"*, me kuptimin *"këputje"*. Duket sikur bimët janë këputur nga kjo tokë e tillë, apo se vetë toka i ka këputur ato bimë.

E veçanta këtu është se ideja shprehet me togfjalëshin *"nesuukul mae"* - *"e sjellim ujin"*. Kjo tregon se natyra e ujit, sipas ligjit të rëndesës së tij, duhet të jetë mbi tokë dhe në vendet e ulëta

shumë dhe, sipas vetisë së tij, i rrjedhshëm, duhet të zbresë në thellësitë e tokës. Kur atij i vjen urdhri Ynë, e humbet natyrën e tij dhe shndërrohet në avull të lehtë, që lëviz në të gjitha anët me fryrjen e flladit.

Me të vërtetë, këto re notuese në qiell janë dete të mëdha prej ujërave të ëmbla, që dërgohen në tokat e thata, me urdhrin e All'llahut dhe me ndihmën e erërave.

Realiteti është i tillë se, sikur të mos ishte shiu, pa dyshim se shumë prej tokave nuk do të shihnin qoftë edhe një pikë uji të vetme. Sikur të supozojmë se atje ka lumenj me ujëra të shumta, pa dyshim se ato ujëra nuk arrijnë në pjesën më të madhe të tokave. Ne shikojmë se, me begatinë e mëshirës hyjnore, kanë mbirë dhe janë zhvilluar barërat, pyjet dhe pemët e shumta mbi majat e maleve, të luginave të thepisura dhe kodrave të larta. Kjo fuqi e çuditshme e shiut për vaditje nuk mund të bëjë asgjë tjetër.

Fjala "*zer'an* زرعا " këtu ka një kuptim të gjerë, që përfshin të gjitha llojet e bimëve dhe të pemëve, edhe pse ndonjëherë përdoret kundër pemëve.

Në këtë ajet, ka mundësi të jetë paraprirja e gjallesave dhe e kafshëve, para njeriut, sepse ushqimi i kafshëve është i bazuar te bimët, në kohën kur njeriu ushqehet me bimët dhe mishrat e kafshëve.

Apo nga ajo anë se bimët, thjesht, me rritjen e tyre, bëhen ushqim për kafshët dhe mund të përfitohet prej tyre, prej tretjes së tyre, në kohën kur përfitimi i njeriut prej bimëve, vonohet, derisa të barset pema dhe të pjekë frutin.

E veçanta këtu është se fjalia: **"A nuk e shohin ata?"** është përmendur në fundin e ajetit që po komentojmë, në kohën kur ajeti i mëparshëm, i cili fliste për rrënojat e banesave të popujve të kaluar, është mbyllur me fjalinë: "**Ata nuk po vënë vesh."**.

Motivi i këtij ndryshimi është: Të gjithë e shikojnë me sytë e tyre panoramën e tokave të vdekura, kur ajo ringjallet nga efekti i zbritjes së shirave, rritjes së bimëve të saj dhe pjekjen e frutave, në kohën kur ata i dëgjojnë shpesh, si lajme, çështjet e popujve të mëparshëm.

Nga seria e dy ajeteve të mësipërme përfitohet se All'llahu i Lartësuar u thotë këtyre gjynahqarëve rebelë të kenë shumë kujdes dhe të hapin sytë dhe veshët. Të dëgjojnë të vërtetat, t'i shikojnë ato dhe të mendojnë se si një ditë i urdhëruan erërat që të shkatërrojnë kështjellat e kombit të Adit dhe banesat e tyre, duke i bërë ato rrënoja dhe gjurmë.

Një ditë tjetër i urdhërojnë ato erëra, që të bartin retë me shi drejt tokave të vdekura, për t'i ringjallur ato dhe për t'i bërë jeshile, prodhuese. A nuk po i dorëzoheni dhe nuk po i bindeni kësaj fuqie?!

Kur ajetet e mëparshme i kërcënonin kriminelët me hakmarrje dhe i përgëzonin besimtarët me prijësi dhe triumf, pa dyshim se jobesimtarët me kryeneçësi dhe mendjemadhësi, duke u justifikuar se, kur do të vërtetohen këto kërcënime, shtronin këtë pyetje: "**Ata pyesin: 'Kur do të vijë Gjykimi, nëse thoni të vërtetën?'"**.

Kur'ani u përgjigjet atyre menjëherë dhe e urdhëron Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe*

mbi familjen e tij!): **"Thuaju: 'Ditën e gjykimit nuk do t'u bëjë dobi mohuesve besimi i tyre e as që do t'u jepet afat.'"**.

Kjo do të thotë, se, nëse qëllimi juaj është që të shikoni sinqeritetin e kërcënimit hyjnor, të cilën e dëgjuat nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, do të besonit, pasi pa dyshim se juve ju ka ikur koha. Nëse ajo ditë vjen, juve nuk ju bën dobi besimi juaj në asgjë.

Nga sa thamë, bëhet e qartë se qëllimi i përdorimit të fjalës *"jeumul fet'hi"* është dita e zbritjes së *"dënimit shfarosës"*, domethënë dënimi që pret të shkuarën e jobesimtarëve dhe nuk u lë atyre shansin e besimit. Me një shprehje tjetër, pa dyshim se dënimi shfarosës është një lloj dënimi i dynjasë, jo nga dënimi i Ahiretit dhe jo nga ndëshkimet e zakonshme të dynjasë, përkundrazi, ai është dënimi që i jep fund jetës së kriminelëve, pasi të plotësohet justifikimi.

Dëshmia e kësaj fjale ka disa çështje:

a) Nëse qëllimi ka qenë ndëshkimet e zakonshme të dynjasë, apo triumfet e ngjashme me triumfin e myslimanëve në Betejën e Bedrit dhe ditës së çlirimit të Mekës, siç e ka thënë një pjesë e komentuesve, atëherë s'ka dyshim se fjalia: **"Ditën e Gjykimit nuk do t'u bëjë dobi mohuesve besimi i tyre**", nuk është i vërtetë, sepse në atë kohë besimi ka qenë i dobishëm dhe dyert e pendimit kanë qenë të hapura jo vetëm në ditën e triumfit në Bedër, por edhe në ditën e çlirimit të Mekës.

b) Nëse kuptimi i togfjalëshit *"ditën e çlirimit"* ka qenë Dita e Kiametit, siç e pranon atë një pjesë e komentuesve, atëherë, ajo nuk i përshtatet fjalisë: **"as që do t'u jepet afat."**, sepse dhënia e

shansit dhe mosdhënia e tij lidhet me jetën e dynjasë. Duhet të shtojmë se *"dita e çlirimit"*, në asnjë temë nga Kur'ani, nuk është përdorur me kuptimin e Ditës së Kiametit.

c) Me të vërtetë, se fjala *"çlirim"*, në kuptimin e dënimit shfarosës, vihet re shpesh në Kur'an, si në ajetin 118 të sures "Esh Shuara", ku Nuhu thotë: **"Prandaj, Ti gjyko mes meje dhe atyre dhe më shpëto mua e besimtarët që janë me mua!"**.

Kjo është treguese e dënimit të tufanit.

I njëjti kuptim, është përmendur, gjithashtu, në ajetin 77 të sures "El Mu'minun".

Nëse qëllimi ka qenë dënimi i shfarosjes në dynja, atëherë pa dyshim se ajo bie dakord me atë që thamë më sipër dhe harmonizohet me të gjithë shembujt. Ajo, në realitet, është kërcënim për jobesimtarët dhe zullumqarët, që të mos kërkojnë vërtetimin e premtimit me çlirim, të besimtarëve dhe zbatimit të dënimit të shfarosjes, ndaj jobesimtarëve, pasi, nëse kërkesa e tyre vërtetohej, atëherë nuk do të gjenin shans për të besuar. Edhe nëse e gjenin shansin dhe besuan, atëherë, pa dyshim, besimi i tyre nuk do të pranohet.

Ky kuptim, në mënyrë të veçantë, harmonizohet shumë me ajetet e mëparshme, të cilat kanë folur për shkatërrimin e popujve rebelë e mizorë, të cilët kanë jetuar në shekujt e kaluar dhe u sprovuan me dënimin hyjnor dhe me shkatërrim, sepse jobesimtarët e Mekës, nëse e dëgjojnë fjalën që u përmend në dy ajetet e mëparshme, do të kërkojnë vërtetimin e kësaj teme në të drejtën e tyre. Kur'ani i paralajmëron ata që të mos e bëjnë këtë kërkesë, sepse, nëse zbret dënimi, nuk do të mbetet asgjë prej tyre.

Ajeti i fundit i sures "Sexhde" thekson një kërcënim e kuptim të thellë: **"Prandaj, mos ua vë veshin atyre dhe prit, edhe ata, me të vërtetë, po presin!"**.

Tani, kur tek ata nuk bëri efekt as përgëzimi dhe as paralajmërimi, kur ata as nuk janë prej njerëzve me logjikë, që të kenë argumentim, që ta njohin All'llahun e Madhëruar, duke parë gjurmët hyjnore në sekretet e krijesave dhe ta adhurojnë Atë, kur ata as nuk kanë koshiencë të gjallë, që në thellësitë e tyre të intonohen me tonin e Teuhidit, që ta dëgjojnë atë, atëherë kundërshtoi ata dhe prite mëshirën e All'llahut të Madhëruar. Ata le të presin dënimin e Tij, sepse, pa dyshim, ata nuk meritojnë tjetër gjë veç dënimit.

O All'llah, na bëj neve prej atyre që dorëzohen dhe besojnë, kur shikojnë shenjat e para të së vërtetës dhe argumentet e saj!

O All'llah, largoje prej nesh shpirtin e mendjemadhësisë, të kryeneçësisë dhe të kokëfortësisë! Na shpëto neve prej tyre!

O All'llah, shpejtoje fitoren e ushtrisë së Islamit ndaj ushtarëve të mohimit, të mendjemadhësisë dhe të kolonizimit!

SURJA "EL AHZÂB"

Medinase, 73 vargje

Shkaku i emërtimit dhe mirësia e saj

Sipas mendimit të dijetarëve islamë, kjo sure ka zbritur në Medine. Numri i ajeteve të saj është 73. Përderisa një pjesë të rëndësishme e kësaj sureje fliste për ngjarjet e betejës së partive (El Ahzab), grupacioneve (Hendekut), u zgjodh ky emër për të.

Për të mësuar mirësinë e kësaj sureje, mjafton të lexojmë një hadith nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Kush e lexon suren "El Ahzab" dhe ia mëson atë familjes së tij, atij i jepet garancia nga dënimi i varrit."*.[1]

Transmetohet nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Kush e lexon shumë suren "El Ahzab", Ditën e Kiametit do të jetë afër Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe bashkëshorteve të tij."*.[2]

Ne kemi thënë shpesh se s'ka dyshim se këto mirësi nuk fitohen me një lexim pa shpirt dhe të zhveshur nga çdo lloj mendimi dhe vepre, përkundrazi leximi që është start i meditimit, i cili ndriçon horizontet e njeriut, i shfaq gjurmët e tij në veprat dhe në sjelljen e tij.

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 334, fillimi i sures "El Ahzab".
2 Burimi i mësipërm.

Përmbajtja e sures "El Ahzâb"

Kjo është një nga suret më të pasura të Kur'anit Famëlartë, me produktin më të qartë. Ndjek dhe diskuton çështje të shumta dhe të larmishme jo vetëm të bazave të Islamit, por edhe degëve të tij.

Problematikat që janë përmendur në këtë sure, mund të ndahen në shtatë:

Së pari: Ajetet e para të sures, ftojnë të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që t'i bindet All'llahut dhe të lërë mënjanë ndjekjen e jobesimtarëve dhe propozimeve të hipokritëve. All'llahu i Madhëruar e përgëzon atë, se do ta mbështesë dhe do ta ndihmojë përballë mohimit të tyre.

Së dyti: Ka treguar për disa trillime të kohës së injorancës, si dhahari (duke i thënë gruas se më je bërë si shpina e nënës sime), duke e konsideruar atë shkaktare të divorcit. Gjithashtu, trajtohet çështja e adoptimit dhe është përqendruar në pavërtetësinë e saj. Surja i përkufizon lidhjet familjare të drejtpërdrejta dhe ato me anë të shkaqeve se janë lidhje të natyrshme dhe reale.

Së treti: Pjesa më e rëndësishme e kësaj sureje lidhet me betejën e grupacioneve dhe ngjarjeve të saj të frikshme, triumfit të mrekullueshëm të myslimanëve ndaj jobesimtarëve, pengesave, fabrikimeve të gënjeshtrave, justifikimi i hipokritëve dhe prishja e marrëveshjeve të tyre. Janë sqaruar ligje të mrekullueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Së katërti: Trajtohet çështja e grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ato duhet të jenë shembulli dhe modeli më i lartë i të gjitha grave të myslimanëve. U paraqet atyre urdhëresa të rëndësishme.

Së pesti: Depërton në historinë e Zejnebit, të bijës së Xhashit, e cila ka qenë për një ditë të vetme gruaja e djalit të adoptuar të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Zejdit. Ajo u nda nga ai dhe u martua me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me urdhër të All'llahut të Madhëruar. Kjo martesë u bë një bajonetë në dorën e hipokritëve. Kur'ani iu përgjigj atyre me fjalë e shprehje kurative.

Së gjashti: Flet për çështjen e hixhabit, mbulimit të femrës, e cila lidhet me diskutimet e mëparshme. I këshillon të gjitha gratë besimtare ta ruajnë me kujdes këtë ligj islam.

Së shtati: Pjesa e fundit na tregon për çështjen e rëndësishme të Kiametit dhe rrugën e shpëtimit në atë vend madhështor. Po kështu, shpjegon dhe sqaron çështjen e madhe të amanetit të njeriut, domethënë çështja e betimit, detyrës dhe përgjegjësisë.

Ajetet 1 - 3

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّبِيُّ ٱتَّقِ ٱللَّهَ وَلَا تُطِعِ ٱلۡكَٰفِرِينَ وَٱلۡمُنَٰفِقِينَۗ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١﴾ وَٱتَّبِعۡ مَا يُوحَىٰٓ إِلَيۡكَ مِن رَّبِّكَۚ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ بِمَا تَعۡمَلُونَ خَبِيرًا ﴿٢﴾ وَتَوَكَّلۡ عَلَى ٱللَّهِۚ وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ وَكِيلٗا ﴿٣﴾

Me emrin e All'llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

"O i Dërguar! Kije frikë All'llahun dhe mos i dëgjo jobesimtarët dhe hipokritët! Me të vërtetë, All'llahu është i Urtë dhe i Gjithëdijshëm."

"Bindju asaj që të është shpallur ty nga Zoti yt, se vërtet, All'llahu e di mirë se çfarë bëni."

"Mbështetu tek All'llahu; All'llahu të mjafton si mbrojtës."

Shkaku i zbritjes

Komentuesit këtu kanë përmendur shkaqe të ndryshme të zbritjes. Të gjitha, afërsisht, trajtojnë një temë të vetme.

Njëra prej tyre është: Këto ajete kanë zbritur për Ebu Sufjanin dhe disa të tjerë koka idhujtarësh, të cilët, pas Betejës së Uhudit, morën sigurinë, amanetin nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe hynë në Medine. Ata, bashkë me Abdullah ibn Ubejen dhe një grup prej shokëve të tyre, erdhën te i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i thanë: "O Muhammed, mos i përmend për keq zotat tanë: Latin, Uzanë dhe Menatin, por thuaj se ata janë ndërmjetësues për këdo që i adhuron. Ne të lëmë ty dhe Zotin tënd.".

I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kur dëgjoi këto fjalë, u mërzit shumë.

Omer ibn Hatabi i tha: "O i Dërguari i All'llahut, na jep leje që t'i vrasim.".

I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: "*Unë u kam dhënë besën atyre.*".

Urdhëroi t'i nxirrnin nga Medina. Më pas zbriti ajeti: **"...mos i dëgjo jobesimtarët"**.

Urdhëroi që të mos dëgjojë propozime të tilla.[1]

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 335, fundi i ajetit është burimi i komentimit, si dhe komentime të tjera.

Komentimi

Ndiq vetëm Shpalljen e All'llahut

Prej kthesave dhe turbullirave më të rrezikshme, të cilat bllokojnë rrugën e udhëheqësve të mëdhenj, është çështja e propozimeve të paqes, e dorëzimit dhe e marrëveshjes, të cilat shtrohen nga ana e kundërshtarëve. Këta bëjnë plane të ngatërruara në kurriz së udhëheqësve dhe përpiqen t'i largojnë ata nga rruga e tyre kryesore. Ky është një provim shumë i vështirë për këta udhëheqës.

Idhujtarët e Mekës dhe hipokritët e Medines kanë shpenzuar gjithçka për të korruptuar të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nga vija e Teuhidit, duke i ofruar propozime dhe marrëveshje paqeje. Njëra prej tyre është ajo që përmendëm në shkakun e zbritjes. Ajetet e para të sures "El Ahzab" zbritën dhe u dhanë fund kurtheve të tyre dhe e ftuan (ajetet) të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* të vazhdojë metodën e tij, vijën e Teuhidit, pa tërheqjen më të vogël dhe pa marrëveshje paqësore.

Këto ajete e urdhërojnë të Dërguarin e All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me katër urdhëresa të rëndësishme:

E para: Në aspektin e devotshmërisë, e cila i përgatit kushtet për çdo program tjetër dhe thotë: "**O i Dërguar! Kije frikë All'llahun...**".

S'ka dyshim se e vërteta e devotshmërisë është ndjenja e brendshme e përgjegjësisë. Sikur të mos ishte kjo ndjenjë, pa dyshim se njeriu nuk do të lëvizte në drejtim të asnjë programi konstruktiv.

Devotshmëria është pikësynimi më i lartë i udhëzimit dhe i përfitimit nga argumentet e All'llahut, ashtu siç thuhet në ajetin e dytë të sures "El Bekare": **"Është udhëzues për ata që janë të devotshëm."**.

Është e vërtetë se faza përfundimtare e devotshmërisë arrihet pas besimit dhe veprimit, sipas urdhëresave të All'llahut të Madhëruar, vetëm se faza e saj fillestare realizohet para të gjitha këtyre çështjeve, sepse njeriu, nëse nuk e ndien përgjegjësinë nga ana e brendshme, jo vetëm nuk përpiqet të vërtetojë thirrjen e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por as nuk e dëgjon atë, duke mos u larguar nga e keqja. Teologët dhe dijetarët e besimit e kanë konsideruar këtë çështje, bazë dhe shtyllë për të njohur All'llahun, pasi ajo, pa dyshim, është degë e devotshmërisë.

E dyta: Ndalimi dhe refuzimi i bindjes së jobesimtarëve: **"mos i dëgjo jobesimtarët dhe hipokritët!"**. Ajeti thotë në fund, duke e miratuar këtë temë: **"Me të vërtetë, All'llahu është i Urtë dhe i Gjithëdijshëm."**.

Kur All'llahu i Lartësuar të urdhëron ty të mos i përfillësh ata, s'ka dyshim se ai urdhër buron nga mençuria e pafundme e

Tij, sepse All'llahu e di se çfarë është fshehur në këtë ndjekje dhe paqe të plotë.

E megjithatë, s'ka dyshim se puna e parë, pas devotshmërisë dhe ndjenjës së përgjegjësisë, është larja, pastrimi i zemrës nga çdo gjë tjetër dhe shkulja e problemeve dëmtuese, lënduese nga kjo tokë materiale.

E treta: Citon farat e Teuhidit dhe ndjekjes së shpalljes hyjnore: **"Bindju asaj që të është shpallur ty nga Zoti yt, se vërtet, All'llahu e di mirë se çfarë bëni!"**.

Duke u bazuar në këtë ajet, pa dyshim se detyra e parë është dëbimi i shejtanëve nga thellësitë e shpirtit, që vendin e tyre ta zënë engjëjt; t'i shkulë gjembat dhe vendin e tyre ta zënë lulet. Toka duhet të pastrohet nga mizorët, që të zëvendësohen nga qeverisja e All'llahut dhe nga sistemi i Tij i Shenjtë.

Dhe meqenëse atje ka shumë probleme, kërcënime, kurthe dhe pengesa në vazhdimin e zgjedhjes së kësaj rruge, atëherë pa dyshim se All'llahu i Lartësuar shfaq urdhrin e katërt: **"Mbështetu tek All'llahu; All'llahu të mjafton si mbrojtës!"**.

Edhe pse atij që i adresohet në këtë ajet, është Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk ka asnjë dyshim se ajo është një fjalë për të gjithë besimtarët dhe për të gjithë myslimanët. Ky ajet është një recetë mjekësore, që dhuron jetë, është ilaç i mbajtjes aktiv dhe gjallë në çdo kohë.

Një pjesë e komentuesve kanë thënë se e folura me fjalën *"ja ejjuhe"* - *"o ti"* është e veçantë. Përdorimi i kësaj fjale, synon

tërheqjen e vëmendjes së të gjithëve, për një kërkesë çfarëdo, edhe sikur të jetë një person që i flitet. E kundërta e të folurës me *"ja" - "o"* përdoret në kuptimet e personit në fjalë.[1]

Përderisa ky ajet ka filluar me fjalën *"ja ejjuhe" - "o ti"*, atëherë ajo miraton se këto ajete janë gjithëpërfshirëse.

Dëshmia tjetër për universalitetin është: Fjalia: **"All'llahu e di mirë se çfarë bëni!"**, është përmendur në formën e shumësit. Nëse ai që i adresohet, do të ishte Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, atëherë ajeti duhet të thoshte, se s'ka dyshim se All'llahu e di mirë se çfarë bën.

Nuk mund të fshihet se këto çështje që i drejtohen Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nuk do të thonë se ai ishte i padevotshëm apo se i ndjek jobesimtarët dhe hipokritët. Përkundrazi, këto urdhëresa kanë cilësinë e miratimit të detyrave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nga njëra anë dhe nga ana tjetër, janë mësim dhe për të gjithë besimtarët.

1 Tefsiri "Kebijr", vëll. 25, f. 190, fundi i ajeteve është burimi i komentimit.

Ajetet 4 - 6

مَّا جَعَلَ ٱللَّهُ لِرَجُلٍ مِّن قَلۡبَيۡنِ فِي جَوۡفِهِۦۚ وَمَا جَعَلَ أَزۡوَٰجَكُمُ ٱلَّٰٓـِٔي تُظَٰهِرُونَ مِنۡهُنَّ أُمَّهَٰتِكُمۡۚ وَمَا جَعَلَ أَدۡعِيَآءَكُمۡ أَبۡنَآءَكُمۡۚ ذَٰلِكُمۡ قَوۡلُكُم بِأَفۡوَٰهِكُمۡۖ وَٱللَّهُ يَقُولُ ٱلۡحَقَّ وَهُوَ يَهۡدِي ٱلسَّبِيلَ ﴿٤﴾ ٱدۡعُوهُمۡ لِأٓبَآئِهِمۡ هُوَ أَقۡسَطُ عِندَ ٱللَّهِۚ فَإِن لَّمۡ تَعۡلَمُوٓاْ ءَابَآءَهُمۡ فَإِخۡوَٰنُكُمۡ فِي ٱلدِّينِ وَمَوَٰلِيكُمۡۚ وَلَيۡسَ عَلَيۡكُمۡ جُنَاحٞ فِيمَآ أَخۡطَأۡتُم بِهِۦ وَلَٰكِن مَّا تَعَمَّدَتۡ قُلُوبُكُمۡۚ وَكَانَ ٱللَّهُ غَفُورٗا رَّحِيمًا ﴿٥﴾ ٱلنَّبِيُّ أَوۡلَىٰ بِٱلۡمُؤۡمِنِينَ مِنۡ أَنفُسِهِمۡۖ وَأَزۡوَٰجُهُۥٓ أُمَّهَٰتُهُمۡۗ وَأُوْلُواْ ٱلۡأَرۡحَامِ بَعۡضُهُمۡ أَوۡلَىٰ بِبَعۡضٖ فِي كِتَٰبِ ٱللَّهِ مِنَ ٱلۡمُؤۡمِنِينَ وَٱلۡمُهَٰجِرِينَ إِلَّآ أَن تَفۡعَلُوٓاْ إِلَىٰٓ أَوۡلِيَآئِكُم مَّعۡرُوفٗاۚ كَانَ ذَٰلِكَ فِي ٱلۡكِتَٰبِ مَسۡطُورٗا ﴿٦﴾

"All'llahu nuk i ka dhënë asnjë njeriu dy zemra në kraharor. Ai nuk i konsideron gratë, që ju i ndani si nënat tuaja e as fëmijët tuaj të birësuar nuk i konsideron si bij të vërtetë.

Këto janë vetëm fjalë që dalin prej gojës suaj, kurse All'llahu thotë të vërtetën dhe udhëzon në Rrugë të Drejtë."

"Thërritini të birësuarit sipas etërve të tyre! Kjo është më e drejtë në sytë e All'llahut. Në qoftë se nuk e dini emrin e etërve të tyre, konsiderojini ata si vëllezërit tuaj të besimit dhe si të mitur nën tutelën tuaj. Nuk është gjynah nëse gaboni, por është gjynah, kur zemrat tuaja bëjnë faj me qëllim. All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."

"I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin; gratë e tij janë (si) **nënat e tyre. Sipas Librit të All'llahut, pjesëtarët e farefisit janë më të afërt për njëri-tjetrin, sesa besimtarët e tjerë dhe të mërguarit, përveç rastit kur doni t'u bëni ndonjë të mirë miqve tuaj të afërt** (me anë të testamentit)**. Kjo është shënuar në Libër."**

Komentimi

Pretendime boshe

Ajetet e mëparshme e urdhëronin Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që të ndiqte vetëm Shpalljen e All'llahut dhe të mos ndiqte jobesimtarët dhe hipokritët. Këto ajete reflektojnë rezultatin e ndjekjes së idhujtarëve dhe e ftojnë njeriun në një seri trillimesh dhe legjendash.

Ajeti 4 ka përmendur tri prej tyre. Në fillim thotë: **"All'llahu nuk i ka dhënë asnjë njeriu dy zemra në kraharor."**.

Një grup komentuesish, për shkakun e zbritjes së kësaj pjese të ajetit, kanë thënë se ky ajet ka zbritur për të hedhur poshtë pretendimet e idhujtarëve për Xhemil ibn Muammer. Ky njeri kishte kujtesë të mahnitshme dhe pretendonte se kishte dy zemra dhe secila prej dy zemrave ishte më e kuptueshme se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Për këtë arsye, idhujtarët kurejsh e quanin atë "njeri me dy zemra!".

Kur ishte dita e Luftës së Bedrit, ku idhujtarët u mundën, në mesin e tyre ishte edhe Xhemil ibn Muammeri. Ebu Sufjani e thirri atë. Xhemil ibn Muammeri mbante në dorë një nga këpucët e tij, kurse tjetrën e kishte në këmbë. Ebu Sufjani i tha atij: "O Ebu Muammer, si është gjendja e njerëzve?".

Xhemil ibn Muammeri iu përgjigj: "U shpartalluan.".

Ebu Sufjani e pyeti: "Po ti, pse një këpucë e ke në dorë, kurse tjetrën në këmbë?".

Ebu Muammeri tha: "Nuk e kam ndier fare këtë. Mendoja se e kisha në këmbë.".

Atë ditë ata e kuptuan se ai kishte vetëm një zemër, përderisa e kishte harruar këpucën në dorën e tij.[1] Madje nuk logjikonte dhe nuk kuptonte as sa masa e atij me një zemër të vetme.

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 335, fundi i ajetit është burimi i komentimit. Tefsiri i Kurtubijut

Ajo që kuptohet prej fjalës *"el kalbu"* - *"zemra"*, në këtë kontekst, është "logjika".

E megjithatë, s'ka dyshim se ndjekja e jobesimtarëve dhe e hipokritëve dhe mosndjekja e Shpalljes hyjnore, e fton njeriun në këto ideologji trilluese.

Duke e larguar shikimin prej asaj, pa dyshim se për fjalinë ka një kuptim më të thellë, që është: Njeriu ka vetëm se një zemër të vetme dhe kjo zemër përmban dhe magazinon vetëm dashurinë e një të adhuruari të vetëm. Për këtë qëllim, s'ka dyshim se ata që ftojnë në idhujtari, që adhurojnë shumë zota, duhet të kenë shumë zemra, që secilit prej tyre t'i ndërtojnë nga një shtëpi, për të adhuruar secilin.

Është e padiskutueshme se personaliteti i njeriut të shëndoshë ka një karakter të vetëm dhe vija e tij e logjikës është dhe duhet të jetë një, në unitetin e tij, qoftë kur është vetëm, qoftë kur është me shoqërinë, qoftë kur është brenda, qoftë kur është jashtë, qoftë kur është në punë, qoftë kur është me pushime, pasi çdo lloj hipokrizie personaliteti është një çështje e detyruar për njeriun dhe në kundërshtim me natyrshmërinë e tij.

Njeriu, për shkak se ka një zemër të vetme, duhet të ketë një natyrë, strukturë lidhëse të vetme dhe t'i përulet një ligji të vetëm.

Në zemrën e tij nuk hyn përveçse dashuria e një të dashuri të vetëm.

Ai zgjedh një rrugë të caktuar në jetën e tij, që të integrohet me një grup të vetëm dhe në një shoqëri të vetme, ose në të kundërt, pa dyshim se numri i madh, përçarja, rrugët dhe synimet

e ndryshme, do ta drejtojnë atë drejt joobjektivitetit dhe devijimit nga rruga e njehsimit të natyrshëm.

Për komentimin e këtij ajeti, le të shohim një hadith nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Dashuria jonë dhe dashuria e armikut tonë nuk bashkohet në brendësinë tonë. All'llahu nuk i ka bërë një njeriu, në brendësi të tij, dy zemra, që me një të dashurojë, kurse me tjetrën të urrejë. Për sa i përket të dashurit tonë, atëherë kthjellohet dashuria për ne, ashtu siç çlirohet floriri nga zjarri, pa asnjë pisllëk në të. Kush dëshiron të mësojë, le ta sprovojë zemrën e tij e, nëse bën ortak në dashurinë tonë, dashurinë e armikut tonë, atëherë ai nuk është prej nesh dhe ne nuk jemi prej tij.*".[1]

Duke u bazuar në këto fjalë të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, themi se zemra është qendra e një besimi të vetëm dhe zbaton vetëm një program praktik, sepse njeriu nuk mund të besojë në një gjë të vërtetë dhe të ndahet nga ajo në vepër, ashtu siç bën një pjesë e kontemporanëve. Ata, duke pretenduar se kanë shumë personalitet, thonë se filan punë e kanë bërë për arsye politike, kurse punën tjetër, për arsye fetare. Me këtë mënyrë, përballin veprat e tyre kundërshtuese, pasi ajo buron nga hipokrizia dhe tendencat e tyre të këqija. Me këto fjalë duan të përplasin ligjin e krijimit.

Është e vërtetë se dimensionet e jetës së njeriut janë të ndryshme, mirëpo ato duhet t'i gjykojë një vijë e vetme dhe njeriu duhet të ecë brenda një rruge të vetme.

1 Tefsiri i Ali ibn Ibrahimit, sipas transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 234.

Pastaj Kur'ani trajton një trillim tjetër nga trillimet e injorancës. Ajo është fabula e dhaharit. Idhujtarët, kur i largonin shikimet e tyre nga gratë e tyre dhe donin të tregonin veçimin e tyre, mungesën e kënaqësisë së tyre, u thoshin grave të tyre: "Ti për mua je bërë si shpina e nënës sime." E konsideronin atë njësoj si nëna e tij. Kjo fjalë konsiderohej në shkallën e ndarjes, divorcit.

Kur'ani, në vazhdimin e këtij ajeti, thotë: **"Ai nuk i konsideron gratë, që ju i ndani si nënat tuaja."**. Islami nuk e miratoi këtë ligj të injorancës dhe as nuk e mbështeti atë, përkundrazi vuri ndëshkime për atë që e praktikonte. Këto ndëshkime janë: ai që e shqipton këtë fjalë, nuk ka të drejtë t'i afrohet gruas së tij, derisa të paguajë shlyerjen e fajit. Nëse nuk e paguan atë dhe nuk i vjen gruas së tij, pa dyshim se asaj i lind e drejta të kërkojë ndihmën e një gjykatësi të ligjit, për ta detyruar atë në dy gjëra: ose ta divorcojë atë sipas ligjeve islame dhe të ndahet nga ajo, ose të falet dhe të vazhdojë si më parë jetën e tij bashkëshortore.[1]

Çfarë logjike është kjo, që gruaja të bëhet në gradën e nënës, vetëm duke i thënë asaj: "Ti për mua je si shpina e nënës time." Pa dyshim se lidhja e nënës me fëmijën është një lidhje e natyrshme, që nuk vërtetohet thjesht me fjalë.

Ajeti 2 i sures "El Muxhadele" thotë qartë: **"Ata midis jush, që i ndajnë gratë e veta, duke u thënë se iu duken si nënat e veta, duhet ta dinë se ato nuk janë nënat e tyre. Nënat e tyre janë vetëm ato që i kanë lindur ata. Fjalët që ata thanë, janë të**

1 Një sqarim më i detajuar, në lidhje me çështjen e dhiharit, do ta bëjmë në fundin e ajeteve të sures "El Muxhadele".

pahijshme dhe të pavërteta. Megjithatë, All'llahu është Falës dhe Shlyes i gabimeve.".

Nëse qëllimi i tyre, duke thënë këto fjalë ishte ndarja me gruan, kështu ka qenë në kohën e injorancës, atëherë, që të ndahesh nga gruaja, nuk është e nevojshme të thuhen këto fjalë të këqija e të shëmtuara. A nuk është e mundur që divorci të qartësohet me një shprehje të vërtetë, larg gjithë asaj shëmtie?

Një pjesë e komentuesve kanë thënë se *dhihari,* në kohën e injorancës, nuk e aplikonte ndarjen e burrit nga gruaja, përkundrazi e mbante gruan të lidhur, pa e ditur gjendjen dhe rezultatin e saj. Nëse çështja ka qenë e tillë, pa dyshim se krimi i kësaj vepre dhe shëmtia e saj do të qartësohej, sepse një fjalë që nuk ka kuptim, ia ndalonte burrit lidhjen e tij bashkëshortore me gruan e tij, pa qenë gruaja e ndarë.[1] Pastaj ajeti trajton trillimin e tretë të injorancës: **"E as fëmijët tuaj të birësuar nuk i konsideron si bij të vërtetë."**.

Sqarimi i kësaj pjese të ajetit është: Në kohën e injorancës ka qenë zakon që të zgjidhnin disa fëmijë. Duke i konsideruar ata si fëmijët e tyre, u jepnin atyre të gjitha të drejtat që meriton fëmija nga babai. Djali që adoptohej, trashëgonte, ashtu siç trashëgonte djali nga babai dhe zbatohej mbi ata të dy të ndaluarit ndaj gruas së babait, ose gruas së të birit.

Islami i ndaloi këto zakone të palogjikshme dhe trilluese në mënyrën më të ashpër, madje, siç do ta shohim, Profeti

1 Tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 6, f. 534, fundi i ajetit është burimi i komentimit.

Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për të fshirë këtë traditë të gabuar, u martua me gruan e djalit të tij të adoptuar, Zejd ibn Harithe, pasi Zejdi e ndau atë. Nëpërmjet kësaj tradite Profetike u bë e qartë se këto fjalë boshe nuk mund të ndryshojnë të vërtetat dhe realitetin, sepse lidhja Profetike dhe prindërore është një lidhje e natyrshme, që nuk arrihet kurrë nëpërmjet shprehjeve, marrëveshjeve dhe ndjenjave.

Martesa e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me gruan e ndarë të Zejdit shkaktoi një zhurmë të madhe në mesin e armiqve të Islamit dhe u bë një shtizë e informacionit të keq në dorën e tyre, mirëpo ky keqinformim meritonte të përballej me durim me qëllim shkatërrimin e kësaj tradite të kohës së injorancës. Për këtë Kur'ani thotë: **"Këto janë vetëm fjalë që dalin prej gojës suaj."**.

Ju thoni se filani është djali im. Ju e dini shumë mirë se çështja nuk është e tillë, pasi janë vetëm dallgët zanore që dalin nga goja juaj dhe fjalët nuk buron nga bindja e zemrës. Këto fjalë janë vetëm fjalë boshe, të pavërteta. Kur'ani thotë: **"All'llahu thotë të vërtetën dhe udhëzon në rrugë të drejtë."**.

Fjala e vërtetë thuhet për fjalën që zbatohet plotësisht në realitetin subjektiv.

Në kohën e injorancës, çështja e "*dhiharit*", apo "*adoptimi*", nuk kanë qenë nga temat e identitetit dhe as nga konsideratat mbrojtëse të interesave të njerëzve në përgjithësi.

Pastaj Kur'ani, duke miratuar dhe duke sqaruar vijën e vërtetë dhe logjike të Islamit, shton: **"Thërritini të birësuarit sipas etërve të tyre! Kjo është më e drejtë në sytë e All'llahut."**.

Pa dyshim se mënyra e të shprehurit me *"aksatu"* - *"më e drejtë"*, nuk do të thotë se, nëse ata u thërrasin atyre me emrat e adaptuar të tyre, është e drejtë dhe, nëse i thërrasin me emrat e etërve të tyre të vërtetë, atëherë është më e drejtë. Përkundrazi, siç e kemi thënë shpesh edhe më parë, forma sipërore përdoret në një pjesë të kuptimeve dhe nuk tregon përshkrimin e kundërt të një cilësie çfarëdo. Po japim një shembull: Ne themi se është mirë që njeriu të rezervohet e të mos e hedhë veten në rrezik. Por kjo nuk do të thotë se vënia e vetes në rrezik është e mirë, por rezervimi ndaj saj është më e pëlqyer, madje edhe qëllimi është krahasimi mes të mirës dhe të shëmtuarës.

Ajeti, për të ngritur motivet dhe justifikimet, thotë: **"Në qoftë se nuk e dini emrin e etërve të tyre, konsiderojini ata si vëllezërit tuaj të besimit dhe si të mitur nën tutelën tuaj."**.

Kuptimi i kësaj pjese të ajetit, me pak fjalë, është: Mungesa e njohjes së etërve të tyre, nuk është argument që t'i vini emrin e një personi tjetër si babai i këtij fëmije, madje ju mund t'u flisni atyre siç i flisni vëllait tuaj në fe apo shokëve dhe të afërmve tuaj.

Fjala *"el meuali"* është shumësi i fjalës *"meula"*. Komentuesit kanë përmendur shumë kuptime për këtë fjalë. Disa e kanë komentuar me kuptimin e shokut dhe të shoqëruesit. Një pjesë tjetër, me kuptimin e fëmijës së liruar nga skllavëria, i lirë, sepse një pjesë e të adoptuarve kanë qenë skllevër që bliheshin,

pastaj liheshin të lirë. Kur pronarët e tyre interesoheshin për ta dhe i donin ata, atëherë ata u thërrisnin atyre si fëmijët e tyre.

Ajo që meriton kujdes është se shprehja *"meula"*, lidhej me skllevërit e liruar në atë anë, që ata ruanin lidhjet e tyre me pronarin e tyre, pas lirimit të tyre. Kishte lidhje që anonin nga dhembshuria, në disa drejtime nga ana e të drejtës. Për këtë atyre, u thuhej *"ue laul itki"* - *"miqësia e lirimit të skllavit"*.

Në transmetimet islame lexojmë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pasi e lëroi nga skllavëria Zejd ibn Harithin, thirrej Zejd ibn Muhammed, derisa Kur'ani zbriti urdhrin e mësipërm. Që prej asaj kohe, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha atij se ishte Zejd ibn Harithi. Njerëzit, pas kësaj, e thërrisnin atë: ndihmësi, shoku i të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[1]

Gjithashtu, kanë thënë se Ebu Hudhejfe kishe një fëmijë, që quhej Salim. E liroi atë nga skllavëria dhe e adoptoi atë. Sapo zbriti ky ajet, atë e quanin, Salimi, shoku i Ebu Hudhejfes.[2]

Ndoshta personi e thërret një njeri, që nuk është babai i tij, baba, për shkak të zakonit të mëparshëm, ose i është mësuar gjuha. Kjo është jashtë kufijve të zgjedhjes së njeriut. Pa dyshim se All'llahu, i Drejti, i Mençuri, nuk e ndëshkon një njeri të tillë, prandaj ajeti shton: **"Nuk është gjynah nëse gaboni, por është**

1 Tefsiri "Ruhul Meanij", vëll. 21, f. 131, fundi i ajetit është burimi i komentimit.
2 Tefsiri "Ruhul Bejan", fundi i ajetit që po komentojmë.

gjynah, kur zemrat tuaja bëjnë faj me qëllim. All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë.".

All'llahu i Lartësuar jua fal juve ato që keni bërë më parë dhe e fal harresën dhe dyshimin, por, pas zbritjes së këtij ligji, s'ka dyshim se All'llahu nuk do t'jua falë juve kundërshtimin tuaj, nëse bëhet me qëllim, duke i thirrur personat jo me emrat e baballarëve të tyre, si dhe vazhdoni të ndiqni këtë zakon të keq.

Disa komentues kanë thënë se tema e gabimit përfshin kapituj, ku njeriu thotë me dashuri për dikë tjetër: "Djali im, biri im."

Apo për respekt, i thotë dikujt: "O babush!"

Kjo fjalë është e vërtetë dhe këto shprehje nuk konsiderohen gjynah, as për hir të adresimit të gabimit, sepse këto shprehje kanë cilësinë e antonimit dhe të figuratives.

Ajeti që vijon më pas, trajton një çështje tjetër të rëndësishme, prishjen e rregullit të vëllazërimit mes tyre.

Sqarimi i asaj është: Kur myslimanët emigruan nga Meka në Medine dhe Islami i preu plotësisht të gjitha lidhjet dhe miqësitë me të afërmit dhe njerëzit e tyre idhujtarë, që ishin në Mekë, Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me urdhrin e All'llahut, bëri një lidhje vëllazërimi mes tyre dhe nënshkroi marrëveshjen e vëllazërimit mes muhaxhirëve dhe ensarëve, ku trashëgonin njëri-tjetrin, njësoj si dy vëllezër të vërtetë. Ky ligj ishte i përkohshëm dhe i veçantë për një situatë shumë përjashtuese. Sapo Islami u zgjerua dhe u rikthyen lidhjet e mëparshme, nuk ishte më e nevojshme të

vazhdohej me këtë ligj, zbriti ajeti i mësipërm dhe e anuloi rregullin e vëllazërimit, i cili kishte zënë vendin dhe ligjin e trashëgimisë e të ngjashëm me të, duke e thyer këtë ligj vetëm për të afërmit e vërtetë të barkut.

Megjithëse, ligji i vëllazërimit ishte një ligj islam, i kundërt me rregullin e adoptimit, i cili ishte rregull i injorancës. Mirëpo ishte e domosdoshme që pas largimit të gjendjes së nevojshme të anulohej dhe kështu u bë.

Ajeti, para se ta përmendë këtë ligj, ka përmendur dy ligje të tjera, domethënë Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është më i ndjeshëm ndaj besimtarëve se sa vetë ata për veten e tyre dhe gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë në vend të nënave të tyre. Si fillim, ka thënë: **"I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin; gratë e tij janë** (si) **nënat e tyre."**.

Edhe pse Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është në gradën e babait, kurse gratë e tij janë në gradën e nënave të besimtarëve, përsëri ata nuk trashëgojnë prej tyre në mënyrë absolute, atëherë si pritet që të trashëgojë djali i adoptuar?!

Pastaj ajeti shton: **"Sipas Librit të All'llahut, pjesëtarët e farefisit janë më të afërt për njëri-tjetrin, sesa besimtarët e tjerë dhe të mërguarit."**.

Me qëllim që myslimanëve të mos u përplaseshin dyert në fytyrë dhe besimtarët të kishin mundësi t'u caktohej një pjesë e vogël nga trashëgimia për vëllezërit e tyre, edhe sikur të jepnin

një të tretën e pasurisë, atëherë ajeti shton në fund: **"përveç rastit kur doni t'u bëni ndonjë të mirë miqve tuaj të afërt** (me anë të testamentit)**."**.

Në fund të fjalisë, duke miratuar të gjitha ligjet e mëparshme, apo ligjin e fundit, shton: **"Kjo është shënuar në Libër."**, domethënë në Leuhi Mahfudh, ose në Kur'an.

Kjo përmbledhje ishte komentimi i ajetit të mësipërm. Tani duhet të analizojmë secilin prej katër ligjeve, të përmendura në këtë ajet.

Ligji i parë: Cili është qëllimi në qënien e Profetit më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin?

Kur'ani ka përmendur në këtë ajet afërsinë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* me myslimanët. Kuptimi i saj është: Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është më i afërt te njeriu mysliman, sesa vetë veta e tij, në të gjitha mirësitë që njeriu ka për të drejtën e vetes së tij.

Edhe pse një pjesë e komentuesve e kanë komentuar këtë fjali me "drejtimin e çështjeve shoqërore", ose "më parësori në çështjen e gjykimit", ose me "bindjen e urdhrit", mirëpo ne nuk kemi asnjë argument që ta përkufizojmë ajetin me një nga këto tri çështje.

Prandaj duhet të thuhet: Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është më i afërt te çdo njeri mysliman, qoftë në çështjet shoqërore dhe

individuale, qoftë në çështjet që janë të lidhura me qeverinë, gjykimin dhe thirrjen. Pa dyshim se dëshira dhe mendimi i tij paraprin dëshirën dhe mendimin e çdo myslimani.

Ne nuk duhet të habitemi nga kjo çështje, sepse Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i pamëkatë *(ma'sumun)* dhe i autorizuari i All'llahut të Madhëruar dhe as nuk mendon e as nuk merr vendim vetëm se në interes të shoqërisë dhe të individit. Ai kurrë nuk e ndjek pasionin dhe nuk i konsideron interesat e tij parësore ndaj interesave të të tjerëve, përkundrazi është e kundërta, pasi ai paraqet interesat e ymetit ndaj interesave të tij, gjithmonë te kontradikta e dy interesave.

Kjo afërsi është një degë prej afërsisë së vullnetit të All'llahut, sepse çdo gjë që ne kemi, është nga All'llahu i Madhëruar. Përveç kësaj, njeriu e arrin besimin e fortë vetëm kur sakrifikon lidhjet dhe nxitësit më të fortë, që është dashuria e tij për veten e tij në rrugën e dashurisë ndaj All'llahut të Madhëruar dhe mëkëmbësve të Tij. Kjo është arsyeja që në një hadith, lexojmë: *"Asnjë prej jush nuk ka besuar, derisa pasioni i tij të jetë ndjekës i asaj me të cilën unë kam ardhur."*.[1]

Në një hadith tjetër thuhet: *"Pasha Atë që ka në dorë shpirtin tim, askush nga ju nuk ka besuar plotësisht, derisa unë të jem më i dashur te ai se vetja e tij: pasuria e tij, fëmija i tij dhe të gjithë njerëzit."*.[2]

1 Tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 6, f. 540, fundi i ajeteve është burimi i komentimit.
2 Burimi i mësipërm.

Po kështu është transmetuar nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Nuk ka asnjë besimtar, që unë të mos jem më i afërti i njerëzve te ai në dynja dhe në Ahiret."*.[1]

Kur'an Kerimi, në ajetin 36 të sures "El Ahzâb" thotë: **"Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur All'llahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren. Kush e kundërshton All'llahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur."**.

Theksojmë edhe një herë tjetër, se kjo fjalë nuk do të thotë se All'llahu e ka bërë urdhrin e njerëzve ndjekës të pasioneve dhe dëshirave të një personi çfarëdo, por Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka një pozitë mbrojtjeje të miratuar: **"Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo** (që thotë) **është vetëm Shpallje hyjnore, që i vjen atij."**.[2]

Gjithçka që thotë Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është fjalë e All'llahut dhe prej All'llahut dhe ai është më i kujdesshëm dhe më i mëshirshëm në këtë ymet, edhe se babai.

Nga këto argumente bëhet e qartë se kjo afërsi vendos mbi shpatullat e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* përgjegjësi të rënda, shumë të mëdha. Për këtë çështje lexojmë një transmetim të njohur, të përmendur jo vetëm nga burimet e shi'itëve, por edhe te burimet synite, se

1 "Sahihu i Bukhariut", vëll. 6, f. 145, komentimi i sures "El Ahzâb", e mbështetur nga Ahmedi, vëll. 2, f. 334.
2 Sure "En Nexhm", ajetet 3-4.

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Unë jam më i afërt te çdo besimtar, se sa ai për veten e tij. Kush lë pas një pasuri, ajo i takon trashëgimtarëve dhe, kush lë pas një borxh apo pagesë për t'u paguar, atëherë ajo është e imja dhe detyrë e imja."*.[1]

Duhet të theksojmë se kuptimi i fjalëve *"shpenzimi"*, *"pagesa"*, këtu janë me kuptimin e fëmijëve apo të familjes, të cilët kanë mbetur pa kryefamiljarë, kurse mënyra e të shprehurit me fjalën *"ed dejnu"* - *"borxhi"*, para saj, është një kontekst i qartë për këtë kuptim, sepse qëllimi i thënies, është mbetja e borxhit pa pasuri dhe pa e shlyer atë.

Ligji i dytë: Ky ligj lidhet me gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të cilat konsiderohen si nëna për të gjithë besimtarët. Sigurisht që ajo është mëmësi morale dhe shpirtërore, ashtu si Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është baba shpirtëror dhe moral i ymetit.

Efekti i kësaj lidhjeje morale ka qenë i kufizuar në çështjen e ruajtjes së respektit të grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Martesa me to ishte e ndaluar, ashtu siç erdhi i qartë ligji i ndalimit të martesës me to, pas vdekjes së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i*

1 Ky hadith është transmetuar nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të të!)*, nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në metodat shi'ite, vëll. 17, f. 551. Kjo përmbajtje është përmendur më një ndryshim të lehtë në tefsirin e Kurtubijut dhe në tefsirin "Ruhul Meanij", në fundin e ajeteve që po komentojmë. Gjithashtu, është përmendur edhe te "Sahihu i Bukhariut", vëll. 6, f. 145, komentimi i sures "El Ahzâb".

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), në ajetet e kësaj sureje. Në të kundërt, kjo lidhje nuk ka as efektin më të vogël nga ana e trashëgimisë dhe ndaj të gjitha ndalimeve relative dhe shkakore, domethënë myslimanët kishin të drejtën e tyre që të martoheshin me vajzat e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në kohën kur askush nuk mund të martohej me vajzën e nënës së tij. E njëjta gjë është edhe çështja se ato janë të huaja për ta dhe nuk lejohej shikimi i tyre, përveç të ndaluarve (tabuve).

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"Një grua i tha Aishes: 'O nënoke!' Ajo i tha: 'Unë nuk jam nëna jote, por unë jam nëna e burrave tuaj.'"*.[1] Ky hadith tregon se është e ndaluar martesa me të.

Ka edhe një çështje të shtruar: Respekti dhe vlerësimi i tyre. Gratë e myslimanëve kishin mundësi t'u thërrisnin "nënë" grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në shenjë respekti ndaj tyre.

Dëshmitar për këtë fjalë, është Kur'ani: **"I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin."**.

Kjo do të thotë: Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është më i afërt te të gjitha gratë dhe burrat. Përemri i fjalisë që vijon, i referohet këtij adresimi me kuptim të gjerë. Lidhur me këtë çështje, lexojmë shprehjen e transmetuar nga një prej grave të Profetit Muhammed

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 338 dhe tefsiri "Ruhul Meanij", fundi i ajeteve është burimi i komentimit.

(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), Ummu Seleme: "*Unë jam nëna e burrave dhe e grave tuaja.*".[1]

Këtu shtrohet një pyetje: Kjo fjali: **"gratë e tij janë** (si) **nënat e tyre"**, a është në kundërshtim me atë që përmendet në ajetin 2 të sures "El Muxhadele": **"Ata midis jush, që i ndajnë gratë e veta, duke u thënë se iu duken si nënat e veta, duhet ta dinë se ato nuk janë nënat e tyre. Nënat e tyre janë vetëm ato që i kanë lindur ata. Fjalët që ata thanë, janë të pahijshme dhe të pavërteta. Megjithatë, All'llahu është Falës dhe Shlyes i gabimeve."**?

Si mund të konsiderohen gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në këtë gjendje, nënat e myslimanëve, kur ata nuk kanë lindur prej tyre?

Përgjigjja: Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet të kthejmë vëmendjen te mënyra e të folurit të një gruaje çfarëdo, duke e quajtur veten "nënë", që është, ose nga ana trupore, ose nga ana shpirtërore.

Për sa i përket anës trupore, kjo bisedë ndodh vetëm kur njeriu ka lindur nga ajo. Kjo është ajo që thuhet në ajetet e kaluara, se nëna biologjike për njeriun është vetëm ajo që e lind atë.

Për sa i përket babait apo nënës shpirtërore, është ai që ka të drejtë morale ndaj njeriut, si Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i cili

1 Tefsiri "Ruhul Meanij", fundi i ajeteve është burimi i komentimit.

konsiderohet babai shpirtëror i ymetit. Për hir të tij edhe gratë e tij përfituan gradën dhe respektin e nënës.

Problemi me të cilin përballeshin arabët e injorancës, në kuptimin e *"dhiharit"*, ishte se, kur ata u flisnin grave të tyre siç i flisnin nënës, atëherë ishte e padiskutueshme se qëllimi i tyre nuk ishte ana shpirtërore e nënës, por ata i konsideronin gratë e tyre si nënat biologjike dhe prandaj e konsideronin atë një lloj divorci. Ne e dimë se nëna biologjike nuk vërtetohet thjesht me shprehje, përkundrazi s'ka dyshim se kushti i saj ishte lindja trupore. Në bazë të kësaj, pa dyshim se fjala e tyre ishte e mohuar dhe gënjeshtër.

Lidhja me gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pavarësisht se ato nuk janë nënat e tyre biologjike, ato janë nënat e tyre shpirtërore, e përfituar kjo nga pozita dhe respekti i Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ata kanë për detyrë t'i respektojnë njësoj si nëna. Në ajetet e ardhshme shohim se Kur'ani e ka ndaluar martesën e grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. S'ka dyshim se ajo është një çështje tjetër prej çështjeve të respektit të tyre dhe respektit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Në Islam ka edhe një lloj të tretë të nënave. Ajo është nëna mëndeshë, për të cilën është folur për të në ajetin 23 të sures "En Nisa": **"Ju ndalohet martesa me nënat tuaja, me bijat tuaja, me motrat tuaja, me hallat tuaja, me tezet tuaja, me bijat e vëllezërve dhe bijat e motrave, me nënat** (gratë) **që ju kanë dhënë gji, me motrat tuaja, që kanë thithur prej një gjiri, me**

nënat e grave tuaja, me vajzën e gruas suaj që gjendet nën kujdestarinë tuaj, nëse me atë grua keni pasur marrëdhënie bashkëshortore; e, nëse nuk keni pasur marrëdhënie bashkëshortore, atëherë nuk ka pengesa. Ju ndalohet martesa me gratë e bijve tuaj dhe t'i bashkoni dy motra, përveç rasteve që tashmë kanë kaluar. Pa dyshim, All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë.".

Ajo është një degë e nënës së trupit.

Ligji i tretë: Çështja e përparësisë së të afërmve në trashëgimi, në lidhje me të tjerët, sepse ligji i trashëgimisë, në fillimet e Islamit, ku myslimanët i prenë lidhjet me fiset dhe të afërmit e tyre për shkak të hixhretit, është vendosur në bazë të emigrimit dhe vëllazërimit, domethënë emigruesit trashëgonin njëri-tjetrin ose bashkë me ensarët, të cilët u vëllazëruan me ta. Mirëpo nuk kishte ndonjë pengesë në vazhdimin e saj, pas zgjerimit të Islamit dhe rikthimit të shumë lidhjeve fisnore dhe farefisnore të mëparshme, si rezultat i islamizimit të popullit të tyre. (Duhet ta theksojmë se surja "El Ahzab" ka zbritur në vitin e pestë të hixhretit dhe ai është viti i "luftimit të grupacioneve". Kjo është arsyeja se pse është theksuar përparësia e farefisnisë në lidhje me të tjerët.

Duhet të theksojmë se ky ajet trajton përparësinë e të afërmve përballë të huajve dhe jo përparësinë e tri shtresave të trashëgimisë në lidhje me njëri–tjetrin, pasi më të preferuarit këtu janë besimtarët dhe muhaxhirët, të cilët janë përmendur në tekstin e Kur'anit: **"...pjesëtarët e farefisit janë më të afërt për njëri-tjetrin, sesa besimtarët e tjerë dhe të mërguarit."**.

Në bazë të kësaj, pa dyshim se nocioni i ajetit bëhet: S'ka dyshim se afërsia e të afërmve nga barku janë më meritorë se të huajt, nga ana e trashëgimisë. Mirëpo, si do të trashëgojnë këta të afërm? Mbi ç'bazë dhe standard? Pa dyshim se Kur'ani ka heshtur rreth kësaj çështjeje, megjithëse ai ka komentuar një temë të detajuar në ajetet e sures "En Nisa".[1]

Ligji i katërt: Është përmendur në ajetin e mësipërm, si përjashtim, përfitim dhe dobi nga shokët dhe personat ndihmës, të cilët çështja i veçon ata prej pasurive që njeriu ua lë si kujtim. Kjo është sqaruar me fjalinë: **"...përveç rastit kur doni t'u bëni ndonjë të mirë miqve tuaj të afërt** (me anë të testamentit)**."**.

Miratimi i saj i qartë është ligji i trashëgimisë, ku njeriu, një të tretën e pasurisë së tij, mund ta vërë ku të dëshirojë, apo ia këshillon kujt të dojë.

Kur Islami i ka vënë bazat e trashëgimisë mbi shtyllat e afërsisë dhe farefisnisë, në vend të lidhjeve dhe marrëdhënieve të mëparshme, nuk i ka prerë plotësisht lidhjet e gjakut mes njeriut dhe të dashurve të tij, të cilët e duan atë dhe pjesës së mbetur të vëllezërve të tij myslimanë, pasi njeriu është i lirë ta përdorë si të dojë pasurinë e tij, si nga ana e sasisë, ashtu edhe e mënyrës, vetëm se kjo liri është e kushtëzuar, që të mos shkojë më shumë se një e treta. Është normale se, nëse njeriu nuk ia ka këshilluar

1 Në bazë të kësaj, argumentimi me këtë shpreheje që disa dijetarë i bënë përparësisë së shtresave të trashëgimisë në lidhje me njëra-tjetrën nuk duket i saktë. Mbase prania e shkronjës *"ba"* në thënien: **"kanë më tepër përparësi ndaj të tjerëve"** është shkaktare e këtij dyshimi, pasi menduan se më parësorët janë vetëm një pjesë, ndërkohë që Kur'ani Kerim ka përmendur qartë se parësorët janë besimtarët dhe muhaxhirët.

dikujt pasurinë e tij, s'ka dyshim se e gjithë pasuria e tij ndahet mes të afërmve të tij dhe ata me lidhje gjaku, sipas ligjit të trashëgimisë. Në këtë situatë nuk i lihet më atij një e treta.[1]

Hulumtim

Për komentimin e ajetit të mësipërm janë përmendur shumë transmetime nga Imamët e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*. Çështja që ka pasur më shumë komentime e diskutime, ka qenë: "Trashëgimia e pasurisë", e cila është trajtuar brenda çështjes "Trashëgimia e kalifatit dhe e qeverisë" për familjen e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Imamët e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Kur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për komentimin e këtij ajeti, ka thënë: *"Ka zbritur për fëmijët e Hysejnit."* Më pas është pyetur: *"Për çështjen e trashëgimisë?"*

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* iu përgjigj: *"Jo. Ky ajet ka zbritur për udhëheqjen."*.[1]

---

1 Një grup komentuesish mendojnë se përjashtimi në fjalinë **"përveç nëse doni t'u bëni ..."** është një përjashtim i kufizuar, sepse ligji i testamentit nuk është ligj i trashëgimisë. Ne mendojmë se nuk ka ndonjë pengesë që përjashtimi këtu të jetë i lidhur, sepse fjalia **"farefisi nga barku ..."** është një argument se të afërmit janë më meritorë se të huajt, në lidhje me pasurinë që i ka lënë i vdekuri, përveç, nëse është lënë me testament, pasi në atë rast, atij që i është lënë testamenti, është më meritor se të afërmit, në kornizën e një të tretës. Kjo është e ngjashme me rastet e përjashtuara, të cilat janë përmendur në ajetet e trashëgimisë, me formën "**pas testamentit ..."**.

Qëllimi i këtyre haditheve nuk është ndalimi i çështjes së trashëgimisë së pasurisë, përkundrazi qëllimi i tyre është kthimi i shikimit nga kuptimi i gjerë që ka fjala "trashëgimi". Ajo përfshin trashëgiminë e pasurisë, trashëgiminë e kujdesit dhe trashëgiminë e kalifatit.

Kjo trashëgimi nuk ka asnjë ngjashmëri me çështjen e trashëgimisë së sulltanëve, pasi trashëgimia këtu është si rezultat i meritës dhe i vlerës dhe ajo përfshin djemtë e Imamëve, që e kanë pasur këtë meritë. Kjo i ngjason plotësisht asaj që dëshironte Ibrahimi *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nga All'llahu i Madhëruar për pasardhësit e tij.

All'llahu i thotë atij se udhëheqjen dhe mbrojtjen nuk e marrin zullumqarët, përkundrazi ajo është veçori për ata që janë të pastër: **"Premtimin Tim nuk e marrin zullumqarët."**.

Gjithashtu, kjo i ngjason edhe asaj që themi kur vizitojmë varret e dëshmorëve në rrugë të All'llahut. Njëra prej tyre është ajo që themi para varrit të Imam Hysejnit *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Paqja qoftë mbi ty o trashëgimtar i Ademit, o trashëgimtar i Nuhut, o trashëgimtar i Ibrahimit, o trashëgimtar i Musait, o trashëgimtar i Isait dhe i Muhammedit.*".

S'ka dyshim se kjo trashëgimi është nga anët e besimit, e edukatës, e moralit dhe e shpirtërores.

---

1 Këto hadithe i ka nxjerrë dijetari i nderuar Hashim El Bahrani, në tefsirin "El Burhan", vëll. 3, f. 292-293. Njëri prej tyre është hadithi i mësipërm dhe hadithi 16, nga zinxhiri i këtyre haditheve.

Ajetet 7 – 8

وَإِذْ أَخَذْنَا مِنَ ٱلنَّبِيِّـۧنَ مِيثَـٰقَهُمْ وَمِنكَ وَمِن نُّوحٍ وَإِبْرَٰهِيمَ وَمُوسَىٰ
وَعِيسَى ٱبْنِ مَرْيَمَ ۖ وَأَخَذْنَا مِنْهُم مِّيثَـٰقًا غَلِيظًا ﴿٧﴾ لِّيَسْـَٔلَ ٱلصَّـٰدِقِينَ
عَن صِدْقِهِمْ ۚ وَأَعَدَّ لِلْكَـٰفِرِينَ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿٨﴾

"Ne lidhëm besën me ty (o Muhammed) **siç bëmë me Profetët e tjerë: me Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, të birin e Merjemes. Ne lidhëm me ata një besë solemne."**

"Që All'llahu të mund t'i pyesë të sinqertët për besnikërinë e tyre. Ndërsa për mohuesit Ai ka përgatitur dënim të dhembshëm."

Komentimi

Besa e fortë e All'llahut

Ajetet e kaluara bënë të qarta kompetencat e gjera të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin."**.

Ajetet 7-8 sqarojnë detyrat e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të të gjithë Profetëve të mëdhenj. Ne e dimë se kompetencat shoqërohen gjithmonë me përgjegjësitë dhe, nëse ka drejtësi, në krah të saj është detyra dhe përgjegjësia, pasi këto dy çështje nuk ndahen kurrë nga njëra–tjetra. Në bazë të kësaj, pa dyshim se Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, nëse ka të drejtë dhe kompetencë të gjerë, detyra e tij është përgjegjësia e madhe.

Ajeti 7 thotë: **"Ne lidhëm besën me ty** (o Muhammed) **siç bëmë me Profetët e tjerë: me Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, të birin e Merjemes. Ne lidhëm me ata një besë solemne."**.

Ajeti, në fillim, përmend të gjithë Profetët në çështjen e besës, pastaj i veçon, duke përmendur prej tyre pesë Profetët më të vendosur: Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain *(Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!)*. Mbi ta qëndron Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për madhështinë, pozitën e lartë dhe fisnikërinë e tij.

Kjo shpall se besa e përmendur, ishte një besë e përgjithshme, që është marrë nga të gjithë Profetët, edhe nëse të vendosurit kanë qenë të premtuar me atë besë dhe përgjegjës për të në formën më të fortë. Kjo besë është qartësuar me një miratim

shumë të fortë, të ashpër, me fjalinë: **"Ne lidhëm me ata një besë solemne."**.[1]

E rëndësishme është të dimë se çfarë bese është kjo që është marrë nga të gjithë Profetët. Komentuesit për këtë çështje, kanë pasur mendime të ndryshme. Mund të themi se të gjitha janë degë të ndryshme të një origjine, që është zbatimi i përgjegjësisë së përcjelljes së mesazhit, udhëheqjes dhe udhëzimit të njerëzve në të gjitha fushat e jetës.

S'ka dyshim se Profetët, që të gjithë kanë qenë të detyruar të thërrisnin njerëzit në Teuhid, para çdo gjëje tjetër, si dhe kanë qenë të detyruar, gjithashtu, të mbështesnin njëri–tjetrin. Profetët që vijnë, pranojnë si të vërtetë dhe vërtetojnë thirrjen e Profetëve të mëparshëm. Përmbledhja është: Thirrja të jetë në një drejtim, t'u përcillet të gjithëve një e vërtetë e vetme dhe të gjithë popujt të bashkohen nën një flamur të vetëm.

Mund të vihet re dëshmia e kësaj fjale në të gjitha ajetet e Kur'anit. Po përmendim disa prej tyre: Në ajetin 81 të sures "Ali Imran" lexojmë: **"Kujto kur All'llahu mori besëlidhjen nga Profetët** (dhe u tha)**: 'Çfarëdo që t'ju jap prej Librit dhe Urtësisë, kur t'ju vijë një i Dërguar, vërtetues i asaj që ju është dhënë, pa dyshim që duhet ta besoni dhe ta ndihmoni atë! A e pranoni këtë dhe barrën që po ju ngarkoj?' Ata u përgjigjën: 'E pranojmë'.** (All'llahu) **u tha: 'Bëhuni dëshmitarë, se edhe Unë bashkë me ju jam dëshmitar.'"**.

1 Kuptimi i fjalës *"el mithaku"* është *"marrëveshje e sigurt, me betim dhe besë"*. Duke u bazuar në kuptimin e kësaj fjale, si dhe përmendja e fjalës *"galidhan"-"e fortë"*, në ajet e përforcon akoma më shumë këtë kuptim.

I njëjti kuptim përmendet në ajetin 187 të sures "Ali Imran": **"Kujtoje** (o Muhammed) **kohën kur All'llahu mori premtimin nga ata që u është dhënë Libri se do t'ua shpjegojnë atë njerëzve dhe nuk do të fshehin asgjë nga ai. Pastaj ata e hodhën pas shpine** (premtimin) **dhe e ndërruan atë me një vlerë të vogël. Eh, sa këmbim të shëmtuar që bënë ata!"**.

All'llahu i Madhëruar e mori besën e sigurt nga Profetët, që do t'i ftojnë njerëzit në Njehsimin e All'llahut, Teuhidin e fesë së vërtetë dhe feve qiellore. Po kështu mori besën prej dijetarëve të ithtarëve të Librit, që të mos neglizhojnë sqarimin e fesë hyjnore, me sa mundësi që të kenë dhe të mos e fshehin atë kurrë.

Ajeti 8 sqaron qëllimin e dërgimit të Profetëve dhe besën e fortë që u mor nga ata: **"All'llahu të mund t'i pyesë të sinqertët për besnikërinë e tyre. Ndërsa për mohuesit Ai ka përgatitur dënim të dhembshëm."**.

Komentuesit e Kur'anit kanë bërë komentime të shumta për fjalën *"es sadikine"* - *"të sinqertit"*. Kush janë ata që synohen me këtë fjalë? Çfarë pyetje është kjo? Ajo që duket e harmonizuar, jo vetëm me ajetet e kësaj sureje, por edhe me ajetet e tjera të Kur'anit, është: Ata që synohen me fjalën *"të sinqertët"*, janë besimtarët që e vërtetuan sinqeritetin e pohimit të tyre duke e përkthyer në vepra. Ata dolën me kokën lart nga arena e sprovës dhe e testimit hyjnor.

Po listojmë disa fakte, për të argumentuar këtë fjalë:

Së pari: "Të sinqertët" këtu janë vënë përballë jobesimtarëve. Ky kuptim përfitohet qartë nga konteksti i përballjes.

Së dyti: Lexojmë ajetet 23-24 të kësaj sureje: **"Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me All'llahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre. Nuk ka dyshim se All'llahu do t'i shpërblejë të sinqertët për sinqeritetin e tyre e do t'i dënojë hipokritët, nëse do ose do t'u pranojë pendimin. Vërtet, All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**.

Së treti: Ajeti 15 i sures "El Huxhurat dhe ajeti 8 i sures "El Hashr" i ka përkufizuar mirë (të sinqertit). Në ajetin e sures "El Huxhurat" lexojmë: **"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë All'llahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë, por luftojnë në rrugën e All'llahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Këta janë besimtarë të sinqertë."**.

Ajeti 8 i sures "El Hashr" thotë: **"Një pjesë e plaçkës i takon edhe mërgimtarëve të varfër, të cilët u përzunë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e All'llahut dhe duke ndihmuar All'llahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e sinqertë."**.

Me këto ajete bëhet më se e qartë se të sinqertit janë: Ata që e vërtetuan sinqeritetin dhe pastërtinë e tyre në aspektet e mbrojtjes së fesë së All'llahut, të luftës, të qëndrimit dhe të vendosmërisë përballë problemeve. Ata sakrifikuan jo vetëm pasurinë e tyre, por edhe jetën.[1]

1 Një grup komentuesish kanë supozuar një variant tjetër për kuptimin e këtij ajeti. Ajo që nënkuptohet nga fjala **"të sinqertët"**, këtu janë Profetët, që, në Ditën e Kiametit, do të pyeten për kohën e qëndrimit të tyre, mbajtjes së besës dhe premtimit të tyre. Tri dëshmitë që i përmendëm më lart, e mohojnë këtë komentim.

Për sa i përket qëllimit të pyetjes për të sinqertët, bëhet e qartë nga ajo që thamë më lart: A janë të pastër në nijetin e tyre, në veprat e tyre? A janë besnik në pohimet e tyre, në shpenzim, në luftë dhe vendosmëri para vështirësive dhe problemeve, dhe në mënyrë të veçantë përballë vështirësive të fushëbetejës?

Ku bëhet kjo pyetje? Në pamje të parë, nga ajo që kuptojmë me një lexim të shpejtë të ajetit, duket se kjo pyetje bëhet në Kiamet, në gjykatën e drejtësisë hyjnore. Ajete të shumta të Kur'anit lajmërojnë bërjen e pyetjeve të tilla në Kiamet, në formë të përgjithshme.

Është supozuar, gjithashtu, që kjo fjalë është gjithëpërfshirëse, përfshin Profetët dhe besimtarët. Komentimi që u përmend më lart, është më shumë në harmoni jo vetëm me ajetet e kësaj sureje, por edhe me të gjitha ajetet e tjera të Kur'anit.

Ajetet 9 – 11

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ ٱذۡكُرُواْ نِعۡمَةَ ٱللَّهِ عَلَيۡكُمۡ إِذۡ جَآءَتۡكُمۡ جُنُودٞ فَأَرۡسَلۡنَا
عَلَيۡهِمۡ رِيحٗا وَجُنُودٗا لَّمۡ تَرَوۡهَاۚ وَكَانَ ٱللَّهُ بِمَا تَعۡمَلُونَ بَصِيرًا ٩ إِذۡ
جَآءُوكُم مِّن فَوۡقِكُمۡ وَمِنۡ أَسۡفَلَ مِنكُمۡ وَإِذۡ زَاغَتِ ٱلۡأَبۡصَٰرُ وَبَلَغَتِ
ٱلۡقُلُوبُ ٱلۡحَنَاجِرَ وَتَظُنُّونَ بِٱللَّهِ ٱلظُّنُونَا۠ ١٠ هُنَالِكَ ٱبۡتُلِيَ
ٱلۡمُؤۡمِنُونَ وَزُلۡزِلُواْ زِلۡزَالٗا شَدِيدٗا ١١

"O ju që keni besuar! Kujtoni mirësinë e All'llahut kur ju erdhi një ushtri (idhujtarësh)**, e Ne dërguam mbi ata erë dhe një ushtri** (engjëjsh) **që ju nuk e shihnit; ndërsa All'llahu i sheh të gjitha ato që bëni ju."**

"Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt dhe besimi juaj tek All'llahu u lëkund."

"Aty besimtarët u vunë në provë dhe u tronditën si nga një tronditje e fuqishme."

Komentimi

Sprova e madhe e All'llahut në përballjen me Ahzabët

Këto ajete dhe ajetet e tjera që do të vijnë më pas, të cilat formojnë një seri prej shtatëmbëdhjetë ajetesh, flasin rreth sprovave dhe provimeve më të vështira të All'llahut për besimtarët dhe hipokritët. Gjithashtu, në këto ajete tregohet sprovimi i të sinqertëve në punë. Kjo gjë është diskutuar në ajetet e mëparshme.

S'ka dyshim se këto ajete diskutojnë një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë islame, betejën e grupacioneve. Kjo betejë ishte pikë kthese në historinë islame, që përmbysi ekuilibrat e fuqive mes Islamit dhe mosbesimit, në favor të myslimanëve. Kjo fitore ishte çelsi për triumfet e ardhshme të mëdha, pasi në këtë betejë, u thye shpina e armiqve dhe pas kësaj, ata nuk mundën të ngriheshin për asnjë punë të rëndësishme.

Beteja e grupacioneve, ashtu siç e tregon edhe emri, ishte një përballje gjithëpërfshirëse nga ana e të gjithë armiqve të Islamit, grupeve të ndryshme, të cilat vunë në rrezik interesat dhe të mirat e tyre të paligjshme, si rezultat i zgjerimit dhe i përhapjes së kësaj feje.

Shkëndija e parë e luftës u ndez nga ana e çifutëve Beni Nedhir, të cilët erdhën në Mekë dhe i mashtruan kurejshët, që të luftonin Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke u premtuar atyre se do t'i mbështesnin dhe do t'u qëndronin në krah, deri në frymën e

fundit. Pastaj shkuan te fisi Gatafan dhe i përgatitën edhe ata për këtë çështje.

Më pas, këto fise ftuan aleatët e tyre, si fisi Beni Esed dhe Beni Selim. Kur të gjithë e ndien rrezikun, u bashkuan dhe ranë dakord që t'i jepnin fund Islamit dhe të vrisnin Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të shfarosnin myslimanët , të sulmonin Medinen dhe të shuanin dritën e llambadarit të Islamit.

Myslimanët, kur e panë veten e tyre para këtij legjioni gjigant, u mblodhën dhe u këshilluan me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Para së gjithash, morën mendimin e Selman Farisijut. Ata hapën një kanal të madh e të gjerë rreth Medines, me qëllim që armiku të mos kalonte me lehtësi e të sulmonte Medinen. Kjo është arsyeja, që një nga emrat e kësaj beteje ishte Beteja e Hendekut.

Myslimanët kaluan çaste shumë të vështira dhe të rrezikshme. Zemra po u dilte nga vendi, nga frika, kurse hipokritët, nga ana tjetër, morën zemër për ta zhdukur Islamin. Tabloja ishte kjo: Armiqtë ishin të shumtë në numër, kurse myslimanët, shumë të paktë. Kanë përmendur se numri i jobesimtarëve ishte dhjetëmijë, kurse myslimanët ishin tremijë. Jobesimtarët ishin të armatosur me të gjitha mjetet luftarake. Të gjitha këto vizatuan në sytë e myslimanëve një tabllo të llahtarshme.

Mirëpo, All'llahu i Madhëruar dëshiroi që t'i zbriste këtu një goditje tjetër mosbesimit dhe të dallonte radhët e hipokritëve, duke ua çjerrë maskën kurtheve të tyre dhe t'i vendoste myslimanët e vërtetë në pozitën e sprovës së vështirë.

Kjo betejë mbaroi me triumfin e myslimanëve, pasi, me urdhrin e All'llahut, fryu një shtrëngatë e madhe, që i shkuli çadrat e jobesimtarëve dhe i shkatërroi mjetet e tyre. Në zemrat e tyre hodhi frikë të madhe. All'llahu Madhëruar, në ndihmë të myslimanëve, dërgoi forcat e panjohura të engjëjve.

Është regjistruar në këtë beteje forca e madhe e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, para Amër ibn Abdu Vudit. Idhujtarët u detyruan të arratisen, pa pasur fuqi që të bënin gjë.

Zbritën shtatëmbëdhjetë ajetet e kësaj sureje. Nëpërmjet analizimeve të hollësishme dhe të qarta të tyre, myslimanët përfituan shumë, triumfin e Islamit dhe shtypjen e hipokritëve.

Ky ishte një demonstrim i betejës së grupacioneve, e cila ka ndodhur në vitin e pestë hixhri.[1]

Fillojmë komentimin e ajeteve. Të gjitha hapat e kësaj beteje do t'i diskutojmë njëra pas tjetrës.

Kur'ani e përmbledh këtë ngjarje në një ajet të vetëm: **"O besimtarë! Kujtoni dhuntinë e All'llahut kur ju erdhi një ushtri** (idhujtarësh)**, e Ne dërguam mbi ata erë dhe një ushtri** (engjëjsh) **që ju nuk e shihnit; ndërsa All'llahu i sheh të gjitha ato që bëni ju."**.

All'llahu i di veprat e çdo grupi dhe çfarë u bë në këtë fushëbetejë të madhe.

---

1 Ajo që përmendëm më lart ishte një përmbledhje i një diskutimi të detajuar, që kanë paraqitur historianët. Njëri prej tyre është Ibn Ethiri në librin e tij "El Kamil".

Këtu ka disa kërkesa që meritojnë të saktësohen:

Së pari: fjala *"përkujtoni"*, tregon se këto ajete kanë zbritur, pasi ka përfunduar lufta dhe ka kaluar një periudhë kohe. U dha leje myslimanëve, që të përpunonin në mendjen e tyre ato që kishin parë, të reflektonin rreth tyre, me qëllim që ndikimi të ishte më i madh.

Së dyti: Fjala *"ushtarë"* tregon grupacionet e ndryshme të injorancës, si: kurejshët, gatafanët, Beni Selimët, Beni Esedët, Beni Fezaret, Beni Eshxhaut dhe Beni Murretët, si dhe grupi i çifutëve në brendësi të Medines.

Së treti: Kuptimi i fjalisë **"ushtri që ju nuk e shihnit"**, e cila zbriti të ndihmojë myslimanët, janë melekët. Në fund të ajetit 9 të sures "El Enfal" e kemi sqaruar këtë fakt. Ne nuk kemi argument se këta ushtarë hyjnorë, të padukshëm kanë zbritur në fushën e betejës dhe kanë luftuar. Kontekstet e pranishme, e bëjnë të qartë se engjëjt kanë zbritur për të ngritur lart moralin e besimtarëve, për të forcuar vendosmërinë e tyre, si dhe për të rritur entuziazmin e tyre.[1]

Ajeti 10 mishëron situatën e nevojshme në atë betejë, fuqinë e frikshme luftarake të armiqve dhe frikën e madhe të shumicës së myslimanëve: **"Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt dhe besimi juaj tek All'llahu u lëkund."**.

Shumë komentues mendojnë se fjala *"feuka"* - *"lart"*, në këtë ajet, është tregues i anës lindore të Medines. Ai është vendi

1 Për më tepër sqarim, shih fundin e komentimit të ajetit 9 të sures "El Enfal" në këtë komentim.

nga hyri fisi Gatafan, kurse *"esfel"* - *"poshtë"* është tregues i perëndimit të qytetit, ku hynë kurejshët dhe të tjerët që ishin me ta.

Nëse vërejmë, Meka bie fiks në jug të Medines. Atëherë është normale që fiset idhujtare erdhën nga jugu. Mbase shtegu i rrugës dhe hyrja e Medines ka qenë në atë situatë, ku këta janë rrotulluar pak rreth Medines dhe kanë hyrë në perëndim. Megjithatë, fjalia e mësipërme është treguese e rrethimit të këtij qyteti nga ana e armiqve të ndryshëm të Islamit.

Togfjalëshi **"sytë tuaj u errësuan"**, duke vënë re se fjala *"zaagat"* rrjedh nga fjala *"ez zejgu"*, domethënë *anim nga njëri krah, shtangie,* është tregues i situatës, kur njeriu ndien frikë dhe shqetësim, ku sytë e tij shikojnë vetëm në një drejtim, shtangen dhe vazhdojnë të përqendrohen në një pikë të caktuar dhe në atë moment mbetet i habitur.

Fjalia **"zemrat ju erdhën në fyt"** është metaforë e bukur rreth situatës së frikës dhe shqetësimit, sepse në të kundërt, zemra lëndore nuk lëviz nga vendi i saj dhe asnjëherë nuk arrin në fyt.

Kurse fjalia **"besimi juaj tek All'llahu u lëkund",** tregon se disa myslimanëve u shkonin ndërmend mendime djallëzore, sepse ata akoma nuk kishin arritur fazën e përsosjes së besimit. Pikërisht, për këta besimtarë tregon ajeti.

Mbase një pjesë e tyre mendonte se do të mundeshin, do të triumfonte ushtria e armikut me këtë fuqi dhe madhështi, u afrua fundi i jetës së Islamit dhe premtimet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për triumf, nuk do të vërtetoheshin asnjëherë.

Është normale se këto mendime shfaqnin besim të paqëndrueshëm, ishin ngacmime që ndodhnin në thellësitë e zemrës së disave. Kjo është e ngjashme me atë që përmendet në Betejën e Uhudit: **"Pastaj, pas dëshpërimit tuaj,** (All'llahu) **ju dërgoi qetësinë - një gjumë, që kaploi një grup prej jush. Kurse grupi tjetër** (hipokritët) **kujdesej vetëm për veten, duke menduar për All'llahun të pavërtetën, ashtu si mendonin paganët. Ata thoshin: 'Ku është fitorja që na ishte premtuar?' Thuaju** (o Muhammed!)**: 'Të gjitha janë në dorë të All'llahut!' Ata fshehin në vete atë që nuk duan të ta shfaqin ty. Ata thoshin: 'Sikur të pyeteshim ne për këtë gjë, nuk do të vriteshim këtu'. Thuaju: 'Edhe sikur të kishit qenë nëpër shtëpitë tuaja, prapëseprapë atyre që u është shkruar të vriten, do të dilnin në vendin e vrasjes'. All'llahu e bëri këtë për të provuar atë që keni në kraharorët tuaj dhe për t'ju pastruar atë që keni në zemrat tuaja. Vërtet, All'llahu e di mirë se ç'keni në zemër."**.[1]

Nuk ka dyshim se atyre që u adresohet ky ajet që po komentojmë, janë besimtarët. Fjalia: **"O ju që keni besuar"**, e cila është përmendur në ajetin e kaluar, është argument i qartë për këtë kuptim. Mbase nuk e ka kthyer shikimin tek ata që e konsideruan hipokritët se janë ata që u adresohet këtu. Mbase ata menduan se mendime të tilla nuk i shkojnë për shtat besimit dhe Islamit, në kohën kur shfaqja e mendimeve të tilla nuk konsiderohet ngacmim djallëzor, sidomos në ato kushte të vështira e shumë shqetësuese. Kjo është një çështje normale, për

1 Sure "Ali Imran", ajeti 154.

sa u përket atyre me besim të dobët dhe atyre që janë fillestarë në Islam.[1]

Këtu sprovimi i All'llahut i kaloi përmasat, siç thotë edhe ajeti 11: **"Aty besimtarët u vunë në provë dhe u tronditën si nga një tronditje e fuqishme."**.

Është normale se, nëse njeriu përfshihet nga furtunat mendore, pa dyshim se trupi i tij nuk mund të shmanget nga ky sprovim, madje te ai do të shfaqen gjurmët e shqetësimit dhe të tronditjes. Në shumë raste shohim se personat që janë të shqetësuar mendërisht, nuk mund të qëndrojnë pa lëvizur dhe shqetësimet e tyre mendore reflektohen qartë nëpërmjet lëvizjeve të tyre, nga mbajtja e duarve të lidhura me njëra–tjetrën.

Një nga dëshmitë e kësaj frike dhe shqetësimi të fortë është ajo që transmetohet: Pesë nga heronjtë e famshëm arabë, me në krye Amër ibn Abdu Vudin, zbritën në sheshin e luftimit me arrogancë të theksuar dhe krenari të madhe. Ata pyetën: "A ka ndonjë sfidues?"

Amër ibn Abdu Vudi tallej me myslimanët dhe përbuzte Xhennetin dhe Ahiretin dhe thoshte: "O ju myslimanë, a nuk keni thënë se të vrarët tuaj janë në Xhennet? A ka ndonjë nga ju, që e ka marrë malli për Xhennetin?"

Por heshtja kishte pllakosur mbi ushtrinë myslimane, para talljes, përqeshjes dhe thirrjes së tij për të dalë në shesh. Askush

1 Një grup komentuesish e kanë komentuar fjalën *"dhunune"* me kuptimin e përgjithshëm *"për mendimin e keq dhe të mirë"*, vetëm se kontekstet e pranishme në këtë ajet dhe në ajetin që pason, sqarojnë se këtu, fjala *"dhunune"* përfshin *"mendimet e këqija"*.

nuk doli në duelin e tij, përveç Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili u vërsul për ta sfiduar atë. U dhuroi myslimanëve një fitore të madhe. Kjo çështje do të diskutohet hollësisht më pas.

Me të vërtetë, nëse hekuri futet në zjarr, rritet fortësia dhe myslimanët e parë duhet të hidheshin në vatrën e ngjarjeve të vështira, të hidhëta e sidomos në betejat si beteja e grupacioneve, që të bëheshin më të fortë e më të qëndrueshëm.

Ajetet 12 - 17

وَإِذۡ يَقُولُ ٱلۡمُنَٰفِقُونَ وَٱلَّذِينَ فِي قُلُوبِهِم مَّرَضٞ مَّا وَعَدَنَا ٱللَّهُ وَرَسُولُهُۥٓ إِلَّا غُرُورٗا ١٢ وَإِذۡ قَالَت طَّآئِفَةٞ مِّنۡهُمۡ يَٰٓأَهۡلَ يَثۡرِبَ لَا مُقَامَ لَكُمۡ فَٱرۡجِعُواْۚ وَيَسۡتَـٔۡذِنُ فَرِيقٞ مِّنۡهُمُ ٱلنَّبِيَّ يَقُولُونَ إِنَّ بُيُوتَنَا عَوۡرَةٞ وَمَا هِيَ بِعَوۡرَةٍۖ إِن يُرِيدُونَ إِلَّا فِرَارٗا ١٣ وَلَوۡ دُخِلَتۡ عَلَيۡهِم مِّنۡ أَقۡطَارِهَا ثُمَّ سُئِلُواْ ٱلۡفِتۡنَةَ لَأٓتَوۡهَا وَمَا تَلَبَّثُواْ بِهَآ إِلَّا يَسِيرٗا ١٤ وَلَقَدۡ كَانُواْ عَٰهَدُواْ ٱللَّهَ مِن قَبۡلُ لَا يُوَلُّونَ ٱلۡأَدۡبَٰرَۚ وَكَانَ عَهۡدُ ٱللَّهِ مَسۡـُٔولٗا ١٥ قُل لَّن يَنفَعَكُمُ ٱلۡفِرَارُ إِن فَرَرۡتُم مِّنَ ٱلۡمَوۡتِ أَوِ ٱلۡقَتۡلِ وَإِذٗا لَّا تُمَتَّعُونَ إِلَّا قَلِيلٗا ١٦ قُلۡ مَن ذَا ٱلَّذِي يَعۡصِمُكُم مِّنَ ٱللَّهِ إِنۡ أَرَادَ بِكُمۡ سُوٓءًا أَوۡ أَرَادَ بِكُمۡ رَحۡمَةٗۚ وَلَا يَجِدُونَ لَهُم مِّن دُونِ ٱللَّهِ وَلِيّٗا وَلَا نَصِيرٗا ١٧

"Por hipokritët dhe ata me zemra të sëmura e të dobëta, thanë: 'All'llahu dhe i Dërguari i Tij nuk na kanë premtuar asgjë, pos mashtrimit!'"

"Dhe një grup prej tyre tha: 'O banorët e Jethribit, s'ka qëndrim këtu për ju, andaj kthehuni!' Një grup tjetër nga ata kërkoi leje prej të Dërguarit, duke thënë: 'Në të vërtetë, shtëpitë

tona janë të pambrojtura!' Por ato nuk ishin të pambrojtura. Ata donin vetëm të iknin."

"Sikur armiku t'i pushtonte ata nga të gjitha anët e t'u kërkonte që të bëheshin idhujtarë, ata do të bëheshin duke ngurruar fare pak."

"Ndërsa më parë i qenë betuar All'llahut, se nuk do të zmbrapseshin. Për këtë besëlidhje me All'llahun do të përgjigjen."

"Thuaju: "Nuk do t'ju bëjë dobi të ikurit, nëse ikni prej vdekjes apo vrasjes. Edhe atëherë, ju do të kënaqeni vetëm për pak kohë!"

"Thuaju: 'Kush është ai, që do t'ju ruajë nga All'llahu, nëse Ai dëshiron që t'ju godasë e keqja?! Kush mund ta pengojë Atë, nëse Ai do që t'ju japë mëshirë?!' Ata nuk do të gjejnë as mbrojtës, as ndihmës tjetër, përveç All'llahut."

Komentimi

Hipokritët në oborrin e Ahzabëve *(grupacioneve, partive)*

Iku ndriçimi i sprovës së luftës së grupacioneve. Të gjithë u sprovuan me këtë provim të madh e të vështirë. Është e qartë se njerëzit që qëndrojnë dukshëm në një radhë të vetme, në kushte të zakonshme, ndahen në shumë radhë të ndryshme, në situata shqetësuese, të vështira. Këtu, gjithashtu, myslimanët u ndanë në

grupe të ndryshme: besimtarët e vërtetë dhe grupi i besimtarëve të veçantë dhe xhemati i atyre me besim të dobët, grupi i hipokritëve dhe pjesa e hipokritëve kokëfortë dhe fanatikë. Një pjesë e tyre mendonte për shtëpinë, jetën e tij dhe arratisjen. Një grup tjetër përpiqej për largimin e të tjerëve nga lufta, kurse një pjesë tjetër përpiqej në kompromisin e lidhjeve shoqërore me hipokritët.

Përmbledhja: Pa dyshim se secili shfaqi sekretet e tij të fshehta dhe çfarë ka përgatitur për të Kiameti, në këtë ditë, kur gjithçka del hapur.

Në ajetet e mëparshme flitej për një grup myslimanësh me besim të dobët, të cilët ranë në grackën e ngacmimeve djallëzore, të mendimeve të këqija dhe refuzuan ajetet që iu zbritën. Kur'ani, për hipokritët dhe për ata që kishin zemra të sëmura, thotë: **"Por hipokritët dhe ata me zemra të sëmura e të dobëta, thanë: 'All'llahu dhe i Dërguari i Tij nuk na kanë premtuar asgjë, pos mashtrimit!'"**.

Në historinë e luftës së grupacioneve përmendet: Gjatë hapjes së kanalit, kur myslimanët ishin të zënë me hapjen e kanalit, u përballën me një copë shkëmbi shumë të madh, që nuk i bënte gjë asnjë kazmë. Lajmëruan Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai erdhi vetë te kanali dhe qëndroi në krah të shkëmbit, mori kazmën dhe e goditi shkëmbin me një goditje të vetme, të fortë. Shkëmbi u nda e prej saj dolën shkëndija. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e madhëroi All'llahun, duke thënë: "All'llahu Ekber!" Edhe myslimanët e madhëruan All'llahun.

Pastaj e goditi gurin edhe një herë tjetër dhe u nda përsëri, duke nxjerrë shkëndija prej saj. Përsëri Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e madhëroi All'llahun. Edhe myslimanët e madhëruan All'llahun. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* goditi për herë të tretë dhe u shkërmoq pjesa e mbetur e gurit, duke dalë përsëri shkëndija. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e madhëroi All'llahun, kurse myslimanët i ngritën lart zërat e tyre, duke e madhëruan edhe ata. Selmani e pyeti Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për këtë. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: "Hiraja dhe kështjellat e Kisrasë m'u shfaqën si fragment në shkëndijën e parë dhe Xhebarili më lajmëroi se ymeti im është në rrethinat e saj. Në shkëndijën e dytë, m'u dha si fragment kështjella e Humrit në tokat e Shamit dhe të Rrumit. Xhebraili më lajmëroi se ymeti im është në rrethinat e saj. Në të tretën, m'u tregua kështjella e San'asë. Xhebraili më lajmëroi se ymeti im është në rrethinat e saj, prandaj gëzohuni!" Myslimanët u gëzuan.

Hipokritët shikuan njëri-tjetrin dhe thanë: "A nuk po habiteni? Ai ju premton të pavërtetën, të kotën dhe ju lajmëron juve se ai shikon nga Jethribi në Hira dhe qytetet e Kisrasë dhe ata do t'i çlironi ju, kur ju nuk mund të provoni fuqinë tuaj.".

All'llahu zbriti ajetin: **"Por hipokritët dhe ata me zemra të sëmura e të dobëta, thanë: 'All'llahu dhe i Dërguari i Tij nuk na kanë premtuar asgjë, pos mashtrimit!'"**.[1]

E vërteta është se lajme dhe përgëzime të tilla, në atë ditë, hipokritët i kanë konsideruar mashtrim, por syri mbretëror i Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte i aftë të shikonte çlirimin e portave të kështjellave të mbretërve të Iranit, të Rrumit dhe të Jemenit, nëpërmjet shkëndijave fluturuese nga ai shkëmb. E përgëzon këtë ymet sakrifikues, i cili ka mbajtur zemrat në ekuilibër dhe ka larguar nga rruga perden e sekreteve të së ardhmes.

Mbase nuk kemi nevojë të kujtojmë se ajo që nënkuptohet me fjalinë: **"ata me zemra të sëmura e të dobëta"** janë hipokritët. Kjo fjali përmendi një realitet të fjalës "hipokrit". Më parë është përmendur se cila sëmundje është më e keqe dhe më e dëmshme se hipokrizia, sepse njeriu i shëndoshë, i cili ka natyrshmëri të shëndoshë hyjnore ka vetëm një fytyrë të vetme, kurse ata që kanë dy apo më shumë fytyra, pa dyshim janë të sëmurë. Ata janë gjithmonë të sprovuar me shqetësim dhe kontradiktë në fjalë dhe vepra.

Dëshmitar për këtë çështje është ajo që përmendet në fillim të sures "El Bekare", kur përshkruhen hipokritët: **"Në zemrat e**

1 "El Kamilu" i Ibn Ethirit, vëll. 2, f. 179. Kjo ngjarje është përmendur me një ndryshim të lehtë në historinë e Ibn Hishamit, ku Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Për sa i përket shkëndijës së parë, All'llahu më hapi dyert e triumfit në Jemen, kurse te e dyta, All'llahu më hapi dyert e triumfit të Shamit dhe të Marokut, kurse për sa i përket të tretës, All'llahu më hapi dyert e triumfit të Lindjes.". Kjo radhitje harmonizohet me zinxhirin historik të çlirimit të këtyre tri zonave.

tyre ka një sëmundje, të cilën All'llahu ua shton. Ata i pret një dënim i dhembshëm, për shkak të hipokrizisë së tyre.".[1]

Ajeti tjetër sqaron gjendjen e një grupi tjetër prej këtyre hipokritëve, me zemra të sëmura, të cilët ishin më të pisët e më të shthurur se pjesa e mbetur: **"Dhe një grup prej tyre tha: 'O banorët e Jethribit, s'ka qëndrim këtu për ju, andaj kthehuni!'"**.

Përmbledhja e çështjes është: Ju nuk mund të bëni asgjë përballë legjioneve të zhurmshme të armiqve, prandaj tërhiquni nga beteja dhe mos u hidhni me duart tuaja në shkatërrim, kurse gratë dhe fëmijët tuaj nën poshtërimin e robërve të luftës. Me këto fjalë ata donin të ndanin, të izolonin ensarët nga ushtria e Islamit.

Në anën tjetër lexojmë: **"Një grup tjetër nga ata kërkoi leje prej të Dërguarit, duke thënë: 'Në të vërtetë, shtëpitë tona janë të pambrojtura!' Por ato nuk ishin të pambrojtura. Ata donin vetëm të iknin."**.

Fjala *"auretun"* rrjedh nga fjala *"aarun"* dhe thuhet për diçka që detyron shfaqjen e tij lakuriq, të zhveshur. U thuhet, gjithashtu, edhe çarjeve apo plasaritjeve që shfaqen në rroba apo muret e shtëpisë. Thuhet për pikat e dobëta dhe pikat kufitare, ku depërtimi dhe shkatërrimi i tyre është i mundur. Gjithashtu, thuhet edhe për atë që njeriu ka frikë dhe i ruhet. Këtu ka për qëllim shtëpitë, të cilat nuk kanë mure të sigurta dhe derë të fortë dhe frikësohet nga sulmi i armikut.

Hipokritët, duke paraqitur këto arsye, donin të arratiseshin nga arena e luftës, t'i largoheshin luftimit dhe të qëndronin në shtëpitë e veta.

1 Sure "El Bekare", ajeti 10.

Në një transmetim thuhet: Grupi i Beni Harithes dërgoi një njeri prej tyre te Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: "Shtëpitë tona nuk janë të sigurta dhe nuk ka shtëpi të ensarëve që nuk i ngjason shtëpive tona. Ne nuk kemi asnjë problem mes nesh dhe "Gatafanëve", të cilët kanë sulmuar në lindje të Medines. Na jep leje neve, që të kthehemi në shtëpitë tona dhe të mbrojmë gratë dhe fëmijët tanë.".

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u dha leje.[1]

Ky lajm iu përcoll Sa'd ibn Muadhit, më i madhi i ensarëve dhe i tha Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Mos u jep atyre leje, pasi, betohem për Zotin, këta njerëz janë justifikuar me këtë, sa herë që kemi pasur një problem. Ata gënjejnë."*.

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi që ata të ktheheshin.

Fjala "*Jethrib*" është emri i vjetër i Medines, para se të emigronte atje Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Pas hixhretit të tij, dalëngadalë, emri i saj u bë "qyteti i të Dërguarit" dhe thjesht Medine.

Për këtë qytet ka shumë emra. Sherif Murtediu *(All'llahu e mëshiroftë!)* ka përmendur njëmbëdhjetë emra të tjerë, duke shtuar edhe këto emra: *Tibe* (e mirë), *Tabe* (mirësia), *Sekinetu* (qetësia), *Mahbubetun* (e dashur), *Merhumetun* (e mëshiruar).

1 Tefsiri "Fi Dhilalil Kur'an", vëll. 6, f. 554.

Disa mendojnë se fjala *"Jethrib"* është emri i një toke të këtij qyteti.[1]

Në disa transmetime thuhet se Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Këtë qytet mos e thërrisni me emrin 'Jethrib'."*.

Arsyeja e kësaj fjale të të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vjen ndoshta nga kuptimi i kësaj fjale. Fjala *"Jethrib"* rrjedh nga fjala *"therbun"*, njësoj si *"harbun"*, që do të thotë *"qortim"*. Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk dëshironte këtë emër për këtë qytet të bekuar.

Biseda e hipokritëve ndaj popullit të Medines me: **"O banorët e Jethribit"** nuk ishte një bisedë dashamirëse. Mbase ata vendosën ta quanin me këtë emër, pasi e dinin se Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka neveri këtë emër. Ndoshta ata donin të lajmëronin mosnjohjen e tyre ndaj Islamit dhe emrin e qytetit të të Dërguarit, apo që të ktheheshin me familjen e tyre, në fazën e injorancës.

Ajeti tjetër tregon besimin e dobët të këtij grupi. Këta kishin besim aq të dobët, sa, kur ushtria e mohimit do të hynte në Medine nga çdo anë e saj dhe do ta pushtonte atë, e kur t'i ftonte ata në idhujtari dhe mosbesim, atëherë ata do ta pranonin atë dhe do të nxitonin në të: **"Sikur armiku t'i pushtonte ata nga të gjitha anët e t'u kërkonte që të bëheshin idhujtarë, ata do të bëheshin duke ngurruar fare pak."**.

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 346.

Është e ditur se njerëz me këtë dobësi dhe pavendosmëri janë të papërgatitur të takohen me armikun dhe luftimin e tij. Ata nuk janë të gatshëm as të pranojnë të bien dëshmor në rrugë të All'llahut, përkundrazi dorëzohen me lehtësi dhe e ndryshojnë rrugën e tyre. Duke u bazuar nga këto që thamë, fjala *"el fitnetu"* përfshin këtu idhujtarinë dhe mohimin, ashtu siç thuhet në ajetet e tjera të Kur'anit, si ajeti 193 i sures "El Bekare". Një pjesë e komentuesve kanë supozuar se ajo që ka për qëllim fjala *"el fitnetu"*, këtu është: Lufta kundër myslimanëve. Sikur kjo t'u shfaqej këtyre hipokritëve, do t'i përgjigjeshin me shpejtësi dhe do t'i ndihmonin njerëzit tradhtarë. Ky komentim nuk harmonizohet me fillimin e fjalisë: **"t'i pushtonte ata nga të gjitha anët"**.

Mbase për këtë shkak, shumica e komentuesve kanë zgjedhur kuptimin e parë.

Kur'ani e fton këtë grup hipokritësh në një proces gjyqësor: **"Ndërsa më parë i qenë betuar All'llahut, se nuk do të zmbrapseshin. Për këtë besëlidhje me All'llahun do të përgjigjen!"**.

Për këtë, pa dyshim se ata janë përgjegjës para premtimit të dhënë.

Disa kanë thënë se ajo që nënkuptohet me fjalën *"besë"* dhe *"premtim"* është besa që Benu Harithe ia dha All'llahut dhe të Dërguarit të Tij Ditën e Uhudit, kur ata vendosën rikthimin nga fushëbeteja. Pastaj u penduan dhe i premtuan vetes së tyre se nuk

do të bënin kësi punësh. Por në betejën e grupacioneve ata e menduan përsëri prishjen e marrëveshjes dhe të besës.[1]

Disa mendojnë se është tregues i premtimit që i dhanë të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në Betejën e Bedrit, apo në Akabe, para hixhretit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.[2]

Çdokush që beson, i jep fjalën Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i premton atij se do ta mbrojë Islamin dhe Kur'anin, edhe sikur t'i kushtojë atij jetën.

Përqendrimi te besa dhe premtimi është për shkak se edhe vetë arabët e injorancës e respektonin çështjen e besës, atëherë si mund ta thyejë njeriu besën dhe ta shkelë me këmbë, pasi ka pohuar Islamin?

Pasi All'llahu i Madhëruar e përhapi nijetin e hipokritëve dhe bëri të qartë se qëllimi i tyre nuk ishte mbrojtja e shtëpive të tyre, por arratisja nga fushëbeteja e luftës, u përgjigjet atyre me dy urdhëresa: **"Thuaju: 'Nuk do t'ju bëjë dobi të ikurit, nëse ikni prej vdekjes apo vrasjes. Edhe atëherë, ju do të kënaqeni vetëm për pak kohë!'"**.

Supozoni se ju mund të arratiseni, atëherë çështja është vetëm se në dy situata: ose Exheli të jetë afati juaj përfundimtar dhe vdekja ju ka afruar, pasi kudo që të jeni, vdekja do t'ju marrë

1 Tefsiri i Kurtubijut dhe tefsiri "Fi Dhilalil Kur'ani", fundi i ajeteve është burimi i komentimit.
2 Këtë fjalë e ka transmetuar Alusij në tefsirin "Ruhul Meanij".

për qafe, edhe sikur të jeni në shtëpitë tuaja dhe mes grave dhe fëmijëve tuaj.

Nëse nuk ju ka ardhur afati i vdekjes, atëherë do të jetoni në këtë dynja pak ditë të tjera, që janë të shoqëruara me poshtërim dhe përbuzje. Do të jeni në mëshirën e armiqve tuaj dhe në dorën e tyre. Pas kësaj do të merrni dënimin e All'llahut.

Ky sqarim i ngjason asaj që përmendet në Betejën e Uhudit, ku Kur'ani tregoi për një grup tjetër hipokritësh, të demoralizuar dhe përçarës të unitetit: **"Pastaj, pas dëshpërimit tuaj,** (All'llahu) **ju dërgoi qetësinë - një gjumë, që kaploi një grup prej jush. Kurse grupi tjetër** (hipokritët) **kujdesej vetëm për veten, duke menduar për All'llahun të pavërtetën, ashtu si mendonin paganët. Ata thoshin: 'Ku është fitorja që na ishte premtuar?' Thuaju** (o Muhammed)**: 'Të gjitha janë në dorë të All'llahut!' Ata fshehin në vete atë që nuk duan të ta shfaqin ty. Ata thoshin: 'Sikur të pyeteshim ne për këtë gjë, nuk do të vriteshim këtu.' Thuaju: 'Edhe sikur të kishit qenë nëpër shtëpitë tuaja, prapëseprapë atyre që u është shkruar të vriten, do të dilnin në vendin e vrasjes.' All'llahu e bëri këtë për të provuar atë që keni në kraharorët tuaj dhe për t'ju pastruar atë që keni në zemrat tuaja. Vërtet, All'llahu e di mirë se ç'keni në zemër."**.[1]

Së dyti: Të gjitha fatet tuaja janë në dorë të All'llahut dhe nuk do të jeni kurrë të aftë të largoheni nga kufijtë e qeverisjes së All'llahut, fuqisë dhe vullnetit të Tij: **"Thuaju: 'Kush është ai, që do t'ju ruajë nga All'llahu, nëse Ai dëshiron që t'ju godasë e keqja?! Kush mund ta pengojë Atë, nëse Ai do që t'ju japë**

1 Sure "Ali Imran", ajeti 154.

mëshirë?!' Ata nuk do të gjejnë as mbrojtës, as ndihmës tjetër, përveç All'llahut.".

Në bazë të kësaj, s'ka dyshim se, nëse ju e dini se të gjitha fatet tuaja janë në dorë të All'llahut të Madhëruar, atëherë bindjuni urdhrit të Tij në luftë, e cila është baza e forcës, e nderimit dhe e madhështisë në dynja dhe te All'llahu, deri edhe nëse vendos që të marrësh meritën e të rënit dëshmor, atëherë ju duhet ta prisni atë me krahë hapur.

Ajetet 18 – 20

۞ قَدۡ يَعۡلَمُ ٱللَّهُ ٱلۡمُعَوِّقِينَ مِنكُمۡ وَٱلۡقَآئِلِينَ لِإِخۡوَٰنِهِمۡ هَلُمَّ إِلَيۡنَاۖ وَلَا يَأۡتُونَ ٱلۡبَأۡسَ إِلَّا قَلِيلاً ﴿١٨﴾ أَشِحَّةً عَلَيۡكُمۡۖ فَإِذَا جَآءَ ٱلۡخَوۡفُ رَأَيۡتَهُمۡ يَنظُرُونَ إِلَيۡكَ تَدُورُ أَعۡيُنُهُمۡ كَٱلَّذِي يُغۡشَىٰ عَلَيۡهِ مِنَ ٱلۡمَوۡتِۖ فَإِذَا ذَهَبَ ٱلۡخَوۡفُ سَلَقُوكُم بِأَلۡسِنَةٍ حِدَادٍ أَشِحَّةً عَلَى ٱلۡخَيۡرِۚ أُوْلَٰٓئِكَ لَمۡ يُؤۡمِنُواْ فَأَحۡبَطَ ٱللَّهُ أَعۡمَٰلَهُمۡۚ وَكَانَ ذَٰلِكَ عَلَى ٱللَّهِ يَسِيرًا ﴿١٩﴾ يَحۡسَبُونَ ٱلۡأَحۡزَابَ لَمۡ يَذۡهَبُواْۖ وَإِن يَأۡتِ ٱلۡأَحۡزَابُ يَوَدُّواْ لَوۡ أَنَّهُم بَادُونَ فِي ٱلۡأَعۡرَابِ يَسۡـَٔلُونَ عَنۡ أَنۢبَآئِكُمۡۖ وَلَوۡ كَانُواْ فِيكُم مَّا قَٰتَلُوٓاْ إِلَّا قَلِيلاً ﴿٢٠﴾

“All’llahu i njeh mirë ata midis jush, që pengojnë (të tjerët nga vajtja në luftë) **dhe u thonë vëllezërve të tyre: ‘Ejani te ne!’ Vetëm pak prej tyre vijnë në luftë.”**

“Por edhe atëherë ngurrojnë që t’ju ndihmojnë. Kur frikësohen, ata të shikojnë ty (o Muhammed) **për ndihmë, duke i rrotulluar sytë sikur të ishin në agoni. Por, sapo t’u kalojë frika, ata ju sulmojnë me gjuhë të mprehtë dhe janë koprracë**

me ju për çfarëdo të mire. Këta janë ata që nuk kanë besuar, andaj All'llahu i ka asgjësuar veprat e tyre. E, kjo për All'llahun është lehtë."

"Ata mendonin se ende nuk kishte ikur ushtria e aleatëve e, nëse do vinte ushtria e aleatëve, ata do të dëshironin të ishin në mesin e arabëve të shkretëtirës e të pyesin për ju. Por edhe sikur të mbeteshin me ju, pak do të luftonin."

Komentimi

Grupi pengues

Këto ajete flasin për situatën e një grupi tjetër të hipokritëve, të cilët braktisën luftën e grupacioneve (Ahzabëve) dhe ftonin të tjerët që të largoheshin nga lufta. Ajeti thotë: **"All'llahu i njeh mirë ata midis jush, që pengojnë** (të tjerët nga vajtja në luftë) **dhe u thonë vëllezërve të tyre: 'Ejani te ne!' Vetëm pak prej tyre vijnë në luftë."**.

Fjala *"el muau'uikijne"* rrjedh nga fjala *"aukun"*, njësoj si fjala *"sheukun"*. Kuptimi i saj është: Diçka të pengon për të bërë një punë dhe përpjekja për t'ua larguar të tjerëve këtë pengesë. Kuptimi i rrënjës së fjalës *"el be'su"* është: e keqja e fortë. Ajo që nënkuptohet në këtë ajet këtu është lufta.

Supozohet që ajeti i mësipërm të jetë tregues i dy grupeve: grupi i hipokritëve, të cilët ishin në radhët e myslimanëve. Fjala

"*prej jush*" e dëshmon këtë gjë. Ata përpiqeshin të ndalonin besimtarët me besim të dobët të shkonin në luftë. Këta janë "penguesit".

Grupi tjetër janë hipokritët ose çifutët, të cilët mbajtën vetëm njërën anë. Kur takonin ushtarët e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ata thoshin: "Ejani me ne dhe tërhiquni nga lufta.". Për këta ka folur fjalia e dytë.

Supozohet që ky ajet të jetë sqarues i dy situatave të ndryshme për një grup të vetëm, ata që pengojnë njerëzit nga lufta, kur janë në mesin e tyre. Kur ata i veçohen, i ftojnë njerëzit drejt vetes.

Në një transmetim, lexojmë: Një nga shokët e Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* erdhi nga fushëbeteja e luftës së Ahzabëve brenda Medines, për nevojat e tij. Kur pa vëllain e tij që kishte vënë para vetes bukë, mish të pjekur dhe pije, i tha atij: "Ti je këtu, duke u kënaqur, kurse i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është në luftë, mes shpatave dhe heshtave?!".

I vëllai iu përgjigj: "O budalla, qëndro me ne dhe merr pjesë në qejfin tonë, pasi ai që është aleat dhe i shkon pas Muhammedit, s'ka dyshim se nuk do të kthehet nga kjo betejë! Kjo ushtri gjigante që është bashkuar kundër tij, nuk do ta lërë Muhammedin dhe shokët e tij gjallë.".

Vëllai që ishte në luftë, i përgjigjet: "Ti gënjen. Betohem për Zotin, se do të shkoj e do t'i tregoj të Dërguarit të All'llahut për atë që the.".

Shkoi te Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tregoi se çfarë ndodhi. Pastaj zbrit ajeti. Sipas shkakut të zbritjes, pa dyshim se fjala (vëllezërit e tyre) është përmendur këtu me kuptimin e vëllezërve të vërtetë, ose me kuptimin, shokët e një ideologjie dhe të një rruge.

Ajeti 27 i sures "Isra", shpenzuesit e tepërt, i ka quajtur vëllezërit e shejtanëve: **"Dorëshpuarit me të vërtetë, janë vëllezërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij."**.

Ajeti që vjen më pas, shton se nxitësi i pengesave që u vunë para jush, është koprracia e tyre: **"Por edhe atëherë ngurrojnë që t'ju ndihmojnë. Kur frikësohen, ata të shikojnë ty** (o Muhammed) **për ndihmë, duke i rrotulluar sytë sikur të ishin në agoni. Por, sapo t'u kalojë frika, ata ju sulmojnë me gjuhë të mprehtë dhe janë koprracë me ju për çfarëdo të mire. Këta janë ata që nuk kanë besuar, andaj All'llahu i ka asgjësuar veprat e tyre. E, kjo për All'llahun është lehtë."**.[1]

Ata nuk janë koprracë vetëm në fushëbetejën e luftës, përkundrazi janë koprracë deri edhe në mjetet ndihmëse materiale, në përgatitjen e mjeteve të nevojshme të luftës, edhe në

1 Fjala *"eshihhaten"* është shumësi i fjalës *"shehihun"*. Rrjedh nga fjala *"eshehhu"*. Kuptimi është: Koprraci e shoqëruar me dëshirë. Sipas mendimit të shumicës së komentuesve, kuptimi i fjalës është *"gjendje"*, mirëpo ajo nuk e mohon që të jetë gjendje në pozitën e sqarimit të motivit. Shikojeni me kujdes.

forcat trupore për hapjen e kanalit, madje janë koprracë edhe në ndihmesën mendore. Një koprraci që shoqërohet çdo ditë me kujdes të tepruar.

Pas sqarimit të koprracisë dhe pengimit të tyre në çdo lloj ndihme dhe altruizmi, ajeti qartëson cilësitë e tjera të tyre. Një cilësi është e përgjithshme te të gjithë hipokritët, në çdo kohë e vend: **"Kur frikësohen, ata të shikojnë ty** (o Muhammed) **për ndihmë, duke i rrotulluar sytë sikur të ishin në agoni."**.

Kjo ndodh, sepse ata akoma nuk e kanë shijuar shijen e besimit të vërtetë dhe nuk janë mbështetur në një shtyllë të fortë në jetë, pasi ata e humbin kontrollin ndaj vetes së tyre, kur përballen me një ngjarje të vështirë dhe dilemë kritike. Duket sikur ata përballin vdekjen.

Ajeti shton: **"Por, sapo t'u kalojë frika, ata ju sulmojnë me gjuhë të mprehtë dhe janë koprracë me ju për çfarëdo të mire."**.

Ata vijnë te ju sikur janë çliruesit e vërtetë dhe bartësit e mobilizimeve të luftës. Festojnë, kënaqen dhe kërkojnë pjesën e tyre të plaçkës së luftës, kur ata janë më koprracë se të gjithë për gjithçka që ka të bëjë me luftën.

Fjala *"selekukum"* rrjedh nga fjala *"selkun"*. Kuptimi është: Hapja e diçkaje me nervozizëm dhe inat, njësoj sikur kjo hapje të ishte me dorë apo me gjuhë. Kjo shprehje përdoret për atë që kërkon diçka me parandalim dhe formë urdhërore. Grupi emëror *"me gjuhë të mprehta"* tregon gjuhët plagosëse dhe lënduese. Këtu është antonim i ashpërsisë së fjalës.

Ajeti tregon në fund një cilësi tjetër të tyre, e cila është esenca e stresit dhe e hidhërimit të tyre: **"Këta janë ata që nuk kanë besuar, andaj All'llahu i ka asgjësuar veprat e tyre. E, kjo për All'llahun është lehtë."**.

Si përfundim, mund të themi: Penguesit kanë qenë hipokritë, që dalloheshin me cilësitë e mëposhtme:

1- Ata nuk kanë qenë kurrë luftëtarë, përveç një pakice të vogël.

2- Nuk kanë qenë prej atyre që sakrifikonin, si pasurinë, ashtu edhe veten. Nuk i kalonin vështirësitë dhe problemet më të vogla.

3- Prej frikës së madhe, humbitnin ekuilibrat e personalitetit të tyre në çastet e vështirësive të mëdha.

4- Mendojnë se janë ata që kanë korrur fitoren dhe kanë të gjithë krenarinë për triumfin.

5- Ata kanë qenë njerëz pa besim dhe veprat e tyre nuk kishin asnjë vlerë tek All'llahu i Lartësuar.

Këto janë cilësitë që hipokritët kanë në çdo kohë, në çdo shoqëri.

Me anë të këtij përshkrimi të detajuar që ka bërë Kur'ani, kushdo mund t'i njohë ata, mund të njihet se kush i shoqëron ata në mendim dhe sjellje. Sa shumë shohim ne sot si puna e këtyre!

Ajeti 20 mishëron frikën dhe tmerrin e këtij grupi: **"Ata mendonin se ende nuk kishte ikur ushtria e aleatëve..."**.

Nga frika dhe tmerri i madh, ata imagjinonin makthe të frikshme, sikur ushtarët e mosbesimit kalonin gjithmonë para syve të tyre dhe u drejtonin shpatat dhe heshtat drejt tyre.

Këta luftëtarë frikacakë dhe hipokritë, me zemër dhe fuqi të dobët, kanë frikë edhe nga hija e tyre. Mbyllen në vetvete nga frika, sapo dëgjojnë hingëllimën e kalit dhe pëllitjen e buallit, duke menduar se ushtritë e grupacioneve aleate u kthyen përsëri.

Ajeti shton: **"Nëse do vinte ushtria e aleatëve, ata do të dëshironin të ishin në mesin e arabëve të shkretëtirës..."**, domethënë, të shpërndarë në shkretëtirë, mes arabëve beduinë, duke u fshehur mes tyre, duke ndjekur prej aty lajmet e tyre: **"e të pyesin për..."**.

Ata pyesin çdo udhëtar për lajmet e fundit, me qëllim që grupacionet aleate të mos jenë duke iu afruar atyre. Megjithatë, ata ju favorizonin juve, sepse ata i ndiqnin gjithmonë lajmet tuaja.

Fundi i ajetit është: **"Por edhe sikur të mbeteshin me ju, pak do të luftonin."**.

Prandaj mos u mërzisni dhe mos u shqetësoni për largimin e tyre. As mos u gëzoni për praninë e tyre në mesin tuaj, pasi ata janë njerëz që nuk kanë asnjë vlerë dhe asnjë cilësi që të lëvdohet dhe mungesa e tyre është më e mirë se prania e tyre.

Kjo punë me vlerë të vogël, gjithashtu, nuk ishte për All'llahun, përkundrazi ajo ishte si rezultat i frikës së sharjeve dhe qortimit të njerëzve, për t'u dukur dhe për dyfaqësi, sepse, sikur ajo të ishte për All'llahun, ata do të qëndronin dhe do të ishin të vendosur në fushëbetejë, për aq kohë sa tek ata pulsonte gjaku në vena.

Ajetet 21 - 25

لَّقَدۡ كَانَ لَكُمۡ فِي رَسُولِ ٱللَّهِ أُسۡوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرۡجُواْ ٱللَّهَ وَٱلۡيَوۡمَ
ٱلۡأٓخِرَ وَذَكَرَ ٱللَّهَ كَثِيرٗا ٢١ وَلَمَّا رَءَا ٱلۡمُؤۡمِنُونَ ٱلۡأَحۡزَابَ قَالُواْ هَٰذَا مَا
وَعَدَنَا ٱللَّهُ وَرَسُولُهُۥ وَصَدَقَ ٱللَّهُ وَرَسُولُهُۥۚ وَمَا زَادَهُمۡ إِلَّآ إِيمَٰنٗا وَتَسۡلِيمٗا
٢٢ مِّنَ ٱلۡمُؤۡمِنِينَ رِجَالٞ صَدَقُواْ مَا عَٰهَدُواْ ٱللَّهَ عَلَيۡهِۖ فَمِنۡهُم مَّن قَضَىٰ
نَحۡبَهُۥ وَمِنۡهُم مَّن يَنتَظِرُۖ وَمَا بَدَّلُواْ تَبۡدِيلٗا ٢٣ لِّيَجۡزِيَ ٱللَّهُ ٱلصَّٰدِقِينَ
بِصِدۡقِهِمۡ وَيُعَذِّبَ ٱلۡمُنَٰفِقِينَ إِن شَآءَ أَوۡ يَتُوبَ عَلَيۡهِمۡۚ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ
غَفُورٗا رَّحِيمٗا ٢٤ وَرَدَّ ٱللَّهُ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ بِغَيۡظِهِمۡ لَمۡ يَنَالُواْ خَيۡرٗاۚ وَكَفَى
ٱللَّهُ ٱلۡمُؤۡمِنِينَ ٱلۡقِتَالَۚ وَكَانَ ٱللَّهُ قَوِيًّا عَزِيزٗا ٢٥

"Në të Dërguarin e All'llahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek All'llahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë All'llahun."

"Kur besimtarët e vërtetë panë ushtrinë e aleatëve, thanë: 'Kjo është ajo që na ka premtuar All'llahu dhe i Dërguari i Tij;

sigurisht, premtimi i tyre u vërtetua!' Kjo ua forcoi atyre besimin dhe përuljen."

"Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me All'llahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre."

"Nuk ka dyshim se All'llahu do t'i shpërblejë të sinqertët për sinqeritetin e tyre e do t'i dënojë hipokritët, nëse do ose do t'u pranojë pendimin. Vërtet, All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."

"All'llahu i zmbrapsi jobesimtarët me hidhërimin e tyre dhe ata dolën duarbosh. Ai i kurseu besimtarët nga lufta. Vërtet, All'llahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm."

Komentimi

Roli i besimtarëve të sinqertë në luftën e grupacioneve *(Ahzabëve)*

Deri tani vazhdon fjala për grupet e ndryshme, planet dhe rolet e tyre në luftën e grupacioneve (ahzabëve). Na parapriu fjala për ata që kishin besim të dobët, për hipokritët dhe për kokat e mohimit dhe të hipokrizisë, për penguesit e xhihadit, luftës së shenjtë.

Kur'ani Famëlartë, në fund të udhëtimit, flet për besimtarët e vërtetë dhe nivelin e lartë shpirtëror të tyre, për burrërinë, për vendosmërinë e tyre, si dhe për të gjitha veçoritë e tyre në luftën e madhe.

Paraqitja e këtij diskutimi nis duke folur për Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i cili ishte prijësi dhe shembulli i tyre: **"Në të Dërguarin e All'llahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek All'llahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë All'llahun."**.

Profeti Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është shembulli më i mirë për ju, jo vetëm në këtë aspekt, por në të gjitha aspektet e jetës, pasi secili tipar: durimi i tij, qëndrimi i tij në rrugë të drejtë dhe vendosmëria e tij, zgjuarsia dhe njohuria e tij, sinqeriteti i tij dhe drejtimi i tij kah All'llahut, autoriteti dhe kontrolli i tij ndaj ngjarjeve, mosdorëzimi dhe mospërkulja e tij para vështirësive dhe problemeve, është një model që duhet ta imitojnë, ta ndjekin të gjithë myslimanët.

Ky komandant i madh nuk ia lejon vetes dobësinë dhe nxitimin, si një rrugë kur shtrëngatat më të fuqishme e rrethojnë anijen e tij dhe e godasin dallgët e forta, sepse ai është kapiteni i anijes dhe ankoruesi i saj i sigurt. Ai është llamba e udhëzimit, motivuesi i rehatisë, i qetësisë dhe i sigurisë shpirtërore për udhëtarët.

Ai e merr vetë në dorë kazmën, që të hapë kanalin, me pjesën tjetër të besimtarëve, e grumbullon dheun me shatë dhe e nxjerr atë me një enë që ka me vete. Bën shaka me shokët e tij për të ngritur lart moralin e tyre dhe për t'ua lehtësuar atyre

vështirësitë, zgjon dëshirën tek ata në recitimin e vjershave entuziaste, për të ndezur ndjenjat e tyre dhe për të forcuar zemrat e tyre. I nxit ata gjithmonë në përmendjen e All'llahut të Lartësuar, i përgëzon ata për të ardhmen brilante dhe për mposhtjet e mëdha.

I paralajmëron ata nga kurthet e hipokritëve dhe u jep atyre njohuri dhe përgatitjen e nevojshme.

Ai nuk është i pavëmendshëm asnjë çast në përgatitjen, armatimin e vërtetë të luftës dhe zgjedhjen e metodave më të mira ushtarake. Në të njëjtën kohë, nuk e ul vigjilencën nga zbulimi i mënyrave të ndryshme, të cilat nxisin përçarjen dhe krijojnë përplasje në radhët e armiqve.

Ai është shembulli më i lartë për t'u ndjekur dhe shembulli më i mirë për besimtarët jo vetëm në këtë fushëbetejë, por në të gjitha fushat.

Kuptimi i rrënjës së fjalës *"el usvetu"* është: Gjendja e vërtetë e njeriut në ndjekjen e një tjetri. Me një shprehje tjetër: Ai është konsolidimi dhe shembulli për t'u ndjekur. Në bazë të kësaj, ajo ka kuptimin e paskajores, jo të cilësisë.

Kuptimi i fjalisë: **"Në të Dërguarin e All'llahut ka një shembull të mrekullueshëm"** është: Ju, te Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* keni shembull të mirë, pasi ju mund ta ndiqni atë, të merrni shembullin e tij, të rregulloni çështjet tuaja dhe të ecni në rrugën e drejtë.

E veçanta është se Kur'ani e konsideron këtë shembull të mirë, për atë që ka tri cilësi të veçanta: besimin në Zot, besimin në Ditën e Kiametit dhe e përmendin shumë All'llahun.

Besimi në zanafillën dhe në Ditën e Kiametit është shkaku dhe nxitësi i kësaj lëvizjeje. Përmendja e All'llahut punon në vazhdimësinë e tij. Nuk ka dyshim se kujt nuk i është mbushur zemra me kaq besim, nuk mund ta vendosë këmbën e tij në vendin e këmbës së Profetit Muhammed *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Nëse nuk e vazhdon gjithmonë përmendjen e All'llahut dhe e gjallëron zemrën e tij me të, gjatë vazhdimit në këtë rrugë dhe t'i largojë shejtanët prej vetes, atëherë nuk do të jetë i aftë të vazhdojë gjithmonë ndjekjen e shembullit.

Meriton të tregohet një transmetim nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Kur shtohej e keqja, kishim frikën e Profetit Muhammed (Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), pasi nuk kishte njeri më afër armikut.*".[1]

Pas përmendjes së kësaj parathënie, ajeti që vjen më pas, qartëson gjendjen e besimtarëve të vërtetë: **"Kur besimtarët e vërtetë panë ushtrinë e aleatëve, thanë: 'Kjo është ajo që na ka premtuar All'llahu dhe i Dërguari i Tij; sigurisht, premtimi i tyre u vërtetua!' Kjo ua forcoi atyre besimin dhe përuljen."**.

Mirëpo çfarë premtimi ishte ky që All'llahu dhe i Dërguari i Tij ua kishin premtuar atyre?

Disa kanë thënë se tregon fjalën që e kishte folur më parë i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe*

1"Nehxhul Belaga", Fjalët e urta, Pjesa "Çuditë", Fjalia 9.

mbi familjen e tij!), që fiset arabe dhe armiqtë e tyre të ndryshëm do të bashkohen kundër jush dhe do të vijnë tek ju. Ata duhet ta dinë mirë se aleati i tyre, në fund, do të jetë fitorja, triumfi. Sapo besimtarët e panë sulmin e aleatëve, u bindën plotësisht se kjo është ajo që ua kishte premtuar atyre i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe thanë se, përderisa pjesa e parë e premtimit u vërtetua, atëherë është e padiskutueshme se pjesa e dytë, domethënë fitorja, do të vërtetohet pas saj. Për këtë u shtua besimi dhe mbështetja e tyre.

Një pjesë tjetër ka thënë se ky premtim është ajo që ka përmendur All'llahu i Madhëruar në ajetin 214 të sures "El Bekare": **"Vërtet mendoni të hyni në Xhennet, pa provuar atë që kanë provuar të tjerët para jush? Ata i goditi mjerimi dhe sëmundjet dhe, aq shumë u tronditën, saqë çdo i Dërguar dhe ndjekësit e tij, thirrën: 'Kur do të arrijë ndihma e All'llahut?' Ja, ndihma e All'llahut është afër."**.

Atyre u ishte thënë se do të sprovoheshin me një sprove të vështirë. Sapo panë aleatët, u vërtetua sinqeriteti i lajmërimit të All'llahut dhe të Dërguarit të Tij dhe u shtua besimi dhe mbështetja e tyre.

Sigurisht se këto dy komentime nuk kundërshtohen, sidomos duke vënë re se njëri nga dy premtimet, në thelb, ishte premtim i All'llahut, kurse tjetri premtim i të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Të dyja kanë ardhur së bashku në ajetin që po komentojmë. Duket se bashkimi mes tyre është i përshtatshëm plotësisht.

Ajeti tjetër tregon për një grup të veçantë besimtarësh. Ata ishin shumë të lidhur me Profetin Muhammed *(Paqja dhe bekimi i*

All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe qëndruan me vendosmëri në premtimin e tyre, besën që ia kishin dhënë All'llahut, sakrifica në rrugën e fesë së Tij, deri në frymën e fundit dhe deri në pikën e fundit të gjakut: **"Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me All'llahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre."**.

Ata nuk devijuan as edhe një grimcë nga vija e tyre, nuk kursyen asnjë mundim në rrugë të All'llahut, nuk u tronditën për asnjë çast. E kundërta me hipokritët dhe me ata me besim të dobët, të cilët furtuna e ngjarjeve i përmbysi këtu dhe atje dhe nxori në pah vështirësitë në mendjet e tyre boshe në mendime. Besimtarët qëndruan si mal i lartë dhe vërtetuan se besa që ata kishin dhënë, nuk e pranon prishjen apo kthimin pas.

Fjala *"nahbun"* është sinonim i fjalës *"ahdun"*, që do të thotë *"besë", "dhënie fjale", "premtim"*. Ndonjëherë është përmendur me kuptimin *"vdekje"*, ose *"rrezik"*, ose *"ecje e nxituar"*, ose *"qarje me zë të lartë"*.[1]

Mes komentuesve të Kur'anit ka mosmarrëveshje për kuptimin e këtij ajeti.

Dijetari i njohur i Ehli Synetit, Hakim Ebu Kasim Haskaniju, transmeton një thënie me zinxhir transmetimi nga Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili ka thënë: *"Për ne ka zbritur ajeti* : **"që e kemi mbajtur besëlidhjen me All'llahun."**. *Unë, për*

1 "Mufredatu" Rragib, tefsiri "Mexhmaul Bejan" dhe "Lisanul Arab", Lënda "Nehabe".

Zotin, po pres dhe nuk kam ndryshuar kurrë, pasi prej nesh pati burra që ranë më parë dëshmorë, si Hamzai, kryetari i dëshmorëve.".[1]

Disa të tjerë kanë thënë se fjalia: **"Disa prej tyre kanë vdekur",** u dedikohet dëshmorëve të Bedrit dhe Uhudit. Fjalia: **"të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre."**, flet për besimtarët e tjerë, të sinqertë, të cilët ishin në pritje të njërës prej dy të mirave: triumfit, ose të jepnin jetën.

Nga Enes ibn Maliku transmetohet se xhaxhai i tij, Enes ibn Nadri, nuk ishte i pranishëm në Betejën e Bedrit. Kur e mori vesh më pas dhe lufta kishte përfunduar, i erdhi keq që kishte munguar në luftë dhe i dha besën All'llahut, që do të merrte pjesë në luftë, nëse do të kishte një betejë tjetër dhe do të qëndronte në të, edhe sikur të ishte duke vdekur. Ai mori pjesë në Betejën e Uhudit. Kur një grup u largua nga fusha e betejës, ai nuk u largua me ta dhe qëndroi, rezistoi derisa u plagos dhe ra dëshmor.[2]

Ibn Abasi ka thënë: "Fjalia: **'E kanë mbajtur besëlidhjen me All'llahun.',** i dedikohet Hamzait, i biri i Abdul Mutalibit dhe pjesës tjetër të shehidëve të Uhudit dhe Enes ibn Nadrit dhe shokëve të tij.".[3]

Nuk ka asnjë kundërshtim mes këtyre komentimeve, sepse ajeti ka një nocion të gjerë, që përfshin të gjithë dëshmorët e Islamit, të cilët u martirizuan para betejës së grupacioneve dhe të

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 350, fundi i ajetit është burimi i komentimit.
2 Këto transmetime i kanë përmendur me një ndryshim të lehtë autorët e tefsireve të Kurtubijut, te vepra "Fi Dhilalil Kur'ani" dhe "Mexhmaul Bejan".
3 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 350, fundi i ajetit është burimi i komentimit.

gjithë atyre që ishin në pritje për fitoren apo martirizimin. Mbi kokat e tyre kishte burra, si Hamzai, i pari i dëshmorëve dhe Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Në tefsirin "Es Safij" flitet, se secili nga shokët e Hysejnit në Kerbela, që dëshironte të luftonte krah për krah me Hysejnin *(Paqja qoftë mbi të!)*, i thoshte atij: "Paqja qoftë mbi ty, o djali i të Dërguarit të All'llahut!". Ai i përgjigjej: "Paqja qoftë edhe mbi ty! Edhe ne jemi pas teje." Më pas lexoi ajetin: **"Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me All'llahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre."**.[1]

Në librat e jetëshkrimit të Imam Hysejnit *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet se Imam Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)* e lexoi këtë ajet te trupat e dëshmorëve të tjerë, si Muslim ibn Ausexhe dhe kur i erdhi lajmi i martirizimit të Abdullah ibn Jaktarit.[2]

Nga këtu bëhet e qartë se për ajetin ka një nocion të gjerë, që përfshin të gjithë besimtarët e vërtetë, të sinqertë të çdo kohe, njësoj si ai që veshi rrobën e martirizimit në rrugë të All'llahut, si ai që qëndroi dhe e mbajti fjalën me Zotin e tij dhe nuk u drodh, por ishte i gatshëm për luftë dhe për të rënë dëshmor.

Ajeti që vjen më pas, e bën të qartë rezultatin përfundimtar të veprave të besimtarëve dhe të hipokritëve: **"Nuk ka dyshim se All'llahu do t'i shpërblejë të sinqertët për sinqeritetin e tyre e do t'i dënojë hipokritët."**.

1 Tefsiri "Es Safij", fundi i ajetit është burimi i komentimit.
2 Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 259.

Nuk mbetet sinqeritet, pastërti dhe premtim i besimtarëve pa u shpërblyer dhe as dobësi dhe pengesë e hipokritëve pa u ndëshkuar.

E megjithatë, me qëllim që të mos u mbyllej në fytyrë rruga e kthimit dhe e strehimit tek All'llahu këtyre hipokritëve kokëfortë, All'llahu i Madhëruar i ka hapur dyert e pendimit para tyre: **"Nëse do, ose do t'u pranojë pendimin."**, nëse pendohen. All'llahu i Madhëruar e përshkroi veten e Tij shumë Falës dhe Mëshirues: **"All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**, me qëllim që të ringjallë tek ata lëvizjen drejt besimit, sinqeritetit, pastërtisë dhe mbajtjes së fjalës me obligimet e tyre para All'llahut dhe veprimit me atë që kërkohet.

Përderisa kjo fjali është përmendur si rezultat i veprave të shëmtuara të hipokritëve, disa komentues të mëdhenj, duke u bazuar në të, mendojnë se gjynahu i madh në zemra që kanë prirjen e udhëzimit mbase ka qenë një nxitje e lëvizjes së kundërt dhe e rikthimit drejt të drejtës dhe të vërtetës dhe e keqja mund të jetë një çelës i mirësisë dhe i udhëzimit.[1]

Ajeti 25, që flet për luftën e aleatëve dhe e mbyll këtë diskutim, bën një përmbledhje të qartë për këtë ngjarje: **"All'llahu i zmbrapsi jobesimtarët me hidhërimin e tyre dhe ata dolën duarbosh."**.

Fjala *"el gajdhu"* do të thotë *"inat, mllef"*. Ndonjëherë vjen me kuptimin e dëshpërimit. Në këtë ajet janë bashkuar të dy kuptimet, pasi ushtritë e aleatëve shpenzuan të gjitha energjitë e tyre për të triumfuar ndaj ushtrisë islame, mirëpo ata dështuan

1 Tefsiri "El Mijzan", fundi i ajetit është burimi i komentimit.

dhe ushtarët e mohimit u rikthyen në vendet e tyre gjithë mllef dhe dëshpërim.

Ajo që kuptohet nga fjala *"el khajru"* është triumfi në luftë. Ushtria e mohimit nuk arriti kurrë asnjë të mirë, përkundrazi ajo është e keqe. Kur Kur'ani fliste për pikëpamjen e tyre mendore, e shprehu atë me të mirë. Kjo tregon se ata nuk morën asnjë fitore në këtë aspekt.

Disa kanë thënë se kuptimi i fjalës *"el khajru"* këtu është *"pasuria"*, sepse kjo fjalë është përdorur në vende të tjera me këtë kuptim. Një prej tyre është ajeti i testamentit, ajeti 180 i sures "El Bekare": **"Ju është urdhëruar që, nëse ndonjërit prej jush i afrohet vdekja dhe ka pasuri për të lënë pas, atëherë të lërë testamentin në mënyrë të drejtë për prindërit dhe farefisin; ky është detyrim për besimtarët e devotshëm."**.

Edhe pse një nga synimet kryesore të ushtrisë së mohimit ishte përfitimi i plaçkave të luftës së Medines dhe invazioni mbi këto toka, ne nuk kemi argumentin e kufizimit të fjalës *"el khajru"* me kuptimin e pasurisë, përkundrazi ajo fjalë përfshin të gjitha triumfet që ata dëshironin dhe pasuria ishte njëra prej tyre, mirëpo ata u privuan nga të gjitha.

Fjalia: **"Ai i kurseu besimtarët nga lufta."**, tregon: All'llahu përgatiti faktorë, që lufta të përfundonte pa pasur nevojë për koherencë të gjerë mes dy ushtrive, sepse ciklonet e forta shkatërruese i copëtuan pozicionet e idhujtarëve nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, All'llahu hodhi frikën dhe tmerrin në zemrat e tyre me ushtarët e All'llahut që nuk shiheshin.

Një anë e tretë, është edhe goditja që i dha Ali ibn Ebu Talibi luftëtarit më të madh të tyre, Amër ibn Abdu Vudit. Kjo vrasje bëri që ëndrrat dhe shpresat e tyre të shkojnë dëm. I nxiti ata që të mblidhnin mjetet e tyre, të linin rrethimin e Medines dhe të ktheheshin te fiset e tyre, duke i paraprirë shpartallimit dhe dështimit.

Fjalia e fundit e ajetit thotë: **"All'llahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm."**.

Ka shumë njerëz të fuqishëm, mirëpo ata nuk janë ngadhënjyes që nuk mposhten, madje ka nga ata që mposhtin ata që janë më të fuqishëm prej tyre. I Fortë, Ngadhënjyes, në botë është vetëm All'llahu. Forca dhe fuqia e Tij nuk ka kufi dhe as mbarim, pasi All'llahu zbriti ndihmën mbi besimtarët në një situatë të vështirë dhe shumë të rrezikshme, ku ata as nuk patën nevojë të dilnin në dyluftim dhe të bënin sakrifica.

Hulumtime

1- Shënime të rëndësishme për betejën e Ahzabëve

a) Beteja e Ahzabëve, siç është e njohur prej emrit të saj, ishte një luftë ku u bashkuan të gjitha fiset dhe grupet e ndryshme që kishin armik Islamin, me synimin për ta shuar Islamin.

"Lufta e Ahzabëve ishte përpjekja e fundit e mosbesimit, shigjeta e fundit në kukurë (çantë shigjetash) dhe manifestimi i fundit i forcave të idhujtarisë. Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"I tërë besimi u përball me të tërë idhujtarinë."*.[1]

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, u përball me një nga trimat më të mëdhenj të armikut, Amër ibn Abdu Vudin.

Triumfi i njërit do të thoshte triumfi i mosbesimit ndaj besimit apo i besimit ndaj mosbesimit. Me një mënyrë tjetër të shprehuri: ishte një punë kritike, që përcaktonte të ardhmen e Islamit dhe të idhujtarisë. Idhujtarët nuk ngritën krye pas mposhtjes së tyre në këtë përballje gjigante dhe pas saj, fuqia qeverisëse ishte gjithmonë në dorën e myslimanëve.

U shua ylli i armiqve dhe u shkatërruan shtyllat e fuqisë së tyre. Në një hadith lexojmë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, pas përfundimit të betejës së aleatëve, ka thënë: *"Tani jemi ne që i luftojmë ata dhe ata nuk na luftojnë dot neve."*.[2]

b) Ndryshimi në numër dhe në mjete luftarake

Disa historianë kanë përmendur se numri i individëve të ushtrive të mosbesimit ishte më shumë se dhjetëmijë luftëtarë. Makrizi, te vepra "El Imtau", thotë: "Kurejshët erdhën me

1 "Biharul Anuar", vëll. 20, f. 215. Ky hadith është transmetuar nga Kiraxhkij.
2 "Et Tarijkhul Kamil" e Ibn Ethirit, vëll. 2, f. 184

katërmijë burra, njëmijë e treqind kuaj, njëmijë e pesëqind deve dhe zbritën te bregu i kanalit. Fisi Beni Selim erdhi me shtatëqind burra dhe u takuan me të tjerët në rrugën e kalimit. Beni Fezaretu erdhi me njëmijë ushtarë. Beni Ezhxhau dhe Beni Murre erdhën me katërqind vetë. Fiset e tjera dërguan një numër burrash. Numri përfundimtar ishte dhjetëmijë burra.

Numri i myslimanëve nuk i kalonte tremijë veta. Kampingun e tyre kryesor e kishin bërë poshtë, në rrëzë të malit të Silit. Ishte një pikë e lartë në anë të kanalit të Medines fisnike. Nëpërmjet harkëtarëve ata mund të kontrollonin lëvizjen e kalimit nga kanali.

Ushtria e jobesimtarëve i kishte rrethuar myslimanët nga të gjitha anët. Ky rrethim zgjati njëzet ditë. Është thënë edhe njëzet e pesë ditë, kurse në disa transmetime, një muaj.[1]

Edhe pse armiku kishte epërsi ndaj myslimanëve, në drejtime të ndryshme, në fund dështoi, siç e kemi thënë dhe u kthye në shtëpi duarbosh.

c) Mënyra e hapjes së kanalit të Hendekut

Çështja e hapjes së kanalit, siç e dimë, u bë me këshillën e Selman Farisijut. Kjo çështje ishte një metodë mbrojtëse e zakonshme në vendet e Persisë në atë kohë dhe nuk ishte e njohur në Gadishullin Arabik. Kjo gjë konsiderohej një dukuri e re edhe për skajet e Medines. Hapja e këtij kanali kishte një rëndësi të

1 "Biharul Anuar", vëll. 20, f. 228.

madhe, si nga ana ushtarake, ashtu edhe nga ana e dobësimit të moralit të armikut dhe ngritjes së moralit të myslimanëve.

Ne nuk kemi informacione të hollësishme për cilësinë e kanalit dhe hollësitë e tij, por historianët kanë thënë se gjerësia e tij ishte aq sa kuajt e armikut nuk mund ta kalonin me galop. Thellësia e tij ishte aq, sa nëse dikush binte brenda, nuk mund të dilte me lehtësi nga ana tjetër.

Duke shtuar se kontrolli i harkëtarëve myslimanë mbi zonën e kanalit u mundësonte atyre se kush përpiqej të kalonte, bëhej shënjestër i shigjetave të tyre, mes kanalit dhe para kalimit të tij.

Gjatësinë e këtij kanali, disa e kanë vlerësuar se ishte dymbëdhjetëmijë pash (gjashtë mijë metra), duke u mbështetur në tregimin e njohur për hapjen e kanalit. Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte urdhëruar që të gërmohej çdo dhjetë burra, dyzetë pashë. Dimë se numri i ushtarëve të myslimanëve, sipas asaj që dihet, i pati kaluar tremijë burra.

Është e nevojshme të dimë se hapja e një kanali të tillë dhe me mjete primitive të përdorura në atë ditë, ishte dërrmuese, e lodhshme. Myslimanët kishin vështirësi të mëdha dhe nevojë urgjente për përforcime, dhe mjete të tjera.

Është e padiskutueshme se hapja e kanalit zgjati për një kohë të gjatë. Kjo tregon se ushtria myslimane e kishte vlerësuar dhe e kishte llogaritur, kishte pritshmërinë e duhur me një saktësi të plotë, para se armiku të sulmonte, saqë hapja e kanalit u bë tre ditë para se të arrinte ushtria e jobesimtarëve.

ç) Sheshi i madh i sprovës

Beteja e Ahzabëve ishte një gur prove dhe një sprovim i çuditshëm, jo vetëm për të gjithë myslimanët, por edhe për këdo që pohonte Islamin, si dhe për ata që ndonjëherë pohonin neutralitetin, se kishin në brendësi një lidhje dhe një marrëveshje me armiqtë e Islamit dhe bashkëpunonin me ta kundër fesë së All'llahut.

Pozicioni i të tri grupeve: i besimtarëve të sinqertë, i atyre me besim të dobët dhe i hipokritëve, u sqarua plotësisht nëpërmjet veprës së tyre. U qartësuan plotësisht vlerat dhe nocionet islame, pasi secili prej këtyre tri grupeve reflektoi në luftën e ndezur, besimin e tyre të mirë ose shëmtinë e tij, sinqeritetin e nijeteve të tyre apo mungesën e tij.

Furtuna e fuqishme nuk la gjë për asnjë njeri, që të fshehë atë çfarë ka në zemrën e tij. Në më pak se një muaj dolën në pah shumë çështje, ku zbulimi i tyre kishte nevojë për vite, që mbase, në kushte normale, janë të gjata.

Këtu ka një çështje që meriton të shikohet me kujdes. Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vërtetoi praktikisht besimin e tij të plotë me atë që u dërgua, transmetimin e mësimeve hyjnore. Këtë e bëri në çdo mënyrë, nëpërmjet rezistencës së tij, vendosmërisë së tij, gjakftohtësisë së tij dhe mbështetjes te All'llahu e mbështetjes te vetja. Po kështu, ua vërtetoi njerëzve se ai i zbaton para të tjerëve ato që ai i urdhëron të bëjnë, nëpërmjet ngushëllimit të tij ndaj myslimanëve dhe ndihmës së tij në hapjen e kanalit, mbështetjes në vështirësitë e luftës.

d) Dueli historik i Imam Aliut me Amër ibn Abdu Vudin

Prej situatave të ndjeshme historike të kësaj lufte është dyluftimi i Imam Aliut me heroin, kampionin e madh të ushtrisë armike, Amër ibn Abdu Vudin. Thuhet se ushtria e Ahzabëve kishte ftuar arabët e fortë guximtarë për të dhënë kontributin në këtë luftë. Më të famshmit mes tyre ishin pesë: Amër ibn Abdu Vudi, Akreme ibn Ebu Xhehli, Hubejre, Nufeli dhe Darari.

Në një nga ditët e luftës, këta u përgatitën për një duel të vetëm. Veshën veshjet e luftës, u përpoqën të çanin kanalin dhe të kalonin me kuajt e tyre në krahun tjetër, nëpërmjet një pike të ngushtë në të, që ishte larg shënjestrës së harkëtarëve myslimanë dhe të qëndronin para ushtrisë myslimane. Më i njohuri ndër ta ishte Amër ibn Abdu Vudi.

Ai bëri përpara. I kishte hipur krenaria dhe mendjemadhësia. Ai kishte një përvojë të gjatë në luftë dhe ngriti zërin e tij, duke kërkuar se kush do ta sfidonte atë në duel.

Thirrja e tij: "A ka ndonjë sfidues?", kumboi në sheshin e luftës së Ahzabëve dhe, kur nuk po dilte askush nga myslimanët, që ta luftonte atë, mburrja e tij u shtua edhe më shumë. Filloi të tallej me parimet, bindjet e myslimanëve dhe tha: "Ku është Xhenneti juaj, që e pohoni se, kush vritet prej jush, hyn në të? A ka ndonjë në mesin tuaj që ta dërgoj në Xhennet apo të më çojë mua në zjarr?".

Këtu lexoi poezinë e tij të njohur:

"U ngjira duke thirrur në mesin tuaj: 'A ka ndonjë sfidues, duelist?'

Qëndrova në vendin e heroit luftëtar, si u frikësua kurajozi.

Vërtet, falja dhe guximi është instinkti më i mirë te djali.".

Në atë çast, Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi që t'i dalë një burrë dhe ta largojë të keqen e tij nga myslimanët. Nuk iu përgjigj askush Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përveç Ali ibn Ebu Talibit.

Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "Ai është Omeri.".

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Edhe në qoftë Omeri.".

Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u lut dhe e publikoi atë. E ngjeshi shpatën e tij të veçantë, pastaj bëri një lutje për të: "O All'llah, mbroje atë nga përpara tij dhe prapa tij, nga e majta dhe e djathta e tij, nga sipër tij dhe poshtë tij.".

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* eci drejt sheshit të betejës, duke thënë:

"Mos u nxito, sepse po t'i përgjigjet zërit tënd jo një njeri i dobët,

që ka një vendosmëri, shikim dhe sinqeritet që ia kalon çdo fitimtari.

Uroj të të çoj në anën e të vdekurve,

nga goditja e habitur, që zëri i saj mbetet pas dridhjes.".

Këtu Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha fjalën e tij të njohur: *"I tërë besimi u përball me të tërë idhujtarinë."*.[1]

Kur u takuan, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, në fillim e ftoi atë në Islam, por ai refuzoi. Pastaj e ftoi atë që ta braktisë luftën, e refuzoi edhe atë dhe e konsideroi atë turp, fyerje për të. Herën e tretë e ftoi atë që të zbriste nga shpina e kafshës së tij dhe të luftonin në këmbë. Amri u inatos dhe tha: "Nuk e kam falur asnjë arab, që ma ka bërë mua këtë ftesë.".

Zbriti nga shpina e kalit të tij dhe e goditi Imam Aliun në kokë. Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* e priti atë me një mjeshtri të veçantë me mburojën e tij. Shpata e gërvishti dhe i çau kokën Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Këtu Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)* përdori një metodë të veçantë dhe i tha Amrit: "Ti je kampioni i arabëve dhe unë të luftoj ty. Kë ke marrë pas vetes tënde?" Sapo ktheu kokën Amri, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* e goditi me shpatë në këmbë. Amri ra në tokë dhe bëri pluhur aty ku ra. Hipokritët menduan se Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* u vra me shpatën e Amrit. Kur ata dëgjuan tekbiret (All'llahu Ekber) që u shtuan, mësuan për fitoren e Imam Aliut. Papritur panë Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)* duke u kthyer te ushtria e tij. Gjaku pikonte nga koka e tij. Në buzët e tij kishte buzëqeshjen e fitores. Kufoma e Amrit kishte rënë në një anë të sheshit.

1 "Biharul Anuar", vëll. 20, f. 203; Ibn Ebi Hadid, "Sherhu Nehxhul Belaga", vëll. 4, f. 344, sipas transmetimit "Ihkakul Hakk", vëll. 6, f. 9.

Vrasja e kampionit të njohur arab i dha një goditje të fortë ushtrisë së aleatëve, i zhduku shpresat dhe shkatërroi moralin e tyre. Mposhtja e tyre ishte një mposhtje e urryer. U shuan shpresat e tyre për fitore dhe triumf. Për këtë ngjarje, i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Sikur sot të peshohej vepra jote me veprat e gjithë ymetit të Muhammedit, vepra jote do të favorizohej mbi veprat e tyre, sepse nuk ka mbetur shtëpi idhujtarësh, që nuk është poshtëruar me vrasjen e Amrit dhe nuk ka mbetur shtëpi myslimanësh, që nuk është madhështuar me vrasjen e Amrit.*".[1]

Dijetari i njohur syni, Hakim Nisaburiju, e ka përmendur këtë fjalë, por me një shprehje tjetër: "*Dueli i Ali ibn Ebu Talibit ndaj Amër ibn Abdu Vudit, Ditën e Hendekut është nga veprat më të mira të ymetit tim, deri në Ditën e Kiametit.*".[2]

Qëllimi i kësaj fjale është i qartë, sepse në atë kohë Islami dhe Kur'ani ka qenë në buzë të greminës dhe myslimanët po kalonin çastet më kritike dhe më të vështira të tyre, prandaj sakrifica në këtë luftë ishte nga sakrificat më të mëdha, pas sakrificave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai e ruajti Islamin nga rënia, e mbrojti nga rreziku dhe siguroi qëndrimin e tij deri në Ditën e Kiametit. Islami u rrënjos dhe u bë fakt i kryer me begatinë e sakrificës së Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*. Degët dhe gjethet e Islamit përfshinë botët. Në bazë të kësaj, adhurimi i të gjithëve është ruajtur me punën e tij.

1 "Biharul Anuar", vëll. 20, f. 216.
2 "Mustedrekul Hakim", vëll. 3, f. 32.

Një pjesë kanë përmendur se idhujtarët dërguan njërin prej tyre, që të blinte kufomën e Amrit me dhjetëmijë derhemë. Ata mendonin se myslimanët do të vepronin me kufomën e Amrit ashtu siç vepruan ata, me zemër të ashpër, me trupin e Hamzait, ditën e Uhudit. Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*Ai është juaji. Ne nuk e hamë pasurinë e të vdekurve.*".

Këtu ka një qëndrim që meriton të përmendet: Motra e Amrit, sapo mbërriti te trupi i të vëllait të saj dhe pa se Imam Aliu *(Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)* nuk e kishte zhveshur mburojën e tij të shtrenjtë, tha: "*Nuk e ka vrarë atë vetëm se një kopetent bujar.*".[1]

dh) Procedurat ushtarake dhe politike të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* **në këtë luftë**

Triumfi i Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në betejën e aleatëve erdhi si pasojë e disa faktorëve dhe metodash ushtarake dhe politike. Gjithashtu, edhe faktori i bindjes dhe i besimit kontribuoi në triumfin e Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të myslimanëve, duke shtuar mbështetjen hyjnore nëpërmjet erërave dhe shtrëngatave të forta, të cilat i shkatërruan, i copëtuan shumë rëndë ushtritë e aleatëve. Po kështu, edhe ushtarët e padukshëm të All'llahut.

1 Në këtë krah u mbështetëm te librat: "Ihakul Hakk, vëll. 6; "Biharul Anuar", vëll. 20; Tefsiri "El Mijzan", vëll. 16; "Habijbu Sejri", vëll. 1; "Furugul Ebedijeh", vëll. 2.

Disa prej këtyre faktorëve dhe procedurave ishin:

1- Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* futi një metodë të re, duke pranuar propozimin e hapjes së hendekut, që nuk ishte i pranishëm dhe i njohur mes arabëve deri në atë ditë. Ky ishte një faktor i rëndësishëm në ngritjen e moralit të myslimanëve dhe thyerjen e fuqisë së jobesimtarëve.

2- Qëndrimet dhe llogaritë e sakta të myslimanëve, metodat dhe manovrat ushtarake ishin një faktor ndikues në mosdepërtimin e armikut në brendësi të Medines.

3- Vrasja e Amër ibn Abdu Vudit me dorën e heroit të madh të Islamit, Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe shuarja e shpresave të aleatëve me vrasjen e tij konsiderohet një faktor tjetër ndikues.

4- Besimi në Zot, mbështetja tek All'llahu, ajo që mbolli Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, leximi i Kur'anit dhe fjalët ndikuese të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ujitën zemrat e myslimanëve gjatë luftës.

5- Metoda e Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, shpirti i tij i madh dhe mbështetja te vetja e tij, u jep myslimanëve forcë dhe qetësi.

6- Duke shtuar, se puna e Neim ibn Mes'udit ishte një nga faktorët e rëndësishëm në krijimin e përçarjes mes ushtrive aleate.

f) Neim ibn Mes'udi dhe përçarja e ushtrisë së armikut

Neimi erdhi te Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ishte bërë mysliman, kurse fisi i tij Gatafan nuk dinte gjë për të. Neimi i tha Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Unë jam bërë mysliman. Populli im nuk e di këtë, prandaj më urdhëro çfarë të duash."*

Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha atij: *"Ti je vetëm një njeri në mesin tonë, prandaj na tradhto si të duash, pasi s'ka dyshim se lufta është mashtrim, hile."*.

Neimi u largua me një plan të shkëlqyer dhe erdhi te çifutët e Beni Kurejdhave. Ai kishte miqësi me ta, para se të bëhej mysliman. U tha atyre: *"Unë jam shoku juaj dhe ju e dini këtë."*.

Ata thanë: *"Të vërtetën the. Ne nuk të akuzojmë kurrë ty."*.

Ai tha: *"Ky është qyteti juaj dhe ju keni këtu pasuritë tuaja, fëmijët tuaj dhe gratë tuaja, kurse kurejshët dhe gatafanët nuk e kanë vendin e tyre, por erdhën, deri sa u bashkuan me ju. Nëse e shohin rastin, përfitojnë prej saj dhe, nëse shohin diç tjetër, kthehen në vendet e tyre dhe e lënë bosh vendin mesh jush dhe burrit (Muhammedit). Ju nuk keni fuqi për këtë, prandaj mos luftoni, derisa të jeni të sigurt nga fisnikët tuaj, të saktësoni që të mos ju braktisin, derisa të ndeshin Muhammedin."*.

Ata thanë: *"Ti na dhe një mendim të mirë."*.

Beni Kurejdhat e pranuan fjalën e tij.

Pastaj Neimi shkoi fshehurazi te Ebu Sufjani dhe te fisnikët e kurejshëve dhe u tha: *"O paria e kurejshëve, ju e dini dashurinë time për ju dhe ndarjen time me Muhammedin dhe fenë e tij. Unë po vij te ju me një këshillë, prandaj më dëgjoni mua."*.

Ata thanë: *"Po të dëgjojmë."*.

Ai tha: *"Ju e dijeni se Beni Kurejdha është penduar për atë që ndodhi mes tyre dhe Muhammedit, prandaj, ata i shkruajtën atij: Vërtet, ti nuk je i kënaqur me ne vetëm nëse marrim peng nga populli e prej fisnikëve të tyre dhe të t'i japim ty e ti t'i vrasësh ata. E më pas ne do të jemi me ty kundër tyre, derisa t'i nxjerrim ata nga vendi yt."*.

Ata thanë: *"Posi jo, nëse dërgojnë njeri tek ju dhe ju kërkojnë njerëz prej burrave tuaj, atëherë mos u jepni asnjë burrë. Kini kujdes."*.

Pastaj shkoi te fisi i vet, Gatafan dhe tha: *"Ju e njihni mbështetjen time dhe prejardhjen time. Unë ju respektoj juve dhe nuk mendoj se ju dyshoni në sinqeritetin tim."*.

Ata thanë: *"E dimë këtë."*.

Ai tha: *"Kam për ju një lajm, prandaj mbajeni sekret dhe mos më zbuloni mua."*.

Ata thanë: *"Po të dëgjojmë."*.

U tha atyre ato çfarë u tha kurejshëve. Kjo ndodhi natën e të shtunës së muajit Sheval, vitin e pestë të Hixhrit.

Ebu Sufjani dhe prijësit e Gatafanit dërguan një grup te Beni Kurejdhat dhe thanë: *"Këmbët dhe shputat na u prishën dhe ne nuk kemi vend ku të qëndrojmë, prandaj shkoni te Muhammedi, derisa ta luftojmë atë."*.

Çifutët iu përgjigjën atyre: "*Nesër është e shtunë dhe ajo është një ditë ku ne nuk punojmë dhe ne nuk mund të luftojmë me ju, derisa të na jepni një garanci prej burrave tuaj, që të sigurohemi, që ju nuk ikni dhe na lini neve, ndërkohë që luftojmë Muhammedin.*".

Kur e morën këtë mesazh kurejshët dhe gatafanët, thanë: "*Për Zotin, Neimi na paralajmëroi për këtë.*".

Ebu Sufjani i dërgoi lajm: "*Ne nuk ju japim juve as edhe një njeri. Nëse doni, dilni dhe luftoni e, nëse doni, rrini.*".

Sapo çifutët mësuan për këtë, thanë: "*Për Zotin, këtë gjë na tha edhe Neimi. S'ka dyshim se ka hile në këtë çështje. Këta nuk duan të luftojnë, duan të mashtrojnë e të kthehen në shtëpitë e tyre dhe t'ju lënë juve dhe Muhammedin.*".

Dërguan mesazh te kurejshët dhe te gatafanët: "*Ne jemi të vendosur, për Zotin, që të mos luftojmë, derisa të na jepni garanci.*".

Kurejshët dhe gatafanët ngulën këmbë në fjalën e tyre. U ndez konflikti mes tyre. All'llahu i Madhëruar dërgoi tek ata një erë të fortë e shumë të ftohtë, që i shkuli çadrat e tyre dhe i përmbysi forcat e tyre.

Ata mblodhën të gjitha sendet e tyre dhe pëlqyen të arratisen, në vend që të qëndronin. Nuk mbeti asnjë burrë në sheshin e luftës.[1]

1 "Sijretu e Ibn Hishamit", vëll. 3, f. 240, shkurtimisht.

f) Tregimi i Hudhejfes

Në pjesën më të madhe të historive, thuhet se Hudhejfe Jemani kishte thënë: "Për Zotin, kemi parë Ditën e Hendekut. Ne kishim lodhje, uri dhe frikë, aq sa nuk e di kush veç All'llahut. Në një natë prej netëve, pasi ndodhi konflikti mes ushtrive aleate, i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thotë: *'A ka ndonjë njeri, që të na sjellë lajm nga ata njerëz, që All'llahu ta bëjë atë shoqëruesin tim në Xhennet?'"*.

Hudhejfe thotë: "*Pasha All'llahun, asnjë nuk u çua prej nesh, nga frika dhe uria. Kur i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) e vuri re këtë gjë, më thirri mua. Thashë: 'Urdhëro.'"*.

Ai tha: "*Shko dhe na sill lajm prej tyre. Mos bëj asnjë gjë, derisa të kthehesh."*.

Shkova tek ai popull. Era e All'llahut dhe ushtarët e Tij, po bënin me ta atë që po bënin, duke mos u lënë atyre as ndërtesë, as zjarr dhe as edhe një enë që të rrinte në një vend. Ebu Sufjani doli nga çadra e tij e tha: "*O ju kurejshë, le të shikojë secili prej jush, kë ka afër tij, që të mos kemi këtu ndonjë të huaj."*.

Unë fillova me atë që kisha në të djathtë dhe thashë: "*Kush je ti?"*.

Ai tha: "*Unë jam filani."*.

Unë thashë: "Mirë.".

Pastaj Ebu Sufjani u kthye me kafshën e tij dhe tha: "*O ju kurejshë, për Zotin, ju nuk jeni të këtij vendi. U shkatërrua shputa e*

këmbës dhe thundra e kafshës. Beni Kurejdhat na tradhtuan. Kjo erë nuk na merr gjë neve.".

Pastaj nxitoi dhe i hipi kafshës së tij. Kafsha është e zgjuar, nuk e zgjidhi kapistrën e saj, vetëm pasi hipi mbi të Ebu Sufjani.

Thashë me vete: "*Sikur ta godas me shigjetë armikun e All'llahut dhe ta vras atë, do të duket sikur kam bërë diçka."*.

E bëra gati harkun, vendosa shigjetën në mes të harkut e, sapo isha gati ta lëshoja, kur kujtova fjalën e të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "*Mos bëj asnjë gjë, derisa të kthehesh."*.

Ai kërkoi prej meje që t'i vij me ndonjë lajm. E ula harkun. Pastaj u ktheva te i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i dhashë atij lajmin. I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: "*O All'llah, Ti je Ai që zbret Librin, Ti je i shpejtë në llogari, shkatërroi aleatët! O All'llah, shkatërroi dhe shkundi ata!"*.[1]

e) Rezultatet e luftës së Ahzabëve

Lufta e Ahzabëve ishte një pikë kthese në historinë islame, që përmbysi peshën e ekuilibrit ushtarak dhe politik në favor të myslimanëve, deri në pafundësi. Mund të bëhet përmbledhja e rezultateve produktive të kësaj beteje në disa pika:

1 "Biharul Anuar", vëll. 20, f. 209.

1- Përpjekjet e armikut dështuan dhe forcat e tyre u shkatërruan.

2- Zbulimi i hipokritëve dhe çjerrja e maskës armiqve të brendshëm, të rrezikshëm.

3- Ngushëllimi i dhimbshëm i përkujtimit të disfatës së Uhudit.

4- Forca e myslimanëve dhe tmerri në zemrat e armiqve.

5- Morali i myslimanëve u ngrit lart e, si rezultat i mrekullive të mëdha, të cilat i panë në këtë betejë.

6- Forcimi i pushtetit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* brenda dhe jashtë Medines.

7- Përgatitja e kushteve për pastrimin e Medines dhe shpëtimi i saj nga e keqja e Beni Kurejdhave.

2- Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është shembull për të gjithë

Ne e dimë se zgjedhja e Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në mesin e njerëzve u bë, që të jetë shembull praktik i popujve, sepse një nga anët më të rëndësishme të thirrjes së Profetëve dhe me më shumë ndikim, është thirrja praktike, të vepruarit vetë.

Për këtë, dijetarët e Islamit e kanë konsideruar ruajtjen, virtytin një kusht të pozitës së profecisë. Një nga faktet dhe

argumentet e saj është se ata duhet të jenë shembull për njerëzit dhe model për njerëzimin.

Duhet të shihet me kujdes, se ndjekja e shembullit të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, e përmendur në këtë ajet, është thënë në mënyrë absolute. Kjo përfshin ndjekjen e shembullit në të gjitha aspektet, pavarësisht se shkaku i zbritjes së këtyre ajeteve është beteja e aleatëve. Ne e dimë se shkaqet e zbritjes, nuk i kufizojnë në mënyrë kategorike nocionet e ajeteve, prandaj në hadithet profetike çështjet më të rëndësishme dhe më të lehta janë shtruar në çështjen e ndjekjes së shembullit.

Në një hadith, nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: "*Durimi në çështjen udhehëqësve është e obliguar nga fjala e All'llahut drejtuar të Dërguarit të Tij:* **'Prandaj, ti bëhu i durueshëm** (o Muhammed)**, ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të Dërguarit e vendosur.'**".[1] Përgjigjja e tij është njësoj si ajo ndaj miqve, mbrojtësve të tij dhe atyre që i bindeshin atij: **"Ju keni shembullin më të lartë në të Dërguarin e All'llahut."**.[2]

Në një hadith tjetër nga Imam Sadiku, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*I Dërguari i All'llahut, kur e fali namazin e fundit të darkës, urdhëroi për abdesin e tij dhe sivakun. Te koka e tij vendosi një kuti të vogël.*". Pastaj e sqaron mënyrën e namazit të natës të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në fund të hadithit

1 Sure "El Ahkaf", ajeti 35.

2 "Ihtixhaxh" i Tabasriut, sipas transmetimit "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 255.

thotë: **"Ju kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e All'llahut."**.[1]

Nëse gjatë jetës sonë nuk e marrim shembull Profetin Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: besimin dhe mbështetjen e tij tek All'llahu, sinqeritetin, pastërtinë dhe guximin e tij në organizimin e çështjes së tij, pastërtinë e tij në përpjekjen e tij dhe devocionin e tij, pa dyshim se mënyra e jetesës sonë do të ndryshojë plotësisht. Drita dhe lumturia do të përfshijë të gjitha anët e jetës sonë.

Sot, është detyrë e të gjithë myslimanëve, në mënyrë të veçantë, e rinisë myslimane, që të lexojnë historinë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ta mësojnë përmendësh atë dhe ta bëjnë atë model dhe shembull të tyre në çdo gjë, sepse kjo ndjekje është rruga e lumturisë, çelësi i fitores dhe i fuqisë.

3- Përmendeni shumë All'llahun

Porosia për përmendjen e All'llahut - e në mënyrë të veçantë përmendja e shpeshtë - përsëritet shpesh në ajetet kur'anore. Edhe transmetimet islame i kanë kushtojnë një rëndësi tepër të madhe kësaj çështjeje.

Në një hadith nga Ebu Dherr'rri, lexojmë: "Hyra në xhami dhe shkova te Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai më tha mua: *'E ke për detyrë që ta lexosh Librin e All'llahut dhe ta përmendësh shumë All'llahun, sepse*

1 "Uesailu Shiiah", vëll. 1, f. 356

leximi dhe përmendja e All'llahut është përkujtim për ty në qiell dhe dritë për ty në tokë.'".[1]

Në një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: "*Nëse robi e përmend Zotin e tij njëqind herë në ditë, ajo është e përmendje e shumtë."*.[2]

Në një hadith tjetër nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhet se ai u ka thënë shokëve të tij: "*A t'ju lajmëroj juve për veprën tuaj më të mirë, më të pastrën te mbreti juaj, më të lartën në gradat tuaja, më të mirë për ju se sa floriri dhe argjendi dhe më e mirë për ju se sa t'i hidheni armikut, duke e vrarë atë, ose duke ju vrarë ai juve?"*.

Ata thanë: "*Posi jo, o i Dërguari i All'llahut*.".

Ai tha: "*Përmendeni shumë All'llahun."*.[3]

Mirëpo as nuk mund të mendohet se qëllimi me përmendjen e All'llahut, me gjithë këtë mirësi, është vetëm përmendja me gjuhë e All'llahut. Transmetimet islame e kanë bërë të qartë se qëllimi mes atyre që u përmendën më sipër, është përmendja me zemër dhe vepra, domethënë se njeriu ta përmendë All'llahun, kur ai përballet me haramin dhe ta lërë atë.

Qëllimi i përmendjes së All'llahut, është që njeriu ta bëjë gjithmonë All'llahun fatin e syve të tij, ta ndiejë gjithmonë praninë dhe dëshminë e Tij, të mbjellë gjithmonë dritën e All'llahut në jetën e tij e të mendojë për të, ta përmendë gjithmonë

1 "El Khisal", sipas transmetimit të tefsirit "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 275.
2 "Sefinetul Bihar", vëll. 1, f. 484.
3 Burimi i mëparshëm.

All'llahun dhe të mos jetë i pavëmendshëm ndaj urdhëresave të Tij, por t'u bindet atyre.

Në një hadith thuhet se Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Nxitoni, duke bërë garë për Xhennetin.*".

Ata e pyetën: "*E çfarë është garimi i Xhennetit?*".

Ai tha: "*Të bëni takime ku të përmendet All'llahu.*".[1]

Qëllimi i këtyre takimeve është ringjallja e diturive islame, të shtrohen diskutime edukative, të cilat orientojnë edukimin e njerëzve dhe pastrojnë gjynahqarët, duke i shtyrë ata drejt rrugës së All'llahut.[2]

1 "Sefinetul Bihar", vëll. 2, f. 486.

2 Kemi pasur një hulumtim tjetër rreth rëndësisë së përmendjes së All'llahut dhe nocionit të saj, te fundi i ajetit 120 i sures "Er Rra'd".

Ajetet 26 – 27

وَأَنزَلَ ٱلَّذِينَ ظَـٰهَرُوهُم مِّنْ أَهْلِ ٱلْكِتَـٰبِ مِن صَيَاصِيهِمْ وَقَذَفَ فِى قُلُوبِهِمُ ٱلرُّعْبَ فَرِيقًا تَقْتُلُونَ وَتَأْسِرُونَ فَرِيقًا ﴿٢٦﴾ وَأَوْرَثَكُمْ أَرْضَهُمْ وَدِيَـٰرَهُمْ وَأَمْوَٰلَهُمْ وَأَرْضًا لَّمْ تَطَـُٔوهَا ۚ وَكَانَ ٱللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ قَدِيرًا ﴿٢٧﴾

"Ai i nxori nga kështjellat e tyre ithtarët e Librit që ndihmuan ushtrinë e aleatëve dhe mbolli frikë në zemrat e tyre, kështu që një pjesë të tyre i vratë dhe pjesën tjetër i zutë rob."

"Ai ju bëri trashëgimtarë të tokës, shtëpive dhe pasurive të tyre, si dhe të një toke që nuk e kishit shkelur më parë; All'llahu është i Fuqishëm për çdo gjë."

Komentimi

Beteja e Beni Kurejdha, është një tjetër triumf i madh

Në Medine kishte tri grupacione të njohura të jehudive: Beni Kurejdha, Beni Nedhir dhe Beni Kajnakau. Këto grupacione i kishin dhënë fjalën Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se nuk do ta ndihmonin armikun e tij (Muhammedit), as nuk do ta spiunonin atë tek armiku dhe do të jetonin në paqe me myslimanët. Por Beni Kajnakau e prishi marrëveshjen në vitin e dytë të hixhretit, kurse Benu Nedhiri, në vitin e katërt të hixhretit me lloj–lloj arsyesh. Ata ngulën këmbë të përballeshin me Profetin Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Rezistenca e tyre u shkatërrua. Ata u dëbuan jashtë Medines. Beni Kajnkau shkoi në rrethinat e Shamit. Një pjesë e Beni Nedhirit shkoi në Hajber, kurse një pjesë tjetër e tyre shkuan në Sham.[1]

Në bazë të kësaj, pa dyshim se Beni Kurejdha mbetën të fundit në Medine, deri në vitin e pestë të hixhretit, kur ndodhi lufta e Ahzabëve. Siç thamë në komentimin e shtatëmbëdhjetë ajeteve, që lidhen me luftën e aleatëve, ata e prishën marrëveshjen e tyre në këtë betejë, u bashkuan me idhujtarët arabë dhe ua drejtuan shpatat myslimanëve.

Pas përfundimit të luftës së Ahzabëve dhe tërheqjes së turpshme dhe çnderuese të kurejshëve dhe gatafanëve dhe të gjithë fiseve të tjera arabe nga Medineja, Profeti Muhammed

1 "El Kamil" i Ibn Ethirit, vëll. 2, f. 137 dhe 173

(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), sipas transmetimeve islame, u kthye në shtëpinë e tij. E hoqi mburojën e luftës dhe shkoi të lahej, kur, Xhebraili *(Paqja qoftë mbi të!)*, me urdhrin e All'llahut zbriti dhe i tha: "*Përse i hodhe armët e tua, kur këta engjëj janë përgatitur për luftë? Tani ti duhet të shkosh drejt Beni Kurejdhave dhe t'i japësh fund çështjes së tyre.*".

Nuk kishte rast më të mirë se sa ky për të larë hesapet me Beni Kurejdhat, kur myslimanët ishin në nxehtësinë e triumfit, kurse Beni Kurejdhat po e përjetonin hidhët mposhtjen. Mbi ta kishte pllakosur tmerri i madh, kurse aleatët e tyre, prej fiseve arabe, ishin të rraskapitur, pa asnjë fuqi të mbetur, të dobët në vendosmëri. Ata ishin rrugës së kthimit për në shtëpitë e tyre, duke tërhequr bishtin nga çadrat e tyre. Nuk kishte asnjë që t'i mbronte ata.

Dikush, me urdhër të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, thërret që të drejtohen drejt Beni Kurejdhave, para se të falet namazi i ikindisë. Myslimanët u përgatitën me shpejtësi që të shkonin në luftë, sapo të perëndonte dielli. Kështjellat e forta të Beni Kurejdhave u bllokuan plotësisht.

Kjo bllokadë zgjati njëzet e pesë ditë. Në fund u dorëzuan të gjithë. Një pjesë e tyre u vra. Në regjistrin e triumfeve të myslimanëve u shtua një tjetër triumf i madh. Toka e Medines u pastrua nga pisllëqet e këtyre hipokritëve dhe armiqve të vdekshëm, një herë e përgjithmonë.

Ajetet që po komentojmë, kanë treguar një histori të shkurtër dhe të detajuar për këtë ngjarje. Siç e kemi thënë, këto ajete zbritën pas triumfit dhe e bënë të qartë se kjo ngjarje ishte një

mirësi dhe dhuratë madhështore hyjnore. Ajeti 26 thotë: **"Ai i nxori nga kështjellat e tyre ithtarët e Librit që ndihmuan ushtrinë e aleatëve."**.

Fjala *"sajasi* (الصياصي *"* është shumësi i fjalës *"sajsijetun"*. Kuptimi i saj është: Kala e fortifikuar. Më pas u përdor për të gjitha mjetet mbrojtëse, si: brirët e lopëve, kthetrat e gjelit. Këtu bëhet e qartë se çifutët i kishin ndërtuar kalatë dhe kështjellat e tyre në anë të Medines në një pikë të lartë. Mënyra e të shprehurit me fjalën *"enzele"* e tregon këtë kuptim.

Pastaj ajeti shton: **"mbolli frikë në zemrat e tyre"**. Në fund, lajmëron çështjen e tyre: **"Një pjesë të tyre i vratë dhe pjesën tjetër i zutë rob."**.

Pa dyshim se këto fjali përfaqësojnë një përmbledhje dhe një anë të rezultateve të luftës së Beni Kurejdhave, ku një numër prej këtyre tradhtarëve u vra nga duart e myslimanëve, kurse të tjerët u robëruan. Myslimanët përfituan prej tyre plaçkë të madhe lufte. Njëra prej tyre ishin tokat, shtëpitë dhe pasuritë e tyre.

Mënyra e shprehjes për këtë plaçkë lufte, me fjalën *"irthun"* - *"trashëgimi"*, është se myslimanët nuk derdhën shumë mund për t'i marrë ato. Ato ranë me lehtësi në duart e tyre. E gjithë kjo plaçkë lufte ishte produkt i viteve të gjata të padrejtësisë dhe mizorisë së çifutëve dhe investimeve, përfitimeve të tyre në Medine.

Ajeti 27 thotë: **"Ai ju bëri trashëgimtarë të tokës, shtëpive dhe pasurive të tyre, si dhe të një toke që nuk e kishit shkelur më parë; All'llahu është i Fuqishëm për çdo gjë."**.

Mes komentuesve ka një kontradiktë për fjalinë: **"një toke që nuk e kishit shkelur më parë",** se çfarë synon dhe cila është kjo tokë.

Një pjesë ka mendimin se bëhet fjalë për tokën e Hajberit, e cila u çlirua më vonë me dorën e myslimanëve.

Të tjerë kanë mendimin se bëhet fjalë për tokën e Mekës.

Kurse disa të tjerë, mendojnë se tregon për tokat e Rrumit dhe të Persisë.

Disa mendojnë se tregon të gjitha tokat dhe vendet që ranë në dorën e myslimanëve, që nga ajo ditë dhe pas saj e deri në Ditën e Kiametit.

Asnjë prej këtyre supozimeve nuk është në harmoni me kontekstin e brendshëm të ajetit, në lidhje me kohën e shkuar të foljes, (*ju la trashëgim*). Koha e foljes tregon se kjo tokë u vu nën kontrollin e myslimanëve në ngjarjen e betejës së Beni Kurejdhave, duke shtuar se toka e Mekës, që është një nga komentimet e mëparshme, nuk ishte një tokë që myslimanët nuk e kishin shkelur, në kohën kur Kur'ani thotë: **"një tokë që nuk e kishit shkelur më parë"**.

Është e qartë se kjo fjali tregon për kopshtet dhe tokat e veçanta të Beni Kurejdhave, për të cilat asnjë nuk kishte të drejtë të hynte në to, sepse çifutët shpenzonin shumë për të ruajtur dhe për të mbrojtur pasurinë e tyre. Kjo ka një ngjashmëri të madhe me tokën e Hajberit, e cila është marrë nga çifutët pas një periudhe jo të gjatë dhe u vu nën kontrollin e myslimanëve. Beteja e Hajberit ka ndodhur në vitin e gjashtë hixhri.

Hulumtime

1- Beteja e Beni Kurejdhave dhe motivet e kësaj lufte

Kur'ani dëshmon se motivi kryesor i kësaj lufte ishte mbështetja që jehuditët Beni Kurejdha u dhanë idhujtarëve arabë dhe mbështetja e tyre në luftën e Ahzabëve, sepse ajeti thotë: **"ndihmuan ushtrinë e Ahzabëve"**.

Duhet të shtohet se jehuditët e Medines konsideroheshin kolona e pestë e armiqve të Islamit. Ata ishin shumë të zellshëm në informimin opozitar të Islamit dhe shfrytëzonin çdo rast të përshtatshëm që t'i shtypnin myslimanët dhe t'i vrisnin ata.

Siç e kemi thënë më parë, ky ishte grupi i fundit prej tri grupeve (Beni Kajnakau, Beni Nedhiri dhe Beni Kurejdha) që kishte mbetur në Medine në shpërthimin e luftës së Ahzabëve. Dy grupet e para u dëbuan në vitin e dytë dhe të katërt të hixhretit. Ky grup duhet të dënohej për veprat e tij të shëmtuara, të pista dhe për krimet e bëra. Ky grup kishte dalë hapur për të prishur marrëveshjen me armiqtë e Islamit.

2- Ngjarjet e luftës së Beni Kurejdhave

Ne kemi thënë se Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, menjëherë pas përfundimit të luftës së aleatëve, u urdhërua që t'i kërkojë llogari Beni Kurejdhave për punët e tyre. Thuhet se myslimanët nxituan të arrinin në muret mbrojtëse të Beni Kurejdhave, saqë disa u

treguan të pavëmendshëm për namazin e ikindisë dhe u detyruan ta falin kaza (jashtë kohës së saj). Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* urdhëroi që të rrethohen kështjellat e tyre. Ky rrethim zgjati njëzet e pesë ditë. All'llahu futi tmerrin e madh në zemrat e çifutëve, siç e tregon edhe Kur'ani.

Ka'b ibn Esedi, prej parisë së jehudive, tha: *"Unë jam i bindur se Muhammedi nuk do të na lërë, derisa të na vrasë. Unë ju propozoj juve tri çështje e ju zgjidhni njërën prej tyre:*

ose të bëjmë marrëveshje me këtë njeri, ta besojmë e ta ndjekim atë, pasi s'ka dyshim se ai jua ka vërtetuar juve se është Profet i All'llahut. Ju i gjeni shenjat e tij në librat tuaj. Në këtë rast, do t'u falen shpirtrat tuaj dhe pasuritë tuaja, bijtë e gratë tuaja.".

Ata thanë: *"Nuk e tradhtojmë kurrë ligjin i Teuratit dhe nuk e pranojmë zëvendësimin e tij me asgjë."*.

Ai tha: *"Meqenëse e refuzuat këtë, atëherë ejani t'i vrasim, para tyre, me duart tona, gratë tona dhe fëmijët tanë, që ta kemi edhe shpirtin të qetë. Pastaj rrokim shpatat dhe luftojmë Muhammedin dhe shokët e tij. Të shohim se çfarë dëshiron All'llahu. Nëse vritemi, atëherë nuk frikësohemi më për fëmijët dhe gratë tona. Nëse triumfojmë, do të shtojmë gratë dhe fëmijët."*.

Ata thanë: *"T'i vrasim këta të gjorë me duart tona? Atëherë, pas këtyre nuk do të kemi mirësi në jetën tonë."*.

Ka'b ibn Esedi tha: *"Nëse e refuzoni edhe këtë, atëherë dijeni se kjo natë është nata e të shtunës. Muhammedi dhe shokët e tij mendojnë se ne nuk i sulmojmë ata në këtë natë. Ejani, pra, t'i sulmojmë ata dhe t'i godasim. Mbase triumfojmë kundër tyre."*.

Ata thanë: *"As këtë nuk e bëjmë, sepse ne nuk e dhunojmë kurrë shenjtërinë e të shtunës."*.

Ka'bi tha: *"A nuk ka në mesin tuaj një burrë, që të logjikojë një natë të vetme, që kur e ka lindur nëna e tij?"*.

Pas kësaj ngjarje, kërkuan nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që t'u dërgojë atyre Ebu Lubaben, që të diskutojnë, të këshillohen me të. Kur ai erdhi dhe pa fëmijët e jehudive që qanin pas tij, zemra e tij u zbut. Ata i thanë: *"A mendon ti se ne mund t'i dorëzohemi vendimit të Muhammedit?"*.

Ebu Lubabe tha: *"Po."*.

Bëri me shenjë në qafën e tij, domethënë se do ju vrasë të gjithëve.

Ebu Lubabe thotë: *"Sapo u largova prej tyre, kuptova tradhtinë time. Nuk shkova menjëherë te Profeti Muhammed (Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), por shkova në xhami. U mbështeta në një kolonë dhe thashë: 'Nuk do ta fitoj pozitën time, derisa All'llahu të pranojë pendimin tim.'"*.

All'llahu ia pranoi pendimin prej sinqeritetit të tij dhe ia fali gjynahun. Më pas zbriti ajeti: **"Ndërkaq, disa të tjerë i pranojnë gjynahet e veta, se i kanë përzier veprat e mira me të këqijat. Ka gjasë që All'llahu t'ua pranojë pendimin. Vërtet, All'llahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë."**.[1]

1 Sure "Et Teube", ajeti 102.

Më në fund, Beni Kurejdhat u detyruan të dorëzohen pa kushte. Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"A jeni të kënaqur t'ju gjykojë Sa'd ibn Muadh?"*.

Ata thanë: *"Posi, duam."*.

Sa'di tha: *"Erdhi koha për Sa'din, që All'llahu të mos e vërë atë para mallkimit të dikujt."*.

Sa'di mori vendimin e ri për jehuditët, që ata të pranojnë me atë që gjykon. Pastaj e ktheu shikimin andej nga ku po qëndronte Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe tha: *"A është i zbatueshëm vendimi im mes jush?"*.

Ata thanë: *"Po."*.

Ai tha: *"Unë jap vendimin që të vriten burrat luftëtarë, kurse gratë dhe fëmijët e tyre të mbahen robër lufte. Pasuria e tyre të ndahet."*.

Një pjesë e madhe e tyre u bënë myslimanë dhe shpëtuan.[1]

3- Rezultatet e luftës së Beni Kurejdhave

Triumfi ndaj atij populli zullumqar, kokëfortë, fanatik, barti rezultate të çmuara për myslimanët. Disa prej tyre janë:

a) Pastrimi i frontit të brendshëm të Medines, sigurimi i myslimanëve dhe çlirimi i tyre prej spiunëve çifutë.

1 "Sijretu" i Ibn Hishamit, vëll. 3, f. 244 e më pas. "El Kamil", i Ibn Ethirit, vëll. 2, f. 185 e më tej shkurtimisht

b) Ra shtylla e fundit të idhujtarëve arabë në Medine dhe u pre shpresa e tyre, duke shkaktuar konfuzione dhe shqetësime të brendshme.

c) Myslimanët u forcuan financiarisht, nëpërmjet trofeve të kësaj lufte.

d) Hapja e horizonteve të reja të triumfeve të së ardhmes e në mënyrë të veçantë çlirimit të Hajberit.

e) Përforcimi i pozitës së qeverisë islame dhe prestigji i saj në shikimin e armikut dhe mikut, brenda dhe jashtë Medines.

4- Ajetet dhe shprehjet e tyre të thella

Një nga shprehjet që vihet re në ajetet e mësipërme, është ajo që thuhet në kapitullin e të vrarëve të kësaj lufte: **"një pjesë të tyre i vratë"**. Kjo shprehje i ka paraprirë fjalës *"ferijkan"* - *"një grup"* ndaj *"tektulune"* - *"vrisni"*, në kohën kur ajo e ka vënë fjalën *"një grup"* pas foljes *"te'surune"* - *"robëroni"*.

Disa komentues, për komentimin e kësaj shprehjeje, kanë thënë se arsyeja e shprehjes në këtë mënyrë është siguria ndaj personave në çështjen e të vrarëve, sepse kryetarët e tyre kanë qenë në grupin e të vrarëve, kurse për sa u përket robërve, ata nuk ishin njerëz të njohur, që e gjithë vëmendja të binte mbi ta, duke shtuar se edhe ky përparim dhe kjo vonesë ka çuar në atë që "vrasja" të shoqërohet me "robërimin". Këta janë dy faktorët e triumfit ndaj armikut, duke qenë në krah të njëri-tjetrit dhe duke ruajtur me më shumë kujdes harmoninë mes dy çështjeve.

Po kështu, përmendet zbritja e jehudive nga "kështjellat e tyre" para fjalisë: **"mbolli frikë në zemrat e tyre"** në kohën kur radhitja e vërtetë është e kundërta e saj, domethënë hapi i parë është hedhja e frikës, pastaj zbritja e tyre nga kështjellat mbrojtëse. Shkaku i këtij përparimi dhe vonimi është: E rëndësishme për myslimanët dhe ajo që i gëzon ata dhe që formonte synimin kryesor, ishte shkatërrimi i këtyre kalave të fortifikuara mirë.

Kurse mënyra e të shprehurit me: **"Ai ju bëri trashëgimtarë të tokës, shtëpive dhe pasurive të tyre"**, e bën të qartë të vërtetën se All'llahu i Madhëruar ju ka bërë juve autoritarë ndaj tokave, shtëpive dhe pasurive të tyre, pa shpenzuar shumë energji në këtë luftë.

Në fund, ajeti përqendrohet te fuqia e All'llahut, sepse Ai i mposhti grupacionet me erëra, me ciklone dhe me ushtri të padukshme. Një ditë tjetër mundi ndihmësit e tyre, domethënë jehuditët e Beni Kurejdhave, me ushtrinë e frikës dhe të tmerrit.

Ajetet 28 – 30

يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّبِيُّ قُل لِّأَزۡوَٰجِكَ إِن كُنتُنَّ تُرِدۡنَ ٱلۡحَيَوٰةَ ٱلدُّنۡيَا وَزِينَتَهَا
فَتَعَالَيۡنَ أُمَتِّعۡكُنَّ وَأُسَرِّحۡكُنَّ سَرَاحٗا جَمِيلٗا ٢٨ وَإِن كُنتُنَّ تُرِدۡنَ
ٱللَّهَ وَرَسُولَهُۥ وَٱلدَّارَ ٱلۡأٓخِرَةَ فَإِنَّ ٱللَّهَ أَعَدَّ لِلۡمُحۡسِنَٰتِ مِنكُنَّ أَجۡرًا
عَظِيمٗا ٢٩ يَٰنِسَآءَ ٱلنَّبِيِّ مَن يَأۡتِ مِنكُنَّ بِفَٰحِشَةٖ مُّبَيِّنَةٖ يُضَٰعَفۡ لَهَا
ٱلۡعَذَابُ ضِعۡفَيۡنِۚ وَكَانَ ذَٰلِكَ عَلَى ٱللَّهِ يَسِيرٗا ٣٠

"O i Dërguar! Thuaju grave tuaja: 'Nëse dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani, unë do t'ju lë të kënaqeni për ca kohë dhe do t'ju lëshoj si është më mirë.'"

"Por, nëse dëshironi All'llahun, të Dërguarin e Tij dhe Botën Tjetër, dijeni se All'llahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë vepra të mira."

"O gratë e të Dërguarit! Ato prej jush që bëjnë ndonjë turp të hapur, do të kenë ndëshkim të dyfishtë; kjo për All'llahun është e lehtë."

Shkaku i zbritjes së ajeteve

Komentuesit kanë përmendur shumë shkaqe për zbritjen e këtyre ajeteve. Ato nuk ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra, nga ana e rezultatit. Nga shkaqet e zbritjes përftohet, se gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kërkuan prej tij gjëra të ndryshme, sepse, pas disa luftërave, u shtuan shpenzimet apo nevojat e jetës, pasi myslimanëve u siguroi shumë plaçkë lufte.

Sipas transmetimit të disa komentimeve, Ummu Seleme i kërkoi Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* një shërbëtor për veten e saj. Mejmune kërkoi dekorime. Zejneb bintu Xhahsh dëshiroi copa, pëlhura të veçanta nga Jemeni. Hafsaja rroba egjiptiane. Xhuvejre rroba të veçanta. Seuda, basma prej Hajberi. Rezultati ishte se secila prej tyre dëshironte diçka. Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u frenua që t'u përgjigjej kërkesave të tyre. Ai e di mirë se dorëzimi para këtyre kërkesave, të cilat nuk mbarojnë, do t'i bartë atij dënime. Ai i izoloi një muaj gratë e tij. Më pas zbritën ajetet e mësipërme, duke u folur atyre me tonin e kërcënimit, me vendosmëri, të përzier me dhembshuri dhe mëshirë, duke u thënë, se, nëse ju e dëshironi jetën të mbushur me stolitë e dynjasë dhe bukuritë e saj, atëherë ju mund të ndaheni nga Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe të shkoni ku të dëshironi. Nëse pëlqeni lidhjen tuaj me All'llahun, me të Dërguarin e Tij dhe Ditën e Fundit dhe kënaqeni me jetën e thjeshtë të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi*

familjen e tij!), duke kërkuar krenarinë, atëherë qëndroni me të dhe kënaquni me dhuratat madhështore të All'llahut.

Me këtë përgjigje të prerë, ajetet iu përgjigjën grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, të cilat prisnin jetë luksoze dhe u la atyre të zgjedhin mes qëndrimit bashkë me Profetin Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ndarjes prej tij.

Komentimi

Ose lumturinë e përhershme, ose stolitë e dynjasë

Ju nuk keni harruar se ajetet e para të kësaj sureje i kanë kurorëzuar gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me kurorën e krenarisë. I ka quajtur ato **"nëna të besimtarëve"**. Është e padiskutueshme se vlera dhe pozita e ndjeshme që induktohet nga krenaria, shoqërojnë përgjegjësi të rënda, pasi, si mund të jenë gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nënat e besimtarëve, kur zemrat dhe mendimet e tyre janë të zëna me dashurinë e kësaj bote dhe mashtrimet e saj?

Kështu kishin menduar, pasi përfitimi prej plaçkave të luftës, të cilat ranë në duart e myslimanëve, do të ishte më i

madhi dhe më i çmueshmi, si të gjitha gratë e mbretërve dhe të perandorëve, në kohën kur këtu dhe atje jetojnë njerëz në kulmin e varfërisë.

Pa dyshim, Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk duhet të jetë vetëm ai shembull për njerëzit, sipas ajeteve të mëparshme, madje edhe familja e tij duhet të jetë shembull për të gjitha familjet e tjera. Gratë e tij duhet të jenë model për gratë besimtare, derisa të bëhet Kiameti, sepse Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk është mbret dhe perandor, që të ketë harem (suitë) të veçantë për gratë dhe ato t'i mbulojë me bizhu dhe gurë të çmuar.

Mbase ka pasur një grup myslimanësh muhaxhirë (emigrantë), të cilët kanë ardhur në Medine dhe vazhdojnë të kalojnë netët e tyre nën atë strehë (ai është një vend i veçantë që ishte në krah të xhamisë së Profetit Muhammed). Ata nuk kanë në atë qytet as të afërm, as shtëpi. Në situata të tilla, Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk mund t'ua lejojë grave të tij gjithë atë luks.

Nga disa transmetime lexojmë se disa bashkëshorte të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i folën ashpër atij. Ato i kishin thënë se, edhe po t'i ndante Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ato do të gjenin burrë nga kombi i tyre, njësoj si ai.[1]

1 "Kenzul Urfan", vëll. 2, f. 238

Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është urdhëruar këtu që të përballet me vendosmëri me këtë çështje dhe t'ua bëjë atyre të qartë situatën e tij të përhershme.

Ajeti 28 i flet Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"O i Dërguar! Thuaju grave tuaja: 'Nëse dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani, unë do t'ju lë të kënaqeni për ca kohë dhe do t'ju lëshoj si është më mirë.'"**.

Fjala *"umettiukunne"* rrjedh nga fjala *"mut'atun"* dhe, siç kemi thënë në ajetin 236 të sures "El Bekare", ajo do të thotë udhëzim, që harmonizon situatat e gruas. Ajo që nënkuptohet këtu është sasia e përshtatshme, e cila i shtohet mehrit. Nëse mehri nuk është i përcaktuar, atëherë ai ia jep atë dhuratë të përshtatshme për gjendjen e saj, që ta kënaqë dhe ta gëzojë atë. Ndarja e saj bëhet në një atmosferë të qetë, e mbushur me dashuri.

Rrënja e fjalës *"es serahu"* rrjedh nga fjala *"sareha"*, domethënë pema që ka gjethe dhe fryt. Fjala *"serahtu el ibile"* do të thotë, e lashë të lirë devenë të hajë bar dhe gjethet e pemëve. Pastaj u përdor me kuptim më të gjerë, për çdo lloj lirimi, për çdo gjë dhe për çdo person. Ndonjëherë vjen si nënkuptim i divorcit dhe thuhet *"tesrihu sha'ri"*, për krehjen e flokëve dhe zbukurimin e tyre. Ka edhe kuptimin e gjuajtjes. Megjithatë, ajo që ka për synim fjala *"es sirahul xhemil"*, në këtë ajet, është divorci i grave, i shoqëruar me mirësi, që nuk ka mizori dhe padrejtësi.

Për komentuesit dhe dijetarët e jurisprudencës islame, këtu ka një diskutim të detajuar në zgjedhjen që Profeti Muhammed

(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) u ka bërë grave të tij. Nëse nuk e zgjedhin ndarjen, pa dyshim se ajo konsiderohet plotësisht ndarje dhe nuk ka nevojë për zbatimin e formulës së ndarjes, sepse ato zgjedhin një nga të dyja rrugët. Nëse e duan ndarjen, Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* zbaton formulën e ndarjes, kurse në të kundërt, mbeten në gjendjen e tyre.

Nuk ka dyshim se ajeti nuk flet për asnjërën prej këtyre dy çështjeve. Ajo që mendojnë disa se një pjesë e ajetit tregon për përzgjedhjen e grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e kanë konsideruar këtë ligj të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ai nuk e zbaton për të gjithë njerëzit, nuk duket i vërtetë, përkundrazi, s'ka dyshim se bashkimi mes ajetit të mësipërm dhe ajeteve të divorcit, e bën të domosdoshme që të ketë si qëllim mënyrën e ndarjes.

Kjo çështje është burim debati mes dijetarëve shi'itë dhe atyre syni (traditës Profetike). Thënia e dytë, domethënë ndarja nëpërmjet divorcit, duket më e afërt me kontekstet e brendshme të ajeteve. Në një vend tjetër të Kur'anit, te surja "El Bekare", te ajeti 229, është përdorur me kuptimin e divorcit.[1]

Ajeti 29 shton: **"Por, nëse dëshironi All'llahun, të Dërguarin e Tij dhe Botën Tjetër, dijeni se All'llahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë vepra të mira."**.

1 Për sqarime të mëtejshme shih librat e Jurisprudencës veçanërisht librin "El Xheuahir", vëll. 29, faqe 122 e më pas.

Ky ajet ka bashkuar të gjitha bazat e besimit dhe moralin e besimtarit, pasi, nga njëra anë, është mënyra e besimit, bindjes ndaj All'llahut dhe të Dërguarit dhe Ditës së Fundit, kurse, nga ana tjetër, është programi praktik dhe të qenit e njeriut në radhët e punëmirëve. Në bazë të kësaj, shfaqja e dashurisë së All'llahut, lidhja me Profetin Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe besimi në Ditën e Fundit nuk është e mjaftueshme, përkundrazi programet praktike duhet të harmonizohen me këtë dashuri dhe pasion.

Me këtë, All'llahu i Madhëruar ka bërë të qartë obligimin e grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe detyrën e tyre, që të jenë gjithmonë shembull për besimtaret, sepse ato janë karakterizuar me indiferentizmin ndaj stolive dhe zbukurimeve të kësaj bote, por t'i japin më shumë rëndësi besimit, punës së mirë dhe ngritjes lart të shpirtit, pasi ato mbeten bashkëshortet e Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e meritojnë këtë nderim. Në të kundërt, ato duhet të ndahen nga ai, ose të mbajnë distancë nga ai.

Edhe pse adresimi në këtë ajet u bëhet grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, përmbajtja e ajeteve dhe rezultati i tyre i përfshin të gjithë. Në mënyrë të veçantë atë që është në pozitën e udhëheqjes së njerëzve dhe është shembull për ta, sepse këta janë gjithmonë në rrugë të ndara, ose të përfitojnë nga pozita e dukshme për të arritur një jetë materiale luksoze, ose të qëndrojnë në privimin e tyre, në favor të kënaqësisë së All'llahut të Madhëruar dhe udhëzimit të krijesës së Tij.

Ajeti 30 qartëson vendin e grave të Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* para veprave të mira. Gjithashtu, me shprehje të qarta qartëson pozitën e tyre të veçantë dhe përgjegjësitë e tyre të mëdha: **"O gratë e të Dërguarit! Ato prej jush që bëjnë ndonjë turp të hapur, do të kenë ndëshkim të dyfishtë; kjo për All'llahun është e lehtë."**.

Ju jetoni në shtëpinë e Shpalljes dhe në qendrën e profecisë. Dituria juaj në çështjet islame është më e madhe se te të gjithë njerëzit, për shkak të lidhjes suaj të vazhdueshme me Profetin Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe takimit me të. Duhet të shtohet se të tjerët ju shikojnë juve dhe i marrin veprat tuaja si shembull. Në bazë të kësaj, pa dyshim se edhe gjynahu juaj është më i madh tek All'llahu, sepse shpërblimi dhe dënimi bëhet në bazë të njohurisë dhe masës së diturisë, sepse ju keni një fat edhe më të madh se dituria. Ju keni një vend të veçantë, që ka ndikimin e tij në shoqëri.

Kundërshtimi juaj, nga njëra anë, e lëndon Profetin Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, kurse nga ana tjetër, i jep një goditje qenies dhe qendrës së tij. Kjo konsiderohet një gjynah tjetër dhe e bën të obligueshme një tjetër dënim.

Shprehja "*el fahishetul mubejjine*" tregon për gjynahet e bëra hapur. Ne e dimë, se të këqijat që rrjedhin nga gjynahet që i bëjnë njerëz të lartë, janë më të shumta kur bëhen hapur.

Fjala e All'llahut: **"kjo për All'llahun është e lehtë"**, tregon se gjithçka për All'llahun është e lehtë, pavarësisht lidhjes suaj me Profetin Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi*

të dhe mbi familjen e tij!), duke menduar se kjo lidhje do të jetë pengesë për All'llahun. Jo, kurrë. Nuk ka dyshim se ky ligj do të zbatohet në të drejtën tuaj me të gjithë rigorozitetin.

Hulumtim

Përse dyfishohet shpërblimi dhe dënimi i njerëzve të lartë?

Kemi thënë: Ky ajet, flet për gratë e Profetit Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, se ato, nëse i binden All'llahut, e kanë dyfish shpërblimin dhe, nëse bëjnë gjynah të hapur, atëherë kanë dyfish dënimin për atë që kanë bërë. Meqenëse standardi kryesor i dënimit dhe i shpërblimit është pozita, vendi i lartë dhe karakteri i hapur shoqëror, atëherë ky ligj është i zbatueshëm edhe për personat e tjerë, të cilët kanë një pozitë të rëndësishme shoqërore.

Sjellja dhe morali i këtyre njerëzve nuk është i veçantë vetëm për ata, madje prania e tyre është dydimensional: një dimension që lidhet me ta dhe një dimension që lidhet me shoqërinë. Stili i jetës së tyre mund të jetë shkak i udhëzimit të një grupi njerëzish, ose i humbjes së një grupi tjetër.

Duke u bazuar në këto që thamë, nuk ka dyshim se ka dy ndikime të veprave të tyre: Njëri prej tyre është personal, kurse tjetri është shoqëror. Për secilin ka një shpërblim dhe një dënim. Në këtë kontekst, lexojmë një hadith nga Imam Sadiku *(Paqja qoftë*

mbi të!): *"Injorantit i falen shtatëdhjetë gjynahe, para se dijetarit t'i falet një mëkat."*.[1]

S'ka dyshim se lidhja është një instrument mes standardit të diturisë dhe masës së shpërblimit dhe dënimit, siç thuhet në disa hadithe të tjera fisnike, ku lexojmë: *"Nuk ka dyshim se shpërblimi është sipas mendjes."*.[2]

Në një hadith tjetër të Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)* thuhet: *"Në Ditën e Kiametit, All'llahu u bën robërve të shijojnë llogarinë sipas masës së asaj që u ka ardhur atyre në dynja prej mendjes, diturisë."*.[3]

Në një transmetim tjetër të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, thuhet: *"Nëse shpirti arrin këtu - dhe tregoi me dorën e tij fytin - nuk ka pendim për dijetarin.* Pastaj lexoi: **'All'llahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga padituria dhe pendohen shpejt. Pra, këtyre All'llahu ua pranon pendimin. All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.'"**.[4]

Tashmë bëhet e qartë se mbase kuptimi i dyfishimit, ishte për shtimin, pasi një herë është dyfish, kurse një herë tjetër është disa herë më shumë, njësoj si te numrat që kanë cilësinë e shumimit. Rragibi në librin e tij "El Mufredat" për kuptimin e dyfishimit thotë: *"daaftuhu"*, *"i shtova atij"* do të thotë: i garantova atij shpërblim të njëjtë e më shumë. (Shikojeni me kujdes!)

---

1 "Usulul Kafij", vëll. 1, kreu "Domosdoshmëria e argumentit për dijetarin", f. 37

2 Burimi i mësipërm, f. 9 (kreu: el aklu uel xhehlu)

3 Burimi i mësipërm

4 Burimi i mësipërm, kreu "Domosdoshmëria e argumentit për dijetarin", f. 38; ajeti 17 i sures "En Nisa"

Tregimi që përmendëm pak më parë, rreth ndryshimit të gjynahut të dijetarit dhe injorantit, deri në shtatëdhjetëfish, është një dëshmi tjetër për këtë pohim.

Numërimi i shtresave të njerëzve dhe ndryshimi i ndikimit të tyre në shoqëri, si rezultat i ndryshimit të pozitës së tyre shoqërore dhe të qenit të tyre shembull, e bën të domosdoshme që shpërblimi dhe dënimi hyjnor të jetë me atë shkallë relative.

E përfundojmë këtë diskutim me një hadith nga Imami shumë adhurues, Ali ibn Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)*. Një burrë i kishte thënë atij se pjesëtarët e Ehli Bejtit janë të falur. Ali ibn Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)* u zemërua dhe tha: *"Ne jemi më të merituar që All'llahu të zbatojë për ne atë që zbatoi për gratë e Profetit Muhammed (Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), që të jemi ashtu siç thua. Ne mendojmë se punëmiri ynë ka shpërblimin dyfish, kurse punëkeqi ka dënimin dyfish."*. Pastaj lexoi dy ajetet."[1]

1 Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 8, f. 354, fundi i ajetit është burimi i komentimit.

PËRMBAJTJA

TEMA
Ajetet 46 – 49.....5
Komentimi.....6
Ndiqni metodën më të mirë në dialog e në hulumtim.....6
Hulumtime.....16
I Dërguari i pashkolluar.....16
Rrugët e depërtimit tek të tjerët…….....19
Jobesimtarët dhe të padrejtët…….....22
Ajetet 50 – 55……..23
Komentimi.....24
A nuk është i mjaftueshëm Kur'ani për mrekullinë e tij?.....24
Hulumtime.....34
Argumentet e mrekullisë së Kur'anit.....34
Mbështjetja te hilet për mohimin e mrekullive……34
Mrekullitë e propozuara.....35
Ajetet 56- 60.....36
Shkaku i zbritjes…….....37
Komentimi…….38
Patjetër duhet emigrimi (hixhreti)……..38
Ajetet 61 – 66.....45
Komentimi……..46
Pohimi i monoteizmit nga brenda dhe i politeizmit nga jashtë…….46
Hulumtim……..54
Fatkeqësitë dhe ndriçimi i natyrës së krijuar fillestare *(el fitretu)*…..54
Ajetet 67 – 69.....56
Shkaku i zbritjes.....57
Komentimi……57
Dy hulumtime…….....61
Xhihadi dhe sinqeriteti…….....61

Njerëzit janë tre llojesh…….....……...…63
Sure "Er Rrum"…….....……65
Përmbajtja e sures "Rrum"…….....…….66
Mirësitë e leximit të kësaj sureje…….....…..67
Ajetet 1 – 7…….....…69
Shkaku i zbritjes.....70
Komentimi.....71
Parashikimi i habitshëm.....71
Çfarë është gëzimi i besimtarëve?.....74
Hulumtime.....77
Mrekullia e Kur'anit.....77
Sipërfaqësorët……...…….78
Përshtatshmëria historike……...…….80
Ajetet 8 – 10……...…82
Komentimi……...…83
Fundi i keqbërësve……...……...…..83
Ajetet 11 – 16……88
Komentimi……..89
Përfundimi i kriminelëve dhe vendi i tyre në Ditën e Kiametit…….89
Hulumtim……...92
Përse një prej emrave të Ditës së Kiametit është "Es Saatu"?.....92
Ajetet 17 – 19…….....94
Komentimi……...……95
Lartësimi dhe falënderimi në përgjithësi - janë vetëm për All'llahun……...……...95
Ajetet 20 – 22…….....…101
Komentimi……...……..102
Ajetet 23 – 25……...…111
Komentimi……...…112
Edhe një herë argumente të madhështisë së Tij……..112
Hulumtime……...…….119
1- Mësime për njohjen e All'llahut……119

2- Cilët janë të inspiruarit në këto ajete?.....119
3- Mrekullitë e botës së gjumit…….…....121
4- Lidhja e dashurisë midis dy bashkëshortëve…….123
Ajetet 26 – 29……..……..…..125
Komentimi……...…….126
Sundimi i takon vetëm All'llahut…….……126
Ajetet 30 – 32.....135
Komentimi.....136
Dy hulumtime……..…...…143
1- Teuhidi është një motiv i brendshëm dhe i forte……...143
2- Natyrshmëria e Teuhidit në transmetimet islame……...…….151
Ajetet 33 – 36……154
Komentimi……155
Ajetet 37 – 40…….……..162
Komentimi……163
Ajetet: 41 – 45…….....175
Komentimi……..……..176
Origjina e shkatërrimit dhe burimi i tij janë vetë punët e njerëzve…….…..176
Hulumtime…….……..182
1- Lidhja mes gjynahut dhe shkatërrimit……..…182
2- Filozofia e të ecurit në Tokë……..…….185
3- Feja e vërtetë……...…….187
4- Nuk ka rikthim prapa në Ditën e Kiametit……..…188
Ajetet: 46 – 50…….……189
Komentimi……190
Shiko gjurmët e mëshirës së All'llahut!.....190
Ajetet: 51 – 54……..……199
Komentimi……200
Vetëm të vdekurit dhe shurdhët nuk e dëgjojnë fjalën Tënde……200
Ajetet: 55 – 60……...….207
Komentimi……..……..208

Atë Ditë që nuk bën dobi arsyetimi……...…….208
Dy hulumtime…….210
Sure "Lukman"……..218
Përmbajtja e sures……...…….219
Mirësia e leximit të sures "Lukman"……...…….221
Ajetet: 1 – 5……222
Komentimi……..…….223
Kush janë punëmirët?.....223
Ajetet: 6 -9……226
Shkaku i zbritjes……..…227
Komentimi……....228
Kënga është një nga kurthet më të mëdha të shejtanëve……..228
Hulumtime……...234
1- Ndalimi i të kënduarit *(el ginau)*……...…234
2- Çfarë është kënga?.....237
3- Filozofia e ndalimit të këngës……...…239
Ajetet: 10 – 11……..…243
Komentimi……..…….244
Ky është krijimi i All'llahut……..…….244
Ajetet: 12 – 15……249
Komentimi…….……..250
Respekti i prindërve……...…250
Çfarë është urtësia?.....252
Dy hulumtime……..……...……259
1- Kush është Lukmani?.....259
2- Portrete nga urtësia e Lukmanit……...…..…261
Ajetet: 16 – 19……265
Komentimi……...…….266
Qëndro si mali dhe sillu mirë me njerëzit…….…..266
Hulumtime…….……..271
1- Kultura e të ecurit…….…..271
2- Kultura e të folurit…….……273

3- Kultura e shoqërimit.....274
Ajetet: 20 – 24……276
Komentimi……277
Ajetet: 25 – 30……286
Komentimi……..……..287
Dhjetë sifatet (cilësitë) e All'llahut të Madhëruar:…….. …..287
Ajetet: 31 – 32……298
Komentimi……..…..299
Në vazhdimësinë e fatkeqësisë……...……..299
Ajetet: 33 – 34……305
Komentimi……..……..306
Dituria e gjerë e All'llahut……...…306
Hulumtime……..…….310
1- Llojet e hiles dhe të mashtrimit……310
2- Mashtrimi i dynjasë……311
3- Këto pesë njohuri janë specifike për All'llahun……312
Sure ''Sexhde''……316
Mirësia e leximit të kësaj sureje……..……..317
Përmbajtja e sures "Sexhde"…….318
Ajetet: 1- 5……320
Komentimi……....321
Madhështia e Kur'anit, zanafilla e Krijimit dhe Ringjallja……..…..321
Hulumtim…….……332
Keqpërfitimi nga ajeti *"Ai është që udhëheq çështjen"*……...……332
Ajetet: 6 – 9……..338
Komentimi……...…….339
Fazat e habitshme të krijimit të njeriut!.....339
Hulumtim…….……342
Mënyra e krijimit të Ademit prej dheut……..……342
Ajetet 10 – 14……..346
Komentimi……..……..347
Pendimi dhe kërkesa për t'u kthyer pas edhe një here…….....347

Dy hulumtime……...……..355
1- Pavarësia dhe origjinaliteti i shpirtit ……..…….355
2- Engjëlli i vdekjes……...……...356
Ajetet 15 – 20……..……359
Komentimi……360
Shpërblime të mëdha që askush nuk i di…….360
Hulumtim…….……371
Ata që rrinë zgjuar natën……...……...….371
Ajetet 21 – 22……..…375
Komentimi……...…….375
Dënime edukative ……...…...…….375
Ajetet 23 – 25……..….380
Komentimi……381
Kushti i udhërrëfimit është durimi dhe besimi……...……...381
Hulumtim…….……388
Mbështetja dhe qëndrimi në rrugën e drejtë i udhëheqësve hyjnorë…….……388
Ajetet 26 – 30……..……391
Komentimi……392
Dita e triumfit tonë …….……392
Sure "El Ahzab"……399
Shkaku i emërtimit dhe mirësia e saj……...……400
Përmbajtja e sures "El Ahzab"…….……401
Ajetet 1 – 3……..403
Shkaku i zbritjes…….....…404
Komentimi……405
Ndiq vetëm Shpalljen e All'llahut……...……405
Ajetet 4 – 6……...…409
Komentimi……410
Pretendime boshe …….……..410
Hulumtim…….……430
Ajetet 7 – 8……..…432

Komentimi……432
Besa e fortë e All'llahut……..……432
Ajetet 9 – 11……..……438
Komentimi……....439
Sprova e madhe e All'llahut në përballjen me Ahzabët……....439
Ajetet 12 – 17……..447
Komentimi……448
Hipokritët në oborrin e Ahzabëve *(grupacioneve, partive)*…….……448
Ajetet 18 – 20……459
Komentimi…….……..460
Grupi pengues……....…460
Ajetet 21 – 25……466
Komentimi……..…..467
Roli i besimtarëve të sinqertë në luftën e grupacioneve *(Ahzabëve)*….467
Hulumtime……..……477
1-Shënime të rëndësishme për betejën e Ahzabëve……..477
2- Profeti Muhammed *(Paqja dhe begatia e All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është shembull për të gjithë……..493
3- Përmendeni shumë All'llahun……..495
Ajetet 26 – 27……..…..498
Komentimi……..…..499
Beteja e Beni Kurejdha, është një tjetër triumf i madh……...…499
Hulumtime……...…503
1- Beteja e Beni Kurejdhave dhe motivet e kësaj lufte……...503
2- Ngjarjet e luftës së Beni Kurejdhave……...…….503
3- Rezultatet e luftës së Beni Kurejdhave……...…….506
4- Ajetet dhe shprehjet e tyre të thella…….…….507
Ajetet 28 – 30……509
Shkaku i zbritjes së ajeteve……..…..510
Komentimi……511
Ose lumturinë e përhershme, ose stolitë e dynjasë……...511
Hulumtim…….517
Përse dyfishohet shpërblimi dhe dënimi i njerëzve të lartë?.....517

ألأمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء الحادي و العشرون

تيرانا: 2019

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء بیست و یک)

نویسنده: فقیه مفسّر حضرت آیة الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: وُلْنَتْ مِرْيَا & ادموند عباسی

زیر نظر: وُلْنَتْ مِرْيَا

ویرایش: لیسدا رامای، اسعد بونگوری، یریدا کولا

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2019